Muharrem BLAKAJ

PARAARDHËSIT

roman

Prishtinë, 2009

Muharrem Blakaj
Paraardhësit

Paraardhësit, Roman

Copyright© 2009, Muharrem Blakaj

Ndalohet botimi, ribotimi dhe botimi i pjesshëm pa lejen e autorit

Muharrem BLAKAJ

PARAARDHËSIT

Roman

„KOMBI” (IKDFK)

Prishtinë, 2009

Redaktor
Mustafë Xhemaili

Lektor
Gëzim Llapaj

Ballina
Skënder Hajdari

Realizimi kompjuterik
Ahmet Blakaj

Boton „KOMBI” (IKDFK) - Prishtinë

Copyright 2009
Të gjitha të drejtat janë të autorit

Secili mbahet i mirë edhe i thotë vetit:
„Jam burrë“ e i thonë: „A je burrë!“

Kanuni i Lekë Dukagjinit, neni 888 Fq. 84

KTHIMI

Pas katër vitesh qëndrimi në mesin e studentëve të bekuar të islamit, më në fund arrita në katundin tim. Gjatë kohës sa ndodhesha atje, vendlindja mu kishte fshirë pothuaj e tëra nga kujtesa. I dhënë pas studimeve në njërën anë dhe pas shtegtimeve për kalitje e përzgjedhje në anën tjetër, dalëngadalë kisha filluar ta braktisja nga mendja imazhin e vendit tim të dikurshëm, përveç disa copëzave peizazhesh, që si pasqyrë e thyer, herë pas here kishin lundruar, si të përgjumura, në kujtesën time të kthjelluar nga nuri i ndritur i Allahut xhel-le shanuhu[1]. Kur shkela për herë të parë në katundin tim, mu bë se çdo gjë kishte lëvizur nga vendi duke ndërruar pozicionin. Ajo pamje që më kishte mbetur e ngulitur në mendje kur e braktisa katundin, kishte ndryshuar rrënjësisht, sa që kur e pashë për herë të parë nuk ju besova syve. Por, për

1 *Arab. I lartësuar*

fat të mirë, ashtu siç kishte ndryshuar vendi im i nëmur, kisha ndryshuar edhe unë, duke marrë pamje tjetër, identitet tjetër, veshje tjetër... në vend që në vazhdimësi të qëndroja flokëgjatë e fytyrërruar si grua, tani jam shndërruar në kryerruar, mustaqeprerë e mjekërsynet, në vend të emrit të pakuptimtë Çelë, tani mbaj emrin e ndritur të Allahut, Abdallah, në vend që të jem shqiptar, jam shndërruar në mysliman dhe në vend që të flas shqip, tani e flas gjuhën e bekuar të Allahut xhel-le shanuhu! A ka gjë më të bukur në jetë së të komunikosh me gjuhën e Allahut?... e mos të flas më për rrobat e bekuara islame që i mbaj në trup! El-hamduli-l-lah![2]

Pas luftës, nga katundi im nuk kishte ngelur asgjë e dashur e tërheqëse që duhej rikujtuar përveç shtëpive të djegura, erës së rëndë të tymit të përzier me duhmë kërme të shtazëve të vrara nga paramilitarët! Fill pas këtyre, desha t'i fshij nga mendja edhe njerëzit, që, të pasionuar pas kryqit të perëndimit, kishin lënë rrugën e Allahut xhel-le shanuhu dhe ishin bërë një me idhujtarët e pafe, të njëjtë sikur ata që shekuj me radhë na kishin vrarë e therur si në kasaphanë, dhe të pasionuar pas të pafeve bërtisnin si të çmendur: Amerika, Amerika! Jazëk!

Kur po kaloja pranë trojeve të Avdiut, në shpirt ndjeva një ngazëllim çasti. Nëpër mendje filluan të më lundrojnë kujtimet e kohës së shkuar: Kur isha i vogël, e kisha bërë zakon që ditë për ditë të hidhesha andej nga shtëpia e Avdiut dhe të takohesha me Hilin. Pastaj së bashku ngjiteshim të Lëndina e Milushit duke vrapuar pas manaferrave të pjekura. Na bëheshin duart dhe fytyra zi

2 *Falënderimi i qoftë Allahut*

prej tyre. Herë pas here zbrisnim të Krojzit ku ishte pusi i kalfët dhe aty i lanim duart dhe fytyrën. Pastaj e prisnim Maksutin kur zbriste nga mali pas dhive të tij të kuqe. Derisa dhitë e tij pinin ujë në pus, ne e përqeshnim për sytë e tij të fryrë që na ngjanin në sy hutini. Ai në shenjë revolte vetëm gajasej dhe ikte me nxitim pas dhive të tij të shpejta. Edhe tani më bëhet sikur i shoh veshët e tij vriguj dhe disa fije flokësh të djersitura e të ngatërruara sipëri tyre. Herë pas here Hili e gjuante me llastik qenin e Maksutit që vraponte pas dhive me gjuhën përjashta. Sa herë që e godiste, cijatej dy tri herë dhe ikte me vrap. Vetëm kur largohej në distancë Maksuti i zemëruar kthehej e na e këpuste ndonjë të sharë me zë të ultë sa ne mëzi e dëgjonim, apo na kërcënonte së do të vinte një ditë që do të hakmerrej kundër nesh. Kishte ditë kur zbrisnim pranë kajsive që ndodheshin pranë mullirit të moçëm dhe pasi ngopeshim, e gjuanim njëri-tjetrin me kokrrat e arrira që lëshonin lëng të verdhë! Buzëmbrëmjes zinim pritë tek bërryli i rrugicës dhe bashkë me Hilin i gjuanim me llastik lopët e fqinjëve kur ktheheshin nga kullosa. Kur na diktonte Avdiu, baba i Hilit, nevrikosej... më mirë të them se nxehej deri në atë masë, aq sa mund të nxehej një njeri i butë siç ishte Avdiu. Çdo gjë përfundonte me marrje llastiqesh, fjalë kërcënuese dhe tundje gishti. Kishte raste kur Hili nuk ndodhej në shtëpi. Atëherë pa hezitim e kërkoja Maksutin. Gjithë ditën bridhja pas tij dhe dhive të tij tekanjoze. Kur pushonim në rrafshin e hamallave, nën hijen e blinit, ai zbathej dhe futej në pusin e kalfët për të zënë bretkosa. Pasi i nxirrte në breg i therte me briskun e tij të vogël, duke thënë: *Kështu do ta ther edhe Hilin një ditë... ke për të parë!...* dhe pastaj

për një copë herë nuk pushonte së gajasuri në atë stilin e tij si prej të marri! Derisa e shikoja, më vinte keq për bretkosat e shkreta por edhe irritohesha, prandaj sa herë që e hetoja që e kishte ndërmend t'i masakronte ato të gjora, e ktheja kokën mënjanë për të mos parë se ç'bënte! As idetë për të lozur nuk i kishte më të mençura, prandaj, gjatë gjithë kohës sa isha me Maksutin më bëhej sikur po lozja në ëndërr e me ëndrra! Kishte dëshirë të sorollatej natën. Herë pas here me ftonte edhe mua dhe fshehurazi futeshim në kopshtin plot me kastravecë të Hajrijes. Pasi bënim përzgjedhje në dritën e hënës, i këpusnim nga dy tre copë dhe fshiheshim prapa Gurit të Çaplës[3] për t'i ngrënë. Në vjeshtë, duke kënduar futeshim në vreshtin me rrush të Nakut shurdhmemec. Atij nuk ja kishim frikën fare se do të na dëgjonte.

Në mbrëmje kur ndahesha nga Maksuti, kthehesha në kullën tonë të moçme. Futesha nga dera e pasme dhe ngjitesha në odën e burrave. Nuk kisha aspak dëshirë të takohesha në oborr vetëm për vetëm me Imamin, sepse ai gjithherë më qortonte me të njëjtat fjalë: *„Të pashë me Maksutin, çfarë keni vjedhur sot ë? Mos të shoh më të shoqërohesh me atë qafir së do t'i shkulë flokët me rrënjë edepsëz!"* Pastaj, për një copë herë me mbante shtrëngueshëm nga flokët e gjata dhe herë pas here ma tërhiqte veshin duke e tundur kokën e tij të madhe me çallmë sipëri, derisa dada Zejnebe, e cila prore rrinte në dritarezën e dhomës së saj i lutej të më linte të qetë! Pas lutjeve të saj, me lironte me një shkelm vitheve.

Baba i Imamit zinte vend në të djathtë të oxhakut,

---

3 *Krahinë – mullëz*

atje lartë në odën e burrave. Në anën e majtë zinte vend gjyshi im, ku në murin prapa shpinës së tij si gjithmonë ishte e varur lahuta. Pranë dritares ulej mixha, Imami ulej këmbëkryq pranë babës së vet kurse baba ulej pranë nesh mbi trapazan prapa dere. Ata bisedonin për gjëra të ndryshme dhe herë pas here pinin kafe që i përgatiste baba. Kur kishim miq, mua dhe vëllanë tim Xunin, na nxirrnin jashtë duke na thënë së ne ishim ende të vegjël për të dëgjuar muhabete burrash. Por ne, fshiheshim prapa derës dhe me orë të tëra i dëgjonim bisedat e tyre. Veçmas na disponinin shumë të sharat e ndyra të Imamit, i cili i thoshte ato fjalë turpe natyrshëm e me lezet sikur njeriu që flet për gjëra që i shkojnë për zemër, ndërkohë që unë duke e shikuar Xunin në sy, me një buzëqeshje habie e parafytyroja dadën Zejnebe lakuriq, me atë njollën e zezë në mesin e kofshëve, ashtu siç e kisha parë disa herë nga vrima e bravës duke u larë në hamamxhikun e vjetër në dhomën e saj! Atëherë pata rënë në dashuri dhe nga sikleti, herë pas herë, e veçmas kur Imami më tërhiqte nga veshi e lusja zotin t'ia merrte shpirtin atij edepsëzi dilenxhi, e pastaj të martohesha unë me dadën Zejnebe!

Pas vdekjes së babës së Imamit, që kishte ndodhur kur unë isha të daja, më kujtohet kur Imami e mori me vete dadën Zejnebe dhe iku diku në qytet. Sa gjatë pata qarë për ikjen e saj! Më vonë pata dëgjuar të flitej së hisen e kullës së tij ia kishte shitur gjyshit tim. Pas ikjes së Imamit, unë dhe Xuni shkonim në odën e burrave sa herë që dëshironim. Gjyshi mua me merrte në prehër kurse Xunin e ulte përballë dhe na tregonte përralla të bukura me luftëra divash. Pastaj trimëritë kreshnike i këndonte me lahutë duke na mësuar edhe ne! Sa qejf! Sa herë që e

përfundonte këngën na thoshte: *Gjëja më e shëmtuar në jetë është tjetërsimi! Kur njeriu tjetërsohet, ia mohon vetes, vëllezërve, miqve e të dashurve të tij të drejtën të kenë qasje në atë së çfarë janë në të vërtetë. Prandaj, qëndroni ashtu siç ju ka krijuar i madhi Zot e mos u tjetërsoni në atë së çfarë nuk jeni!* Sikur që më ishin shqitur nga mendja të gjitha këto që i mendova me nostalgji, edhe dashuria ime e parë, kishte zënë të venitej, duke marrë ngjyrat e mjegullës harrestare. Vetëm tani, kur po kaloja pranë trojeve të Laronjve, ku kishin zënë shtat disa shtëpi të reja, më trazuan kujtimet e ëmbla të dashurisë së parë që kisha përjetuar në atë kohë të rëndë lufte. Fytyra e të dashurës sime njomëzake, nuk mu kishte fshirë e tëra nga kujtesa, por edhe ashtu siç ishte në të vërtetë nuk më kujtohej më! Në mendjen time kishte marrë tjetër formë, tjetër trajtë, disi ishte deformuar... ishte tjetërsuar! Ah, sa e urrente ajo tjetërsimin!

Derisa isha nën përkujdesjen e apologëve të shquar, nën mbikëqyrjen e pakursyer të Abu Al Khalidit, nën urdhrat e ndritur të Ikhuanul-Muslimin[4] dhe nën kujdesin e pakursyer të Selef-us-Salih[5] që numëron miliona besimtarë të moderuar, të cilët me vullnet të pathyeshëm agjitonin jo vetëm në vendet ku sundon islami por edhe në Evropë e Amerikë, fillova, jo vetëm të mendoj ndryshe por edhe të marr vendime ndryshe, që përputheshin plotësisht me rregullat e sheriatit famëmadh. Shorti më pat hedhur të agjitoj në ato vende të shenjta, ku flitej gjuha e Allahut, duke i përshkuar ato male të larta e

4 *Vëllazëria Myslimane – Fraksion mysliman i themeluar nga Hasan Al Bana*

5 *Arab. Paraardhësit e devotshëm*

të zhveshura, duke udhëtuar nga një qytet në tjetrin, nga një krahinë në tjetrën, ku shërbeja dhe studioja njëherësh. Duke i vizituar ato vende të shenjta, duke pirë ujë të ftohët nga krojet dhe puset e bekuara pranë oazave të Pejgamberit selamu aljejkum[6], fitova kalitje fizike e mendore, duke i mënjanuar mbeturinat e besimeve besëtyte, duke i tejkaluar me sukses ndikimin e skrupujve moral, ndikimin e ndjenjave dhe të emocioneve dhe bashkë me to edhe ndikimin e dashurisë... shkaqe që besimtarin islam e dobësojnë deri në atë masë sa që arritja e qëllimeve madhore islame për mos ekzistimin e shtëpisë së luftës, do të mbeten vetëm dëshira të parealizueshme. Për arritjen e këtyre qëllimeve madhore dhashë betimin solemn se do të luftoj dhe do të sakrifikoj vetëm për Allah, për islam, për din e iman, jo vetëm pasurinë por edhe gjënë time më të shtrenjtë, jetën!

Kur po kaloja bri varrezave të moçme, edhe pse nuk është fare në traditën time respektimi i të vdekurve, për një çast u ndala pranë tyre. Thuhej se aty ishte varri i një kauri, i cili shekuj më parë e kishte vrarë përhapësin më të denjë të islamit në këto anë, Sulltan Muratin e famshëm, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të. Kur isha fëmijë, më kishte rastisur që me gjyshin tim, rahmet i pastë shpirti, sa herë që kalonim këtej pari, apo me rastin e festave, ndalonim pranë varrit të tij të vithisur dhe faleshim me përulje duke i kënduar sure nga Kurani. Mos e harro o bir, ky është varr shehiti[7], më kishte thënë gjyshi. Pastaj, në oden e burrave me rastin e ndonjë feste, i ulur këmbëkryq, me lahutë në dorë, gjyshi e këndonte me

6 *Përshëndetje Arabe*
7 *Arab. – Dëshmor*

nostalgji këngën epike për trimërinë e këtij kundërshtari të ashpër të islamit! Oh, sa zë të ëmbël që kishte gjyshi im! Sa bukur këndonte nën tingujt e zgavruar të lahutës, kur e fillonte atë këngë të lashtë epike:

Kish pa ëndërr Sulltan Murati
Retë e qiellit në tokë ishin zhdrypë,
Diell e hanë në det ishin mbytë!...

Sa e sa herë i kisha kënduar me gjithë afsh ato këngë të lashta, pa e ditur se këndoja haram!... Pa dashjen time mendja më iku diku thellë në brendinë e errët të kohërave, duke u ndeshur befasishëm me eposet e tmerrshme e plot gjak, nëpër ato bjeshkë kreshnikësh, mbi ato pllaja ku zhvillohen mejdanet e përgjakshme me bajlozët e detit, mbi ata shkrepa ku krushqit qëndrojnë të ngrirë që prej mijëra vjetësh me nuset e rrëmbyera dhe akoma qëndrojnë kaluar mbi kuaj të dehur, nën thirrjen e jehonave kreshnike për dyluftim, ngritje nga varri për të mbajtur njëfarë bese të dhënë në të gjallë, vajtime mallëngjyese të nënave qyqe, rënie mbretërish, trokëllima atllarësh, përpjekje shpatash, ngulje topuzësh shtat pashë nëndhé, klithma zanash diku në pllajat e Lugjeve të Verdha dhe të gjitha ndodhin nën rrezet e diellit që çuditërisht shumë po shndritë e pak po nxeh... Allahu m'i faltë kabahatët... dhe me gjithë afsh këndova këtë ajet nga surja Llukman: *„Po ka nga njerëzit që blenë tregime boshe e me qëllim që t'i largojnë njerëzit prej rrugës së Allahut pa pasur kurrfarë fakti dhe për t'i marrë ato (ajetet) e Allahut si tallje. Për ta me siguri është përgatitur*

dënim i turpshëm!"[8]

Të gjithë më thoshin se i ngjaja gjyshit tim jo vetëm nga pamja, por edhe nga zëri. Por, falë studimeve, falë mësimeve që i kam zënë në ato vende të largëta e të shenjta, unë nuk do të këndoj më me lahutë siç kishte kënduar dikur gjyshi im anakronik, por do t'i këndoj suret e shenjta nga Kurani Kerim[9], dhe në heshtje këndova edhe një ajet nga surja Isra: *„Allahu tha: Shko, e kush prej tyre vjen pas teje, shpërblimi i juaj është xhehenemi... dhe me atë alarmin e zërit tënd mashtroje atë që mundesh prej tyre!..."*[10]

Kësaj radhe nuk u fala para këtyre varreve, por vetëm i vështrova me përbuzje si varre të pafeve që ishin!

Derisa po shqitesha prej aty, pas shpinës sime dëgjova hapa. Ktheva kokën dhe pashë dy vajza që po nxitonin drejtë qendrës së katundit. Nuk i shikova fytyrat e tyre të zbuluara e gjynahqare, sepse është mëkat, por rrëshqitazi i pashë vetëm siluetat e trupave të tyre. Sikur njeriu që shtiret se nuk kishte vërejtur asgjë, ktheva kokën në anën tjetër. Kur kaluan bri meje dhe vazhduan tutje sikur me zuri veshi në mesin e pëshpërimave të tyre fjalën; „kthyer..." Me gjithë kureshtjen për t'i njohur se cilat ishin, nuk i shikova dot! Nuk desha t'i këqyri, e të mbushem haram!

Mixhën dhe babanë i kishin varrosur pranë njëri-tjetrit, kurse vëllanë pak më tutje! Mixha kishte vdekur nga një

---

8 *Kuran 31:6 – transmetuar sipas Abdullah Ibën Mes'udit që do të thotë së fjalët „tregime boshe" nuk janë gjë tjetër veçse këngët.*

9 *I nderuar, me nder, i shenjtë*

10 *Kuran 17:63 dhe 64 – Transmetuar nga Ibën Abasi dhe Muxhahidi të cilët kanë thënë se: Zëri i Shejtanit është kënga, fyejt, zbavitjet dhe argëtimi.*

palë ethe të forta dimrin e dytë që unë nuk ndodhesha në shtëpi. Kurse vëllai rreth gjashtë muaj më parë, i goditur nga kanceri! Pranë varrit të babës qëndrova më gjatë. E ndjeva aromën e dheut të shkrifët mbi varr. E pashë edhe kënatën që ia kishin vendosur sipëri. E njoha. Ishte kënata e moçme që baba e kishte çmuar shumë. Është shumë e vjetër, thoshte herë pas here, ndoshta njëmijë vjet... e gjeta të Arat e Bregut! Kjo kënatë e vjetër, që pjesërisht ishte thyer më përmalloi aq shumë sa që nuk i ndala dot lotët. Nuk e di pse ajo vjetërsinë që asnjëherë më parë nuk ma kishte tërhequr vëmendjen, më mbushi me ngashërim! As tani nuk e përcaktoj dot se sa kohë kam qëndruar pranë varrit të freskët të babës tim të gjorë, por e di se gjatë gjithë kohës kisha qarë me dënesë. Aq shumë isha shpërqendruar sa që nuk e mora vesh në isha duke qarë për të vdekurit që nuk ishin më në këtë botë, nga malli që me kishte kapluar për këto troje të nëmura, apo pse pas kaq vitesh ndodhesha para një fillimi të ri e të panjohur! Pa e kuptuar, kishte filluar të frynte erë e ftohtë e mbështjellë me flluska të rralla bore!

Për të gjitha vdekjet që kishin ndodhur në familjen time, me pati shkruar Imami. Ishte ai, që me profecitë e tij me pati bindur të marr këtë rrugë kaq të ndritur islame! Ai më shkruante shpesh. Më njoftonte deri në imtësi për çdo gjë që ndodhte në mbarë farefisin, e veçmas për ndryshimet dhe grindjet e atyre qafirëve të Bashkësisë Islame. Në letrat që ia pata dërguar, i pata treguar se çfarë isha duke studiuar dhe ç'punë bëja gjatë kohës së lirë në ato vende të largëta. I pata shkruar se puna ime ishte, përveç studimeve, i parapaguar nga ithtar të përzgjedhur e të moderuar selef-us-salih, të bëja inspektime në mesin

e mejtepeve, nëpër fshatra të humbura malore, në mesin e varfanjakëve taleban[11], për të zbuluar talentet e rinj, por të harruar nga shoqëria për shkaqe lufte dhe korrupsioni, dhe t'i regjistroja në defterin tim për t'ua dhënë pastaj atyre që më motivonin dhe më paguanin. Kështu, unë isha i paanshëm në përzgjedhjen e tyre dhe kisha shije të hollë për këtë lloj pune. Kisha bërë përzgjedhje në mesin e të gjitha mejtepeve, e veçmas në ato vende ku varfëria dhe lufta i kishte sfilitur njerëzit. Të uritur për një kothere buke, të lënë pas dore nga shoqëria e cila ishte e zënë pas luftërave vëllavrasëse, pa një cent në xhep, të përgjumur nga droga që e prodhonin vetë, kisha për detyrë që këta të rinj t'i nxirja nga ky kaos dhe t'i nxisja kundër të pafeve dhe idhujtarëve, të cilët ishin shkaktarët kryesorë për mjerimin e tyre, dhe t'i bindja se rruga e vetme e shpresës për jetë, e veçmas për ahiret, ishte lufta e pa kompromis dhe flijimi! Kishte edhe nga ata që hezitonin, por duke i përdorur taktikat e njohura se nëse nuk jeni me ne, jeni murtad[12] dhe për këtë mund të ndëshkoheshin rëndë, jo nga Allahu xhel-le shanuhu sa nga ne... të frikësuar, edhe ata pranonin! Më të preferuarit dhe më të paguarit ishin ata që nën përkujdesjen time bindeshin në rrugën e Allahut dhe me vullnetin e tyre të pathyeshëm e pranonin flijimin!

Në letrën e parafundit që ma pati dërguar Imami, me shkruante se në fshehtësi të plotë e kishte filluar punën në seleksionimin e rinisë drejt rrugës së shenjtë të regjistrimit të tyre në anëtarësinë e Selef-us-Salih. Shkak për marrjen e këtij vendimi ishin bërë disa hoxhallarë të

11 Student të islamit
12 Arab. – tradhtar

pacipë të cilët ua ndalonin të rinjve tonë selef, t'i luteshin Allahut, duke i nxjerrë me potere e të shara nga xhamitë dhe duke i akuzuar së po ua infektojnë xhematin e tyre të përbërë nga dy tre pleq të çalë, të shurdhër apo qorra! Pastaj imoraliteti, shkruante më poshtë Imami, është bërë një plagë e rëndë në shoqërinë tonë të pasluftës! Jemi zhytur keq në kurvëri e pisllëqe të ndyra si dikur populli i Lutit duke e hidhëruar pamasë Allahun e Madhërishëm dhe inshallah m'i dëgjon Allahu lutjet e nuk e lëshon zemërimin e tij të tmerrshëm kundër këtij populli të humbur derisa të kthehesh ti, për t'i pri në rrugë të drejtë! Pastaj, më njoftonte për pengesat që i shfaqeshin gjatë punës, për kundërshtarët e zëshëm dhe të heshtur, të prirë nga Hafizi dhe disa të tjerë, që ishin bërë të padurueshëm! Për të përfituar nga përvoja e juaj, me shkruante pastaj, të ftoj që të kthehesha sa më parë që të jetë e mundur, duke më premtuar një pagesë dy herë më të madhe se këtë që e merrja tani. Për një kohë dyshova në sinqeritetin e tij, por pasi e pashë se shkronjat e para nga fjalët përshëndetëse selamu alejkum i kishte shkruar me ngjyrë të kuqe dhe me miniaturë stilistike, të cilat përbrenda tyre mbanin fshehtësi, me bëri ta ndryshoj mendjen. Duke vazhduar leximin e letrës, sikurse edhe me parë që me kishte njoftuar për vdekjen e mixhës dhe të vëllait, me njoftonte për vdekjen e babës, rahmet u pastë shpirti të gjithëve! Pata dhembje për ta.

Pasi i fshiva lotët, që mu bë se më ishin tharë që më parë, eca drejt qendrës, me mendimin që t'i vë prapë lidhjet e shkëputura me shokët e fëmijërisë... e veçmas me shokët e medresesë. Rrugët kishin ndryshuar tërësisht. I kishin zgjeruar dhe mbushur zhavorr. Mezhdat e mëdha

përgjatë tyre nuk dukeshin gjëkundi. Paksa i ndrojtur, u hodha nga lagja e Kullurëve. Thashë mos rastësisht do ta takoja Hilin, apo Maksutin, por nuk i pashë. Thellë në shpirt ndjeja edhe një dëshirë të zjarrtë që më mundonte pa masë por që kisha frikë edhe ta mendoja lirshëm. Me brente meraku për të dashurën time Fitin. Vallë, ku ndodhet ajo tani? A e ka mbajtur të pastër besën e dhënë? Për një çast, me marifet e largova mendjen nga Fiti që mos të mbushëm edhe më tej haram dhe mbeta i mahnitur kur pashë së edhe lagjja e Maksutit dikur e varfër, me çardakë të vjetër e kasolle të shtrembëruara, me pojata të moçme ku i ngujonin dy tre krerë dhi, kishte marrë pamjen e një lagjeje moderne me shtëpi të reja dy-tre kate, me ballkone të rrethuara me xhama, me oborre të blerta të mbushura me pemë, çetinë e qiparisa! Jo vetëm që nuk i pashë shokët e fëmijërisë, por nuk pashë njeri të gjallë përgjatë gjithë lagjes. Në krye të lagjes pashë një dyqan, rishtas i ndërtuar. Thashë të pushoj disa çaste, dhe të bëj një ekspozim, le të me shohin këta injorantë që u ktheva dhe ndoshta do të takohem me ndonjërin nga miqtë e mi, pastaj nuk do të kem më nevojë të njoftojë askënd. Fjala do të përhapët shpejt: – More vesh gjë ti? – do të pyes njëri; – Jo, pse? – do t'i përgjigjet tjetri; – Çeli i Lulajve, i konvertuar në Abdallah, ishte kthyer nga Arabia! – I konvertuar? I lumi ai i lumi për shpirtin e vetë! E paska fituar xhenetin!

Ende pa e mbaruar mendimin, kur gjendesha nja pesëdhjetë hapa larg derës së atij dyqani të ri, papritmas, para meje u shfaqën dy gra. Ula kokën dhe bëra tutje, por ato ma prenë rrugën.

– U qyqe moj, po ky qenka Çeli i Lulajve! – dëgjova

zërin e mekur të plakës që nuk desha ta shoh. E njoha nga zëri. Ishte Zelfia, gjyshja a Fitit, dhe papandehur u nis drejt meje.

Nuk e shikova fare! As nuk ia zgjata dorën!... pa folur asnjë fjalë bëra një lak me hapa të shpejt dhe u gjenda prapa tyre. E pashë që i mbeten duart e ngritura drejt meje që i bëri gati të më merrte në përqafim ashtu siç me kishte përqafuar dikur!... ka kaluar ajo kohë, tani nuk më përqafon dot plakushë e dreqit! – mendova pasi isha larguar tutje.

Disa bashkëkatundarë kishin dalë jashtë dyqanit dhe sikur po zbaviteshin duke shikuar drejt nesh. Pas pak i dëgjova të gajaseshin si të çmendur. Për një çast ia mora vetes inat pse erdha këtej... edhe asaj plakushë të krisur që më bëri objekt tallje para së të takohesha vetë më këta injorant të dalë feje! Allahu i marroftë!

Pas këtij skandali, mu pre dëshira të ndaloja aty, apo të takoj dikë nga të njohurit! Pa menduar gjatë, mora drejt kullës sime, duke menduar se njoftimin për arritjen time, të vënë në kulmin e talljeve do të dëgjojnë edhe katundet tjera përreth e jo vetëm katundi im! Shtriga plakë! – shfryva me inat derisa isha duke e shty derën e moçme të oborrit.

Vetëm në trojet e mia nuk kishte ndryshuar asgjë. Mu bë se era e vdekjes endej gjithandej oborrit. Kulla e rënduar nga pesha e viteve mu bë se ishte zvogëluar. Dritaret mu dukën edhe më të vogla, ndërsa oxhaku që vazhdonte të nxirrte tym, mu bë se ishte shtrembëruar aq shumë nga lindja, sa që nga çasti në çast, dukej sikur do të binte! Mashalla, mendova i ngazëllyer, paska marrë anën e mbarë!

Derisa po vazhdoja të kundroja kullën me sy të përlotur, ndjeva rrapëllimën e derës, të njohur për mua. Që andej u shfaq silueta e nënës. Edhe ajo, sikurse edhe kulla, mu bë se ishte zvogëluar, duke u tretur brenda rrobave të saj të vjetra. Mezi çapitej. Ajo po vinte nxitimthi drejt meje, me duar të zgjatura para, duke thirrur me atë zërin e saj të lodhur:

– E lumja unë e lumja për ditën e sotme, kush më erdh! Djali i nënës, sa më ka marrë malli o bir!

Me duar të zgjatura deshi të më mbështillte në përqafim! O zot, thashë me vete duke i hedhur disa hapa prapa! U çmend kjo, apo ç'pati? Përqafimet e tilla nuk i lejon islami, sepse kjo para se të jetë nënë është femër e më zgjon ndjenja epshi... pfu Allahu e marroftë! Edhe pse është nënë duhet të ketë kujdes e mos të mbushet vetë, e të më mbushë edhe mua me haram!

– Si je, o birë? – me pyeti ajo pasi më ishte afruar aq afër sa që e kisha të vështirë t'i shmangesha përqafimit të saj.

– Mirë jam oj nënë, mirë! Po, pse sillesh kështu si e çmendur? – e pyeta me duar të zgjatura para, sa për ta penguar marshimin e saj drejt meje, dhe për t'u mbrojtur nga përqafimi i saj haram!

Edhe pse për një moment u step, ajo prapë zgjati duart drejtë meje, dhe m'i grishi pak gishtat, duke me thënë:

– Po me ka marrë malli more bir... shumë kam vuajtur... nga skamja, nga sëmundjet, nga vdekjet e njëpasnjëshme që i kapluan këto troje, për mungesën tënde... eja, eja futu brenda se paske mërdhirë! – tha më në fund me zë të përvajshëm dhe sy të përlotur. Pastaj hoqi dorë përfundimisht nga përpjekjet e saj të marra për të më përqafuar. Duke i fshirë lotët me cepin e shamisë u nis

para meje për të ma hapur derën.

Në dhomën e zjarrit, ku ishte oxhaku i moçëm, nuk kishte ndryshuar asgjë. Zura vend mbi një stol trekëmbësh druri që ma ofroi nëna. Pasi u rehatova pak, ia hodha një vështrim rreth e qark dhomës.

Pas përfundimit të pyetjeve të zakonshme, ra heshtje. Nëna doli jashtë, nuk e di pse. Për herë të parë e ndjeva veten të lodhur. Mu duk se dita ishte zgjatur tej mase. Kisha harruar kur isha zgjuar nga gjumi... sikur para një jave të ketë ndodhur! U përpoqa t'i sjell ndërmend të gjitha ngjarjet që i përjetova brenda kësaj dite tmerrësisht të gjatë... i kujtova lëvizjet, përsiatjet, ndarjet nga vëllezërit e mi selef, fluturimin me avion, biseda të shkapërderdhura, lëvizje njerëzish pa cak, shikime kureshtare, pëshpërima injorantësh ku pas tyre mund të fshihej ndonjë lëvdatë apo ndonjë e sharë, pastaj arritja në katund, vizita pranë varreve, pëshpërimat e vajzave, Zelfia dhe përpjekja këmbëngulëse e nënës për të më përqafuar... sa anakronikë qenkan këta njerëz... ky popull... O Allah, ndihmoje këtë popull të dalë feje, të paditur e të mjerë!

Pa e vërejtur, nëna ma lëshoi një zarf në dorë!

– Është për ty. Para dy ditësh ka arritur... nuk e di nga kush!

ËNDRRA

Unë jam ëndrra. Jam nëna e gjumit në gjithë botën. Që nga kohërat e lashta falë punës sime këmbëngulëse, me qindra e mijëra herë kam bërë ndryshimin e rrjedhave të historisë. Natyrisht së vetëm kumti im që ia solla njerëzimit përmes gjumit e ëndrrave, nuk do të bënte asnjë ndryshim në rrjedhën e jetës së përditshme, po të mos ishin ëndërrshpjeguesit e famshëm e të çmuar grekë, romakë, persë, arabë, kinezë, mongolë etj,etj. Prandaj, për tragjeditë që janë përplasur mbi kokat e njerëzimit gjatë mijëra e mijëra shekujsh unë nuk mbaj asnjë përgjegjësi, sepse këtu nuk ishte çështja e kumteve të mira apo të liga që ua solla njerëzimit, por ishte çështja e zhdrivillimit të gabuar të ëndrrave. Në shumë raste kishte ndodhur që ëndërrparësit nuk e kishin thënë të plotë ëndrrën e tyre duke e stolisë me fantazi e vegulli, por kishte pasur edhe ëndërrshpjegues zevzek që nuk e

kishin besuar ëndrrën, ose e kishin besuar tepër vonë, pasi kishte ndodhur fatkeqësia.

Kur vjen nata dhe krijesat e Allahut bien në gjumë, befasisht, unë gjendëm pranë tyre. I rrëmbej lehtë mbi flatrat e mia dhe i zhvendos mbi pamje areale, mbi zëra të mekur e përsiatje, duke ju sjellë shenjëza hyjnore nga i Madhërishmi. Që nga kohërat e lashta njerëzimit i solla kumte tragjedish, shenjëza fatkeqësish, rënie mbretërish, zgjerime perandorish dhe shfaqje profetësh. Disa popuj të zgjuar e finokë i morën për të vërteta paralajmërimet e mia që ua solla përmes gjumit dhe ëndrrave dhe dolën nga mjerimi. Me zhdrivillimin e tyre arritën t'i parandalojnë fatkeqësitë dhe t'i pranojnë profetët dhe profecitë e tyre. Por, pati edhe nga ata popuj kokëtulë që nuk më besuan dhe i hodhën poshtë si të pavlera kumtet që ua solla. Këto ndodhën për arsyen e vetme së unë ju kisha shfaqur një njeriu të thjeshtë, një bariu stani apo një tyxhari devesh e jo ndonjërit nga të zgjedhurit e shoqërisë, siç pretendonin ata së vetëm atyre duhej t'ju shfaqesha me shenjëza e kumte. Por, pati raste, kur nga mosdija e zhdrivillimit të kumtit, nuk morën masa t'i parandalonin fatkeqësitë apo t'i pranonin profecitë që ua solla si zbritje hyjnore.

Sa herë që vijnë kohëra ndryshimesh të mëdha për mbarë njerëzimin, i Madhërishmi me hedhë mbi dhé pa asnjë paragjykim, ashtu siç e hedh ylberin, rrufenë, borën, shiun, apo edhe ndonjë kometë bishtndezur e të vetmuar natën për hënë! Përderisa Allahu nuk ka ngé ta përcaktojë së cilit duhej dërguar shenjëzën, unë vazhdoj fluturimin mes përmes errësirës së natës dhe kumtin ia dërgoj atij që do ta ketë fat, e që mund të rastisë të ndodhet në gjumin më të rëndë në hapësirën e

ngushtë të ndonjë shpelle, i fshehur në zgavrën e ndonjë lisi gjigant në ndonjë xhungël, në gjumin e parë pas një dashurie në ndonjë kasolle thuprash, në terrin e ndonjë kulle me frëngji e tretur brenda një populli të humbur, në çadër para ndonjë beteje të ankthshme, në vetminë e ndonjë qelie burgu apo në shtratin e butë të ndonjë pallati princëror. Është detyrë e ëndërrparësit pastaj, që përmes ëndërrshpjeguesit ta zhdrivillojë ëndrrën e t'ua sjellë kumtin mbarë njerëzimit.

Kur mbarë njerëzimi ndodhet në gjumë, udhëtoj nga një krijesë e Allahut të krijesa tjetër duke ju dërguar shenjëza. I zhvendosë nga bota reale në një botë të patrajtë, të pakohë, të pa fillim e mbarim. Kështu i mbaj pezull derisa t'ua fus në mendje e shpirt shenjëzën që ua sjell nga Allahu i Madhërishëm. Gjatë kësaj kohe ndjej përsiatje, rënkime, zëra të çrregullt, qeshje të harlisura, vaje të trishtueshme, rreze dielli, dritë hëne, yje të shuara, vrasje, ikje në hapësirë, intriga, dashuri të ndaluara, lakuriqësi turpe, akte seksi, orgazëm, kënaqësi, shkrepje rrufesh, ujëra të turbullta, dete e liqene të argjendta, shira e furtuna, bjeshkë të kreshpëruara, luftëra të përgjakshme, mejdane gladiatorësh, shkrehje armësh, vrasje e rrjedhje gjakrash!... Kur krijesat e të Madhërishmit fillojnë të përmenden dhe të kthehen në zhgjëndërr, truri i tyre i pangopur vazhdon ëndërrimin syhapur duke sajuar shajni e vegime. Kjo ndodhë vetëm të ata njerëz ambiciozë e të paskrupullt, që për t'i përmbushë ambiciet e tyre nuk e zgjedhin arsyen. Këto shajni, nuk janë gjë tjetër veçse pjellë e mendjeve të tyre të pangopura me iluzione dhe intriga për t'i përligjë disa ide, disa dëshira, disa ambicie që janë në kundërshtim të plotë me shenjëzat që ua sjell

unë me urdhrin e dëshirën e Allahut të Madhërishëm.

Kam frikë së një gjest mosbesimi do të me ndodhë edhe sonte, me një torollak mjekërkuq! Ja pse:

Elif:

Ju ka rastisur ndonjëherë të takoheni me një talibje zevzek, trup hajthëm, mjekërkuq e mustaqerruar? Ky djalosh syshkruar e finok nuk i pranon kurrsesi shenjëzat që me emrin dhe urdhrin e të Madhërishmit ia kam dërguar sa e sa herë natën në gjumë. Nga frika së po e sfidon Allahun, shenjëzat e mia po i quan haram, por në të njëjtën kohë, po merret me përpunimin e shajnive vegulli dhe zhgjëndrrave të njëfarë Vehabit, turpshëm, duke e sfiduar të Madhërishmin. Një shajni e tillë ka vite që vegon në mendjen e tij të krisur me pretendimin e kthimit prapa në kohërat e moçme të Selef-us-Salih. I Madhërishmi më urdhëroi t'ia dërgojë edhe një kumt sonte, në gjumin e natës së parë të kthimit të tij nga ato vende të shenjta. Ndoshta kësaj radhe, krijesa e tij në tokë do ta besoj kumtin që i vjen drejtpërsëdrejti nga i Madhërishmi, e do t'ju shmangët shajnive të huaja e të gabuara, edhe islame qofshin ato! Mbetët detyrë e tij dhe e ëndërrshpjeguesit se si do ta trajtojnë shenjëzën pastaj! Pa humbur kohë u nisa, sepse para së të kenë kënduar gjelat e parë, duhet të jem në njërën nga dhomat e ftohta e plot lagështi brenda kullës së tij të moçme, thellë një katund të humbur të Arnautistanit.

Kalova mbi botën e errët e plot gjumë. U thërrmova në mijëra e miliona pjesë duke dërguar shenjëza shqetësuese, hidhëruese, gazmore, fate, trimëri, dashuri... të cilat i

hodha mbi botën e gjumit ashtu, kuturu... kush t'i ketë fat. Kurse kumtet, fillova t'i shpërndaj sipas porosisë.

Kur arrita në qiellin e Arnautistanit, u ndesha me një gjumë të shqetësuar, por të zgërlaqur nën thundrat dhunuese të perandorive të shkuara. Një pjesë e vogël flinte e kryqëzuar, kurse pjesa më e madhe e kërrusur mbi gju. Thuhej së ky popull i lashtë kurrë nuk kishte ëndërruar vetë. Kumtet hyjnore nuk kishin pasur asnjëherë ndikim në parandalimin e fatkeqësive që i kishte rënë mbi kokë, jo se nuk kishin pasur kumte nga i Plotfuqishmi. Estagfirullah[13]! Në vend që të merreshin me zhdrivillimin e ëndrrave të tyre, gjatë gjithë historisë u morën me zhdrivillimin e shajnive të huaja. Kam përshtypjen së edhe kësaj radhe shenjëza ime do të gjymtohet duke marrë formën e shajnisë, do të ndeshet në sy të fjetur dhe në vesh të shurdhër. Allahu ia shtoftë gjumin e rehatshëm këtij populli qorr! Amin!

Si flutur e lehtë ngjyra-ngjyra zura vend mbi qepallën e syrit të tij dhe...

Lam:

... në kohën kur ndodhej pa asnjë përjetim a ngacmim nga jashtë, e rrëmbeva mbi flatrat e mia dhe e solla pranë dritarezës për të parë jashtë. E zhvendosa në një hapësirë të patrajtë, të zymtë dhe të lagësht njëherësh, duke e ndjerë së gjendej pranë dritarezës me perde të vjetra e të tërhequra në anën e majtë, që kundërmonin erë të rëndë myku. Fërfëlliza vazhdonte të dëgjohej e rrëmbyeshme,

13 *Arab. Kërkoj falje nga Allahu*

tallaze-tallaze, herë-herë e fortë duke i përplasur me rrëmbim pikat e shiut mbi xham, e herë-herë vinte më e qetë, duke lënë prapa një vërshëllimë të zgjatur që ngjante në ulërima ujqish. Dalëngadalë, ia përfytyrova retë e bardha të qiellit që zbrisnin në tokë! Pikërisht në kohën kur filloi të binte zhurma e fërfëllizës, kur retë filluan të dyndeshin, u shkërmoq nga një kënaqësi çasti, duke kujtuar se më në fund, tmerri i kësaj nate të pa parë ndonjëherë në jetën e tij, ishte duke u tretur... por jo, pikërisht në këtë kohë, para pamjes së tij ia feksa një dritë të fortë, si dritë vetëtime, që për disa qaste e mbajti të ndritur ambientin përreth... u tmerrua kur pa se ajo dritë vetëtime nuk po lëshohej si zakonisht nga qielli dhe e përcjellë me gjëmë e bubullimë, por po dilte nga dheu, diku nga kreu i katundit, andej nga kodra e Milushit!... O Allah, pashë hatrin tënd, mbrona nga më e keqja, e luti Allahun me gjithë shpirt edhe pse ishte në gjumë. Në çast, ende pa e mbaruar lutjen, u tmerrua edhe një herë kur pa se nga ai vend i shenjtë, drita filloi të ngjitej lartë si gjuhë kuçedre! Allah! – klithi i nemitur duke shikuar zhvendosjet prore të dritës drejt mureve të vjetra e të shkatërruar nga motet, pranë rrethojave me gurë që dallonin diku më shumë e diku më pak, mbi kalldrëmet e moçme që vende-vende ishin zhdukur fare, duke i përlarë trojet e lashta të Milushit... dhe, drita ngjyra-ngjyra, e ngatërruar disi si ngjyrat e ylberit, filloi të ngjitej lartë në kupolën e qiellit që çuditërisht ishte tkurrur aq shumë sa që kishte marrë formën e një gjysmëhëne të përmbysur me brendi të skalitur me përkushtim si nga një dorë e artë mjeshtri mysliman, me ca katrorë të lidhur harmonishëm me njëri-tjetrin. Duke i parë i përqendruar ata katror

ngjyra-ngjyra, sikur në një sfond të imagjinuar përvijohej një mozaik më një figurë stilistike si fytyrë burri... me shall të mbështjellë rreth koke, sy të zgurdulluar... mjekër dhe mustaqe të shkarravitura... dhe pranë supit të tij të djathtë, si në prapavijë, një pikturë foshnje me flatra, e vogël sa një bletë, sikur i bënte roje asaj fytyre që herë-herë, sipas kontrastit të ngjyrave, merrte pamje madhështore të një burri krenar me pamje princi por, pastaj sikur ndërrohej bashkë me ndryshimin e ngjyrave duke marrë pamje gazmore, me një buzëqeshje të varur në cepin e buzës së poshtme që vështirë i dallohej nga leshrat e gjata të mjekrës. Ajo figurë magjepsëse, ndërronte pamjen, nga pamja e harmonishme në pamje të njeriut të dëshpëruar dhe në fund, derisa kishte filluar të zhdukej në atë qiell pa yje, ngeli e vetmuar vetëm pamja e tij agresive, e cila dalëngadalë zvetënohej duke humbur në kupolën e ngushtë të qiellit sterrë të zi! Por, drita nuk u zhduk për fare nga pamja e tij! Për çudi, ashtu e venitur siç ishte, filloi të rikthehej drejtë kullës së tij duke marrë pamjen e një kalorësi mesjetar, të ngarkuar rëndë me peshën e pancirit dhe hanxharin që e mbante shtrëngueshëm në dorë. Sa më shumë që afrohej drejt tij, aq më shumë e humbiste shkëlqimin, zvetënohej dhe përzihej me hingëllima kuajsh, krrokëritje mëllenjash, kuisje dhe vaje grash... Papritur, si hije e zezë nate, në mesin e asaj drite të venitur ia shfaqa pamjen e një korbi duke u rrotulluar në aurorën e asaj drite, që prore zbriste në tokë, duke u shndërruar në flatra pëllumbi, derisa u zhduk fare pranë lëndinës ku thuhej se ishte një varr i vithisur... dhe që andej sikur dëgjoj një zë si të ardhur nga një botë e largët, nga një botë e huaj, nga një botë e humbur... një zë që

vinte i valëzuar, disi me ndërprerje, por i thellë, dhe mbi të gjitha i qartë dhe i vendosur: *„Edhe lindja, edhe perëndimi më përkasin mua... prandaj, po nuk e zbërtheve shenjëzën që ta dërgova, nuk do ta zbërthesh as kumtin e letrës që të erdhi mbrëmë... Mos u merr me komentimin e shajnive të huaja, por merru me zhdrivillimin e ëndrrave tuaja për t'ua lënë testament virtytin e ndritur hyjnor pasardhësve!"* Estagfirullah!... klithi i përdëllyer kur dëgjoj zërin e Tij!

Ëndërr e mallkuar, tha dhe u ul në shtrat. I përthyer nga kumti që ia solla, filloi t'i zhgjëndërronte me finesë të mahnitshme shajnitë vehabe...

Mimë:

...Në kohën e injorancës së tmerrshme, kur kishte filluar të shuhej drita e islamit dhe zemrat e myslimanëve kishin filluar të rrëshqasin në mosbesim, kur sheriati ishte njollosur e deformuar dhe kishte rrëshqitur në xhahilijet,[14] duke ju besuar shenjtërove, besëtytnive e përrallave, kur kishin filluar të ndërtonin përmendore dhe pllaka varrezash duke u falë e flijuar kurban, kur kishin filluar të këndonin me zë të çjerrë xhinësh dhe të hidhnin valle lanetësh, të dridheshin e të përdridheshin nën tingujt e djallëzuar të fyejve e daulleve shejtanësh, befas, në horizontin e ngarkuar nga shirku,[15] ishte feksur një zë drite që i bënte thirrje mbarë njerëzimit që t'i riktheheshin fesë së pastër islame dhe nënshtrimit ndaj mëshirës së Allahut! Ky zë i çmuar nuk ishte gjë tjetër veçse thirrje në rikthimin e mbarë njerëzimit në kohën

14 Injorancë
15 Gjë a veprim që besimtarët e sfidojnë Allahun

e vlerave të vërteta islame. Për arritjen e këtyre qëllimeve të larta myslimane, si gjithmonë, edhe kësaj radhe do të përdoret tehu i mprehtë i shpatës së profetit.

Përhapjes së kësaj ideje të re, për t'u kthyer në kohëra të perënduara po i ndihmon edhe ky mjekërkuq që nuk e mori kumtin që ia solla nga i Plotfuqishmi!

Këto ide të krisura nuk janë kumte shpalljesh nga Allahu i Madhërishëm, por janë shajni vegimtare nga disa mendje të krisura të cilat duke e përdorë vend e pavend emrin e Allahut po përpiqen që krijesat e Tij në tokë t'i vënë në gjumë për t'i argëtuar detyrimisht me ëndrra... me falni, jo me ëndrra, por me vegime, shajni e vegulli... deri në çmendi!

Duke e parë së këtë mjekërkuq zevzek e trutharë nuk e bindin dot pamjet konkrete që i shikon dhe i përjeton çdo ditë, nuk e bindin ëndrrat që i zbritën drejtpërsëdrejti nga Allahu i Madhërishëm por e bindin shajnitë vegimtare vehabe, e lashë të përhumbur në vegullitë e tij të çmendura dhe vazhdova rrugëtimin tim mbi gjumin e ëmbël të mëngjesit dimëror.

KUMTI

Ëndërr e mallkuar thashë, dhe u ula në shtrat. Drita e mugët e mëngjesit dimëror dhunshëm depërtonte nga dritarja e kullës. Edhe pse perdja ishte e shtyrë krejtësisht në anën e majtë, drita e asaj mugëtire ishte e pakët që t'i dalloja orenditë e dhomëzës sime. Mbi xham pashë një shtresë të hollë avulli! Ndërsa në skutat e tjera të dhomëzës ku ndodhej hamamxhiku i vjetër, në të cilin sa e sa herë e kisha parë duke u larë dadën Zejnebe, pranë arkave të moçme të gjyshes, pranë oxhakut gojëhapur e të nxirë nga bloza, pak dallim kishte mugëtira nga errësira e plotë. Në kamaren e murit përballë shtratit tim të drunjtë, dallohej grumbulli i librave, që mbrëmë i kisha lënë aty. Mbi to, kryeneçe po qëndronte letra e palosur në katër fish që mbrëmë ma dha nëna, por që nuk arrita dot ta zbërthej të tërën. Ajo letër, së bashku me gjësendet e tjera, sikur po paraqisnin pamjen e qetë

të dhomëzës sime karshi rrebeshit të jashtëm. Kjo është gjëja e vetme paqësore që ka ngelur akoma pa u trazuar përbrenda dhomëzës sime, por jo edhe brenda shpirtit tim! Këtë qetësi sikur e shprehte vetë neutraliteti i xhamit gjysmë i mjegulluar! Ç'është e vërteta, ajo letër kishte thënë diçka, kishte treguar një lloj kumti të pazbërthyer krejtësisht, disi si një lloj pohimi kryeneç e të zhgërryer paturpshëm, në një lloj ftese të largët e të papërcaktuar që tmerrësisht kërcënonte në rast mospërmbushjeje të një urdhri të fshehtë! Pas trazimeve të ankthshme që i ndjeja në shpirt, përsëri u hodha në zbërthimin dhe interpretimin e letrës duke përdorë gjithfarë fjalorësh. Kot! Nuk e zbërtheva se nuk e zbërtheva dot! Sa më këmbëngulës që bëhesha në zbërthimin e saj, aq më e ngatërruar dhe e largët me dukej. Në këto raste, kur kureshtja ime e papërmbajtur më kthehej në urrejtje të pakontrolluar, e zgjatja dorën furishëm për ta grisur letrën me zemërimin më të madh që me vlonte përbrenda gjirit. Ndërkohë, nën trysninë dhe bekimin e meleqeve, kthehesha në rrugën e Allahut duke u larguar nga yshtjet e shejtanit të mallkuar. Pastaj, kthehesha drejt letrës duke u falur me pendim dhe përulje para saj, para shkronjave të shenjta e të shkruara me elegancë, që si me qesëndi, vazhdonin të qëndronin mbi atë letër të vrugët, mbi ato shkronja të patrazuara dhe të ngatërruara me njëratjetrën, duke e fshehur edhe më thellë kumtin që e mbanin të ndryrë në brendinë e tyre. Derisa po i shikoja me ngulm ato shkronja, më bëhej sikur me qesëndi po më thoshin: Ti nuk na zbërthen dot o i mjerë! Ke shkelur në një truall të huaj, të panjohur dhe të rrezikshëm! Më mirë është të na lësh të qeta ne shkronjave të ngatërruara të

Allahut e të merresh me shkronjat tuaja kaure! Sa për ta ngushëlluar veten, erdha në përfundim se shkaku i mos zbërthimit të letrës, ishte stili sektar i të shkruarit, stil që nuk kishte asnjë ngjashmëri a lidhje me stilin e shkrimit të bekuar të paraardhësve.

E vetmja gjë që e deshifrova pa vështirësi ishte një numër telefoni dhe një i ashtuquajtur „profesor“ te i cili duhej të paraqitesha, dhe asgjë tjetër!

Në çast mu bë se dëgjova një cijatje dere diku nga dhomat e tjera të kullës sonë të moçme! Pas pak, pasoj një si kuisje dërrase në dyshemenë e vjetër që më erdhi si e shurdhër. Fill pas saj, u dëgjuan hapat e lehtë të nënës... ndërsa fërfëlliza, sikur me këmbëngulje kërkonte shpërqendrimin tim, me gjithë egërsinë e vetë u përplas mbi xhamin e hollë e të avullt të dritares së dhomëzës sime. Me erdhi keq prej xhamit, që ishte i shtrënguar të qëndronte neutral në mes dy botëve të armiqësuara çuditërisht për vdekje kundër njëra-tjetrës!

Padashur, në mendje m'u skalit pamja e hirshme e Fitit. Me erdhi disi e çuditshme, me disa tipare të pamjes së dadës Zejnebe... gji stolisur e plot shëndet! Sa e hareshme ishte atë ditë pasi ishim kthyer në kullën tonë të moçme, kur erdhi për vizitë me Cufin e gjyshen e saj. Kur ma zgjati dorën, pa u vënë re, krejt natyrshëm ma lëshoi në dorë një gjësend. Sa u tremba... qeshë skuqur gjer të veshët! Më vonë e pashë se ishte letër... Ishte letra e dashurisë së parë që me vinte nga një vajzë!

Derisa po i paramendoja sytë saj të shkruar, mu bë sikur ata sy më kapërdinë nga kjo kohë e nemitur duke me kthyer prapa, në një kohë të përdëllyer dhe idile të një mëngjesi të mugët plot trishtim e frikë, dhe... ki-ki-

ri-ki-ki, sikurse atëherë, po këndonin gjelat e parë!

... Atë mëngjes, bashkë më këngën e gjelave, nga gjumi na zgjuan çetnikët, me të shara e shkrepje armësh. Të trembur, pa u veshur mirë, na nxorën në oborr. Me britma na grumbulluan në mesin e katundit. As sot nuk e di se si me rastisi të ndodhëm i ndarë në anën e grave dhe vajzave. Ishte mëngjes i mugët e me shi, prandaj më kishin ngatërruar. Kjo kishte ndodhur edhe për shkakun e flokëve të mia të gjata! Fiti, ndërkohë mu kishte afruar pranë duke ma zgjatur një shami: „Lidhe rreth qafe, do të mendojnë se je vajzë?!"... më kishte thënë me zë të trembur. As tani nuk më kujtohet, se si më erdhi shikimi i saj në atë çast, por edhe sot e kësaj dite e ndjej një drithërimë të lehtë kur e kujtoj! Na grumbulluan të Arat e Mrizit. Disa njësite paramilitarësh filluan nga kontrollet nëpër shtëpi. Pasi i plaçkitnin gjësendet e vlefshme ua vënin zjarrin. Pasi e kishin përfunduar aksionin, marshuan drejt nesh:

U çuditëm kur pamë para tyre të lidhur Nakun e Shytëve. Nga mesi i paramilitarëve doli një burrë i veshur civil, me pallto të gjatë, me flokë gri, dhe me një nishan në faqen e majtë. Ju afrua Nakut. Me zë të thellë e pyeti:

„Pse je fshehur ë?" Ai nuk foli... nuk foli sepse Naku ishte shurdhmemec. Filloi të lëvizë kokën, këmbët dhe trupin për të treguar diçka, sepse duart, të vetmin mjet komunikimi, ia kishin lidhur prapa shpine. Dikush nga paramilitarët e thirri burrin civil

„Gospodine Janko, po flitet se ky është shurdhmemec!"

„Nuk ka gajle, edhe shurdhmemecët i merr plumbi!" tha, dhe nga brezi e nxori revolen duke e drejtuar drejt tij. Nga një distancë e afërme, rreth gjysmë metri, duke buzëqeshur

e tërhoqi këmbëzën. Bashkë me krismën e revoles dhe flakës regëtimë që doli nga tyta e saj e ngushtë, u shemb Naku përmbys para këmbëve të tij. Pastaj, i hakërryer u kthye nga ne:

„Ç'më shikoni ashtu ë? Marsh!" bërtiti me sa fuqi që pati, duke na bërë me shenjë drejtimin që duhej ndjekur. O Allah, ajo fytyrë e lëmuar, ajo pamje e qetë dhe engjëllore, ajo buzëqeshje dashamirëse që e kishte fshehur në brendi një kriminel të pa shpirt, më është ngulitur si thumb në mendjen time dhe nuk më shqitet dot. Sikur ta takoja edhe në mesin e njëmijë burrave të tjerë, atë fytyrë bullafiqe burri e me nishan në faqe, do ta dalloja!

Të ndarë nga burrat na detyruan të marshonim drejtë perëndimit. Isha i vetmi mashkull në mesin e të gjitha vajzave, nuseve, grave dhe plakave të katundit. Ato më mbanin gjithmonë në mes, larg syrit të regjur të paramilitarëve që të mos më diktonin. Isha e vetmja shpresë në rast se burrave dhe djemve të katundit do t'ju ndodhë ajo më e keqja, ajo më e tmerrshmja... vrasja! Por fatbardhësisht, duke ju mbështetur fuqisë së Allahut të Madhërishëm, atyre nuk ju ndodhi asgjë!

Fiti nuk m'u kishte shqitur për asnjë çast, edhe pse herë pas here nëna e saj i kishte folur qortueshëm! Në fillim të rrugëtimit se si e kisha një ndrojtje që ndodhesha në mesin e karvanit të përbërë nga të gjitha femrat e katundit. Ato qanin në heshtje. Të gjitha qanin pa përjashtim, por edhe shpresonin në lirimin e më të dashurve të tyre që kishte kohë që na i kishin zhdukur nga sytë! Duke i parë ato vaje në kor, edhe unë qaja në heshtje. Qaja kur e kujtoja se në mesin e karvanit të burrave që tani më na i kishin zhdukur nga sytë, ishte babai, mixha dhe Xuni! Lotët me rridhnin

pa ndërpre, dhe herë pas here i fshija me cepin e shamisë që kohë më parë ma kishte dhuruar Fiti. Në një rast kur më sy të përlotur pashë nga Fiti, ajo përmes mimike, duke vënë në lëvizje sy e vetulla më bëri më shenjë që mos të qaja më! Më erdhi turp dhe në çast pushova. E ndjeva veten keq që isha ç'burrëruar para saj... dhe para gjithë atyre grave. Ula kokën i dëshpëruar.

Por, vrasja e Nakut dhe fytyra e buzëqeshur e atij farë Jankut nuk më shqitej dot nga mendja, bile herë pas herë, edhe pse nuk dëshiroja, isha i shtrënguar ta rishikoja atë skenë tmerri! E rishikoja Nakun duarlidhur të përcjellë nga paramilitarët nën tytat e pushkëve, pastaj Jankun e buzëqeshur, krismën e revoles dhe shembjen e gjithë atij burri trup fuqishëm!... dhe e ndjeja se në shpirt me kaplonte një ndjenjë urrejtjeje për atë farë të ndyrë njerëzore... për atë farë kaure, të pafe e të pabesë... dhe vazhdimisht e lusja Allahun të ma jepte takatin të hakmerresha ndonjë ditë për Nakun e shkretë... dhe për të gjitha të këqijat që na i kishin bërë kaurët e pabesë!

Pasi u bashkuam secili me të dashurit e vet matanë kufirit, erdhi koha e ndarjes. U përqafuam me përgjërim, me shpresën se së shpejti do të takoheshim në trojet tona të lira. Sikur njeriu që gjatë ushqimit, kafshatën më të shijshme e ruan për në fund, ashtu edhe unë, përshëndetjen ndarëse, më të shijshmen dhe më të dhembshmen e ruajta për në fund. Të njëjtën gjë e kishte bërë edhe Fiti! Kur erdhi çasti i ndarjes, ajo ma zgjati dorën, pa e ndarë nga unë atë shikimin e saj prush. M'u afrua aq pranë sa që nuk e prisja një gjest të tillë nga ana e saj. Në fillim ia ndjeva aromën e këndshme të flokëve të saj të drejta e të gjata, dhe pastaj, e ndjeva puqjen e faqes sime me të sajën, që me erdhi e valë

prush. Ndërkohë, me gjysmë zëri fare pranë veshit i thashë:

„Do bëhesh nusja ime?!“

„Po! Në jetë të jetëve!“ – ma kthej.

As tani nuk e gjykoj dot se a bëra mirë apo bëra keq që e shfrytëzova rastin dhe me shpejtësi vetëtime e putha në faqe. Para se të largohej nxitimthi, ndjeva peshën e trupit të saj të mbështetej rëndë-rëndë në trupin tim, dhe në ndarje e sipër pashë fytyrën e saj të kuqe all! Kërcimthi ma kthej shpinën dhe iku tutje duke i valëvitë këndshëm flokët e gjata e të drejta. Unë ngela në mes të rrugës si i ngrirë. Para se të tretej prapa mureve të ndërtesave, kthej kokën vetëtimthi nga unë duke ma dhuruar për të fundit herë një buzëqeshje të pikëlluar, e cila më mbeti e ngrirë në kujtesën time!

Ashtu si i mpirë, pasi dola nga ngrohtësia e batanijes, me hapa të çrregullt ju afrova dritarezës. Me dorën e majtë e fshiva avullin mbi xham, dhe e vërvita shikimin jashtë. Në oborr pashë pjesë të theksuara të dritëhijeve që i krijonte mugëtira e mëngjesit dimërorë. Pashë koshin, hangarin, manin e moçëm në mesin e oborrit, bunarin, veturën e Xunit të parkuar pranë avllisë ashtu siç e kishte lënë ai, dhe në fundin e oborrit gërmadhat e shtëpisë sonë të re së cilës, pas përzënies sonë nga aty, çetnikët ia kishin vënë zjarrin! Për çudi kulla i kishte shpëtuar zjarrit, dhe me t'u kthyer e rregulluam disi, e mbuluam në disa vende çatinë që pikonte dhe u vendosëm në të. Tani jemi këtu, sepse ne nuk e patëm fatin të përfitonim nga ndihmat. E keni kullën, na thanë, dhe nuk u dukën më!

Duke parë jashtë nga dritarja fillova të ndjej të ftohtit që kishte filluar të ma përshkonte mbarë trupin. Pasi u

drodha edhe njëherë, fillova të tërhiqem, por edhe për disa qaste me mbajti si të ngurosur pamja e mrekullueshme e minares së xhamisë. Vështrimi me ngeli në pamjen mahnitëse të gjysmëhënës së shenjtë në majën e saj. Rashë shahadet: La ilahe il-la-llah,[16] duke u kthyer i tëri nga ajo gjysmëhënë e mrekullueshme dhe mu bë sikur isha duke u falur para Allahut të Madhërishëm!

Derisa isha duke i veshur pantallonat e vrugët që me rrinin shumë bukur, edhe pse pakëz të shkurtër, mu bë së dëgjova kur krrokati një korb. Si nga hera, zëri i tij vinte nga matanë kodrës. Nga dritarja e kullës sime gjithmonë atë kodër e shikoja të ndarë në dysh, në pjesën lindore e në atë perëndimore, me minaren si gozhdë në mes.

Pasi rashë shahadet dola në oborr. Pikat e shiut të mbështjella me fërfëllizë mu përplasën furishëm mbi fytyrë. E ndjeva se leshrat e rralla të mjekrës, nga shtytja e fërfëllizës m'u shtrembëruan sa në anën e majtë e sa në të djathtën.

Kur isha duke e mbushur kovën me ujë për ta larë fytyrën, pashë nga shtëpia e zjarrit, ku nga dritarja dallohej drita e venitur e kandilit. Qenka zgjuar nëna, thashë me vete duke e kujtuar lezetshëm kupën me qumësht të valë! Pastaj vështrimin e hodha drejt oxhakut të kullës që kishte filluar të nxjerr tymin e përzier me fërfëllizë dhe me pikat e çrregullta të shiut. Pasi i pastrova duart dhe fytyrën, çështë e vërteta unë desha të marrë abdes aty pranë dërrasës së abdes'hanës që e kisha ndërtuar me duart e mia, por fillova të dridhem nga të ftohtit, prandaj ika me nxitim drejt dhomës së zjarrit!

---

16 Nuk ka hyjni tjetër përveç Allahut

Nëna, si zakonisht me priti në këmbë. Ende pa e përshëndetur, ajo e mori ndër duar legenin dhe ibrikun me ujë të ngrohët, sepse e dinte se çfarë me nevojitej tani mua!

– A fjete mirë, biri i nënës? – me pyeti ajo me zërin e saj të çiltër, derisa në duar mbante shtrëngueshëm legenin dhe ibrikun, kurse në llërë të varur peshqirin.

– Jo besa hiç! Gjumë më të keq nuk me kujtohet të kam bërë ndonjëherë në jetën time, por, pasi ju luta Allahut me gjithë shpirt, dikur pas mesnate, ashtu i lodhur dhe i këputur siç isha, sikur isha kotur pak, por edhe në këtë grimë gjumë, me kanë munduar shumë do ëndrra budallaqe... do ëndrra çoroditëse... – thashë derisa isha duke zënë vend në stolin e drunjtë pranë oxhakut.

– Hair inshalla o bir! Hair! – tha nëna duke më vështruar me dhembshuri.

– Inshalla është hair oj nënë! – i thashë duke e afruar legenin pranë për të marrë abdes dhe për t'ia bërë me dije nënës se nuk kisha aspak dëshirë të bisedoja më!

– Ndoshta e ke nga kasaveti i asaj letre, apo...

– Çka? Për çfarë letre po më flet tash? – ndërhyra i nxehur.

– Nga rruga e gjatë që ke bërë dje, thashë! – tha ajo me gjysmë zëri nga frika se do të shpërtheja me atë zakonin tim të vjetër, duke e ndryshuar aty për aty temën e bisedës. Edhe kjo që tha, mua më mjaftoi. Për një çast mu bë se ajo nuk kishte folur, por më kishte hedhur të tërin në fund të bunarit në ujë të ftohët. Një palë mornica ma përshkuan tërë trupin!

– Lere atë letër tani! Nuk e kam kasavet letrën, por e kam nga rruga e gjatë që kam bërë! – fola vetëm sa për të thënë diçka.

Edhe tani, pas fjalëve të nënës, mu përforcua dyshimi se i gjithë kasaveti më vinte pikërisht nga ajo letër... nga ai dreq profesori me atë numër të nëmur celulari! Rrekjet e mia të deritanishme për ta shmangur nga vetja të vërtetën ngacmuese nga ajo letër, kishin qenë të pafrytshme, bile edhe kundër produktive, sepse ajo letër si me një stil djallëzor ishte bërë me këmbëngulëse, më zotëruese mbi mua, duke me shtyrë drejt një vendimi të panjohur që nuk i dihej fillimi, por, mbarimi jo se jo!

– Po ku e di unë e shkreta! Kështu më pat thënë Cufi i Laronjve! – vazhdoj befas nëna, që mua mu bë se ajo nuk po fliste por vetëm po vazhdonte të më hidhte ujë të ftohët me kovën e madhe të bunarit.

– Pse, kush i tregoi Cufit për këtë letër? – pyeta i hakërryer!

– Unë... kuku qyqja! Paskam bërë keq!?... – filloi të fliste ashtu siç e kishte zakon të shfajësohej kur bënte ndonjë gafë!

– Keq!? Edhe shumë bile! Sa herë të kam thënë moj nënë, që asnjërën nga librat, e as nga letrat e mia, mos t'ia japish kujt, ë? – e pyeta pa e përmbajtur dot zemërimin.

– Po mor bir, më ke thënë! Unë vetëm e luta të ma lexonte... të më tregonte se ç'farë shkruhej në të!... mu thaftë goja mu thaftë që i thashë! – mu përgjigj ajo duke e mallkuar veten.

– Po ku merr vesh Cufi arabisht moj nënë! U çmende edhe ti... t'lan mëndët krejt! – ia ktheva me zemërim të përmbajtur dhe i qetësuar, pasi qesh i sigurt se edhe nëse e ka pasur në dorë këtë letër, vetëm sa e ka rrotulluar pa e shkoqur asnjë shkronjë!

O Allah, bëma kabull zemërimin! – thashë me vete, dhe

me zë pëshpërime vazhdova: – Bismil-lahir Rrahmanir-rrahim!

Porsa e fala namazin e sabahut, u ktheva në dhomën time. E mbylla derën dhe qëndrova në këmbë duke kundruar çdo skaj me kureshtje. Dhoma ishte e errët. Një duhmë e rëndë sikur mi zuri hundët! Mu bë se sapo kisha zbritur në varr. Një palë mornica mu ngjeshën në mbarë trupin... sikur ndjeva të ftohtë. Brenda nuk kishte ndryshuar asgjë. Ashtu siç e kisha lënë para katër vitesh, ashtu edhe e gjeta. Sixhadeja ku lidhesha namaz ishte e shtruar në vendin e vet pranë murit. Shiltja ime ku kisha qëndruar i ulur me orë të tëra pranë stolit në formë të „X – it" ishte po aty, disi e rënduar nga lagështia. Për një çast në mendje mu feks nata e kaluar. U çudita si nuk i kisha vërejtur këto ndryshime para se të shtrihesha në shtratin tim pranë oxhakut? Sigurisht nga lodhja!

Pa cak lëviza nga vendi. Vetë këmbët me çuan pranë kamares në murin përballë ku ishin librat e mia, dhe sipëri tyre letra që ma kishte dërguar Imami para se të arrija në shtëpi. Në njërën anë me pëlqeu organizimi i tyre, por në anën tjetër më bëhej sikur ato që m'i kishte kumtuar Imami nuk ishin të vërteta! Ai me shkruante së kishin vendosur konspiracion të pathyeshëm, duke u kujdesur për njëri-tjetrin, për hallet e përditshme, për varfërinë që kishte trokitur në derën e secilit, për lutjet dhe ndihmat që u shpërndaheshin besimtarëve, duke filluar nga veshmbathjet e ushqimet deri të medikamentet dhe paratë e gatshme që ju dhuroheshin atyre që e pranonin konvertimin! Por, duke i krahasuar ato që më kishte shkruar kohë më parë Imami se ne, paraardhësit, ishim në epërsi shumë më të kënaqshme se sa grupet e tjera,

disi nuk i vërejta ato epërsi... nuk u ndava i kënaqur, sepse që nga koha kur zbrita nga avioni e deri sa arrita në shtëpi, syri mi zuri vetëm dy sish! Pra me një fjalë, nuk përputhej kurrkund letra e tij me realitetin që e pashë. Por, ndoshta vetëm kjo rrugë ishte vërtetë pak për t'i parë dallimet! Instinktivisht, e mora letrën nga dollapi dhe u vura edhe njëherë për ta lexuar. Nuk kishte ndryshuar asgjë! Aty ku nuk e kisha zbërthyer mbrëmë, nuk e zbërtheva as tani. Kureshtja vazhdonte të më brente pa pra! E rilexova ngadalë duke i hasur prapë të njëjtat fjalë kokëforta që nuk i zbërtheja dot, deri të numri i celularit! Atë e shkoqita prapë. Nuk qe ndonjë gjë e vështirë! Disa numra të radhitur njëri pas tjetrit, dhe asgjë më tepër.

Me letër në dorë u afrova pranë shtratit. U ula mbi dyshekun e zhubravitur nga përsiatjet e natës që sapo kishte kaluar. E futa dorën nën jastëk ku e kisha celularin. Disi i shqetësuar, fillova t'i shtypi numrat njërin pas tjetrit derisa e formulova të tërin, ashtu si ishin të shkruar në letër. Pasi i kontrollova edhe njëherë, e shtypa sustën dhe e vura pranë veshit. Pas pak çastesh, në veshin tim arriti sinjali i parë, me një ton të zgjatur. Derisa po prisja që sinjali të përsëritej, nga ana tjetër kumboi një zë i trashë burri: „Profesori!"

– Selamu alejkum zoti profesor! – ia ktheva me një zë që m'u duk se kumboi aq shumë sa që qesh i sigurt se kishte arritur gjer të shtëpia e zjarrit ku ishte nëna!

– Urdhëroni, kush jeni ju! – tha shkurt zëri nga ana tjetër

– Unë? Abdallahu jam!

– Aha! – klithi i gëzuar dhe vazhdoi: – sa më gëzove! Të them të vërtetën të prisja por jo kaq herët... komplet

ashtu siç të kanë përshkruar... i përpiktë, i saktë... Si jeni më shëndet, si keni kaluar në ato vendet e mia... me njerëzit e mi?

– Mirë! – ia ktheva shkurt.

– Dëgjo këtu! – ma preu fjalën tamam kur e kisha ndërmend ta pyesja për shëndetin dhe për gjëra të rëndomta; – Jam shumë i zënë. Nuk kam kohë të takohem me ju, të paktën jo brenda kësaj jave. Por, pa humbur kohë, të këshilloj ta vizitosh Abu Al Khalidin në zyrën e tij! E kam njoftuar për arritjen tënde. Ai të pret!

– Ashtu?

– Po! Ai do të uron mirëseardhje edhe në emrin tim! Unë vetëm do të uroj nga zemra për vendimin që keni marrë! Keni bërë një punë të mrekullueshme atje, dhe jeni kthyer tamam në kohën kur ne kemi më së shumti nevojë për ndihmën dhe punën tuaja... Është kohë e shkurtër që jeni kthyer dhe jam i sigurt se akoma nuk keni vërejtur asgjë nga ngjarjet, ndryshimet dhe pengesat që po na dalin neve, në kryerjen e obligimeve tona. Janë ngritur në këmbë kaurët nga mbarë bota dhe, ç'është edhe më keq, ju kanë bashkangjitur edhe një pjesë e madhe e sojit tuaj që veten e thërrasin mysliman, por në të vërtetë nuk e dinë se nga i bije dera e xhamisë, dhe vend e pa vend marrin si shembull të keq mjekrat tona synet, veshjet e shenjta të paraardhësve tanë të ndritur! Të gjitha këto zhgënjime po i përjetojmë rëndë kur po shfaqen nga populli yt i dalë feje!

Sa me erdhi rëndë kur më cilësoi edhe mua si pjesëtar të këtij populli të humbur. Vrullshëm ia ndërpreva fjalët duke i sqaruar se unë nuk i takoj më këtij populli të nëmur, por i tjetërsuar i takoj popullit të zgjedhur të

Allahut! Me modesti më kërkoi falje dhe vazhdoi bisedën ashtu siç e kishte nisë në fillim, në gjuhën e popullit tim të dikurshëm! Nuk e fliste keq por, se ç'kishte një theks karakteristik që i ngjasonte shumë gjuhës boshnjake. Tani mu kujtua se ai, shumë vite më parë kur kishte ekzistuar Jugosllavia, kishte studiuar në Akademinë Ushtarake të Sarajevës! Kështu ma kishte paraqitur Abu Al Khalidi... „Siç të ka shkruar edhe Imami, në Xhaminë e Madhe çdo ditë xhumaje po e ngritë zërin e tij të çjerrë, injoranti me damkë, Hafiz hoxha. Ai, një pjesë të xhematit, që nuk i kanë as dy fije mend në krye, po ju thotë së rruga e ndritur e paraardhëseve tanë të nderuar, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi ta, nuk ka qenë ashtu siç po e paraqesin disa faqezinj nëpër librat e tyre plot gënjeshtra. Ai e kishte kuptuar së atë turmë trutharësh që e besonte, para së t'i zbaviste me fjalët e tij mikluese, i kishte frikësuar duke ua nxjerrë përpara syve zjarrin e tmerrshëm të xhehenemit dhe duke ju thënë së po ndoqët rrugën e shëmtuar të paraardhësve, do të digjeni e të përvëlohemi në katran të valë! Ai kishte shkuar aq larg duke e mbushur shpirtin e tij haram, kur kishte thënë së asnjëri nga pejgamberet nuk kishin qenë mysliman, përveç hasretit tonë të ndritur. Ky qafir, pa pikë turpi po i merr në mbrojtje bektashinjtë e marrë që të dehur e këndojnë kuranin duke ju rënë daulleve e teneqeve, vallëzojnë të shpuar e të përhumbur duke u zhgërryer pas njëri tjetrit! Kundër këtyre qafirëve, pa humbur kohë, duhet organizuar luftë e ashpër, për ta ç'rrënjosur nga themelet këtë farë të keqe që po ia humb vlerat e larta islamit! Por, cilit duhet prerë gjuha më parë? – më pyeti, dhe pa më dhënë kohë t'i përgjigjesha vazhdoi: – Së

pari duhet t'i pritët gjuha e helmët Hafiz hoxhës e pastaj xhematit të tij gjytyrym e trutharë!"

Derisa po çuditesha për ato fjalë të papeshuara kundër Hafiz hoxhës, dëgjova kur më tha se vetëm rruga ime e denjë dhe gatishmëria për flijim tregon më së miri virtytet e moralit të lartë islam!... Tamam sa u bëra gati ta pyesja se për çfarë flijimi e kishte fjalën, dëgjova të më thoshte se pa humbur kohë duhej të takohesha me Abu Al Khalidin, i cili do të më jepte instruksione të reja! Assesi nuk më kujtohet se a më tha ditën e mirë, por nga ana tjetër ra heshtje. Edhe pasi thirra disa herë; alo, zoti profesor, alo, alo!... linja ishte ndërprerë!

Vallë për çfarë flijimesh e pati fjalën? – e pyeta veten derisa isha duke provuar përsëritjen e thirrjes telefonike, por vazhdimisht më vinte një zë i truar femre që me thoshte se personin që e keni kërkuar nuk ka qasje në rrjet, ju lutem provojeni më vonë!... Shejtane!

Ndërkohë, po më bëhej së sapo isha dalë nga një ëndërr!

TAKIMI

Sa u befasova kur pashë se në zyrën e tij ishte edhe njëri nga drejtuesit më të lartë të Bashkësisë Islame, shkëlqesia e tij, zotëri Hafiz Osmani. Jo vetëm që u befasova, por pata edhe një ndjenjë malli për mësuesin tim të dikurshëm të medresesë. Lëre ti së çfarë me tha dje profesori për të! Kisha vite pa e parë. M'u duk se kishte shtuar në peshë. Përreth çallmës ia dallova flokët e thinjura! Abu Al Khalidi u ngrit në këmbë. Me dorën në zemër u përul lehtë para meje. Flitej se rridhte nga soji i Muhamed Ibn Abdulvehabiut! Kishte qenë njëri nga mësuesit më të mëdhenj të selefinjëve, dhe njëherësh ishte njëri nga Sheikët më të pasur... dhe në fund, në bashkëpunim me organizatat humanitare, kishte arritur që t'i dilte në ndihmë këtij populli të uritur e të devijuar nga rruga e ndritur e Allahut. Duke i shfrytëzuar pozitat e tij, kishte formuar një ekip nga vendasit që do të

merreshin me përzgjedhjen e talentëve të rinj në radhët e rinisë myslimane vendase. Në krye të ekipit ishte emëruar Imami. Që nga përzgjedhja e tij, nuk kishte rreshtuar për asnjë çast duke udhëtuar sa në një xhami në tjetrën, duke ju thënë njerëzve se për të gjitha të ligat që e kanë përfshirë vendin tonë, duke filluar nga lufta me kaurët e deri të skamja e imoraliteti, kanë ardhur si shkak i shmangies nga rruga e ndritshme e Hazretit Muhamed, nga urdhrat e Kuranit Kerim, admirimit që po e shfaqin hapur ndaj kaurëve, heqja e ferexhesë dhe pirja e rakisë në vende publike! Thuhej gjithandej se ai kishte simpati të veçantë për të rinjtë! Në ndihmë ju dilte atyre të pa perspektivë, atyre që shoqëria i kishte lënë nën mëshirën e fatit. Të injoruarve u jepte shpresë, të vobektëve u jepte bukë dhe rroba dhe atyre të dalë dore u jepte këshilla duke i kthyer në rrugën e Allahut xhel-le shanuhu!

Si ngaherë, zoti Abu më priti me ngrohtësi të jashtëzakonshme. Xhybja e tij e gjatë dhe e gjerë, në formë kaftani të bardhë, që mbërrinte gjer në fundin e këmbëve më bëri përshtypje të veçantë, duke shfaqur para meje atë pamjen e tij madhështore. Pasi e ndreqi gutre-në[17] me një palosje të lehtë për ta nxjerrë më mirë pamjen e fytyrës, e rivendosi agall-in[18] mbi të, dhe me sjelljet e tij tani më të njohura për mua, më bëri vend. Nuk ishte hera e parë që e takoja me veshjen e tij karakteristike. Kisha dëgjuar se ai gjatë kohës sa qëndronte brenda zyrës së tij gjithmonë mbante të veshur kostumet e tij tradicionale, duke sjellë një pasqyrë domethënëse orientale. Pranë tij

---

17 Arab. Maramë apo napë që e mbajnë në kokë disa fise arabe

18 Arab. Rreth qelibari apo ebaniti që e vendosin në kokë disa fise arabe, për ta mbajtur më mirë maramën.

e ndjeva veten të fortë dhe të sigurt, njëherësh!

Ishte po ai Abu që e kisha takuar me dhjetëra herë gjatë studimeve. Për herë të parë isha takuar me të para dy vitesh. Pasi kishte marrë vesh për suksesin në punën time, me kishte ftuar në vilen e tij luksoze në breg të Detit të Kuq. Me kishte nderuar shumë, duke përgatitë darkë solemne, nga kuzhinierë të specializuar kinez. Pas darke më kishte ftuar andej nga haremi i tij që binte me pamje nga deti. Kishim zënë vend në frone përrallore. Pa vonuar kishte filluar muzika gazmore orientale, e përcjellë nga një kolorit vajzash valltare, të veshura ngjyra-ngjyra ku dominonte e kuqja dhe të stolisura me rruaza e perishane që shkëlqenin në dritat e forta të neonit. Herë pas here thithnim hashash me shisha[19]! Ndjehesha njeriu më i lumtur në botë, edhe pse herë pas here e ndjeja së kishim rënë në xhahilijet... por zoti Abu e di më mirë! Sipas ritmit të muzikës, edhe valltaret, njëra pas tjetrës aviteshin pranë meje duke tundur gjoksin e stolisura me perishane, barkun lakuriq e vithet gjysmëlakuriq të mbështjella me një tis të hollë, që me ndillnin epsh. Ndërsa, zoti Abu, herë pas here ma hidhte vështrimin e tij gazmor dhe duke më shkelë syrin, sikur me pyeste; „Hë si e ndjen veten tani?“

Zëri nervoz i Hafizit më solli në realitet! Në çast mu bë se prania ime kishte shkaktuar një shtendosje në bisedën e tyre. M'u bë sikur qëllimisht po ndërronin temën e bisedës, dhe tani sa ishin përqendruar në caktimin e një takimi të radhës në mes tyre, apo të dyve së bashku me një

---

19 Enë prej xhami që përdorët në vendet orientale për thithjen e duhanit apo hashashit, e cila mbushet me një sasi uji dhe tymi së pari kalon nëpër ujë duke u filtruar nga nikotina.

person të tretë që nuk përmendej emri në praninë time, por lihej të kuptohej se fjala ishte për një personalitet të lartë! Në çast mendja më shkoj se po flisnin për Imamin. Për shkakun e paraqitjeve të tij ekstreme para xhematit, flitej se ishte bërë mollë sherri në mesin e Bashkësisë. Thuhej se vetëm të korruptuarit i përkrahnin ato ide të krisura, kurse shumica ishin kundër.

Gëzimi im për praninë e Hafizit u fik ndërkohë kur ai vetëm sa luajti nga vendi, pa i bërë aspak përshtypje prania ime. Me një injorancë elegante, duke ma lënë dorën për një copë herë të zgjatur drejtë tij, përtueshëm lëvizi nga vendi dhe ma zgjati dorën e tij të butë... sa për adet! Në çast, një mori mendimesh mu rrokullisën në kokën time të rënduar. E dija se ky ishte njëri nga kundërshtuesit më të zëshëm kundër metodave të paraardhësve që po i shpaloste Imami në njërën anë, kurse në anën tjetër kishte qenë, dhe vazhdonte të ishte njëri nga kundërshtarët më të zëshëm jo vetëm kundër përqafimit të kulturës orientale, por edhe kundër përkthimit të librave të shenjtë sipas metodave të shkrimit arab, nga e djathta në të majtë! Ai thoshte; „*Siç e kemi mbrojtur kulturën tonë për pesë shekuj nën sundimin Osman, duhet ta mbrojmë edhe tani e tutje nga bastardët gjoja të fesë islame të cilët nuk kanë të bëjnë aspak me kulturën fetare, por me atë sektare!*“ Edhe pse Hafizi ishte njëri nga më të zotët brenda Bashkësisë Islame, kishte një injorancë të pashoqe kundër sekteve islame në përgjithësi. Mirë! Këtu kishte të drejtë! Edhe ne jemi kundër sekteve. Të gjithë besimtarët mysliman duhet të kthehen nga kanë ardhur deri sa ta arrijnë kohën e ndritur të hasretit Muhamed! Por ky hutaq, më së shumti e kishte ngritë zërin kundër paraardhëseve, dhe këtë e

kishte bërë gjoja në mbrojtjen e shtyllës së besimit islam të Ehli Synetit-suni, ashtu siç e kishin praktikuar dikur osmanlinjtë! Tani sa u bind edhe ajo pjesa budallaqe e trurit tim, se profesori kishte plotësisht të drejtë kur thoshte së këtij gjarpri duhet prerë gjuha para se ta ketë helmuar mbarë xhematin!

Derisa po e shikoja trupin e tij nga prapa, të veshur me shije, me kokën të kthyer pak nga e majta e me çallmën elegante sipëri, disi me shtini në gjynah. Me erdhi gjynah për kokën e tij të mjerë, që gjoja në emër të Ehli Synetit-suni, të njëfarë patriotizmi, njëfarë kultivimi kulturor, njëfarë tradite popullore ishte vënë këmbë e krye kundër hutbeve[20] të Imamit, të pranuara edhe nga Myftiu, që synonin kultivimin e ideve të reja të lutjeve, të mbështetura në përvoja të gjata të imamëve dhe myftinjve të ndritur arabë. Kishte shkuar aq larg, saqë, me kaçikun e tij kishte zhvilluar, dhe akoma vazhdonte të zhvillonte një luftë të ashpër kundër përkthimit të Kuranit Kelamullah[21] me shkronja kaurë dhe me ligje të gjuhës së ndritur të Allahut, me lexim nga e majta në të djathtë, dhe idesë së modeleve të reja të riteve.

Dalëngadalë, po më shpaloseshin kujtimet e shkuara, kur i ndrituri Imam më shkruante rreth zhvillimit të ngjarjeve; Ideja e Myftiut për përkthimin e Kuranit në fillim kishte qenë e fshehët, por pastaj, përmes Imamit që ishte njëri nga besnikët e tij, kishte filluar ta përhapte pak nga pak atë ide, së pari në rrethin e atyre njerëzve të Bashkësisë Islame që do ta përkrahnin, e pastaj edhe në rrethin e Nënkëshillave që dukej se kishin qëllim

20 Arab. Fjalime apo predikime
21 Arab. Fjalë e Allahut

kundërshtimi, duke i thelluar të çarat, jo vetëm në mes të drejtueseve të bashkësive dhe nënbashkësive por edhe në mesin e xhematit! Ndarja në mes të përkrahësve dhe kundërshtarëve kishte qenë e pashmangshme. Kishin plasur grindjet, sharjet dhe fyerjet e rënda kundër njëritjetrit. Një pjesë e madhe e të ashtuquajturve patriotë kombëtar që vepronin nëpër Këshilla, kishin protestuar ashpër kundër një botimi të tillë që sipas tyre, do ta cenonte rëndë, në njërën anë gjuhën, e në anën tjetër vetë Kuranin e shenjtë, duke i kërcënuar ideatorët e kësaj ideje me dorëheqje nga postet e tyre drejtuese e deri të qërimi i hesapeve fizike. Mirëpo Imami, i përkrahur edhe nga drejtuesi i financave Hoxhë Latifi ishin të vendosur në mbrojtjen e idesë së Myftiut, prandaj në kulmin e zemërimit Imami kishte thënë se përkthimi, si dhe modelet e reja të riteve do të bëhen me ju, ose pa ju! Puna kishte arritur deri të gjykata, ku qeveritaret e atëhershëm kaur, nuk kishin dashur të përziheshin në punët e fesë. Këto mosmarrëveshje duhet t'i zgjidhni vetë, pa ndërmjetësimin tonë, sepse për shkak të situatës së rënduar politike çdo ndërhyrje nga ana e shtetit do të interpretohej si përzierje në punët e brendshme të çështjeve fetare, kishin thënë ata duke ju lënë dorë të lirë të bënin ç'të donin. Pastaj çdo gjë kishte rrjedhur ashtu siç e kishte paraparë Myftiu. Kurani ishte përkthyer dhe botuar, deri diku me ligjet e gjuhës arabe, dhe ju kishte shpërndarë besimtarëve mysliman pak ditë para Ramazanit, kurse metodat e reja të riteve ua kishin lënë besimtarëve ta bënin vet përzgjedhjen. Me gjithë këmbënguljen e Hafizit që të vazhdohej rruga e riteve Hanefi ashtu siç e kishin trashëguar nga myftinjtë dhe

imamët e vjetër, disa besimtar, jo vetëm ritet e reja që i kishin futur në përdorim, por edhe veshjet i kishin ndërruar si burrat ashtu edhe gratë. Meshkujt mbanin pantallona të vrugët dhe pakëz të shkurtër, deri nën gju, tërleme[22] dhe shami me thekë të qëndisura me katror të kaltër apo të kuq, modele palestineze, kurse femrat mbanin tërlik sipas metodave saudite: Turp, – kishte thënë Hafiz Osmani. – Duhet të jesh i lumtur nëse rruga e filluar do të mbarojë këtu, – ia kishte pritë Imami me ironi dhe kishte vazhduar: – Prit dhe ca ditë kur do t'i sjellim modelet e veshjeve të grave afgane! Kulmi!... – kishte bërtitur Hafizi i tronditur.

Zoti Abu zuri vend në kolltukun e tij. Me buzëqeshje të fshehur në mes të leshrave të mjekrës së tij gri, zgjati dorën e djathtë dhe me bëri shenjë të ulesha në kërrigën përballë. Vetëm tani e vërejta se gjatë gjithë kohës sa ndodhesha në zyrën e tij, kisha qëndruar në këmbë. Mënga e gjerë e xhybes nuk u tund fare kur ai e zgjati dorën drejtë meje. Sa më lartë që e ngrinte dorën, aq më tepër zgjerohej mënga. Për një çast më ngjau në një gojë të hapur përbindëshi.

Zoti Abu kishte edhe një simpati të veçantë për mua. Kur ishim duke e falur jacinë në vilen e tij luksoze, me dëshirën e tij i këndova disa ajete nga sura Al Hamd dhe Al Ikhals! E kishte vërejtur se kisha një zë karakteristik. Pas faljes, pasuan lëvdatat për zërin tim të bukur që vetë Allahu i Madhërishëm ma kishte dhuruar, për stilin e interpretimit dhe dredhjen e zërit në kohën e duhur, duke i dhënë ngjyrë komplekse dhe krejtësisht të

---

22 Kapelë myslimane

pavarur nga mjeshtrit e mëdhenj të këndimit të sureve të shenjta. Ky stil, sipas tij, ishte guxim i madh, sepse në vete ngërthente një dalje jashtë kornizave të mjeshtërve të mëdhenj, që botës islame i kishin dhënë një vizion të qartë në thellimin e besimit përmes zërit dhe interpretimit karakteristik, pra, ishte një dalje me një interpretim të njëanshëm jashtë normave të kornizës përcaktuese, por në të njëjtën kohë, ky interpretim, përbrenda bërthamës së vet përmbante një tërheqje magjepse... sa që ngjasonte shumë në metodat që i kishin përdorur shekuj më parë paraardhësit e ndritur! Me duket se vërtetë kështu me kishte thënë! Pastaj, me kishte propozuar që mrekullitë që i kisha të fshehura brenda vetes sime, talentin e lindur që ma kishte dhuruar i madhi Allah, mos ta mbaja të ndryrë, por të nxirja jashtë bashkë me gjithë atë bagazh aftësish që ishin të fshehura përbrenda qenies sime, të pa zbuluara nga askush, bile as nga vetë unë, sepse kurrë nuk e kisha ditur që brenda meje qëndronin të fshehura thesare të tilla të mrekullueshme, të cilat krejt rastësisht ishin zbuluar prej shkëlqesisë së tij. Disa herë rresht më tha se do të ishte mirë që në të ardhmen t'i interpretoja me një pasion të vendosur, meloditë dhe ngjyrat e zërit t'i zgjeroja me ide të reja, të bëja seleksionime shtesë të atyre që pa dashur kishin shkarë pakëz nga melodia e dhënë nga Allahu dhe ishin ngërthyer më nuanca kaure...

Biseda në mes tyre u zhvillua në praninë time dhe pa teklif. U bisedua mbi ndërmarrjet e fundit të disa sekteve që po merren me fitne[23] që ndikuan dukshëm në përçarjen dhe ngatërresat përbrenda besimit islam.

---

23 Arab. përçarje

Hafizi, mendimet që i shfaqte me bëhej se nuk ishin fare të tijat, sepse ai ishte njëri nga fanatikët më të zëshëm për ta mbrojtur të pacenuar, siç thoshte ai, kulturën e popullit të tij të shumëvuajtur. Prandaj, me një zë të qetë vazhdonte të na i numëronte disa nga shkaqet e këtyre dukurive:

– ...se këto skandale në mesin e besimtarëve islam kanë ardhur si rezultat i keqinterpretimeve nga njerëz që punojnë për para dhe famë e jo nga njerëz që punojnë në emër të etikës dhe besimit. Kjo do të thotë se këtë nuk e bënin ata njerëz që me gjithë shpirt ishin të lidhur pas besimit dhe ndërgjegjes së plotë përbrenda Bashkësisë Islame, por e bënin ata që për synim kishin paranë dhe famën e tyre dhe vepronin të ndarë e të pavarur jashtë rregullave të Bashkësisë! Për të arritur deri të përfitimi i këtyre të mirave, gjatë interpretimit të studimeve të tyre pseudoshkencore, këta mjeranë, kishin arritur deri te radikalizmi i akteve të prera si, bije fjala, të ndarja e islamit dhe e luftës së shenjtë në njërën anë, dhe metodave që duhet përdorur për arritjen e sundimit të botës me anë të sheriatit në anën tjetër, tregues të qartë të lënies mënjanë të rrugës së Hasretit Muhamed duke bërë hutbe imam Aliun, Imam Huseinin, apo duke e imituar Imam Muhamed Abdulvehabiun. Këto metoda, që po përdoren gjithnjë e më shumë nga vendet orientale, i kanë zemëruar tej mase jo vetëm bashkësinë islame Hanefi por edhe bashkësitë e besimeve të tjera e veçmas besimin kaur.

– Keni të drejtë Hafiz i dashur, keni shumë të drejtë në mendimin tuaj, por unë këto që i thatë ju, do t'i formuloja disi pak më ndryshe! – ndërhyri zoti Abu, sikur ngutej për diçka, vazhdoi: – Zbulimet e mëdha shkencore, teknike dhe teknologjike, pjellë e mendjes

dhe dorës kaure, dalëngadalë po i zbehin funksionet e besimit, po krijojnë të çara dhe plasaritje nga ku idhujtarët të yshtur nga dorë e fshehët e shejtanit po arrijnë të futën në radhët e besimtarëve të ndershëm duke ua prishur mendjen, duke i tërhequr pas zbulimeve marramendëse si në art, kulturë, shkencë e teknikë... i ke parë të lëshuara në qiellin e Allahut satelit e raketa të pajisura me lloj-lloj aparatesh për marrje e dhënie si për valët e zërit ashtu edhe për fotografitë. Këto zbulime konkrete teknike po ndikojnë në mendjet e luhatshme duke i bërë të fascinohen pas tyre, dhe si pa vetëdije, çështjen e besimit po e fusin në abstraksion duke e humbur besimin të Allahu xhel-le shanuhu! Pas këtij fenomeni aspak të këndshëm për fenë tonë të ndritur, si hallkë zinxhiri po lidhet fenomeni i dytë, ku pikërisht ato mendje të luhatura që i përmenda pakë më parë, po e lënë prapa atë më të çmueshmen e mbarë njerëzimit; lindjen... atë që zë fill të shfaqet, atë që del, atë që zë të krijohet, atë që zë fill të ngjallët... si; lindjen (zbritjen) e Kuranit Kelamullah, lindjen (shfaqjen) në horizont të diellit, lindjen e hënës, lindjen e njeriut, lindjen e çdo krijese mbi dhé, lindjen e çdo të mire materiale... dhe ashtu të fascinuar shikimin e përhumbur e mbajnë andej nga perëndimi... nga ajo që ka filluar të zhduket prapa horizontit, të kthehet nga nuri i Allahut në hije shejtanësh, duke e shndërruar botën hyjnore në hije për t'u zhdukur pastaj në errësirën e përjetshme të xhehenemit! Kësaj katrahure po i prijnë vendet perëndimore që vetë Allahu me madhështinë e Tij i ka vënë pikërisht atje, në atë skaj të botës ku çdo gjë perëndon, përmbysët, humbët në errësirë, ku dominon imoraliteti, sëmundje të padëgjuara

ndonjëherë në historinë e njerëzimit, lakuriqësi turpe, pisllëqe xhunube[24], kurva e prostituta, burra të martuar me njëri-tjetrin, pfuh... farë e fëlliqur, – pështyu me duf, dhe po me atë ton vazhdoi tutje: – pra, këto nuk janë gjë tjetër vetëm fillimi i shenjave të para të shfaqjes së Dexhallit.[25] Të gjitha këto kanë bërë që reagimi i islamit të jetë në përputhje të plotë me rregullat e Kuranit famëmadh, ku thuhet se edhe Lindja, edhe Perëndimi i përkasin Allahut. Kjo thënie është fjalë e zbritur nga Allahu xhel-le shanuhu dhe e shkruar në Kuranin Kelamullah, që për synim ka luftën për pastrimin e këtyre dukurive të pista e të shëmtuara perëndimore, që dalëngadalë qenien hyjnore njeri janë duke e shndërruar në barazi të plotë me shtazët e urryera nga Pejgamberi, selamu alejkum! Ky është një qellim i lartë dhe hyjnor i islamit që ka për synim fikjen e të gjitha prapësive njerëzore të yshtura nga idhujtarët dhe kaurët e pafe, deri në arritjen e sundimit të plotë mbi botë sipas rregullave të sheriatit! Por, me keqardhje duhet të them i dashuri mik, se edhe ju arnautët sikur e keni shmangur në njëfarë mënyre rrugën e Allahut duke e harruar faljen drejtë Kibles dhe keni marrë kthesë të gabuar, drejt perëndimit, duke shpresuar se andej do t'ju vijë shpëtimi! Unë, urojë që me ndihmën e Allahut, kjo kthesë e gabuar e juaja të përmirësohet sa më parë që të jetë e mundur për t'i dhënë shembull të mirë Allahut që t'ju ndihmojë drejtë rrugëtimit tuaj të gjatë në synimin e aspiratave tuaja. Dhe jam i sigurt se kjo kthesë e juaja drejt Allahut do të ndodhë së shpejti, me paqe apo... me

---

24 Arab. Papastërti pas marrëdhënieve seksuale, mendimeve apo ëndrrave erotike.

25 Arab. Gënjeshtar

dhunë! Prandaj, po e them me sinqeritetin më të madh së kur erdha për herë të parë në vendin tuaj, për çudinë time, takova një xhemat të urtë, të dashur e të sinqertë që më dëshirë do t'i nënshtrohej vullnetit tonë të mirë për t'ju prirë drejtë rrugës së ndritur të selef-us-salih. Por, në sytë e këtij xhemati pashë frikë, mosbesim dhe trembje! Në fillim nuk e dija së nga kush ju vinte gjithë kjo frikë, gjithë kjo pasiguri... u dëshpërova! Pas pak kohësh, falë Allahut dhe punës këmbëngulëse të Imamit, arrita të kuptojë së e gjithë frika e mosbesimi vinte nga ju dhe nga ata qafirët e Bashkësisë suaj! Prandaj ne, pa hezitim ju rrekëm punës dhe një pjesë të mirë të xhematit tuaj, e veçmas të rinjtë e të rejat, arritëm t'i kthejmë në rrugën tonë të drejtë, të cilët u shpërblyen dhe do të shpërblehen nga ne, dhe në dynjanë tjetër do të kenë shpërblim edhe më të madh nga Allahu xhel-le shanuhu! Ja kështu, ne i shpërblejmë të devotshmit!... kurse ty, të kam ftuar ta ndash mendimin tuaj me mendimet tona, të na ndihmosh e mos të na pengosh, e veçmas mos ta pengosh Imamin gjatë përpjekjeve të tij drejtë rrugës së ndritur të selef-us-salih ! Vetëm kaq!

Pas një heshtje të shkurtër, Hafiz Osmani sikur kishte qenë në pritje të këtij çasti u ngrit në këmbë duke thënë:

– Izë! Ju faleminderit shumë për ftesën. Edhe më shumë ju falënderoj për pritjen e ngrohtë!

– Nuk po më përgjigjesh në kërkesën time Hafiz?! – pyeti zoti Abu duke u ngritur në këmbë menjëherë pas tij.

– Nuk kam ndonjë përgjigje për këtë kërkesë! – ia kthej Hafizi duke marrë drejtimin e derës.

– Domethënë, do të vazhdosh në qëndrimet tuaja profane?

– Po! – ia kthej Hafizi shkurt.

– Mos u nxito i nderuari Hafiz!... Mos u nxito në marrjen e vendimeve kaq të mëdha me fjalë kaq të vogla! Vendimet e mëdha zakonisht merren pas fjalëve të mëdha! Kam besim të Allahu i Madhërishëm se do ta gjejmë një mes në këtë mosmarrëveshje! Ju keni kaluar një jetë të tërë në shërbim të fjalës dhe ibadeteve të Allahut xhel-le shanuhu. Jeni falë në xhamitë më prestigjioze të botës, i keni vizituar sa e sa herë vendet e shenjta islame, keni mbajt ders[26] sa e sa herë para talebanëve të bekuar islam, keni bërë shërbesa fetare për besimtarët e bekuar e të varfër, keni dhënë zeqate dhe sadaka, dhe befas një ditë, kur ka ardhur koha që të gjitha këto shërbime që ia bëre fesë dhe Allahut xhel-le shanuhu, t'i kurorëzosh me shpërblime të mëdha, me pasuri e autoritet, ke filluar t'i mohosh të mirat që të presin krahëhapur? Unë po ua kujtoj edhe njëherë së ç'thotë Allahu në suren Muhamed: *„O ju besimtarë, respektojeni Allahun dhe respektojeni të dërguarin, e mos i çoni kot veprat tuaja!"* Pra, nëse nuk i respekton thëniet e të Madhërishmit, hiç pa dyshim së do t'i humbasësh veprat tuaja madhore! Jam i sigurt së humbja e tyre do të jetë, jo vetëm dhembje e madhe për ty, por edhe mëkat i pafalshëm për ne dhe nga Allahu do të kesh dënim të madh!

– Nuk është ky mëkat i nderuari Abu! Mëkat është të futësh përçarje në mesin e besimtarëve! T'i nxisësh njërin kundër tjetrit për qëllime përfitimi! Të përkthesh libra të shenjta në gjuhë të huaja duke ua mohuar metodat e tyre drejtshkrimore, duke ua mohuar kulturën popujve

---

26 Arab. fjalime, ligjërata

të tjerë islam se gjoja ata nuk na qenkan mysliman të vërtetë... pra me një fjalë të bësh apologji për atë që në të vërtetë nuk e meriton! Prandaj, po bëj çmos që t'i pengoj depërtimin e atyre rrymave që po shkatërrojnë jo vetëm besimin, por jetën e shumë besimtarëve të pafajshëm duke i futur në luftëra të përgjakshme kundër grupeve dhe fiseve shite a sunite, safi a rufainj, selefinj ose vehabinj... të yshtur dhe nën trysninë e disa pseudo dijetarëve, po i hanë kryet shoqi-shoqit, duke vrarë gra e fëmijë, duke sulmuar vendet e shenjta të islamit, xhami e mejtepe... dhe të gjitha këto po bëhen në emër të Allahut xhel-le shanuhu? Unë nuk dua të jem pjesë e këtyre ndarjeve, nuk dua që populli im të infektohet me viruse të tilla, nuk dua që populli im paqedashës e tolerant ndaj të gjitha besimeve të jetë viktimë e përçarjeve sektare orientale! – ia kthej pa pikë turpi Hafizi.

– Populli i juaj është infektuar... është i sëmurë rëndë që prej kohësh i nderuari Hafiz! Ilaçi i vetëm për shërimin e tij është Kurani Kerim! Ne ua sollëm... boshnjakët e morën...edhe iliridasit e morën... dhe pa pasur frikë së po nxjerr në pah ndonjë sekret, pa hezitim mund të them së ata po përgatiten për luftë të shenjtë kundër kaurëve të pafe... kurse ju, po tregoheni tepër kryeneç...

– Doza e tepruar nuk e shëron sëmundjen zotëri Abu Al Khalid, por e keqëson! Prandaj ata që morën mbidozë, do të janë të shtrënguar të dështojnë me turp...

– Ashtu? Ti do të thuash së Kurani Kerim qenka dozë e tepruar për ju? Ju po krijoni idhuj i nderuari Hafiz! I dini ju fjalët e Profetit tonë të Madhërishëm që ka thënë, se ditën e gjykimit Allahu do t'ua japë dënimin më të rëndë atyre që kanë bërë idhuj... dhe ata do të japin shpirt

sikurse edhe idhujt që i kanë krijuar vetë duke u përballur me zjarrin e xhehenemit?

– Një imam si unë, që i përket një populli tjetër nga ju, një gjuhe e një kulture tjetër nga ajo juaja, nuk ka se si mendon ndryshe përveç atyre që ia thotë zëri i ndërgjegjes, zëri i besimit dhe zëri i përvuajtur i popullit që i takon! Prandaj, ta mbrosh identitetin tuaj, pastërtinë tuaj nga rrymat sektare nuk do të thotë krijim idhujsh, por do të thotë ndërgjegjësim mbi rregullat që i besoj, mbi rregullat që ju shërbej dhe që ju shtrohem plotësisht, pa e qarë kokën se çfarë do të flasin përreth armiqtë, ziliqarët apo fanatikët!

– Do thuash se ti e paske ndërmend t'u qëndrosh besnik mendimeve tuaja profane? – pyeti Abu Al Khalid, dhe vazhdoi. – Siç jam njoftuar, edhe atëherë kur ishte puna e botimit të Kuranit Kelamullah, të përkthyer në gjuhën tuaj të nëmur, ishe kundër botimit sipas ligjeve të shkrimit të Allahut, por e humbe betejën! Kam përshtypjen se edhe kësaj radhe do ta pësosh të njëjtin fat... por megjithatë, të kisha parapëlqyer të kesh më shumë kujdes sepse mund të fluturojë koka siç i kishte fluturuar Ebu Xhehlit nën tehun e mprehtë të shpatës së profetit gjatë betejës së Bedrit!

– Ju po me kërcënoni!? – pyeti Hafizi me sy të zgurdulluar.

– Jo, ne nuk kërcënojmë askënd! Ne, paraardhësit e devotshëm e të denjë të islamit, e kemi për detyrë t'i njoftojmë të gjithë ata që e kundërshtojnë Allahun xhelle shanuhu dhe të dërguarin e Tij, dhe ata, nuk është se vetëm të mbyten ose të gozhdohen, t'u pritën duart dhe këmbët...

– ...por edhe të dëbohen nga vendi... – ndërhyra unë

me ton të ashpër dhe kërcënues!

– Mos u nxito o robi i Allahut, sepse i Madhërishmi dëgjon, sheh! – më ndërpreu me ton të butë Abu Al Khalidi dhe vazhdoi po më të njëjtin ton duke ju drejtuar Hafizit torollak: – kjo masë ndëshkuese është poshtërim në dynja dhe në botën tjetër do të kesh dënim të madh! Prandaj, edhe kësaj radhe do të rrekësh kot sepse ne, me emrin e Allahut xhel-le shanuhu, do t'ia arrijmë qëllimit me një sukses edhe më të madh se ç'ishte suksesi i përkthimit të Kuranit Kelamullah... sepse metoda jonë e punës mbështetet në atë që është e vlefshme dhe e nevojshme për ne, e jo në atë se ç'është e mirë e morale për ju e për xhematin! E ke të qartë tani zoti Hafiz?

– Po! Këtë e kisha të qartë para së të ma kishe thënë ti... por kjo, do të ketë pasoja fatale! – ia priti Hafizi, dhe vazhdoi me të njëjtin ton: – ju po e quani sukses botimin e Kuranit, kurse unë e kam quajtur atëherë dështim me pasoja të rënda, dhe po ta them edhe tani se ishte dhe vazhdon të mbetet dështim... dhe jo vetëm dështim, por edhe mëkat... mëkat i pafalshëm kundër vetë Kuranit Kerim! Do t'i numëroj arsyet pse ishte dështim, dhe pse mëkat: Që gjuha ime të shkruhet dhe të lexohet sipas stilit arab, nga e djathta në të majtë, nuk me tremb aspak! Edhe sikur të vazhdohej në të njëjtin stil, me përkthime dhe botime shtesë të librave të tjerë si e atyre artistik, shkollor, shkencor e mjekësor, nuk do të trembesha dhe ju nuk do të kishit bërë kurrfarë mëkati! Edhe sikur të mos lexoheshin fare ata libra, edhe sikur të hidheshin vend e pavend dhe të zhdukeshin në mënyrat më barbare, në mënyrat më mizore dhe në mënyrat më të ndyra nuk do të ngarkoheshit me mëkate! Por, ky përkthim sakat

i Kuranit të shenjtë, do të vdes pa u shijuar fare nga përdoruesit e kësaj gjuhe të bekuar! Kurse unë, si atëherë, ashtu edhe tani i trembem kësaj vdekje, sepse bashkë me të do të vdes interesi për fenë dhe madhështinë e saj! Besimtarët do të ndjehen keq kur do ta marrin vesh se për leximin e Kuranit Kerim në gjuhën e tyre, së pari duhet ta mësojnë një stil të ri të të lexuarit. Sigurisht se ata nuk do ta torturojnë veten aq gjatë duke mësuar edhe njëherë atë që e kanë mësuar dikur, shkrim-leximin në gjuhen e tyre amtare por të shkruar me ligje të një gjuhe të huaj...

– Do të thuash së gjuha e Allahut për ju qenka gjuhë e huaj? – e ndërpreu me ton të çuditur Abu Al Khalidi

– Po! Për mua dhe për popullin tim, gjuha juaj, edhe e Allahut qoftë ajo, është e huaj! Fatbardhësisht, Zoti nuk na ka harruar as ne! Na ka dhuruar një gjuhë të ëmbël, të bukur e të pastër që e flasim me përkushtim e krenari, dhe e shkruajmë rrjedhshëm e me plot respekt që prej mijëra e mijëra vjetësh... – ia kthej pa keqardhje Hafizi. I skuqur nga turpi ula kokën poshtë. Pas pak, duke shikuar vrazhdë nga unë, vazhdoj: – Prandaj, edhe ata më të devotshmit, që do të rrinë me orë të tëra duke i kënduar suret e shenjta në Kuranin famëmadh, do të jenë të përqendruar të metoda e re e leximit nga e djathta në të majtë, dhe krejtësisht të shpërqendruar nga metoda e të kuptuarit së ç'farë po lexojnë! Të dëshpëruar, do ta lënë mënjanë si gjë bezdisëse për shkak të metodës së shkrimit e kurrsesi për shkak të sureve të shenjta që janë të shkruara në të... pastaj, do ta deponojnë nëpër rafte apo dollapë si gjë dekorative, dhe askush nuk do të merret më me të. Pas indiferencës, duke e deponuar nga një vend në tjetrin, do ta humbë edhe vlerën e dekorit dhe

do të përfundojë diku në ndonjë arkë të vjetër e të bluar nga tenja, në ndonjë sënduk me rroba grash, në ndonjë dollap apo çështë edhe më keq, në ndonjë bodrum të errët të përzier me vjetërsira të pavlerë që presin radhën e zhdukjes, në ndonjë kasafortë me lagështirë ku do ta brejnë minjtë dhe insektet e tjera. Fletët e mbushura plot me sure të shenjta, do të zverdhën nga myku, shkronjat do të fshihen nga lagështia dhe do të zbutet zamka për tu bërë pastaj ushqim i kërkuar minjsh, faqet do të ngjitën me njëra tjetrën kurse fëmijët do të lozin me to. Do t'i shkarravisin duke i shkoqë pa asnjë dhembje... dhe plakat do ta ndezin zjarrin me fletët e tij! Do të shkatërrohen nga zjarret e përmbytjet, dhe nëse ndonjëra do t'i shpëtojë katrahurës që rastësisht apo qëllimisht kishte ngelur në fundin e ndonjë arke, edhe pasi ta kenë zbuluar dhe me ngazëllim do ta marrin në dorë, pas përpjekjeve të para për ta shkoqitur leximin, do ta hedhin tutje si gjë pa asnjë vlerë!... pra mua, nuk me trembin aspak as veshjet apo pamjet e besimtarëve, e as dallimet rituale ne mesin e tyre, por me trembin përçarjet dhe urrejtjet përbrenda sekteve që duan t'ia hanë kryet njëri tjetrit e që do ta çojnë boten islame drejtë gjakderdhjes! Me trembin çorientimet e xhematit, hutimi i krijuar në mesin e besimtarëve se cilit halif[27] duhet besuar apo nga cili autoritet duhet të presin një fetfa që do ta ketë flamurin prijës të islamit, që u mbushën rrumbullak trembëdhjetë shekuj në kërkim të tij, dhe islami s'po e gjen se s'po e gjen dot!

– ...dhe këto janë arsyet? – befas e ndërpreu Abu Al Khalidi.

---

27 Sundues i gjithë myslimanve

– Po! Këto janë vetëm disa nga arsyet, kurse arsyet e tjera janë metodat profane të riteve të dala nga sektet selef-us...

– Nuk ka nevojë të vazhdosh me arsyet e riteve të paraardhësve i nderuari Hafiz! I kam dëgjuar disa herë! Me mjaftojnë boll këto që i the... por më vjen keq për popullin tuaj, sepse po e kthen në mjerim dhe në totemizëm, në mosbindje e në mëkat që herët a vonë do të ndëshkoheni nga Allahu xhel-le shanuhu, ashtu siç e kishte dënuar popullin e Nuhit duke u përmbytur në ujë, si popullin e Adid duke e vrarë nga erërat, si popullin e Themudit që ulërimat e tmerrshme ua kishin plasur zemrat, si popullin e Lutit të zhytur në homoseksualitet që i Lartë-Madhërishmi i ndëshkoi me gurë, si popullin e Shuajbit që Allahu i goditi me tërmet apo Faraonin dhe popullin e tij që e mbyti në det... të gjithë këta popuj, Allahu i Madhërishëm i kishte falë mysliman dhe që të gjithëve ua kishte dërguar pejgamberet, por ata e lanë në harresë udhëzimin e Tij prandaj... – dhe me një buzëqeshje përçmuese ndaj tij vështrimin e hodhi nga unë, që mua mu bë sikur donte të thoshte: „E sheh këtë mjeran se ku ka rënë?“ Pastaj me ton të qetë vazhdoi: – nuk është me rëndësi se çfarë veshje ka besimtari i Allahut xhel-le shanuhu, nuk është me rëndësi nëse i ngritë apo jo duart me rastin e tekbirit, i hapë apo i mbledh këmbët... me rëndësi është që besimtari ta vendosë kokën në sexhde pesë herë në ditë, dhe atë, vetëm për Allahun xhel-le shanuhu!

– Atëherë ç'kërkon nga unë?... – pyeti i çuditur Hafizi

Vetëm tani, pas fjalëve të fundit të Abu Al Khalidit, sikur me erdhi zemra në vend, dhe pa menduar gjatë ju drejtova Hafizit:

– Merr vesh ti apo jo, vetëm këto që i tha shkëlqesia e tij janë me rëndësi dhe më mirë do të ishte për ty, ta mbyllësh gojën para se ta kemi mbyllur ne, jo vetëm gojën, por edhe sytë! Dhe... – në çast vështrimi i rreptë i Abu Al Khalid me detyroi ta ndërpres fjalën në mes, pa arritur t'ia them ato që i mendoja, ato që me vlonin nëpër bark nga zemërimi dhe me vete po mendoja: „Si guxon ky hutaq të flas me këtë gjuhë gjarpri?"

– Çelë, edhe ti a?...

– Nuk më quajnë Çelë por Abdallah dhe shiko së çfarë po flet së për ndryshe... – ju përgjigja ashpër dhe me inat që ma kujtoi emrin tim të dikurshëm!

– Çfarë për ndryshe ë? Mbylle gojën ore mistrec i tjetërsuar... tradhtar i popullit tënd! S'të të vjen turp! – më tha duke me shikuar me një shikim të egër dhe vazhdoi duke ju drejtuar Abu Al Khalidit: – Kurse ti spurdhjak, lutu te Allahu si të duash atje në vendin tënd... edhe këtu në zyrën tënde po deshe, nuk do të përzihem fare... por këtu, në vendin tim, në tokën time, para xhematit tim do t'i përdorë praktikat e lutjeve ashtu siç m'i mësuan baballarët e mi të trashëguara brez pas brezi, siç m'i mësuan imamët e mëdhenj e të nderuar, prijës të denjë të kombit dhe të fesë! – tha Hafizi në kulmin e zemërimit, dhe pa na shikuar fare mori yrysh nga dera!...

– Ne i kemi mbjellë filizat tonë në këtë tokë të nëmur e të çnderuar nga fara kaure i nderuari Hafiz! – ia ktheu me ironi Abu Al Khalidi, duke hedhur vështrimin nga unë dhe vazhdoi: – E sheh këtë talibje? Ka plot të tillë, dhe çdo ditë po shtohet numri i tyre... ua zgjattë Allahu ymrin...

– Këta janë mjeranë të fesë dhe të kombit! Ashtu siç e tradhtuan popullin e vet, duke u shndërruar në atë çfarë

nuk janë, ashtu do t'ju tradhtojnë edhe ju nesër, kur të marrin vesh së ju do t'i trajtoni ashtu siç janë në të vërtetë, pjesë e huaj në trupin tuaj! – ia ndërpreu fjalën Abu Al Khalidit, dhe në kulmin e zemërimit duke me shikuar mua me urrejtje të papërmbajtur, doli jashtë.

– Këta nuk janë mjeranë, o Hafiz... por janë ajka e fesë së madhërishme islame që ka filluar të lulëzojë në këto vende të nëmura të Arnautistanit! Mjeran dhe i pavlerë do të mbetesh ti bashkë me xhematin tuaj trutharë!

Qesh i sigurt se fjalët e fundit Hafiz Osmani as që i dëgjoi. Pakëz i kërrusur dhe me kokën varur nga e majta, e pashë në fundin e korridorit kur mori nga e djathta ku ishin shkallët... kurse mua, me ngeli hatri nga zoti Abu, që nuk më mori nën mbrojtje ashtu siç e prisja dhe siç e meritoja duke me shpallur pjesë të popullit të tij hyjnor! Vallë, mos jam trup i huaj në mesin e popullit të zgjedhur të Allahut?

– Një njeri i tillë, nuk e meriton mëshirën e as mbrojtjen e Allahut xhel-le shanuhu! Mjaft më me gudulisje kundër kësaj fare të ndyrë... mjaft! Allahu kërkon vdekjen e tyre! Allahu kërkon kurban! Allahu kërkon kurban! Allahu kërkon kurban! – mi ndërpreu mendimet e liga Abu Al Khalidi. Pastaj, për një copë herë ngeli duke i lëvizë vetëm buzët dhe duke shikuar në një pikë të pacaktuar diku në mesin e tavanit! – Amin! – thirri me zë të butë duke e përkëdhelur lehtë me të dy duart fytyrën e vetë. Pas pak, zgjati dorën drejt meje duke ma dhuruar një zarf të mbyllur; – E ke dhuratë nga Profesori...

Pas disa ecejakeve brenda zyrës së tij të gjerë, u kthye i tëri nga unë duke më shikuar me sy të zgurdulluar. Pas një heshtje të gjatë më tha:

– Kësaj radhe, Allahu do të na i falë të gjitha mëkatet... por jo edhe Hafizit! Atë e ka dënuar si sfidues, si mosbesimtar, si të pa bindshëm... prandaj atij nuk do t'ia falë mëkatet! Allahu e ndjeftë shpirtin e tij mëkatar! Amin!

– Amin! Vërtetë Allahu ia falë mëkatet atij që do – thashë duke e zgjatur dorën drejtë tij dhe vazhdove më të njëjtin zë; – dhe e dënon atë që do![28] – thashë duke e kthyer dorën andej nga sapo doli Hafizi jashtë.

Abu Al Khalidi tundi kokën në shenjë pohimi duke më shikuar më dhembshuri. Për një çast ngela si i hutuar dhe nuk dija si të sillesha para zotërisë së tij. Pa u vërejtur e peshova zarfin duke e paramenduar vlerën që mbartte brenda, kur befas me pyeti:

– Nuk ndjeheni mirë?

– Jo edhe aq mirë! Pse?

– Një falënderim nga ana e juaj nuk do të ishte i tepërt!... por, ndoshta jeni i lodhur nga rruga?

– Shukran![29] Po për Allah! Mbrëmë kam fjetur keq. Me kanë munduar ca ëndrra... dhe ky hutaqi që sapo iku me hutoi fare... me falni, por ndjehem disi i shpërqendruar!

– Ëndrra the? Në lidhje me çka biri im? – me pyeti i befasuar sa për një çast i ndritën sytë! Nuk e prisja një reagim të tillë, prandaj për disa çaste e ndjeva veten krejt të hutuar!

– Po...

– Fol... thuaje pa hezitim biri im! – me nxiti të flisja sikur të kisha parë një ngjarje të vërtetë e jo një ëndërr!

– Kam frikë së po e sfidoj Allahun!

– Jo biri im! Zbërthimin e ëndrrave e ka lejuar i

28 Kuran 2: 284

29 Arab. Faleminderit

Madhërishmi. E ke parë se sa bukur na e përcjell përmes sures Jusuf! Prandaj, thuaje pa hezitim!

– Nuk e di saktë, por... pashë një qiell pa yje, një dritë nga varret e idhujtarëve, pastaj një kalorës mesjetar, një burrë i veshur me xhelabije[30] që rrinte nën një kupolë të ngushtë, dhe një korb... e dëgjova krrokëritjen e tij, disi të përzier ma krrokëritje mëllenjash!...

– Ma thuaj më hollësisht biri im!

Derisa po ia tregoja ëndrrën, herë pas here më bëhej se disa grimca të saj, që nuk mu kishin kujtuar më parë, me shfaqeshin tani në trurin tim të përqendruar, dhe pa u shpërfillë nga ato që isha duke i thënë, e mata veten se nëse edhe ato grimca duhet t'ia thosha atij, apo t'i mbaja të ndryrë në kujtesën time vetëm për vete! Dhe ashtu bëra! Në disa vende qesh i shtrënguar të lakoja pakëz të vërtetën duke e rrethuar me pak fantazi që me shfaqej aty për aty, por asnjëherë nuk e cenova strukturën bazë të ëndrrës, edhe pse në disa vende e zbukurova pak! Kur e mbarova me pyeti:

– Me flet për përfytyrime, apo për ëndërr të vërtetë?

– Nuk flas për përfytyrime, por për ëndërr të vërtetë, sepse e pashë derisa isha në gjumë! – u përgjigja i vendosur por edhe sedër vrarë njëherësh.

– Këto ëndrra shfaqen zakonisht nga lodhja dhe shqetësimet nga të panjohurat që të presin... nuk e besoj të jenë kumte! Por, megjithatë e pëlqej që pa humbur kohë të shkosh për një vizitë te magjistari!

– Te magjistari?– e pyeta i habitur, edhe pse e ndjeja se kisha nevojë për një konsultim me dike, por nga frika se

---

30 Arab. Fustanellë që e veshin burrat

po bëj haram as që e kisha menduar më parë një gjë të tillë!

– Medoemos! Sot të shkosh... më së largu nesër në mëngjes! Është interpretuesi më i mirë i ëndrrave!

– Nesër në mëngjes do të shkoj. – ia ktheva pas një hamendjeje çasti.

– Shumë mirë! Me njofto pastaj, dhe... kujdes zarfin! Tani vrapo pas tij! – më tha duke lëvizë pak kokën anash në shenjë që ta përndjek prapa Hafizin.

Derisa po i zbrisja shkallët, në vend që të bëja Istigfar[31] pa dashje thashë: „Rahmet i pastë shpirti!“ Pasi këqyra majtas e djathtas se mos me dëgjoi kush, i çliruar se s'pashë njeri të gjallë përreth meje, e korrigjova gabimin dhe bëra istigfar, pastaj i zbrita shkallët dy nga dy!

---

31 Lutje për falje mëkatesh

FITI

Jsha me Dilin, kështu e thërras unë Dilinën, shoqen time më të ngushtë! Ajo është ca më e re nga unë, e bukur dhe e zgjuar. Tani është rritur ca e më kupton, e jo si dikur, kur unë i flisja për dashuri, nga turpi i ulte përdhé syçkat e saj të shkruara. E dini ç'më tha një ditë? Derisa ishim duke biseduar për libra e filma dashurie, ajo si me ndrojtje me tregoi se e kishte takuar një djalë derisa po kthehej nga shkolla. Ishte takuar ballë për ballë me të, dhe kur kishin qenë fare pranë njëri-tjetrit, ai e kishte shikuar disi më ndryshe nga shikimet e rëndomta. Pasi e kishte lënë prapa shpine, nuk ishte duruar dot dhe e kishte kthyer kokën për ta parë nga pas. Ç'të shihte, edhe ai, sikur t'i kishte treguar dikush se edhe Dili do ta kthente kokën për ta parë, kishte ndaluar në mes të rrugës dhe ishte kthyer drejt saj duke e shikuar si i shastisur! Pastaj e kishte pyet si quhej, kjo i kishte treguar: Dilina, pse me

pyet? Ai ju kishte përgjigj: Si pse! Vajzë më të bukur ende nuk më ka zënë syri! T'marrsha nuse! Dili, e turpëruar e kishte ulë kokën përdhé, dhe kishte marrë rrugën për në shtëpi. Disa herë e kishte kthyer kokën prapa, dhe gjithmonë e kishte parë në të njëjtin vend duke shikuar drejt saj. Pastaj, më tha se nuk po e shqiste dot nga mendja! Ashtu?, i thashë unë jo e befasuar, por e sigurt se Dili kishte rënë në dashuri. I thashë edhe asaj: Dili, ti tani je vajzë e rritur... e rritur tamam për dashuri! Ashtu thua?, më kishte pyetur duke me shikuar me ato syçkat e saj të bukura! Po, ashtu them, sepse ashtu është! Bile, po të them shkoqur, i thashë, ti ke rënë në dashuri! U skuq e tëra dhe hodhi vështrimin për tokë, duke belbëzuar: „po unë nuk ia di as emrin!..." Pra, isha me Dilin duke u kthyer në shtëpi. Që nga larg, pranë varreve të Shehitve, pamë një si fantazmë çoroditëse njeriu që ishte kthyer andej dhe i shikonte ato varre të rrafshuara. Nuk na bëri përshtypje fare. Na ishin mësuar sytë që herë pas here të takonim djem të rinj të çoroditur me rrobe dhe pamje orientale, disi ndryshe nga veshjet që i bartin djemtë tanë, prandaj nuk ia vumë veshin, bile edhe bëmë shaka me pamjen e tij çoroditëse. Ç'është e vërteta, unë qesh e para që e ngacmova Dilin, duke i thënë se nëse ai çuni që e ke takuar ditë më parë, sikur të shfaqej me këtë stil, si do të kishe reaguar? Nuk e di, mu përgjigj Dili, por pas pak ma preu shkurt: Do të më vinte turp të me shihte dikush pranë tij... do të më dukej vetja sikur jam dashuruar në një djalë të huaj, disi si në ata djemtë e shkretëtirave që udhëtojnë kaluar mbi deve, që i kam parë në televizor! Pasi u afruam edhe ca, mu bë se pamja e tij ngjasonte me pamjen e Maksutit, për të cilin dikur pata pasur respekt

si njeri serioz e fetar i shquar, por kur e vërejta se ai respektin tim kishte filluar ta keqpërdorë, ju largova fare dhe as sytë nuk ia hodha më! Por, ai këtë ndryshim timin e mori si nazeqar, prandaj sa herë e takoja nuk me shqitej pa me thënë ndonjë fjalë banale apo duke me shikuar ngultas me ata sy, si prej të marri... bile nuk e di se a e pat përfunduar Dili fjalën, kur ai brenda gjysmë çasti e hodhi një vështrim të rreptë drejtë nesh dhe sikur të mos kishte vërejtur gjë, u kthye andej nga varret. Nuk ishte Maksuti! Sa e ndjeva veten të lehtësuar... por ndërkohë, në çast me erdhi si fytyrë e njohur! E pashë më mirë nga prapa! O Zot i madh! Pamja e tij më sëmboi në zemër. Ishte Çeli! Prapë dyshova. E shikova më kujdes të shtuar edhe njëherë nga gjysmëprofili! Jo, jo! Nuk më gënjejnë sytë! Ai ishte! Desha t'i flisja, ta shaja, ta mallkoja dhe të largohesha njëherë e përgjithmonë prej tij, por m'u lidh gjuha në fyt! Jo, jo thashë me vete, kurrsesi nuk duhet të flas në prani të Dilit! Disi, mu bë së më pengoi ajo njomëzake... prania e saj... por, pas pak çastesh, nuk qesh aq e sigurt në ishte vërtetë Çeli im i shtrenjtë apo dikush tjetër i ngjashëm. Shkurt, dyshova! Vërtetë, dyshova në ishte Çeli im... dhe ashtu me pëlqente; të dyshoja e mos të ishte... edhe Maksuti po të ishte, nuk do të me prishej aspak qejfi! Mos u ngut, sikur i thashë zërit të brendshëm që me yshtte t'i hakërrehesha me fjalë e grushte njëherësh! Mos u ngut, më tha prapë zëri, se mund ti bija më qafë kot së koti njeriut të huaj! Dyshimi mu shtua edhe më, kur pashë se ai nuk reagojë fare kur më pa. Bile sikur t'ju kishin shfaqur lugetërit nga ato varre të vithisura që ishte duke i shikuar, ashtu ju dukëm edhe ne, u kthye andej sikur shtihej se nuk kishte parë asgjë! Adet i ri, po

thotë gjyshja për këta të mjerë! Fill, pasi e kaluam, me pëshpëriti Dili:

– Fiti, mua mu bë se Çeli ishte!

– Po Dili, ai ishte!... nuk e prisja kështu? – u përgjigja me një zë të mbytur duke e ndalur me zor ngashërimin!

– Çdo të bësh tani? – me pyeti qetë me atë zërin e saj të padjallëzuar!

– Nuk e di, ndoshta nuk ishte ai! – i thashë edhe pse nuk kisha më asnjë dyshim.

Ishin mbushur katër vite pa e parë. E prisja me padurim ardhjen e tij, por disi ndryshe! Ndoshta ai nuk ishte Çeli im, por dikush tjetër, i ngjashëm me të, i largët, i huaj... jo, jo! Nuk duhet gënjyer veten me këto broçkulla, sepse ai ishte, dhe pikë! O zot, ku kishte rënë! Nuk desha t'ju besoja syve! E kisha paramenduar krejt ndryshe takimin me të... të më shikonte ëmbël me ata sytë e tij të shkruar. Të më shtrëngonte me mall në përqafimin e tij... si dikur... e jo të më shmanget sikur të ishte takuar me dreqin e mallkuar! Unë e ëndërroja ta shihja disi si Hafizin, por të ri, të veshur me rroba kat, me këmishë të bardhë e kravatë me vija kuq e zi, fytyrë bardhë, e i rruar me shije si të gjithë djemtë e rinj, me flokë të shkurtra... kurse çallmën ashtu siç me kishte premtuar, ta vëntë në kokë vetëm në xhami gjatë kohës së riteve... kështu e doja, kështu me kishte premtuar, kështu e prisja... O Zot, ç'kishte ndodhur me të?... ç'i kishte ndodhur shpirtit të tij të dëlirë?... dhe duke qarë pa gjetur ngushëllim rashë përmbys në shtrat! Herë pas here, e ngushëlloja veten me të vetmin argument që me kishte ngelur akoma. Dyshimi! Ndoshta nuk ishte ai! Derisa po qaja e trishtuar, edhe këtë argument të fundit, pa pikë dhembje e shembi gjyshja

kur e dëgjova t'i thoshte nënës se e kishte takuar Çelin! Sa kishte ndryshuar... i shkreti djalë! Kishte lajthitur fare! Mezi e njoha! Ju afrova ta përshëndesja, t'i flisja, t'i uroja mirëseardhje dhe ta përqafoja si dikur por, sikur ta kishin sulmuar shtrigat, iku tutje si i çmendur! E mjera nëna e tij, thashë! I iku djali! Ai tjetri i vdiq në lulen e rinisë, kurse ky i paska fluturuar nga mendja! I shkreti djalë... nuk ishte për doktor ai, jo!... ishte n'derexhe me i fry hoxha... me i shkri plumb mbi krye apo me i shkru' hajmali... po, po! Për hajmali ishte qyqani!

Pasi e mbylla derën, ia dhashë së qarës me ngashërim!

Derisa po qaja e trishtuar, me shpresa të humbura, pa asnjë ngushëllim, fillova ta kujtoj edhe njëherë dashurinë time të parë... ndoshta të fundit:

Kurrë më parë nuk më kishte rastisur të ndjeja një shkërmoqje të tillë në shpirt siç me ngjau atë ditë! Ishte një ditë e hidhur, jo vetëm për mua, por për mbarë katundin... për mbarë krahinën! Po na përzinin nga shtëpitë tona stërgjyshore paramilitarët serbë. Isha e frikësuar dhe e hutuar njëherësh. Kur na nxorën në oborr, pata frikë se do të na vrisnin të gjithëve... do të na dhunonin... para syve të burrave... para syve të Cufit! Tmerr! Por, tmerrin e vrasjes nuk pata shumë frikë, sepse ishim mësuar të dëgjonim çdo ditë për vrasjet dhe vdekjet e dhunshme nga plumbi apo thikat e mprehta të paramilitarëve, por pata frikë nga kjo e dyta, nga dhunimi. Vetëm kur e mendoja më mbulonte turpi... nuk e kisha përjetuar asnjëherë ndjenjën e dashurisë... as atë punën me ndonjë djalë... Unë kisha shumë frikë nga djemtë. Kishte kohë që disa më silleshin vërdallë, jo që nuk më pëlqenin, por i frikësohesha asaj

punës, për të cilën ata më ftonin në forma të ndryshme. Ikni tutje kopilë, u kisha thënë disave që ishin më këmbëngulës e nuk më shqiteshin... Por, atë ditë pasi na kishin grumbulluar në mesin e katundit dhe ishin duke na ndarë nga burrat, befas pashë kur e ngatërruan Çelin e Lulajve dhe e futën në mesin tonë! Kur ai ua ktheu shpinën paramilitarëve dhe u nis drejt nesh, me pa me ata sytë e tij të shkruar, me pa aq thellë sa mu bë se nuk më kishte shikuar por më kishte shpuar anë për tej me atë vështrim të tij të zjarrtë sa për një kohë e harrova veten se ku ndodhesha. Por, edhe unë ama, mos ti hyj vetes në hak, ashtu siç më shikoi, ashtu ia ktheva shikimin tim gozhdë dhe e bëra t'i ulte sytë e tij të shkruar përdhé! Porsa e uli vështrimin për tokë, pashë se flokët ju shpupurishën dhe ia mbuluan këndshëm supin sikur të ishte vajzë. Vetëm tani m'u kujtua se Çeli ishte fëmija më i vogël i Lulajve. Thuhej se i ati, për shkak të shëndetit të tij të hajthëm, e kishte llastuar më tepër se djalin tjetër, duke i lënë flokë të gjata. Edhe pse i kishte mbushur të tetëmbëdhjetat, në fytyrën e tij të brishtë, akoma nuk i kishte mbirë asnjë qime burrërie, dhe në çast më kishte shkuar në mendje se ky nuk ishte nga ata djemtë e rrezikshëm për atë punën, që e dëshiroja por që e kisha shumë frikë! Ndërkohë, më kishte lindur një xhelozi karshi vajzave të tjera që e shikonin si të trullosura. Pa humbur kohë, ia zgjata një shami. Vetëm pasi ia dhashë shaminë, e vërejta se ia kisha dhënë atë shaminë që e kisha qëndisur verën e kaluar derisa ndodhesha për vizitë te daja. Ishte shamia më e bukur që e kisha qëndisur ndonjëherë! Në njërin skaj të saj kisha qëndisur një pëllumb krahëhapur, kurse në skajin tjetër ishte vida që e priste! I thashë ta lidhte rreth qafës që të maskohej sa më mirë në mesin tonë. A

nuk ishte kjo një shenjë që ia bëra me dije, jo vetëm Çelit por edhe vajzave tjera, se ne ishim të dashuruar? Siç mu duk mua, edhe ato nuk ishin budallaqe. I kuptuan shenjat e para të dashurisë që sapo kishte filluar të zinte rrënjë në zemrat tona! Më vonë, gjatë marshimit i dëgjova edhe pëshpërimat e para! Disa ishin zëra të urryer llafazanesh, disa ishin ofshama xhelozie dhe disa ishin pëshpërima dëshpëruese!

Gjatë gjithë rrugës nuk ju shqita. Edhe kur pushonim diku nën ndonjë pemë a lis bri rrugës, nuk i avitesha pranë, por gjithmonë i rrija karshi, duke e parë me kënaqësi nga distanca. Po të më jepej rasti, disa herë e kisha menduar me vete në atë kohë, pa asnjë hezitim, pa asnjë frikë do të gjendesha nën peshën e trupit të tij që me dukej i lehtë si pendël! Frikën nga ajo puna as që e mendoja! Disa herë, kur kalonim buzë maleve, pranë pllajave të zhveshura, pranë lëndinave me driza, fët e fët, fshihesha në mal! Çeli me ndiqte pas! Unë fshihesha pas dëllinjave dhe e vështroja së si më kërkonte me ngulm. Pasi largohej tutje pa më diktuar, si të isha drenushë, rrëmbyeshëm dilja nga dëllinja dhe gjithë gaz vrapoja tutje. Pastaj ai, si të ishte ujk, më ndiqte pas derisa me zinte duke me shtrënguar lezetshëm në gjoksin e tij... Fitiiii!, ma tërhiqte vërejtjen nëna duke e zgjatur zërin gumëzhitës si të gjinkallës...

Tani, nuk më kujtohet se cila nga gratë, apo nuset, e para ia kishte plasur vajit, por e di që të gjitha femrat sa ishim aty, si në kor, ia plasëm të qarës! Hiç nuk më erdhi mirë kur e pashë Çelin e përlotur. Përmes mimikës, që e kam jashtëzakonisht të zhvilluar, i dhashë shenjë që mos të qante! Sa i mirë që ishte! Sa i dashur që ishte! Sa i zgjuar që ishte! Me kuptoi dhe pasi i fshiu sytë e shkruar

me shaminë që ia kisha dhuruar kohë më parë për kujtim të dashurisë, nuk qau më!

Vetëm matanë kufirit ne u bashkuam me burrat dhe baballarët tanë. Edhe një copë rrugë e bëmë së bashku, pastaj erdhi koha e ndarjes. E ruajta për në fund përshëndetjen me Çelin. Në kohën sa isha duke u afruar drejt tij, se si e kisha një hezitim, si frikë që më brente, dhe herë pas here e pyesja veten se çfarë metode duhej përdorur gjatë përshëndetjes me të! Në fillim mendova se mjaftonte vetëm një zgjatje dore dhe një buzëqeshje miqësore sa për ta përligjur një ndarje të zakonshme pa rënë në sytë e të tjerëve dashuria jonë e fshehur, por kur mu kujtua se edhe vajzat e tjera e kishin përqafuar sikur ato të ishin të dashurat e tij, atëherë ndërrova mendje. Vendosa ta mbështjellë të tërin në përqafimin tim! Për inat të tyre thashë! Me shpejtësi marramendëse e shtrëngova dhe aty për aty mendova se nuk do ta teproja fare edhe sikur ta puthja... kur më tha pranë veshit:

„Do bëhesh nusja ime?!“

„Po! Në jetë të jetëve!“ – i thashë dhe pa ia hëngër hakun! Ai qe më i shkathtë. Me puthi aq shpejt, aq papritur sa nuk arrita dot as të mendoj për t'ia kthyer të puthurën. Por, për ta përligjur sado pak dashurinë që kisha për të, e shtrëngova aq shumë, aq furishëm sa e hetova se me mbulojë e skuqura jo vetëm në fytyrën time, por në mbarë trupin tim që mu mbush me mornica! Pastaj me një të shtyrë u shkëputa nga përqafimi i tij i ëmbël. Edhe gjatë kohës sa isha duke u larguar prej tij, e ndjeva se vendi i puthur në faqen time sikur kishte marrë formën e një unaze të ftohët! E preka me dorë, sikur desha ta mbaj të vizatuar përjetë të jetëve atë puthje të ftohët në faqen time

të valë prush! Para se të fshihesha pas bërrylit të rrugës dhe të tretesha pas ndërtesave, ktheva edhe njëherë kokën pas dhe e pashë se si kishte ngelur për gjynah, si i ngrirë në mes të rrugës. Për një çast mu bë se prapa meje nuk e lashë trupin e të dashurit tim të hajthëm, por lash një statujë të lashtë mermeri të skalitur nga mjeshtrit e vjetër antik!

E para që i tregova për dashurinë time ishte shoqja ime më e ngushtë Dili. Ajo, edhe pse ishte me e re nga unë, ishte shoqja më e dashur për mua. Kur unë nuk arrija t'i përcillja lëvizjet e tij, ishte Dili që më tregonte çdo gjë për të... bile me jepte edhe këshilla... pastaj më thoshte se; edhe unë kur të rritëm do të dashurohem sikurse ti! Atëherë, nga gëzimi që kisha shoqe një njomëzake kaq të lezetshme, e puthja në faqe, dhe ajo duke e vënë dorën në vendin e puthur më thoshte: Sa puthje të ëmbël që ke moj Fiti! Lum si ai! Por, pas një kohe të shkurtër, nuk e di as sot se nga kush, e kishte marrë vesh gjyshja dashurinë tonë. Ajo më donte shumë. Kur unë prisja zhgënjimin e saj, qortimet e saj, kur prisje t'i tregonte Cufit i cili nuk durohej dot, t'i tregonte nënës, e cila nuk ishte hiq më e mirë se Cufi... pra kur e prisja që në shtëpinë tonë të fillonte shamata, gjyshja me befasoi duke me dhënë këshilla se si duhej të sillesha me të dhe dashurinë që e ndjeja për të! Ajo më këshillonte të kisha kujdes e mos të bija pre e epsheve të tij. Nëse vërtetë të dashuron nuk do të nget, por nëse është i pasionuar pas epsheve dhe është këmbëngulës, atëherë mos e cilëso si njëri të dashuruar, por thjeshtë si kurvar!

Kur isha e vogël, sa herë që me kishte rastisur të bëja ndonjë faj, gjyshja më kishte dalë në krah duke e marrë fajin tim si të vetin. Unë, pastaj i kërkoja falje gjyshes, dhe ajo më thoshte: edhe kur ta kesh bërë ndonjë faj, sado i vogël

që të jetë, më trego mua me kohë që të jem e përgatitur për pasojat e mundshme! Prandaj, porsa u kthyem në shtëpitë tona të djegura, me padurim e dërgova gjyshen të shkonte të Lulajt për të marrë ndonjë lajm! Nuk më zuri vendi-vend derisa u kthye. Ende pa fol ajo, erdhi Cufi. Siç e kishte zakon të fliste shumë, filloi të tregonte për të gjithë të kthyerit. Për të vrarët dhe të zhdukurit. Në mesin e të kthyerve i përmendi Lulajt. Tregoj se kishte biseduar me Çelin një copë herë pranë shtëpisë së tyre të djegur! Pastaj vazhdoj të tregonte se kush ishte kthyer në lagjen e Kullurëve, sa veta ishin kthyer në lagjen e Shytëve, në atë të Ramrexhve... Për të tjerët as që e dëgjova se çfarë tha. Mezi e gjeta një copë letër dhe një laps. Dola në bahçe dhe i shkrova. Bëja plane se a ishte më mirë që letrën t'ia dërgoja përmes gjyshes apo përmes Dilit! Pasi nuk e hasa askund Dilin, me ndrojtje i thashë gjyshes! Nuk më kundërshtoi, por më tha se ishte bërë vonë. Një ditë tjetër! Nuk donë, thashë me vete dhe u vura prapë në kërkim të Dilit, me shpresë se ndoshta rastësisht do takoja Çelin. Derisa u err nuk lashë vend në katund pa e kërkuar. Vetëm kur filloi të errej, e dëshpëruar u ktheva në shtëpi. Të nesërmen, krejt pa pritur, më tha gjyshja se kishte vendosur mbrëmë që t'ua bënte një vizitë Lulajve, sa për t'ju uruar mirëseardhje. Tamam kur po bëheshim gati të dilnim, se nga piku Cufi nuk e di, por mua, sa nuk më lëshuan këmbët. M'u prenë gjunjët. E dija se nuk do të pranonte kurrsesi që unë të shkoja në shtëpinë e tyre. Një copë herë e luti gjyshja në fundin e oborrit. Më në fund pranoi, por me kusht që të vinte edhe ai me ne! S'patëm rrugë tjetër. U nisëm! Pasi arritëm atje, unë rrija pak anash dhe shtiresha sikur po më vinte turp. Kokulur ia zgjata dorën Çelit, dhe sa çel e

mbyll sytë, në dorë ia lëshova letrën. E pashë se u frikësua pak, por heshti. Pas dy ditësh, rastësisht u takuam të gurra e Milushit ku kisha shkuar me vajzat e fqinjëve për ujë. Nuk isha vetëm, prandaj ne në grup i ndërruam disa fjalë. Unë u shkëputa vetëm për një çast nga shoqet, dhe ai me luti të takoheshim pranë mullirit të vjetër. I thashë: Jo, nuk vij! Të pres me tha, dhe iku!

Gjithë natën nuk më zuri gjumi. Prapë më ishte kthyer ajo frika e dikurshme. Të rrija vetëm për vetëm me një djalë të huaj kur e dija shumë mirë pse më kishte ftuar në takim, kur e dija shumë mirë se ç'farë kërkojnë djemtë e rinj nga dashnoret e tyre... dhe në mendje më vinin gjithfarë mendimesh. Nuk do t'i epesha aq lehtë, mendoja herë pas here! Do t'i largohesha me marifet! Do ta mbaja në distancë pa i dhënë asnjë shkak për ndonjë provokim! Por, për çudi, edhe pse i kisha thënë jo, asnjëherë nuk e kisha paramenduar mos shkuarjen time te vendi i takimit, bile as që e mendoja një gjë të tillë! Nganjëherë, më brente meraku se pasi i kisha thënë jo nuk vij, ai nuk do të vinte fare, dhe unë do të mbetsha në pritje kot së koti!

Nuk më pritej derisa të vinte koha e takimit. Disa herë e bëra atë me faj që e kishte caktuar një kohë kaq të largët, por prapë e qetësoja veten. Sigurisht se do të jetë më mirë. Ja edhe Cufi po përgatitet të dalë. Se ku do të shkojë ende nuk e kam të qartë, por kjo nuk ka asnjë rëndësi tani. Rëndësi ka se ai deri në mbrëmje, ndoshta edhe më vonë nuk do të kthehet në shtëpi. Por, çështë më kryesore; për këtë takim nuk i tregova gjyshes fare! Këtë nuk e bëra që nuk i besoja asaj, por e bëra që nuk i besova vetes sime! Nuk i besova dhe akoma nuk jam duke i besuar, sepse nuk e kam të sigurt se a do të shkoj atje apo jo! Obobo, sa

argument i mirë para gjyshes, por mos shkuarjen as që e vë në dyshim më! E nëse me dikton kështu do t'i them!... Oh, sikur ta takoja Dilin e të më shoqëronte deri afër mullirit!

Për të arritur të mulliri i vjetër, nuk rashë rrugës kryesore që nuk ishte as pesë minuta larg shtëpisë sonë, por kalova tutje nga lagjja e Kullurëve. Pranë shatorit, në oborrin e tyre të madh e pashë Dilin. Më përshëndeti e gëzuar. Më pyeti se si ishin nga shtëpia, si ia kishim kaluar gjatë kohës së eksodit, më pyeti për Çelin pa ia përmendur emrin dhe në fund më pyeti se për ku isha nisur! Për një çast mbeta e dyzuar! T'i tregoj vërtetë se ku e kisha ndërmend të shkoja, apo të gënjeja. Vendosa për të dytën, ta gënjeja, por kur e hapa gojën të flisja aty për aty ndryshova mendje! Jo vetëm që i tregova, por edhe e luta të më shoqëronte deri në afërsi të mullirit. Nuk ma prishi qejfin. U nisëm.

Kur arritëm afër, i thashë të më priste pranë një shelgu, dhe vetë ashtu e trimëruar u futa nga zgavra e murit ku dikur kishte qenë dera.

Brenda ishte errësirë. Një copë herë ndenja pranë pragut të gurtë duke soditur sa majtas, sa djathtas, skutat e errëta të qosheve të mullirit. Për një çast më kaploi një frikë, që nuk e përcaktoja dot se nga më vinte. Mendja filloi të më punojë me shpejtësi marramendëse. Po sikur mos të ketë ardhur! Ndoshta vetëm më ka provokuar për t'i parë reagimet e mia? Ndoshta e kam hidhëruar kur i thashë se nuk do të vija këtu? Ndoshta... Oh sa me trembi, kur befas u ngrit në këmbë nga një qoshe e errët. Pa folur asnjë fjalë më mbështolli në përqafim. Nga turpi, e ula kokën. Ai nuk donte t'ia dinte fare. Me duar të shqetësuara m'i ledhatonte flokët duke m'i larguar nga faqet, nga gusha. Pastaj si i çmendur me puthte pa shikuar se ku! Puthjet e para me

erdhën të befta, por pastaj, sikur ndjeja nevojë për to! Ju lëshova e tëra në krah! Ai i lëvizte duart me shqetësim, sa lartë poshtë duke ma mbështjellë belin e shpatullat. Pastaj e ndjeva pëllëmbën e tij kur u mbush në gjirin tim të majtë. Nuk me shtrëngoi shumë, por disi shkaras, sikur ishte duke e ledhatuar filloi ta shtrëngonte lehtë sa e ndjeva se kisha filluar të dridhesha nga një ndjenjë kënaqësie të paprovuar më parë. Edhe pse dorën nuk e largonte nga gjinjtë e mi, të puthurat nuk i ndalonte dot. Unë, vetëm sa e shtriva qafën duke ia afruar edhe më mirë kurmin pranë buzëve të tija të vala prush. As tani nuk më kujtohet se si dhe kur e kishte nxjerrë njërin gji jashtë, por befas i ndjeva buzët e tij mbi thimthin. Sa nuk rashë për tokë nga kënaqësia... por ai nuk e la më kaq. Me mbështolli edhe më fort në përqafimin e tij sa që edhe trupat tanë sikur u bënë një! E ndjeva peshën e sforcuar të atij sendit që filloi të fërkohej pranë kofshëve të mia. U shmanga vetëm pak dhe e pashë. O zot... Nuk e di a nga turpi a nga frika e dhembjeve që mund të ndjeja nëse do të më shtronte, kërceva tutje e tmerruar. Me një lëvizje të shpejtë u largova të këndi, pikërisht të ai këndi ku pak më parë ai kishte qenë i fshehur, dhe me dorën mbi gjinjtë lakuriq e rregullova këmishën!

„Ç'pate?" – sikur e ndjeva zërin e tij të dridhur.

„Jo tani..." – ia ktheva duke e rregulluar fustanin që vetëm tani e vërejta se me kishte shkarë fare në njërën anë.

„Pse jo tani?" – me pyeti duke i veshur pantallonat.

Vetëm tani e vërejta se ai gjatë përqafimeve kishte arrirë të bëhej gati për...

„Jo tani, jo! Vetëm kur të behëm nusja e jote, vetëm atëherë!" – ia ktheva unë.

„Po, pse erdhe pra?" – më pyeti pas një heshtje të shkurtër.

„Erdha me të pa! Me të pa se të dua!“

„Sikur të më doje, nuk do të trembeshe nga unë!” – tha i ai me zë lutës.

„Të dua! Vërtetë të dua, por edhe ti nëse më do mua, duhet ta kontrollosh veten!“ – i thashë me zë të ëmbël, sa për t’ia zbutur pak zemërimin, sepse që nga këtu i vërejta shenjat e para të një lloj nervoze brenda lëvizjeve të tij të ngathëta. Fytyra i kishte marrë pamje të egër dhe të frikshme njëherësh. Pata frikë... po sikur të më sulmon? Të me shtrojë dhunshëm mbi kashtën e mykur që gjendej para këmbëve të mia... sikur të më dhunoj?

„Nuk po të besoj hiq që më do!“

„Të dua vërtetë!“

„Atëherë, pse ta kontrolloj veten?“ – tha derisa kishte filluar të më afrohej, duke më shikuar ashpër, si ujku prenë dhe me frymëmarrje të shpeshtuar! O Zot, ç’më gjeti, sikur më tha zëri nga brenda, dhe hodha një hap prapa!

Pata shumë frikë. Për një çast mbeta e dyzuar. Nuk e kisha asnjë ide se çfarë duhej bërë në këtë situatë të krijuar. Tani as që më shkonte mendja të dashuria, të sytë e tij të shkruar, të flokët e tij të gjata me aromë portokalli, të fytyra e tij e lëmuar... vetëm tani m’u kujtua se gjatë kohës sa ndodhesha në përqafimin e tij, sikur ia kisha vërejtur disa qime të rralla në mjekër. Harroi tani ato qime, por... ç’të bëjë për të dalë nga kjo situatë? – e pyeta veten derisa ai ishte afruar pranë meje. Tamam kur i zgjati duart drejt meje, as vetë nuk e di si ndodhi, por ia dhashë një të shtyrë me sa fuqi që pata dhe me një kërrusje trupi i depërtova nga duart dhe u gjenda në anën tjetër. E vërejta se gjatë manovrimit më kishte mbërthyer nga flokët dhe jaka e këmishës.

„Do të ikësh nga unë ë?“ – më pyeti duke më tërhequr dhunshëm nga vetja.

„Jo! Nuk dua të iki nga ti... por kam frikë!“ – i thashë me zë të përvajshëm dhe njëherësh duke u përpjekur të lirohem nga dora e tij, dhe vazhdova: – nuk dua ta humbi këtu...“

„S'ka gajle! Si sot si ditën e martesës! Ti tani je e imja...“ – tha me zë të dredhur duke bërë përpjekje të më mbante dhunshëm nga duart.

„Ik të thashë! – klitha me zë pak të ngritur! Isha gati të shpërtheja me dënesa, dhe vazhdova: – Ik se po na sheh kush... lëshomë se thirra në ndihmë!“

„Nuk të lëshoj jo!“ – tha ai me zë që i dridhej, dhe vazhdoi: – nuk të solla këtu me zor, vetë erdhe, prandaj do bësh atë që të them unë se për ndryshe...“

„Çka, për ndryshe?“ – e pyeta e trimëruar.

„Nuk të pyes fare! – m'u përgjigj me të njëjtin ton.

„Do të më dhunosh?“

„Mos e ço veten te dhuna!“ – më tha derisa ishte duke më mbërthyer për flokësh, dhe në çast u gjenda e shtrirë mbi kashtën e mykur dhe nën peshën e trupit të tij. Vazhdova përleshjen kundër puthjeve të tij të ç'frenuara. Përmes gulçimave, me zë të përvajshëm arrita t'i them:

„Lëshomë se e thirra për ndihmë Dilin...“

„Dilin?! Pse ku është ajo?“ – pyeti i çuditur, dhe njëherësh më liroi pak.

„Të shelgu! E mora me vete sepse të pata frikë ty!“ – i thashë me ton pakëz të ulët, por pa e fshehur zemërimin, derisa po çohesha në këmbë, duke u liruar nga shtrëngimi i tij!

„Nga kush pate frikë?“ –më pyeti me zë krejtësisht të zbutur.

„Nga ti!“ – ia ktheva me lot në sy.

„Pse erdhe këtu atëherë, kur më kishe frikë mua? Unë nuk të solla dhunshëm, vetë erdhe!“ – me tha me zë të prerë.

„Erdha se të dua, e jo për këtë punë... unë jam vajzë e ndershme, më kupton... jam e ndershme!“ – i thashë, por tani duke qarë.

„Më fal Fiti!..“ – më tha duke me shikuar me sy fajtori.

Me kokën ulur dola jashtë. Kur po e kaloja pragun e pashë edhe njëherë, dhe ika me vrap drejtë shelgut ku më priste Dilina.

Thonë se zemra e dashuruar nuk njeh kurrfarë ligji, nuk njeh kurrfarë kufiri që i vihet në mes, por rrahë e përpëlitet vetëm për atë që e do, por, kur ndodhin zhgënjime të tilla, përpëlitjet e zemrës së dashuruar janë të dyzuara nga dhembja e të papriturës dhe misteret e të ardhmes, ndërkohë që mendjet e logjikshme ta presin shkurt: „Nuk jeni të përshtatshëm për njëri-tjetrin,“ ose do të thonë së faji është i atij që pranon tjetërsimin, dhe gjasat janë reale që t'i vihet kapaku kësaj pune njëanshëm, duke thënë: „Kjo dashuri nuk do të kurorëzohet me martesë, sepse ne nuk pranojmë një dhëndër me ide, rite e veshje orientale!“ Kaq! Pastaj ti vendos vetë! Dhe herë pas here ai zëri i brendshëm me thoshte: Pa dëgjo Fiti, nëse Çeli ka yshtje nga dikush, por jo edhe vullnet e ndjenja orientale, pas një kohe do të ngopet me to dhe do të kthehet në gjendjen e mëparshme, prandaj mos nxito të bësh ndonjë gafë e ta humbësh për fare! Prapë m'u përfytyrua puthja e parë dhe fjalët...

„Do bëhesh nusja ime?!“

„Po! Në jetë të jetëve!“

Por, si t'i marr vesh tani ndjenjat e tij? Si? Ka vite që nuk e kam takuar! As letrat nuk mi kthente kohëve të fundit! Ah, po! Tani po i shkruaj, mendova kalimthi, dhe pa e kuptuar, duke i fshi lotët me shami, e kisha marrë lapsin dhe letrën.

Befas u hap dera. Ishte Lulja, vajza pesë vjeçare e tim vëllai, Cufit.

– Ku ishe ti? – e pyeta kot.

– Në selishtë! – u përgjigj ajo duke i larguar flokët nga faqja

– Ç'kërkoje atje? E sheh se bënë ftohët? – e pyeta prapë, por ajo në vend që të më përgjigjej më pyeti:

– Prapë po qanë për Çelin?

– Po!

– Si nuk e ditke ti moj Fiti? Çeli ka ardhur... por, ishte i sëmurë! Kështu i tha gjyshja mamit!

– I sëmurë? – e pyeta e çuditur.

– Po, por nuk është për doktor, ka thënë gjyshja! – tha ajo duke i lëvizur duart e vogla.

– Po për kë ishte atëherë? – e pyeta me buzë në gaz, derisa isha duke i fshirë lotët me cepin e shamisë.

– Nuk e di unë, por gjyshja e përmendi hoxhën që shkruan hajmali!

Nuk u përmbajta dot, dhe e mora në përqafim duke e shtrënguar në gjoksin tim dhe duke e puthur me afsh. Edhe ajo më mbështolli në përqafim me duart e saj të vogla duke mmë thënë:.

– Fiti, ai Imami, e di ti, ai shoku i babit i ka thënë gjyshes se edhe ti je e sëmurë!

– Pse, aty është Imami? – e pyeta e çuditur

Kishte kohë që herë pas here familjen tonë e vizitonte

Imami i Lulajve i cili kishte vite që jetonte diku në qytet. Në fillim dukej njeri me namuz, por pastaj, vërejta se ishte një tinëzar ngucakeq, duke e fituar përshtypjen se ai nuk po vinte për Cufin siç linte të kuptohej, por thjeshtë për mua e Dinoren... sepse sa herë që na takonte vetëm për vetëm e thyente zakonin e tij dhe na e zgjaste dorën duke na shikuar me ata sy të etshëm prej kurvari! Kurse, kur takohej me nënën apo me gjyshen, i zbatonte parimet e tij duke mos i shikuar në sy dhe duke mos ua shtri fare dorën! Ne të dyja e urrejmë, por ende nuk kemi marrë vendim për t'i treguar Cufit për sjelljet e tij! Në fillim i treguam gjyshes, por ajo na qortoi rëndë duke na thënë: „Ju plaçin sytë, ju plaçin! Mos t'ua dëgjoj këto fjalë Cufi, se bëhen gjaqet!"

– Po. Ka ardhur dhe e kërkoi babin! – m'i ndërpreu mendimet Lulja.

– Dhe ai i ka thënë gjyshes se unë qenkam e sëmurë, ë? – e pyeta e çuditur.

– Po, je e sëmurë sepse po qanë shumë për Çelin. Kështu i tha gjyshja Imamit!...

– E ai ç'farë i tha gjyshes? – desha ta nxisja të fliste.

– Ai i tha... a e din ti moj Fiti, kur ata po flisnin për ty, dy herë me nxorën jashtë duke me thënë; shko luaj me fëmijët, se këto që po flasim ne nuk janë për ty!

– E si i dëgjove ti atëherë? – e pyeta me nënqeshje.

– Vjedhurazi u ktheva prapë dhe u fsheha pas derës. Pastaj e dëgjova Imamin duke i thënë gjyshes që sa më parë t'i duhet të shkosh për vizitë te njëfarë Magjistari... sepse ty, vetëm hajmalia e tij të bënë mirë!

– A është hala Imami aty? – e pyeta kureshtare

– Jo! Tani sa dolën me babin! Unë erdha të të tregoj se

çfarë folën për ty!

– I dëgjoi Cufi këto fjalë?

– Jo babi nuk ishte në shtëpi! Posa erdhi babi, gjyshja e Imami nuk folën më. Pastaj Imami u përshëndet me gjyshen dhe dolën bashkë me babin!

– Ashtu?

– Ëhë! – ma ktheu ajo duke me shikuar në sy, sikur të ishte e rritur dhe priste reagimin tim.

– E mami a ishte aty? – e pyeta pas pak.

– Jo! Kur erdhi Imami, mami iku, u ngjit shpejt lartë!

– A i foli mami Imamit? – e pyeta me buzë në gaz.

– Ë-ë! Nuk i foli hiç! – tundi kokën në shenjë mohimi.

– Mirë, atëherë! Shko tani e ma thirr Dilin! – i thashë derisa isha duke e lëshuar për tokë.

– Tani menjëherë? –më pyeti duke i larguar flokët nga faqja.

– Po shpirt, tani!

– E ç'ti them?

– I thuaj të vijë njëherë te unë!

– Mmmm! Nuk më shkohet tani atje! Kam ftohët! Mami më ka thënë mos të dal jashtë se do ftohem... prandaj!

– Do ftohësh? Oh, jo zemër nuk ftohesh, sepse ti shkon e kthehesh me vrap, dhe kur njeriu vrapon nuk ftohet...

– E nëse ftohem?

– Shko se do ta fali një shall të bukur! – i premtova,

– Cilin?

– Atë të qëndisurin me trëndafila të kuq!

– Vërtetë? Uaaa sa mirë! Ma jep tani?

– Jo tani, kur të kthehesh!

– E dua tani, se po dola kështu, do ftohem, të thashë njëqind herë!

– Kur të kthehesh, edhe unë të thashë njëqind herë... tani nuk e gjej dot!

– E gjej unë! – ma priti ajo duke e nxjerrë shallin nga dollapi.

– Mirë! Merre pra! Shko tani!

– A t'i them të vijë menjëherë? – me pyeti derisa ishte duke dalë nga dera.

– Po, i thuaj të vijë menjëherë! – i thashë.

Pasi e mbylla derën fillova të shkruaj.

LETRA

Tamam sa e fala içindien dhe zura vend në shilten time pranë stolit të formës „X“ ku e kisha të hapur Kuranin Kelamullah që ishte i shkruar me miniaturë stilistike në një Mus-haf të vjetër, në derë u dëgjua një e trokitur e lehtë, tak-tak! Isha duke kënduar në suren El Infalë. Isha aq shumë i përqendruar në fjalët dhe urdhrat e Allahut xhel-le shanuhu, që në këtë rast, po më mësonte së si duhet luftuar dhe ndëshkuar ata që nuk besojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij, prandaj nuk e pashë të arsyeshme që ta ndërpres menjëherë këndimin. Vazhdova edhe për pak, por i shpërqendruar. E trokitura u përsërit, por kësaj radhe pak më e fortë. U çova nga shiltja ku kisha zënë vend, me mendimin se e trokitura nuk me erdhi e njohur, duke më shpërqendruar edhe më shumë. Duke menduar se pas kësaj të trokiture të lehtë mund të fshihej vetëm Fiti, e çela derën. Ç'të shoh! Në

vend të Fitit që e kujtova mallëngjyeshëm pak çaste me parë, para meje mu shfaq një pamje krejt tjetër! Si të ishte statujë e ftohët antike, pashë një vajzë të bukur si hëna së pari. Për një çast nuk e njoha! Pasi i lashë anash vetëm për disa sekonda shikimin haram, e përqendrova vështrimin mbi pamjen e saj tërheqëse... e njoha. Ishte Dilina. Sa nuk klitha! Vërtetë para meje po qëndronte Dilina! Ishte rritur dhe zbukuruar pa masë këto vitet e fundit. Pas një shikimi të shpejtë me ata sy të shkruar, me përshëndeti me luhatje koke, duke i tundur lehtë flokët e saj të bukura e të lidhura gërshet! Pastaj, me dorën e shtrirë drejtë meje, ma lëshoi në dorë një send të mbështjellë në një beze të bardhë, dhe pa folur asnjë fjalë ma ktheu shpinën. Unë, ashtu siç e kisha çelë derën, ashtu edhe e mbylla pasi pamja e saj u zhduk në tatëpjetën e shkallëve të vjetra e të drunjta që cijatnin lehtë nën peshën e këmbëve të saj të vogla! I shpërqendruar vazhdoja ta mbaja në dorë atë gjë të lehtë që për momentin nuk kisha asnjë ide se ç'mund të ishte. E ndjeva veten se pamja e saj njomëzake ma kishte trazuar shpirtin! Sa e bukur! Sa e hijshme! Sa e lezetshme qenka bërë për... mendova pa dashur, por mendova keq... haram, duke e humbur abdesin! Më bëri për ujë dreqi, thashë me vete derisa u ktheva te shiltja ime, pa e pasur fare mendjen te ajo gjëja që sapo ma kishte lëshuar në dorë. Zura vend pranë stolit dhe e hapa atë beze të bardhë. Ishte një copë letër e palosur në disa palë, por përshtypje më bëri se nuk ishte e palosur në katër këndе siç palosen zakonisht letrat por ishte e palosur në tre këndе, në formë hajmalie! O Allah, kujt ju paskan tharë trutë që m'i dërgon letrat në këtë stil? – e pyeta veten duke e soditur atë letër interesante. Pasi e

shpalosa të tërën, pashë se ishte shkruar nga dora e Fitit. Mirë, thashë! Kjo letër mund të lexohet edhe pa abdes, dhe e hapa! Në vend të titullit kishte shkruar:

U bëre për hajmali, hajmali po ta dërgoj!

Vetëm nga titulli i letrës e ndjeva veten të fyer. Mendova se nuk do t'ia vlente të merresha fare me té, dhe zgjata dorën për ta lëshuar përkohësisht mbi Mus-haf, sa për t'i dhënë vetes pak kohë për të menduar se ç'duhej bërë: ta lexoja apo ta hidhja në shportë ashtu të palexuar, por në çastin e fundit e tërhoqa dorën me rrëmbim, akoma pa e lëshuar letrën mbi Mus-haf, sikur gishtat të m'i kishte pickuar ndonjë e kafshuar gjarpri! Shyqyr që mu kujtua me kohë e nuk u mbusha me haram duke e vënë letrën gjynahqarë e me germa kaurë, sipëri Mus-hafit të shenjtë!

Pas një mëdyshjeje të gjatë, mora vendim se letrën gjithsesi duhej lexuar. Por jo tani! Jo tani sepse ajo letër, siç me dha të kuptojë palosja dhe titulli i saj, për mua sjell një mesazh të keq, dhe ai mesazh i keq, do të më shpërqendrojë në studimet e radhës... dhe si i përhumbur vërvita shikimin rreth e qark duke parë brendinë e dhomëzës sime të shndërruar në modelet e dhomëzave tipike orientale, sikurse janë dhomat e talebanëve të bekuar të islamit! Ndërkohë, m'u kujtuan fjalët e Abu Al Khalidit. Ai më kishte thënë se edhe librat armiqësor duhet lexuar, edhe letrat armiqësore duhet lexuar por nuk duhet të biesh pré e tyre, edhe nëse të tërheqin me të gjitha madhështitë artistike, stilistike apo edhe me miniaturë qofshin ato! Pra, edhe letrën, sado armiqësore dhe e rrezikshme të jetë, gjithsesi duhet ta lexoj, pa rënë

kurrsesi pré e ndjenjave të dashurisë së madhe që kam për Fitin! Sa interesant me erdhi në çast, me dëshirën dhe madhështinë e Allahut, gjithmonë më hapën rrugët në çdo situatë! Ja edhe kësaj radhe, pa hyrë në gjynah, vetë mëshira e Allahut ma hapi rrugën e bekuar për ta lexuar letrën! U largova në distancë nga Mus-hafi i shenjtë, dhe fillova nga leximi:

I dashuri im i shtrenjtë Çelë!

Me sy të përlotur po ta shkruaj këtë hajmali (letër) të fundit! Nëse të bën mirë të pres në përqafimin tim! Por, nëse nuk është ilaç për shpirtin tënd të trazuar pas atyre shkronjave të ngatërruara, pas atyre sureve sektare që i këndon me atë zë aq të bukur, por, që të larguan nga gjiri i traditës sate popullore të trashëguar brez pas brezi, që të larguan nga epika jonë legjendare, nga këngët e lahutës, nga këngët e çiftelisë, nga melosi i larmishëm popullor, nga veshjet tona të larmishme kombëtare me tirq e jelek, xhamadan e plis të bardhë, nga veshjet moderne me xhins që po i bartin të rinjtë... që të ndanë nga vëllezërit dhe motrat tuaja që u rrite në mesin e tyre, që të mirën dhe të keqën e ndamë së bashku në ditët më të vështira të eksodit të dhunshëm masiv... por që me nder, (sepse kështu po të duket ty) pikërisht ato motra, ato nëna, ato gjyshe me dëlirësinë dhe dashurinë e tyre sot po ta ndyjnë namazin, me afrinë dhe mirësinë e tyre, sot po ta qartin abdesin, me sinqeritetin dhe shijen e tyre, sot po ta cenojnë veshjen sektare orientale... dhe ashtu, i ndërsyer kundër nesh po e harron djepin që të përkundi, ninullën që ta këndoi nëna

para se të vente në gjumin e ëmbël foshnjor, po i largohesh popullit tënd që të rriti, po ia kthen shpinën natyrës sate që ta fali bukurinë, po e shqelmon ujin e krojeve të bekuara që ta dhuruan zërin... dhe atë zë, nuk po e përdorë për t'ia kthyer borxhin këtij vendi, i cili pa asnjë rezervë t'i fali të gjitha të mirat e begatitë, por po ia falë shkretëtirave arabe që më së paku ta kanë nevojën ty dhe zërit tënd të konvertuar!

Të pashë dje pas katër vitesh pritjeje të gjatë e të mundimshme, që kishe ndaluar pranë varrit të Milushit! Gati sa nuk plasa nga marazi për ty... për ndryshimin tënd të paparë ndonjëherë në këto anë, nga ajo veshje e huaj e deformuar, nga ajo tërleme myslimane për shkakun e së cilës i humbe flokët tuaja të gjata dhe të arta që aq shumë t'i desha, për atë mjekër stil cjapi... o zot, a je duke e parë veten se ku ke rënë?

Të bëj thirrje t'i kthehesh traditës, t'i kthehesh gjuhës tonë të bukur, t'i kthehesh këngës tradicionale, me atë zërin tënd melankolik, t'i kthehesh dashurisë që kam për ty, t'i kthehesh zemrës sime që e ke lënë peng të vuajtjes, t'i kthehesh shpirtit tim të trazuar dhe syrit të përlotur... të pres me padurim!...

Kthehu të lutëm! Kthehu se të dua shumë, të dua si shqiptar me besë e traditë, të dua si këngëtar të melosit tonë të bukur që si dikur t'i japish fuqi këngës me atë zë bilbili... e kurrsesi nuk do të pajtohem të shndërrohesh në atë çfarë nuk je, sepse në syrin e të huajve gjithmonë do të trajtohesh tradhtar, injorant dhe i pavlerë... nëse vazhdon kështu, këtë injorancë prej të huajve do ta përjetosh edhe ti ashtu siç e kishte përjetuar dikur Milushi ynë i madh!

Kthehu... të pres me padurim!

Fiti

Dikur, kur pranoja letra nga Fiti, para se t'i kisha hapur, e paramendoja stilin e të shkruarit, renditjen e shkronjave të imta në radhë dhe me parandjenjat e dashurisë të shkruara nga dora e një vajze të re e të dashuruar. Pasi i lexoja me kujdes një herë, apo kishte raste që i rilexoja katër dhe pesë herë pa u ngopur me ato kumte dashurie që më sillnin, ulesha i trishtuar në trapazanin prapa derës së odës së moçme të burrave dhe me orë të tëra rrija në kujtime të këndshme të dashurisë. Natën, derisa më zinte gjumi, para pamjes sime zinin vend vetëm sytë e saj, fytyra e imët me atë lëkurën e hollë dhe të freskët e me çuka në faqe, buzët e saj pakëz të fryra dhe të lëngështa, flokët e saj të gjata dhe të drejta që lironin aromë të këndshme ftoi, e që më mbushnin plot epsh! Pasi i merrja edhe disa veprime shtesë... e ndjeja veten të lehtësuar. Dilja te bunari dhe me ujin e ftohët akull bëhesha paq duke e pastruar trupin dhe shpirtin tim të trazuar nga dashuria dhe duke e lutur Allahun që të m'i bënte kabull ato veprime, vazhdoja studimin e mëtutjeshëm mbi suret që ishin të shkruara në Mus-hafin e shenjtë.

Pas pak, i shpërqendruar fare, e lexova letrën për të dytën herë, dhe pashë se në të nuk ishin të shkruara ato fjalët e mëdha e tërheqëse të dashurisë, por ishte e mbushur përplot me akuza dhe fyerje të rënda që i bëheshin besimit tim të lartë! Ishin kërcënime që më bënin thirrje të tërhiqem sa më parë nga rruga ime e shenjtë, sepse sipas saj, kjo na qenka një rrugë e gabuar që nuk të shpinte gjëkundi! Ç'të bëjë tani? Ajo nuk e kupton dot së nëse tërhiqem nga kjo rrugë... se si dhe ku do të përfundonim ne! Pse them ne? – e pyeta veten me ngashërim, – Ajo me thotë qartë se nuk do të jetë pjesë

e dashurisë sime nëse vazhdoj rrugën e konvertimit... ç'farë konvertimi moj aman! Po ti moj e dashura Fiti, nuk e merr dot me mend se ku do të tretem unë nëse e marr një vendim që ma këshillon ti! Nuk e kupton dot! O Allah, më ndihmo ta ndajë drejtë këtë hall që kam!... Por, edhe pse ju luta me gjithë shpirt Allahut, nuk m'u hap asnjë shtegdalje, por në të kundërtën, koka mu bë lëmsh, prandaj vendosa mos ta lexoja më letrën që aq shumë më ngazëlleu duke m'i kujtuar ditët idile të dashurisë së parë në njërën anë, dhe po aq shumë më mbushi më pezëm duke marrë kahet e shkatërrimit të asaj dashurie, në anën tjetër!

Nuk kishte kaluar shumë kohë që kur e kisha lexuar në Mus-hafin e vjetër dhe të shenjtë mbi rrethanat e vahjit[32] ku thuhej se askush nuk mund t'i pranojë fjalët e Allahut, sepse njeriu është krijesë e dobët materiale! Këtë mund ta bënte vetëm meleku Xhibril, krijesë e lartë dhe jo materiale, i cili i kishte pranuar fjalët e Allahut dhe besnikërisht ia kishte kumtuar njeriut... në këtë rast Pejgamberit të Madhërishëm! Kurse letra që tani rrinte e qetë në parmakun e dritarezës së dhomëzës sime, nuk vinte nga një melek, nuk vinte nga një engjëll, nuk vinte nga një zanë mali por vinte nga një krijesë e dobët njerëzore e materiale, nga një krijesë e bukur, e dashur dhe tërheqëse por që në shpirtin e saj, siç dukej, fshihej vetë shejtani i mallkuar, duke e shndërruar në një idhujtar të pafe që e meriton ndëshkimin e Allahut në bazë të rregullave të sheriatit! Pikë! Kaq nga ana ime e dashura Fiti!

---

32 Arab. frymëzim, ngacmim apo instinkt.

Këto i mendova sa ndodhesha në kulmin e zemërimit. Por duke bërë përpjekje që të isha sa më i arsyeshëm fillova të mendoj se nuk do të ishte ndonjë e keqe sikur edhe të mplakesha e shëmtohesha si beqar i përjetshëm, i varfër e pa trashëgimtar, para të keqes së madhe kur ta kisha kuptuar se për mua askush nuk do të bëhet më xheloz... dhe kjo do të nënkuptonte se jam fare i pavlerë!

Këtë po e ndjej! Me gjithë të arriturat e mia, me gjithë zërin tim të mrekullueshëm, me gjithë pamjen time të veçantë, me gjithë lavdërimet nga vëllezërit e mi selefus-salih askënd nuk po e bëj xheloz... përkundër, në vend të xhelozisë ata të pagdhendur e kanë zgjedhur injorancën, kurse unë si kundërpërgjigje vetë jam bërë xheloz, jam bërë i padurueshëm në rrethin familjar, në lagje e katund, jam bërë objekt talljeje në rrethet më të gjëra! Këto rrethana ndikuan ta humbi rrethin më të mirë të miqve, dhe tani së fundi po e humbi edhe Fitin! Vallë, mund ta humbi Fitin që dikur çmendej nga xhelozia për mua? Disi kam një parandjenjë se ajo nuk vuan më për mua si dikur... nuk xhelozon! Ku zbutet xhelozia, bie dashuria! Tmerr!... por e ndjej së nuk kam nevojë për përjetim... me mjafton ta imagjinoj Allahun në çdo vend e në çdo kohë! Më mjafton!

HAFIZI

Kopuk! – shava me afsh derisa isha duke i zbrit shkallët me nxitim. Ktheva edhe njëherë kokën prapa dhe e pashë Çelin mjekërkuq, hasmin e pejgamberit selamu alejkum, që me këqyrte pa nda me atë vështrimin e tij idhnak e tinëzar njëherësh! Sa nuk u përplasa me një mjekërzi që nuk e kisha vërejtur më parë, kur rastësisht kishte qenë duke i ngjitur shkallët me nxitim. Pasi i kërkova falje, e shtyva derën e rëndë në fundin e korridorit dhe u gjenda në rrugë.

Ashtu, i nevrikosur siç isha, kalova përmes pazarit dhe mora drejt Xhamisë së Madhe për lutjet e içindies, dhe me qëllim që të takohesha me Myftiun, e t'i tregoja një për një se ç'më ngjau me ata edepsëzë, por nuk e pashë! Mora abdes dhe u fala. As më vonë, Myftiun nuk e pashë gjëkundi. Njëri nga predikuesit e Xhamisë së Madhe ishte edhe Imami. Atë e takova pas faljes së namazit,

por nuk desha t'i flisja, e aq më tepër t'i tregoja se ç'më ngjau! E mora me mend se ai ishte i informuar që më parë deri në imtësi për sa më ngjau mua, prandaj më shikonte me ironi! Edhe kështu më rëndonte boll prania e tij mendjemadhe.

Imami ishte bërë shumë i pasur pas rënies së komunizmit. Për këtë, së pari më pat treguar fqinji i tij, që e mbante për gazep të hapur një dyqan mallrash pranë gjimnazit. Sa herë shkoja të blija kostume, këmisha dhe kravata mëndafshi, pallto, apo stof të sjellë nga Kina që e përdorja për xhybet e mia, ai më tregonte gjithfarë historish që i dëgjonte nga njerëzit që hynin e dilnin vazhdimisht në dyqanin e tij! Ai më pat thënë për Imamin, se rridhte nga një familje me tradita! Nëna e tij ishte bija e njërit nga shërbyesit më të devotshëm të një teqeje diku në perëndim të vendit. Në rini të hershme kishte pranuar petkun e dervishit duke i pranuar dhe ekzekutuar ritet e shpimit! Këto shërbesa i kishte braktisur pasi kishte filluar t'i ndiqte mësimet në medresenë e qytetit. Pas përfundimit të medresesë kishte shërbyer në disa xhami si hafëz. Shtytjen e parë drejtë pasurisë sikur ia kishin dhënë disa student të pasur arabë, të cilët kishin studiuar në Sarajevë në fushën e artit ushtarak! Flitej së gjatë asaj kohe ishin pajtuar që në të ardhmen e afërt t'i ndihmonin Imamit në përkthimin dhe botimin e Kuranit të shenjtë sipas rregullave të shkrimit arab, gjë që disa vite më vonë edhe kishte ndodhur. Por, as dreqi nuk i merr vesh pështjellimet e tij, prandaj edhe ky përkthim i Kuranit duke e bastarduar gjuhën e vet nuk dihet në është vërtetë prej tij apo nga dikush tjetër që është përzier në këtë çorbë dhe që përpiqet të dalë duarlarë para xhematit!

Pas përfundimit të studimeve dhe posteve të larta që i kishin realizuar në vendet e tyre, ata ish studentë kishin udhëtuar në kryeqytet dhe ishin takuar përsëri më Imamin, por kësaj radhe në cilësinë e sheikëve të pasur. Imami, për asnjë çast nuk ju kishte shkoqur! Herë pas here kishte udhëtuar në Bosnje duke sjellë me vete valltare e këngëtare për t'i dëfryer e kënaqur mysafirët e nderuar! Flitej në atë kohë se ata çmendeshin pas flokëverdhave dhe sykaltrave tona. Ishin gati të paguanin çmime marramendëse për t'i blerë si robëresha, prandaj Imami s'kishte pushuar së vrapuari sa në një qytet në tjetrin, në Bosnje, Serbi, Bullgari e dreqi e di se ku, për t'i gjetur vashat fillake e flokëverdha sipas kërkesave të miqve të nderuar! Pasi ua kishte siguruar nga një harem të tërë vashash sykaltra dhe flokëverdha, ata ishin larguar! Fill pas tyre, për një kohë ishte zhdukur edhe Imami. Ishte përfolur se kishte shkuar për studime diku në Arabi. Disa vite më vonë ishte parë në mesin e kryesisë së Bashkësisë Islame. Pas një kohe të shkurtër prapë ishte zhdukur. Flitej se vullnetarisht kishte pranuar të shkonte në Bosnje për ta predikuar fenë atje ku vazhdonte lufta e përgjakshme! Në fillim, kur pata dëgjuar për këtë gjest të tij, sa human aq edhe itikat, pata një simpati për këtë mësues të fesë, që e kishte futë kokën në trastë vetëm e vetëm që feja të aplikohej edhe gjatë betejave të përgjakshme, por më pastaj e pashë si kisha qenë gabim në vlerësime. Kishte shërbyer në një xhami të humbur diku në një fshat të vogël në rrethin e Sarajevës. Pasi paramilitarët i kishin përzënë të gjithë banoret e fshatit bashkë me hoxhën e tyre, ai ishte vendosur në Sarajevë, dhe aty kishte qëndruar derisa kishte përfunduar lufta. Kur një ditë, befas, ishte parë në

qytet pas një mungese më shumë se katërvjeçare. Para se të shkonte në shtëpinë e tij për t'i takuar gruan dhe fëmijët e vet, kishte shkuar në mejhane dhe kishte kërkuar dy dhoma me qira. Mejhanexhiu e kishte pyetur se ç'i duheshin dy dhoma kur në lagjen tjetër e kishte shtëpinë me grua e fëmijë? Ai ju kishte përgjigjur se i kishte sjellë dy skamnore që i kishte gjetur të alivanosura nga dallgët e luftës dhe i kishte marrë për t'ua shpëtuar jetën. Pas një kohe u mor vesh se ato nuk kishin qenë skamnore por dy nuset e tij të reja që i kishte sjellë nga Sarajeva. Gruaja e tij e revoltuar e kishte përzënë nga shtëpia, por Imamit nuk ju kishte bërë vonë kjo punë! Edhe për një kohë kishte qëndruar si qiraxhi tek mejhanexhiu, dhe një ditë ishte zhdukur bashkë me dy nuset e tij të reja. Të gjithë u befasuam kur mësuam se ai kishte blerë një shtëpi pesë kat në anën perëndimore të qytetit, por edhe me tepër u çuditëm kur një ditë erdhi në mbledhjen e kryesisë së Bashkësisë si anëtar i përhershëm! Ky ishte një bakshish këmbëngulës dhe vulgar që na e kishte dhuruar Abu Al Khalid.

Befas u ndodha para derës së xhamit të berberhanes pranë pazarit të teshave! Nuk e di as vetë se si kisha arritur deri aty. Vërtetë, në mëngjes ia pata vënë vetes obligim të ktheja këtu e t'i qethja flokët se më ishin rritur tepër, por pas fjalosjes me ata horra, kisha harruar krejt. Për një copë herë u çudita me veten time... dhe ishte për t'u çuditur se si vetë këmbët më sollën këtu?

Kur u gjenda brenda, berberi u kthye i tëri nga unë. Pasi ma zgjati dorën e tij të ritë, më dha shenjë të ulesha në stolin e drunjtë që ishte i vendosur përballë pasqyrave të mëdha! Myshteriun e tij që ishte duke e rruar, nuk e

njoha. Pas pak, më tha se ishte njëri nga të huajt. Nuk u ngazëlleva fare për praninë e tij! Dikur, kur takoja ndonjë të huaj bëhesha kureshtar të dija se cili ishte, nga ç'vend vinte, ç'njohuri kishte për vendin tim, ç'përshtypje kishte për popullin tim, pastaj e pyesja me interes të madh së cilit popull i takonte, cilën gjuhë e fliste, i cilit besim ishte e kështu me radhë. Tani nuk më bëjnë përshtypje fare, përkundër kanë filluar të më irritojnë... jo të huajt... po më irritojnë tanët, e pikërisht ata që po përpiqen të bëhen më të huaj në vendin e vet, së të huajt në vendin tonë, duke i imituar kulturat, doket e zakonet e tyre... dikush dëshiron me çdo kusht të bëhet spanjoll, tjetri italian, tjetri gjerman, dikush kinez, dikush arab dhe po harrojnë qyqarët se do ta humbin përkatësinë e vet kombëtare duke kujtuar se mund të bëhen çfarë nuk janë në të vërtetë... dhe të gjitha përpjekjet do t'iu shkojnë huq, sepse të huajt kurrsesi nuk do t'i pranojnë këta mjeranë si pjesë e popullit dhe kulturës së tyre sado të devotshëm të tregohen. Ka pasur edhe nga ata që para këtyre qyqarëve e kanë provuar konvertimin në përpjekje që të bëheshin turq, serbë... jo vetëm që nuk i pranuan, por me krismat e pushkëve të para i shtrinë përdhé si qenë të zgjebosur! Kështu do ta pësojnë edhe këta mjeranë, por a më jep Zoti ymër me i pa?!

Pasi berberi e përfundoi betejën e vet me leshrat e kokës dhe fytyrës sime, ia bëra pagesën. Jam i xhymert, prandaj edhe kësaj radhe si gjithherë, i fala bakshish! Kur dola në rrugë, kishte filluar të errej. Dritat e neonit ishin ndezur. Tutje te këndi ma zuri syri njërin të sojit të Imamit. Mu bë se ishte ai maskarai që e kisha takuar në zyrën e atij ngatërrestarit arab. Nuk desha t'ia shoh surratin, prandaj

nxitova në drejtim të xhamisë për lutjet e akshamit.

Më që ra fjala për ngatërrestarët, edhe pse nuk e pata ndërmend hiç të merrem me ta, pa dashur mu kujtuan ngatërrestarët e tipit të tij që nga koha e Hasretit Muhamed. Edhe në ato kohëra, sikurse edhe sot, ngatërrestarët me qëllime të ndryshme përfitimi, kanë bërë ndryshime gjatë lutjeve dhe riteve... me një fjalë kanë bërë fitne. Njëri thotë se duhet lutur në këtë mënyrë, kurse tjetri e akuzon të parin se lutjet po i bën gabimisht, pastaj hidhet i treti dhe thotë se as i pari e as i dyti nuk janë në rrugën e Pejgamberit, sepse ai lutjet i ka bërë në këtë mënyrë që i bëj vetëm unë, dhe unë jam në rrugën e drejtë, prandaj ju duhet të më ndiqni pas! Jo, hidhet i pari! Ti je gabim, ne nuk do të lutemi ashtu si ti, sepse bëjmë gjynah! Pastaj hidhet i dyti duke thënë se nëse nuk luteni edhe ju si unë, mbusheni haram duke rrëshqitur nga rruga e drejtë e pejgamberit, ndërkohë që hidhet i treti duke thënë se nëse nuk bëni lutjet sikur po i bëjë unë me ithtarët e mi, do të jem i detyruar ta përdori shpatën sepse jeni bërë qafirë duke e lëshuar rrugën e Profetit... dhe pikërisht këtu fillojnë ngatërresat, duke ia hedhur fajin njëri-tjetrit si shkaktarë për ndarje, shkaktarë për grindje, shkaktarë për rite të gabuara e kështu me radhë deri të gjakderdhjet! Pas ditëve të paqes, duke mos hequr dorë asnjëri nga mënyrat e veta të riteve, dhe duke e mënjanuar tmerrshëm Kuranin Kelamullah, fillojnë të rrëmojnë në sira[33] e hadithe[34] duke shkruar komente e studime

33 *Tregime mbi jetën dhe luftërat e profetit Muhamed*
34 *Tregime të shkurtra mbi atë se çka ka thënë dhe si ka vepruar profeti*

të nxjerra nga tarikhet[35] apo tefsiret,[36] duke e shpallur transmetimin e vet si më të mirin, më të përshtatshmin, më të qartin, më të besueshmin që ka dalë nga origjinali i Pejgamberit selamu alejkum, e të cilin hadith ia kishte transmetuar një shok i besueshëm që e kishte pasur mik një mikun e mikut të profetit!... vërtetë teza origjinale e të besueshme, që pa dyshim duhet mbrojtur me jetë njerëzish!... sa ironi!

Që nga ajo kohë e deri me sot janë shkruar me qindra e mijëra libra të tilla duke u bazuar jo në shkrimet e kohës së profetit të cilat pa ndonjë shpjegim u zhdukën, por që u mblodhën pastaj, u klasifikuan, u riprodhuan dhe u botuan nga pasuesit pas dhjetëra deceniesh duke i cilësuar si dokumente të dorës së parë të Selef-us-Salih!

Nuk isha larg nga Xhamia e Kajmekamit, kur hoxha filloi të këndonte ezanin. Ishte e vetmja xhami që hoxha nuk kishte pranuar instalimin e aparateve për thirrjen e ezanit e as dritat elektrike. Ai kishte thënë së në kohën e Pejgamberit nuk kishte pasur këso marifetesh, prandaj as unë nuk do t'i pranoj, derisa të jem imam në këtë xhami. Vendosa që akshamin ta fali në mugëtirën e kësaj xhamie antike. Mora kthesën e parë, duke përshkuar rrugicën e errët bri varrezave për të arritur sa më shpejt të dera e xhamisë. Pa dashur më shkoi mendja te thirrja e ezanit dhe bëra krahasime më kohën e sotme më atë të Pejgamberit. Si është thirrur ezani nga hoxhallarët në atë kohë, kështu si sot apo në një mënyrë tjetër? Si e kishin kënduar në atë kohë Kuranin, si sot apo përmes hafëzëve? Sa herë i luteshin besimtaret Allahut brenda

35 *Histori apo kronologji nga jeta e profetit*
36 *Komente mbi Kuranin, gramatikën dhe përmbajtjen e tij.*

ditës, tri herë në ditë siç e thotë edhe Kurani Kelamullah, apo pesë herë në ditë siç e thonë hadithet që nuk janë Kelamullah? Po këndimi i mevludit a bëhej në atë kohë dhe si bëhej? Të vdekurit a i varrosnin sikur ne sot, me dërrasa qarri, apo i hidhnin ashtu si kërmë në varr pa dërrasa e pa qefin? Hiq nuk m'u mbush mendja se edhe sot bëheshin ritet si në atë kohë, sepse frymëzuesit shpirtërorë të sekteve të kohërave të vjetra kishin bërë ndryshime të kohëpaskohshme, sikurse edhe këta qafirët e sotëm që i ngarkon shejtani e falën në stilin e një imami që kishte jetuar rrumbullak njëmijë e dyqind vjet më vonë se Pejgamberi, dhe pa fije turpi thonë: „Ne jemi në rrugën e drejtë, në rrugën e paraardhësve, në rrugën e Pejgamberit, selamu alajkum!"

Unë nuk e kam ndërmend të them diçka fshehurazi. Atë çka ma lejon nderi im personal, nderi familjar, nderi i kombit tim dhe nderi i fesë sime të madhërishme, e them pa hezitim! Këtë e kam thënë shumë herë më parë, dhe e kam argumentuar në mënyrë profesionale. Edhe në revistat e Bashkësisë Islame i kam dhënë qartë mendimet, jo mendimet, por studimet e mia gjithmonë duke u mbështetur në thëniet e madhërishme të Kuranit të shenjtë! Por kush i beson këto? I beson vetëm ai që është i paanshëm në rrugën e shenjtë e të ndershme të Zotit, kurse hileqarët, në mungesë të argumenteve e humbin arsyen, dhe në mungesë të arsyes e humbin legjitimitetin duke i dhënë vetes të drejtë të merren me gjithfarë shpifjesh, me gjithfarë zbukurimesh, me fjalë të ëmbla dhe premtime boshe për t'i përligjur rrenat e tyre. Dhe për çudi, rrenat e tyre të stolisura besohen dhe merren për të vërteta, kurse të vërtetat tona lakuriq, të

zhveshura nga stolitë merren si rrenë dhe nuk besohen! Dhe turma, gojëhapur dëgjon ligjëratat plot zjarr të të përhumburit Imam, përderisa flet, nga goja i rrjedhin jargët: „Hej, o xhemati im, lutjet drejtuar Allahut të rangut Hafiz, dhe të disa shokëve të tij janë haram, janë anakronike dhe të dala boje, sepse Pejgamberi ynë i Madhërishëm nuk i ka bërë lutjet në atë stil të vjetruar por me këtë stilin tonë të ri, të shpikur rishtas nga selef-us-salih-ët e mrekullueshëm, nga Ikhuanul-Muslimin-et e devotshëm, nga talebanët trima që me gjak e jetë po e mbrojnë islamin! Ritet anakronike janë në dëm të rinisë, sepse i mbanë të mbërthyer pas vjetërsirave, janë në dëm të shoqërisë sepse i mbanë në terrin e së kaluarës... vetëm metoda jonë e re, metoda e paraardhëseve, pra, ajo që e ka praktikuar dikur Pejgamberi ynë i Madhërishëm është metoda e drejtë të cilën duhet ndjekur gjithë njerëzimi! Prandaj, praktikuesit anakronik që nuk i përmenda këtu duhet të nxirren nga xhamitë dhe të degdisen në fundin e dynjasë, atje ku perëndon dielli, sepse atje e kanë vendin!"

Brendia e xhamisë ishte e mugët. Anë e kënd ishin të vendosura shandanë tunxhi me qirinj dhe llamba me vajguri që ndriçonin. Kupola nuk ishte e lartë, megjithëse, nga gjysmerrësira vështirë dallohej. Në mesin e kupolës vareshin disa zinxhirë dhe në mesin e tyre, për çudinë time pashë të varur disa shandanë! Ishte koha e fillimit të lutjeve, prandaj nuk e pashë të arsyeshme të bëja ndonjë pyetje. Hoxha më luti t'i prija xhematit në faljen e akshamit, por nuk pranova. I thashë se dua të falëm pas tij si gjithë besimtarët e tjerë. Nuk nguli këmbë në kërkesën e tij, dhe filloi. U lidha namaz. Mos më shti o Zot në gjynah, por namaz më të shpërqendruar, nuk kam falur

asnjëherë në jetën time! Duatë i këndoja përmendësh pa e pasur mendjen fare aty. Pastaj, disa herë më rastisi të bëja sexhde me vonesë, e disa herë para kohe. O Allah, bëma kabull, ju luta në fund, dhe rashë shahadet! Nuk e kisha vërejtur, por hoxha ishte kthyer i tëri nga unë... nga xhemati dua të them dhe kur nuk e prisja fare ai tha:

– O xhemati im i shtrenjtë! Sonte patëm nderin që në mesin tonë, gjatë faljes së akshamit, ta kemi Hafiz Osmanin, njeriun më të nderuar të Bashkësisë Islame! Prandaj, pasi e ka bërë n'jetë dhe inshalla Allahu ia bënë kabull këtë namaz që e fali në mesin tonë, pata dëshirën ta lusja zotërinë e tij që të na rrëfen ndonjë gjë të mençur, sepse ky është njëri nga më të diturit në mesin e udhëheqësve të Bashkësisë Islame! Si thoni ju?

– Më dëshirë do ta dëgjojmë! – tha njëri që kisha më afër, dhe pastaj vazhduan të tjerët.

U bë zhurmë! Dëgjoja copa fjalësh të shkëputura, lutje, fjalë ngazëlluese, fjalë miradije, lëvdata...

– Jo, hoxhë efendi! – ua ndërpreva!

Në çast u bë qetësi. Xhemati u kthye nga unë duke krijuar një rreth përqark meje!

– Unë sonte krejt rastësisht kam ardhur në këtë xhami, dhe jam shumë i kënaqur se lutjet e akshamit i bëra në mënyrën më antike që mund të jetë, siç po e quajnë sot kohën e vjetër! Historikun e kësaj xhamie e di shumë pak, siç i di në vija të trasha historitë e të gjitha xhamive të vendit! Prandaj, nëse me tregoni për këtë xhami diçka më hollësisht, unë do të ndahem shumë i kënaqur me ju!

– Po! do ta tregoj historikun e kësaj xhamie, por së pari do të tregoj se xhamia është në gjendje shumë të keqe. Janë dobësuar shumë muret, sa mezi po i mbajmë që mos të

shemben. Disa herë ju kemi bërë kërkesë ju të bashkësisë për ta marrë nën mbrojtje edhe këtë xhami, sepse është shumë e vjetër, por deri më tani askush nuk është marrë me këtë çështje. Po merren me riparimin e disa xhamive që janë në gjendje shumë më të mirë se kjo e jona! Kam frikë se një ditë do të shembet e do të na zë të gjithëve brenda!

– Pa dyshim se e kemi parasysh gjendjen e kësaj xhamie. Me sa më kujtohet mua, vitin e kaluar kem marrë një iniciativë jo vetëm për këtë xhami, por edhe shumë të tilla anë e kënd vendit. Projekti është i gjerë dhe duhet pritur radha. Me sa më kujtohet, edhe ju jeni të njoftuar për formën e projektit dhe kohën e fillimit të punimeve.

– Po, jemi të njoftuar, por kam frikë se gjendja e xhamisë nuk do të mund t'i qëndrojë besnike datave që i keni caktuar ju, prandaj po kërkoj që të bëhet një përjashtim në lidhje me këtë relikt të rrallë... pastaj xhamia e vogël pranë mazgjahut u riparua!

– Po! Vërtetë ajo xhami është riparuar por pasi hoxha i saj i shkëputi lidhjet nga bashkësia jonë dhe u lidh këmbë e krye me Imamin dhe disa ngatërrestarë arab duke i pranuar kushtet e tyre! Më sa di unë ju nuk pranuat një gjë të tillë?

– Jo! Nuk kemi pranuar edhe pse na premtuan meremetimin e xhamisë dhe shuma parash... por kushti i tyre ishte i rëndë sepse kërkonin nga ne të tjetërsohemi në atë së çfarë nuk jemi në të vërtetë, ne nuk pranuam...

– Ju lumtë! Ndërsa për meremetimin e kësaj xhamie kam shpresë se së shpejti do të jeni edhe ju në radhë, sepse projekti ka filluar dhe punët në restaurime po shkojnë shumë mirë. Për këtë mos keni fare dyshim. Nevojitët vetëm ca durim!

– Të sigurojë se unë dhe xhemati im do të kemi durim dhe do ta presim datën e caktuar për fillimin e punimeve, por se a është në gjendje që këtë pritje ta bëjë edhe xhamia, nuk e di! Por sido që të jetë ne do të presim dhe ca! Kurse për historinë e kësaj xhamie, më mirë së Zeneli mik e di askush sepse është mësues historie. Fillo Zenel! – ju drejtua hoxha njërit prej të pranishmëve, por nga gjysmerrësira nuk e dallova dot se cili ishte.

– Quhet Xhamia e Kajmekamit[37], sepse e ka ndërtuar një udhëheqës turk, i quajtur Xhafer Tajari, i cili kishte ardhur me urdhrin e Sulltanit në këto anë për të marrë vergji,[38] në një kohë kur populli kishte dalë dore dhe nuk paguante, thuhej së i rrinte Padishahut karshi! Sipas dokumenteve të arkivuara del se ai kishte qenë një gjakpirës i vërtetë. Kur e kishin emëruar në këto anë kishte qenë shumë i ri dhe shumë aktiv. Brenda një kohe të shkurtër, duke përdorur taktikat e dinakërisë dhe të pabesisë, i kishte shtruar kryengritësit e kësaj ane, duke i vrarë, burgosur e internuar. Thuhet se vendi ishte shkretuar aq shumë sa që ishte vështirë ta gjeje ndonjë mashkull të ri, përveç ndonjë plaku të çalë apo të verbër, dhe fëmijëve nëpër djepa. Vendi kishte mbetur në gra, vajza e plaka! Pas pesë vitesh të gjata tmerresh që ju kishte shkaktuar banorëve të varfër të kësaj ane, befas një ditë ishte zhdukur për t'u kthyer pas tridhjetë vitesh, kur emri i tij zihej në gojë vetëm për të keq. Për çudi, në vend të brutalitetit që ishte pritur të ndërmerrte pas kthimit, kishte ndodhur e kundërta! Ai ju kishte kërkuar falje banorëve të kësaj ane, dhe me lejen e tyre e me shpenzimet

37 Turqisht, zëvendës i guvernatorit në një krahinë, gjatë sundimit osman
38 Turqisht, taksa që paguhej për pasurinë në kohen e sundimit turk

e tij e kishte filluar ndërtimin e kësaj xhamie. Po atë ditë që ustallarët i kishin filluar punimet ai ishte zhdukur dhe nuk ishte kthyer më. Thuhet se pas gjithë vrasjeve, masakrave e dhunimeve që i kishte bërë, një natë derisa ishte në gjumë ju kishte shfaqur në ëndërr një dervish dhe i kishte kumtuar se për shkak të këtyre zullumeve Allahu do ta ndëshkojë jo vetëm në atë botë, por edhe në këtë botë duke e lënë në kohën më të keqe pa familje! Në fillim nuk e kishte besuar kumtin që ia kishte dërguar Allahu xhel-le shanuhu dhe kishte vazhduar të bënte zullume siç ishte mësuar derisa një ditë gjatë luftimeve me kryengritësit, e kishin zënë rob disa malësorë. Edhe pse ata e kishin trajtuar mirë, nuk e kishin torturuar, nuk e kishin ofenduar me fjalë të këqija, i kishin dhënë me ngrënë dhe i kishin shtruar për të fjetur në konakët e tyrbes, ai kishte ndjerë frikë, jo nga malësorët, por nga kumti i dervishit që e kishte parë ëndërr dikur. Derisa ishte në gjumë, dervishi i dikurshëm i rikthehet me të njëjtin kumt, duke shtuar se kryengritësit do ta lironin por nuk do të gjente më prehje as në këtë botë, e as në ahiret![39] Dhe vërtetë të nesërmen kryengritësit e lirojnë, dhe kur kthehet në zyrën e tij gjen një letër që e përligjë kumtin e dervishit. Një pjesë e familjes dhe farefisit ishin vrarë. Fëmijët që kishin shpëtuar ishin tretur diku për të mbijetuar kurse sarajet dhe gruan ia kishte rrëmbyer bimbashi! Një pjesë e këtyre që thashë gjenden në arkiv, kurse pjesa tjetër janë përcjellë gojë me gojë ndër breza!

Koha kishte ecur pa e vërejtur në mesin e këtyre besimtarëve të mirë. I lypa izën hoxhës, duke i kërkuar

39 *Arab. Dita e gjykimit*

falje se e kisha vonuar, jo vetëm atë, por edhe një pjesë të mirë të xhematit. Duke biseduar dolëm në oborrin e ngushtë të xhamisë. Pasi u përshëndeta edhe me besimtarin e fundit, ia zgjata dorën hoxhës, i cili u nda shumë mirënjohës për vizitën time të papritur, dhe këtë nuk e fshihte dot. Jo vetëm sytë, që më dukej se edhe përmes errësirës e reflektonin gëzimin që e ndjente përbrenda, por këtë e shprehte edhe zëri i tij i butë! Eja prapë, më tha derisa isha duke u larguar në drejtim të rrugicës së errët.

Sa më thellë që hyja në atë rrugicë të ngushtë, aq më tepër dendësohej terri. Në fillim e pata të vështirë të mbaja ekuilibrin, por dalëngadalë sytë filluan të më mësoheshin me terrin. Në vija të trasha në mesin e territ i dalloja vetëm objektet e mëdha, si muret e shtëpive, dyert e mbyllura, ndonjë kaçubë dhe murin rrethues të varrezave deri të këndi i errët ku ishte një mezhdë e madhe e ngjitur për mur, ku përtej dukej si mullar sane. Derisa isha duke i hapur sytë tej mase për t'i parë me kohë pellgjet e mbushura me ujë që t'ju shmangsha, mu bë se një hije me vegoi për një çast para syve dhe u zhduk pranë mezhdës që nga këtu me dukej e zezë si futa. Nuk ia vura veshin, ndonjë qen thashë me vete sa për ta larguar dyshimin fillestar që pata. Kur arrita edhe më pranë, sikur ajo gjë e zezë ishte zhdukur fare, dhe në çast mendova se kot isha frikësuar. Ende pa e mbaruar këtë mendim, hija mbiu dy hapa para meje duke me trembur, dhe ashtu i shpërqendruar u hodha dy hapa prapa, duke lëshuar një zë që as vetë nuk e njoha.

– Ah... Firaun, me trembe!

– Hafiz, ti je? – me pyeti një zë i butë!

Me erdhi zë i njohur, disi identik më zërin e atij që më pati goditur disa herë me shufër hekuri para ca muajsh kur po dilja nga xhamia! Hala pa ndjerë frikë e risolla në mendje atë zë të frikshëm. Dallimi ishte i madh, sepse ky zë, nuk i kishte ngjyrat e egërsisë së zërit të atëhershëm! Sido që të jetë, mendova, është dikush i njohur përderisa e diti se cili jam. Prandaj pa menduar gjatë ju përgjigja:

– Po, unë jam... po ti...

– Në emër të Allahut, je i dënuar me vdekje! – më ndërpreu zëri, që tani më erdhi edhe më i qartësuar, por i përzier me një tmerr që fill pas fjalëve të tij kishte filluar të ma kaplonte tërë shtatin. Një palë bulëza djersë të vala sikur ma mbuluan ballin. Vallë e dëgjova vërtetë një kërcënim të tillë të frikshëm apo ndodhëm në ëndërr? O Zot, cila qenie e Allahut fshihet pas këtij zëri shpirtzi?

– Po, pse o njeri i mirë? – e pyeta me zë të butë, duke menduar se mund ta shti në gjynah, e do të heqë dorë nga ai qëllim i tmerrshëm!

– Sepse ke bërë idhuj! – mu përgjigj me një zë të zgavruar.

Idenë që e pata në fillim për atë zë që me erdhi i njohur, tani mu largua fare. Mu bë se ishte zë që për herë të parë po e dëgjoja.

I mbështjellë nga errësira në njërën anë, dhe nga qetësia e rënduar si e atyre varreve që nuk i kisha dhjetë hapa larg, ktheva kokën majtas nga kreu i rrugicës sa për të parë se mos rastësisht po kalonte dikush këndej pari. Hiq nuk me shkoi mendja se lëvizjet e kokës sime vëreheshin qartë për shkak të çallmës sime të bardhë, prandaj i dëshpëruar vendosa mos të lëvizi pa nevojë duke u përpjekur ta mbaja nën kontroll situatën duke e

zgjatur sa më shumë që të jetë e mundur bisedën me të!

– Ndoshta mund të kem gabuar në ndonjë rast, por të kem bërë idhuj qëllimisht është e pamundur! – ju përgjigja me zë të qetë, kurse me vete thashë: „Hej more Allah që po më dëgjon, dërgoje një zemërmirë në këtë rrugicë të nëmur e të me shpëtoi nga ky malukat!"

– Jo në ndonjë rast, Hafiz! Ke bërë gabime në shumë raste! Prandaj Allahu të ka dënuar!

– Atëherë ti mos dil para Allahut për ta ekzekutuar dënimin e tij... le ta bëjë Ai vetë...

– Ai me ka dërguar mua! – ma ndërpreu rreptë.

– Cili je ti, more djalë? – e pyeta sa për ta nxitur të flasë sa më shumë, për të fituar në kohë, dhe ndoshta do të ketë ndonjë lëvizje në këtë rrugicë të shkretë!

– Azraili[40] jam! – mu përgjigj pa fije turpi.

– Azraili? Nuk po të besoi hiç! – ia ktheva me ton të lodhur.

– Pse? – foli ai me ton shumë të butë sa që për një çast me shkoi mendja se e gjithë kjo ngjarje nuk ishte gjë tjetër vetëm një lojë e kurdisur nga dikush i njohur kundër meje, sa për të më përqeshur pastaj duke thënë se e frikësuam Hafizin, e bëmë të çirret si kalama nga frika... apo e bëmë t'i mbushë brekët! Jo, jo! Asnjëra nga këto nuk kanë për të ndodhur, i dhashë zemër vetes!

– Sepse Azraili nuk vë maskë për ta fshehur fytyrën e vet! – thashë me zë të ulët dhe mu prenë gjunjët nga një frikë që me një shpejtësi marramendëse ma përshkoi tërë trupin!

Mendja me punonte shpejtë dhe saktë në këtë situatë të

---

40 Engjëll që i ç'shpirtëzon njerëzit

rrezikshme, prandaj aty për aty mendova ta lusja, dhe t'i jepja çfarë do të dëshironte para se të m'i ketë kërkuar ai! Kisha dëgjuar për maskat, apo më qartë të thuhet, për të maskuarit që si gjind ju dilnin në pritë njerëzve të vonuar dhe i plaçkitnin duke ua marrë paratë dhe gjësendet e tjera me vlerë. Këto ishin risi që na i kishin lënë trashëgim të keq sunduesit e egër sllav, sepse shqiptari kurrë nuk e kishte pasur zakon të bënte plaçkitje dhe dhunime të tilla duke e fshehur fytyrën e vet! Çdo gjë që e kishte bërë, kishte qenë i vetëdijshëm, gjakftohtë dhe i vendosur duke i marrë parasysh edhe pasojat!

– Kurse unë, Azraili yt, nuk e fshehu fytyrën nga frika e dikujt që mund të me diktojë se cili jam, por nga syri yt i keq...

– Nga syri im i keq? – e ndërpreva, disi i trimëruar.

– Po! Sepse, po me panë sytë tu të mbushur haram, do vete edhe unë në atë dynja, ashtu sikurse edhe ti, pa iman! – ma ktheu me zë kërcënues dhe lëvizi pak nga vendi duke u tundur në errësirë!

– Domethënë, vetëm ky qenka faji im? – e pyeta i çuditur me fjalët e tij.

– Jo! Nuk është vetëm ky! Ti ke bërë edhe faje tjera! Disa prej fajeve tua të shumta janë edhe vazhdimi i riteve tuaja ambicioze e të dala boje, që sapo more pak famë, t'u rrit mendja dhe fillove t'i akuzosh të tjerët se kanë dalë nga rruga e Allahut! Fillove të krijosh vepra duke e ditur se ai që krijon është vetëm Allahu, që i jep shpirt asaj që nuk ka jetuar kurrë, kurse ti deshe të matesh me të duke bërë shirk me ato vepra tuaja të mallkuara, prandaj, Allahu që është një e nuk ka shok tjetër, nuk i duron ata që bëjnë shirk, nuk i duron ata që duan t'i bëhen shok... nuk i duron

sfiduesit, por ua dërgon Azralin për t'ua marrë shpirtin dhe për t'i degdisur në flakën e xhehenemit!

– Nëse është ashtu, atëherë unë më se paku kam bërë faje, më se paku kam bërë shirk! A nuk janë shkruar me mijëra hadithe, bukhare e tefsire të ndryshme që nga koha e Pejgamberit selamu alejkum, duke sfiduar Kuranin e shenjtë? A nuk janë kënduar me mijëra vargje që i kushtohen Profetit? A nuk janë shkruar me mijëra qitapë që e përshkruajnë fenë dhe shartet e saj ndryshe nga Kurani? A nuk kanë rënë me mijëra shehitë me thirrjen e Allahut në gojë për t'i mbrojtur librat, shkrimet dhe komentimet e imamëve që këmbëngulin se vetëm stili i tyre duhet të aplikohet, duke u larguar nga ato që janë të shkruara në Kuran? Ti do të thuash se këta imam nuk paskan bërë shirk duke shkruar ndryshe nga ato që thuhen në Kuranin Kelamullah? – i thashë me zë të ngritur duke pasur parasysh se mund të na dëgjonte dikush dhe të jepte kushtrimin për ndihmë! Pas një heshtje të shkurtër pata përshtypjen se ai u kishte besuar fjalëve të mia, dhe do të hiqte dorë nga mendja e tij e krisur.

– Jo! Këta nuk kanë bërë shirk, sepse... sepse këta... këta të gjitha që i kanë shkruar dhe komentuar janë mbështetur në Kuranin e Kelamullah të cilin e kanë kuptuar, sepse e kanë kënduar në gjuhën e tyre! Kurse ti, ose nuk e ke kuptuar se nuk e njeh gjuhën e Allahut, ose je profan në këtë fushë, por sigurisht se të kanë yshtur djajtë dhe nuk ke dashur ta kuptosh të vërtetën dhe u hodhe duke shkruar në ato studimet tuaja shkencore se gjoja Allahu na qenka hyjnesha hënë, apo thjeshtë hyjni sepse sipas gjuhës arabe, me demek Zoti po u quaka

Rab... Pastaj e ke bërë edhe fajin tjetër, duke e lartësuar kombin para kësaj feje të madhërishme! Ky është kulmi i budallallëkut tënd! Po ku ka komb para kësaj feje të shenjtë e të madhërishme, qafir! – ma ktheu me ton të ulët por kërcënues, dhe vazhdoi: – Ke vetëm një rrugë që të shpëtosh. T'i lutësh Allahut për të gjitha të këqijat që i ke bërë dhe të kthehesh në rrugën e drejtë... dua të them të kthehesh në rrugën tonë!

– Në cilën rrugë the? – e pyeta me zë të lartë.

– Në rrugën tonë, thashë!

– Cila është rruga e juaj mor bir, ma thuaj! Pastaj do të tregoj se a do të pranoj të kthehem apo jo! – i thashë derisa e vërejta lëvizje të turbullta që mezi shquheshin nga errësira.

Edhe unë lëviza pak nga vendi. Derisa po flisja, me bëhej se fjalët që i thosha po mi nxirrte dhunshëm dikush tjetër nga goja që me ishte tharë. E vërejta se nuk me kishte mbetur asnjë rrugë tjetër, veç asaj të nënshtrimit pa kushte apo e rezistencës! Diçka me lëvrinte nëpër bark. Gjaku me lëvizte vrullshëm nëpër damarë, kurse koka më rëndonte nga e panjohura që me rrinte karshi, e patundur dhe e zezë si futa! Ndërkohë, nga varrezat u ndien disa të lehura qensh! Për një çast u ngazëlleva, sepse mu bë se prej tyre mund të më vinte shpëtimi... por vetëm nëse qentë na sulmojnë! Të lehurat u përsëritën më të afërta! I ndjeva edhe ngërdhucet e dhëmbëve sikur të kishin ndjerë erë gjaku!

Rrinim përballë njëri-tjetrit sikur të ishim në duel. Nga zëri mu bë se e njoha, por nuk isha i sigurt! Me shpejtësi marramendëse i kujtova të njohurit dhe të panjohurit që mund të kishin rrjedhur nga mendja dhe të me dilnin në

një rrugicë të errët në skajin e qytetit e të më akuzojnë se gjoja paskam bërë shirk, se gjoja e paskam sfiduar Allahun e Madhërishëm dhe pastaj të më detyron t'i bie në gjunjë për t'ia dëshmuar pafajësinë time? Prapë mendja me fluturoi larg... diku nëpër klasat e medresesë duke i parë nxënësit të ulur që më shikonin me kureshtje kur ua shpjegoja suret e shenjta të Kuranit! Cili prej tyre mund të jetë vallë?

– Më mirë mos të kthehesh në rrugën tonë! – më tha pas një heshtje që mua mu duk relativisht e gjatë, dhe vazhdoi: – nëse i shpëton sonte hidhërimit të Allahut, kur të shërohesh do të bisedojmë edhe njëherë, nëse nuk i shpëton, takohem në botën tjetër, atje, në ahiret! – më tha dhe filloi të avitej me hapa të ngadalshëm por të sigurt!

– Ç'kërkon nga unë... mos më çart! Do para? – e pyeta me zërin që po me dridhej.

– Jo! Azraili nuk pranon para! Ai do vetëm shpirtra! – më tha derisa ishte duke e ngritë krahun lartë. Nuk e dallova dot se a e kishte lëvizur vetëm njërin krah, apo të dytë së bashku... dhe nuk qesh i sigurt se a kishte ndonjë send në dorë apo... Nuk e përcaktova dot se a ndodhën ndaras apo së bashku, dhembja në mes të çallmës dhe ballit dhe dy drita që me dolën rreptë nga sytë! Kurse britmën „Ah!" që me doli nga goja pa dijen time e dëgjova pak më vonë, dhe bashkë me atë britmë i hetova të dyja duart që e mbuluan ballin tim tani më të çarë dhe pa çallmë! Pëllëmbët mu ngrohën nga vrushkujt e gjakut që i ndjeja kur vërshonin jashtë kafkës sime të çarë. Derisa isha duke u kërrusur nga dhembjet në kokë, ndjeva një shpim në mes të barkut, sa mu bë se edhe sytë po me dilnin nga vendi! Nuk e mbajta dot ekuilibrin. E ndjeva çikjen e gjurit të

majtë me ftohtësinë e ujit të pusit të rrugicës. Derisa po e vendosja edhe gjurin tjetër në pus, ndjeva edhe një të rënë pas kokës, pikërisht në atë vend që orë më parë berberi me kujdesin më të madh, me briskun e tij të mprehtë i kishte rruar qimet e rritura duke e nxjerrë sheshit lëkurën e butë të qafës. Bashkë me dhembjen ndjeva edhe kërcëllimën e kafkës gjatë procesit të thyerjes. Prapë, pa dashjen time nga goja me doli një gulçimë. Pastaj, e provova që gulçimën e radhës ta shndërroi në zë për të kërkuar ndihmë por, prapë nuk më doli zë... vetëm gulçimë e venitur! E ndjeva se trupi im po shkonte drejtë rënies së plotë. Këtë rënie nuk kishte më së kush mund ta ndalte, kurse dhembjet ishin të tmerrshme. Së pari me preku bërryli i dorës së majtë në pellg, pastaj edhe supi, kurse fytyra mu bë se me mbeti jashtë pellgut, në një breg të vockël, të ftohët akull dhe pa ujë! Mu bë se ai i poshtri që më bëri gjëmën, i pushoi goditjet. U ngazëlleva për një çast, pasi mu bë se e la me kaq, sepse kështu, ende llogaritsha me të gjallët, por ai katil, prapë i rikthej goditjet. Me goditi furishëm, në trup, në kokë... me shpoi shpinën anë për tej! Nuk i numërova dot të goditurat e shpimet... dhembjet ishin të tmerrshme. Nuk e di se si i duroja. E ndjeva dorën që më ishte mbushur me baltë, dhe pastaj, dëgjova hapa që po largoheshin! O Zot, pashë hatrin tënd, dërgoje një njeri të mirë, të me gjejë e të më ndihmojë... të paktën ta lajmëroj familjen... Ka vite e dekada që nuk m'u ka kujtuar një hadith, që në rini të hershme e kisha lexuar diku në një qitap të vjetër ku shkruante se shpirti del vetëm nga goja! Unë ende jam i gjallë. Jam i rrëzuar përmbys në mesin e një rrugice të errët dhe me gropa. Dorën e majtë ma ka zënë trupi përfundi, dhe nuk e lëvizi dot!

Kurse me të djathtën ende po manovroj duke e mbushur me baltë e zall të rrugës. Kokën e kam të thyer e të bërë përshesh, kurse fytyra mu ka palavitë mbi një bregore pranë pellgut me ujë. Goja më ka ngelur e mbyllur me nofull të bllokuar përdhé! Struktura e fytyrës, e ndjej se ka marrë pamje çoroditëse, me bëhet së këtë po e shoh, dhe pa nda po e luti Zotin që mos ta shikojë më fytyrën time në këtë gjendje të mjerë! Nuk e kuptova dot se sa kohë kam qëndruar aty i gjallë, por si në ëndërr e ndjeva kur shpirti e la trupin tim në mes të rrugës, dhe mori rrugën e kthimit tek ai që ma kishte dhuruar dikur! Nuk di se nga doli! Jam i sigurt se nga goja jo, sepse ishte e mbyllur dhe e mbushur plot gjak!

MAGJISTARI

Tamam sa e përcolla hallexhiun e radhës dhe me dy mendje u ktheva në ordinancë! Ndjehesha i lodhur dhe isha në mëdyshje ta pranoja edhe një pacient apo ta mbyllja për sot? Ndërkohë, ia behu gruaja e me tha:

– Pranoje edhe një vajzë të re! Ka mbi dy sahat që po të pret!

– Po pse moj grua nuk më ke treguar më parë?

– Për shkak të kritereve!

Sa me erdhi inat kur mi përmendi kriteret! Një copë herë nuk fola nga mëria. Pastaj, kur mu duk se kishin filluar të më binin nervat, i thashë gruas të ma sillte nga dera tjetër pa u rënë në sy atyre që prisnin, të cilëve pas pak u thashë:

– Ejani nesër, sot u mbyll!

Edhe pse gruaja ime është në dijeni se pasurinë më të madhe e kemi vënë në saje të këtyre vajzave hallemëdha,

prapë se prapë e mbanë të fshehur në shpirt atë xhelozinë e dikurshme. Sa herë që paraqitet ndonjë vajzë e bukur, ajo nuk më lajmëron menjëherë, por e lë po thuaj të fundit, dhe kur i them pse, për shkak të kritereve, thotë! Vërtetë, kjo puna e kritereve në lidhje me hetimin e bukurisë së vajzave ka një domethënie të veçantë në syrin tim! Edhe pse unë gjithmonë jam përpjekur t'i mbaj të fshehura ngacmimet epshore kur më rastisë të takoj vajza të bukura, ajo m'i zbulon para së t'i kam ndjerë vetë dhe pa pikë dhembje m'i thotë troç! Sa më e bukur e naive të jetë vajza, aq më lehtë do të ndodhet nën peshën e trupit tim... natyrisht se edhe fitimi do të jetë i majmur sepse me marifet i përdori shantazhet pastaj! Por ç'e do! Ec e mbushja mendjen kësaj!

Për t'ju shmangur xhelozisë së saj, u bëra gati për t'ia shkruar hajmalinë asaj vajze fatkeqe, sepse e merrja me mend se për këtë punë kishte ardhur, kur para meje mu shfaq një plakë! Ngrita vështrimin i habitur! Gruaja me tha se ishte një vajzë e re, nga mbiu kjo kërrutë plakë tani? Por, në çast zemra me erdhi në vend, kur prapa saj u shfaq një perri të bukur si Allahu që kishte ditur me e jaratisë Me marifet, së pari i bëra vend plakës nja dy-tre këmbë pas krahut tim të djathtë, që dërdëlliste pa ndërpre duke me thënë se kishte ardhur bashkë me mbesën për një hall të madh, sikur ia kishin shituar ata qofshin larg nesh, por unë nuk ua vura veshin fjalëve të saj, duke qenë i sigurt se kjo është njëra prej atyre që do të pranojë të zgërlaqet nën peshën e ekstazës sime, prandaj, pa humbur kohë i thashë vajzës të qëndronte në këmbë rreth një metër larg meje dhe vetë zura vend përballë saj. Të gjitha këto do të duken si gjëra të tepërta që nuk kanë lidhje fare

për dertin e tyre. Por jo, nuk është fare ashtu! Këto janë marifete që lidhen me rregullat e punës sime në njërën anë, kurse në anën tjetër testi provues, pa pasur mundësi që gjyshja e saj prapa t'i shoh shprehjet e syve të mi. Vetëm kështu mund ta identifikoj atë perri se a është njëra nga ato naivet që do ta pranon hipnozën, apo është nga ato që mjafton një hajmali dhe disa udhëzime shtesë për t'i thënë natën e mirë!

– Si të quajnë? – e pyeta

– Fiti. – ma kthej.

Mezi e mbajta veten. Emri i saj ma kujtoi një urdhër të fshehtë që sapo e kisha marrë, dhe gjithsesi duhej zbatuar! Një palë mornica ma përshkuan mbarë trupin. Pas një heshtje të gjatë me zë të tulatur e përgëzova për emrin:

– Paske emër të bukur Fiti! E gëzofsh! – i thashë me gjysmë zëri, kurse me vete mendova: e mjera ti moj vajzë, paske rënë në kurth.

– Ju faleminderit!

– Dëgjo Fiti; pa kundërshtime duhet t'i zbatosh urdhrat e mi! Mirë?

– Mirë! – mu përgjigj me atë zë të ëmbël

– Je e gatshme t'ia fillojmë?

– Po!

– Mbylli sytë! – i thashë derisa kisha marrë qëndrim solemn para saj, duke kënduar një dua, dhe pastaj duke fry lehtë në drejtim të saj!

– Shumë mirë! Kjo përfundoi me sukses! Tani shko disa hapa pas, dhe ulu në divan! – i thashë!

Ndërkohë, ajo ishte ulur në divan, por dukej e ndrojtur! Ka turp, mendova, dhe i thashë:

– Mbështetu mirë, dhe mbylli sytë!

Me dëgjoi, dhe veproi ashtu.

– Apo sheh gjë? – e pyeta.

– Jo! – mu përgjigj me zë të ndrojtur!

– Kërko brenda asaj errësire dhe do të hasësh në një dritë të venitur! – i thashë duke e parë fytyrën e saj të njomë dhe të bukur.

– Nuk po shohë gjë!

– Kërkoje me ngulmë, se aty është! Unë po e shoh! Kërkoje!

Ia ktheva i vendosur

– E gjeta! – u përgjigj pas pak çastesh!

– Shumë mirë! Tani mos u nxito! Prit pak, sepse ajo dritë duhet të rritet! – i thashë i gëzuar jashtë mase, dhe me vete mendova; e mori të mbarën!

– Po ka filluar të rritët! – tha me zë të ultë!

– Shumë mirë! Kur të bëhet e plotë, në mesin e saj kërko dhe do ta gjesh një pikë të zezë!

– Ende nuk është e plotë!

– Pritë dhe ca... përpiqu ta zmadhosh dritën me ngulmë! Do ta gjesh se s'bënë!

– Nuk po shoh gjë!

– Prit dhe ca... kërkoje, kërkoje! – e urdhërova.

– Ka filluar të më shfaqet!

– Zgjate dorën drejt asaj pike!

– Si?

– Zgjate dorën drejt asaj pike dhe kape!

– Kë?

– Pikën e zezë që t'u ka shfaqur! Zgjate dorën dhe kape! Ashtu!... Ashtu... Shumë mirë, shumë mirë! Tani hidhe tutje... Hidhe... dhe kërkoje pikën tjetër! – i flisja ngadalë derisa isha afruar fare pranë, ku ja dëgjoja frymëmarrjen

e lehtë, dhe e soditja me ëndje fytyrën dhe trupin e saj të lezetshëm mbështetur në divan!

– Ashtu vazhdo! Kur të mbarojnë pikat e zeza, me njofto!

– Mirë!

– A ka shumë?

– Po! po shtohen vazhdimisht!

– Vetëm ato që janë të zeza hiçi!

– Janë shumë... nuk i zë dot!

– Vetëm të zezat...

– Nuk i zë dot të gjitha!...

Ishte pikërisht ashtu siç e kisha planifikuar. Pas testit të parë, kjo pa asnjë kundërshtim do të pranonte sugjerimet e radhës, prandaj ishte koha e kalimit në fazën e dytë!

– Duhet pastruar rrobat!... Po nuk u bë kjo, çdo gjë do të mbetët në gjendjen e mëparshme! – thashë pak i ndrojtur nga ndonjë reagim i papritur i plakës që shikonte e hutuar. Kur e pashë se pasoi heshtja, që për mua, në raste të tilla nënkupton pranim, trokita dy herë në dollapin pranë divanit.

Ndërkohë, në derë u shfaq gruaja.

– Pastroja rrobat! – I thashë pa ia vërë veshin vështrimeve pyetëse të plakës hutaqe.

– Zgjohu ngadalë!... zgjohu, ashtu! Mbahu për mua se tani je shumë e lodhur... mbahu nga krahu im! Ashtu, ashtu! Shumë mirë! – i fliste gruaja ime duke krijuar përshtypjen sikur vërtetë vajza ishte tepër e lodhur! Edhe ajo sikur ta kishte kuptuar hilen tonë se ne këtë aktrim e dëshironim, pa qenë e sigurt në forcat e veta, krijonte përshtypjen së vërtetë ishte shumë e lodhur!

Pasi dolën nga dera, u ktheva drejt plakës për t'i sqaruar

se çfarë ishte duke ndodhur me mbesën e saj, kur nga padurimi ajo me pyeti:

– Mu bë sikur thatë se duhet larë rrobat?

– Po, por jo me ujë! Duhen kënduar dua vetëm rrobave, jashtë trupit të saj! Këtë punë e kryen gruaja ime në dhomën matanë. M'i sjellë rrobat këtu, ua bëjë duatë përkatëse dhe pastaj të pastruara nga pikat e zeza ia kthen prapë. Këtu nuk ka asgjë të keqe!

– Aha! Tani e mora vesh! Por ju sikur nuk me pyetët fare se çfarë ka vajza? – me pyeti me dashamirësi!

– Ju, në fillim... sikur me thatë se e kanë shituar ata qofshin larg nesh! Është kështu apo jo? – i thashë i shpërqendruar për një çast. Vërtetë ishte ashtu, por vetëm kjo nuk mjaftonte, prandaj sa për t'ia bërë qejfin plakës e pyeta: – Keni edhe diçka tjetër për të shtuar në lidhje me vajzën?

– Po!

– Thuaje pra! – ia ktheva duke bërë përpjekje për ta fshehur zemërimin që kishte filluar të më ngacmonte.

– Mbesa ime është e dashuruar. I dashuri i saj ka studiuar katër vite diku në Arabi dhe tani është kthyer, por i tjetërsuar me ca veshje, me ca sjellje që kurrë nuk janë parë në këto anë! Thotë se nuk e përballon dot tjetërsimin e tij... – vazhdoi të fliste plaka me atë zërin e saj të mekur, por unë nuk i dëgjova fjalët pasuese.

Me t'u përmendur studimet e atij bandillit në Arabi, tjetërsimi në veshje dhe sjellje ndjeva një si goditje në kraharor, sepse e dija se vetëm studentet e teologjisë ua mësyn atyre vendeve! Ata e mësojnë Kuranin e shenjtë në gishta dhe nuk i mashtroj dot. Tani ishte tepër vonë të ndërmerrja diç për ta ndaluar procesin e riteve!... pastaj

filloi të më mundon pa masë urdhri i fshehtë! Shpejt u gjenda në dy mendje, ta ndërpres apo ta zbatoj urdhrin? Ndërkohë, plaka vazhdonte të fliste me zërin e saj të mekur: – ...meazallah, unë e di se ç'kam hequr që t'ia mbushë mendjen të vijë deri këtu! Dyshonte, trembej, nuk besonte në ndihmën e tjetërkujt përveç të atij që e ka pru në këtë orë të ligë!... – e ndërpreu bisedën vetëm atëherë kur e ngrita gishtin të hunda duke ia bërë:

– Shshshsh!... tani duhet t'i këndoj duatë! – e ndërpreva qëllimisht. Nuk i duroja dot dërdëllitjet e saj.

Nga dhoma matanë vinte zëri i gruas sime i qartë derisa e urdhëronte vajzën t'i bënte ritet e radhës. Për një çast, kalimthi nëpër mendje më shkoi pamja e trupit të saj tanimë lakuriq. Për disa sekonda u shkërmoqa nga kënaqësia... por edhe u rrëqetha kur m'u kujtua urdhri i fshehtë dhe pamja e atij bandillit selef!

– Derisa ta dëgjosh fjalën „Amin" nga dhoma tjetër, duhet të sillesh ngadalë tri herë nga e djathta në të majtë, tri herë nga e majta në të djathtë, tri herë të ulesh dhe tri herë të ngritësh, tri herë të shtrihesh dhe ashtu e shtrirë mbi shtrat të rrotullohesh tri herë majtas e tri herë djathtas! Nëse ende nuk e ke dëgjuar fjalën Amin, nisja edhe njëherë nga fillimi! Kaq! E ke të qartë?

– Po! – mëzi u dëgjua zëri i saj i ndrojtur!

– Mirë pra! Këto veprime bëj sa më ngadalë, në mënyrë që të jenë të përputhura me duatë! Pasi të dal unë, nisja! Mirë?

– Mirë!

Ra heshtje! Ua vura veshin lëvizjeve të gruas që vinte drejt meje me rroba ndër duar. Filloi t'i shtrinte mbi sëndukun më tërë gjatësinë e tyre, duke i tërheq me

kujdes. M'u dukën të shkreta. Sikur kisha një parandjenjë ogurzezë nga rasti ideal që më jepej. Kishte kohë që kisha kërkuar një rast të tillë, por... disi jo me një urdhër kaq të prerë! Do të doja që kjo që po me ndodhë tani, të më kishte ndodhur me njërën nga ato vajzat e përdala... që kanë dashnorë njërin prej atyre djelmoshave që studiojnë diku në perëndim, që janë të butë dhe të arsyeshëm, e jo kësi studentësh kokëtrashë të lindjes... po ku vijnë të përdalat këtu? – e pyeta veten i habitur! Ato punët e dashurisë i zgjidhin vetë, kurse kjo që ka zemrën e dëlirë, besimin dhe karakterin e fortë, dashurinë që i buron nga zemra e jo nga lajkat, nga frika se mund ta humbas atë që e do me gjithë shpirt vjen dhe kërkon ndihmën time! Kurse unë, për pak para... dhunshëm jam i shtrënguar t'i zbatoj urdhrat... ahhhh... haj medet haj, po ç'më gjeti më atë dreq profesori!

– Çdo gjë është gati, mund t'ia fillosh! – m'i ndërpreu mendimet gruaja në largim e sipër.

Nuk pata rrugë tjetër! Këndimin e sureve e bëra shumë më shkurt.

Në raste të tilla nuk kishte qenë asnjëherë stili im që të jem kaq i rrëmbyeshëm. Se nga më vinte një ndjenjë ndryshe, e pa përjetuar. Vërtetë përbrenda meje kishte filluar të ndodhte një ndryshim, i mbështjellë me një tis të hollë frike që më vinte nga ai profesor i mallkuar që nuk m'u shqit tërë jetën! Sikur të mos mjaftonte ai malukat, se nga mbinë ca studentë, ca të rinj që nuk ju besojnë magjive, duke m'i deshifruar letrat në xhep!

Edhe pse e di që magjia është e ndaluar me Kuran, ku është e shkruar fare qartë në suren El Bekare, se magjia e ndan burrin nga gruaja por pa pëlqimin e Allahut, i

bëja në çdo kohë e në çdo vend që me jepej rasti dhe më dilte fitimi! Kurrë më parë nuk më kishte shkuar mendja te humaniteti, edhe pse këtë fjalë, tërë jetën e pata fort për zemër, sepse më sillte fitime të majme! Gjatë kohës së shkrimit të magjive, fytyra ime merr pamje humane, por që në realitet nuk është gjë tjetër përveç maskë ku pas saj fshihen gënjeshtrat, mashtrimet... por, e ndjej se sot jam i shtrënguar të lëshoj pé dhe të bëjë disa vepra humane! Jo nga dëshira, por nga frika e atij bandillit që sapo qenka kthyer!... se ç'kam një frikë prej tyre, jo që me janë kërcënuar ndonjëherë, Estagfirullah[41], por nga ai seriozitet i tyre i shtirë, nga ato mjekra të ngatërruara e pa stil, nga heshtja e tyre naive, nga shikimet e tyre hutaqe, nga veprimet injorante e veçmas ndaj femrave, nga veshjet që më bëhen sikur janë uniforma dervishësh të çmendur, që vetëm kamat dhe jataganët ju mungojnë për t'ju sulur të paudhëve, idhujtarëve, të pafeve... dhe të gjithë atyre që nuk ju besojnë stileve të tyre! O Allah, qofsha nën mëshirën tënde jarabi[42]!

Derisa isha duke i kënduar duatë, mendjen nuk e kisha fare në atë së çfarë po këndoja. Ishte hera e parë që në mendje më shfaqej shejtani me gjithë madhështinë e tij, i fshehur pas hijes së kësaj vajze dhe i veshur me atë stilin që e ka sjellë me vete ai bandilli i saj! Pa entuziazëm, fillova ta paramendoj vajzën lakuriq duke u rrotulluar mbi shtratin e shtruar me mëndafsh të kuq! As këto mendime, kësaj radhe nuk më mrekulluan, prandaj vendosa ta përfundoi!

– Amin! – thirra me zë të lartë.

Gruaja u duke në derë. E pashë se ishte e hutuar dhe e

41 Kërkoj falje nga Allahu
42 Arab. Im Zot!

çuditur njëherësh! Nuk i dhashë asnjë shkak të kuptonte gjë nga mimika ime, por e ula kokën në atë stilin e njohur! Ajo mori rrobat dhe iku drejtë dhomës matanë, ku e priste vajza! Duke e menduar atë bandillin e saj, mora vendim: Nuk do t'i shkruaj fare as hajmali, as tiveleh! Do t'i them se nuk je për magjitë e mia, por je për doktor! Ato që më nevojitën për ta dërguar në vend urdhrin e fshehtë i mora. Edhe fitimi nuk do të mungojë, prandaj, të paktën, në sytë e saj do të tregohem human. Nuk do t'i marr para! Kaq! Ndërkohë gruaja dhe vajza u panë në derë. Ia bëra me shenjë të vinte pranë tryezës sime. Pasi u ul i thashë:

– Keni depresion! Kjo ju vjen nga zhgënjimi i madh që ju ka tronditur. Keni pritur kohë të gjatë, keni ëndërruar diçka tjetër, dhe në një çast ju ka zhgënjyer realiteti që ka qenë krejt i kundërt nga ai që e keni dëshiruar dhe që e keni ëndërruar me vite të tëra, prandaj unë të udhëzoj; të bësh një kontroll te doktori... sepse ti nuk je për hajmali e as për ilaçet e mia! Kaq nga ana ime. Mund të shkoni!

– Sa duhet paguar? – pyeti plaka

– Asgjë! Unë jam human! Ruaj paratë që t'i kesh për doktorin, sepse atje duhet të paguash! Natën e mirë! – ju thashë pa asnjë entuziazëm, edhe pse mimika e gruas thoshte diçka tjetër!

– Ju faleminderit! – u dëgjua të fliste plaka! Fare në fund ndjeva zërin e ëmbël të vajzës kur tha:

– Natën e mirë!

E mjera ti moj vajzë hallemadhe, mendova derisa ato po largoheshin në mesin e përplasjeve të çrregullta të derës dhe shushurimës së hapave të lehtë.

Gruaja u nis pas tyre për t'i nxjerrë nga dera e pasme.

Ngela i vetëm në dhomën gjysmë të errët. Pa dashur m'u

shfaq një fytyrë mjekroshë, ngjitur për një kokë të madhe, me ca sy të zgurdulluar që më shikonin vetullngrysur! Nuk e di se si po ndjehem tani, i mbërthyer pas mendimeve të tilla ogurzeza, por që asnjërën nga këto mendime nuk i kam të qarta! Të gjitha më vijnë të ngatërruara dhe të radhitura keq njëra pas tjetrës, duke fshehur brenda tyre një trishtim të padukshëm. Kokën e kam lëmsh, por e di se si do që të veproja, në këtë stilin që kam punuar deri me tani, apo në ndonjë stil tjetër, medoemos do të vinte një ditë që ndërgjegjja ime pa më pyetur fare do të më pëshpëriste pranë veshit duke vlerësuar se çfarë bëra mirë dhe çfarë bëra keq në jetë, cilit i hyra në hak, e cilin e shpërbleva! Dhe si zakonisht, do të ndodhte ashtu siç kishte ndodhur ngaherë; do të anoja nga fitimi, nga paraja, sepse ndërgjegjja nuk i përshtatet fytyrës sime hipokrite, edhe pse nga pamja e jashtme nuk duket e tillë!

Gruaja kishte bërë grumbullimin e kasetave dhe me ftonte pranë televizorit që ndodhej në studion e punës, për t'i verifikuar materialet e porsa marra. Përtueshëm u ngjita lartë. Ajo kishte filluar t'i bënte analizat e para. Pashë në televizor Fitin lakuriq të ngjitej mbi shtrat, që çaste me parë më kishte thënë natën e mirë. Edhe pse pa vullnet, pamjet e trupit të saj të njomë më tërhoqën! Lëvizjet i bënte ngadalë, ashtu siç e kishte porositur gruaja. Kishte një trup të mbushur, belhollë, gjoks gufuar, këmbë dhe kofshë të drejta që lidheshin bukur pas vitheve të lëmuara, të mbuluara këndshëm nga majat e flokëve të arratisura, të arta e të drejta, duke ia mbuluar supet e saj të bëshme! Derisa e shikoja ato tablo, me bëhej se nuk isha duke parë trupin e një vajze hallemadhe, por isha duke e parë një trup të huaj, të ftohët dhe të largët si

statujë mermeri, ndërsa po më bëhej sikur më thoshte: po bën gjynah... po më ç'nderon... dhe në çast më shfaqej pamja e kërleshët e atij mjekroshit të imagjinuar që më thoshte me sy të zgurdulluar; më ke prekë në namuz!... je mbushë haram! Për të gjitha këto do të përgjigjesh ditën e gjykimit! Mos më detyro të përgjigjem tani në këtë botë, sikur po i thosha përmes atij zërit tim të brendshëm, se me atë botën tjetër as që më frikëson mua! Askush nuk ka dalë që andej e të thotë se filani që ka bërë gjynahe në këtë botë, po digjet në zjarrin xhehenemit në botën tjetër! Ëndrra! Por, të gjitha këto më dukeshin se nuk ishin gjë tjetër vetëm orvatje sa për ta ngushëlluar veten!

Derisa gruaja ime e dashur, ishte duke e futë në rekorder kasetën e kamerës së pestë, ra zilja e telefonit. Vetëm tani e vërejta se gjatë gjithë kohës sa kishte zgjatur verifikimit i tyre, edhe pse sytë vazhdimisht i kisha në televizor, nuk e kisha vërejtur se kur dhe si i kishte ndërruar kasetat njërën pas tjetrës! Për një çast m'u bë se kjo nuk kishte qenë një shkarje nga ana ime, sepse pamjet e katër kamerave tregonin gati të njëjtat skena. Dallimi ishte se të gjitha ishin të vendosura në kënde të dhomës dhe të kurdisura në atë mënyrë që njëra t'i merrte pamjet më afër, tjetra më larg, tjetra pjerrtas nga lart poshtë, dhe e fundit pjerrtas nga poshtë lart. Vetëm kamera e pestë ishte e vendosur në tavan, dhe pamjet i merrte drejtpërsëdrejti mbi shtrat, nga lart poshtë! Këto skena me fascinonin, dhe konsideroheshin me vlera më të larta! Pa i shqitë sytë nga televizori e mora telefonin:

– Alo! – thirra me zë të ulët

Nga ana tjetër e telefonit me erdhi zëri i njohur i profesorit. Jo si gjithmonë, një bisedë e shkurtër me

motive pune, një urdhër apo kërkesë në fund, dhe natën e mirë! Por kësaj radhe sikur e zgjati bisedën diç më tepër se ç'ishte zakoni i tij. Në fillim më njoftonte për një të ri që nesër në mëngjes do të vinte për vizitë të unë për zbërthimin e një ëndrre. Pa pikë mëshire më tha se ishte i sojit të paraardhësve... „të rrezikshëm!" – këtë të fundit, pa e thënë ai, e mendova vetë, dhe trupin ma përshkuan një palë mornica! Mu bë së ballin ma mbuluan një palë bulëza djersësh të nxehta valë! Në vija të trasha ma tha ëndrrën e tij, të cilën ia kishte thënë njëri nga bashkëpunëtorët. Me urdhëroi të mbaja shënim, që gjatë komentimit të jem sa më i saktë. Pastaj më pyeti se a kisha bërë filmin e urdhëruar? Nuk e di as vet se sa çaste nuk qesh në gjendje t'i përgjigjesha! Isha i dyzuar dhe nuk vendosja dot, t'i thosha po, apo t'i thosha jo... por, pasi para sysh m'u shfaqën paratë që do të m'i sillte pas pak ndërmjetësuesi, i thashë po, duke i sqaruar se në të njëjtën kohë e kisha zbatuar edhe urdhrin e tij! Disi e ndjeva veten të lumtur pasi fola, sepse nuk më kujtohej të më kishte ndodhur që të jem kaq i luhatur në marrjen e vendimeve, e veçmas i atyre vendimeve që më sjellin fitime të majme! Pastaj, e dëgjova kur më njoftoi se si nga hera do ta dërgonte atë të përhershmin t'i merrte materialet në kundërvlerën e caktuar më parë! Mirë i thashë, dhe e mbylla telefonin.

Në fillim fare, sa kisha filluar të merresha me shkrimin e hajmalive, kishte ardhur një burrë i leckosur dhe ma kishte zënë derën duke kërkuar lëmoshë! E kisha futë brenda dhe i kisha shtruar për të ngrënë. As që i kishte shikuar ato ushqime, por duke me shikuar mrrolshëm, më kishte thënë: Dëgjo këtu, nuk kam ardhur për të ngrënë, por për një punë krejt tjetër; me ka dërguar profesori

të bisedoj shtruar me ju për disa çështje me interes të përbashkët! Cili është ai profesor, e pyeta? Kjo nuk ka rëndësi fare! Atëherë dil jashtë, ju pata kërcënuar! Pasi më kishte shikuar me një palë sy dinak me ishte përgjigjur: Nuk është në interesin tuaj të nxitohesh! Profesori që më ka dërguar këtu, i di në imtësi të gjitha gjërat e paligjshme që po i bën ti, prandaj, unë kërkoj nga ti të jesh më i arsyeshëm dhe të tregosh vullnet të mirë... në të kundërtën, pasojat për ty do të jenë të rënda! Dashtë Zoti e mos t'i provosh... se nuk do t'i mbajë dot kjo lëkura juaj e dhjamur! Ç'kërkon ai profesor nga unë?, e pyeta duke e parë se dikush fshihej pas këtij llagapi, por nuk e kisha asnjë ide se kush mund të ishte, bile as sot nuk e kam asnjë ide se kush fshihet pas tij!... Për sot, më tha pas pak, asgjë më shumë se një numër të koduar telefoni, mu përgjigj qetë duke më shikuar me një buzëqeshje cinike të varur në buzën e poshtme, dhe vazhdoi; nesër në ora tetë fiks ta telefonosh! Kaq, tha pasi ma lëshoi në dorë një zarf, dhe u ngrit në këmbë. Vetëm një fjalë që del sheshit për sa folëm ne të dy, ndëshkimet do të jenë të rënda... të tmerrshme, besoj që e more vesh!? Pasi më tha ditën e mirë, doli sikur mos të kishte ndodhur asgjë! Dita sikur mu ngrys, sikur mu kthye në errësirë të natës! Njëmijë pyetje ia kisha shtruar vetes në atë kohë, pa qenë në gjendje t'i përgjigjem asnjërës prej tyre! Nata qe edhe më e mundimshme. Nuk me shqitej nga mendja ai leckaman që ma kishte sjellë letrën por, as figura e imagjinuar e profesorit, jo vetëm që nuk më shqitej nga mendja por zhytej edhe më shumë duke marrë forma dhe trajta të përbindshme që me bënin të ç'mendesha nga frika. Ashtu siç isha shtrirë në mbrëmje, ashtu më

zuri drita e mëngjesit! E kisha zbërthyer kodin në bazë të një udhëzimi që ma kishte dërguar bashkë me numrin dhe porsa ra ora tetë, e solla! Profesori, m'u përgjigj një zë burri. I tregova se kush jam! Të prisja, me tha pastaj, dhe vazhdoi me të njëjtin ton si atë të fillimit. Shiko, jam në dijeni deri në imtësi për punën tuaj, për pasurinë tuaj dhe për metodat tuaja gjatë punës! Unë mund t'ju ndihmoj duke ju dërguar klient të rinj, që ti po i quan pacientë, por mund edhe t'ju shkatërroj deri në asgjësim nëse nuk pranon bashkëpunimin me ne! Kur e pyeta së cili ishte dhe ç'kërkonte nga unë, më tha: Kush jam unë nuk ka asnjë rëndësi tani për tani! Kurse nga ti kërkoj ndërlidhje dhe informata! Kaq! Pata pranuar duke pasur idenë se nuk do të jenë aq të rëndësishme ato kërkesa të tij, por para se të fillonte lufta dhe deri kah fundi i saj unë e di se ç'kam hequr për t'i siguruar ato informata të shkreta! Dy herë me nxorën para pushkatimit, jo vetëm njëra palë që ishte e përfshirë në luftë, por të dyja palët, dhe të dyja kërkonin llogari nga unë! Nga ana e pushtetit me pat shpëtuar profesori, kurse nga ana e tanëve me pat shpëtuar njëri nga ndërmjetësuesit, i cili edhe sot vazhdon të njëjtën punë të fëlliqur, me mua të gjorin në mes! Pas luftës, për një kohë nuk m'u lajmëruan fare as profesori e as ndërmjetësuesi. E ndjeja veten të lumtur edhe pse fitimi ishte shumë më i vogël! Por një ditë, kur nuk e prisja fare, pasi ra zilja e telefonit, sa nuk me lëshuan këmbët kur nga ana tjetër me erdhi zëri i tij. Nuk kisha rrugë tjetër... bile as tani nuk kam rrugë tjetër... ai i di të gjitha! E di se unë ia kam qitë në pritë për t'i vrarë heronjtë më të mirë të shpallur sot, që dikur ishin armiqtë më të përbetuar të regjimit! E di se vajzat më të bukura

i kam filmuar dhe ia kam dhënë ato materiale atij për t'i përdorur pastaj për punët e tij të liga! Shumë nga ato të gjora kanë përfunduar tragjikisht! E di se shtëpia ime e pajisur me të gjitha aparatet më moderne për dhënie e marrje është strofull spiunësh që mbarë vendin e mbanë nën mbikëqyrje, e di se pjesa më e madhe e „hallexhinjve" që vijnë të unë, nuk janë gjë tjetër vetëm informatorë, ndërlidhës të fshehur, që nën petkun e një të varfri, apo të një qyqari vijnë këtu dhe sjellin informata, marrin pagesat në formë hajmalie dhe zhduken, pastaj vijnë ndërlidhësit dhe i marrin ato informata dhe treten sikur t'i ketë përpirë dheu!

Shtypja e ziles në derë sipas stilit të ndërlidhësit m'i ndërpreu mendimet. U ndjeva i shqetësuar sepse nuk i kisha përgatitur materialet që më parë, prandaj u hodha në këmbë i nevrikosur. Derisa po shkoja drejt derës, pashë gruan me kasetat e mbështjella në një shami që ia dha atij „varfanjakut syfryrë" që priste në prag të derës duke mos pushuar së thirruri: „Bëni me rahmet, o njerëz të mirë!" Pasi e mori shaminë dhe e futi në thes, nxori një pusullë dhe ia dha asaj duke thënë: „Allahu ju ndihmoftë... Allahu u dhashtë bereqet!... Allahu ua dhashtë të gjitha të mirat o njerëz të mirë!"... dhe për një copë herë qëndruan shtrëngueshëm në përqafimin e njëri tjetrit. Derisa po e pyesja veten së çfarë janë duke bërë ata kështu, u shkëputën nga përqafimi dhe gruaja fillojë t'i ngjiste me vrap shkallët! Kur mu afrua pranë, me një vështrim të ëmbël me tha:

– Të vërejta kur dremisje, prandaj të gjitha punët i kreva vetë... edhe kopjen e kasetave e ke këtu, edhe paratë, edhe mua... ha, ha, ha! – më tha duke u qeshur me të madhe

dhe ndërkohë më mbështolli në përqafim!

Vetëm tani e vërejta se të gjitha shqetësimet, të gjitha dyshimet e deritashme nuk kishin qenë gjë tjetër vetëm një makth, apo një ëndërr që më kishte mbërthyer derisa po dremisja! Ëndërr qofshin, edhe frika edhe dyshimi që kam! Amin!

INTERPRETIMI

Ku ishe more birë gjithë natën? – me pyeti nëna porsa hyra në shtëpi.

– Në xhami! – i thashë, – e fala sabahun! Pse çka ndodhur?

– Jo, jo! Asgjë nuk ka ndodhur, vetëm sa u merakosa për ty!

– Jo moj nënë, nuk ke pse merakosesh! Kështu e kanë punët e fesë... Ika unë.

– Ku po shkon tani? – me pyeti kureshtare.

– N'qytet! Kam pak punë! – i thashë duke i bërë me shenjë se e kisha ndërmend t'i ndërroja rrobat e përlloçura. Ajo e kuptoi dhe doli nga dhoma ime.

Këtë mot bora e parë kishte zënë shumë më herët se që pritej në të vërtetë, këtë ma tha nëna porsa arrita në shtëpi. Pas një acari të paparë, dukej sikur moti ishte zbutur pak. Dita ishte e vërejtur, dhe me shi të imtë. Pellgjet nëpër

rrugë ishin mbushur plot me sqotë e ujë të turbullt të rrahur nga rrotat e veturave që qarkullonin pa pra.

Rrugën deri të magjistralja e bëra me këmbë. Në stacionin e autobusëve kishte shumë njerëz. E ndjeja veten të vetmuar në mesin e tyre. Të gjithë ishin të një pamje tjetër, të një kulture tjetër, të një besimi tjetër, disi si të një populli tjetër... perëndimorë! Çudë, brenda katër vitesh të mungesës sime, sa kishin ndryshuar këta njerëz... apo mos vallë kam ndryshuar unë? Befas e pashë Hilin e Avdiut, njërin nga shokët e mi të pandarë të fëmijërisë. Kishte zënë vend pranë një vajze. Herë pas here i vidhja me bisht të syrit lëvizjet e tyre. Dukej se ishin të dashuruar... të lumtur... shumë të lumtur! Ndërkohë erdhi autobusi. U përqafuan shtrëngueshëm me njëri-tjetrin. Ajo filloi të qante! Pa dashur mu kujtua Fiti. Mu kujtua dita kur isha ndarë prej saj dhe bëra krahasime! Nuk ishte njësoj! Në të vërtetë vetëm lotët ishin njësoj, kurse sjelljet e tjera ishin krejt ndryshe! Edhe sot jam i lumtur për atëherë që e mbajta veten e nuk u mbusha haram! Më në fund ata u shkëputën nga përqafimi. Haram u qoftë, thashë me vete duke e ndrydhë dhunshëm atë zërin e brendshëm që si me lajka ngrinte krye e më thoshte: „Sa mirë! Lum si këta!...“ dhe zemra m'u dridh nga kënaqësia! Prapë u bëra për ujë... nuk u përmbajta dot! O Allah, bëma kabull, se pa dashje, syri im pa haram!

Hili hipi në autobus, kurse ajo vazhdoi të qëndronte në stacion duke i fshirë lotët me shami. Me qëllim mora pozicionin drejt saj, sa për t'i parë reagimet vijuese... edhe kështu e kisha humbur abdesin! Me bisht të syrit, krejt vjedhurazi e pashë. Ajo qëndroi në vend, duke e tundur dorën në shenjë lamtumire, derisa u zhduk prapa

kthese! Në brendi të autobusit u ndodha fare pranë Hilit. Së bashku ishim rritur e së bashku e kishin përfunduar medresenë! Pastaj na kishin ndarë hallet e jetës, dhe secili e kishte marrë rrugën e vet! E përshëndeta! I ndritën sytë kur me pa. M'u hodhe në përqafim duke me thënë se nuk të njoha... sa paske ndryshuar? Pastaj, kur e pa se unë nuk ia vara fort, me fjalë të ftohta me tregoi se ishte duke e përfunduar një kurs policie, kishte qenë i zënë me ushtrime të vazhdueshme, me studime, dhe se sot e kishte provimin e diplomës, prandaj edhe ndjehem si i hutuar, më tha pastaj... dhe kur nuk e prisja fare, më ftoi edhe mua që të regjistrohesha në të njëjtin kurs për gjeneratën e ardhshme! Nuk ka asgjë të keqe më tha, ti i plotëson të gjitha kushtet! Nuk e përcaktoja dot se a e kishte me gjithë mend kur më ftonte edhe mua të regjistrohesha në atë kurs, apo fliste si gjithmonë në atë stilin e tij të pa mbulesë prej llafazani! Sido që të jetë, mendova ndërkohë, nuk i ndërroj dot rrobat që i mbaj veshë me një palë kostume Parisi e jo më me një uniformë policie kaurë! Por atij nuk i thashë gjë, sepse deri në mbarimin e medresesë kishim qenë të pandarë. Edhe sot ushqej respekt për të! Duke bërë përpjekje ta ndërpriste bisedën sa më parë me mua, më tha: „Do të takohemi një ditë dhe do të pimë nga një kafe së bashku, atëherë do të sqaroj më hollësisht për përgatitjen e dokumenteve për aplikim!" Pastaj, sikur nuk i pritej të largohej nga unë, u bë sikur do ta takonte një të njohur prapa krahëve të tij! Pasi ma dha numrin e celularit, duke më përshëndetur përzemërsisht iku tutje! Në çast më erdhi një ndjenjë dhembshurie për të, por pas pak fillova të mendoj ndryshe. Të gjitha këto veprime i bëri duke më shikuar me një vështrim injoranti! Porsa

e ndjeva këtë në shpirt, ika tutje duke e përshëndetur me gjysmë zëri. Vërtetë, e ndjeva veten të fyer! Por nuk e fajësova atë! Isha i sigurt se këto veprime i bënte për shkak të syve kureshtarë që na shikonin pa pra. Pastaj, kush e di se si i dukej vetja në prag të bartjes së uniformës. Është mbushë haram! Do të pendohet, thashë me vete sa për ngushëllim.

Duke e vërvitë vështrimin përreth, në fundin e autobusit pashë Maksutin. Edhe pse ishte bërë tebdil me tërleme dhe mjekër të zezë e të gjatë, e njoha nga sytë e tij të fryrë. Si gjithmonë, i hutuar shikonte rreth e qark. U përpoqa t'ia bëj me shenjë që të shikonte nga unë por nuk qe e mundur. Si gjithmonë, edhe tani qenka i trullosur! I shkreti Maksut!

Që në ditët e para kur ia patëm filluar mësimeve në medrese, duke e parë se ai nuk e kishte fare mendjen të mësimet i pat thënë Hafiz Osmani disi si me ironi; „Urdhëro ti simpatik, na thuaj të lutem se ç'farë kemi mësuar orën e fundit?" Pastaj, ne nuk ia ndamë së thirruri në këtë epitet. Në fillim inatosej me atë që e thërriste kështu, por dalëngadalë filloi t'i hynte në qejf ky epitet, sepse vetja i dukej së vërtetë ishte simpatik! Edhe tani po me duket i vetmuar, i mjerë! Vetëm një gjë ia pëlqeva shumë. E kishte pranuar identitetin tim! Mu bë më i afërt dhe disi fillova ta dua edhe më shumë. Provova edhe njëherë t'ia tërhiqja vërejtjen të më shikonte, por nuk qe e mundur. Mu duk e largët koha derisa të zbrisnim nga autobusi dhe të përqafohesha me të, prandaj e mata me sy rrugën që duhej bërë deri të ai. Nuk ishte edhe aq e lehtë. Kishte shumë njerëz... burra, gra, vajza... që dhunshëm duhej të fërkohesha për trupat e tyre derisa të arrija të ai. Në fillim

mendova mos të lëvizja fare nga vendi derisa të zbrisja në qytet, por pastaj vendosa se nuk ishte aspak gjë e mençur të tregohesha qyqar para gjithë këtyre injorantëve. Dhe ashtu siç isha i mllefosur nga injoranca e tyre, mora drejt fundit të autobusit. Çava pa ua vënë veshin ankimeve të rastit, sharjeve pëshpëritëse që m'i zuri veshi, pa shikuar aspak se ku e veja këmbën, pa çarë kokën se mund të shkelja dhe ta lëndoja ndonjë kalama që nuk do ta vëreja me kohë, dhe, duke i shtyrë me urrejtje ata që më gjendshin në rrugë, arrita të mjekroshi im. Ai, pasi e kishte përcjellë me sy marshimin tim plot zemërim duke çarë përmes turmës, kishte vënë buzën në gaz! Kur u gjenda përballë tij, sa nga malli për të, sa për ta përligjë marshimin tim para injorantëve, e shtrëngova atë në përqafim sa mu bë se e teprova pak! Gjatë kohës sa ndodhesha në përqafimin e tij, prapa shpatullave të tij pashë motrën e tij të re që me shikonte me një palë sy pyetës. Ajo mbante të veshur mantelin e gjatë gjer në fundin e këmbëve dhe shami të zezë të mbështjellë rreth kokës sa mezi i dallohej fytyra. Për një çast, mbi fytyrën e saj, në mendjen time e skicova fytyrën e Fitit të mbështjellë më atë uniformë të zezë. Ja, thashë me vete i ngazëllyer, edhe Fiti do të dukej si kjo bukuri! Por, mos t'i hyjë në hak as kësaj, ishte bërë shumë e bukur! Sa do të mrekullohesha sikur shikimi im të ndeshej drejtpërsëdrejti mbi lëkurën e saj të butë, e jo mbi këto rroba të errëta e të vrazhda, më tha në çast ai zëri i brendshëm!

Ende pa e përfunduar përqafimin me të, që për një çast m'u bë se e teprova, ai foli me ton të ulët, duke më dhënë të kuptoja se donte të largohej nga përqafimi im:

– Kur u ktheve?

– Pardje! – i thashë me zë të ulët sa mu bë se ai nuk më

dëgjoi fare, prandaj me zë pak më të ngritur vazhdova:
– Po ju si jeni me shëndet?

– Mirë, El-hamdu li-l-lah, mirë! Po ti si kalove në ato vende të shenjta? – më pyeti duke më shikuar me ata sy të mëdhenj!

Mu bë se kishte ndryshuar. Sytë ju kishin fry edhe më shumë, kurse leshrat e mjekrës ia nxirrnin fytyrën e madhe që në çast mu bë se nuk i shkonte fare trupit të tij amorf!

E pashë se ai me dëshirë do të vazhdonte bisedën, por kur për të dytën herë më vërejti duke ia hedhur vështrimin motrës së tij që qëndronte në këmbë ngjitur prapa trupit të tij, sikur e humbi atë shkëlqimin fillestar dhe në fytyrën e tij u vizatua një vërejtje idhnake, sa që pata frikë se do të shpërthej me të gjitha fjalët e tij më të rënda kundër meje, që ia njihja nga fëmijëria. Pastaj me vështrim të ashpër, u kthye drejt saj, e cila me t'u ndeshur me vështrimin e tij, uli sytë poshtë! Vetëtimthi mendova se këta nuk ishin aspak besimtarë, dhe pa dashur mu kujtuan fjalët e Hafiz Osmanit kur i thoshte zotit Abu se ka njerëz që punojnë për para dhe famë e jo për etikë dhe besim. Edhe këta të dy të tillë duhet të jenë, që edhe veshjet i bartin për para, edhe në xhami shkojnë për para, edhe Allahut i lutën për para... për famë... kinse ne jemi mysliman të vërtetë! Allahu i marroftë!

– Është motra ime! – më tha duke më shikuar me inat. Për një çast më erdhi turp për ato që i mendova çaste më parë. Për të dalë nga situata, u bëra sikur nuk e vura re, dhe vazhdova t'i përgjigjem në pyetjen e mëparshme;

– Shumë mirë kam kaluar atje! Jam shumë i lumtur që pata rastin e mirë të studioj dhe të bëj hutbe me metodat

e reja të riteve në ato vende të shenjta! Po ti? – e pyeta pas pak; – ke ndonjë vend pune apo?...

– Çfarë pune ore? Po jetojmë sot për nesër.

– Megjithatë, me sa po shoh unë, qenke kthyer nga e mbara! Edhe kështu fiton diçka!

– Eh, lere mos pyet! Thotë një fjalë e urtë; për t'i fituar dy, duhet dhënë një! Kurse të ne është e kundërta; Për ta fituar një duhet dhënë dy! – tha duke më shikuar me një vështrim që shprehte padjallëzi!

– Përse e ke fjalën! – e pyeta pak i çuditur me filozofinë e tij!

– Po ja! – bëri me shenjë duke prekur mjekrën, pastaj xhaketën dhe në fund vështrimin e hodhi nga motra e tij që akoma mbante kokën ulur, sikur donte të thoshte: A s'po e sheh se ku jemi katandisur? Pastaj bëri edhe ca lëvizje duke pëshpëritë diçka të veshi motrës së tij që nuk ia shikoja dot më fytyrën dhe jo vetëm që nuk u afrua për ta vazhduar bisedën, por bëri sikur unë nuk ndodhesha fare pranë tij!

Gjatë gjithë rrugës nuk i foli dy fjalë me mua. Edhe ato që i tha pastaj, nuk kishin asgjë fisnike. Menjëherë e kuptova se edhe ky ishte një injorant nga ata që na rrethonin. Prandaj, as unë nuk e pashë të udhës të ndërmerrja biseda shtesë, sepse ngjasonte që përbrenda qenies së tij fshihte xhelozi... apo mos e dhashtë Allahu së mund të fshihej një urrejtje e papërmbajtur! Këtë e thoshin qartë shprehjet e syve të tij dinak, që shkëlqenin si dy thëngjij të ndezur në fytyrën e tij të madhe e plot lesh! Pak para se të zbrisnim nga autobusi mu afrua dhe ma zgjati një copë letër, duke më thënë;

– Ta përgatita numrin e celularit, dhe kur të keni kohë

më lajmëro dhe do të takohemi e të çmallemi... për sot më fal, por ashtu kam një punë!

– Mirë, mirë! Vërtetë më erdhi mirë që të takova! – i thashë, dhe pasi ia dhashë dorën u ndamë!

Porsa zbrita nga autobusi, kalova nëpër rrugicat e mbushura me sqotë, midis dyqaneve të mbushura përplot me gjithfarë mallrash dhe frutash, pranë disa teneqexhinjve dhe bri ndërtesës së vjetër të Qazim nallbanit që e lidhte rrugën me çarshinë e madhe ku të nxirrte pastaj të medreseja. Aty mora kthesën pranë lagjes së mekanikëve, ku si në verë ashtu edhe tani buzë dimrit, kundërmonte era e rëndë e vajrave dhe e katranit të djegur. Kur bëra të dilja në rrugicën e ngushtë që të shpinte të xhamia e Kajmekamit, kthesë që e bëra qëllimisht, pashë një grumbull policësh dhe disa ushtarë të huaj. Ata, porsa me panë, me thanë se duhej të kthehesha dhe të merrja një rrugë anësore që të shpinte drejt qendrës, sepse rruga ishte e zënë.

– Ç'farë ka ndodhur? – e pyeta njërin nga policët.

– Është çështje e jona! – mu përgjigj me zë të trashë dhe pas pak, kur e pa se unë nuk e kisha ndërmend të lëvizja nga vendi pa e parë se ç'kishte ndodhur, të paktën nga distanca, mu kthye me zë urdhërues: – Ç'më shikon ashtu si hut ë? Ec, shporru që këtej!

Ç'janë këto që po më ndodhin tani? – e pyeta veten pa mundur të gjeja përgjigje të saktë, edhe pse për të gjitha këto dyshova se duhet të jenë xhelozi kundër pastërtisë sime ndaj besimit! Jo, thashë! Janë pjesë e veprimeve të mia, të ndërlidhura me kumte që mi solli ëndrra! Këto po i mendoja me vete derisa isha duke ecur drejt sheshit të gjerë nga ku shiheshin ndërtesat e përfaqësive

diplomatike. Kur po kaloja fare pranë atyre ndërtesave, pashë me neveri dhe urrejtje të përmbajtur pllakatin me mbishkrim: U.S.A. „United States of America".

Eca skajit të rrugës duke ju shmangur gropave të mbushura me ujë, dhe pa dashur trupi me fërkohej pas mureve të shtëpive apo pas rrethojave të oborreve. Diku kah mesi i lagjes, kur rrugica merrte pak në të majtë, pashë shtëpinë tre kate të Magjistarit. Thuhej se ai ishte njeriu më i pasur, jo vetëm në lagjen e tij, por edhe në gjysmën e qytetit. Ai shkruante hajmali dhe veçmas teveleh për vajzat dhe nuset e reja që kishin për qëllim të ndikonin mbi burrat apo të dashurit e tyre, që t'i bënin të çmendeshin nga dashuria për to! Thuhej se disa herë ia kishin tërhequr vërejtjen të mos merrej me këto punë se bënte shirk, dhe mund ta pësonte keq, por ai kishte vazhduar me të tijën! Ishte fituar përshtypja se ai kishte mbrojtjen e dikujt, prandaj çdo kërcënim kundër tij mbetej vetëm kërcënim teorik dhe asgjë më tepër! Krahas këtyre ai merrej edhe me shërimin e të shituarve nga magjitë e zeza, dhe veçmas me zbërthimin e ëndrrave! Thuhej se ai ishte interpretuesi më i mirë i ëndrrave, dhe ky zanat e kishte ngritur nga një varfanjak pa shtëpi e katandi, në një pasanik të madh!

Qielli ishte i rënduar nga retë e zeza plumb. Me bëhej se ishte buzë mbrëmje e jo mëngjes. Një erë e ftohët m'u përplasë fytyrës duke sjellë vërdallë disa fjolla bore. Një veturë, duke lëvizur ngadalë, sa kaloi pellgun me ujë! Unë u mbështeta pas një muri për t'i hapur rrugë.

Pranë kangjellave të hekurt, ku ishte dera, pashë një pllakat alumini, me një mbishkrim. Me kureshtje u afrova më pranë dhe e lexova në heshtje: *„Pasi ta shtypsh*

butonin e ziles, mos e shty derën. Prit sa ta hapim ne! Ju faleminderit për mirëkuptim.“

E shtypa sustën dhe u mbështeta për murin rrethues, pranë derës së mbyllur. E ndjeve veten si të humbur, në pritje pranë një dere të huaj. Prapë në mendje mu fanit Fiti! U përpoqa ta parafytyroj të plotë fytyrën e saj. Në çast e ndjeva veten disi fajtor. Ai zëri i brendshëm disa herë me kishte trokitur në tru duke më hapur shumë mundësi që ta takoja dhe të çmallesha me të ashtu si gjithë njerëzia, por duke e cilësuar atë zë si thirrje djalli, nuk e përfillja, i sigurt së kështu po qëndroja pranë urdhrave të Allahut... dhe po largohesha nga pamja haram, nga mendimi haram, nga shkelja haram dhe nga prekja haram! Kështu, arrita që ta bëj të vuaj atë krijesë të mjerë! Në çast u ndjeva fajtor për vuajtjet e saj që po ia shkaktoja, por edhe krenar që pikërisht unë po e bëja të vuante nga dashuria për mua... në çast u ndie e vrazhdë zhurma e llozit elektrik. E shtyva derën dhe u gjenda brenda oborrit të mbushur përplot me pemë e qiparisa. Nuk e kisha vërejtur se kur kishte filluar të binte borë, por tani e pashë se pllakat e mermerit të shtruara në rrugicën që të shpinte drejtë hyrjes, sa kishin zënë një shtresë të hollë bore, ku dalloheshin gjurmët e disave që kishin hyrë në atë shtëpi kohë më parë! I ndoqa ato gjurmë, duke përshkuar përmes oborrit të heshtur, pranë lisave dekorues dhe barit të gjelbër që kishte filluar të zhdukej nën shtresën e hollë të borës që vazhdonte të binte.

Në korridor kishte shumë njerëz. Porsa u hap dera, ata kthyen kokën nga unë duke më shikuar si të kisha zbritur nga një botë tjetër. Me një vështrim i përlava të gjithë, duke kërkuar ndonjërin nga të mitë, por nuk pashë asnjë

të tillë. Zura vend në një stol druri pranë derës. Nga e majta sikur më erdhi një zë i trishtuar burri që thoshte:

– E kishin mbytur për gazep... e kishin shkallmuar!

– Nuk u mor vesh se kush?... – pyeti një burrë i imtë që kishte zënë vend pranë një gruaje të re.

– As unë se mora vesh! Vrasësi kishte ikur! – u përgjigj i pari.

– Nuk të pyeta se cili ishte vrasësi, por cili ishte i vrari? – pyeti prapë burri i imtë.

– Thanë se ishte Hafiz Osmani... Hafiz Hoxha!

– Hafiz Hoxha?! – e ndërpreu tjetri i çuditur.

Nuk e dëgjova më bisedën e tyre, edhe pse veshi mi zuri ca fjalë të shkoqura, ca ofshama dhembshurie, ca të shara kundër vrasësit, dhe ca komente rreth shkaqeve të mundshme të vrasjes, që dikush nga të pranishmit i quajti shkaqe politike, e dikush tjetër xhelozi! Cilësimi i fundit më pëlqeu më shumë, sepse motivi i vrasjes tërthorazi lidhej me imoralitet!

– Ishte njëri nga mësuesit më të zellshëm në medrese. – vazhdoj të fliste i pari. – Por, se ç'kishte ndodhur me shpirtin e tij kohëve të fundit nuk dihej. Thuhej se kishte qenë njeri me pasion të madh në trajtimin e vlerave të reja mbi këndimin dhe komentet pasuese të sureve të Kuranit. Gjatë gjithë kohës kishte qenë më i zëshmi në interpretimin e sureve gjatë përkthimit që i kishin bërë librit të shenjtë. Por, kur kishte ardhur puna e radhitjes së shkronjave, kishte qenë njëri më këmbëngulës që mos të përdorej stili arab i të shkruarit, stil që flitej së ishte i përkrahur hapur nga Imami e fshehurazi nga Myftiu! Edhe pse kishte qenë kundër këtij varianti, në fund ishte marrë vendimi që të dy palët të lëshonin nga pak

pé dhe të gjendet një mes kompromisi! Ata që kishin qenë këmbëngulës që radhitja e shkronjave të bëhet nga e djathta në të majtë, kishin hequr dorë duke pranuar vetëm trajtimin në radhitjen e faqeve dhe të shtyllave nga e djathta në të majtë, kurse këta që kishin qenë kundër që nga fillimi që shkronjat dhe teksti mos të shkruheshin me atë stil, por t'i përshtateshin rregullave drejtshkrimore të gjuhës, kishin lëshuar pé duke e pranuar variantin e trajtimit të faqeve dhe shtyllave nga e djathta në të majtë pa e cenuar radhitjen e shkronjave dhe të fjalëve nga e majta në të djathtë! Vetëm Hafizi nuk kishte pranuar as këtë variant duke thënë: Edhe kështu leximi i Kuranit është mjaft i komplikuar! Urdhëroni, bëjeni pa mua! I këtij mendimi nuk kishte qenë Imami, i cili kësaj ideje i kishte dhënë rëndësi të veçantë, sepse siç kishte thënë ai, gjuha jonë kishte filluar vonë të shkruhej me alfabetin kaur, prandaj pa ndonjë vështirësi mund të zëvendësohej, së pari vetëm stili i të shkruarit nga e djathta në të majtë me shkronja kaure, e pastaj kur të merrte një zgjerim të kënaqshëm të bëhej edhe ndërrimi, nga shkronjat kaure në shkronja të shenjta të Allahut! Kjo, së pari duhej të pranohej nga besimtaret islam e pastaj të merrte zgjerim në mbarë trevat ku jeton populli ynë. Në fillim do të dukej gjë e pamundur për lexuesin, por shpejtë jo vetëm që do të mësoheshin me këtë stil të shkruarit dhe të lexuarit, por do të vazhdonin edhe me botime!...

Derisa po e dëgjoja të panjohurin të fliste, mu kujtua koha e shkuar kur për herë të parë pata dëgjuar për këtë stil të të shkruarit. Atëherë, nga çudia në kokën time e pata skicuar se si do të dukej ky lloj shkrimi? Si do të lexohej? A do të krijonte vështirësi? A do të ishte vështirë të mësohej

me këtë lloj shkrimi sepse shkronjat duhej radhitur nga e djathta në të majtë plotësisht në formën që kanë? Në fillim e bëra një provë. Vërtetë më erdhi vështirë t'i shkoqisja dhe t'i shkruaja në letër. Pastaj duke e ushtruar dorën arrita ta formulojë një tekst të tërë. Dhe në fund, pasi ia kisha marrë dorën bukur mirë, e shkrova me miniaturë stilistike titullin e Kuranit ashtu siç e kishin botuar ata në kapakët e Mus'Hafit, por me radhitje shkronjash kaure nga e djathta në të majtë!

i-na'ruK
epiqsh nëhugj ën mitnemok em mithkrëP

Nuk kishte qenë aspak e vështirë. Sikurse lexoheshin nga e majta në të djathtë, me të njëjtin stil mund të lexoheshin edhe nga e djathta në të majtë. Nuk ishte ndonjë gjë e madhe, por atëherë, për fat të keq nuk ishte pranuar ky stil që më kishte fascinuar. Duket se as pas kërkesës që ishte bërë së fundi nuk do të pranohej ky lloj stili i të shkruarit, edhe pse unë i pata propozuar Imamit që botimi të vihej në aktin e kryer dhe pastaj, incidenti do të kalohej lehtë, bile edhe më lehtë se botimi i parë kur në mesin e besimtarëve do të vërshonin falas disa miliona Kuranë të tillë! Po përzihesh në punët e huaja, me pat thënë me përbuzje mësuesi Hafiz. Sa të fyer e pata ndier veten atëherë!

Derisa isha duke menduar se duhej të prisja gjatë radhën, dera u hap, dhe në prag u shfaq një grua. Pasi i shikoi të gjithë me radhë, vështrimin e ndali tek unë, duke e shoqëruar me lëvizje dore.

– Ti, eja! – tha duke më shikuar ngultas në sy, gjë që i

kisha shumë mërzi shikimet e tilla!

E ndoqa pas. Pasi kaluam një korridor të ngushtë, u gjendëm në një dhomë të madhe, por të mbushur me tryeza të gjata dhe mbi to plot libra dhe letra të ndryshme. Në fillim nuk vërejta, por më pas, pashë se në mesin e tyre mu shfaq papritur pamja e Magjistarit. Pa luajtur nga vendi, e zgjati dorën duke më bërë shenjë të ulesha në një karrige përballë tij. Sytë i shndritën nga një buzëqeshje e pahir, duke i nxjerrë jashtë dhëmbët e tij të veshur me ar. Pasi e ndreqi shaminë që e mbante të lidhur në kokë sikur të ishte grua, me pyeti:

– Ju, për ëndrrën keni ardhur?

– Po! – i thashë i çuditur. Ku e di ky se përse kam ardhur këtu?

– Sonte nuk ke parë ëndërr? – me pyeti duke me shikuar zhbirueshëm në sy. E ula vështrimin, se e kam mërzi të më shikon dikush ashtu!

– Jo! – u përgjigja i trembur, kurse me vete thashë: „Ku sheh njeriu ëndërr pa fjetur?“

– Domethënë, është vetëm ajo e një nate më parë?

– Po! Vetëm ajo! Nuk kam parë tjetër ëndërr! – u përgjigja kësaj radhe pak i çliruar.

– Mirë! – tha duke lëvizur pak nga vendi, dhe vazhdoi: – fillojmë! Ju keni parë në ëndërr qiellin e zi sterrë, pa yje?

– Po! – u përgjigja shkurt, i befasuar tej mase, dhe e pyeta veten: „Ku e di ky se çfarë kam parë në ëndërr?“

– Keni parë dritë të fortë të dalë nga varret? – me pyeti prapë, duke i nxjerrë prapë dhëmbët e tij të artë!

– Po. – U përgjigja i hutuar dhe me sy të zgurdulluar, por ai nuk ma vuri veshin fare. Vetëm tani e vërejta se ai po merrte shënime.

– Qiellin në formë kupole të ngushtë?
– Po!
– Një kalorës mesjetar të armatosur, a është kështu?
– Po!
– Burrë, apo princ me veshje të moçme orientale?
– Po!
– Meleqe?
– Po!
– Një korb të përzier me dritën?
– Po!
– Dhe në fund krrokëritjen e korbit?
– ... e përzier me krrokëritje mëllenjash! – shtova unë i kënaqur sepse një insert të ëndrrës nuk e tha ai!
– E kam parasysh edhe këtë! – mu përgjigj duke me shikuar ngultas, sikur donte të me thoshte; e di, e di!, dhe vazhdoi: – Mirë! Tani do ta interpretojë me radhë duke ia nisë nga e para. Për kumtin, të mirat apo të ligat që i mbartë interpretimi i ëndrrës suaj, unë nuk marrë përgjegjësi! Qartë?
– Ë?... – ia bëra unë pa e pasur të qartë se çfarë kërkonte nga unë!
– Nëse nuk më ngarkon mua me përgjegjësi, mund t'ia fillojmë interpretimit, në të kundërtën, jam i shtrënguar ta ndërpres menjëherë! – më tha me zë të qetë, por të vendosur.
– Jo, jo! Kurrsesi nuk do të ngarkoj me përgjegjësi! Dua që të vazhdosh me çdo kusht interpretimin! – ia ktheva disi i mundur nga kureshtja që më brente për të dëgjuar më shkoqur ato kumte të ëndrrës të interpretuara me mjeshtri të hollë prej tij!
– Së pari duhet ta bësh pagesën! Nëse nuk ndahesh i

kënaqur me interpretimin tim, do ta kthej në para vetëm pjesën e pakënaqësisë! Pajtohesh? – më pyeti me dorë të zgjatur.

– Pajtohem! – ia ktheva shkurt duke i nxjerrë paratë nga xhepi.

Ia lëshova në dorë një bankënotë, duke shpresuar se do të jetë i kënaqur, por ai as që e lëvizi dorën nga vendi. E kuptova. Ishin pak. Atëherë ia zgjata edhe dy bankënota! I pranoi, por e vërejta se nuk ishte edhe aq i kënaqur. Vetëm sa e lëvizi pak dorën në shenjë pakënaqësie! Më mirë t'ia japi edhe dy sosh... mos të ndikojë negativ në interpretim, mendova kalimthi duke ia zgjatur edhe dy të tjera. Pasi i shikoi, sikur i ndriti fytyra, e tërhoqi dorën!

– Ëndrrat, dhe koha e ëndrrave... janë një botë në vete, janë botë fenomenale!... – filloi të fliste ngadalë Magjistari duke shikuar në një qitap të vjetër! – ...botë që i takon mbarë njerëzimit. Në atë çast kur njeriu bie në gjumë, kalon në një botë tjetër, apo thënë më mirë në një gjendje tjetër, me ligje tjera që nuk i nënshtrohen as mendjes, as logjikës së botës normale që e jetojmë, por i nënshtrohet një bote tjetër jashtëkohore, jashtë normalitetit dhe nuk është më i lidhur për botën materiale e konkrete, por shndërrohet në botën abstrakte dhe ligjeve të saj... pra ligjeve të misticizmit! Këto ndryshime janë dhuratë e Allahut xhel-le shanuhu, që i tregon njeriut që ndodhet në gjumë se ai, që nga ai moment transformohet në botën e vdekjes, në botën e pastajme duke i dërguar copëza paralajmërimesh se si do të duket ajo botë e përjetshme. Ato kumte që i shfaqen njeriut në gjumë, nuk janë gjë tjetër vetëm copëza realiteti që njeriu i pashpirt... dua të them; i vdekuri, do t'i përjeton në ahiret prandaj pasojnë

përsiatje, tinguj të ndryshëm, përfytyrime ogurzeza apo ogurbardha, vaje, buzëqeshje, gëzime, dashuri deri në orgazëm, luftëra, gjakderdhje e kështu me radhë, deri në atë moment që Allahu xhel-le shanuhu, t'ia kthej prapë shpirtin dhe njeriu të zgjohet nga gjumi i alarmuar, i gëzuar, i trishtuar apo thjeshtë, vetëm i ç'lodhur! Mirëpo, sa i besojnë njerëzia të gjitha këto kumte? – më pyeti befas!

Pas një heshtje të shkurtër e shkëputi vështrimin nga libri duke me shikuar ngultas në sy. Edhe pse e pata mërzi atë shikim, nuk i ika dot, bile nuk bëra asgjë t'i shmangesha. Prandaj vazhdova të shikoj pa nxjerrë zë! Pas një heshtje të shkurtër vazhdoi:

– Jo! Kaurët nuk i besojnë! Ata mendojnë se ëndrra është vend i përshtatshëm ku të pafetë e takojnë shejtanin dhe bëjnë dashuri me të, duke i hidhëruar jezuitët, të cilët nën kërcënimin e shpatës i detyrojnë t'i përshkruajnë xhindet dhe djajtë që i shohin në ëndrra, apo i trillojnë për t'ju shpëtuar torturave dhe pastaj dënohen si mëkatarë duke i djegur në turrë të druve! Pra, më këto që i thashë, kisha parasysh t'ju kujtoi edhe njëherë së parja e vërtetë e ëndrrës dhe shpikja e saj për qëllime të ndryshme nuk janë një lloj! Interpretimi i ëndrrës së vërtetë është i lehtë dhe i qartë, me kumte domethënëse, kurse interpretimi i ëndrrës së trilluar nxjerrë telashe dhe sjell kumte të gabuara, sjell intriga!

Për çudinë time, ai pushoi së foluri. Vështrimin e kishte vendosur mbi pamjen time, edhe pse e kisha shumë mërzi. E ndjeja se po më bezdiste, por nuk bëja dot gjë që t'i shmangesha! Sikur u lirova nga ai shikim kur e pashë se ai u ngrit në këmbë! Pas disa hapash që i bëri përreth tryezës së tij, prapë doli aty ku kishte qenë, pa ma

shkoqur vështrimin. Tamam kur isha duke menduar se duhej ndërmarrë diçka sa për t'ia bërë me dije se e kisha shumë mërzi që dikush të më shikonte ashtu, më pyeti:

– Si thua ti?

– Për çka e ke fjalën? – e pyeta pa kuptuar asgjë!

– Si për çka e kam fjalën? Për ëndrrën tuaj po flas! E ke parë vërtetë apo është trillim i mendjes tuaj!

– Çfarë trillimi ore hej?! E kam parë vërtetë! – u përgjigja disi i fyer!

Për një çast më bëri të dyshoja në vetvete!

– Mirë! Edhe unë jam i sigurt se ti vërtetë e ke parë këtë ëndërr! Mos ma merr inat se të pyeta. Kjo nuk ka asgjë me mosbesimin tim ndaj jush. Është pjesë e punës sime gjatë interpretimit!

– Aha!... – bëra duke e tundur kokën i lehtësuar.

– Janë dy gjëra kyçe që njeriu motivohet nga ëndrrat. E para është kur njeriu dëshiron të arrijë diçka, por rrethi nuk e kupton dëshirën e tij! Atëherë, sa për t'ua kujtuar u thotë se e pashë në ëndërr, për shembull; sikur bëja dashuri me filan vajzën. Gjatë komentimit të ëndrrës do të përhapën fjalët, se filan djali paska parë ëndërr se ka bërë dashuri me filan vajzën. Dalëngadalë, gjatë komentimit nga njerëz të ndryshëm e të pandërgjegjshëm do t'i hiqen fjalët „ka parë ëndërr" duke marrë kuptimin se filan djali ka bërë dashuri me filan vajzën!... dhe e dyta, nëse dëshironi të shpifni diçka kundër dikujt, atëherë do të thoni se pashë në ëndërr sikur filan Myftiu sorollatej rrugëve të qytetit i dehur... edhe në këtë rast ëndrra do të shpërndahet, në fillim e tillë, por pastaj do t'i hiqen fjalët: „ëndërr" dhe do të ngelët vetëm ajo kompromettuesja: Filan Myftiu sorollatej rrugëve të qytetit i dehur! Këto t'i

thashë sa për të kujtuar se ëndrra e juaj nuk i ka ngjyrat e tilla kompromettuese! Vazhdojmë! – tha pas pak sikur ishte duke folur me veten e tij, dhe njëherësh, qitapin e vjetër e afroi më pranë!

– Vazhdojmë! – ia ktheva unë duke e shikuar i çuditur nga lëvizjet e tij, si dhe nga disa lutje që i thoshte me zë pëshpërime që nuk po merrja vesh asgjë!

E para: Qielli pa yje, ka kuptimin e ndonjë kasaveti, ndonjë gajleje a pune që vetëm orientimin e di, por fillimin, rrjedhën dhe mbarimin nuk e ke të qartë! Këto nuk varen prej jush, por prej dikujt tjetër... e në rastin tënd prej dikujt që për ju është fare i panjohur!

E dyta: Drita nga varret: Paraqet zhgënjim, mashtrim, mosrealizim të planifikimeve e dëshirave tuaja!

E treta: Qielli i ngushtë në formë kupole, do të thotë grackë, qorrsokak, pa rrugëdalje, mbërthim!

E katërta: Kalorësi: Jeni i plotfuqishëm, lojal dhe në kërkim të trimërive tuaja që nuk të mungojnë, por që akoma nuk i di se ku i ke të fshehura dhe në cilin segment do t'i shfrytëzosh, dhe ndërkohë, do të jesh i tradhtuar dhe i zhgënjyer nga njëri më besnikët tuaj!

E pesta: Burrë, apo princ me veshje të moçme orientale, Simbolizon sigurinë dhe besimin tuaj ndaj të tjerëve, principet dhe vendosmërinë tuaj ndaj asaj që i beson dhe i falësh, dhe si kundërshpërblim për të gjitha mundimet tuaja, e ke jetën e pasigurt, në varfëri dhe në rrezik permanent!

E gjashta: meleqet, paralajmërim për kthim në rrugën e drejtë!

E shtata: Korbi i përzier me dritë, do të thotë; edhe pse je shumë i aftë, nuk e arrin dot qëllimin, dhe...

E teta: krrokëritja e korbit e përzier me krrokëritjen e mëllenjave nënkupton; Tërheqja e fundit e vërejtjes para vdekjes!

Magjistari, për një copë herë pushoi. Sytë nuk i shqiste nga qitapi i vjetër, dhe me zë pëshpërime bënte dua! Duart i mbante të ngritura lartë, dhe duke e luhatë lehtë kokën sa majtas sa djathtas, me zë të ngritur ra shahadet! „Bismil-lahir Rrahmanir-rrahim!“ dhe fill pas u ngrit në këmbë, me duart dhe kokën kthyer drejtë tavanit thirri me zë të lartë:

– Lailahuilallah! Lailahuilallah! Lailahuilallah! – dhe vazhdoi me zë të ulët lutjet e radhës.

Ndodhesha në një situatë të vështirë. Nuk dija se ç'farë duhej bërë! Duhej të ngritsha në këmbë dhe të lutsha bashkë me të, apo të qëndroja derisa t'i përfundonte lutjet. Vendosa se gjithsesi ishte më mirë të prisja, dhe ashtu doli. Pas pak, ai u qetësua dhe u ulë në fronin e tij. Duke më shikuar me ata sy të zjarrtë! Pas pak mu drejtua:

– Ëndrra e juaj nuk sjell kumte të mira! Janë të ngatërruar disa kumte që në vete ngërthejnë intriga ku ti do të jesh pjesë e tyre dhe njëherësh, pré e tyre! Unë e luta Allahun që të mbrojë nga çdo e ligë që do ta mendon dikush ty, dhe nga çdo e ligë që ti ia mendon ti dikujt tjetër! Qofsh nën mëshirën e Allahut! Amin! Mund të shkosh! – më tha në fund.

Pasi u ngrita në këmbë, dhe u bëra gati të dal, vendosa t'ia shtroi edhe pyetjen time të fundit dhe t'ia shpreh hapur dyshimin që me brente;

– Dua t'ju pyes edhe diçka?

– Fol pa ndrojtje biri im?... thuaje çfarë të mundon? – ma ktheu me zë të ëmbël.

– Kush ta tregoi ëndrrën time?

– Meleqet biri im! Meleqet! Askush tjetër! Allahu qoftë me ty! Allahu ta ndriçoftë rrugën! Allahu të shpëtoftë nga intrigat që ti po ia kurdisë dikujt tjetër dhe nga intrigat që të tjerët po t'i kurdisin ty! Amin! – më tha në fund duke më dhënë të kuptoja se kishte mbaruar punë me mua, dhe duhej të dilja.

Trokita në derë, tak-tak! Doli magjistrica. Ishte një grua e trashë, topolake. Çapitej ngadalë-ngadalë si shotë! Kishte një vështrim ca të rënduar por tërheqës. E shikova më thellë! Buzëqeshi këndshëm.

Në dhomën gjysmë të errët m'u shfaq magjistari. Së pari kërkoi paratë. Ia dhashë. Derisa ma mbante dorën time në mesin e duarve të tij të buta, me një buzëqeshje të mugët nën shkëlqimin dhëmbëve të artë, më tha:

– Me emrin e Allahut të Madhërishëm, Mëshirëplotit! Së shpejti do ta mësosh të vërtetën... por mos u dëshpëro, sepse magjia ime, rastësisht, mund të ndikojë në një rast të dytë... aty ku Allahu i Madhërishëm paraprakisht ta ka shkruar nafakën!

Pasuan disa pëshpërima të radhës. U përqendrova t'i kuptoj ato fjalë interesante, por nuk mora vesh asgjë! Mjafton që këto fjalë lutëse t'i kuptojë i Madhërishmi dhe të m'i plotësojë dëshirat! Mjafton!

– Allahu do t'i plotësojë të gjitha dëshirat në bazë të riskut të caktuar prej Tij! Amin! Mund të shkosh tani! – Më tha pastaj, duke me shikuar me të njëjtën buzëqeshje.

Me përcolli magjistrica. Prapë vështrimi tërheqës dhe buzëqeshja e këndshme e përcjellë me fjalët pëshpërimë:

– Pas dy javësh eja prapë!

Tha, apo nuk tha magjistari që pas dy javësh të paraqitesha prapë, kurrë nuk e mora vesh!

VRASËSI

Kuk ka kaluar më shumë se një çerek nga koha kur e shtriva përdhé atë mendjemadh! Jam mbushur frymë nga vrapi që e mora për tu larguar sa më shpejt nga vendi i krimit. Tani ndodhëm në rrugët e qytetit. I vetmuar, po kaloj ballëlartë sikur gjithë të tjerët. Përballë mu shfaq pirgu i lartë i Sahat-Kullës që ndodhët përballë Xhamisë së Madhe. Dalëngadalë po i afrohem ish kantinës së dikurshme të mejtepit që akoma po e quajnë me emrin e moçëm: Mejhane! Vend ideal për t'u freskuar pak me pije të vjetra të orientit... pastaj, le të më shohin këta fraunë, duke qenë i sigurt se asnjëri nga këta nuk mund të ma lexoj fytyrën time hipokrite, prandaj me lehtësi dhe bindshëm do ta parapërgatiti alibinë!

Në kohëra të vjetra mejhania i kishte takuar mejtepit. Ishte përdorë si konvikt nxënësish të medresesë. Pas luftës së dytë botërore komunistët e kishin shndërruar në

kafene dhe një pjesë të dhomave të saj i kishin përdorur për strehimin e zyrtarëve komunistë. Pak më vonë e kishte humbur këtë rol duke e shndërruar në depo mallrash kurse dhomat e saj në zyre kooperativash. Rreth viteve të shtatëdhjeta ishte dhënë me qira dhe kishte marrë formën që e ka sot. Mejhanexhiu në fillim kishte përgatitur vetëm ushqime e pije freskuese orientale, zakon i trashëguar nga familja e tij dhe i kërkuar nga nxënësit e medresesë. Për t'i shpëtuar falimentimit, pronari i saj ishte shtrënguar të pranojë edhe pije të tjera alkoolike si dhe herë pas here t'i lëshojë me qira dhomat e saj, jo vetëm për nxënësit e medresesë por edhe për studentë dhe klientë të tjerë. E vetmja gjë që nuk kishte ndryshuar asnjëherë ishte emri i saj: Mejhane.

Mejhanexhiu, porsa me pa, doli nga banaku dhe me përqafoi gëzueshëm! Njiheshim që nga koha kur isha nxënës i medresesë. Isha myshteri i rregullt i tij.

– Ku je more djalë, ka kohë që nuk të kam parë, u trete sikur të kishte përbirë dheu... eu, po shumë qenke mbushë frymë!? – me bombardoi me ato pyetjet e tij budallaqe që nuk më jepte kohë as t'i përgjigjesha!

Edhe ky është një budalla mendjemadh, i rangut të atij që sapo e shtriva përdhé, mendova derisa isha duke u afruar pranë kërrigës për t'u ulur!

– Pas autobusit vrapova! – thashë me zë të ulët, dhe vazhdova me ton pakë të ngritur – por qe do, nuk e zura se nuk e zura dot!

Vërtetë, kjo sjellje e imja pati sukses, sepse pjesa më e madhe e atyre që me rrethonin u kthyen drejtë meje duke më vështruar me ato shikimet e tyre naive e pyetëse njëherësh!

– Do të pish diçka? – më pyeti pasi i kishte bërë një shërbim një qifti të ri që kishin zënë vend prapa derës!

– Salep. – ia ktheva duke i shikuar të pranishmit me radhë me atë buzëqeshjen time dashamirëse që vetëm unë di ta krijoi jo sipas qejfit që e ndjej, por sipas situatës që me krijohet! Pastaj ula vështrimin mbi një gazetë që e kishte lënë dikush mbi tryezë, dhe bëra sikur po lexoja pa e pasur fare mendjen aty.

Kjo nuk është vrasja e parë që e bëra! Të gjithë të tjerët që i kam vrarë deri me tani, përveç Ismajlit mendjemadh, kanë qenë të panjohur. Fytyrat e tyre i kam takuar vetëm dy herë në jetë. Një herë para vrasjes, dhe herën tjetër pas përpëlitjeve të fundit të jetës! Prandaj nuk i mbaj mend!

Ka kohë që e kam ndërprerë numërimin e vrasjeve, dhe këtë, për shkak se pata dëgjuar se një mëkat janë vrasjet, e dy mëkate numërimi i tyre! Por nuk është aspak e vërtetë se bëj gjynah. Sa për gjynah, do t'i numëroja gjithë ditën, por ishte diçka krejt tjetër që më detyroi ta ndërpresë numërimin! Sa herë që i numëroja, pa dashur isha i detyruar t'i kujtoja përpëlitjet e fundit në të gjallë, dhe qetësisë fillestare pas vdekjes, të atyre që i dërgoja tek të shumtit atje në botën tjetër. Këto pamje më mundonin shumë, sidomos përpëlitjet e fundit, që nuk i shqisja dot nga mendja, sepse më bëhej sikur shpirti nuk po u dilte atyre por mua!...

Si çdo profesion që njeriu e mëson dhe ia përshtatë qenies së tij, ashtu edhe vrasjet mësohen dhe përshtatën duke filluar nga teoritë paraprake, e deri në realizimin praktik. Pak vështirë është ta bësh vrasjen e parë, sepse ke dilema, të mungon përvoja, stili, dhembja për viktimën, mënyra e goditjes, emocionet e përziera me një lloj frike

të pa përjetuar më parë... disi të ngjashme si të vajzave të reja gjatë kohës së humbjes së virgjërisë! Pastaj mësohesh me to dhe të duket sikur je duke e kryer profesionin tuaj por... edhe nuk mund të rrish pa vrarë, sepse shpirti nuk të qetësohet, vazhdimisht e kërkon një kënaqësi të tillë sado e shëmtuar që do t'ju duket të tjerëve!

Vrasjen e parë nuk e kam kryer vetë, por e kam parë dike tjetër duke e ekzekutuar! Ishte shumë e thjeshtë! Nuk nevojitej shumë kohë, një sekondë, të shumtën dy, dhe çdo gjë do të qetësohet. Kjo ndodhë vetëm në rastet e ekzekutimeve, kurse rastet e shpimeve, prerjeve të kokave, apo mbytjet me dajak kërkojnë qasje dhe metoda tjera!

Me rastin e vrasjes së parë, duke i kujtuar ato skena që i kisha parë dikur, bëra vetëm imitimin, pa menduar se po bëja vrasje, dhe rezultati nuk mungoi. Para këmbëve të mia pashë të shtrirë një trup njeriu të ç'shpirtëzuar nga duart e mia. Ndaj, kjo vrasje që e kam bërë dikur sa vjen e me ç'trajtësohet duke u fanitur nga mendja ime si dritëhijet e një shpendi që tretet në horizont! Por, vrasjen që e kam parë duke e realizuar dikush tjetër, e mbaj të kthjellët në kujtesë. Nuk e shqis dot nga mendja dhe... çdo herë kur yshtem nga djajtë ta vras dike, ajo skenë më rikthehet duke pulsuar valëvitshëm në mendjen time të rënduar dhe dalëngadalë më motivon deri në shtytje të veprimeve konkrete!

Çdo vrasje që bëhet, është e prirë nga një shtytje paraprake! Të them të drejtën unë nuk kam pasur arsye të forta ta vras dike! Asnjëherë nuk më ka ndodhur që dikush të më shtyj në ndonjë tronditje për të reaguar ashpër kundër tij, apo gjatë një sulmi të beftë nga dikush për të qenë i shtrënguar të përdori forcën e tepruar për ta

mbrojtur veten!... ah po, tani sa m'u kujtua së vetëm një herë më ka rastisë të jem i shtrënguar ta godas tinëzisht Hilin, atë mendjemadh që nuk është hiç më i mirë së ky që sapo e shtriva përdhé... por atëherë, pasi më mungonte strategjia e goditjeve vdekjeprurëse më shpëtoi vetëm me disa plagë në kokë! Shyqyr që nuk e di që e kam goditur unë, sepse ai inatçi dinak, do të hakmerrej ashpër kundër meje. E gjithë kjo kishte ndodhur pas një sulmi të tij të hakërryer e plot zemërim kundër meje! Sa mirë isha gjendur në atë kohë! Në vend të zemërimit nga sharjet dhe goditjet e tij vetëm isha gajasur por pastaj, në errësirë të plotë, nga prita e pata sulmuar, por... ah, më shpëtoi për pak! Edhe sot e kësaj dite nuk po gjej qetësi... disi ia kam frikën atij qeni të pabesë! Kam parandjenja që po i afrohet radha, sikurse edhe disa të tjerëve, t'i këndoj shpirtit të tij rahmet!

Të gjitha vrasjet e plagosjet tinëzare i kam bërë me paramendim, planifikim dhe gjakftohtësi profesionale. Përzgjedhja e viktimës, sipas nevojës e rastit, herë është përzgjedhur nga unë, e herë me porosi... me porosi të profesorit... ja si kjo e tanishmja! Pra, me një fjalë, i yshtur nga idealet e mia, dhe nga këshillat e miqve të mi, e veçmas nga ata që me paguajnë, kam vrarë dhe kam zbatuar urdhra! Gati të gjitha viktimat e mia kanë qenë njerëz të thjeshtë, por, ka pasur në mesin e tyre edhe me ngritje të lartë që i kanë shkel disa rregulla, që i kanë kaluar disa kufij, që e kanë lënë rrugën e Allahut, apo që kanë bërë dashuri të ndaluara! Shumë herë më është thënë se njerëz të pafajshëm nuk duhet të vriten. Këto thënie janë të shkruara edhe në Kuran, në suren Israë, ku thuhet se Allahu e ndalon vrasjen e njeriut pa

pasur ndonjë shkak të fortë! As idhujtarët më të mëdhenj nuk duhet të vriten, sepse ata për gabimet e tyre do të përgjigjën para Allahut ditën e gjykimit. Por unë i kam vrarë shumë sish! I kam vrarë se kam pasur arsye shumë të forta... sepse të gjithë ishin nga ato krijesa që Allahu kishte hequr dorë me kohë prej tyre, dhe vrasja ishte plotësisht e arsyeshme. Prandaj, unë nuk pendohem! Nuk pendohem dhe nuk i trembem askujt, as ligjeve e dënimeve që mund të më japin njerëzit në këtë botë, sado të rënda qofshin ato! Nuk pendohem sepse jam i sigurt se gjysma e fajit i shkon Kabilit![43] Frikë, gjunjëzim dhe pendim ndjej vetëm para Allahut të Madhërishëm, por... edhe Allahu, pasi ka heqë dorë me kohë nga ata mjeranë, do të ma falë gjysmën tjetër të fajit, sepse Ai është që shumë falë, është mëshirues!

Ka raste sikur gjërat po ndryshojnë kur po i mendoi gajb-at.[44] Pa dashur po me futet një frikë tinëzare në shpirt, dhe po mbushëm me pezëm. Në suren Furkanë, thuhet se në atë botë, ditën e gjykimit vrasësit do të ndëshkohen shumë më rëndë se kriminelet e tjerë! Edhe unë do të jem njëri ndër të gjykuarit e tillë, dhe në çast para syve me feksën ato flakët e ashpra të xhehenemit të përziera me tortura të rënda të djajve, me katran të djegur e gumëzhitje vargonjsh që pasohen me vërshëllima kamxhiku e uturima dhembjesh... Përderisa i mendoj këto, filloj të dyshoj në kam bërë ndonjëherë vrasje. Sa më shumë të mendoj, aq më shumë me mbushët mendja se unë, kurrë në jetën time nuk kam bërë ndonjë vrasje.

---

43 Djali i Adamit, i cili ishte i pari që e kishte praktikuar vrasjen

44 Arab, çdo gjë që nuk arrihet me anë të shqisave, siç janë; Allahu, meleqet, shejtani, ringjallja, xheneti, xhehenemi etj.

Në suren Enfal shkruan: „*Ju nuk i mbytët (në të vërtetë) ata, por Allahu (me ndihmën që ua dha) i mbyti ata...*“ pra, sipas kësaj thënie, unë po dal duarlarë!... me ndihmën që ma dha Allahu, Ai i ka vrarë ata! Prandaj, këto që me vërvitën në mendje nuk janë gjë tjetër vetëm fanitet trishtues nga ndonjë skenë filmi, nga ndonjë bisedë apo nga ndonjë lajm i marrë nga ndonjë mik apo i lexuar në gazetë! Me mjeshtri të hollë i sistemoj vrasjet, duke i sajuar njërën pas tjetrës ashtu siç janë kryer, se në cilët filma i kam parë ato skena të tmerrshme, ato vrasje makabre, ato krime të trishta që më mbushin me frikë dhe nuk më zë gjumi gjithë natën, sepse më behët se vrasësi i tmerrshëm, që në këtë rast jam unë, më pret i fshehur në errësirën e natës diku prapa derës për të më vrarë... Edhe gjatë procesit të ç'jetëzimit, e paramendoj veten se nuk ndodhem në realitet por në abstraktim të plotë, në një gjendje jashtëkohore, në një hapësirë të pa trajtë ku në arenën e errtë dhe të rrethuar nga qindra e mijëra spektatorë, zhvillohen duelet e përgjakshme për jetë a vdekje... ndërsa shikuesit me zemër të ngrirë nga frika, me sy të zgurdulluar nga tmerri i shohin goditjet, i dëgjojnë britmat e llahtarshme, rënkimet nga dhembjet dhe ngjyrën e kuqe që del nga trupi i porsa vrarë... të tmerruar lëshojnë zëra të lemerishëm, mbahen pas njëri-tjetrit derisa djersët ju rrokullisën pikë-pikë tatëpjetë ballit... ndërsa unë, pasi e ndjej aromën e gjakut të derdhur, hidhem tutje dhe me vrap dal nga skena... derisa largohem vetëtimthi për zhdukjen e gjurmëve, me bëhet se nga prapa shpine me përcjellin brohoritjet euforike e plot ngazëllim të miqve e dashamirëve të artit tim vrastar!

Por... realiteti është krejt ndryshe. Është vështirë të

mësohesh dhe të pajtohesh me vrasjet. Edhe kur rri në dhomë, në shoqëri, në mesin e gazmendit kur të tjerët dëfrehen, këndojnë dhe kërcejnë, e ndjej veten të tërhequr. Ata më ftojnë që edhe unë të jem pjesë e gëzimit të tyre, por mua nuk me lejojnë ta shijoj gëzimin e harenë shpirtrat e atyre që në vendin e Azrailit i kam marrë dhe i kam degdisur në qiell pa urdhrin... më falni, me urdhrin e të madhit Allah... apo, gjithsesi në emër të Tij... ndaj, shpirti im nuk gjënë qetësi! Kudo që ndodhëm më ndjek angështimi! Dua t'ju largohem përfytyrimeve të ankthshme, perceptimeve të frikshme dhe bëjë lëvizje nga një vend në tjetrin, tërhiqem nga leximi dhe fshehurazi dëgjoj muzikë, nga heshtja në bisedë, nga vetmia në shoqëri, nga përmallimi në gajasje të shfrenuara sa që behëm i mërzitshëm për të tjerët, të cilët me shikojnë me sy të keq! Kur arrij në këtë pikë, i mërzitur dhe i zhgënjyer, dal në rrugë dhe bredhi sa poshtë lartë pa ndonjë cak, duke i vështruar fytyrat e njerëzve të turmës dhe bëj krahasime, nuhas. Të gjithë ata që nuk kanë kryer ndonjë vrasje në jetën e tyre duken fytyrë shkretë, mjeranë e naiv bashkë, por gjithsesi shpirtbardhë, kurse vrasësit dhe kriminelët e kamufluar në mesin e turmës i dalloi menjëherë. Nuk me nevojiten dy vështrime mbi fytyrat e tyre për t'ua hetuar reflektimin e rrezatimit djallëzor të dalë nga shpirti i tyre mëkatarë, e të shprehura përmes fytyrës dhe syve të tyre dinak!

Tani jam i vetëdijshëm dhe e ndjej se nuk e dua askënd, nuk i besoj askujt, nuk më tërheqë askush dhe asgjë dhe nuk me dhimbset askush... as vetja ime! Prandaj, edhe kur fle, njërin sy e mbajë të hapur, njërin vesh pipëz, njërën këmbë pranë këpucës dhe njërën dorë te thika!

Nuk e kam vërejtur se kur kam pirë salepin, por kur desha ta ngre gotën, pashë se ishte bosh. Hodha vështrimin rreth e rrotull, pastaj thirra mejhanexhiun. Pasi ia bëra pagesën, u përshëndeta me të dhe dola! Vetëm tani e pashë se kishte kaluar më shumë se një orë, sa kisha qëndruar ulur duke e shfletuar gazetën!

Tani gjendëm në mesin e turmës së njerëzve që shëtisin në sheshin e gjerë nën dritat e neonit. Është traditë e moçme e këtij qyteti të lashtë. Por, nga frika se në mesin e tyre ka kriminel të rangut tim, që vetëm ata dinë t'i lexojnë mendimet që më gëlojnë në mendje, e që shprehen përmes pamjes së jashtme të fytyrës sime, dhunshëm jam i shtrënguar t'i ndërroj mendimet që nuri i fytyrës mos t'i shpreh rrezet e krimit por t'i shpreh rrezet e dashurisë, të zemërmirësisë apo të naivitetit! Kjo është gjëja më e vështirë që duhet të përballëm çdo ditë, kudo dhe sido që të ndodhem! Kam përshtypjen se më vështirë e kam ta fsheh një vrasje, se t'i kryej dhjetë sosh. Përfytyrimet më kanë munduar edhe herë të tjera, e veçmas në rini të hershme, por jo në lidhje me vrasjet, por në lidhje me seksin. Kjo puna e vrasjeve ka filluar të më shfaqet vonë, pasi kam filluar të merrem me to, dhe shpejt e gjeta çelësin e maskimit të tyre, kurse këtë të seksit më duket më vështirë ta maskoj, sepse më është shfaqur shumë më herët, në rrethana krejt tjera dhe zgjatet e stërzgjatet në vazhdimësi të pandërprerë! Në fillim më ishte shfaqur para se ta kisha provuar ndjenjën e seksit. Përfytyrimet e vajzave lakuriqe, më ndodhnin herë pas here dhe vend e pavend! Më së tepërmi më mundonte kur më shfaqeshin pasi lidhesha namaz. Pasi më futeshin në mendje ato përfytyrime erotike, nuk i ndalja dot derisa e ndjeja atë

sendin që më rritej prore brenda pantallonave, dhe nga turpi e frika bashkë, se mos m'i lexonin mendimet të tjerët rreth meje, përpiqesha dhunshëm t'i ndërpres! Edhe tani në mesin e kësaj turme të stërmadhe që shëtisin të patrazuar, në mesin e vashave të reja dhe fytyrëzbuluara, mendjen e hoqa krejtësisht nga vrasjet... por edhe nga urdhrat e Pejgamberit selamu alejkum, këtë të fundit e thashë me gjysmë zëri nga frika se më dëgjon dhe më ndëshkon i Madhërishmi... kurse shikimin e drejtova andej nga i përshtatej syrit tim të uritur!

Pasi u shkriva në mesin e gjithë asaj turme, krejt mendimet ia përshtata seksit. Kjo sa më imponohej nga pamjet e vashave të bukura që me kalonin pranë sa gati fërkoheshin me mua, sa nga aroma e këndshme e parfumeve dhe nga gjysmë lakuriqësia e tyre, e veçmas nga epshi që më rëndon! Pikërisht këtu është vendi që mund të ngopem se shikuari vasha të bukura të të gjitha moshave dhe me veshje gjysmëlakuriqe, pa u ndrojtur nga askush, pa pasur frikë se dikush do të më akuzonte pastaj që kam shikuar haram! Për syrin tim të uritur, edhe këto pamje do të më mjaftojnë që për disa ditë rresht, t'i kujtoj me nostalgji fytyrat dhe kofshët e tyre të lëmuara që do të më mbushnin me epsh. Këto skena nuk i harroj lehtë, por edhe kur i harroj për një copë herë, prapë më rishfaqen me gjithë madhështinë dhe bukurinë e tyre delikate, dhe sa herë që më shfaqen, më mbushin me forca të reja duke i harruar pothuaj tërësisht vrasjet!

Kjo gjendje e tanishme zgjati aq kohë sa e kalova turmën hutaqe dhe u ndodha prapë i vetmuar në mes të rrugës. Prapë mendja m'u rikthye të vrasja. Si çdo vrasës, që bënë plane paraprake, e zbulon vendin se

nga do të kaloj viktima, ia përshtatë rrobat kohës, e përgatitë mjetin, dua të them armën, atë të zjarrit apo të ftohtë, shufrën e hekurt apo litarin dhe duke e ruajtur gjakftohtësinë, e zë pritën. Ashtu edhe unë për të gjitha vrasjet isha përgatitur paraprakisht me një precizitet të mahnitshëm që do të ma kishin zili edhe kanibalët rus apo vrasësit amok të Teksasit! Të gjitha këto në vija të trasha duken identike me stilin e të gjitha vrasjeve, por pas një analize të thjeshtë del se asnjëra vrasje nuk ka gjë të përbashkët me vrasjen tjetër, sepse këtu ka ndikim të pakrahasueshëm, stili! Çdo vrasës e ka stilin e vet që e përdor gjatë kryerjes së procesit të vrasjes, thënë më butë, gjatë procesit të ç'jetëzimit!

Derisa po eci trotuarit si fantazmë, për të arritur në vendin e caktuar ku do të takohem me profesorin për raport dhe pagesë, mendja nuk më shqitej për asnjë çast nga përpëlitjet e fundit të Hafizit, që e lash të shtrirë në mes të rrugës duke dhënë shpirt. Edhe tani, jam më se i sigurt se punën time e kreva në mënyrën më profesionale. Vetëm një çast m'u deshtë, sa për t'i ndërruar pozicionet me Hafizin! Se nga më erdhi një imagjinatë e tillë nuk e di, por duke e paramenduar veten në vendin e tij, kur pa pritur nga errësira e natës sikur ma kishte prerë rrugën një pamje e nxirë njeriu me një shufër të rëndë metali në dorë! Por, kurrë nuk do të frikohesha si ai! Do të kërkoja mënyra se si t'i kundërvihesha, apo në rastin më të volitshëm do të kërkoja shtegdalje nga prita e jo të rrija si nuse e stolisur para vrasësit tim i cili me gjithë të ligat që i lëviznin nëpër bark, kishte edhe një të mirë; hapur me tregonte se e kishte ndërmend të më vriste! Edhe pse nuk desha ta kujtoj tani këtë imtësi, vetvetiu

më erdhi në kujtesë! Po sikur t'ju kisha lutur vrasësit tim të imagjinuar, sikur m'u lut mua Hafizi, a do të ma kishte falur jetën? Ndoshta po! Besoi se po... jam i sigurt se do të ma kishte falur jetën, sepse vrasësi im i imagjinuar nuk do të ishte i stilit tim, por do të ishte i stilit të atyre budallenjve që nuk kanë bërë kurrë vrasje dhe nuk e ndjejnë mbi shpatullat e tyre peshën e të ashtuquajturit vrasës! Kurse unë, në raste të tilla jam shpirtkazmë! Nuk fali... nuk fali sepse e urrej viktimën, e urrej aq shumë saqë nuk ngopëm pa ia marrë shpirtin... nganjëherë edhe marrja e shpirtit më duket pak! Pastaj, vijnë me radhë edhe disa arsye të tjera pse nuk bënë t'ia fali jetën viktimës! Kam humbur shumë kohë në përgatitjen e planit! Së pari, sipas urdhrit, apo sipas dëshirës e kam bërë përzgjedhjen e viktimës, pastaj përgatitjen e mjeteve për vrasje, i kam përgatitur maskat për fshehjen e fytyrës dhe të trupit, e kam përcjellë viktimën fshehurazi ditë e natë të tëra duke vrapuar si i çmendur pas tekave të tij derisa e kam gjetur kohën e duhur dhe ia kam zënë pritën, duke ju shfaqur befasishëm përpara... dhe pasi t'ia kam dëgjuar lutjet dhe lemerisjet mendoni se duhej t'i kërkoja falje për trembjen e shqetësimin që ia krijova dhe të kthehem duarthatë, pa ia marrë shpirtin, për të cilin isha munduar deri aty? Jo të dashur miq të stilit tim vrastar! Kjo nuk më ndodhë mua! Biseda që zhvillova me Hafizin, kishte karakter pune! Nuk dëshiroja ta vrisja një njeri tjetër të pafajshëm që do mund të më ngjasonte me të, prandaj qesh i shtrënguar të pyesja se cili ishte! Pastaj ia tregova shkakun pse duhej vrarë! Edhe kjo ishte pjesë e realizimit të planit! I shkreti Hafiz, jo vetëm që m'u lut, por edhe ma argumentoi shumë bukur se nuk kishte bërë idhuj,

nuk kishte bërë mëkate duke shkruar vepra dhe artikuj tjerë studimor, nuk kishte bërë shirk, sepse të njëjtën gjë e kishin bërë me mijëra dijetarë para tij, dhe e bënin edhe sot e kësaj dite, me mijëra e mijëra imamë e myftinj në mbarë botën, ndërsa ata shpërblehen dhe nderohen për punën e tyre, Hafizi i gjorë duhej të vdesë për të njëjtën vepër, në vend që t'i thureshin lëvdata! Por unë, nuk isha në gjendje të bëja një gjest të tillë human për t'ia falur jetën, sepse kisha një urdhër të prerë: Jo ta plaçkiti, jo ta masakrojë, jo ta plagos por thjeshtë: ta vras! Dhe vrasja duhet bërë me mjete të topitura, për t'i shkaktuar dhembje sa më të mëdha, derisa t'i del shpirti! Ky ishte mallkimi i fundit në këtë botë dhe në botën tjetër do të ketë një dënim shumë më të madh!

Tani, për shkak se dyshoj se dikush nga ju që po me shikoni me ngulm derisa po parakaloni pranë meje, mund të jeni të rangut tim dhe të m'i lexoni mendimet, nuk do të vazhdoj më të mendoj rreth vrasjeve, por do të përqendrohem kryesisht në mendime të ëmbla intimiteti! Kaq për sonte!

NATA

Disa dijetar më kanë quajtur pjesa e errët e ditës. Gjepura! Asgjë nuk më lidhë me dritën! Përkundrazi, dita dhe drita janë armiqtë e mi më të mëdhenj. Ka miliona vjet që dielli me rrezet e tij flakë, më përndjek det me det e shkrep me shkrep por nuk më zë dot! Andej nga lindja mugullojë kurse nga perëndimi venitem, por ju, mos mendoni se trupin e kam futë të zi! Jo! Falë Allahut të Madhërishëm që më freskonte e më shndriste prore me rrezet e tij të arta, ndjehesha krijesa më e lumtur në mesin e shtatë qiejve! Por, kjo lumturi imja nuk zgjati shumë!

Pasi Allahu i Madhërishëm i kishte krijuar engjëjt, ju mbush mendja të krijonte djallin nga një materie e zjarrtë që do të më digjte prore gjatë sundimit tim mbi dhé! Vetëm unë e di se si ju qëndrova atyre djegieve të tmerrshme që m'i shkaktonte ai i mallkuar derisa erdhi

një kohë dhe i Madhërishmi e krijoj njeriun nga dheu, nga një materie freskuese e materiale që zjarri mund ta djeg me flakët e tij të vala! Në fillim, pata menduar së kjo krijesë do të më freskonte edhe mua në jetë të jetëve. U zhgënjeva! Që nga ajo kohë kur shejtani i mallkuar nuk pranoi t'i përulej kësaj krijese të dobët e materiale të quajtur njeri, për mua, përveç djegieve të padukshme që m'i shkaktonte kohë pas kohe shejtani, filluan djegiet e dukshme që m'i shkaktonin njerëzit.

Disa mendje të krisura njerëzish, së pari filluan të me therin me ca bishtukë, me ca flakadanë, me ca qirinj e llamba vajguri duke e sfiduar dritën e të Madhërishmit. Të gjitha këto më dukeshin gudulisje mbi trupin tim të errët. Disi, sikur argëtohesha me to! Mirëpo, të trimëruar, pasi nuk ndëshkoheshin nga askush, filluan të ndezin zjarre! Në çdo vend që kaloja gjatë rrugëtimit tim, më prisnin të njëjtat vuajtje, të njëjtat djegie, të njëjtat plagë, të njëjtat dhembje! Isha e sigurt se këto koka të krisura i bënin shirk të plotfuqishmit me ato drita gjytyryme, dhe herët a vonë do të ndëshkoheshin! Tamam në kohën kur isha mësuar me ato plagë që më gudulisnin, më erdhi kumti nga i plotfuqishmi së çdo gjë ishte bërë më dëshirën dhe vullnetin e Tij! Atëherë fillova që edhe unë t'i dua ato plagë drite që më shkaktoheshin nga zjarret! As kjo kënaqësi nuk zgjati shumë. Një natë, gjatë sundimit tim, një kauri të krisur e të pafe, ju kishte mbushur mendja ta zëvendësonte dritën e Allahut, me një të rreme, dhe atë të rremen ta përdorte vetëm gjatë radhës së sundimit tim mbi dhé, pa e përfillur Të Madhërishmin kur thotë: *„Largohuni nga shpikjet sepse çdo shpikje është*

bidat e çdo bidat është humbje!"[45] Gjëma i ardhtë prej të Plotfuqishmit, e pata mallkuar në atë kohë, pastaj, se si më erdhi një forcë, një bindje që ma largoi frikën fare prej asaj mendje të krisur! Isha e sigurt se me gjithë përpjekjet e tij nuk do të arrinte gjë... por edhe nëse do të arrinte diçka, do të ndëshkohej rëndë nga i Plotfuqishmi, sepse e dinte fort mirë së Ai që krijon është vetëm Allahu. Por atij kauri, pa ju trembur syri nga ndonjë ndëshkim i mundshëm, vazhdonte punën e tij të nisur, jo vetëm ditën për diell, por edhe natën gjatë sundimit tim, nën dritën e qiriut, me penë në dorë, rrinte zgjuar i mallkuari, duke e ngjyer penën në kallamarë dhe bënte vija e pika me bojë të zezë mbi ca letra të bardha, derisa e zbuloi një marifet të paparë ndonjëherë! Me ca tela të zgjatur, me ca bobina, me ca fusha magnetike, (kështu ju thonë ata qafir atyre marifeteve) nxori ca drita të forta sa më verbuan, më mugëlluan, më venitën duke e bërë errësirën e trupit tim vrima-vrima! Që nga ajo kohë trupi im i errët është bërë shoshë nga ato drita vezulluese që nuk ka pjesë të trupit që nuk e kanë shpuar dhe që nuk po e shpojnë! Tani, ngado që sillem, ndjej shpime, dhe herë pas here i them vetes: A do të ndëshkohet ndonjëherë ky kaur i pafe që ka bërë kaq shumë mëkate duke e sfiduar dritën e Allahut? Jo! Nuk u ndëshkua atëherë, nuk po ndëshkohet as sot e kësaj dite, e nuk do të ndëshkohet as në të ardhmen! Përkundrazi, e uruan... e uruan edhe ata që nuk duhej ta uronin sepse e dinin se ai kaur i pafe kishte bërë shirk duke i sfiduar punët e Allahut të Madhërishëm! Mjerisht, të gjithë e uruan duke i thënë; „Tu ndritë varri, o shpirtbardhë!"

45 *Hadith sahih*

Po këto urime që ia dhanë ata me pavetëdije, ia dhashë edhe unë me vetëdije të plotë dhe me gjithë afsh! Gjatë gjithë kohës e kisha mallkuar me gjithë qenien time që varri i tij të jetë i ndritur nga ato drita xhuxhe që vetë i ka bërë dhe të digjet bashkë me to në zjarrin e xhehenemit, dhe shpirti i tij mos të gjej prehje në gjithësinë time të errët e të freskët, por të shkojë drejt dritës së diellit dhe të verbohet e përvëlohet, e të zhduket fare nga faqja e dheut, pa gjetur derman!

Derisa dielli i inatosur më ndjek prore duke lëshuar rreze të nxehta flakë, duke krijuar shkretëtira, e duke përcëlluar fusha e pllaja, duke i molisur krijesat e Allahut të Madhërishëm, unë si një nënë e dashur shkoj pas tij duke i freskuar me errësirën time, i njomi me vesë dhe i vë në gjumë për të pushuar, për të ëndërruar dhe dashuruar! A nuk jam unë nata që kam përcaktuar dhe vazhdoj të përcaktoj fate popujsh, fate betejash, fate njerëzish, fate dashurie dhe fate zije? A nuk isha unë nata e zezë futë kur në terrin tim e mbështolla Pejgamberin, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, derisa po i zbriste vegulli shpallja e sures së parë Alek? A nuk isha unë nata që nën terrin dhe freskinë time Pejgamberi, selamu alejkum, bënte plane dhe i lutej Allahut për fitore pak para betejës së Bedrit? A nuk isha unë nata e zezë kur në terrin tim e çorientova Ebu Sufjanin dhe tremijë luftëtarët e tij në Uhud, derisa e humbën luftën? A nuk isha unë nata e Israsë[46] që në terrin tim e mbështolla Pejgamberin e shoqëruar nga Xhibrili kur shkoi kaluar

46 *Fluturim i Pejgamberit Muhamed nga Meka në Mesxhidul Aksa (Jerusalem)*

mbi Burakun[47] e Tij të Bardhë në Mesxhidul Aksa, e prej aty në Miraxh? A nuk isha unë nata e zezë kur në terrin tim i mbështolla murtadet, ithtarë të Musejleme Kedhabit që i vranë shtatëdhjetë hafëzët, dhe kështu ju mbush mendja Ebu Bekrit ta lejonte Ymerin e Hatabit ta tubonte Kuranin e shenjtë? A nuk isha unë nata e zezë që në terrin tim i mbështolla kriminelët e Kalifit Jezid që i shkuan në shpatë Imam Huseinin bashkë me shtatëdhjetë e dy hafëzët e tij? A nuk isha unë nata që ia mundësoja lutjet drejtuar Allahut nga Salahudin El Ejubit para betejave të famshme kundër kryqëzatave? A nuk isha unë nata që i mbrojta luftëtarët trima të islamit kur e mposhtën Kartagonë e Sirakuzën? A nuk isha unë e zeza natë që i dhashë takat vezirit të Kalifatit të Kordobës Kara Al Mansurit që t'i shtronte me shpatë të pafetë nga Zamora e Coimbra, Leoni e Barcelona, Santiago de Compostela e Amoriumi e deri të Anadolli bizantin? A nuk isha unë nata e zezë futë, që pasi e kisha përgjumur Sulltan Muratin, predikuesin më të madh të islamit në ato vende të nëmura të Arnautistanit, ua hapa rrugën të dërguarve të Allahut, meleqeve, t'ia dërgonin ëndrrën nga i Madhërishmi se do të binte shehit nga dora e Arnaut Milush Kopiliqit të pafe, por që islami do të lulëzonte në ato troje të nëmura?... dhe së fundi, a nuk isha unë nata e zezë që me vetëdije të plotë dhe qëllimisht e mbështolla në errësirën time vrasësin e Hafizit sepse me vetëdije e kryeneçësi ishte shmangur nga rruga e ndritur e selef-us-salih?... dhe a dini ju se cilin jam duke e fshehur sonte

47 *Kafshë e bardhë në formë të kalit, por shumë e shpejtë, me të cilën Pejgamberi Muhamed ka fluturuar natën e Israsë nga Mesxhidul Aksa (Jerusalemi) drejtë Miraxhit (Qiellit të shtatë)*

për të bërë edhe një të zezë të radhës?... sigurisht se nuk e dini, por as unë nuk do t'ju tregoj... nuk ju tregoj sepse ju, këto ndodhi që kryhen brenda sundimit tim po i quani herë ëndrra e herë krime të zeza, kurse për mua këto nuk janë as ëndrra e as krime të zeza sepse nuk po i kryejnë djajtë, armiqtë e mi të zjarrtë e të ndritshëm, por janë shajni e vegulli që po i kryejnë më të dashurit dhe më besnikët e mi të errtë e të zi si futa... Allahu ju dhëntë kuvet!

VENDNGJARJA

Hilë! O Hilë! Zgjohu... zgjohu shpirt! – e ndjeva si në ëndërr zërin e Zogës sime të bukur, dhe njëherësh, dorën e saj të lehtë që po me tundte në supin e djathtë.

U zgjova! Sa u gëzova kur e pashë fytyrën e saj të bardhë e të mbuluar me flokë të shpupurishura. I zgjata duart drejt saj dhe ia mbështolla faqet me pëllëmbët e mia. Pastaj e tërhoqa nga vetja, dhe e putha me afsh në buzë!

Ishte herët, ende pa zbardhë drita. Fillova të vishem ngadalë, duke e shikuar me admirim teshat e reja! Pasi e kisha dhënë edhe provimin e fundit me sukses të shkëlqyer, kisha marr diplomën e detektivit të kualifikuar. Eprorët e kishin caktuar njësinë policore ku do të shërbeja.

– I bajsh me shëndet! – më tha Zoga

– Shëndet paç! – ia ktheva derisa isha duke e shikuar veten në pasqyrën e madhe të dollapit të ri që e patëm

blerë me rastin e martesës!

Derisa shikohesha në pasqyrë duke u kthyer sa majtas djathtas, Zoga ime e dashur, po më shikonte hareshëm nga këndi i shtratit ku kishte qëndruar në këmbë për të më parë më mirë nga distanca. Herë pas here e vëntë buzën në gaz duke më shikuar me atë shikimin e saj të ëmbël, dhe pastaj afrohej qetë-qetë duke m'i rregulluar cepat e jakave të këmishës dhe kravatën! Ishim akoma në muajin e mjaltit, prandaj shqetësimet e saj ishin të arsyeshme, sepse dukej se çdo gjë e bënte nga dashuria, edhe pse mua më dukej sikur po e tepronte me kujdesin e saj!

– E di si po me dukesh tani me këto tesha? – më pyeti derisa ishte duke m'i mbërthyer kopsat e xhaketës.

– E si po të dukem, ë? – e pyeta duke parë fytyrën e saj të mbufatur nga gjumi i pakët që kishte bërë!

– Si ata detektivët që luajnë nëpër filma!

– Po mahitesh! – i thashë duke ia larguar lehtë dorën nga pjesa e epërme e barkut tim sepse ndjeja gudulisje!

– Hë, ç'pate tani? – më pyeti duke qeshur, sepse i dinte vendet ku gudulisem!

– Jo, jo, asgjë... por, po më gudulisë me ata gishta... ha, ha, ha! – pa e mbaruar fjalën filloi të më gudulisë edhe më shumë sa që nuk durova dot dhe e mbërtheva rreth belit me të dyja duart dhe e ngrita lartë duke e shtrënguar fort dhe duke e puthur me gjithë afsh në faqe e gushë!

– Lëshomë... ah! Lëshomë se ma ndave frymën!... si i ke ato duar si darë!

– Ma jep fjalën se nuk më gudulisë më?

– Lëshomë njëherë!

– Nuk të lëshoj pa ma dhënë fjalën!

– Mirë de! Lëshomë tani! – më tha, por kur bëra ta lëshoj

më shtrëngoi me gjithë fuqi që pati dhe më mbështolli të tërin në përqafim. – se si e kam një parandjenjë, një lloj frike... sikur do të humbi përgjithmonë!... – më tha, dhe në faqen time ndjeva ngrohtësinë e lotëve të saj.

– Edhe ti me këta lot! – i thashë disi edhe i nevrikosur edhe me dhembshuri. – kështu bëre dje kur më përcolle deri të autobusi, të gjithë mendonin se po ndahemi përgjithmonë! Kështu bënë edhe tani!? Mos u bëj ndjellakeqe! Para mbrëmjes do të jem në shtëpi! – i thashë derisa isha duke u shkëputë nga përqafimi i saj!

Në derë ia behu nëna! E kishte dëgjuar bisedën tonë, dhe e shqetësuar hyri brenda pa trokitur. Porsa e pa nusen e përlotur mu drejtua mua;

– Ç'ka nusja që qanë?

– Nuk i thashë gjë të pahijshme nënë, të betohem!

– Jo, nënë jo! Ai nuk më tha gjë, por unë... se si e kam një frikë për të... po më duket disi ndryshe!

– Si ndryshe moj bijë? – e pyeti nëna me atë zërin e saj pajtues.

– Disi... sikur do të bëhet armiqësor pas emrit detektiv dhe do të më harron mua... do të na harroj ne... dhe... kam frikë se për shkak të punës së tij do të krijojë armiq dhe pastaj do ta vrasin!...

– Jo moj bijë! Për këtë mos ke fare frikë! Tani nuk janë më ato kohërat e trazirave! Është kohë paqeje dhe mosmarrëveshjet e njerëzve nuk do të zgjidhen me dhunë... – foli nëna jo edhe aq e sigurt në ato që po i thoshte.

Megjithatë m'u bë sikur Zoga u qetësua pak dhe i fshiu lotët me një shami që e mbante në dorë. E vërejta se koha ecte më shpejtë se ç'e mendoja, prandaj pa e zgjatur shumë

i mbështolla të dyja në përqafim dhe bëra nga dera kur ajo me tha:

– Prit! Po të shoqëroj deri në stacion.

U ktheva i tëri drejt tyre. Nëna sikur e miratoi kërkesën e saj. Pastaj, ajo zgjati dorën drejt xhepit tim të xhaketës dhe shaminë që pak më parë i kishte fshirë lotët me të ma futi në xhep. Njëri cep i ngeli jashtë. E shtyva më dorë më thellë në brendi të xhepit dhe e hapa derën duke thënë:

– Ika unë, se u bë vonë! Ditën e mirë!

– Ditën e mirë! – ma ktheu nëna buzagaz.

Kur isha duke e mbyllë derën e korridorit ktheva kokën edhe njëherë prapa dhe e pashë nënën që kishte qëndruar në prag! Sa shumë e dua, thashë me vete dhe e mbylla derën.

Derisa po e prisnim autobusin, në stacion ia behu Maksuti me motrën e tij të bukur të mbështjellë me tërlik të zi sa as fytyra nuk i shihej mirë. Më përshëndeti, jo duke me shikuar mua, por duke e shikuar si i marrë Zogën time të bukur! Tutkun i pagdhendur do mbetesh për tërë jetën o mjeran, i thashë më vete. Kur erdhi autobusi, Zoga ia dha të qarës. Sa ma ngushtoj shpirtin! Derisa po bëhesha gati ta qortoja ashpër, më dhembje e shtrëngova në përqafim duke u përpjekur ta qetësojë dhe u ndamë.

Pasi u nis autobusi, fare papritur u ndesha më vështrimin pyetës të Çelit që ditë më parë ishte kthyer nga studimet. Kishte marrë pamjen e tjetërsuar sikurse Maksuti. Pasi u përshëndetëm, fillojë të fliste rëndë-rëndë me një theks të rënduar arab, pa i bërë përshtypje biseda ime. Pasi ia dhashë numrin e celularit u ndava prej tij duke i premtuar së do të takoheshim një ditë tjetër.

Në stacionin policor me priti komandanti. Ishte një

burrë trupshkurtër. Dukej i qetë dhe i kujdesshëm, me gjithë fjalët që kisha dëgjuar për të së ishte nopran i padurueshëm. Me mori në zyrën e tij. Derisa po zinte vend në ulësen e tij matanë tryezës, si më vete tha:

– Ti je i vetmi detektiv që keni mbaruar medresenë...

Për një çast mbeta i hutuar! Me erdhi aq papritur sa që nuk arrita as të mendoj së çfarë përgjigje duhej t'i jepja. Kur filloi të fliste prapë, me të njëjtin ton, ndjeva së fillova të lirohem nga sikleti.

– ... është i vetmi sektor i pambuluar me njerëz besnikë dhe të profesionit, të cilët i njohin në thelb punët e fesë dhe udhëheqësit aktual... – derisa po mendoja se ç'lidhje kishte profesioni im prej detektivi me fenë dhe udhëheqësit e fesë, nga radiolidhja erdhi një zë i mbytur burri që lajmëronte një vrasje në një rrugicë pranë një xhamie, dhe njëherësh urdhëronte urgjentisht daljen në vendin e ngjarjes! Komandanti e mori përgjegjësinë. Dha urdhër që njësiti të rreshtohej në oborr, kurse mua më tha ta ndiqja pas. Hymë në një zyrë të ngushtë. Prapa një tavoline të madhe kishte zënë vend një burrë rreth të tridhjetave dhe shikonte diçka në monitorin para tij duke e lëvizur miun e kompjuterit. Pasi u ngrit në këmbë, pashë se edhe ai ishte i veshur me rroba civile.

– Ky është detektivi i ri, për të cilin të kam njoftuar më parë. Hilë ia thonë emrin. Sapo i ka mbaruar kurset përkatëse të trajnimit dhe sot fillon detyrën në njësitin tonë.

– Kujtimi – tha me zë të thellë dhe ma zgjati dorën. Ishte një burrë i pashëm, bjond e sykaltër.

– Kujtim, sapo na lajmëruan se në njërën nga lagjet periferike ka ndodhur një vrasje. Përgatitu dhe nisuni

menjëherë bashkë me Hilën.

– Si urdhëro!

Të alarmuara, makinat e lanë stacionin policor dhe morën drejt periferisë së qytetit. I shikoja me kureshtje automjetet që ndodheshin duke qarkulluar në rrugë se si strukeshin anash duke kërkuar ndonjë shteg për të na hapur rrugë! Kalimtarët e rastit shikonin nga ne sikur donin të pyesnin; „ç'farë ka ndodhur?", por kishte edhe prej atyre që nuk ju bënte përshtypje fare sirena e alarmit, por vazhdonin të ecnin kokulur dhe indiferentë duke e shikuar rrugën se ku e vënin këmbën!

Porsa u futëm në rrugicën në fjalë, pamë një patrullë policie që kishte arritur kohë me parë dhe e kishte bërë ruajtjen e vendit të ngjarjes. Në mesin e tyre ishte edhe mjeku i medicinës ligjore. Zbritëm nga makina. Me urdhrin e komandantit u morën masat e para të fillimit të këqyrjes. Pas pak, njëri nga policët patrullues e solli tek ne një burrë rreth të gjashtëdhjetave, i cili e kishte bërë kallëzimin për rastin në fjalë.

– Si quhesh ti? – e pyeti detektivi

– Daut Murati. – u përgjigj ai me një ton të mekur

– Si ndodhi? – pyeti detektivi.

– Në mëngjes kur po dilja nga shtëpia, që larg pashë një gjë të zezë të shtrirë për tokë! Në fillim mendova se mund të ketë ngordhur ndonjëri nga qenët endacak. U afrova më afër. Thashë ta largoj nga rruga, kur befas pashë se nuk ishte qen por njeri. Atëherë, me të shpejt zbrita nga makina dhe e preka në faqe. Akull. Me të shpejt i lajmërova policinë!

– E njeh viktimën?

– Jo! Nuk e njoh! Por, megjithatë dyshoj se mund të

jetë Hafiz Osmani.

– E keni njohur për së afërmi Hafizin?

– Po... dua të them se nuk kam pasur kurrë kontakt me të por shumë herë kam qenë anëtar i xhematit të tij. Vetëm kështu njihem me të! Pastaj, mbrëmë i ka falur lutjet e akshamit në xhaminë tonë! Këtë e dinë të gjithë, edhe hoxha!

– Pasi e gjetët të vrarin, hetuat rreth e qark ndonjë lëvizje të dyshimtë?

– Jo, nuk pashë gjë.

– Dhe pyetja e fundit: Ku ishe mbrëmë para mesnate?

– Në shtëpi! Kisha, në realitet kam hala mysafirë. Pse me pyesni? Ju mendoni se unë kam ndonjë lidhje me vrasjen?

– Jo, jo! Ishte një pyetje rutinë! Megjithatë, ju faleminderit!

Ndërkohë mjeku ju afrua viktimës dhe i bëri një kontroll të shpejt duke hetuar pulsin në dorën e djathtë që i kishte mbetur e shtrirë para, me grushtin e mbushur me zhavorr të rrugës. Pastaj ia vuri dorën në damarët e qafës duke e kthyer vështrimin ngadalë nga ne.

– Gjasat janë se viktima ka vdekur gjatë goditjeve! Vrasja duhet të ketë ndodhur para mesnate. – foli mjeku pa ju drejtuar askujt.

Shkurtimisht u morën në pyetje edhe disa dëshmitarë të tjerë që ndodheshin aty. Edhe ata e konfirmuan se i vrari ishte Hafizi, dhe se mbrëmjen e kaluar fare papritur e kishte vizituar xhaminë e tyre.

Me të dëgjuar emrin e profesorit Hafiz, një ndjenjë trishtimi më sëmboi së brendshmi. Sa nuk klitha nga dhembja për të. Krahas dhembjes vetvetiu me erdhi në mendje një pyetje tjetër; cili ishte vallë ai i shkalluar që e

vret një mësues zemërbardhë siç ishte Hafizi? Ç'e shtyri atë katil të poshtër të merrte një vendim të tillë? Mendja me vajti të maskat, siç po i quajnë disa kriminel të maskuar që po dalin netëve të errëta dhe po i plaçkitin udhëtarët, veçmas ata që derti i ka nxjerrë nga shtëpitë e tyre!

– Të kujtohet se cili është ndarë i fundit nga i ndjeri? – pyeti detektivi duke m'i ndërpre mendimet njëherësh.

– Kur jam larguar nga oborri i xhamisë, të dy, Hafizin dhe hoxhën e xhamisë sonë i lash duke biseduar në oborr!

– Vetëm për vetëm ata të dy? – pyeti detektivi.

– Po. Vetëm ata!

Komandanti me disa policë, me mua dhe specialistin, u larguam tutje duke marrë masat përgatitore në ruajtjen dhe rrethimin e vendit ku ishte kryer vrasja. U morën për bazë metodat spirale dhe brezore, për shkak të terrenit të thyer!

Filluam duke lëvizur ngadalë nga periferia që ishte e përfshirë edhe një pjesë matanë murit të varrezave që i ndante ato nga rrugica, në drejtim të qendrës aty ku ndodhej i vrari! Gjatë marshimit pamë gjurmët e para që i kishte lënë vrasësi, i cili dukej se kishte qëndruar në pritë i fshehur prapa murit derisa ju kishte shfaqur viktima. Bëmë hetimin përreth duke kërkuar gjësende të tjera që do të kenë lidhje me vrasjen. I bëmë edhe disa pyetje në shtëpitë përreth se mos dikush nga banoret e atyshëm, gjatë natës kishte dëgjuar ndonjë thirrje për ndihmë apo britma fjalosjesh.

Pastaj, me urdhrin e komandantit, kufomës ju bënë një serë fotografish! Vetëm gjatë kësaj kohe u vërejt çallma, e rënë në llagëm disa metra larg trupit të tij. Ishte e deformuar nga goditja, gjë që lente të kuptohej se i ndjeri

ishte goditur në kokë me një mjet të fortë. Pasi ju bënë disa fotografi, e morëm çallmën dhe e vendosëm në një thes najloni të tejdukshëm. Duke kërkuar gjurmë të tjera, arritëm edhe në disa sosh të mbetura nga kacafytjet si, gjurmë këpucësh, një laps, një palë syze dhe një kuletë! Pas një kontrolli erdhëm në përfundim se këto gjëra i takonin të vrarit. Kuleta dukej se ishte e paprekur. Një letër e palosur dhe e shkruar me alfabetin arab ndodhej në mesin e saj. Paratë dhe disa gjëra me vlerë që zakonisht i lakmojnë plaçkitësit ishin aty. Edhe unaza me gur rubini në gishtin e dorës së majtë ishte aty! Të gjitha këto lenin të kuptohej se motivi i vrasjes nuk ishte plaçkitja! Pastaj, nga kuleta e tij nxorëm letërnjoftimin, që i vërtetonte thëniet e dëshmitarëve se i vrari ishte Hafiz Osmani.

Pasi u thye versioni dyshues i vrasjes për plaçkitje, sikur m'u shtypën mendimet si kokrrat e grurit nën peshën e gurit të mullirit, duke e nxjerrë të zgërlaqur në kujtesën time një motiv tjetër që duhej të ishte vetëm politik! Këtë mendim e arsyetoi me njohjen e viktimës në tri dimensione!

Dimensioni i parë, që ngërthehej brenda strukturës dhe fizionomisë së tij ishte patriotizmi. Ishte njëri nga pasardhësit e denjë të Sefë Kosharës, i varur nga ushtarët turq në maje të lisit. Pas përfundimit të medresesë, Hafizi kishte studiuar teologjinë në Damask dhe ishte kthyer në vendlindje duke punuar si mësues i medresesë. Ligjëratat e tij fetare kishin një dimension të ndryshëm nga mësuesit e tjerë. Ai çdo studim fetar që ua paraqiste nxënësve, e bënte duke e ndërlidhur me çështjen dhe historinë e popullit të tij të shumëvuajtur. Me ka mbetur në kujtesë kur shpjegonte kohën e zbritjes së Kuranit të shenjtë,

kohën e Pejgamberit Muhamed, pa hezituar e tërhiqte një diagonale drejt popullit të tij që në të njëjtën kohë kishte qenë i detyruar të mbrohej me lufta të përgjakshme kundër dyndjeve barbare sllave në Ballkan. Ndikimet e para të islamit në ato treva deri të vrasja e Sulltan Muratit nga Milushi, i lidhte me thëniet e teologut të famshëm Ibn Kaldun i cili, në të njëjtën kohë paralajmëronte se në islam xhihadi parashihet me ligj dhe ka mision universal, më qëllimin e lartë, që mbarë njerëzimit t'ia dhuroi vullnetarisht apo detyrimisht fenë Islame!

Dimensioni i dytë ishte feja. Ishte i denjë dhe i pastër. Kishte zë të këndshëm. Gjatë këndimit të sureve në gjuhën arabe, ashtu siç ishin të shkruara në Kuranin e shenjtë, fjalët i ndante në rrokje, shkoqur e qartë, duke ju dhënë theks të veçantë arab që edhe imamët më të mirë do t'ia kishin zili! Për të na i sqaruar ne nxënësve, çdo sure dhe ajet, bënte komentimet e nevojshme duke dhënë shembuj konkret për madhështinë a tyre, që jo vetëm koha e tashme por as koha e ardhshme dhe asnjë kohë tjetër nuk do të kenë ndonjë ndikim në zbehjen e shkëlqimit të tyre! Ishin fjalë të arta, të zbritura direkt nga i madhi Allah, që kurrë nuk do të zbehen deri në ditën e kiametit që është e shënuar në Kuran. Zëri i tij i denjë kumbonte brenda klasës. Gjatë komentimit të sureve, se si do të dukej xheneti e si do të dukej xhehenemi, metodat dhe dredhitë gjatë yshtjeve të djajve, pamjet lakmitare të haramit e shumë të tjera na fusnin në mendime fantastike dhe ato që i thoshte ai, na dukeshin se nuk ishin fjalët e tij, por ishin përjetimet tona që na gëlonin brenda shpirtit, si në këtë kohë të shkurtër të kësaj dynjaje, ashtu edhe në dynjanë tjetër! Vonë, pak para përfundimit të maturës

arrita ta kuptoj një ves të tij, që pak kush nga nxënësit e kishin vërejtur. Sa herë që binte radha e komentimit të sureve El Nisaë, El Enfalë, apo Et Tevbe dhe disa të tjera, bënte një komentim të shpejtuar pa u ndalur në detajet siç vepronte në suret e tjera. Vonë e pata kuptuar së këtë gjest human e të sinqertë e bënte për t'ju shmangur komentimit të disa ajeteve luftënxitëse!

Dhe, dimensioni i tretë i tij ishte morali. Skrupujt moral ngërtheheshin thellë në qenien e tij prej filozofi. Kurrë nuk ngutej në përgjigjet delikate. Gjatë bisedës, bënte një pushim të shkurtër të shoqëruar me fjalën „demek" përmes së cilës arrinte një ekuilibër në përgjigje të sakta dhe të qarta pa i dhënë mundësi tjetrit për një pyetje të ngjashme, edhe provokuese qoftë ajo! Ato që i nxirrte nga goja nuk ishin fjalë të thëna dosido, por ishin të matura e me vlera të larta, të thella e të prera sa tërë qenien e vetë e lidhte pas tyre. Ishte njohës i shkëlqyer jo vetëm i fesë, por edhe i shumë lëmenjve të tjera siç ishte historia e astronomia, traditat e kulturat e popujve të ndryshëm, për të cilat mbante respekt të veçantë. Edhe ndaj besimeve të tjera reflektonte tolerancë të admirueshme, por mbi të gjitha këto, kulturën e popullit të tij nuk e ndërronte me asnjë kulturë tjetër, bile as me kulturën arabe, që nga besimtarët islam cilësohej dhe lidhej ngushtë si kulturë hyjnore që ka zbritur nga Allahu xhel-le shanuhu bashkë me Kuranin e shenjtë! Jo, jo! Me kulturën, gjuhën dhe traditat arabe ne nuk na lidhë asgjë, thoshte herë pas here. Me ta na lidhë vetëm feja ashtu siç na lidhë me boshnjakët, afganët apo turqit! Kultura e një populli është e shenjtë sepse aty ngërthehen larmi ngjyrash në radhitje shekujsh që ju vishen brezave duke ju mbështjellë popujve

veç e veç që i bënë të dallohen nga njëri-tjetri! Sikurse populli arab që i ka heronjtë dhe dijetarët e vetë dhe ju falen atyre, pa marrë parasysh se cilit besim i kanë takuar ata në lashtësi, edhe ne i kemi heronjtë dhe dijetarët tanë që duhet të falemi para veprave të tyre madhështore pa marrë parasysh se cilit besim i kanë takuar në kohën kur kanë jetuar ata!

Për një çast m'u bë se sapo arrita nga një botë tjetër në një realitet të hidhur kur para këmbëve të mia qëndronte i shtrirë trupi i pajetë i profesorit dhe predikuesit tim më të dashur, i fesë dhe i kombit, shkëlqesia e tij, Hafiz Osmani. Mu bë së kësaj radhe sëmbimi i brendshëm me tradhtoi duke m'i nxjerrë dy pika lotësh, që më rrodhën tatëpjetë faqeve me ngashërim të brendshëm. Mbaje veten, je në ditën e parë të detyrës, sikur më tha një zë nga brenda! I fshiva lotët me shaminë që ma dha Zoga në mëngjes. Si i dalë nga një ëndërr, sa nuk klitha kur e pashë orën! Vallë a është e mundur të jetë akoma mëngjes?

Pas fotografive që ju bënë pozitës së kufomës dhe gjësendeve tjera për rreth, si gjurmëve të këpucëve që kishte lënë vrasësi, kuleta, syzet dhe lapsi, me urdhrin e mjekut e rrotulluam kufomën në shpinë. Duke pasur kujdes në vazhdimin e ruajtjes së gjurmëve, kufomës ju bënë edhe disa fotografi, si dhe u bë vizatimi i plan – skicës mbi pozitën e vendit ku është kryer vrasja deri të pozita e kufomës dhe e gjësendeve përreth. Mjeku i bëri kontrollet e radhës duke përcaktuar deri në një masë mjetin e ekzekutimit të vrasjes që duhej të kishte qenë shufër me katër këndë të topitura hekuri e me maje të mprehtë, sepse edhe shenjat e shpimeve në trupin e viktimës dukeshin se ishin shpuar me të njëjtën shufër,

e cila nuk u gjend në vendngjarje.

Pas përfundimit të procedurës, u bë plotësimi i procesverbalit, të cilin e plotësoi gjyqtari hetues, me urdhrin e të cilit pasoi edhe përgatitja e kufomës për transport në objektet e medicinës gjyqësore.

E futëm në një thes najloni të zi, dhe, ngadalë, sikur kishim frikë se po e lëndonim trupin e tij madhështor, por të masakruar, e vendosëm në vig, e që andej e bartëm deri të vetura.

Vonë pas dreke u kthyem në zyrën e komandantit për t'i përfunduar formalitet e mëngjesit. Me insistimin e Kujtimit, ia thashë gojarisht versionin e parë hetimor, edhe pse nuk isha i ngarkuar drejtpërsëdrejti me një urdhër të tillë. Pa u thelluar në natyrën e vrasjes që rezultoi pas këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe fakteve të ekzaminimit të pjesshëm nga ana e mjekut ligjor, u përqendrova në motivin dhe personat që mund të jenë të përfshirë në vrasje. Bisedën e fillova duke folur ngadalë, pa emocione dhe duke u mbështetur kryesisht në mësimet teorike që i kisha mësuar gjatë kurseve dhe stërvitjeve. Në fillim m'u duk e vështirë për transmetimin e një raporti të tillë sepse ishte i pari i këtij lloji që po e raportoja para eprorit tim, e që në gjuhën e kriminalistikës quhet versioni i parë hetimor!

– Duke u mbështetur në metodat e kërkimit të fajtorit që nuk është zbuluar, në bazë të gjurmëve që kanë ngelur në vendngjarje, pas marrjes në pyetje të atyre njerëzve që i porsa vrari kishte pasur kontaktet e fundit derisa ishte i gjallë, si dhe duke u mbështetur në autoritetin e lartë që e kishte gëzuar në rrethin e ngushtë familjar, në rrethin e farefisit dhe të miqve, është e pamundur

të gjendet edhe një njeri i vetëm që të thotë një fjalë të papëlqyer për shkëlqesinë e tij, e aq më pak një i tillë që do të kishte motiv të ngrinte dorë kundër jetës së tij, pohoj se vrasja është bërë me paramendim, dhe nga prita. Në bazë të gjurmimeve të deritanishme, të atyre çfarë i pamë dhe që arritëm t'i analizojmë me rastin e shikimit të vendit të ngjarjes, del se motiv i vetëm për vrasjen e tij është pengesa e tij e pakalueshme në zbatimin e reformave islame të iniciuara nga disa arabë që po veprojnë në qarqe të ndryshme nxitëse, duke futur huti në mesin e besimtarëve dhe përçarje në mesin e anëtarëve të kryesisë së Bashkësisë Islame! Në fillim këto përçarje nuk ishin vënë re aq shumë, dhe ishin trajtuar si mosmarrëveshje të lokalizuara që do të kaloheshin lehtë. Mirëpo, me rikthimin e Imamit në kryesi, rikthim që u bë me ndërhyrjen vulgare të Abu Al Khalidit, gjërat sikur morën të tatëpjetën. Kryesia u nda në dysh, edhe pse ithtarët e Imamit ishin të pakët në numër dhe pa ndonjë ndikim në radhët e kryesisë. Me përkushtimin e tyre këmbëngulës arritën t'i bindin disa anëtarë të luhatshëm duke e fajësuar Hafizin që ishte bërë mollë sherri në mesin e kryesisë me qëndrimet e tij të ngurta.

– Ju mendoni se vrasësin duhet kërkuar në mesin e radhëve të kryesisë? – me pyeti komandanti i çuditur nga ato që i dëgjoi nga unë. Të paktën kështu m'u duk mua!

– Jo! Nuk ma merr mendja së vrasësi do të gjendet në radhët e kryesisë!

– Po ku atëherë? – me pyeti duke luajtur pak nga vendi.

– Motivi bashkë me nxitësin ndodhën në radhët e ithtarëve të Imamit, kurse dorasi mund të jetë njëri nga besimtarët naiv të vëllazërisë së vehabinjëve, ose të

paraardhësve, siç po e quajnë veten me këtë epitet të zbutur!

– Ju e keni njohur për së afërmi Hafizin? – me pyeti befas. Edhe unë për një çast u befasova jo nga pyetja e tij, por, se nga e dinte ai se unë njihesha që moti me Hafizin dhe me rrethin e kundërshtarëve të tij.

– Po! Por jo vetëm të ndjerin, i kam njohur dhe i njoh mirë edhe kundërshtarët e tij!

– Dhe ata, dua të them, kundërshtarët e tij nuk e dinë se ti ke filluar punën në polikrim?[48]

– Jo! Përveç familjes sime të ngushtë askush nuk është në dijeni. Ka edhe disa syresh që e dinë se jam duke i vizituar disa kurse...

– Ëhë! Shumë bukur! Shumë bukur... këtu desha të dal! –foli me entuziazëm dhe u ngrit në këmbë. Duke ecur ngadalë vazhdoi: – Ti, tani e tutje je pjesëtar i shërbimit tonë me betim të dhënë. Gjithashtu, je në dijeni se të presin detyra të rënda dhe të rrezikshme, por nuk e di se a je në dijeni se çfarë kërkojmë ne prej teje?!

– Po! – ju përgjigja spontan, dhe, u pendova që fola!

– Çka? – pasoi pyetja që pritej pas përgjigjes sime ngacmuese.

– Disiplinë, korrektësi, përpikëri, përkushtim...

– ...dhe në fund; besnikëri dhe heshtje... – më ndërpreu duke vënë gishtat e dorës së djathtë pranë gojës sikur donte të thoshte: qepe, mbylle!

Për një çast e ndjeva veten të hutuar nga kumbimi i zërit të tij urdhërues, që nuk e ndava dot së për çfarë besnikërie dhe heshtje me urdhëronte. Pas pak, zëri i tij kumbues, e mbushi zyrën e qetë dhe të gjerë:

---

48 Policia kriminale

– Ne, gjatë ditës, kur ti ndodheshe në shërbim me rastin e shikimit të vendit të ngjarjes, i diskutuam hollësisht këto që sapo i the ti, dhe arritëm në përfundim se situata e krijuar kërkon përpilimin e një plani të ri... krejtësisht të ri, në qendrën e të cilit duhet të jeni ju bashkë me Kujtimin!

Ashtu siç isha i ngrirë në këmbë, vetëm sa u shtanga edhe më tepër, duke e pyet veten: Si mund të jetë që këto që sapo ia thashë këtij, t'i kenë diskutuar në kohën kur unë nuk ndodhesha këtu? Nga e morën vesh vallë?...

– Është një rast ideal që një fytyrë e pa konsumuar, krejt rastësisht të gjendet në mesin e rrethit të shokëve të tij të dikurshëm, por tani i konvertuar dhe nën urdhrat, apo thënë më butë, nën dëshirat e tyre!

Tani më, nuk më kujtohet fare se kur ishte kthyer nga unë dhe në ç'kohë kishte filluar të më shikonte me një vështrim të atillë, sikur donte të kuptonte nga heshtja ime së në ç'masë isha duke i kuptuar fjalët e tij. E folura e tij me erdhi e largët, e panatyrshme dhe e fshehtë sa që për një çast m'u bë se nuk isha duke e dëgjuar zërin e komandantit tim të ardhshëm, por zërin e një aktori filmi, dhe ato që i thoshte, do të konkretizoheshin në skenat pasuese!

Derisa po përpiqesha që ato fjalë të panatyrshme t'i konkretizoja me ngjyrat e një urdhri pasues, ai vazhdoi me të njëjtin ton:

– Qysh sot, derisa gjurmët dhe gjësendet tjera janë akoma të freskëta, të kërkohet me ngulm personi që i ka lënë ato gjurmë në vendin e krimit. Të ruhet edhe për një kohë të caktuar vendi i ngjarjes, të merren në pyetje anëtarët e familjes se në ç'kohë ka dalë viktima

nga shtëpia, motivi i daljes dhe takimet e planifikuara apo të rastit. Të zbulohen dhe të pyeten personat që kanë pasur takime gjatë ditës, ata të fundit, e veçmas hoxha, i cili duket të jetë personi i fundit, që e ka takuar të ndjerin Hafiz para se të vritej. Kaq nga ana ime. Punët dhe detyrat e tjera koordinoni së bashku me Kujtimin. Fillim të mbarë!

– Ju faleminderit!

– Si Urdhëron! – ia kthej Kujtimi dhe mori nga dera. Kurse unë, i turpëruar e ndoqa pas Kujtimin.

HUTBE

Herë pas here, vjedhurazi e shikoja profilin e Imamit, derisa ishte i përqendruar në ngasjen e veturës së tij të tipit Mercedes. Pas bisedës së zakonshme, në kabinë kishte rënë heshtja. Radioja vazhdonte me transmetimin e lajmeve të mëngjesit, kurse vetura tundej lehtë, kur rrotat binin në ndonjë pus të mbushur me ujë përgjatë rrugës së mbuluar me zhavorr. Pamja e Imamit dukej fytyrëvrarë dhe e zbehtë. Kjo zbehtësi dendësohej edhe më tepër kur ia shikoje flokët e thinjura gri, dhe rrudhat në ballë. Me shikimin e përqendruar në rrugë të bëhej sikur shprehte pakënaqësi të tendosur, me ca mendime të shthurura dhe të pa cak, sikurse ngjanin në karrierën e tij të larmishme dhe disi të dyshimtë.

Pasi vetura doli në magjistrale, sikur ndjeva një lehtësim në shpirt. Imami e mbushi me gaz veturën derisa motori buçiti trishtueshëm duke marrë shpejtësinë e duhur. Tani,

pas përfundimit të tundjeve nëpër gropa, i çliruar, disa herë bëra përpjekje për të thyer qetësinë që kishte rënë brenda kabinës, qetësi që më mundonte. Pa dashur ta vë veten në një pozitë inferiore, nga xhami i veturës, i përmbajtur shikoja rrugën jashtë! Herë, herë më bëhej se të njëjtin mendim inferioriteti e kishte edhe Imami, prandaj priste që unë t'ia filloja bisedës i pari. Nga përvoja e gjatë me imam të ndryshëm, kam vënë re se shumë gjëra që duken të komplikuara, të pa zgjidhura, pa rrugëdalje, befas ju hapet rruga e zgjidhjes nga një qetësi rasti, nga një zemërim, sherr apo grindje, duke i kthjelluar ato nga amullia paraprake, si era që davarit mjegullën! Por, brenda kësaj kabine nuk po ndodhte asnjëra, prandaj dalëngadalë kishte filluar të më gërryente zemërimi kundër tij dhe në të njëjtën kohë i bëja pyetje vetes: Është ky Imami që më shkruante me aq entuziazëm për punën e madhe që e kishte bërë anë e kënd vendit? Është ky Imami që më kishte shkruar letra të gjata e disa herë edhe të mërzitshme duke i nxjerrë në sipërfaqe përplasjet me Hafizin dhe shokët e tij që pengonin rrugën e ndritur të selef-us-salih? Është ky Imami që më kishte njoftuar deri në imtësi për listën e gjatë të atyre besimtarëve që i kishte kthyer në rrugën e besimit të sinqertë të Hazretit Muhamed? Është ky Imami që më ftonte të kthehesha sahat e parë për t'i ndihmuar gjatë riteve dhe përzgjedhjeve të radhës me përvojën time të gjatë? Është ky Imami që më shkruante duke më njohur deri në imtësi për rritjen e tmerrshme të imoralitetit që e kishte goditur çdo shtresë të shoqërisë e veçmas rininë? Është ky Imami që me njoftonte për rrëshqitjen e zemrave të besimtarëve në xhahilijet dhe që populli po zhytej në haram dhe më ftonte t'i vija në

ndihmë që të shpëtohet nëse akoma ka ngelur ndonjë gjë për t'u shpëtuar nga zemërimi i Allahut! Vallë, pse tani heshtë?!

– Si thua, të futëm menjëherë në qytet apo të kalojmë edhe për pak përgjatë unazës periferike? – me pyeti befas Imami.

– Është koha e faljes së namazit të drekës, prandaj nuk do të ishte keq të ndalonim në ndonjë xhami këtu afër! – ia ktheva qetë përgjigjen duke kthyer kokën drejt tij.

– Atëherë po ndalojmë në Xhaminë e Sulltan Mehmet el Fatihut, ose në Çarshi Xhami siç e quan populli!

– Kam dëgjuar për këtë xhami! – ia ktheva me shikim të përqendruar jashtë dritares së veturës.

– Është xhami e vjetër, i përket shekullit të pesëmbëdhjetë! – filloi të sqaronte qetë Imami, që fliste aq mundimshëm, sikur dikush tjetër ishte duke ia nxjerrë dhunshëm fjalët nga goja! Ky zë i mekur, që nuk i përshtatej fare natyrës së tij, për çudi, sikur i shkonte për shtati këtij mëngjesi të mugët vjeshtak, qe në vetvete ngërthente zemërim!

– Nga kush udhëhiqet kjo xhami? – e pyeta kureshtar.

– Nga ata të Bashkësisë Islame! Pse?

E shikova me ironi por nuk fola! Më mirë, sikurse edhe më parë, të vazhdoj shikimin jashtë!

Që larg dallova shumë fëmijë që gumëzhinin brenda një rrethoje teli, në një oborr shkolle! Ndjeva dhembje për ata njomëzakë që ishin të detyruar të vazhdonin mësimet në këto shkolla me plan-programe komplet kaurë, pa pasur asnjë njohuri për besim e fe, për dinë e iman! Ata mësojnë matematikë, gjeografi, fizikë... e çka nuk mësojnë, duke e lënë anash me përbuzje besimin madhështor islam, besimin më fisnik, më të shenjtë, më të dëlirë e më të pasur

që ka njohur bota e njerëzimit ndonjëherë... atë besim që u hapë fëmijëve horizonte të gjëra për jetë të denjë dhe të pasur shpirtërore e materiale, që ua pastron zemrat e njoma e të mbushura përplot me idhujtari të trashëguara nga kjo shoqëri profane, e demoralizuar dhe e dalë feje! Këta fëmijë rriten të tulatur, të butë e të dëgjueshëm si zonja holandeze që nuk dinë të kundërshtojnë! Dhe kur të rritën në këto rrethana, do të çojnë jetë të ç'thurur, të zhytur në imoralitet, të dhunuar moralisht, shpirtërisht e seksualisht, të dergjur nga narkomania dhe alkooli, pa i çmuar vlerat më të larta të bashkësive familjare e fisnore duke rënë në nivelin e Edipit që u martua me nënën e tij dhe duke e thelluar imoralitetin deri në dhunimin e motrave apo vajzave të tyre! Të gjitha këto vijnë si rezultat i mosnjohjes së egërsisë lindore që po vazhdon luftën dhëmb për dhëmb, të filluar para trembëdhjetë shekujsh për ta shpëtuar njerëzimin nga fara e ndyrë jezuite që ka marrë hov së bashku me kaurët e pafe!

Për një çast mendja me shkoi tek fëmijët e atyre vendeve të bekuara ku për katër vite me radhë kisha shtegtuar duke bërë vizita të njëpasnjëshme nëpër mejtepe edhe njëherësh duke përzgjedhur talent të rinj! Si në një përkundje gjumashe më erdhi në mendje kujtimi i atyre talebanëve të bekuar, të veshur me kaftan të hirtë dhe me tërleme në kokë, të ulur pranë tavolinave të formës „X", që gjatë procesit të mësimit gumëzhinin si bletët në zgjua nga zërat e tyre të njomë duke luajtur kokat sa lartë poshtë gjatë këndimit të sureve të Kuranit Kerim! Mu kujtua mësuesi Ahmadin Al Abdul me ata sy të zi e me vështrim nazeqar, me leshra pis të zeza kur më priti për herë të parë në kasollen e tij. Pasi më bëri një pritje

të mrekullueshme, filluam bisedën rreth fesë tonë të ndritur... më falni, por as vetë nuk e di së çfarë po më shtynë tani të gënjej! Ndoshta shejtani!? Atë natë nuk biseduam fare për fe! Ai më dëshirë e hodhi bisedën rreth traditave të popullit tim, e veçmas rreth grave fytyrëzbuluara. Në fillim qe i ashpër në vlerësime duke thënë së pamja njerëzore e grave ngjallë te burrat epsh dhe dhembje shpirtërore, e sidomos nga gratë e bukura, të cilat është më mirë të mos i takosh fare në jetë, sepse të futen në shpirt si shejtani e nuk i shkoq dot! Kështu urdhëron edhe feja jonë e shenjtë... pastaj më tha: „Ja, më shih mua! Unë kam parë edhe këtu në vendin tim mjaft gra fytyrëzbuluara! Përveç time mëmë, kam parë edhe pesë tezet e mia dhe tri nuset e babës! Të them të drejtën nuk më kanë lënë ndonjë përshtypje të veçantë përveç njërës, asaj më të resë! Kur erdhi nuse në shtëpinë tonë ajo shejtane, nuk kishte më shumë së trembëdhjetë vjet, kurse unë sa i kisha mbushë të shtatëmbëdhjetat por, qesh dashuruar marrëzisht... e ndjeja së edhe ajo më dashuronte me gjithë shpirt! Ah, së si më shikonte me ato vështrimet e saj të vala prush, së si më ledhatonte kur rastiste ndonjëherë të më takonte vetëm për vetëm... së si më përqafonte... sa ëmbël më puthte me ato buzë të nxehta... por kur na diktoi baba sa nuk e mbyti atë me dajak, kurse mua më përzuri nga shtëpia! Pastaj, kam parë edhe dhjetë sosh që patën ardhur me autobus andej nga vendet tuaja për ta vizituar shkollën tonë! Që nga ajo kohë nuk më shqitën nga mendja ato bukuroshe, dhe sa herë i kujtoj mbushem me epsh! E vetmja mundësi për ta shuar atë zjarr që më përvëlon në shpirt e zemrën ma zhuritë për shkak të atyre shejtaneve, janë shoqërimet me

djelmosha të ri që po të betohem për Allah, nuk ua lënë gjë mangut as grave më të bukura të vendeve tuaja!“ Kur e vërejti së po çuditesha me tregimin e tij më tha së porsa ta provosh shoqërimin e mrekullueshëm me djelmoshat tanë do ta harrosh për fare të dashurën tuaj!

Pastaj, pasi më kishte bindur të kyçesha në ato ndjesi, sa herë që shkoja për vizitë, më priste me padurim duke m'i prezantuar djelmoshat e ri. Këto vizita i bëja për përzgjedhje dhe për të parë nga afër se si mësonin nxënësit e tij të devotshëm. Qëndroja tek ai me ditë të tëra duke dëgjuar ata zëra melankolik që i drejtoheshin me lutje Allahut xhel-le shanuhu. Nxënësit ishin të ri dhe të pashëm, të përkulshëm e të tulatur. Shpirti i tyre i vogël ishte i mësuar të jetë i nënshtruar nën vullnetin e mësuesit të tyre të devotshëm dhe nën mëshirën e Të Madhërishmit, prandaj gjatë kohës sa isha mysafir i tyre, më vështronin me shikim të ngazëllyer sikur unë isha ai që ua kisha dhuruar dashurinë dhe një grimë liri, të paktën për ato ditë sa qëndroja aty, sepse gjatë pranisë sime ishin të kursyer nga shkopi i pamëshirshëm i mësuesit të tyre të dashur. Kishte edhe nga ata që gjatë pranisë sime, nuk i kapnin dot suret e Kuranit Kelamullah, andaj mësuesi i tyre i dashur, ishte i shtrënguar t'i përdorte metodat e detyrimit por, në këto raste pakëz më të zbutura duke i goditur lehtë me shkop në kokat e tyre të rruara, vetëm sa për t'i trembur. Pastaj ata që ishin hatërmëdhenj, këndonin edhe qanin, ndërsa lotët e tyre të dëlirë ju pikonin mbi suret e shenjta të Kuranit Kerim! Kjo metodë detyrimi dukej jo humane. Kishte pasur zëra që e kishin kritikuar, por tek Ahmadin Al Abduli ata zëra të mekur nuk kishte pasur ndonjë ndikim. Ai si me qesëndi u

përgjigjej atyre; *„Po ua mësove fëmijëve Kuranin e shenjtë, i ke përgatitur për jetë, por nëse ju lë prona, para, dije e pasuri pa e njohur Kuranin Kelamullah, do të mbesin gjithë jetën të vobektë!“*

– Këtu afër ndodhët mulliri i Haxhi Zekës! Nëse ke dëshirë kemi kohë për një vizitë të shkurtër, pastaj pa humbur kohë shkojmë dhe e falim namazin e drekës në Çarshi Xhami! – tha ndërkohë Imami duke mi larguar mendimet.

Për një çast u ndjeva tepër i fyer! Aq i fyer sa gati nuk bërtita nga një hidhërim çasti, kur ma përmendi mullirin. Desha t'i hakërrehem me fjalët më vulgare që më lëviznin pa pushim nëpër bark dhe me vinin deri në maje të gjuhës për të dalë jashtë... pastaj ta godisja pa mëshirë me grusht fytyrës dhe trupit! Për çfarë më pandeh ky mua, për Don Kishot? I lashë ato vende të bekuara për të parë mullinj këtu? Jo Imam i dashur, jo! Me mua jo! Nuk kam ardhur këtu për të parë mullinj edhe me ujë qofshin ata, por kam ardhur të shoh se deri ku keni arritur ta pushtoni kolltukun dhe arkën e stërmbushur të Bashkësisë Islame, deri ku i keni kthyer besimtarët në fenë e vërtetë të Hasretit Muhamed selamu alejkum, deri ku keni arritur t'i çlironi xhamitë që i mbajnë të pushtuara ata qafirë të tipit Hafiz! Për këto më ftove e për këto erdha, kurse tani pa pikë turpi më drejton drejt mullinjve! Por ndërkohë, zëri i arsyes i prirë nga meleqet më thoshte të kisha durim... sabër selamet! Rashë shahadet!

– Jo, jo! Me dëshirë do ta vizitoja ndonjë xhami që ndodhet në duart tona... dua të them xhami që ndodhët në duart e xhematit tonë selef!

– Si?! Xhami që ndodhët në duart e selefinjëve? – më pyeti i hutuar.

– Po! Pse çuditësh? – ia ktheva me nervozë sa mezi e përmbaja veten.

– Si pse? Po, ku ka xhami të tilla? Të gjitha udhëhiqen nga ata qafirët e Bashkësisë! Pse, si mendove ti, se ne i kemi çliruar nga dora e tyre? Jo i dashur Çelë! Sikur të ishte ashtu, ne nuk do ta kishim nevojën ty hiç! – ma ktheu duke i zgurdulluar sytë si hut.

– Jo Çelë, por Abdallah!

– Më fal Abdallah!

– Do të thuash se ne nuk kemi asgjë në dorë? – e pyeta me zë të butë.

– Nuk dua të them, por mjerisht ashtu është, se ne, vërtetë, nuk kemi asgjë në dorë!

– Hiç?

– Jo, hiç... përveç parave dhe disa besimtarëve ngatërrestarë!... kemi edhe disa myezinë, ja si këtë që do ta takojmë sot...

– Pse më ftove atëherë? – e ndërpreva duke e ndrydhur dhunshëm atë zërin nervoz që më lëvizte pa pra së brendshmi!

– Si pse të ftova? Për çlirimin e xhamive pra! Çështë e vërteta, ne kemi disa imamë, disa myderrizë dhe myezinë që kanë dorë në udhëheqjen e disa xhamive, por besimtarët nuk ju binden riteve të tyre, bile as që guxojnë t'i shpalosin ato kur në xhami xhemati është i shumtë, sepse do të ndëshkohen prej tyre! Prandaj duhet shumë punë, shumë përkushtim... për të mos thënë duhen shumë para për t'i thyer ata qafirë! Ka disa prej besimtarëve që i kanë pranuar ritet tona, por ka edhe nga ata që nuk duan t'i pranojnë dhe vazhdimisht këmbëngulin në metodat e vjetra duke bërë çmos që këta tanët t'i përjashtojnë

nga xhamitë duke i quajtur padrejtësisht ekstremistë në praktikat e fesë islame! Pastaj fillojnë ngatërresat, sharjet e ndërsjella deri të rrahjet masive! Gjithmonë ne mbesim fajtorë, jo vetëm para xhematit, por edhe para hyqymetit, sepse ata të drejtësisë po thonë se ligjet në fuqi nuk i kanë paraparë këto rite. Por mos të harrojmë se ka edhe nga ata që i ushtrojnë ritet tona aq sa bëhet pagesa, pastaj, po s'pate para, ata kthehen në gjendjen e mëparshme!

– Sikur nuk më keni njoftuar më parë për këto marifete? – e pyeta sa i çuditur aq i revoltuar, dhe në mendje me erdhi Ahmadin Al Abduli me metodat e tij të detyrimit!

Vetura u gjend në një park të madh. Pasi Imami e parkoi veturën, morëm drejt një rrugice të ngushtë që gumëzhinte nga njerëz të shumtë. Në të dy krahët kishte tezga të shumta të mbushura plot e përplot me mallra të ndryshme. Tregtarët thërrisnin me zë të çjerrë; mall me kualitet të lartë, stofra nga Stambolli, enë porcelani kinez, aparate amerikane, kompjuterë japan, celular gjerman... Kaluam në një shesh të gjerë dhe u gjendëm përballë Çarshi Xhamisë. Aty morëm abdes. Gjatë kohës kur isha duke e larë kokën e rruar taze, hetova se jo vetëm xhemati, por edhe kalimtarët e rastit që endeshin përgjatë pazarit, vëngëronin drejt nesh sikur ne të kishim zbritur nga një botë tjetër! Vura tërlemen dhe pa qarë kokën për çudinë e tyre u gjendem në xhami. Duke u përvjedhur skajit të djathtë sikur të kishim hyrë aty për të vjedhur e jo për lutje, zumë vend në radhën e rrallë që nuk kishte më shumë se pesëmbëdhjetë apo njëzet burra. Një plak që rastësisht mu gjend pranë, filloi nga lutjet para se të ketë filluar hoxha. E shikova vëngër! Ai edhe kotej edhe falej. Në çast e luta me gjithë shpirt Allahun që të ketë

mëshirë për këta besimtarë të dalë feje, dhe aty për aty mendova se duhej përshpejtuar përpjekjet tona për t'i dalë në ndihmë këtyre besimtarëve të vrarë shpirtërisht nga dora profane! Pas një qëndrimi në të njëjtën pozitë, sikur në skajin e mendjes zuri vend si një gozhdë shpata e Profetit... dhe me vete thashë: Vetëm ajo i sjell në din këta qafirë që janë vënë në gjumë kur rrinë zgjuar kaurët.

Pas faljes së namazit, hoxha u kthye nga xhemati. Me një vështrim të përhumbur që e vërtiste rreth e qark duke e ndaluar për disa çaste mbi mua, por si e hetonte shikimin tim drejt tij, e largonte vështrimin nga unë për të ma hedhë në një moment tjetër! E hetova se ai qafir kishte filluar një lojë të rrezikshme pa e llogaritur përfundimin e saj! Ai nuk e dinte se provokimet e tilla tek unë ishin të papranueshme! Sa i pata mërzi ato shikime dinake! Shyqyr, thashë me vete, kur ai filloi të fliste. Fjalët e tij të ndara në rrokje, sikur merrnin ngjyrim belbëzimi.

– Në qitapin e vjetër, të quajtur Ahval ul Kiamet, kam lexuar se si do të përmbyset bota ditën e kiametit. Prandaj, sot do t'u flas për të ligat që njeriu i bën në këtë botë, kush i nxitë dhe për ç'arsye njerëzit bëjnë keq, për të cilat do të përgjigjet në ditën e gjykimit! Shejtani vëllezër, është një gjë e padukshme, abstrakte, që i futet njeriut në trup e në shpirt duke i bërë trysni të vazhdueshme për të bërë keq! Por, dikush nga ju do të pyet; pse shejtani i yshtë njerëzit të bëjnë vetëm keq? I yshtë sepse është betuar para të Madhërishmit! Kur Allahu xhel-le shanuhu, e krijoi njeriun nga dheu dhe i fryu duke i dhënë shpirt nga shpirti i tij, kërkoi nga shejtani dhe meleqet, që t'i përuleshin me bindje e nderim krijesës së tij të përsosur! Meleqet ju binden thirrjes së Allahut dhe u përulën para

njeriut, kurse shejtani, nga xhelozia, nuk pranoi përuljen, duke thënë se njeriu është krijuar nga dheu, kurse unë jam nga zjarri, prandaj nuk i përulem kësaj krijese të brishtë! Allahu, këtë veprim të guximshëm të shejtanit e quajti krenar, por e urdhëroi të zbriste menjëherë nga parajsa duke i thënë se ty nuk të takon ta shpalosësh këtu madhështinë që pretendon se e ke! Duke e parë rrezikun që i kanosej, shejtani e luti Allahun e Madhërishëm që ta lejonte të jetonte deri në ditën e kiametit, pra deri në ringjalljen e të vdekurve dhe ditën e gjykimit. Dhe Allahu i Madhërishëm, i dha jetë shejtanit deri në ditën e kiametit. Edhe kësaj radhe shejtani u tregua mosmirënjohës dhe i pakënaqur ndaj Allahut xhel-le shanuhu. Pasi e kishte fituar përjetësinë nga Allahu, u betua se deri në ditën e kiametit do të mashtronte sojin e Ademit selamu alejkum, të porsa krijuar nga Allahu xhel-le shanuhu, duke e yshtur sojin njeri që të bënte sa më shumë të këqija gjatë jetës së caktuar nga Allahu. Atëherë, Allahu xhel-le shanuhu, ju kishte përgjigjur shejtanit se edhe unë nuk do të reshti së dërguar në xhehenem ato krijesa të sojit të Ademit që do të bien pre e mashtrimeve tuaja! Kështu, shejtani filloi nga puna e tij e keqe duke u hyrë në bark e shpirt krijesave të Allahut për t'ua prishë mendjet dhe për t'i kthyer nga rruga e besimit në Allah, në rrugën e besimit në idhuj apo në mosbesim. Këto tundje kanë filluar prej asaj dite kur krijuesi i të gjitha botëve e bëri botën tonë, e bashkë me të edhe njeriun dhe do të vazhdojë pa ndërprerë deri në ditën e kiametit! Mirëpo, këtu ka një dallim! Paraqitjet e shejtanit nuk kanë qenë dhe as që do të jenë të njëjta sikur ato të fillimit, me këto që vazhdojnë sot dhe të atyre që do të vijnë në të ardhmen!

Disa imam të kënduar kanë thënë se shejtani ka njëfarë marrëveshje me të Madhërishmin, gjoja për t'i ndihmuar të Plotfuqishmit për t'ua pështjelluar mendjet njerëzve për të bërë keq, të cilët pa vetëdije fillojnë të bëjnë të liga duke thënë se vetëm ne jemi në rrugën e drejtë e të denjë të Lartë-Madhërishmit! Këta njerëz me dinin në gojë e shejtanin në bark kanë pushtuar botën me paudhësitë e tyre! Ndodhen edhe në mesin tonë! Të mirat e Allahut i marrin pa ngurrim, dhe asnjëherë nuk gabojnë e as nuk falënderojnë, kurse të këqijat thonë se i bëjnë nga dobësitë e tyre duke i përjashtuar përfundimisht yshtjet e shejtanit që ju lëvizë pa pra nëpër bark! Thonë se njëfarë imami që nuk ka më shumë se dyqind vjet që ka ndërruar jetë... dhe shpirti i tij gjettë prehje në xhehenem, paska bërë hutbe në fenë islame sikurse hasreti Muhamed në kohën e tij duke e sfiduar Kuranin Kelamullah dhe vetë Allahun e Madhërishëm! Duke e quajtur veten selef-us-salih, pra paraardhës i devotshëm i Profetit!... Pasardhësit e këtij farë imami thonë pa ngurrim së; ne i lutemi Allahut ashtu siç ju kishte lutur hasreti Muhamed dikur, ne jetojmë në skamje dhe ndershmëri si hasreti Muhamed dikur, ne vishemi thjeshtë e me modesti me atë stil rrobash që i kishte veshur hasreti Muhamed dikur, ne mbajmë mustaqe të shkurtra e mjekra të gjata, dhe i rruajmë kokat sikurse hasreti Muhamed dikur, ne martohemi me hyritë e detit ashtu siç ishte martuar hasreti Muhamed dikur, ne pimë ujë nga kroi i Kërtherit ashtu siç kishte pirë hasreti Muhamed dikur... dhe unë i pyes këta sfidues të Allahut: – ku e diti ai imam që ka jetuar para dyqind vjetësh se si ka jetuar hasreti Muhamed njëmijë e dyqind vjet më parë? Ku e dinë këta sot se si i

ka bërë ritet hasreti Muhamed njëmijë e katërqind vjet më parë? Këta prijës të vetëshpallur të fesë islame bëjnë hapur shirk duke e sfiduar Allahun xhel-le shanuhu, dhe Kuranin Kerim? Këta sfidues, me ritet dhe mësimet e tyre të yshtura nga shejtani, janë bërë tmerri i botës së sotme islame por edhe më gjerë! Prandaj vëllezër, t'i lutemi Allahut që sa më shpejt t'ua tregojë rrugën e ndritshme të hasretit Muhamed nga shpirtrat e xhindosur të kësaj fare idhujtarie! Eudhu bil-lahi minesh shejtanir rraxhimë! Bismil-lahir Rrahmanir Rrahim!

Pas disa lutjesh me zë të ulët që unë nuk mora pjesë, u dëgjua zëri i hoxhës:

– Amin!

– Amin! – u dëgjuan disa zëra të shkapërderdhur nga ana e xhematit.

Gjatë gjithë kohës sa kishte folur hoxha, vetëm unë dhe shpirti im i trazuar e dimë se ç'hoqëm për ta mbajtur shpërthimin e sigurt kundër tij dhe fjalëve të tij hipokrite. Ishte hera e parë pas kthimit nga ato vend të shenjta që po ballafaqohesha me këta sfidues kokëkrisur. Herë pas here i mbështillja leshrat e gjata të mjekrës rreth gishtit tregues e i tërhiqja me forcë për ta përqendruar vëmendjen të dhimbjet e mjekrës e jo të dhembjet e shpirtit nga ato fjalë të turpshme e profane, dhe për ta arsyetuar mosshpërthimin e sigurt që më vlonte përbrenda si vullkan i valë prush. I dëgjoja fjalët profane të hoxhës dhe herë pas here mendoja se edhe këta hipokritë do të ndëshkohen nga Azraili që merr shpirtra, duke u shkaktuar dhembje, duke i rrahur para e prapa dhe duke i njoftuar për zjarrin që i pret në xhehenem! Isha i sigurt se edhe vetë Allahu me mëshirën e tij të madhe, pasi

do t'i ketë dëgjuar këto fjalë mohuese do të heqë dorë prej mëshirës së tij ndaj tyre, dhe vrasja, masakrimi e shkatërrimi i tyre do të përligjet edhe nga vetë Madhëria e Tij!

Pas një shikimi majtas e djathtas, sikur isha duke dhënë selam, e theve heshtjen me zërin tim të regjur për raste të tilla jo favorizuese. Duke e ndrydhë atë zërin e brendshëm që e mbaja dhunshëm në gji dhe që herë pas here me yshtte të shpërtheja me gjithë zemërim, fillova bisedën me lutjen hyrëse;

– Lailahuilallah, Lailahuilallah, Lailahuilallah! Vëllezër! Nuk është aspak e ndershme që një hoxhë si ky këtu, që nuk ia di as emrin... dhe dashtë Allahu e mos ia mësofsha kurrë, sepse edhe unë mund ta humbi dinin dhe imanin për shkak të emrit të tij të zhgërryer, qoftë larg meje! Pfu, pfu, pfu! Amin! Është e padrejtë që të alarmohet ky xhemat, që unë me plot kuptimin e fjalës, do ta quaj xhemat kërrutë, që po i prinë ky malukat, pfu, pfu, pfu, mos qoftë nga goja ime... pra është e padrejtë të alarmohet xhemati se gjoja mjekra ime synet, veshja, shalli dhe tërlemja ime stil lindor po ua prishka të tjerëve rehatinë, besimin dhe ardhmërinë e fëmijëve të tyre? Nga mësimet e imamëve dhe dijetarëve të tjerë islam, të cilët me këshillat e tyre modeste tentojnë që jetën e tyre private ta jetojnë më devotshmëri e pastërti islame siç e kishte jetuar Profeti Muhamed dikur, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, që pretendon thjeshtësi dhe dashuri për besimtarin e devotshëm dhe flijues, gjëra që janë të shkruara edhe në Kuranin Kelamullah! Çdo veprim, duke filluar nga veshjet e deri të lutjet, janë të përzgjedhura vetëm sipas shijes së Allahut ashtu siç ia

kishte kumtuar Profetit të tij, Muhamedit selamu alejkum. Prandaj, ne që po na deklasoni me lloj–lloj epitetesh, ne që po na fajësoni për gjynahet tuaja që i keni bërë dhe që vazhdoni t'i bëni përditë, ne që po na akuzoni për dështimet tuaja morale, fetare e shkencore... ne pra, jemi pjesa më e çiltër e besimit islam në gjirin e këtij populli, jemi pjesa më patriotike, më e pastër dhe më e devotshme jo vetëm në fushën islame por edhe në atë kombëtare e politike! Ne e sakrifikojmë veten tonë në varfëri e mjerim vetëm për sevap të Allahut xhel-le shanuhu. Në gjirin tonë kemi të rinj e të reja të pastra si loti. Ne nuk rrejmë, nuk vjedhim, nuk mashtrojmë, nuk korruptohemi e as nuk korruptojmë, jemi atdhetar të flaktë, nuk ia bëjmë të padrejtën mikut, bile as armikut... ne nuk rrahim kënd, nuk plagosim e as nuk vrasim pa nevojë e pa të drejtë... por, në anën tjetër, ne nuk na dhimbset vetja e as jeta për Allah, për din e iman e për islam! Prandaj vëllezër...

– Do të thuash se kur keni nevojë dhe të drejtë ju vrisni? – me pyeti hoxha duke ma ndërpre bisedën, njëherësh edhe fillin e mendimeve, sepse kisha shumë për të folur, me argumente e fakte të bollshme!

– Po! Kur të kemi nevojë dhe të drejtë ne vrasim!

– Ku e dini ju paraprakisht se kur keni nevojë dhe të drejtë të vrisni? – pyeti prapë i paudhi.

– Po na tregoni ju çdo ditë se kur, ku, si dhe kë duhet vrarë!

– E dini ju, se me Kuran ndalohet vrasja? – ma shtroi pyetjen që e prisja.

– E dini ju se me Kuran ndalohet krijimi i idhujve? – ja ktheva me kundër pyetje në vend që t'i përgjigjesha.

– Do të bënit mirë ta lironi xhaminë time, sepse po kam frikë së po ma infektoni xhematin me këtë flamë haram!

– Nuk është flamë, por është besimi më i drejtë që e ka lënë me gojën e tij Profeti Muhamed selamu aljejkum. E sa për ta liruar xhaminë siç po kërkon ti, tani për tani nuk e kemi ndërmend, sepse kemi udhëtuar me orë të tëra për t'i ardhur në ndihmë këtij xhemati të mrekullueshëm dhe për ta shpëtuar njëherë e përgjithmonë nga dergja juaj profane!

– Harrove se pak më parë pikërisht këtë xhemat e quajte kërrutë, kurse tani po e mrekullon? Cilës teori tuaj duhet t'i besojmë ne? – me pyeti befas, dhe për një çast me zuri ngushtë, por me ndihmën e Allahut ndërkohë mu kujtua përgjigjja;

– Këta përzgjedhin vetë: Nëse i lutën Allahut pas jush, janë dhe do të mbetën xhemat kërrutë dhe do të jenë të përjashtuar nga mëshira e të Lartëmadhërishmit! Nëse kthehen në rrugën e vërtetë të paraardhësve, këta do të mrekullohen... që tani do t'i kenë xhepat plot para dhe derën e xhenetit të hapur në botën tjetër! Zgjidhni! Doni para? Doni jetë të lumtur në këtë botë? E doni xhenetin në botën tjetër? – ju drejtova xhematit i bindur se i kisha thyer moralisht dhe shpirtërisht, dhe shumica do të vinin pas meje... pas parave të premtuara, pas xhenetit! U ngrita në këmbë me shpresë se do të me ndiqnin pas, por në pabesi ndjeva se dikush nga prapa ma përdrodhi dorën duke me përulë me kokë poshtë sa nuk më preku në qilim dhe ashtu zvarrë, me dhembje që mezi i duroja, më shtyu drejtë derës. Ndjeva edhe disa shqelma vitheve dhe e pashë veten që u përplasa jashtë derës, nëpër shkallët e gurta! Derisa u çova në këmbë, pashë se e njëjta gjë i kishte ndodhur edhe Imamit, të cilit ia dhanë edhe disa grushte fytyrës sepse u përpoq të kundërsulmonte, dhe

e përplasën pranë çezmës së abdes'hanës. Imami filloi të çohet ngadalë duke e mbuluar syrin e djathtë me dorë, kurse nga hundët pa ndërpre i rridhte gjak! E lau gjakun, me ujin e çezmës së abdes'hanës që e kishte afër. Në derë kishin qëndruar disa të rinj trupmëdhenj duke na shikuar me inat. U afrova dhe i mora këpucët. Krejt ngadalë fillova t'i mbathë. Kur e pashë se Imami trup gërmuq u largua, shumë më shpejtë se ç'e prisja, vetëtimthi arrita t'i marr disa palë këpuca dhe me hidhërimin më të madh që e ndjeja në shpirt i hodha tutje, disa në ujë pranë çezmës, disa matanë murit në rrugë, duke i goditur pa dashje kalimtarët e rastit. Kur e pashë se do të me sulmonin prapë ia dhashë vrapit dhe u gjenda në mesin e njerëzve në midis të pazarit!

Kur u gjenda pranë veturës, pashë imamin që ishte futë brenda dhe po më vështronte me sy të zgurdulluar. Mollëzën dhe syrin e djathtë i kishte të nxira. Hundën të përgjakur dhe të ënjtur. Derisa po i kujtoja trimëritë e tij të krisura, që po të mi kishte thënë dikush nuk do t'i besoja së vërtetë Imami ishte një shok që nuk të lë për asnjë çast në baltë, me pyeti:

– Ku e ke tërlemen?

– Tërlemen? Me paska rënë pa e ndjerë gjatë përleshjeve me ata qafirë – thashë me zë të përvajshëm nga dhembja për të, dhe instinktivisht dorën e vura mbi kokën e rruar... e kisha kujtim nga mësuesi Ahmadin Al Abduli.

– S'ke ç'bën!... Ah, sikur t'i kisha këmbët tuaja të lehta...

– Çka? Boll të lehta i kishe... ike si lepur!

– Vërtetë ika si lepur, por pasi nuk i pata me vete nja dy kokrra dardha e t'ua dhuroja bakshish...

– Atyre qafirëve a? Një, kishte me ju dalë boll...

– Ashtu? Një e kam të fshehur në gepek!

– Vërtetë? Atëherë ç'presim pra? Eja e t'i çojmë në erë edepsëzët!

– A, jo? Rregullat e luftës sonë nuk janë kështu! Në raste të tilla, ai më i përgatituri duhet t'i sulmojë kurse tjetri duhet të jetë i gatshëm për ikje, për zhdukje gjurmësh. Prandaj... – më tha duke dalë nga vetura.

Pas disa rrapëllimash prapa në veturë, u kthye dhe zuri vend në ulësen e vet. Në dorë kishte një gjë të mbështjellë me beze të bardhë. Pasi e vërtiti vështrimin majtas e djathtas, uli duart poshtë duke larguar napën. Në dorën e tij u shfaq një bombë dore.

– Pasi ta kesh marrë tërlemën, kështu të mbështjellë me napë, hiqja siguresën, hidhejau brenda, mbylle derën dhe ikë me vrap. Në gjendje gatishmërie të pres pranë derës! Qartë? – tha duke me vështruar me dyshim dhe njëherësh ma lëshojë në dorë bombën.

– Si urdhro!

Ra celulari. Krejt ngadalë e nxori nga xhepi dhe e hapi duke shtyp sustën. Në mënyrë elegante e vuri pranë veshit të majtë. Buza e epërme, me një pikë gjaku të ngrirë sipëri ju kishte ënjtur. Sytë e nxirë nga të goditurat e grushteve të atyre qafirëve i mbante të ngulur në një pikë të pacaktuar në horizontin e ngrirë gri. Fytyrën e kishte jashtëzakonisht të zbehtë. Për një çast mu bë se po ta prekje nga hunda do t'i dilte shpirti! Vallë në cilën pjesë të trupit e ka shpirtin tani?

– Po! Rrugës jam... po, e kam edhe Abdallahun me vete! Si urdhëro! Po, po! Më se largu për gjysmë ore do të jem atje. Alejkum selam!... po na presin për drekë! Shkojmë?

– Po tërlemen... sulmin...? – e pyeta me neveri, sepse e

pashë se nuk e kishte ndërmend ta qante kokën për ato që m'i tha pak më parë.

– Shko! – më tha duke më shikuar me një vështrim mëshirues dhe vazhdoi: – Nëse do të ndodhë diçka, ti do të shpallesh shehiti i parë vehabi! Paç fat vëlla mysliman!

I vendosur dhe me turr dola nga vetura.

Porsa hyra në xhami, pashë se kishte ngelur vetëm hoxha me nja dy tre pleq. Porsa me pa, me plot frikë kthej kokën nga unë duke me thënë:

– Ja ku e ke tërlemen. Merre, të dhjefsha në të!

– E dhjefsh çallmën tënde, edepsëz! – ia ktheva derisa isha duke e vënë në kokë dhe po mendoja së nuk ia vlen të hidhet një bombë për dy tre pleq qorra e sakata! Pa e shikuar fare atë mut dola jashtë.

– Kishin ikur të gjithë! – i thash Imamit derisa po hyja në veturë!

Pasi zura vend mirë në ndenjësen time, desha t'ia kthej bombën e mbështjellë me napë të bardhë ashtu siç ma kishte dhënë, kur më tha egër:

– Le aty! – dhe mrrolshëm e drejtoj gishtin nga kasaforta

Në heshtje e zbatova urdhrin e tij.

Në kabinë dëgjohej vetëm zhurma e lehtë e motorit. Disa herë i vodha me bisht të syrit buçkat plot mrrola të Imamit. Fytyra i dukej si e mbështjellë me një aurorë zbehtësie dhe më bëhej se nga çasti në çast do t'i dilte shpirti nga ato vrima të gjëra të hundëve që akoma vazhdonin të turfullonin nga zemërimi! Vetëm tani fillova t'i përforcoj bindjet e mia për ekzagjerim faktesh nga ana e tij, kur më shkruante në ato letrat e tij të gjata. Realitetin që e pashë dhe e përjetova me shqelma bythëve ishte në kundërshtim të plotë me ato që m'i

kishte shkruar ai. Njerëzit nuk ishin të hareshëm dhe të afërt siç i kisha lënë para katër vitesh. Kishin një dozë të tepërt zhgënjimi që kishte ndikuar në demoralizimin e tyre. Të gjithë të njohurit që i kisha takuar dhe i takoja, se ç'kishin një vështrim ndryshe, një pamje ndryshe, një bisedë ndryshe nga ato që i kisha lënë në mesin e tyre para katër vitesh. Dukej se ishin bërë lakmitarë të mëdhenj, llupës të pangopshëm dhe pa punëtorë! Në çdo vend ku isha, nuk ngurroja së treguari se: po u lidhët si mishi me kockën në rrugën e madhërishme të Allahut, çdo gjë në këtë botë të rreme do ta keni më të lehtë! Do të mësoheni të jetoni në thjeshtësinë më të madhe, duke ëndërruar me ëndje begatitë e të mirat e rrejshme të kësaj bote, dhe begatitë e vërteta e të bollshme të botës tjetër, pra xhenetin që Allahu ua ka përgatitur paraprakisht atyre që janë të devotshëm në rrugën e tij në këtë botë!

Tundjet e veturës në një rrugë fushore që kishte marrë drejtimin e një bjeshke të lartë që shtrihej si gungë madhështore para nesh, më larguan nga kujtimet duke më kthyer prapë në realitetin e hidhur. Disa herë radhazi e mendova me vete edhe pse nuk e fola më zë, se në mua nuk kishte mbetur asnjë grimë entuziazmi për të bërë përpjekje tua mësoja fenë e shenjtë të hasretit tonë të Madhërishëm këtij populli të humbur e të pa perspektivë, e aq më pak të tentoja t'i ktheja në kohën e ndritur të paraardhësve! Në çast, fare pa dashur në mendje më erdhën mësimet e Profetit në kohën e tij dhe bëra krahasim! Dallimi ishte i madh. Ai fenë e madhërishme e kishte praktikuar duke udhëtuar nga një vend në tjetrin herë me deve, herë me gomar apo me kalë dhe këmbëzbathur duke kapluar male të thepisura me gur

e shkrepa, lugina me rërë e pluhur shkretëtirash, pranë oazave të rralla ku e kishte shuar etjen dhe kishte pushuar nën hijen e palmave derisa kishte arritur t'ua mbushte mendjen jo vetëm besimtarëve të devotshëm, por edhe idhujtarëve... dhe i kishte kthyer në fenë e vërtetë, në dinë e iman, për të besuar vetëm në një Allah... kurse unë? Unë rrugën e kaloi më veturë luksoze të projektuar dhe të ndërtuar nga kaurët e pafe, ushqim dhe ujë pi kudo që të dua, bëjë gjumë të rehatshëm pa më pickuar as morrat e as pleshtat... dhe i lutem Allahut të ketë mëshirë për gjynahet që po i bëj duke rënë në luksin kaur! Për një çast mbetëm i nemitur, dhe e pyes veten: Vallë, a jam unë në rrugën e drejtë të Allahut? A jam në rrugën e drejtë të paraardhësve?, dhe aty për aty e gjej përgjigjen: jo! As unë nuk jam në rrugën e drejtë... as ata që thonë se janë dijetarët më të mëdhenj islam nuk janë në rrugën e drejtë! Ne sot, pra si unë këtu e si ata që jetojnë në ato vende të shenjta nga lindi rrezja e parë e dritës hyjnore islame, punojmë dhe udhëtojmë me makineri që i shpikën dhe i ndërtuan mendjet kaure e të pafe, pa na shkuar fare në mendje se këto gjëra duhej zbuluar nga islami, nëse jo nga islami, nuk duhej zbuluar fare... po mirë, ja që u zbuluan nga kaurët e pafe, të paktën nuk duhej pranuar nga islami por... i pranuan faqezinjtë!

– Erdhëm! – tha Imami duke e fikë motorin.

Jashtë ishte ftohët. Disa fjolla të rralla bore vërviteshin përtueshëm nëpër hapësirë derisa zinin vend në tokën e ngrirë. Vetura jonë kishte ndaluar pranë një rrethoje teli. Matanë dukej një shtëpi e re paksa e vetmuar nga ato të lagjes që ndodheshin tutje. Të lehurat e një qeni idhnak nuk pushonin. Në derë u pa një djalë i ri mjekërkuq.

Me buzën në gaz u nis drejtë nesh. Foli diçka, por nuk i shkoqëm fjalët për shkak të lehurave të shpejtuara të qenit i cili tundej e shkundej në zinxhirët e tij me gjithë egërsinë e vet. Disa herë i bërtiti qenit të pushonte. Me bishtin nën shalë filloi të rrotullohej sa majtas sa djathtas duke na shikuar me egërsi dhe herë pas here ngërdhucej. Pasi u përshëndetëm me të riun, u gjendem në një korridor të gjerë e të errtë! Aty në këmbë na pritën edhe katër të tjerë, që të gjithë nga tanët. Pas përshëndetjeve të radhës u gjendëm në një dhomë të rregulluar me shije. Zumë vend në një divan, pranë një tryeze të ulët. Përballë nesh zunë vend njëri pas tjetrit. Të gjithë ishin selef, të sojit tonë! Zemra m'u bë mal! Pranë murit përballë, ishte një vitrinë me dyer të rënda xhami ku dalloheshin lloj-lloj librash. Brenda xhamit të mesëm pashë Kuranin që e kishin vendosur ballas si të ishte gjë dekorative. Në mendje mu feks Hafizi, tani më i ndjerë, që kishte thënë se Kurani do të mbahej nëpër vitrina xhamash si gjë dekorative e jo për t'u lexuar! Sa tmerr!

– Këta të tre janë vëllezër, kurse ata dy janë kushërinj të afërm, – filloi Imami nga prezantimi në lidhje me familjen mikpritëse, – Janë njëra nga familjet e rralla, që kanë një trashëgimi të shkëlqyer fetare. Babai i tyre kishte qenë mjek, dhe njëherësh i ndjekur nga regjimi. Kishte qenë i burgosur, për çështje fetare...

– ... për çështje atdhetare e politike, po ku ka pasur të burgosur fetarë pashë Zotin?! – ia ndërpreu fjalën një zë femre.

Instinktivisht ngrita vështrimin. Në atë gjysmerrësirë pashë një vajzë shtatlartë, me një tabaka të madhe në dorë duke ardhur drejtë nesh.

– Është motra e tyre, Albana e quajnë! – tha njëri nga të pranishmit, që ishte gërmuqur mbi një stol përballë nesh, që mua m'u duk si të ishte njëri nga shtatë shkurtabiqët e përrallës.

Me një buzëqeshje të ëmbël, që shprehte dashamirësi vazhdoi të fliste Albana:

– Baba, ndjesë pastë, nuk ka qenë asnjëherë i burgosur për çështje feje, sepse virtytet fetare islame nuk e kanë cenuar asnjëherë politikën shoviniste serbomadhe, bile përkundrazi, e kanë ndihmuar, sepse hoxhallarët tanë në ato kohëra kanë thënë, bile edhe tani thonë së nga feja ortodokse, myslimanet i ndanë një tis i hollë sa cipa e qepës... katolikët janë ata që e bastardojnë dhe e shkatërrojnë fenë islame... më falni por nuk dua të flas për këtë çështje! Në rininë e tij të hershme, baba kishte përqafuar idetë komuniste. Me fillimin e luftës së dytë botërore me iniciativën e tij ishte formuar i pari formacion partizan në këto anë! Kishte shërbyer në poste të ndryshme. Ishte burgosur gjatë aksionit famëkeq të Byrosë Informative. Pas vuajtjes së dënimit ishte kthyer në shtëpi. Nuk e kishte gjetur askënd. Nëna dhe gruaja e tij, që i kishte lënë shëndosh e mirë në shtëpi, për shkaqe sëmundjesh e skamje kishin vdekur. Kishte marrë vendim se nuk do të martohej, por do të vazhdonte studimet. Për shpenzimet e nevojshme, e kishte shitur një pjesë të trojeve, ja ato vise përballë nesh që janë fare pranë xhadesë. Me ato para i kishte vazhduar studimet për mjekësi në Beograd, dhe pas rreth pesë apo gjashtë vitesh ishte kthyer me diplomën e mjekut në xhep. Kishte shërbyer në një ordinancë në qytezën e vogël këtu afër. Aty kishte rënë në kontakt me nënën time,

dhe në moshën pesëdhjetë e pesë vjeçare ishte martuar për të dytën herë. Jemi katër vëllezër e një motër! Vëllai i madh punon dhe vepron në Gjermani, kurse këta të tre, edhe pse i kanë përfunduar shkollat e mesme dhe disa kurse shtesë, aktualisht ndodhen të papunë! Unë kam titullin profesor historie dhe punoj në një shkollë këtu afër!... Më falni se e zgjata pak tepër, mirëserdhët! – tha në fund duke lëshuar tabakanë e mbushur me pije dhe gota mbi tryezën e ulët. Nuk na e zgjati dorën, sigurisht se i dinte huqet tona, por gjatë gjithë bisedës e vërejta së për asnjë çast nuk m'i shkoqi sytë. Kësaj radhe nuk e pata fare mërzi shikimin e saj!

Derisa ajo fliste me vete po mendoja se ishte mëkat i madh që një vajzë si kjo të qëndronte në anën e atyre që nuk besojnë në Allah e në dinë e iman! Është mëkat i pafalshëm! Kjo duhet të jetë e thyeshme. Duhet pasur kujdes dhe me këmbënguljen e vëllezërve selef-us-salih, ta kthejmë në besimin tonë të ndritur!

– Ju lutem, është koha e drekës, prandaj urdhëroni andej nga kuzhina! – tha Albana duke u rishfaqë para nesh.

Gjatë gjithë kohës sa zgjati dreka si nuk pushuan së foluri në mes tyre dhe Imamit. Nuk e di pse me erdhi një mendim i çuditshëm derisa isha duke i shikuar ata të ulur gërmuq në radhë pranë njëri tjetrit me mjekra të gjata e tërleme të bardha në kokë! Instinktivisht i numërova. Me mua ishim rrafsh shtatë veta dhe Albana që rrinte në këmbë duke na shërbyer... e madhe, e hijshme, shtathedhur... *ne, shtatë shkurtabiqët, derisa po drekonim, Borëbardha qëndronte në këmbë me shtambën e ujit në njërën dorë, e në tjetër mbante gotën e mbushur...* – O Allah, gati sa nuk thirra me zë të lartë nga një shkrëndje çasti! U

ndjeva i lumtur sikur t'isha çliruar nga një fanitet, nga një ëndërr syçelë... Me vështrim të ngadalshëm i shikova të gjithë me radhë duke e ndal vështrimin e valë prush mbi fytyrën e hijshme të Borëbardhës... më falni, të Albanës, e cila e ndjeu peshën e shikimit tim dhe sikur i dogji, e uli kokën poshtë! E la shtambën mbi tryezë dhe doli! Ajo, edhe pse fshehurazi kisha dëshirë ta kundroja bukurinë e saj, nuk u duk më. Biseda e Imamit, e niveluar me të tyren, që nuk kishte asgjë të mençur e fisnike brenda atyre llomotitjeve të pambarim, kishte rënë në nivelin më të ulët që mund të mendohej. Pa asnjë arsye e merrnin nëpër gojë Profetin e Madhërishëm dhe përpiqeshin ta imitonin se si kishte ngrënë bukë në kohën e tij, jo vetëm në rrethin e tij familjar, por edhe në mesin e miqve, dhe e sollën aq afër bisedën sa gati nuk thanë se ne, bashkë me profetin, derisa po drekonim, hyzmet po na bënte një vajzë e bukur fytyrëzbuluar, dhe jo e fshehur pas perdes siç e kërkonte nderi islam! Disa herë në heshtje të plotë e luta Allahun që të këtë mëshirë për këto krijesa të mjera, dhe zgjodha një dua nga surja Ali Imran. Në fillim këndova në heshtje dhe me afsh, por kur e pashë së përqendrimi i vëmendjes në këndimin e duasë nga ana ime nuk ua tërhoqi aspak vërejtjen, e këndova edhe njëherë me zë të lartë duke ju dhënë të kuptonin se e kishin tepruar!

Më në fund e kuptuan dhe heshtën! Dëgjoheshin vetëm lugët dhe mbllaçitjet e tyre, që hanin ngutshëm e të mbushur frymë, sikur ndiqeshin nga dikush! Ndërkohë, në mendje m'u ngjitën fjalët e Albanës, që e mbante veten për intelektuale. Pak më parë e kishte thënë troç se vëllezërit e saj ishin të shkolluar gjë që në pamje të parë nuk dalloheshin të tillë! Ata dukeshin të heshtur dhe të

tulatur, ndoshta pak më tepër se ç'mendohej në shikim të parë! Që në fillim vërejta se ata ishin të përkushtuar, dhe të lidhur ngushtë në besimin tonë të Madhërishëm, por pas bisedave që i ndërruan në mes tyre dhe Imamit gjatë kohës së drekës, vërejta mbi ta një dritëshkurtësi, një vendosmëri këmbëngulëse mbi pavlera miope! Pas një studimi të çastit, arrita në përfundim së vërtetë këta djem ishin të përgatitur për çfarëdo sfide, por vetëm deri aty ku arrinte pagesa! Ata besonin në ritet tona jo nga devotshmëria, jo nga simpatia që kishin për ne por thjeshtë për para e famë! Mua me erdhi mirë që ishin të tillë, sepse të tillët që e shesin identitetin e vet për pak para, manipulohen lehtë. Përderisa janë kaq të heshtur, nga provoja ime e gjatë në përzgjedhje, kam parametra të pagabuara se këta me një fjalë të mirë, me një bakshish të vogël, me një lavdërim të tepruar ndaj përkushtimeve të tyre, ndaj veshjes dhe pamjes së tyre, mund t'i tërhiqje nga hunda tërë ditën... edhe natën po deshe! Këta ishin të gatshëm të bënin edhe të pamundurën për bindjet e tyre... për bindjet tona desha të them! Fenomene të tilla më kishin rastisur edhe në ato vende të shenjta, ku për katër vite kisha bërë përzgjedhje! Përzgjedhja e këtyre tipave vlerësohej nga eprorët tanë si më e qëlluara. Ata që kishin fat dhe tipat e tillë arrinin ti kthenin në besimin e vërtetë dhe të Madhërishëm, ishin më të privilegjuarit, dhe paguheshin më së miri! Por mjerisht, besimtarët e atyre vendeve të bekuara kishin dallime të pakrahasueshme me besimtarët e këtyre vendeve të nëmura dhe të rrethuara nga profanë, të paganë dhe kaurë! Prandaj, në këto rrethana, vështirësia për të përzgjedhur talent të rinj, është shumë më e madhe se në ato vende të bekuara.

Që nga dita e parë që u takova me këta njerëz, u ndesha drejtpërsëdrejti me pengesa të papara e të pa përjetuara më parë nga grupe injorantësh. Është vështirë të punosh në këto rrethana. Ka raste që po demoralizohem aq shumë sa që po bëhem gati të heqë dorë fare nga përpjekjet e mëtutjeshme, si gjë e pamundur për t'ua mbushur mendjen këtyre krijesave të krisura, që ju pëlqen më tepër jeta e shthurur se sa besimi i pastër islam!

Pas drekës, prapë zumë vend ashtu siç ishim edhe më parë. Albana na solli çaj. Pasi na i vendosi secilit përpara bëri disa hapa prapa! Mendova se do të dilte nga dhoma, dhe të them të drejtën, disi thellë në shpirt ndjeva një boshllëk! Në çast erdha në vete dhe u pendova për ato mendime haram. Rashë shahadet, dhe desha të flisja diçka fisnike sa për ta larguar mendjen time nga ato mendime mëkatare, kur befas foli Albana:

– Më falni, por më dëshirë do t'ju sqaroja disa ndryshime tek vëllezërit e mi, nga ndikimi i drejtpërdrejt i riteve tuaja.

Derisa po matesha në duhej ta kundërshtoja apo ta pranoja dëshirën e saj, Imami pa marrë sinjale nga mimika ime, nxitimthi foli:

– Më gjithë dëshirë mund t'i sqarosh preokupimet tuaja... dhe mos harro, çdo preokupim mund ta konsultosh me ne! Jemi gati t'ju ndihmojmë!

– Në fillim, kur këta e kishin pranuar konvertimin nga yshtjet e Imamit, edhe unë u ndjeva pakëz e gëzuar, sepse mendova se më në fund vëllezërit e mi e gjetën veten dhe do të largoheshin njëherë e përgjithmonë nga sorollatjet e rrugëve dhe lokalet e natës. Do të liroheshin nga dëmet që ua shkaktonin ato lokale këtyre, dhe nga dëmet që këta i shkaktonin vetvetes, rrethit të ngushtë familjar dhe

shoqërisë! Sido që të jetë, pata menduar atëherë së më mirë dhe më të sigurt do të jenë në mesin e besimtarëve islam në xhami nën përkujdesjen e hoxhës se sa në rrugë dhe lokale nate, që nuk i kthente në shtëpi as drita e agimit. Edhe kur ktheheshin, ose ishin të dehur dhe nuk e kontrollonin dot veten, ose ktheheshin kryeçarë e të gjakosur, ose nuk ktheheshin fare, sepse ndaloheshin nga policia për shkak të prishjes së rendit dhe qetësisë publike! Por, koha e konvertimit, nga rrugaçë e ngatërrestarë në besimtarë të denjë të islamit nuk i mbajti gjatë! Vërtetë tani nuk shkojnë në lokale nate, nuk kthehen në shtëpi kohë e pa kohë dhe të dehur si më parë, por pas çdo lutje namazi kthehen nga xhamia të plagosur herë shpirtërisht e herë fizikisht e me turi mavi e të deformuar si të Imamit. Nuk i durojnë dot sharjet dhe fyerjet që ju bëhen nga besimtarët e tjerë. Të zënë ngushtë reagojnë pa arsye, hapin debate pa nevojë duke u vënë në mbrojtje të atyre tezave fetare që nuk i njohin dhe që janë aq të thella, aq të përgjithësuara sa që as nuk janë në gjendje t'i pranojnë e as t'i mohojnë! Kështu, në mungesë argumentesh për t'i mbrojtur tezat tuaja sektare, bien pre e shuplakave dhe grushteve, e herën e fundit edhe të thikave! E ku ndodhin gjithë këto mund të pyesni ju? Në shtëpinë e Allahut... në xhami! E pse? Sepse nuk janë në gjendje t'i arsyetojnë para besimtarëve të tjerë ndryshimet e tyre gjatë riteve dhe me kryeneçësi bien në apologji duke e mbrojtur fizikisht besimin islam, nga besimtarët, po ashtu islam! Jam e ndërgjegjshme se ky besim nuk e meriton një mbrojtje të tillë as nga apologjet e fesë e as nga besimtarët e painformuar e sektarë! Prandaj, që në fillim ju thashë se vëllezërit e mi, janë të demoralizuar nga papunësia,

nga lënia mënjanë e shoqërisë... Imami është i njoftuar më kohë me problemet dhe preokupimet e tyre deri në imtësi! Ne, rrethi i ngushtë familjar dhe farefisi, disa herë i kemi udhëzuar që të jenë të kujdesshëm në marrjen e vendimeve, mos të kenë ngarkesa të panevojshme ideologjike, të jetojnë larg preokupimeve dhe problemeve ditore, financiare, familjare e shoqërore, të freskohen me humor e me art dhe me gjëra që i bëjnë të gëzueshëm! Por mbi të gjitha këto, për një gjë me vjen keq për ju! Keni marrë përsipër një barrë të rëndë, një barrë që nuk po e mbartin dot as udhëheqësit më të devotshëm të atyre viseve ku lindi dhe u zhvillua islami si fe, dhe nuk do ta mbartni as ju në këto troje që vonë e panë islamin! Jeni të gjykuar turpshëm të dështoni! Pa dashur t'ju fyej, dhe pa hy në detaje dhe filozofi fetare se si ka ndodhur, pse ka ndodhur apo si do të ndodhë në të ardhmen, po ju them vetëm një gjë: duke u nisur nga vëllezërit e mi, investimi i juaj në njerëz të zhgënjyer nga shoqëria, të pa perspektivë, ngatërrestar e kokëkrisur pa dyshim se do të jetë investim sakat që prodhon kundërvlerë! Investimi i juaj në besimtar gjaknxehtë, ngatërrestarë, pijanecë e rrugaçë pa dyshim se do të ndikoj në cilësi duke u trajtuar nga masat e gjëra të popullit si besim i të çmendurve, ngatërrestarëve, pijanecëve dhe rrugaçëve! Njerëzit do t'ju shikojnë me bisht të syrit si apologë të dhunshëm që nuk ofron diçka të mirë, të hijshme, fisnike e njerëzore që do t'i kishte tërhequr edhe ata! Keni ardhur si miq në shtëpinë tonë, prandaj ju pritëm dhe do t'ju përcjellim ashtu siç ka hije, si miq! Por, e gjithë ky kundërshtim nga ana ime vjen si rezultat i gjendjes së rënduar në mbarë familjen tonë, prandaj lutja ime është që të ndikoni mbi

vullnetin e tyre dhe t'i bindni që t'i ulin tensionet dhe të bien në nivel me besimtarët e tjerë, duke i zhveshur nga shenjat dalluese... të paktën për një kohë, derisa edhe këta ta gjejnë veten në mesin e shumtë të besimtarëve islam!

U përqendrova në kërkesën e Albanës, e cila në pamje të parë dukej e thjeshtë dhe njerëzore, por pas një analize të shpejtë që ia bëra gjendjes, dola me përfundimin se Albana nuk ka aspak të drejtë të përzihet në dëshirat dhe vullnetin e të tjerëve, edhe vëllezërit e saj qofshin ata!

– Dëgjo këtu! – ndërhyri Imami duke ju drejtuar Albanës: – Nëse dëshiron t'ju vini në ndihmë vëllezërve tuaj ashtu siç po pretendon, siç të kam sugjeruar edhe më parë, ti duhet të biesh në nivelin e tyre!...

– Mirë e ka Imami? – ia ktheva duke e vështruar butësisht fytyrën e saj të ëmbël.

– Edhe ti je në një mendje me té? – ma ktheu duke me shikuar ngultas me ata sy bajame, gjë që, jo vetëm që nuk e pata mërzi, por ndjeva kënaqësi!

– Po! Edhe unë mendoj që ta pranosh konvertimin nga kjo formë që e ke tani në formën e tyre!

– Pra, sipas jush, vetëm konvertimi na qenka zgjidhje?

– Jo sipas nesh, por sipas të gjitha gjasave kjo është e vetmja zgjidhje! Mos e mashtro veten me iluzione të kota, sepse rrugë tjetër nuk ke! Shumica ndodhen në anën tonë!

– Unë kërkova nga ju që të ndikoni me autoritetin tuaj në bindjen e vëllezërve të mi të heqin dorë nga qëndrimet e tyre të ngurta, e jo të me kështilloni se si të transformohem edhe unë me ato qëndrime, dhe të bie në nivelin tuaj sakat!

– Të thashë: tjetër rrugë nuk ke! Ne, paraardhësit mbështetemi në atë së çfarë është e nevojshme dhe e

vlefshme për ne, e jo në atë se çfarë është e mirë e morale për ju, prandaj, nuk jemi nga ata që heqim dorë nga qëndrimet tona për hatër apo për qëllime të dikujt tjetër edhe të ngurta qofshin ato! Ne e kemi platformën tonë, në bazë të së cilës marrim vendime, prandaj kërkesa e juaj për tërheqjen e vëllezërve nga rrugë e shenjtë e përzgjedhur me dëshirën e tyre dhe vullnetin e Allahut, është e pamundur! E vetmja mundësi që t'ju vish në ndihmë vëllezërve tuaj, siç të thashë edhe më parë, është të marrësh formën e tyre!

– ... dhe të kacafytem me besimtarët e tjerë? – ndërhyri buzëvarur.

– Jo të kacafytësh por të studiosh, të pranosh mbulesën e femrave të bekuara islame, të pranosh kështillat tona dhe të përfitosh jo vetëm shpirtërisht por edhe materialisht!... në të kundërtën, do të digjesh në zjarrin e xhehenemit... kurse ju, – ju drejtova vëllezërve të saj: – vazhdojeni rrugën tuaj të shenjtë! Mos u ligështoni nga asnjë situatë! Luteni Allahun pa ndërpre sepse, herët a vonë, Ai do t'ua dhurojë atë që e dëshironi, atë që e kërkoni prej Tij duke thënë: „Bëhu!" dhe ai bëhet menjëherë." Kështu që, për plotësimin e këtyre dëshirave duhet vetëm të luteni... vazhdimisht të luteni... pambarim të luteni, të jetoni në modesti këtë jetë të rreme, këtë botë të shkurtër, duke e ëndërruar me ëndje jetën e përjetshme atje në xhenet, ku do t'ju presin të gjitha të mirat, ku ju është premtuar ju që jeni të devotshëm, së atje do të gjeni lumenj me ujë të kulluar, do të gjeni lumenj nga qumështi me shije të paprishur, do të ndesheni me lumenj nga vera e shijshme për njerëz, do të gjeni lumenj nga mjalti, do të ushqeheni me gjithfarë lloj pemësh, do të uleni rehatshëm në kolltuk

ku do t'ju shërbejnë hyritë e bukura symëdha dhe nuk do të jeni kurrë të njëjtë si ata që nuk besuan, të cilët do të përballen me zjarrin e xhehenemit dhe etja do t'ju shuhet me ujë të valë duke ua copëtuar zorrët... Pra vëllezër të dashur selefinjë, mos u ligështoni nga zërat profanë, nga zërat blasfemi që me idhujtarit e tyre po përpiqen t'ju largojnë nga të mirat që ju presin në xhenet, në atë vend të bekuar ku do të qëndroni me shekuj të ulur në kolltukë dhe nën shoqërimin e hyrive symëdha! Vazhdoni këmbëngulës rrugën e shenjtë... dhe padyshim se atje do të gjeni falje nga Allahu i Madhërishëm!

– A do të ketë edhe femra në xhenet? – me pyeti Albana me ironi duke ma ndërpre fjalën, sepse kisha edhe shumë për të folur.

– Pse me pyet? A nuk me dëgjove kur i përmenda hyritë symëdha? – i shtrova kundër pyetje në vend që t'i përgjigjesha.

– Po, por më sa kuptova unë, femrat edhe në botën tjetër do të ngelin vetëm shërbëtore burrash për t'ua kënaq shpirtrat dhe epshet e tyre të pangopura... unë të pyeta së a do të ketë femra të ulura në kolltukë të rehatshëm që do t'ju shërbejnë hyritë symëdha?

– Sigurisht së do të ketë edhe femra në xhenet dhe ato do të jenë shoqëruara nga hyritë symëdha! – tha me ironi njëri nga vëllezërit e saj.

– Atëherë unë nuk do dëshiroja që edhe në atë botë t'ju shërbej burrave, e as të më shërbejnë mua hyritë symëdha, por do të dëshiroja të më shërbejnë...dhe mundësisht të më shoqërojnë beqarët!

– Pse kush të tha se ti e ke fituar xhenetin në atë botë që të shërbejnë dhe shoqërojnë beqarët? Ti do të digjesh

në zjarrin e xhehenemit... ti do të përvëlohesh...

– Mos ke frikë... nuk e kam ndërmend të përzihem në punët abstrakte të asaj bote mistike që nuk i kapim dot as unë e as ti! Do të vazhdoj ta shijoj xhenetin e kësaj bote konkrete... kurse atë botën tjetër abstrakte që po pretendon së është aq e begatë, aq e bukur, aq e lezetshme, me gjithë dëshirë po ta dhuroj ty... dhe mos prit gjatë këtu se mos ta rrëmbejnë të tjerët! Mbështillu me qefin dhe... rrugë të mbarë... – ende pa e mbaruar fjalën, shpërthyen të qeshura të shfrenuara.

– Dëgjo Abdallah! Në suren Nahl thuhet: „Nëse ti (Muhamed) përpiqesh për t'i vënë në rrugë të drejtë ata (dije se), Allahu nuk e udhëzon atë që e ka humbur, dhe për ata nuk ka ndihmëtar." Prandaj, edhe unë do të këshilloja që mos të lodhesh kot duke e sfiduar vullnetin e Madhërisë së Tij me këtë të humbur! – ndërhyri Imami.

– Unë nuk po bëjë hutbe për ta kthyer një të humbur nga Allahu, por po bëj hutbe për t'ia treguar rrugën e drejtë të Allahut!

– Përderisa Allahu nuk më udhëzon në rrugë të drejtë dhe më ka humbur, përderisa për mua nuk paska ndihmëtarë, atëherë po ju pyes ju: pse po e sfidoni vullnetin e Tij, kur e dini së Ai ia fal atij që do dhe dënon atë që do?... Pse po i dilni Allahut përpara? Më lini në mëshirën apo fatin e caktuar prej Tij...

– Këto janë fjalë kaurësh! Këto janë yshtje djajsh... Ti e meriton vdekjen... mbytjen me gurë! Ti... ti... Estagfirullah!...

– Qetësohu pak, qetësohu! Mos merr yrysh! Nuk ju kemi ftuar të na fyeni në shtëpinë tonë... ne kemi një marrëveshje me Imamin, të cilën, deri më tani asnjëherë

nuk e ka përmbushur! E sheh se si jemi katandisur me këto mjekra pa stil e me këto tërleme pa vlerë? Këto na i solli Imami duke na premtuar pagesë mujore nëse do t'i pranonim! Ne i besuam këtij dhe i pranuam, por ky asnjëherë nuk e përmbushi premtimin. Prandaj sot, jemi mbledhur këtu për t'i marrë paratë e premtuara që nga rasti i konvertimit e këtej, që sipas Imamit ti na i solle nga Arabia, në të kundërtën lirshëm mund t'i merrni me vete tërlemet dhe të ktheheni nga keni ardhur!

Në çast shpërthyen të qeshura të papërmbajtura, kurse Imami sa i drejtohej njërit e sa tjetrit.

– Ju lutem... ju lutem... të më kuptoni drejtë... paratë ende nuk na kanë ardhur... ju betohem për Allah! Por edhe ju duhet të keni besim në sinqeritetin tonë... nëse e doni pagesën menjëherë atëherë ne do t'ua bëjmë porsa ta ketë pranuar Albana konvertimin... ndërrimin e emrit dhe vënien e tërlikut!... për ndryshe duhet të prisni!

– Si? Tani pagesat i kushtëzon me konvertimin e Albanës?

– Jo vetëm tani... unë gjithmonë e kam kërkuar një gjë të tillë!

– Si thua ti Albana? E ke ndërmend t'ju besosh betimeve kaq të sinqerta të Imamit e të tjetërsohesh? – pyeti njëri nga kushërinjtë e saj

– Nëse e bënë pagesën menjëherë, së pari për mua e pastaj edhe për ju, përse mos t'i besoj?

– Jo... po... pagesën do ta bëj nesër në sabah... besomëni, për Allah që s'ka be mbi Madhërinë e Tij! Njëherë për Albanën pastaj edhe për ju... për këtë ju garanton Abdallahu!

– Shumë Abdallaha si ky na kanë garantuar deri më sot,

por ne akoma nuk i kemi marrë paratë e premtuara! Sipas jush, për përmbushjen e kësaj çështje mjaftojnë betimet tuaja boshe dhe shpresat tona të pafund! – ia priti njëri që deri në atë kohë nuk kishte folur asnjëherë.

– Po, po! Mjaftojnë... Shpresa dhe mbijetesa...

– Si thoni ju? Të vazhdojmë të shpresojmë në premtimet boshe mbi dyvjeçare të Imamit apo t'ia kthejmë tërlemet? – pyeti njëri nga vëllezërit e saj duke ia ndërprerë fjalën Imamit.

– Po ua kthejmë tëlemet... me duket më e drejtë!

– Mirë atëherë... si i doni tërlemet, të mbushura me lesh mjekrash apo... – pyeti një tjetër me ironi

Prapë shpërthyen të qeshura.

Duke e ndjerë veten të fyer dhe të vrarë shpirtërisht, u ngrita në këmbë dhe pa folur bëra nga dera. E pashë kur ia hodhën tërlemet fytyrës Imamit derisa çirreshin duke u gajasur me njëri-tjetrin!

Me bisht të syrit pashë Imamin që u ngrit pas meje dhe u gjendëm në veturë. Nuk u përshëndeta me ata qafirë, por një gjë e kam të qartë: të gjitha këto që po më ndodhin që nga dita e parë që u ktheva nga ato vende të bekuara, janë të ndërlidhura me gjynahet që i bëra kundër vetvetes duke i besuar këtij hileqari dhe u ktheva duke e mbushur shpirtin tim të dëlirë me haramin e këtyre njerëzve mendjemëdhenj dhe më të ulët se vetë paganët! Që ditën e parë, Allahu mi dërgoi meleqet në ëndërr, të cilët ma sollën kumtin... si t'ia bëj tani? Është hera e parë që ia shtroj vetes këtë pyetje, që kishte filluar të më gërryente që nga mëngjesi i parë kur më erdhi kumti nga i Plotfuqishmi! Ç'të bëj? Të qëndroj këtu e të flijohem vetëm për Allah dhe t'i marr me vete edhe

këta të paudhë... apo të kthehem prapë andej nga erdha? Vallë a do të më pranojnë edhe njëherë në gjirin e tyre ata që më përcollën?

– Tepër po ngutësh... me fjalë të pamatura e rrënove gjithë punën time të arrirë me mund e sakrifica vite të tëra!... – tha Imami me zë të ulët duke m'i tretur mendimet.

– Kush e rrënoj punën tuaj? Unë që ua solla hutbet e Allahut nga ato vende të bekuara apo ti që i ke rrejt për pagesa me vite të tëra? Mbylle gojën gënjeshtar i paturpshëm! – ia ktheve kërcënueshëm.

Uli kokën e nuk foli!

Shyqyr që nuk foli!

I mbështetur pas kolltukut të veturës, dhe i ngrohur mbylla sytë! Për një çast u gjenda në ato vende të shenjta, në mesin e miqve dhe mësuesve të nderuar! Kalova nga një qytet në tjetrin dhe arrita në vilën luksoze të Abu Al Khalidit! I kujtova me nostalgji ato valë deti që vinin vrullshëm përgjatë bregut duke sjellë me vete freski që m'i mbushnin mushkëritë me ajër të pastër. Kalova të mësuesi Ahmadin Al Abduli! Qëndrova në klasën e tij duke i kundruar me dashuri ata nxënës që e këndonin pa pra Kuranin e shenjtë, me zëra që vëngonin valë-valë duke u ngjitur lartë në kupën e qiellit mbi flatrat e meleqeve deri të i Madhërishmi! Që nga aty kalova në stërvitoret e vetëflijuesve të lavdishëm. I kujtova momentet e fundit të jetës së tyre! Lutjet drejtuar Allahut dhe amanetet për të dashurit e tyre që i linin në vuajtje e mjerim në këtë botë mëkatare! I përfytyrova përgatitjet e tyre të fundit dhe ngujimi në veturat e mbushura plot dinamit... shikimet e tyre që shprehnin frikë e dhembje bashkë, kur niseshin

të vendosur në rrugën e tyre të pa kthim!

– Arritëm! – tha befas Imami duke m'i ndërprerë ato mendime të tmerrshme. Hapa sytë i zhgënjyer jo vetëm ndaj shokëve të mi të besimit por edhe ndaj vetvetes! Fjalën që ia kam dhënë Allahut duhet ta përmbushi, dhe atë këtu, në mesin e këtij populli të dalë feje!

E përshëndeta ftohtë Imamin dhe sakaq u gjenda në rrugë!

– Abdallah! – e dëgjova zërin e mekur të Imamit. Ktheva kokën drejtë tij duke e shikuar habitshëm. – Prit se harrova diçka! – më tha duke e tundur dorën mbi timon.

– Çka? – e pyeta qetë dhe me përtesë u ktheva i tëri nga ai.

Nga dritarja e veturës zgjati pak kokën duke me thënë:

– Nesër në ora shtatë të mbrëmjes në lokalet e bashkësisë do të mbahet mbledhja me anëtarët e kryesisë! Do të merren vendime historike!

– E di!

– Edhe për vendimet që do të merren je në dijeni?

– Jo, nuk jam në dijeni së për çfarë vendimesh e ke fjalën!

– Ti je njoftuar për sulmet që do të bëhen!

– Po, por ende nuk kemi vullnetar që do ta pranonin flijimin!

– Gjatë mbledhjes do të shqyrtohen të gjitha mundësitë, dhe në fund, nëse nuk ka vullnetar do të hidhet shorti... kush ta ketë fatin! A je i pajtimit ti?

– Po! – ia ktheva shkurt.

Për të parën herë më shikoi gjatë në sy, sikur kërkonte nga unë përulje, nënshtrim! Pasi që edhe njëherë mora vendim se do të merrja pjesë jo vetëm në mbledhje, por edhe do t'ju përmbahesha urdhrave dhe kërkesave që do

të dilnin nga vendimet e saj historike, ia ktheva me po atë vështrim të gjatë e sfidues pa pasur frikë se po e shkelja ndonjë rregull respekti përulës ndaj tij! Ky ishte çast vendimtar që përcaktonte bindjen time ndaj urdhrave të Allahut e jo ndaj kërkesave të tij.

– Do të jetë rast ideal për shpalosjen e përvojave tuaja! – vazhdoi ai me një zë lajkatar.

– Nuk është koha për shpalosje përvojash, por për marrje vendimesh! – ia ktheva i vendosur, duke ia kthyer shpinën.

Pas krahëve ndjeva zhurmën e motorit që po largohej.

Prapë trokita lehtë mbi derën e mbyllur, tak-tak! Dëgjova hapa të lehtë matanë. Nuk e marr dot me mend së cili është ai që po afrohet për ta hapur derën, por gjithsesi dëshirojë të jetë ajo!

Ishte magjistrica. Me trup të bëshëm, por më e hareshme, më e buzëqeshur... si nur i Allahut!

Më pa me admirim. Shikoi njëherë jashtë, pastaj me dha shenjë të futëm brenda.

Pasi e mbylli derën prapa krahëve të mi, pa pritur, më mori në përqafim! U tremba!

– Mos u tremb! Jemi vetëm për vetëm ne të dy! – më tha duke me mbështjellë prapë në përqafim.

Kishte një erë të këndshme... disi limon e ftua bashkë. Ndjeva një shkërmoqje çasti, një dyzim, një dyshim... por nga aroma e këndshme e flokëve të saj tani më të shpupuritura dhe të dalë nga shamia, nga përqafimet dhe fërkimet trup me trup, ndjeva së ai sendi brenda pantallonave të mi, prore po merrte një formë tjetër... atë të fryrjes! Pastaj, e ndjeva së ma rrëmbeu kallamin... me

erdhi turp. I mbylla sytë!

Për një çast ndjeva që më shkau nga dora trupi i saj. Hapa sytë. Ishte aty. Afër. Pranë shtratit të mëndafshtë e me ngjyrë të kuqe, duke e heqë nga trupi pelerinën e saj ngjyrë vjollce! Para meje m'u shfaq trupi i saj lakuriq. I bëshëm. I plotë. Me gjinj të mëdhenj. Me kofshë të trasha, shumë të trasha dhe me atë njollën e zezë, të madhe e delikate në fundin e barkut.

Mu afrua pranë dhe prapë me mori në përqafim. Me rrotulloi mbi shtrat. Me ngjeshi lehtë. Më shtypi butë. Pastaj, peshoi rënd-rënd mbi mua. Herë pas here dëgjoja refrene gulçimash. Lëvizje të rënduara, të çrregullta, ritmike, zgërlaqje! Prapë gulçima dhe... në fund një gulçimë të zgjatur, të zgjatur që prore sikur shkonte drejt shterjes! Pastaj ndjeva një mekje çasti. Një shtrëngim të rënduar. Një shtangim. Një zënie fryme... një shpërthim!

Pushuam ashtu, lakuriq.

Po vazhdoja pushimin kur ajo tundi vithet. Lehtë u largua nga trupi im duke u ngritur në këmbë.

– Do ma plotësosh një dëshirë? – me pyeti befas derisa po e hidhte mbi shpatulla pelerinën.

– Po, gjithsesi – ia ktheva duke e shikuar me admirim trupin e saj të mbushur.

M'i hodhi rrobat sipëri.

– Vishu, tani është koha! – më tha me zë urdhërues. – Më prit në korridor, mirë?

– Mirë! – ia ktheva me zë të tulatur.

– Këto materiale do t'i dërgosh në njërën nga lagjet e qytetit dhe do ia dorëzosh profesorit! Qartë?

– Si urdhëro zonjë! – i thashë pa e ditur së ç'kishte brenda asaj pakoje të vogël.

Thuaj: „O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse vërtetë, Allahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që falë shumë dhe është mëshirues!“

Kuran – Sure Ez Zumer (39), ajeti 53 Fq. 532

DYFYTYRËSIA

Vetëm në bodrumin e kësaj shtëpie të braktisur e të shkatërruar nga lufta, e gjej veten. Sa herë që ndjehem i pasigurt në mesin e shoqërisë apo pas grindjeve me nënën, tinëzisht vij në këtë bodrum dhe rri me orë të tëra! Edhe tani jam këtu, i vetëm, i shtrirë mbi dyshek që e pata marrë në shtëpinë e Hajries atë natë kur pata dëgjuar se ajo plakushë e krisur kishte shkuar në një dasmë në katundin e saj të lindjes! Thjeshtë, e vodha... por natën!

Kur erdha për herë të parë, dhoma ishte e mbushur plot bërllok, dera dalë bagllamash dhe dritarja e thyer. Solla një kazmë, një shatë dhe një lopatë nga shtëpia, dhe ju përvesha punës. E dëlira, e fshiva dhe e lava për shtatë palë qejfe. Dritaren e mbylla nga brenda me dërrasa bredhi, derën e vendosa në vend dhe ia vura drynin nga

jashtë! Pastaj, bleva pije, ushqime të konservuara, qirinj... e solla dyshekun, dy jastëkë, dy batanije dhe një sixhade! Kurse në një çengel hekuri që ndodhej i ngulur në murin e betonit, e lë të varur kallashnikovin dhe sipëri tij xhyben time futë të zezë. Në një qoshe, të fshehur mirë mbaj edhe dy shishe raki rrushi, prodhim Ereniku.

Kur ndodhem këtu, edhe ndjehem mirë, edhe ndjejë mall për dashurinë time të parë dhe... ndoshta të fundit! Hë! Dashuri i thënçin! Unë e dua, kurse ajo, e ndjej se nuk më do fare. Gjithmonë më shikon me neveri sikur të isha ndonjë kërmë!

Rri me orë të tëra i tretur në mendime, duke e shikuar dhomën që e kam rregulluar për qejf. E shikoj dyshekun, jastëkun, batanijen dhe e ndjej me dhembje mungesën e saj, brenda kësaj thjeshtësie mahnitëse! Kam dëgjuar nga pleqtë se në kohëra të lashta, kreshnikët, pasi ua fusnin kokën në thes, i rrëmbenin vajzat e mbretërve, dhe si robëresha i dërgonin në kalatë e tyre. I mendoj kacafytjet dhe kundërshtimet e tyre gjatë grabitjes, dhe pastaj zbutjet dhe nënshtrimet para zotave të tyre kreshnikë! Ndjehem i pikëlluar që kam lindur tepër vonë nga ajo kohë e bukur kreshnike! Pastaj shkrehem në kujtime të pafundme duke përfytyruar rrëmbimin e të dashurës sime me thes në kokë, kundërshtimet, dhe sjelljen e saj në kalanë time të mrekullueshme! E paramendoj me mall zbutjen e saj, mallin e saj për mua... trupin e gdhendur, ngrohtësinë dhe aromën e këndshme të flokëve deri të përfytyrimet lakuriqe... edhe pse kurrë se pashë atë lakuriqësi mahnitëse! I mërzitur tej mase për një çast i harroj thëniet e Allahut të Madhërishëm që janë të shkruara në Kuranin Kelamullah, i harroj udhëzimet e Pejgamberit të ndritur paqja dhe mëshira e

Allahut qofshin mbi té, i harroj këshillat e udhëheqësve të paraardhësve selef dhe i tretur nën mëshirën djallëzore të shejtanit, i afrohem shishes së rakisë... pastaj, aty e gjej prehjen e dytë. Pi, dhe mendoj! Mendoj dhe analizoj shkaqet që ajo nuk më do, dhe në fund vij në përfundim se shkak për humbjen e asaj simpatie që e kishte në fillim për mua dhe të kthyer pastaj në neveri, kishte ndodhur vetëm pas konvertimit tim... tërlemja dhe mjekra e gjatë, xhaketa e pantallonat xhuxh, që të gjitha së bashku m'i mbuluan bukuritë që m'i kishte dhuruar i madhi Allah, e që aq shumë m'i dëshironte nëna, por që nuk e fshehën dot shëmtinë që fshihej përbrenda tyre, shëmti që ajo e kishte hetuar para nënës! Prandaj, porsa e vërejti ajo atë shëmti, u distancua duke e fikur edhe atë fije shprese që më kishte mbajtur akoma!

Kështu, në kulmin e pikëllimit veprova edhe mbrëmë! Kur ai zëri i brendshëm më tha se mjaft pive për sonte, u çova si hije dhe duke vëzhguar terrenin dola jashtë! Pasi u gjenda në rrugë, për një copë herë mbeta i dyzuar se nga të shkoja. Nuk me shkohej në shtëpi! M'u kujtua Milaimi, miku im i vjetër. Tani është bërë pronar i një „Bar-kafeje." Kisha dëgjuar së aty shërbenin plot bukuroshe. U zotova se më paratë e pista që m'i kishte dërguar profesori do ta blej lumturinë time. Nuk prita gjatë. U nisa. Hyra nga dera e pasme dhe si në ëndërr u gjenda në shtratin e butë të njërës prej tyre! Mëngjesi më zuri të tretur në përqafime dashurie!

Edhe tani jam duke menduar së ka ardhur koha të afrohem pranë shishes së rakisë, kur ra celulari! Ishte Rexhepi, njëri nga shokët e medresesë! Me njoftoi se sot në mëngjes ishte gjetur i vrarë ish profesori i jonë i dikurshëm

Hafiz Osmani, dhe me ftonte për pjesëmarrje në varrim! I thashë po, gjithsesi do të marr pjesë! Megjithatë, nuk e ndala manovrimin. E mora shishen në dorë dhe fillova t'ia hapë kapakun, kur prapë ra celulari! Ishte Nexhi, edhe ai sikur para pak çastesh që më njoftoi Rexhepi, më tha se kishte urdhër nga udhëheqësit e ndritur të paraardhësve të devotshëm, që të formohej një komision prej tre vetash që do të përkujdeseshin me rastin e ceremonisë së varrimit, duke e shpallur hero dhe anëtar nderi, që gjoja kohën para se të vritej e kishte kaluar si anëtar i fshehtë i selefiinjëve! Pasi ia konfirmova pjesëmarrjen, ai shkoi pak më larg duke thënë se ishte duke e bërë një organizim të përsosur nga të gjithë ish nxënësit e tij të gjeneratës sonë dhe do të merrnim pjesë në varrimin e tij me një referat të shkurtër mortor! Pastaj filloi të shante dhe të villte vrer kundër vrasësit të tij kriminel dhe kërcënohej se po ta gjente do ta vriste vetë me duart e tij, e shumë broçkulla të tilla! Nuk ia prisha qejfin! E lash të shfrynte, e të shfrynte, e të shfrynte... dhe me vete mendoja; „hajt, hajt se as ti nuk je hiç më i mirë se ai!" Nuk e di se kur e ndërroi temën duke më thënë:

– Hilën a po e lajmëron ti, apo...

– Jo, jo! Më mirë lajmëroje ti! Natën e mirë!– ia gjeta momentin e përshtatshëm duke i uruar natën e mirë sa pa e hapur ndonjë temë tjetër.

Me t'u përmendur emri i Hilit, në mendjen time u skicua ai huni i madh që ia pata ngjeshë kresë! Më shpëtoi i poshtri! Isha i pa përvojë atëherë, dhe nuk e dija masën e goditjeve... këtë e mësova vetëm atëherë kur ia ngjesha kresë Ismajlit! Atij bukuroshi që çmendeshin vajzat pas tij... prandaj e urreja! Por kishte qenë i fortë i poshtri!

Pas goditjeve të para, nuk e di së si ndodhi, por e pata ndjerë një dhembje të tmerrshme në lule të ballit! Atëherë e zhdëpa dru derisa nuk lëvizi më! Pastaj qova fjalë së gjoja isha kacafytur me ariun, ha, ha, ha!... sa budallenj janë njerëzia; më parë e besojnë gënjeshtrën e stolisur së të vërtetën lakuriq! Edhe atëherë, nuk e besuan të vërtetën rreth vrasjes së Ismajlit por gënjeshtrën e kacafytjes sime me ariun e besuan... dhe këtë, duke e shndërruar në legjendë pastaj!

Duke e parë se do të më prishej imazhi i tanishëm i kujtimeve të këndshme, dhe veprimeve që pritej t'i merrja së shpejti, pasi me erdhën edhe tre apo katër thirrje të tjera, të gjithë duke me njoftuar për të njëjtën vrasje, vendosa ta mbylli celularin për sonte. Dhe ashtu bëra. I bërë xurxull, i ndërrova rrobat duke i veshë një palë kostume të zeza, këmishë bojëkafe e kravatë të kuqe. Ashtu siç isha, ashtu dola, si hije u gjenda në veturë. Mora drejt Bar-kafesë, tani më të preferuar për mua. Kur u gjenda fare afër, përmes celularit e njoftova Milaimin se po shkoja, dhe e pyeta se a kishte diçka për mua? Si mbrëmë, më tha dhe më urdhëroi të paraqitesha nga dera e pasme! E shtypa gazin, derisa makina ushtoi trishtueshëm. Fluturimthi u gjenda pranë Bar-kafesë.

U ndjeva shumë i kënaqur kur pashë veten në shtratin e veshur me mëndafsh të kuq dhe trupin tim të zgërlaqur nën peshën e një biondine fillake nga Moldavia, e cila nuk e kuptonte gjuhën time, por punën e saj e bënte për mrekulli ama!

Nata më pëlqen më shumë se dita, sepse përmes natës mund ta këqyri veten me atë lumturi që të tjerët më shohin gjatë ditës. Çdo veprim i imi që përputhet me

fytyrën time të dytë, të cilin e njoh vetëm unë, si; vjedhjet, shkatërrimin e varrezave myslimane që zemrat e tyre kanë rrëshqitë në kufër[49], rrahjet tinëzare, plagosjet, vrasjet nga prita dhe dëfrimet erotike në shtretërit e mëndafshtë të hyrive symëdha i realizoj i mbështjellë në terrin e natës! Sikur dikush, që do të mund të m'i lexonte mendimet e mia, dhe ato t'i akordonte me veprimet që i marr natën do të kishte thënë i sigurt se unë mbaj maskë në fytyrë... ose thjeshtë, dyfytyrësh! Sigurisht! Edhe pse nuk mbaj maskë të posaçme mbi fytyrën time, në të njëjtën kohë jam i maskuar, sepse jam i tillë, dyfytyrësh! Ku ka maskë më të mirë së dyfytyrësia? Në çdo vend, në mesin e miqve, në xhami, në kafene dhe tani në shtratin e butë të biondinës jam i maskuar. Fytyrën e kam të pastër, të dashur dhe të qeshur. Kam zë të bukur dhe flas ëmbël. Vetëm fjalë të zgjedhura nxjerr nga goja, dhe ato i shoqëroj me shikime dashamirëse, me rrezatim besnikërie e sinqeriteti bashkë! Kam shpirt të dhembshur dhe jam sy përlotur... por, nën lëkurën e fytyrës sime, ndodhet ajo fytyra tjetër, krejt e kundërt me këtë që më shohin të tjerët. Atë fytyrë nuk e sheh askush përveç meje, nuk e ndjenë askush egërsinë e saj përveç meje dhe nuk frikësohet askush prej saj përveç meje... natyrisht se e shohin e ndjejnë dhe i frikësohen edhe ata të cilëve ua tregoj vetëm një herë në jetë, por për shkak të gjumit të madh që i vë, e harrojnë menjëherë dhe askush nuk ka frikë më nga brutaliteti i saj! Vetëm mua, herë pas here me brenë ajo frika tinëzare se kjo fytyra e dytë do të me tradhtojë një natë nga ndonjë dritë vetëtime të pa llogaritur paraprakisht! Kujdes!

---

49 Arab. Mosbesim

Pasi ia bëra pagesën Milaimit, dola nga dera e pasme e barit. Me nxitim hipa në veturë dhe mora drejt shtëpisë së braktisur për t'i ndërruar teshat. Duke e parë se rruga, jo vetëm që ishte e errët, por edhe e shkretë në këtë orë të hershme mëngjesi, thashë ta parkoj veturën në brendi të oborrit të pasmë. Nën dritën e qiriut, sikur u lirova nga një samarë delikat që e mbaja prej kohësh në shpinë, dhe nën ngrohtësinë e teshave të bekuara të Pejgamberit selamu alejkum, ju ktheva komplet normalitetit. Pasi e fika qiriun dhe bëra të dilja jashtë, m'u bë se tutje nga rruga dëgjova hapa. Mbajta vesh. U afrova edhe më pranë derës së daljes dhe pashë nga rruga. Një hije e mugët, sa mezi shquhej nga errësira po ecte me nxitim. Nuk lëviza nga vendi. Thashë të pres derisa të largohet, kur befas e pashë se ia dha vrapit. Për një çast dyshova së më ka hetuar dhe nga frika ime, i panjohuri iku me vrap. Kur hapat e tij po dëgjoheshin të largët, dola nga ajo derë e ngatërruar dërrasash dhe u gjenda në veturë.

Për shkak të shqetësimeve të brendshme, që më ndodhen në çast, sikur të isha takuar me ndonjërin nga vëllezërit shpirtdëlirë dhe naivë të selef-us-salih, i cili nga frika mund të më spiunonte, në mendje me erdhi një mendim i çuditshëm: T'i vihem prapa asaj hije nate dhe „aksidentalisht" ta bëjë petë nën rrotat e veturës! Derisa po mendoja se cili mund të jetë i aksidentuari, në çastet e fundit mora kthesën drejt katundit!

Isha xhunub. Vendosa që së pari të bëjë gusllin[50], e pastaj ta fali namazin e sabahut! Në hamamxhik ishte ftohët. E mora tangarin me prush dhe e afrova pranë. E solla

---

50 Arab. – Pastrimi i trupit pas marrëdhënieve seksuale etj.

ujin e ngrohët dhe nisa të lahem duke marrë avdes në të njëjtën kohë. Pasi u fshiva me peshqir, me ngutë u vesha dhe e mora qitapin në kamare. E putha tri herë duke e vënë në ballë, dhe u lidha namaz. E këndova Fatihanë: „Eudhu bil-lahi minesh-shejtani-rraxhim, Bismil-lahirr rrahmanirr-rrahim," por, nuk e di së nga me erdhi një ndjenë pendimi ndaj Allahut, dhe pa menduar gjatë bëra një dua nga surja El Maide dhe fill pas saj edhe një nga surja El Mumtehine. O Allah i Madhërishëm, falmi këto kabahate, këto veprime të liga e pamjet haram... dhe rashë ruku[51] duke thënë me zë të lartë: *„Allahu ekber,"* dhe me zë të ultë këndova: *„Thuaj: O robërit e mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse Allahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është mëshiruesi.* "Rashë sexhde, dhe me zë të lartë këndova: *„Allahume-gfir li dhenbi kuluhu dikahu ve xhulehu ve ahirehu ve alanijehu ve sirrehu,*[52]*" Amin!*

I çliruar nga pendimi, dhe i sigurt për faljen e mëkateve nga ana e të Madhërishmit, si pendël e lehtë u hodha andej nga dollapi. Pasi i shikova në i kisha të gjitha gjërat e mia në torbë, i veshur me veshjen time modeste që më mbron, jo nga të ftohtit sa nga syri mëkatar i të mallkuarve që kanë dalë feje, e hodha torbën në krah dhe bëra të dal, kur befas nëna me pyeti:

– Ku po shkon pa ngrënë?

– Në varrim! E kanë vrarë Hafiz Osmanin!

– Si the? E kanë vrarë Hafizin? – pyeti ajo e çuditur

---

51 Arab – Përkulje gjatë namazit

52 O Allah falmi të gjitha gjynahet, të vogla e të mëdha, të parat e të fundit, të dukshmet e të padukshmet, Amin!

– Po, e kanë vrarë! – i thashë shkurt, duke i dhënë shenjë se nuk ia kisha ngenë të merresha me té!

Sikur ta kishte porositur dikush të më nxirrte nga pyetjet e pambarim të nënës, ra celulari. Ishte Rexhepi. Me njoftonte se varrimi do të bëhej në fshatin e tij të lindjes. Ende pa e mbyllur bisedën me té, ai zëri i brendshëm më tha; „Mos shko!“ Jo, jo! Sido që të bëhet, më duhet të shkoj, ju përgjigja zërit me një pështërimë të arsyeshme.

Një copë herë mbeta si i ngrirë pranë furrxhiut hasjan. Isha në mëdyshje në ishte më mirë të drekoja në mejhane apo në ndonjë lokal tjetër. Ende pa marrë vendim u nisa drejtë qendrës. Ndalova në byrektoren e re, pranë ish dyqanit të sahatçiut çifut. Tutje nga banaku mu bë së po ma bënin me sy byrekët e valë. Kur i pashë që po nxirrnin avull, me shkoi lëng nga goja. I porosita dy, dhe një gotë të madhe kos. Pasi i gëlltita lezetshëm, e porosita edhe një kafe sade.

Së pari u takova me Rexhepin. Pas pak erdhi Nexhi dhe Hili mendjemadh. U tubuam edhe me shokët e tjerë të medresesë. Të prirë nga Imami, morëm rrugën e katundit. Disa herë ia bëra pyetjen vetes, por edhe atyre, pse nuk e kishin varrosur në varrezat e qytetit, për t'ia rritur autoritetin madhërisë së tij, por e kishin degdisur në atë katund të humbur! E ka lënë me gojën e vet para se të vdiste, më thanë! Ëh... e ka lënë me gojë... po ku e dinë këta hajvanë më mirë së unë se çfarë ka lënë me gojë para se të vdiste? Budallenj, thashë me atë zërin e brendshëm ironik, derisa ishim duke u futur në radhën e gjatë të kortezhit. Ne, ish nxënësit e tij, të prirë nga Imami, ishim shumë pranë tabutit, prandaj sa për të më parë edhe të tjerët, u afrova edhe më afër dhe e mora mbi shpatullën

e djathtë drurin që e mbante tabutin me trupin e ndjerë të Hafizit! Mu afruan shumë të tjerë, por nuk e lëshova nga shpatulla ime derisa arritëm të guri i musallës që ishte pranë xhamisë. Aty e lëshuam ngadalë për ta falur namazin e xhenazes! Se si më zuri një ndjenjë urrejtje kur pashë se në vend të Imamit, faljen e xhenazes po e bënte një hoxhë i panjohur, por me një mjeshtri të përsosur që vetëm unë e kam të ngulitur në qenien time, atë urrejtje e shndërrova në hidhërim dhe pa dashje i çaravesha buzët përvajshëm... bile kur e pashë djalin e Hafizit, flitej së ishte mjek, pa një pa dy ia dhashë të qarës! Qanin edhe familjarët, edhe një apo dy shokë të tjerë nga shokët e medresesë. Kurse unë, m'u bë sikur ua mbaja ison duke i squllur sytë! Rexhepi me mbante nga krahu dhe herë pas here më thoshte të veshi ta mbaja veten, por nuk e përfilla edhe pse ai kishte pasur të drejtë! Edhe Imami më luti të mos qaja aq shumë sepse nuk do të ishte mirë t'ju bija të tjerëve në sy. Vetëm kur e pashë vështrimin tinëzar të djalit të tij mjek, e hetova se e kisha tepruar, prandaj u tërhoqa pak duke ndenjur në distancë kokulur, dhe fillova të këndoi duanë Allahyme!

Kur e sollën tabutin bri varrit, pjesëtarët e familjes së tij filluan të qanin me oi-oi të mbytur. Mua me shkrepi në mendje se do të ishte mirë të filloja të thirrja me ton pak të ngritur Allahu Ekber! Dhe ashtu veprova edhe pse Imami më tha disa herë të mos merrja ndonjë veprim të pamatur! Kësaj radhe nuk i shpëtove shikimit të egër të Hilit. Disi fillova t'ia kam frikën atij torollaku, prandaj e pashë të rrugës të tërhiqem pak dhe pa rënë në sy, u largova disa hapa pas, sa mos të ekspozohesha pa nevojë para kësaj turme injorantesh, bashkë me atë injorantin që

po e shtinin në dhé, mos i pastë shpirti rahmet!

Ndërkohë filloi të binte një shi i imtë i përzier me një erë të ftohët. U mbështolla edhe më mirë brenda gëzofit tim dhe sytë e qullur nuk i ndaja nga tabuti që tanimë ishin duke e hedhur në gropë! Njëri nga vëllezërit e tij, që nuk ishte aspak më i mençur se ai që po e groposnin, ishte zhytur në varr deri në bel dhe bënte renditjen e dërrasave të qarrit! Kurse Hili mendjemadh rrinte breg varrit duke i zgjatë dërrasat njërën pas tjetrës. Disa herë me vështroi me një palë sy budallai, sa që për një çast m'u bë se do të ishte mirë për të, të shtrihej edhe ai në varr pranë Hafizit para sa ta kam shtrirë unë!

Kur ishim duke ia hedhur dheun me shat e lopata, gjeta rastin për t'i shpreh ngushëllime vëllait të Hafizit, ati budallait, i cili me shtrëngoi më tepër se ç'e mendova duke me thënë:

– Vërtetë ti e kishe dashur me gjithë shpirt profesorin Hafiz!

– Si mos ta doja? – e pyeta me zë të përvajshëm, dhe vazhdova duke u shtirë sikur isha i ngashëryer. – Ai ishte shpirt njeriu! Ishte zemra dhe mendja e talebanëve, ishte krenaria e medresesë!... – dhe ula kokën sikur po qaja vërtetë, por në të njëjtën kohë isha duke menduar poshtërimet e tij që m'i kishte bërë sa e sa herë para gjithë shokëve të klasës të cilët gajaseshin pastaj duke u zgërdhirë para meje me ditë të tëra me ato fjalë poshtëruese që m'i thoshte herë pas here Hafizi, duke ma shndërruar medresenë strofull djajsh dhe po thosha me vete; mirë ia bëra qenit!

Pata frikë se po më tradhtonin sytë, sepse asnjë pikë loti nuk e nxora dot, edhe pse desha që në këto çaste dhembje

të qaja vërtetë! I përqulla disi sytë duke i fshirë me shami, dhe kokulur bëra të largohem! Por, ai na qenkësh më budalla se budallai i vërtetë. Unë bëja të largohesha prej tij, kurse ai hajvan, më vinte pas duke me mbajtur nga krahu se mos po rrëzohesha!

Ik ore torollak se po të futa në listën time, shpejt do ta bëjnë gropën edhe ty përbri tij!

U tmerrova për mendimin që më erdhi pa vullnetin tim, por me vullnetin e atij zërit të brendshëm që herë pas here ngre krye e më shfaqet vend e pa vend, ja si tani. Pasi e qetësova veten, ju afrova më pranë Rexhepit duke ia bërë me dije atij budallait se nuk ia kisha më nevojën!

I dhënë më tepër pas aktrimeve se sa pas aktit të varrimit, nuk e kisha vënë re se kur kishte filluar ta mbante fjalimin mortor Imami. Si nëpër ëndërr ndjeva kur e përmendi devotshmërinë e Hafizit që kishte dhënë për komb e fe, duke e cilësuar se ishte anëtari më i vyer i Vëllazërisë së selefinjëve... ndërkohë nuk i dëgjova fjalët e tij vijuese sepse dikush nga pjesëmarrësit e kortezhit bërtiti më sa zë që pati:

– Le boll e mos ha mut, qen bir qeni!...

– Mbylle sa s'të futa në gropë bashkë me të!... – klithi një tjetër.

U bë një zhurmë që nuk e merrte vesh kush me kë fliste, cili cilin e shante, kush kujt i drejtohej... pastaj turma lëvizi drejt varrit bri të cilit ndodhej Imami. E tërhoqën zvarrë dhe e hodhën tutje të rruga duke e kërcënuar së nëse edhe një herë do të guxonte të afrohej pranë varrezave, nuk do t'i kursenin grushtet e as shqelmat!

I liruar nga ankthet e njëpasnjëshme që me patën mbërthyer gjatë varrimit të Profesor Hafizit, dhe pas

sherrit që ua la Imami pjesëmarrësve të kortezhit, u nisëm drejtë qytetit duke lënë Hafizin e ngratë në qetësinë e gropës së tij, dhe të imazhit gri që i rrethonte varrezat! Shiu vazhdonte të binte me ritëm të ngadalësuar, kurse andej nga perëndimi qielli kishte marrë pamje të purpurt, që premtonte mot të mirë në ditët e ardhshme! Allahu e ndjeftë shpirtin e tij mëkatar, që sonte, natën e varrit do t'i bëhet gjykimi i parë, dhe ai shpirt gjettë prehje në gjithësi, në prehrin e djajve! – me gjithë afsh e luta Allahun për shpirtin e tij të zi, me atë zërin e brendshëm, kur dëgjova Rexhepin t'i thoshte Imamit:

– Si thua ti? Të ndalemi pak në mejhane?

– Nuk është aspak nder që pas varrimit të kthehemi në mejhane, prandaj...

– Shkojmë, shkojmë, pse jo, edhe ngrohemi pak! – ia ndërpreu Rexhepi i pasuar edhe nga të tjerët. Vetura mori drejtimin e mejhanes.

Derisa po uleshim në një skaj të lokalit, sytë me shkuan në murin përballë ku ishte e varur një pikturë e punuar sipas stilit të mjeshtërve të moçëm frëng!

– E kujt është ajo pikturë? – e pyeti Rexhepi mejhanexhiun që erdhi ndërkohë për të marrë porositë!

– Është pikturë e Hasretit Muhamed!

Pa ju besuar këtyre fjalëve, e vërvita shikimin tim gozhdë mbi pikturë. Ishte një kalorës në një peizazh të errët dhe me pamje nga prapa duke qëndruar zbathur pranë dy grave të cilave nuk ju shihej fytyra, por vetëm shamia, gjysmë profili dhe rrobat e zeza e të gjata deri në fundin e këmbëve.

– Kurse piktura tjetër përbri saj, është e Imam Huseinit! – tha mejhanexhiu kur i solli pijet dhe me shikoi i

ngazëllyer kur pa se unë nuk i shkoqja dot sytë nga ajo pikturë mahnitëse e punuar sipas stilit perspektiv perëndimor.

Edhe me pëlqeu, edhe u çudita kur Rexhepi filloi të fliste në lidhje më pikturën perspektive

Derisa po e rrotulloja vështrimin rreth e qark, befas pashë profesorin tebdil. Përmes mimike me njoftoi së do të bëhej dorëzim-pranimi i parave. Ç'është e vërteta, për këtë rast ai me kishte njoftuar me kohë, por nuk ma mori mendja së do të ktheheshim të gjithë së bashku në vendin e takimit! Duhej ndërmarrë diçka. Si t'ia bëj që të shkëputëm pa u vërejtur prej këtyre budallenjve hajvanë... e sidomos prej syrit të regjur prej spiuni të fëlliqur të Hilit! Ah, po! Vjedhurazi i nxora cigaret nga kutia dhe i futa në xhepin e xhaketës, kurse kutinë e zbrazët e hodha mbi tryezë... ja shkaku që të arsyetohem për largim, gati sa nuk thashë me zë të lartë! Derisa po largohesha, vështrimi im u kryqëzua rreptë me vështrimin e dyshimtë e të frikshëm të Hilit. Padashur e ndjeva së brenda qenies sime kishte filluar të më trokiste ai zëri i brendshëm duke bërë porosinë për vrasjen e radhës, dhe padashur më shpëtuan fjalët; „*Ai ia fal atij që do dhe dënon atë që do*". Sa për t'i maskuar ato që i thashë, vështrimit të Hilit ju përgjigja me një buzëqeshje dashamirëse! Pas pak u gjenda jashtë.

Përmes dritares së pasme të mejhanes u gjenda në tualet. Vjedhurazi, duke ecë në maje të gishtave u afrova pranë fuçive boshe të verës dhe u fsheha pas tyre. Nuk vonoj dhe ia behu profesori.

– Hej! Këtu jam! – i bëzana duke nxjerrë pak kokën anash

– Ç'është gjithë kjo tollovi, ë? – me pyeti rreptë, duke

bërë me dorë drejtë sallës ku kishin zënë vend ish shokët e medresesë në krye me Imamin.

– Më vjen keq, por ishte e paparashikuar zotëri! – ia ktheva me zë të ulët dhe desha t'i sqaroja se si qëndronte puna. Nuk më la të arsyetohesha, por vazhdoj me urdhrat e prerë, ashtu siç ishte zakoni i tij:

– Mos vepro sonte! Nesër në mbrëmje, pak para mbledhjes së kryesisë! Qartë?

– Më mirë do të ishte të veproj sonte... mos t'i japim kohë, sepse deri nesër ai mund t'i fsheh të gjitha paratë, dhe ne do të ngelemi me gishta në gojë pastaj...

– Jo, Jo! Kurrsesi mos vepro në mesin e kësaj tollovie... nesër... – ndërkohë u hap dera.

Ishte Imami. U afrua pranë profesorit, i cili me taktikë i tërhoqi lëvizjet e tij, që ai të pozicionohej me shpinë nga fuçitë e verës, ku isha i fshehur unë. Me kujdes të shtuar pashë kur profesori ia dha paratë të mbështjella me najlon të bardhë, dhe i tha që t'i shpërndante, jo menjëherë pas mbledhjes por nja dy tri ditë pasi të jetë marrë vendimi historik. U rrëqetha kur e mendova rolin tim gjatë dhe pas marrjes së vendimit historik.

Profesori doli, kurse Imami u avit pranë derës ku shkruante „privat" dhe e hapi. I dëgjova hapat që po ngjitej lartë me nxitim, kurse unë, si hije nate, u gjenda pranë dritares. I lehtë si ketri u hodha jashtë.

Kur zura vend, Hili më vështroi për një copë herë sikur donte të më pyeste së ku isha, kurse Rexhepi po vazhdonte tregimin e tij për pikturat dhe vuajtjet e shpirtrave në berzah.[53]

---

53 *Purgator – Vendi ku pastrohen shpirtrat nga mëkatet*

Për një çast mu bë se piktura, në heshtjen e saj absolute, përmes zërit të Rexhepit, rrëfente diçka të padëgjuar ndonjëherë! Në ato çaste, kurrsesi nuk munda ta ndaj nëse vërtetë foli piktura, pashë ëndërr syhapur apo isha në makth!

Rashë shahadet!

PIKTURA

Ju djem të rinj, që po me shikoni me ata sy të bukur, me ato vështrime mahnitëse, mos mendoni se unë jam thjeshtë një pikturë e heshtur dhe nuk marr vesh asgjë! Edhe pse ju për momentin jeni krijesa të gjalla me trup e shpirt, me ndjenja gëzimesh e hidhërimesh ashtu siç isha edhe unë dikur, mos mendoni së unë që jam pikturë nuk ndjej pikëllim, dhembje e vuajtje, sikurse edhe ju tani? Kam kaluar dhjetëra e dhjetëra vite që detyrimisht udhëtoi nga një vend në tjetrin, nga një shtet në tjetrin, nga një kontinent në tjetrin për t'ua kënaqur kërshërinë besimtarëve të Allahut... ju nuk mund ta merrni dot me mend se në ç'vuajtje ndodhet shpirti im i trazuar atje në berzah... kurse ju, pa u shqetësuar fare për tragjedinë e shpirtit tim po me shikoni të mahnitur duke menduar se unë jam thjeshtë një pikturë e pandjenja që nuk mund të mendoj dhe nuk di të flas? Jo të dashur miq

të një kombi të humbur, të një gjuhe të shkapërderdhur, të një alfabeti kaur, edhe unë di të flas, të mendoj dhe të gjykoj, por vetëm për ata që dinë të me kuptojnë!

Ju të gjithë mendoni se unë jam një pikturë e bukur e punuar nga një miniaturist i talentuar mysliman ashtu siç e pëlqen feja e shenjtë islame! Unë ju them jo! Edhe pse nuk jam një pikturë origjinale, por kopja e një, apo më shumë se e njëmiliontë, prapë se prapë ju them jo! Mjeshtri im nuk ishte miniaturist por thjeshtë piktor i talentuar, që për ta bërë pikturën time, për çudi shkeli rregullat islame! Vendosi ta zgjidhte artin perspektiv perëndimor në vend të artit famëmadh areal të orientit! Ngjyrosi me ato ngjyra që ngjyrosë vetëm Allahu i Madhërishëm, duke i shndërruar në ngjyra rebele që ia kishin shpërthyer shpirtin e tij prej talenti dhe bëri shirk... bëri shirk me ato ngjyra që i kishte shpallur tabu vetë Pejgamberi, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të. Hidhërimi i Allahut mbi atë piktor të talentuar nuk kishte ardhur pse ai kishte shkelur të gjitha rregullat islame dhe kishte bërë piktura, por kishte ardhur nga vërtetësia me të cilën e kishte pikturuar modelin e trupit dhe të pamjes sime të dikurshme, kryekëput, si të kohës kur isha i gjallë!... (nuk dua të më dëgjojnë të tjerët, sepse pikturën time e ka bërë shumë më të bukur se ç'isha në të vërtetë!) A nuk ju duket edhe ju mëkat i madh që një pikturë kështu si e imja të jetë kopje komplet e modelit, në këtë rast e pamjes sime të dikurshme? Por, nganjëherë, kur po ndodhem në kulmin e zemërimit, po mendoj duke e ngushëlluar veten së gjithsesi me rastin e pikturës sime kanë rrjedhur disa gabime. Për shembull, po i marr rrobat e mia me të cilat me ka pikturuar ai piktori im i talentuar!

Kaftani i mëndafshtë në pikturë, është aq i bukur, me ngjyra të shndritshme e të pastra sa që gjatë gjithë jetës sime kurrë nuk e kam pasur një të tillë! Pastaj pamja ime e fytyrës nuk ka aspak ngjashmëri me pamjen time të vërtetë që e kam pasur dikur, atëherë kur isha i gjallë... por megjithatë, jam i lumtur se piktori im sybajame, po ashtu edhe ju që po më shikoni tani në pikturë nuk më keni parë asnjëherë në të gjallë për të bërë krahasime... dhe shyqyr që nuk më keni parë!

Para se të kishte filluar nga puna për ta bërë pikturën time, piktori im sybajame, nxori nga sirtarët e moçëm Sira e Hadithe të vjetra dhe në to lexoi historinë time, që unë do t'ua rrëfej një pjesë të saj, por vetëm atyre që dinë ta kuptojnë këtë gjuhën time të heshtur:

Derisa po bënim hutbe për fenë e ndritshme islame të zbritur nga Allahu xhel-le shanuhu, na sulmuan të pafetë! Përpëlitjet e trupit tim të prerë, të gjymtuar dhe të gjakosur nga shpata murtade e Kalifit Jezid, pat vuajtur aq shumë nga dhembjet e padurueshme derisa ndërhyri Azraili për ta ndarë përfundimisht trupin tim të gjorë nga shpirti. Deri në çastet e fundit kur trupi dhe shpirti im ishin së bashku, të gjitha vuajtjet fizike e shpirtërore i përjetuam të pandarë! Prerjet e mishit nga shpata, thyerjet e kockave, çarjen e kafkës dhe derdhjen e gjakut e kishte përjetuar deri në çmendi trupi im i gjorë, i bërë përshesh nga goditjet e pamëshirshme të atyre vrasësve të poshtër dhe as në grahmat e fundit, shpirti im i dashur nuk ishte pajtuar me realitetin e hidhur se vërtetë kishte ardhur koha që ne të ndahemi nga njëri-tjetri, për të jetuar ndaras deri në ditën e gjykimit të madh që do të na bëhet! Kur e shikoja shpirtin tim të shkretë që përpëlitej

me gjithë forcë duke u mbajtur fort pas trupit tim tani më të shkallmuar, ndjeja dhembje të pakrahasueshme! As dhembjet nga sharjet e fyerjet nga më të rëndat që i bëheshin së bashku trupit dhe shpirtit tim nga ata horra të pafe, nuk me patën munduar atëherë, e nuk po mundojnë as sot, sa më patën munduar dhembjet e përpëlitjet e trupit të mjerë që po ndahej përgjithmonë nga shpirti im i dëlirë prej hazreti!

Tani nuk e di se sa kohë më kishte qëndruar te koka Azraili, por e di se disa herë më kishte thënë; Hape gojën pak e jepi udhë shpirtit të del lirshëm dhe unë ju kisha përgjigj; nuk e hapë dot se nofullat i kam të thyera, gojën e mbushur me gjak e fytin e prerë rrafsh, prandaj epi udhë ti shpirtit të dalë vetë nga vrimat e gjoksit që m'i shpuan të paudhët me hanxhar... mund të dalë edhe nga gryka e gurmazit tani më të prerë rrafsh me shpatë! As sot nuk e di se si dhe në ç'rrethanë më doli shpirti, por për një gjë jam shumë i sigurt. Në momentin kur shpirti doli dhunshëm nga trupi im, ndjeva një shkërmoqje, pastaj më erdhi një lehtësim që m'u bë se ma mbështolli mbarë trupin e shkallmuar... por pas pak çastesh vërejta se isha gabim. Trupi nuk kishte përjetuar kurrfarë lehtësimi, përkundër, ishte rënduar edhe më! Lehtësimi i kishte ndodhur vetëm shpirtit tim, që nën flatrat e Azrailit kishte filluar të largohej tutje, në qiellin e vrenjtur gri të asaj dite të trishtueshme që po lindte!

Ashtu siç është e shkruar edhe në librat e shenjtë, tre ditët e para, pasi shpirti ishte çliruar nga trupi im tani më kërmë e vdekur, ishte vërtitë vërdallë rreth e qark tij duke e qarë me dhembje braktisjen e parakohshme, kur ne së bashku, trupi e shpirti, ishim në kulmin më frytdhënës në

aplikimin e hutbeve tona të shenjta! Një braktisje të tillë, disa dijetarë të mëvonshëm e kishin cilësuar si tradhti e shpirtit ndaj trupit, tek i cili kishte gjetur prehje dhe qetësi, ku kishte përjetuar gëzime lumturi e të gjitha të mirat që i jetojnë të gjallët dhe në fund, fare pa e paralajmëruar e kishte braktisur në mesin e fushëbetejës trupin tim të vrarë e të sakatuar nga dora kriminale Jezide. Kështu kishin vepruar edhe shpirtrat e tjerë që i kishin braktisur trupat e tyre kudo e në çdo rrethanë si në punë, në gjumë, në luftë, pranë fitores, afër ngadhënjimit, në ujë, në zjarr, në dashuri e në shumë rrethana të tjera! Pastaj, me lejen e të Madhërishmit shpirti ishte ngjitur lartë në berzah për pastrimin e mëkateve të vogla që në bashkëpunim me trupin i kishim bërë ndoshta pa dije e pa dashje derisa ne ishim të gjallë, një e të pa ndarë! Ashtu siç i përjeton dhembjet e vdekjes trupi, ashtu i përjeton dhembjet e pastrimit shpirti gjatë qëndrimit të tij në berzah! Oh, ç'dhembje!

Ç'është e vërteta, para se të më kishte lindur trupi, me gjithë atë bukuri që ma kishte dhuruar i Madhi Allah, shpirtrat kishin jetuar në një kohë pa fillim e mbarim, duke pritur radhën e jetësimit të ndonjë trupi që do t'ia caktonte i Madhërishmi!

Edhe tani, shumë shekuj pas ndarjes së trupit nga shpirti, e kujtoj me dhembje atë kohë, se sa i lumtur kisha pas qenë sa isha i gjallë! Këtë e pata kuptuar menjëherë pasi Azrali e kishte ndarë shpirtin nga trupi. Isha gojëtari më i mirë i hutbeve pas Pejgamberit të Madhërishëm. Kisha fituar zemrat e mijëra e mijëra besimtarëve, të cilët me përuleshin me nderim! Me kishin dhuruar shtëpi e katandi, prona e pasuri sa më kishin barazuar

me kalifin mendjemadh! Me kishin dhuruar djem të rinj e trima të armatosur për të me mbrojtur nga sulmet Jezide! Fjala ime ishte balsam për zemrat e vuajtura të besimtarëve! Në faltore e kuvende, në gazmende e ditë festash, gjithmonë isha i pari! Në familje e shoqëri, pranë hyrive të reja e sy bukura të cilat më nderonin, më përkëdhelnin dhe më mbështillnin në përqafimet e tyre të buta dhe lëkurëmëndafshta duke ma dhuruar virgjërinë... ndjehesha njeriu më i lumtur në botë!

Por tani, ka ndryshuar çdo gjë! Trupi im i dikurshëm, i pashëm, i bukur dhe i fuqishëm është zhdukur fare, vetëm disa kocka kanë ngelur. Pikturën time perspektive me përmasa reale ma bëri piktori im sybajame, ndërsa shpirti im i trazuar nga shirku i tij ngeli në berzah për të vazhduar pastrimin nga harami që bëri ai piktor i paudhë, Allahu e degdistë në zjarrin e xhehenemit! Amin!

Disa arkeologë duke gjurmuar kanë zbuluar ca eshtra në afërsi ku me patën vrarë e sakatuar idhujtarët dikur e në një kohë, por t'ju them të vërtetën nuk ishin eshtrat e trupit tim! Duke menduar të kundërtën ata i varrosën me nderime të mëdha dhe bënë festë të madhe pranë atij varri të huaj!

Në shenjë nderimi dhe respekti për trupin tim të dikurshëm që dergjet diku në një gropë që ende nuk e kanë zbuluar ithtarët e mi te të gjitha kohërave, dhe shpirtit tim që gjendet në berzah në pritje të hyrjes së tij në parajsë, kur besimtarët e shumtë faleshin para atij varri dhe ngritin kokat lartë për t'ju falur shpirtit tim të dëlirë, ndodhi hataja! Piktori im sybajame bëri shirk, pa pasur frikë nga ndëshkimet e mundshme, duke më pikturuar aq bukur sa që shpirti im u dashurua pas pikturës, duke

e harruar trupin e tij të vërtetë që dikur i kishte dhënë shpirt e jetë! Tani, pritja shekullore për ringjallje sikur është vënë në dyshim! Vallë, kur të vijë ajo ditë, nga cila anë do të anojë shpirti im i gjorë; nga skeleti i trupit tim që dergjet tre pashë nën dhé apo nga piktura ime e shpërndarë në miliona kopje në mbarë botën?

Në fillim fare, kur mjeshtri i talentuar bëri pikturën time të parë, për shpirtin tim sikur nuk qe ndonjë gjëmë e madhe, sepse ishte vetëm një pikturë dhe shpirti im kishte ndarë një pjesë nga fryma e vet sa për t'ia dhuruar pikturës së dashuruar me rastin e ringjalljes, por piktori im sybajame nuk ishte i kënaqur me kaq. Duke i anashkaluar me përbuzje rregullat litografike orientale, përdori ca aparate kopjuese, (kështu i patën emëruar kaurët e pafe ato marifete që i patën zbuluar duke bërë hapur shirk) filloi nga shumëzimi i kopjeve të pikturës së punuar prej tij, duke e arritur numrin e tyre në miliona të tilla! Me kohë shpirti kishte filluar të shqetësohej, por nuk kishte asnjë mundësi të ndërhynte për ta ndaluar shirkun. Përpëlitjet e shpirtit tim të gjorë i kishte vërejtur i Madhërishmi dhe i kishte thënë se duhej të qëndronte edhe disa shekuj, ndoshta edhe disa miliona vjet të tjera në berzah për të vazhduar pastrimet e kësaj idhujtarie që po i bëjnë ithtarët e mi, trupit dhe shpirtit tim të mjerë!

Nga marazi e pezmi që e kishte zënë shpirtin tim të gjorë pas kumtimit të lajmit nga i Madhërishmi se duhej vazhduar të qëndrojë në berzah edhe një kohë të pakohë, shpirti kishte filluar të shëtitej sa në një kënd të berzahut në këndin tjetër duke u takuar me shpirtra të tjerë që edhe ata i mundonte i njëjti hall; piktura apo skulptura perspektive e trupave të tyre që i kishin braktisur dikur,

por të punuar me përkushtim nga mjeshtër të mëdhenj, pa i përjetuar ato, pa e hetuar, shpirtrat kishin filluar të dashuroheshin pas atyre pikturave apo skulpturave! Duke e parë i Madhërishmi se shirku dhe idhujtaria që vazhdonin t'i bënin krijesat e tij të gjalla në tokë nuk kishin të sosur, kishte filluar t'i kthente në berzah shpirtrat e tyre! Kthimi në berzah bëhej për t'u pastruar dhe pastaj të ktheheshin prapë nga kishin ardhur, në xhenet... por tani nuk dihej se kur do të ndodhë një mrekulli e tillë!

Dukej se në berzah nuk do të kishte më vend për shpirtrat e trupave të vdekur e të dëshpëruar nga idhujtarit dhe shirku që i bëheshin Allahut nga krijesat e tij të gjalla në tokë! Ata e kishin quajtur fitore të madhe kur një idhujtari kaur e të pafe ju kishte mbushur mendja se kishte ardhur koha që botës t'ia dhuronte një të ashtuquajtur fotografi që do ta zëvendësonte punën e lodhshme të piktorit e të litografit. Duke përdorur ca materie kimike si pluhur pambuku që ndizet, eter sulfurik, alkool të pastër, përzierje acidi acetik, sodë iposulfide... dhe në fund pamja e krijesave të Allahut ngjitej në letër duke marrë përmasa aq identike sa që, vetëm shpirti ju mungonte! Disa dijetarë të frikësuar nga shirku dhe të hidhëruar nga idhujtaria e atyre kaurëve të pafe e kishin ndjerë veten të fyer dhe nuk e kishin pranuar atë gjë të mallkuar ta kishin në mesin e tyre. Ata kishin pasur të drejtë sepse e dinin se vetëm i Plotfuqishmi është ai që krijon... dhe bota e njerëzimit, e yshtur nga shejtani i mallkuar, kishte filluar ta pranonte atë gjë të nëmur duke e përsosur edhe më tej pa e pasur frikë Të Plotfuqishmin!

Kaurët e pafe, pa e qarë kokën se po e sfidonin Allahun e Madhërishëm, pa e qarë kokën se bënin sakrilegj,

vazhdonin me të tyren derisa një ditë ju kishte mbushur mendja se ato piktura të mallkuara, të shpikura prej tyre që i quanin fotografi, t'i mbërthenin në një shirit që zgjatej e stërzgjatej pambarim dhe t'i fusnin në kuti, bashkë me pamjet dhe zërat e tyre dhe nën rrezet e atyre dritave xhuxhe që i kishin krijuar të pafetë, t'i reflektonin në pëlhurë të bardhë si të ishin të gjalla. Ato dritëhije shejtanësh, të pashpirta, i shndërronin në çmendi mahnitëse krijesat e Allahut... që pa emrin dhe kyvetin e Tij, i kishin krijuar ato marifete duke i harruar thëniet e Kuranit Kerim ku shkruan qartë se vetëm Allahu është ai që krijon!... Dijetarët e devotshëm islam, të tmerruar nga këto idhujtari të papara e të padëgjuara ndonjëherë, kishin pyetur njëri-tjetrin së ç'janë këto marifete malukatësh me pamje, zëra e lëvizje njerëzish, e me hije shejtanësh? Kush guxon t'i krijojë këto pamje të mallkuara pa dhënë emër Allahu i Gjithëfuqishëm? Ku janë besimtarët e devotshëm të islamit? Ku është shpata e mprehët e Profetit? O Allah, të na i bësh kabull mallkimet tona kundër të pafeve, kundër idhujtarëve e kokë krisurve kaurë që me paudhësitë e tyre po e sfidojnë Madhërinë Tuaj! O Allah, mbushja mendjen atyre kokë shkretëve që ta ndërpresin imitimin e qenieve të krijuara nga Madhëria e Juaj... largoi nga përjetimi e konkretja dhe jepu rrugë të mbarë të yshten në dehje shpirti e t'ju qëndrojnë besnik imagjinatës, abstraktes, misticizmit dhe të largohen sa më parë nga krijimi, sepse vetëm Madhëria e Juaj është Ai që krijon!

Besimtarët e bekuar të islamit, në fillim i injoruan me përbuzje këto marifete që kaurët e pafe i quajtën fotografi. Por, të yshtur nga shejtani i mallkuar disa nga besimtarët

filluan të afroheshin dalëngadalë drejt tyre duke thënë se janë të nevojshme për mbrojtjen e islamit... pfu jazëk, të paudhët... kur e dinë se i Madhërishmi ia dhuroi njerëzimit sheriatin për ta mbrojtur islamin. Në surën Tevbe, fjala e Allahut e sqaron bukur së si duhet mbrojtur virtytet islame kur i Madhërishmi thotë: *„Luftoni ata që nuk besojnë Allahun e as botën tjetër, nuk e konsiderojnë të ndaluar (haram) atë që e ndaloi Allahu dhe i dërguari i Tij, nuk besojnë fenë e vërtetë...“*[54] Islamin nuk e mbrojnë ato fotografi të mallkuara por e mbron besimi dhe... *„Ata që besuan luftojnë në rrugë të Allahut, e ata që nuk besuan luftojnë në rrugë të djallëzuar. Luftoni pra miqtë e djallit, s'ka dyshim se intriga e djallit është e dobët.“*[55] *„O ju që besuat! Mos zini miq as jehuditë, e as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtetë Allahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqarë.“*[56]

Në berzah shpirtrat janë të trazuar. Lëvizin sa lartë e poshtë duke provuar të pastrohen, por kot! Harami mbidhé vazhdon me intensitet të shtuar. Sfida ndaj të Gjithëfuqishmit vazhdon me hapa marramendës. Krijesat e të Madhërishmit vazhdojnë pa çarë kokën për shirk e idhujtari, të krijojnë ato që nuk janë në kompetencat e tyre por janë punë dhe detyrë e Allahut! Vazhdojnë zbulime të reja duke e sulmuar dhe therur qiellin e shtatë... atë qiell që me lejen e Tij e kishte vizituar vetëm i dërguari i Allahut salamu alejkum, kaluar mbi Burakun e tij të bardhë dhe nën shoqërimin e Xhibrilit,

---

54 Kuran 9:29
55 Kuran 4:76
56 Kuran 5:51

paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi shpirtin e tij të dëlirë! Dhembjet nga këto therje janë të tmerrshme! Pezmi ka arritur kulmin. Shpirtrat janë të dëshpëruar. Meleqet janë të trazuara! Zjarri i xhehenemit ka marrë hov duke i përvëluar ata që bënë shirk e nuk besuan. Dera e xhenetit po ngushtohet... disa nga ata që ishin aty kanë filluar t'i nxjerrin dhunshëm sepse siç duket të yshtur nga shejtani i mallkuar po e marrin lakmi botën e shthurur të atyre që janë të gjallë mbi dhé. Të sulmuar nga kjo kohë idhujtarie, nga shirku i besimtarëve të tij të devotshëm, nga të shfrenuarit dhe të degjeneruarit perëndimor që kanë marrë dhenë, islami po detyrohet të bëjë reforma, duke i lënë anash ato rregulla që me ndihmën dhe mëshirën e Allahut, Pejgamberi i kishte caktuar dikur dhe në vend të tyre po nxjerrin bidate të reja e anësore të kopjuara nga një imam-hoxhë-predikues që përballë mbanë të varur fotografinë apo pikturën e vet, dhe pa ngurrim po ju thotë besimtarëve; o xhemati im, vetëm unë i lutëm Allahut ashtu siç ju kishte lutur hasreti Muhamed dikur, vetëm unë lidhem namaz ashtu siç ishte lidhur Imam Aliu dikur, vetëm unë bie sexhde ashtu siç kishte rënë Imam Huseini dikur... dhe xhemati i tij porsa del nga xhamia, i yshtur nga shejtani i mallkuar shkon drejt e në kinema për të parë ata filma të tmerrshëm, të riprodhuar nga të pafetë që prapa atyre dritëhijeve fshihet vetë shejtani i mallkuar!

O ju djem të rinj, mos u mrekulloni me pamjen e pikturës sime por le t'ju vij gjynah për trupin dhe shpirtin tim dhe sa herë të më shikoni më ata sy të bukur, lutuni para të Madhërishmit për mua, kopjen e pikturës së mjerë që për ca para të qelbura më shitën dhe më blenë

me dhjetëra e qindra herë ca matrapazë të pacipë duke dorë me dorë derisa me bleu ky faqezi që po pinë dhe po i shërben klientët e tij me verë e raki dhe pa fije turpi më vendosi në muret e nxira nga bloza të kësaj mejhaneje, duke krijuar përshtypjen para jush se është besimtar i denjë i islamit... dhe ju kokëtulë e trutharë po e besoni? Haram u qoftë nëse e besoni!

E marr me mend, e ndjej, se sa herë me shikoni mua, në mendje ju ringjallën lloj-lloj historish që kanë udhëtuar nëpër shekuj të zbukuruara dhe të deformuara nga njerëz të ndryshëm që tani të përkthyera në gjuhën tuaj të shkapërderdhur dhe të shkruara me germa kurrë, kanë arritur deri të ju dhe çuditërisht të besueshme! Allahu ju ndëshkoftë! Dhe kështu siç po ju shoh unë, në dritën e syve tuaj e ndjej se në heshtje po më pyesni jo për historinë time që ua rrëfeva pakëz më parë, por për punën e shpirtit tim që ndodhet në berzah dhe botën e pastajme, pra për xhenetin dhe xhehenemin, sepse ju jeni të sigurt se unë me hutbet e mia në të gjallë e kam fituar dhe e meritoj xhenetin! Jo! Nuk e kam fituar, sepse Allahu i Madhërishëm nuk e dërgon në xhenet atë që e meriton por e dërgon atë që do dhe e djeg në zjarrin e xhehenemit atë që do!

E di që të gjallëve ju intereson të dinë se ç'farë shohin shpirtrat në dynjanë tjetër, duan të dinë si del shpirti, si paraqitet Azraili pranë atij që e ka dërguar i Madhërishmi për ta ç'shpirtëzuar! A ndjen dhembje? A ndjen frikë? Ku shkon shpirti, në xhenet apo në xhehenem? Duke e falënderuar Allahun e Madhërishëm që e ka dhënë edhe një botë tjetër të kundërt nga ajo që të yshtin drejt saj idhujtarët dhe shejtani i mallkuar, nga pozita që kam

këtu para jush si kopje pikture e varur në mur dhe nga pozita e shpirtit tim që për shkak të shirkut që e bënë dhe po vazhdojnë ta bëjnë ithtarët e mi, mund t'ju them se shpirti im i gjorë, bashkë me shpirtrat e atyre idhujtarëve që më patën vrarë dikur, në paqe të plotë ndodhemi në berzah për t'u pastruar nga disa mëkate të vogla! Kurse sa për ato mrekullitë që shkruhen në Kuranin Kelamullah, shpirti im akoma nuk i ka hasur! Nuk më ka rastisur as të dëgjoj nga ata shpirtra që dhunshëm i kthyen nga xheneti në berzah për t'u pastruar sepse ithtarët e tyre në tokë ju kishin bërë piktura, fotografi e filma! Pra, me një fjalë, shpirti im akoma nuk ka takuar ndonjë pallat të artë ku pranë tij rrjedhin lumenj nga mjalti, nuk ka hasur në verë të ëmbël për njerëzit, nuk ka parë pemë gjethemëdha me lloj-lloj frutash, nuk i ka rënë të ulet në kolltukë të rehatshëm e nuk i ka rastisur shpirtit tim t'i shërbejnë hyritë symëdha... por ju, mos u brengosni, sepse në botën tuaj të gjallë, bukuroshe të tilla symëdha nuk keni nevojë t'i ëndërroni sikurse ne shpirtrat e gjorë! Ju keni mundësi t'i takoni, t'i shikoni, t'i ndjeni pranë vetes, t'i ledhatoni dhe t'i dashuroni me gjithë qenie, duke e shijuar nektarin e tyre të ëmbël, sepse bota është e gjallë dhe për të gjallët! Por ju, mos mendoni se unë me këshillat e mia modeste po ju tërheq drejt mosbesimit... Estagfirullah! Të gjitha këto duhet kuptuar drejt dhe ashtu siç po i them për shkak të gjendjes së shpirtit tim të trazuar tej mase nga dorë idhujtarie. Prandaj, ekzistimi apo mosekzistimi i lumenjve apo virgjëreshave symëdha që gjenden në xhenet, shpirti im, brenda këtij rrugëtimi të gjatë mijëvjeçar nuk i ka takuar asnjëherë! Po të doni të informoheni më realisht për xhenetin dhe xhehenemin,

ndalojeni menjëherë shirkun, luftojeni idhujtarinë, ndërpriteni krijimin dhe binduni se kjo është specifikë vetëm e Allahut, Ai bën të paqenën dhe i jep shpirt të pashpirtës, besoni në Allahun që është një e nuk ka shok tjetër! Po filluat t'i bëni këto, duhet së pari t'i shkatërroni ato që i krijuat pa lejen e të Madhërishmit, duhet t'i shkatërroni ato drita xhuxhe që i krijuat pa pëlqimin e Allahut të plotfuqishëm... sepse po të dëshironte Allahu do t'i kishte krijuar vetë! Duhet t'i shkatërroni pikturat e skulpturat perspektive, fotografitë e filmat që flasin dhe lëvizin me pamje njerëzish e me dritëhije shejtanësh, çdo gjë që ngjyrosni duhet ta bëni vetëm me ngjyrat e Allahut! Duhet të rreshtoheni drejt areales, drejt mospërjetimit që ju shpie në imagjinatë... forcojeni fantazinë dhe thellojuni në ëndrrat tuaja... me një fjalë; jetoni jetën tuaj ashtu siç na këshillon i Madhërishmi; nën peshën e abstraktes absolute!... Dhe në fund, t'i çuni kryemadh e sy mëzat që po me shikon hutueshëm, duhet të ndërgjegjësohesh dhe t'i shkatërrosh ato tri fotografi të asaj vajze të bukur e të mjerë, të bëra nga magjistari për ca para të fëlliqura, e mos t'i përdorësh për intriga kundër saj! Po e bëre ti i pari një gjest të tillë human, ashtu siç të këshillon feja e shenjtë islame, dije mirë se mbarë njerëzimi do ta ndjek pas shembullin tuaj të mirë dhe bota do të fillojë të lëvizë prapa me gjithë të mirat e mrekullitë e saj derisa të arrijë në kohën e ndritshme të Pejgamberit selamu alejkum dhe në atë kohë, nuk do të ketë më as lindje e as vdekje, as fëmijëri as rini e as pleqëri... koha nuk do të ecë as para e as prapa... dhe kështu, bota do të mbetet pezull përgjithmonë, në jetë të jetëve, deri në ditën e kiametit!

Edhe një këshillë para se të ndahemi: Gjatë rrugëtimit

tuaj hyjnor drejt kthimit prapa deri të paraardhësit, keni kujdes e ta ndaloni hapin në kohën e profetit... sepse, po kaluat vetëm një hap më tutje, do të gjendeni në kohën e tmerrshme të idhujtarisë! Po ju ndodhi kjo, kurrë nuk do të gjeni ilaç për shërimin e sëmundjes së rrezikshme të mosbesimit! Sa tmerr!

Allahu qoftë me ju!

Amin!

FOTOGRAFITË

Sa mirë e ndjeva vetën kur ngela i vetmuar, larg Imamit hileqar, pa e menduar asnjërën nga ngjarjet e trazuara të ditës, pa i vënë re fjollat e borës që kishin zënë të rralloheshin kur eca mes për mes rrugës që më shpie brenda ngrohtësisë së kullës sime, ku vetëm aty, pranë vatrës dhe bukës së valë gjej prehje e trupi më pushon, syri më dremitë dhe mendja lirshëm ëndërron të bukurën duke dëgjuar fjalët e ëmbla të nënës, që më vijnë si dallgë deti duke me përkundur lehtë si në prehrin e ninullave të moçme. Çdo gjë më duket ndryshe nga ajo që e lash në djepin e ditës së përgjumur që po tretët, sikur vetë Allahu të kishte krijuar rishtas, vetëm për mua, një botë areale me plot ëndrra që më mbërthejnë dhe më degdisin tutje në qiellin e davaritur nga retë!

Tutje nga perëndimi retë kishin filluar të zvarriteshin njëra pas tjetrës, duke krijuar një dritë të kuqërremtë!

Shtresa e hollë e borës mbi fijet e gjata të barit, tutje në kopsht, kishte marrë formën e vijave të lakuara. Qeni përtac kishte zënë vend në ngrohtësinë e shtëpizës së tij. Vetëm kur kalova bri tij ngriti pak kokën dhe më pa me ata sy të përgjumur. Hapi gojën e madhe përgjumshëm duke lëshuar një zë të mekur dhe u ngrit në këmbë duke tundur bishtin në shenjë nderimi. Kalova pranë manit të moçëm që nën peshën e hollë të borës dukej edhe më i heshtur se vetë heshtja ime, dhe u gjenda pranë hangarit të vjetër. Nën strehën e tij pashë të varur një thes kërpi bosh që e kishte varë nëna për t'u tharë! Për disa çaste u afrova edhe më pranë, duke e shikuar me pikëllim thesin që m'u bë sikur e sfidonte qetësinë boshe të hangarit, që kishte ngelë i zbrazët dhe pikërisht ajo zbrazësi ma trazoi shpirtin duke më rikthyer në të kaluarën që më solli nostalgji. Peizazhi përreth m'u mjegullua. Si në vegime pashë babën, vëllanë dhe xhaxhanë që në thellësi të hangarit sikur po merreshin me deponimin e drithërave... ju këndova rahmet!

Kur e hapa derën e ahurit të kullës së moçme, e përzier me cijatjen e zgjatur, i beftë me erdhi zëri i mekur i nënës. Për një çast ngriva në vend. Prita edhe ca çaste. Zëri i nënës sikur pushoi. Bashkë me cijatjen e zgjatur, ngadalë, sikur kisha frikë se po i zgjoja nga gjumi i rëndë shpirtrat e vdekur të kësaj kulle, e mbylla derën. Ishte po ajo derë e rëndë e punuar me dërrasa bungu, që kishte mbi dyqind vjet që hapej e mbyllej nga dorë e brezave të këtij trualli! Në të vërtetë, sa herë që kthehem nga diku dhe futem gati vjedhurazi nga kjo derë, disi ndjehem mirë. Teksa eci hajatit të errët, si gjithmonë, ndoshta për shkakun e vjetërsisë së kullës, mendja më ikë larg në të kaluarën.

Sikur më vijnë të njohur brezat e trojeve, të veshur me tirq galanë e me pushkë në dorë duke zënë pritë pranë frëngjive të radhitura njëra pranë tjetrës. Në çast më vijnë ca zëra të përçartë si vaje foshnjash, ca zëra pajtues që pasojnë me ca ninulla të përhumbura, ca këngë vajzash të shoqëruar me def... dhe ashtu, duke i ngjitur shkallët e drunjta, që cijatin vajtueshëm nën qëndresën e tyre të moçme dhe mbi peshën e këmbëve të mia të reja, tutje nga divahanja sikur dëgjoj zëra burrash të tretur nën tingullin e zgavruar të lahutës... dhe pa dashur kthej kokën për t'i parë ato frëngji të ftohta, të heshtura e të dala kohe dhe nga ajo dritë e mugët që depërton prej tyre brenda hajatit të errët, e ndjej se dalëngadalë po me shfaqen ndjenja të forta të fitoreve të reja. Por... cilave fitore se?

Të gjitha këto vaje foshnjash, këngë dasmash të përcjella me lahutë, valle e këngë vajzash me def dhe ninulla nusesh që ishin përcjellë brez pas brezi brenda mureve të gurta të kësaj kulle, arritën deri këtu si kujtime të lodhura nga pesha e rënduar e viteve, të tkurrura nën qetësinë gri të brendisë së saj, dhe nën velin e tejdukshëm të hijes së një plake fantazmë të drobitur, që çapitet sa në njërin kënd të kullës në këndin tjetër, duke pritur e përcjellë herë pas herë, jo si dikur motit, kaçakët që luftonin për t'i mbrojtur këto troje të përvuajtura nga këmba gjakatare e pushtuesve të egër, por pret e përcjell hoxhë-imam-predikuesit e denjë të islamit... drojë të shembet nga dallgët e këtij zakoni të ri që kurrë nuk e pati kjo kullë, më ushtuan në vesh fjalët e nënës që m'i tha ditë më parë!

Kalova mes për mes hajatit të gjerë, të errët dhe të ftohët dhe u gjenda pranë derës së shtëpisë së zjarrit. Zëri i nënës më erdhi më i thekshëm, disi i përvajshëm! Ndala hapin!

Qetësi! Eca edhe pak. M'u bë se dëgjova dënesje... vaj! Pastaj, një zë i qetë, ngushëllues, por i panjohur, përzihej vazhdimisht me zërin e nënës... por tani m'u bë së dëgjova dy zëra, dy dënesje, dy vaje! O Allah, ç'paska ndodhur? Rashë shahadet!

Pasi vura veshin pranë derës, dëgjova zëra plakash. Vetëtimthi i paramendova dy plaka, nëna ime dhe Zelfia, së cucërruari përballë njëra-tjetrës, që kuvendonin si nga hera. Për kë kuvendojnë vallë?

– ...ditën e Shën Mitrit ra bora e parë! Shumë herët! – dëgjova zërin e nënës.

– Vërtetë shumë herët!... Çeli s'qenka në shtëpi? Deshi të vinte edhe Cufi për t'i uruar mirëseardhje... besa, edhe për ngushëllim! U koritëm, por nuk dolëm dot! – më erdhi zëri i mekur dhe i njohur i Zelfies.

– Jo besa, nuk është në shtëpi! Por, ju ejani, se edhe ai nuk do të vonohet.

– Gjyshe, a t'i lajmëroj mamin dhe babin le të vijnë? Edhe Fiti ka shumë qejf të vij këtu!– me erdhi i beftë një zë fëmije.

– Jo, jo! E sheh që nuk qenka në shtëpi Çeli? – ju përgjigj Zelfia

– Po, por dada Silvi po thotë se baca Çelë do të vij së shpejti!...

– Ashtu është!... vërtetë ai do të vijë shpejt! Shko e thirri! – u dëgjua zëri i nënës!

Para se të hapej dera arrita të fshihesha në terrin e nën shkallëve. Ende pa zënë vend mirë, dera u hap. Që andej, nën peshën e heshtjes së asaj gjysmerrësire pashë të vijëzohej një trup i imtë vajze me flokë të gjata e të drejta që me vrap mori drejtë daljes duke e mbyllur rëndë-rëndë

derën e Ahurit që çaste më parë e kisha mbyllur vetë. Disa shqetësime të papritura filluan të më lëvrinë nëpër bark e që lidheshin me mbrapshti, si; përgjim, dhunim, vrasje...

Qetësia e krijuar pas rrapëllimës së derës sikur me yshtte të afrohem pranë derës për të dëgjuar se ç'po flisnin dy plakat, edhe pse ai zëri i brendshëm më thoshte se isha duke bërë një gjë të keqe që nuk është e shkruar as në Kuranin Kerim! Megjithatë, në maje të gishtave u afrova.

– ...po besa! Sot i mbushi gjashtë muaj që nga dita që e varrosa djalin... e mjera nëna e mjera, mi la librat shkret! – e dëgjova zërin e përvajshëm të nënës.

Sikur u ndërgjegjësova nga këto fjalë të nënës që mua nuk m'i kishte thënë asnjëherë! Teksa përpiqesha t'i kujtoja vitet e fëmijërisë që i kishim kaluar së bashku me të vëllanë, disi e ndjeva veten fajtor që asnjëherë nuk ia kisha hapur zemrën nënës rreth vdekjes së tij!

– Me duket se ditën e Shën Gjergjit e patën varrosur? – m'i ndërpreu mendimet zëri i Zelfies që depërtonte disi kryengritës në mesin e dënesave të dhembshme të nënës.

– Jo!... tri ditë më vonë... ditën e Shën Markut... se harroj kurrë atë ditë! – ia kthej nëna në mes të dënesave.

Thonë se është gjynah përgjimi fshehur kur llafosen të tjerët, por kësaj radhe sikur të isha i gozhduar nuk po shqitesha dot nga ai kënd ku kisha zënë vend dhe i dëgjoja të dy plakat që llafoseshin për vdekjen e tim vëllai. Fjalët e tyre prekëse dhe dënesët e nënës sikur më sollën nostalgji për vëllanë e vdekur në moshën më të mirë. Sytë mu mbushën me lot dhe në çast e ndjeva veten keq, disi të turpëruar përpara Allahut që gjatë gjithë këtyre ditëve nuk e kisha kujtuar asnjëherë. Bile edhe sot ika që me agun e parë pa çarë kokën për lutjet

e nënës që të qëndroja në shtëpi të paktën sot sepse do të vinin njerëz për ngushëllim me rastin e festës së Shën Mitrit. Nuk doja kurrsesi të isha pjesëmarrës i këtyre festave që si mbeturina kaurë kanë mbetur akoma të rebeluara ndër ne!

– Moj, thuaj shyqyr që më erdhi çuni shëndosh e mirë!

– Të lumtë goja moj Zelfi! Edhe unë po them shyqyr... sa u gëzova për ardhjen e tij, por, po aq edhe u mërzita... – ia kthej nëna.

– Pse moj u mërzite? – e pyeti Zelfia me zë pak të ngritur.

– Për tjetërsimin e tij... po mërzitem shumë! Nuk e prisja kështu... tjetërsoj! – ia kthej nëna me zë të përvajshëm

– Ani se erdhi tjetërsoj... nuk ka gajle! Djali është i ri dhe gjërat i merr me rrëmbim por, do të kthehet në rrugën e Allahut. – e ngushëlloi Zelfia

– Në rrugën e Allahut? Jo inshalla! Ajo rrugë ia mori mendjen. Është bërë si i çmendur, nuk duron dot. Rri gjithë ditën i mbyllur me ato libra në dorë, kurse gjithë natën bredh fshat me fshat e xhami me xhami, për t'ua mësuar të tjerëve fenë e vërtetë thotë! Po ku di unë e mjera se ç'bën ai! Edhe kur ndodhet në shtëpi i vijnë për vizitë shokët e tij dhe gjithë natën rrinë zgjuar duke kënduar ilahi me zë të lartë sa që mua po më mbërthen frika nga ato sure, nga ato libra... nga ato shkronja të ngatërruara që vetëm magjitë e zeza shkruhen me to! Qyqja unë! E mjera unë, me iku djali!...

– Mos e merr me kaq zemërngushtësi! Djali është i ri dhe beqar. Kur të martohet do të këndellet dhe bashkë me nusen do t'i kthehen jetës normale si gjithë të tjerët! Sabër e selamet!

– E moj Zelfi, do të ishte mirë të ndodhte ashtu siç po

thua ti por, ti nuk e merr me mend se sa shumë është dhënë pas atyre librave. Të them të drejtën së po kam frikë se një ditë do ta gjej në dhomën e tij të shituar nga qoftëlargu siç e kishin gjetur dikur Sylejmanin e trentë.

– Si the, kë e kanë gjetur të shituar? – e pyeti Zelfia

– Sylejmanin e trentë, thashë! Kur isha vajzë e kam pas njohur Sylejmanin e trentë, kështu e quanin! Thuhej se ai kishte qenë njeri i mbërrimë! Kishte kënduar Kuranin e shenjtë derisa i kishte ftuar rreth vetes ata qofshin larg... xhindet... Ju kishte dhënë urdhra dhe duke kënduar sure nga Kurani dalëngadalë i kishte shpërndarë për t'i zbatuar urdhrat e tij! Mirëpo një mbrëmje, pasi i kishte tubuar rreth vetes, ju kishte dhënë urdhra si gjithmonë dhe kur kishte ardhur koha për t'i shpërndarë, ata nuk kishin luajtur nga vendi. Kishte provuar prapë, por prapë nuk ju kishin bindur urdhrave të tij për t'u shpërndarë! Kishte vazhduar me marifet këndimin në Kuranin e shenjtë gjatë gjithë natës, por meazallah, ata nuk ju kishin bindur më urdhrave të tij! Të hidhëruar, të nesërmen ia kishin marrë mendjen! Dhe ashtu, pa mend në kokë, Sylejmani i trentë, që nga ajo ditë kishte filluar bredhjet e tij të përjetshme sa nga një fshat në fshatin tjetër, sa nga një lagje në lagjen tjetër duke kërkuar lëmoshë!... E mjera unë! Kam frikë djalin! Hall me ata që më vdiqën e hall me këtë që më ngeli gjallë! Drojë se do të çmendet një ditë dhe do të bredhë rrugë me rrugë e pazar me pazar.

Pas këtyre fjalëve të nënës, në shpirt sikur ndjeve një sëmbim! Derisa ajo fliste, disa herë tentova ta shtyja derën me rrëmbim dhe t'i kundërvihesha nënës me tërbimin më të madh që më gëlonte pa ndërpre nëpër mendje dhe në të njëjtën kohë ta përzë nga shtëpia ime atë shtrigë plakë që

më bëhej se ajo ishte shkaktare për paragjykimet e këqija që i kishte nëna për mua. Sa herë që e zgjata dorën për ta shty derën, një zë nga brenda sikur më thoshte: „Prit! Tani vjen Fiti!“ Vetëm përfytyrimi i saj, disa herë m'i zbuti nervat! E ndjeva se kisha filluar të dyzohesha. Kisha të drejtë që e adhuroja dhe e besoja me gjithë qenien time Allahun e Madhërishëm, por kishte të drejtë edhe nëna që frikësohej së do të më humbte edhe mua, filizin e fundit të këtyre trojeve! Pastaj, sikur e mora situatën në duart e mia. Së pari rashë shahadet dhe këndova disa ajete nga Kurani i shenjtë duke e mposhtur dyshimin e frikën nga e panjohura që më rrethonte. Pas pak fillova këndimin e sureve për përzënien e xhindeve, djajve dhe fantazmave që siç duket kishin zënë vend diku në brendi të hatullave të kullës së moçme. Si një rreze e largët drite që duket diku në horizont, filluan të më vijëzoheshin në mendje disa tregime të vjetra që i kisha dëgjuar nga dijetarë të shquar e me përvojë në jetë, që rrëfenin për njerëz të mbërrimë, të cilët duke kënduar Kuranin e shenjtë e kishin humbur mendjen! Këso tregimesh kisha dëgjuar edhe gjatë kohës sa ndodhesha për studime në ato vende të bekuara! Bile, më kishte ndodhur të më thoshte edhe njëri nga mësuesit e mi më të shquar që në rrethana të tilla kur të tjerët të shohin ndryshe nga ajo se si ti e shikon veten, mos u nxito në marrjen vendimeve të pamatura mirë! Merru për disa çaste me vetveten, studioji situatat në të cilat ndodhesh, rrethanat, shkaqet dhe dyshimet pse të tjerët të shohin ndryshe... me një fjalë shpenzo aq energji sa për ta kuptuar, apo të paktën sa për të filluar ta njohësh vetveten!

Kur veshi më zuri një kërcitje të lehtë brenda shtëpisë,

nuk e di as vet përse, por mendja me vajti të shpirtrat e të vdekurve të kësaj kulle. Sikur nuk po gjenin qetësi! Kur kërcitja u përsërit, vërejta se bashkë me té brenda shtëpisë u shpërnda era e këndshme e kungullit të pjekur! Në çast i mendova edhe kokrrat e ziera të misrit dhe lutjet besëtyte të nënës me rastin e festës së Shën Mitrit! Mu kujtua gjyshja ime e gjorë, rahmet i pastë shpirti, kur me tregonte për shpirtrat e të vdekurve që çdo herë gjatë festave, pas darkës së begatë, në qetësinë e natës, pasi të gjithë binin në gjumë bashkoheshin pranë vatrës dhe në vorbën e moçme kërkonin hisen e tyre. Për ta përligjur frikën që kishte filluar të më shtrëngonte në gjirin e saj të ftohët dhe të panjohur, thashë me vete se kam filluar të mërdhi!

I mbështetur pas murit, pranë shkallëve të drunjta, qëndrova një copë herë të gjatë duke menduar për atë frikë të papërcaktuar që sa vinte e më shtohej. Kjo ndoshta më vinte sepse isha duke e pritur si në ethe ardhjen e Fitit! Disa herë dyshova që ajo do të pranonte të vinte të ne pas asaj letre që ma kishte shkruar ditë më parë! Duke i kujtuar madhërishëm suret e Kuranit të shenjtë ku thuhet se Allahu i gjithëmëshirshëm i falë krijesat e tij kur pendohen dhe lutën para madhështisë së Tij, pse mos t'ia falë edhe unë kabahatin asaj që vërtetë e dua, pasi të më ketë rënë në gjunjë e penduar?

E lehura e qenit paralajmëroi se dikush ishte në oborr. Pa menduar gjatë u hodha pranë frëngjisë sikur isha duke zënë pritë me martinë në dorë. I vura në shënjestër të porsaardhurit. Të parin e pikasa Cufin, i cili dukej si prijës i asaj çete të vogël. Pastaj pashë nënën e Fitit, dhe vajzën e vogël, të cilën e mbante shtrëngueshëm nga dora. Siç

dukej, vogëlushja trembej nga të lehurat e qenit. Përbri saj ishte Dinorja, nusja e bukur dhe flokëdredhur e Cufit dhe në fund, vështrimin e ndala mbi fytyrën e pashme dhe pakëz të hequr të bukuroshes sime, Fitit! Bashkë me pamjen e saj se si m'u shfaq edhe një rreze e pjerrtë nga drita e diellit që po perëndonte. Sikur vetë Allahu ta kishte porositur enkas për mua një bukuri të tillë mahnitëse, që pas katër vitesh për herë të parë ta shikoja të dashurën time të stolisur nën aurorën e rrezeve të dritës së diellit dhe të rrethuar si me kurora lulesh pranverore. Kur ishin afruar afër meje, por që nuk e dinin se isha i fshehur aty dhe i vështroja si i çmendur, vështrimin e përqendrova në sytë e menduar të Fitit. Sa më pikëlluan ata sy! Në çast mu bë sikur e reflektonin dritën si pasqyrë dhe nga çasti në çast do të më kapërdinin në brendinë e tyre si në ndonjë pus pafund. Shkarazi, vështrimin e vura mbi buzët e saj pakëz të fryra që më bëhej se shprehnin ndrojtje dhe brengë bashkë. Kur ishte afruar aq shumë, dhe pritej që të zhdukeshin nga pamja ime, vërejta kur ju tundën lehtë flokët e gjata mbi kordelen e mëndafshtë, që i kishte lëshuar shpupurishëm mbi supe dhe ndërkohë, mallëngjyeshëm era ia luajti tufëzat e shamisë që e kishte të lidhur rreth qafës.

Më një lehtësi si prej atleti i hodha shkallët njërën pas tjetrës duke u gjendur në divahanen e errët! Me kujdesin më të madh i vendosa këmbët skajeve të dërrasave të vjetruara të mos cijatnin nën peshën e këmbëve të mia! Pasi u struka prapa dyshekllakut, dëgjova kërkëllimën e derës së ahurit që u hap. Fill pas u dëgjua zëri i thellë i Cufit:

– O i zoti i shtëpisë, a donë miq ore!

Për një çast mbeta si i gozhduar. Nuk e kisha paraparë se ai do të me thërriste sipas zakonit të moçëm, prandaj mbeta i dyzuar; t'i përgjigjesha dhe të krijoja përshtypjen se ndodhesha lartë në dhomëzën time, apo mos të paraqitesha fare derisa me mirëpritjen e tyre do të merrej nëna! Ende pa e përfunduar mendimin, dëgjova zërin e nënës duke ju uruar mirëseardhje! U ndjeva i lehtësuar.

Pasi u mbyll dera e shtëpisë së zjarrit, dhe zërat e tyre u tretën prapa saj, përreth meje mbretëroi një heshtje e zymtë, që dalëngadalë filloi të më rëndonte aq shumë në shpirtin tim të trazuar sa që nuk e shpjegoi dot tani. Vetëm një gjë e kisha të qartë: pamjen e Fitit! Dhe për çudi, atë pamje që gati sa nuk e kisha flakur për fare nga kujtesa ime, tani pasi e pashë nga afër, m'u bë qenia më e dashur në botë. Në çast, aty për aty më lindi një dëshirë gati e marrë: ta shoh fytyrën e saj, por ajo të mos me shohë! Sa mirë!

Zbrita shkallët dhe u afrova ngadalë pranë derës së moçme të shtëpisë së zjarrit, e cila ishte e ndërtuar me dërrasa bredhi. Në mes të saj ndodhej një birë e vogël e krijuar nga një nyje e rënë. Nuk ua vura veshin zërave që vinin nga brenda, por me kujdes e vura syrin pranë birës dhe pashë në brendi! Shikimin e përqendrova mbi fytyrën e Fitit që nga distanca nuk e shikoja dot të plotë, por vetëm në gjysmë profil. Tani, në krahasim me pamjen e mëparshme të oborrit, fytyra e saj m'u duk shumë më e zbehtë dhe në çast ndjeva tronditje! Ah, e shkreta Fiti, pse je katandisur kështu, apo ndoshta nuk të zë gjumi natën nga dashuria që ke për mua? Pikërisht në këtë kohë hapi gojën e trëndafiltë duke nxjerrë një zë të qetë dhe të dhembshur bashkë dhe papritur ndjeva një dëshirë të

marrë që ato buzë të saj rozë t'ia thithja me gojën time! Dalëngadalë vështrimin e ndala në faqen e saj të zbehtë që tani pasi e kishte heq shaminë, këndshëm i dukej gusha e bardhë dhe një pjesë e gjoksit! Sa do ta doja ta kisha afër dhe t'ia prekja me dorë ato faqe të zbehta, atë gushë të bardhë dhe me gishtat e shqetësuar t'ia ledhatoja flokët e gjata! Pastaj vetëtimthi i mendova leshrat e mjekrës sime mbi gjoksin e saj të valë, buzët që më digjeshin pranë gjinjve të saj të fryrë dhe duart e shqetësuara rreth përmjetit të saj të këputur!

Aq shumë më pëlqyen këto mendime sa që e ndjeva veten se dalëngadalë kisha filluar të mbushesha me epsh. Mendjen nuk e kisha më të Allahu e as te hutbet. Nuk pata frikë se po bëja haram dhe do të ndëshkohesha ditën e gjykimit të madh që do të na bëhet! Ajo e lëvizi pak kokën dhe e hodhi shikimin nga unë... nga dera. Mu bë se më kishte pikasur dhe më vështronte me ata sy të bukur, por jo në sy, diku në gjoks! Vetëm tani e pashë fytyrën e saj të plotë. M'u duk edhe më e bardhë! Flokët mu dukën më të gjata dhe fustani i gjerë! Me erdhi tepër e imtë, e humbur brenda fustanit! Vështrimin, kuptohet me njërin sy, e ngrita lartë dhe e përqendrova prapë mbi fytyrën e saj që kishte marrë pamje gazmore. Sikur e pashë veten pranë saj duke ia zhveshë rrobat njërën pas tjetrës dhe duke e mbështjellë ashtu lakuriq në përqafimin tim! Sikur e shtrëngova pranë vetes duke ia puthur me afsh buzët! Ndërkohë, kur Cufi po fliste për miqësinë e tij me Imamin, pashë se fytyra e saj e hareshme u vrenjt në çast! Vështrimin, neveritshëm e hodhi përdhé, pastaj u kthye e tëra nga ana tjetër ku ishte e ulur Lulja dhe filloi të pëshpëriste diçka me të!

Në çast e urreva Imamin. Në çdo situatë, si në gëzime ashtu edhe në hidhërime më gjendet pranë gjoja për të më ndihmuar, por nuk e merr dot me mend se dalëngadalë po m'i shkatërron nervat... disi, nuk po më lë të qetë as në gjumë e në ëndrra e as në kujtime, por si hije xhindi më futet në mes dhe m'i shkatërron dëshirat!

Nuk më mbeti gjë tjetër vetëm të hyj brenda dhe t'ju uroi mirëseardhje. Së pari vendosa të dilja jashtë dhe që andej të futëm brenda me zhurmë duke krijuar përshtypjen se tani sa erdha. Ashtu bëra. Qetë-qetë, pa u ndie dola në oborr.

Sa kishte rënë nata. Pas një kohe të shkurtër, kur sytë filluan të më mësohen me terrin, pashë se gjysmëhëna po e shndriste paq oborrin e mbuluar me një shtresë të hollë bore. Vetëm tani e ndjeva të ftohtit që më ishte futur gjer në palcë gjatë gjithë kohës së përgjimit!

E shtyva me rrëmbim derën e rënd të ahurit, dhe u gjenda në hajatin e errtë. Pa menduar asgjë, duke u shtirë se nuk kisha asnjë ide për mysafirët që më prisnin pikërisht mua, kalova mes për mes territ të hajatit dhe e shtyva derën e dhomës.

Të gjithë njëherësh u ngritën në këmbë!

Porsa u gjenda në mesin e tyre, ju ktheva zakonit tim të shtirë, duke e harruar zakonin real që kohë me parë, në errësirë dhe në vetmi të plotë i kisha shtjelluar lirshëm! Eh, kështu na mëson feja jonë e shenjtë! Ato janë gjëra që bëhen në vetmi, me fantazi dhe fshehurazi... Allahu xhel-le shanuhu na shikon! U ndjeva i penduar. Mëzi u kapërdiva!

– Selamu alejkum! – i përshëndeta nga distanca pa i shikuar fare fytyrat e tyre.

Vështrimin e ndala mbi fytyrën e Cufit.

– Mirëmbrëma! – ma kthej Cufi duke ma zgjatur dorën.

Zura vend në divan pranë Cufit. Derisa isha duke zënë vend më mirë, me një vështrim të shpejt i përlava të gjithë më radhë. Edhe pse nuk desha, pa vullnetin tim, shikimi im qëndroi më gjatë i mbërthyer mbi sytë e Fitit, e cila ishte duke më shikuar jo me atë zjarrin që e prisja por disi me ndryshe, indiferent!

– Si keni kaluar në ato vende të shenjta, a u mërzitët shumë?

– Po për Allah... gjithë kohën sa qëndrova në ato vende të bekuara, vetëm lajmet të hidhura me shoqëruan. E lashë shtëpinë plot dhe e gjeta vetëm nënën! Të gjithë vdiqën!

– Ngushëllime! – mu bë sikur ma ndërpreu fjalën Cufi. Pastaj edhe të tjerët me radhë më ngushëlluan secili në mënyrën e vet.

Zëri i Fiti më erdhi shumë më i dashur se që prisja në të vërtetë. Kishte vite pa e dëgjuar atë zë të ëmbël, që vetëm tani e vërejta se i kisha harruar po thuaj fare ngjyrat e tij. Derisa ajo po fliste me atë zërin e saj melankolik, nuk ma shkoqi për asnjë çast vështrimin e saj gozhdë, që mua mu duk disi i mjegulluar. Jo që nuk i qëndroja dot atij vështrimi por, nuk ishte në nderin e traditës sime të re t'i shikoja femrat në dritën e syrit, e veçmas në praninë e tjerëve. Prandaj, vështrimin e përqendrova larg fytyrës së saj, diku në një pikë të pacaktuar tutje në murin përballë. Edhe nga ky këndvështrim, gjithsesi u ndava i kënaqur sepse aurorën e dritëhijes së fytyrës së saj e kisha të mbërthyer krejtësisht, sikur të ishte afreskë e pikturuar nga mjeshtrit perspektiv në kishat kaure!

– Hiqe dorën nga goja! – u dëgjua zëri pëshpërimë i

nuses së Cufit duke e qortuar Lulen.

– Të thashë edhe më parë mami, dhëmbi po më luan!

– Eja të halla një herë! Afrohu këtu shpirt!– u dëgjua zëri melankolik i Fitit.

Heshtja sa kishte filluar të rëndohej. Lëvizjet e Fitit dhe të Lules sikur më larguan nga realiteti që isha duke e përjetuar në këto çaste dhe këto që i shikoja më bëhej së isha duke i rikujtuar si një ngjarje që kishte ndodhur në një kohë të shkuar!

– Para ca ditësh ishte për vizitë të ne Imami! – tha si nëpër dhëmb Cufi

– Ashtu? – ia ktheva sa për të thënë diçka, sepse nuk e kisha mendjen fare të Imami e as të biseda që sapo e filloi Cufi, por në mënyrë indirekte i tëri isha përqendruar pas Fitit dhe lëvizjeve të saj.

– Po, ai na viziton shpesh! Mua më pëlqen shumë ai njeri. Se çka një stil të ëmbël kur tregon pjesë nga historitë e Pejgambereve.

– Ashtu është! – ia ktheva me interes të shtuar kur pashë se edhe ai kishte një lloj simpatie për reformat e reja, dhe vazhdova duke e lavdëruar: – është njëri nga më të diturit brenda Bashkësisë.

– Po, po! Po flitet se tani pas vrasjes së Hafizit, ai po e pretendon postin udhëheqës. Por me gjasë nuk do ta kurorëzojë atë pozitë për shkak se po e akuzojnë si interpretues radikal të reformave të reja islame.

– Më fal, por më duhet t'ju them sa për sqarim së këto nuk janë reforma radikale dhe nuk synojnë vetëm Bashkësinë Islame por edhe myslimanët. Sipas kësaj strategjie, myslimanët duhet t'i përqafojnë idetë e pastra të Ehli Synetit që është drejtimi zyrtar i Islamit në tërë

botën, duke u kthyer prapa deri të paraardhësit, e të largohen nga risitë që i kishin shpifur dikur disa pseudo-dijetar dhe nga risitë që po vazhdojnë t'i shpifin edhe sot të paditurit e qëllimkëqijtë. Për përmbushjen e këtyre reformave duhet zbatuar në tërësi sheriatin famëmadh, që është baza e islamit.

– Edhe ne jemi që të vazhdohet me praktikën e drejtimit fetar Hanefi që është pjesë e Ehli-Synetit suni...

– Po i ngatërroni gjërat! Jo suni, por Medh'hebi[57] Selefi, që do të thotë kthim prapa me shekuj dhe zbatim në praktikë i traditave profetike! Sipas historisë së Islamit, deri në shekullin e pestë hixhret, ka mbizotëruar fraksioni selsefi. Pas kësaj periudhe dalëngadalë filloi të zbehet ky fraksion i ndritur për t'u rikthyer para dy shekujsh shumë më i fuqishëm së ç'ishte atëherë. Prandaj, pa një kthim të mirëfilltë prapa...

– Më falni! Një gjë nuk e kam fare të qartë! Si e parashikoni ju këtë kthim të mirëfilltë prapa?

– Fare thjeshtë! Halifi[58] dhe të gjithë besimtarët myslimanë, dalëngadalë duhet të kthehen prapa deri të paraardhësit...

– Gjë e pamundur! Ligjet fizike nuk lejojnë kthim prapa të një sekonde të vetme kurse ju, tentoni të ktheheni me shekuj?!

– Prapë po i ngatërroni gjërat!

– Të lutem! Nuk po i ngatërroj gjërat por ju po i thoni të ngatërruara!

– Dëgjo këtu: Ne, nuk po tentojmë ta kthejmë kohën prapa, por po tentojmë t'i kthejmë besimtarët myslimanë

---

57 Arab. Drejtimi

58 Arab. Sundues i gjithë myslimanëve

në kohën e shkuar!

– E si doni t'i ktheni besimtarët myslimanë në kohën e shkuar?

– Të jetojnë në thjeshtësi e modesti, të vishen me rroba të moçme të kohës së profetit, të jetojnë në kasolle nën dritën e zjarrit, të kandilit apo të pishës, t'ju largohen shpikjeve teknike, rrymës elektrike, televizorit, fotografive, këngëve e dëfrimeve, të martohen siç urdhëron islami, me vajzat e axhës, me vajzat e hallës, me vajzat e tezeve e kështu më radhë... dhe duke jetuar në thjeshtësi e modesti tamam si hasreti Muhamed dikur!

– E si do t'i përmbushni gjithë këto obligime?

– Fare thjeshtë! Çdo gjë arrihet me lutje drejtuar Allahut xhel-le shanuhu!

– Më sa jam në dijeni unë, çdo gjë në jetë arrihet me punë e jo me lutje! Çdo gjallesë mbi dhé, përfshirë këtu edhe njeriun, ushqehet dhe është ushqim! Për të kërkuar ushqimin duhet punë, mund e sakrifica, e për të mbijetuar duhet mbrojte! Të gjitha këto, sipas teorisë suaj, arrihen vetëm me lutje, kurse me punë arrihet vetëm shkatërrimi i të arriturave të gjertanishme deri të kthimi prapa në kohën e perënduar! Prandaj të dalësh para besimtarëve e t'ju thuash së nëse e dëshironi mirëqenien në këtë botë dhe xhenetin në botën tjetër, punoni për t'i shkatërruar të gjitha thesaret e shpikura si në art, kulturë, teknikë e shkencë që kanë ndodhur pas largimit të profetit nga kjo botë, e për ushqim e mirëqenie mjaftojnë lutjet drejtuar Allahut!... E cili është ai që do të pranojë t'i shkatërrojë të arriturat konkrete të njerëzimit për t'u kënaqur pastaj duke i kujtuar ato në mënyrën abstrakte? Beson së do të gjesh budallenj të tillë?

– Ne nuk po kërkojmë budallenj, të lutem! Ne po kërkojmë besimtarë!

– Dhe mendoni së do të gjeni besimtarë të tillë!

– Me emrin e Allahut, do të gjejmë...

– Ndoshta, por do ta keni shumë vështirë! Njerëzit tanë, këto reforma tuajat do t'i shikojnë... më fal, jo do t'i shikojnë, por kanë filluar t'i shikojnë si ndikim negativ dhe përzierje sektesh islame në kulturën e traditat e popullit tonë! Këto përzierje po e cenojnë kulturën gjuhën dhe traditat. Prandaj, të dalësh para besimtarëve dhe të kërkosh zbatimin e reformave profetike duke i kthyer prapa në mesjetën e hershme, në gjirin e një populli të huaj, në kushtet klimatike të një kontinenti tjetër, është sikur të kërkosh prej tyre ndërrimin e kombit... ndërrimin e ngjyrës gjë që është e pamundur!

Derisa po fliste Cufi, pashë se kishte marrë pamje solemne. Pa i dhënë të drejtë vetes të jem i hidhëruar me mendimet e tij injorante, u përpoqa ta mbledh veten dhe me një ton të qetë që në raste të tilla nuk i shkon fare natyrës sime, t'i sqaroja ato që ai o nuk i dinte o nuk dëshironte t'i dinte.

– Dëgjo këtu! Dua t'i sqarojë disa gjëra: Qëllimi i këtyre reformave është kthimi i myslimanëve në fenë e pastër dhe të drejtë nga e cila kanë devijuar, e jo të pretendohet kthimi apo nënshtrimi ndaj traditave arabe, duke e konsideruar shkurtimin e pantallonave dhe rritjen e mjekrave si traditë arabe. Kjo nuk ka të bëjë aspak me traditat e tyre sepse ata nuk veshin pantallona fare, veshja e tyre kombëtare është fustanella e quajtur „Xhelabije" ose „Theub". Shkurtimi i rrobave për meshkujt është obligim në islam, por që mjerisht nuk e kanë përvetësuar të gjithë

myslimanët, disa sepse janë të dobët në besim e disa se e konsiderojnë si sekondare. Ndërsa rritja e mjekrave dhe shkurtimi i mustaqeve, pranohet nga të gjithë myslimanët dhe dihet se ajo është traditë e profetit, paqja dhe mëshira Allahut qofshin mbi të. E sa për traditat e popullit tuaj, ato duhet të ç'rrënjosen një herë e përgjithmonë dhe vendin e tyre duhet ta zë ligji islam sheriati, pa të cilin as që mendohet përhapja i kësaj feje të ndritur.

– Pse nuk thua traditat e populli tonë?

– Sepse unë nuk i takoj më këtij populli të dalë feje!

– E cilit popull i takon atëherë?

– Popullit e traditave hyjnore... popullit të Allahut, El-hamdu li-l-lah! – thashë me mburrje dhe lëviza nga vendi në shenjë respekti për fenë e ndritur.

Derisa po i tregoja me entuziazëm për vlerat e larta të konvertimit nga një pjesëtar i një populli të humbur, në një pjesëtar të përdëllyer të popullit hyjnor, pa e larguar asnjëherë mendjen nga ato që po flisja, disa herë vjedhurazi i pashë shprehjet e vrenjtura të fytyrës së Fitit. Isha i sigurt së kjo e vrenjtur vinte si rezultat i bisedës sime, që pa hezitim po e përligjja konvertimin, nga një i humbur në rrugën e ndritur të profetit. E vërejta së asaj aspak nuk po i pëlqente, jo vetëm biseda por as konvertimi. Por, kur të fus në grusht moj zogëz, jo vetëm që do të pëlqejnë të gjitha këto, por do t'i mësosh dhe do t'i zbatosh e konvertuar një për një!

– Megjithatë, ai popull dhe tradita e tij hyjnore që po i përket ti, për ne, për mua dhe popullin tim nuk kanë ndonjë dallim të madh. Që të dyja kanë lindur nga i njëjti popull dhe nga e njëjta kulturë, prandaj është e pamundur që mos të kenë huazuar diçka nga njëra tjetra!

Kurse ne, fenë e morëm nga osmanlinjtë ndërsa traditat i trashëguam nga të parët! Kjo përzierje, fe-traditë, në sytë e hyjnorëve tuaj po shikohet dhe gjykohet ndryshe, gjë që për ne është krejt normale, prandaj reformat islame, deshe apo nuk deshe, nuk po i prekin ndryshimin e lutjeve dhe sjelljeve të selefinjëve sa po e prekin traditën tonë të trashëguar brez pas brezi!

Prapë vjedhurazi e shikova Fitin. Mu bë se edhe ajo po çuditej sikurse unë kur Cufi thoshte „ne" duke me përzier edhe mua në çorbën e sojit të tyre injorant! Megjithatë, u ndjeva edhe unë mirë kur pashë se në buzët e saj filloj të vijëzohet një buzëqeshje e ëmbël! Anon nga i vëllai, mendova në çast.

– Pra sipas teje, ne nuk po bëjmë reforma islame por reforma traditash? Dihet mirëfilli së në këtë rast nuk kemi të bëjmë fare me porositë nga jeta e myslimanëve të parë, por thjeshtë me aplikimin praktik të mënyrës së jetës së myslimanëve të parë! Nuk e marr dot me mend se në çfarë tezash po i mbështetë ti idetë tuaja? – e pyeta qëllimisht, në të njëjtin stil sikurse ai duke e përdorë përemrin „ne"!

– Fare thjeshtë! Por, para se të përgjigjem, po ta shtroj një pyetje! Kur hyre në dhomë, dallove ndonjë gjë të jashtëzakonshme?

– Jo! – ju përgjigja shkurt pa e pasur idenë se ku donte të dilte.

– Mirë! Atëherë po ta them unë! E shikon tepsinë me kunguj të pjekur? E shikon vorbën me kokrra misri të ziera? Me thuaj të lutëm pse nëna i ka zier pikërisht sonte?

Kësaj radhe nuk shikova fare nga Fiti. Krahasimi i tij jo vetëm që më erdhi i beftë, por edhe më çarmatosi nga argumentet e mia. Ishte pikërisht ashtu siç thoshte ai. Por

nga ana ime kjo ishte e papranueshme. Duhej kërkuar me ngulm një përgjigje të përshtatshme! Mendja më punonte me shpejtësi dhe saktësi marramendëse, ndërsa sa për të fituar në kohë, nga goja me dolën fjalët:

– Do të jetë ndonjë rastësi!

– Kurse unë them ndryshe!

– E si thua ti?

– Unë flas kësaj radhe me argumente! Sonte gatesat janë bërë me rastin e festës së Shën Mitrit!

– E pastaj? – e pyeta me inat pa gjetur ngushëllim në vetvete.

– Pastaj, reformat tuaja islame e prekin pikërisht këtë festë, e shumë të tjera sosh, prej të cilave nënat dhe baballarët tanë e kanë vështirë të shkëputën!

– Këto janë festa kaurësh, festa pagane apo festa idhujtarie! – ia ktheva në kulmin e zemërimit

– Pyeti nënat tona ti... edhe gjyshen po deshe! Këto të tregojnë më së miri së ç'farë festash janë këto dhe a duhet festuar apo jo!

Prapë pashë nga Fiti. Ishte shumë e vrenjtur. Sytë e buzët e saj kishin marrë pamje dëshpëruese. Më erdhi keq për té! E jo vetëm për té, por edhe për veten time sepse në prani të saj, duke mos gjetur asnjë përgjigje që ta mbërtheja Cufin, e ndjeva veten para saj si një leckë e pavlerë. Nga zori e vura buzën në gaz.

Edhe Fitit i ndriti fytyra!

Pas një heshtje relativisht të gjatë, m'u kujtua një ajet nga Kurani, që për momentin i përshtatej mjaft mirë bisedës sonë! Në çast e ndjeva veten sikur isha kthyer në të shkuarën dhe që nga ajo kohë e perënduar po pozicionohesha për ta paraqitur të tanishmen dhe për

ta mbrojtur të ardhmen që po lindte!

– Popujt, – thashë duke ia hedhur një shikim të shpejt Fitit, pastaj, pas një pushimi të shkurtër, me të njëjtin shikim i përlava edhe të tjerët me radhë derisa në fund vështrimin e ndala mbi fytyrën e bardhë dhe të njomë të Lules, e cila sikurse edhe më parë, i mbante gishtat në gojë, sigurisht aty ku i luante dhëmbi. Vazhdova: – pra, popujt janë si shtazët! Kjo është shkruar me shkronja të arta në suren Furkan, ku thuhet: *„A mendon ti se shumica e tyre dëgjojnë ose kuptojnë? Ata nuk trajtohen ndryshe, por vetëm si kafshë, bile janë edhe më të humbur nga e vërteta.“*[59] Dhe kështu, ushqehen nga natyra, pinë ujë nëpër puse luftojnë për të mbijetuar dhe bien në gjumë! Ky ritëm vazhdon me vite, decenie e shekuj duke formuar historikisht traditat të cilat ruhen, trashëgohen e zhvillohen më tej si një thesar i çmuar nga njëri brez në tjetrin. Këto tradita që dikur janë formuar dhe janë trashëguar brez pas brezi kanë ardhur si rezultat i reformave që i kanë zbuluar dhe zbatuar udhëheqësit e popujve në ato kohëra të lashta! Pra, çdo traditë rezulton me një reformë! Sikur të mos kishte reforma nuk do të kishte as tradita. Ka pasur reforma në të kaluarën e largët dhe të afërt, ka edhe tradita të së kaluarës së largët dhe të afërt! Traditat e largëta kanë ngelur si relikte të rralla dhe vetëm emri ju ka ngalur, ja si festa e sotme e Shën Mitrit, kurse tradita e festës së Bajramit e futur në legjendë tani është bërë traditë edhe të populli ynë... dua të them të populli i juaj dhe është relikt i tanishëm që e festojnë me miliona njerëz në mbarë botën! Me një fjalë, edhe

59 *Kuran 25:44*

kjo festë tradicionale ka ardhur si rezultat i një reforme që Hasreti Muhamed selamu alajkum e kishte marrë dikur! Prandaj, reformat myslimane nuk janë gjë tjetër veçse tërësi ndryshimesh me karakter fetar që janë të organizuara nga klasa udhëheqëse e Ehli Synetit e që ka për qëllim zgjatjen dhe përforcimin e sundimit të vet në botën islame në njërën anë, kurse në anën tjetër, synon sundimin e botës sipas sheriatit pa i cenuar themelet e zhvillimit ekzistues! Siç thashë edhe më parë, populli, pasi të jetë ngopur mirë, dëshiron të bie në gjumë të rehatshëm pa e çarë kokën për rreziqet që ju kanosen, ndërkohë që prijësit e tyre mendojnë ndryshe. Ata duke ndenjur zgjuar i nuhasin rreziqet dhe i zbulojnë kohërat e përshtatshme të mbrojtjes! Ato kohëra, nuk janë gjë tjetër veçse reforma mbrojtëse të traditave, e në rastin tonë konkret, është mbrojtja e traditave të kohës së Hasretit Muhamed. Prijësit tanë të nderuar, të alarmuar e kanë zgjuar popullin nga gjumi duke e ftuar në pjesëmarrje aktive për ato reforma. Ata që i kundërshtojnë reformat në raste krizash të tilla, udhëheqësit janë të shtrënguar ta përdorin tehun e shpatës për t'i detyruar, siç e kishte përdorur dikur profeti ynë i Madhërishëm, mëshira e Allahut qoftë mbi të, siç e përdori imami i shquar Abdulvehabiu para dyqind vitesh, siç e përdori Imami i Madhërishëm, Ajatollah Homein në vitet e tetëdhjeta dhe siç po kërkohet të përdoret edhe tani nga ne!

Derisa po flisja, pashë se Fiti kishte marrë pamje serioze. Kjo më dha guxim për të qenë krenar me zgjuarsinë time që tregova në këtë rast, që në rrethana të tjera, pas provokimeve të tilla, të ngjashme me të Cufit, sigurisht se nuk do të isha treguar kaq tolerant! Edhe pse këto fjalë që

i thashë me një ton të qetë dhe të lakmueshëm nuk ishin të miat, por të dikujt tjetër, që në këtë rast kjo nuk ka asnjë rëndësi dhe së çuditërisht më nxorën mrekullueshëm nga situata! Rëndësi ka fakti se fjalët kishin rrjedhur aq hareshëm dhe bindshëm nga goja ime duke i lënë të tjerët gojëhapur dhe në anën tjetër, isha i sigurt se Cufi nuk do ta zgjaste më këtë bisedë, pasi e kisha lënë pa tekst!

U befasova kur filloi të fliste prapë, dhe prapë për të njëjtën temë;

– Po flisni për reforma fetare apo për reforma politike që për synim kanë ardhjen në pushtet?

– Po flas për reforma fetare që tani për tani synojnë rrëmbimin e rolit udhëheqës të Bashkësisë Islame e pastaj, pse jo edhe pushtetin!

– Ashtu!? Pas gjithë këtyre që i the, unë krijova përshtypjen se ti je në kundërshtim me fjalët tuaja! Që më parë the se reformat nuk kanë për qëllim islamin por myslimanët, duke bërë një ndarje nga tradita e veshjeve arabe me „Xhelabije“ apo „Theub“ dhe në anën tjetër shkurtimin e rrobave të meshkujve si obligim islam, kur dihet së të dyja së bashku, si veshjet arabe, si ato obliguese islame i takojnë të njëjtit popull që jeton në kompaktësi të plotë brenda territoreve arabe. Kurse, në anën tjetër, reformat i paraqet si zgjatje e sundimit mbi islamin dhe synim mbi sundimin e botës, sipas rregullave të sheriatit, pa i cenuar themelet e zhvillimit ekzistues! Me një fjalë, synohet që bota islame të jetë sikurse ishte në kohën e profetit Muhamed, me mjekra të gjata e mustaqe të shkurtra, pa e sqaruar veshjen, me xhelabije apo pantallona, në thjeshtësi modeste duke jetuar nëpër kasolle, pa elektrik, pa ujësjellës, pa kanalizim, pa

televizor, pa celularin që e mbanë edhe ti në xhep... dhe paralel këtyre e pranon zhvillimi ekzistues, ku në vend të devesë që përdorej në kohën e profetit, të përdorën makineritë e rënda transporti, në vend të bishtukut të përdorët elektriku e kështu me radhë... o duhet të bëni reforma për mbrojtjen e traditave të kohës së profetit dhe të ktheheni prapa me shekuj, o duhet të bëni reforma e t'i përshtateni kohës moderne që po e jetojmë ne sot!... pra me një fjalë, o duhet marrë e tëra, o duhet kundërshtuar e tëra, e jo të pranohet një pjesë që ju pëlqen ju, e pjesa tjetër të hidhet poshtë si e pavlerë... *A e besoni një pjesë të librit, e tjetrën e mohoni?!*[60]

– Ne nuk e kemi ndërmend ta reformojmë popullin arab me bidate të reja, por duam që xhematin tonë, dua të them xhematin tuaj ta shpijmë drejtë nurit të ndritur islam!

– Po, por është mirë që vetëm traditat fetare islame, pra ato të Ehli Synetit-suni t'i shpini drejt nurit të ndritur islam, pa i cenuar traditat shekullore të popullit tonë, edhe në qofshin ato në kundërshtim të plotë me traditat dhe rregullat islame apo të sheriatit!

– Megjithatë, pa i çrrënjosur këto tradita të lashta nga mendjet e humbura të këtij populli me tri fe në shpirt e me zemër pagane në gjoks, nuk bëjmë dot reforma!

– Nuk e di se a do të pajtohej populli ynë zemërpagan me këto reforma tuaja të paraardhësve islam, duke pranuar shkatërrimin e traditave dhe zakoneve të përcjella me xhelozi brez pas brezi, apo do të vazhdojë t'i ndjekë ato rite të trashëguara që po i predikon tash e sa shekuj me radhë?

---

60 *Kuran 2:85 – është fjala për Jehudit që një pjesë të Tevratit e besonin kurse pjesën tjetër jo!*

– Unë jam i sigurt së sot apo nesër, me dëshirë apo pa të, këto reforma do të zbatohen... e ata që nuk i pranojnë do të përballën me pasoja. Kaq!

– Por, qëndrimi i juaj, besnik ndaj paraardhësve arab dhe fyes e përbuzës ndaj nesh dhe paraardhëseve tanë nuk shikohet ndryshe veçse thikë pas shpine nga tabori islam kundër popullit tonë! I harrove kaq shpejt fjalët e gjyshit tuaj, ndjesë pastë, kur thoshte: *Gjëja më e shëmtuar në jetë është tjetërsimi! Kur njeriu tjetërsohet, ia mohon vetes, vëllezërve, miqve e të dashurve të tij të drejtën të kenë qasje në atë së çfarë janë në të vërtetë. Prandaj, qëndroni ashtu siç ju ka krijuar i madhi Zot e mos u tjetërsoni në atë së çfarë nuk jeni!*

– Çdo veprim që merret për hir të islamit, qoftë tjetërsim apo tradhti ndaj vetvetes, është e arsyeshme... të tjerat janë ëndrra! – ia ktheva flakë për flakë.

– Edhe pse jam i bindur se ke shkelë në një fushë të virgjër me ide për reforma të tilla, me dëshirë do t'ua citoj një Hadith të transmetuar nga Muslimi, ku thuhet: „*Fjala më e mirë është fjala e Allahut, Kurani, udhëzimi me i mirë është udhëzimi i profetit, selamu alejkum; veprat me të këqija janë ato të shpikurat; çdo shpikje është bidat dhe çdo bidat është lajthitje, dhe çdo lajthitje çon në zjarr.*" Të jetosh lezetshëm në luksin e shpikjeve modern, në mesin e bidateve e të lajthitjeve kaure, në njërën anë dhe në anën tjetër të mendosh dhe të veprosh në modestinë e paraardhësve myslimanë, më duket se nuk qëndron! Prandaj, për realizimin e bindjeve tuaja nga koha e mesjetës së hershme duke ua përshtatur kohërave moderne, mund të them vetëm një gjë: „mprehe shpatën!" Ikim... qëllimi i vizitës sonë nuk kishte karakter bindjesh,

por thjeshtë, karakter ngushëllimi dhe mirëseardhje. Shyqyr që u ktheve në trojet tua dhe e gëzove nënën plakë! Natën e mirë!

Tunda kokën sikur vërtetë po pajtohesha me mendimin e tij, edhe pse më preku rëndë kur m'i përmendi fjalët e gjyshit tim! Brenda meje, si në ethe po vazhdonte të lëvrinte një zemërim sa që mezi po e ndryja. Isha në shtëpinë time dhe nuk e ndjeja për trimëri të shpërtheja me atë zemërimin tim të vrazhdë. Fill pas tij u ngrita në këmbë. Vjedhurazi, me bisht të syrit pashë nga Fiti. Fytyra e saj kishte marrë pamje të vrerosur. Në çast, kur nuk e prisja, e hodhi drejt meje një vështrim të rreptë e të mbushur plot dhembshuri. Sa më preku në shpirt kur pashë se sytë i kishte me lot!

Kur u ndava përfundimisht prej tyre, nuk i vërejta dot shprehjet e fytyrës së saj nën rrezet e dritës së zbehtë të hënës! Pasi mbeta i vetmuar në fundin e oborrit, nën rrezet magjepsëse të hënës, sikur ndjeva se nga gjoksi mu shkëput një thesar i tërë vlerash shpirtërore dhe pa pikë mëshire u tretën prapa dyerve, tutje në rrugicën e ngushtë dhe të shpërlarë nën rrezet e hënës.

– Desha të shkoj për vizitë te Dili, si thua? – e ndjeva të largët zërin e ëmbël të Fitit

– Mirë, shko bashkë Lulen por mos u vononi shumë. Mirë? – dëgjova zërin e thellë të Cufit derisa po largoheshin sokakut.

Bashkë me hapat dhe pëshpërimat e atyre që po largoheshin, mu bë sikur nga unë po largohej një herë e përgjithmonë gjëja më e çmuar që kisha pasur ndonjëherë në dorë! Pesha e vetmisë sikur vazhdonte të më rëndonte pa pikë mëshire në shpirtin tim të vrerosur! Vetja m'u

duk krijesa më e mjerë në botë! Mu bë së nuk isha gjë tjetër veçse një asket i mjerë që duhej torturuar trupin tim për nder të disa paraardhësve të huaj dhe për disa çaste më erdhi gjynah prej vetvetes! Nuk rashë shahadet, sepse mu bë se as me këtë gjest simbolik nuk do të gjeja ngushëllim! U ktheva në shtëpi.

I dhënë pas lutjeve të mbrëmjes, sikur e harrova për një copë herë plagën që më ishte rihapur në zemër. Sillesha vërdallë për ta qetësuar shpirtin tim të gjorë pas gjithë këtyre vuajtjeve, dhe s'kishte dyshim se të gjitha më vinin nga shqetësimi dhe mjerimi i dashurisë për Fitin, që po e ndjeja të rikthyer. E ndjeja se do ta kem një natë të përhumbur, të shpërqendruar, të gjatë e pa gjumë. Provova të lexoj diçka, por nuk shkonte fare. Duart më hanin t'i përgatisja materialet për mbledhjen e kryesisë, por e ndjeja se nuk isha i vendosur së ç'duhej bërë; të shkoja apo... detyrimisht më duhet të shkoj... për pak para të shkreta, për një ideal të huaj e shita vetën, kohën, ndjenjat, dashurinë...

Mendja në çast, si flutur me krah të plagosur më iku të pamja e mrekullueshme e Fitit. Në vesh e ndjeva uturimën e zërit të saj të çiltër. Duke u ulur në shtrat, e luta Allahun të ma falte Fitin sonte, të paktën në flatrat e një ëndrre të bukur.

Duke bredhë me mendje sa në një ngjarje të ngjarja tjetër, që i kisha përjetuar gjatë gjithë ditës, që tani mu bë se kisha kaluar një ditë tmerrësisht të gjatë, në fund prapë mu rikujtua koha e mbledhjes së kryesisë së paraardhësve! Ishte një rast ideal të përgatisja një fjalim të shkurtër në lidhje me vlerat e Ehli synetit islam dhe dallimet që shfaqën gjatë përhapjes së tyre me ato të kohës së profetit.

I vënë në kërkim të materialeve, mbi tryezë pashë një zarf! Nuk pata asnjë ide se nga kush kishte ardhur. E mora në dorë. Pasi e hapa, pashë një letër dhe pa humbur kohë e nxora jashtë. Kishte diçka, si lloj kartoni të mbështjellë me letër vezulluese. Sipëri saj ishin të shkruara tri fjali të shkurtra, me fjalë të mençura! E njoha shkrimin e Imamit. E lexova me nge por pa vullnet:

E para:
Kujdes para së të bëhet!
E dyta:
U bë!
E treta:
Nuk zhbëhet më!

E vura buzën ne gaz. Si gjithmonë, mendova për Imamin. Sa herë që më shkruante letra kur ndodhesha në ato vende të shenjta, gjithmonë i fillonte me fjalë të mençura, herë të marra nga Hadithet, e herë nga fjalët e moçme të popullit tim të dikurshëm. Thellë në shpirt ndjeva keqardhje për té, e sidomos për mendimet që i pata pasi u ndava prej tij.

Në anën tjetër të letrës ishte e shkruar edhe një fjali tjetër e mençur: *„Mos u merr më shkakun por me shkaktarin!“*

Derisa po e nxirrja atë gjë të mbështjellë me letër, që asnjë ide nuk e kisha se ç'mund të ishte, mu duk se diçka shndriti si lustër brenda saj! E tërhoqa me rrëmbim. Një pjesë e letrës mbështjellëse u gris. Ajo gjëja që pak më parë nuk e pata idenë se ç'ishte, si befasi mahnitëse më mbeti në dorë! Ishin tri fotografi erotike që për një çast më ngazëllyen. Pa dashje vështrimin e ktheva andej nga

hamamxhiku ku për një çast para syve mu fanit pamja lakuriq e dadës Zejnebe më atë nishanin e zi në mesin e kofshëve, komplet ashtu siç e kisha parë nga vrima e bravës së derës kur isha i vogël.

Atë që e kisha parë sa e sa herë në ëndrrat e mia të këndshme, befas e pashë zgjuar, teksa po i shikoja me ngulmë ato fotografi që rastësisht më mbetën të shpërndara në shuplakat e duarve! Një vajzë lakuriq, me trup të ngrirë si statujë e gdhendur mermeri, me gjinj mesatar e me thimtha të fortë si sumbulla xhamadani, me duar të lëshuar poshtë pa takt. Qendrën e vëmendjes e përqendrova në atë pjesën trekëndëshe e delikate, pakëz të nxirë në fundin e barkut, aty ku fillon ndarja e kofshëve nga trupi! Pastaj, vështrimin e përqendrova të fotografia tjetër që kishte marrë pamjen profile duke nxjerrë pakëz përpara njërën kofshë të plotë dhe të lëmuar, kurse flokët shpupurishëm ia mbulonin vithet. Në çast, ato flokë me erdhën të njohura, të dashura!... I shikova më mirë! Identike! Ndjeva një luajtje brenda pantallonave! Ndërrova fotografinë. Një fytyrë e trishtuar me shikim të mallëngjyer, vetullvrenjtur, buzë shpërvjelur gati përvajshëm... Allah!...

Pra Fitin, që kohë më parë ju luta Allahut të ma falte në flatrat e një ëndrre, për çudinë time, Imami ma kishte falur lakuriq dhe të shkrirë për shtat palë qejfe mbi sipërfaqen e lustruar të fotografive. Ja pra, ky qenka ai imoraliteti i futur thellë në ndërgjegjen e humbur të këtyre njerëzve. Ky qenka ai imoraliteti që sa e sa herë më kishte shkruar Imami! Ky qenka ai imoraliteti që duhet zhdukur nga rrënjët... *„Mos u merr me shkakun por me shkaktarin!“*

Po, po! Vërtetë nuk do të merrem shkakun, por me

shkaktarin, dhe para sysh me doli dera e hekurt dhe roja pranë zyrës amerikane. Shkaktari! – mendova i tronditur.

I vrerosur dhe i turpëruar njëherësh, pa e pasur mendjen në vend u zhyta në botën e ndjenjave zhgënjyese që më rëndonin si plumb mbi shpatullat e mia të kërrusura. A mund t'i qëndrojë vallë kësaj peshe amorale?

Me zë të lartë dhe me fytyrë të kthyer drejt tavanit të ulët të dhomëzës sime, vazhdova duke e përsëritur tri herë mallkimin e Allahut kundër çdo populli që vepron sikurse kishte vepruar dikur populli i Lutit!

– O Allah, goditi pa mëshirë, me gurë e rrufe përvëluese, mbyti në ujë dhe vriti me erëra të forta, plasja zemrat me britma tmerri të dalë nga dheu dhe mbyti në det këtë popull të dalë feje! – pastaj me zë pak më të ulët vazhdova lutjet e radhës: – Eudhu bil-lahi minesh shejtanir rraxhimë! Bismil-lahirr Rrahmanir Rrahim! Lailahuilallah! Allahu ekber, Allahu ekber, Allahu ekber!...

– E mjera unë e mjera, djali! – dëgjova zërin e tmerruar të nënës, derisa po i ngjiste shkallët me vrap. Kur u gjend në dhomë, i thashë:

– Mos u shqetëso oj nënë. Ishin lutje që ia bëra Allahut para së të dal!

– Ku do të shkosh tani mor bir?

– Në mbledhje!

Pasi u binda se shpirti im i trazuar nuk do të gjente qetësi as brenda gjysmerrësirës së dhomëzës sime të heshtur, as jashtë nën rrezet e arta të gjysmëhënës së ftohët, vendosa të nisem pa humbur kohë! U përgatita shpejt e shpejt dhe me torbën në krah dola në oborr. Kur po bëhesha gati të hipja në veturë, para këmbëve të mia pashë se era e kishte hedhë përtokë thesin e moçëm që

kohë më parë kishte qenë i varur pranë hangarit. E mora dhe e hodha në brendi të veturës dhe pa humbur kohë u gjenda në rrugë! Derisa vetura çante mes për mes rrugës fushore, në mendjen time zuri vend një burrë i leckosur që endej sa në një katund në tjetrin duke kërkuar lëmoshë... por ai njeri nuk ishte Sylejmani i trentë siç më kishte treguar nëna sa e sa herë, por isha unë, i çmendur... jo nga këndimi i sureve të shenjta të Kuranit Kelamullah, por nga paudhësitë dhe idhujtaria e këtyre njerëzve... nga tradhtia e rëndë e Fitit!

IMAMI

Derisa po rrinim në mejhane, pranë tavolinës përballë pikturave të Pejgamberit selamu alejkum dhe të imamëve të mëdhenj, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi ta, nën shtresën e mjegullt të tymit të duhanit dhe nën zhurmën e pareshtur të klientëve pijanecë, pashë profesorin tebdil që u struk në qoshe duke zënë vend pranë një pijaneci hundëmadh. E ndjeva veten ngushtë kur profesori më shikoi ngultas në mesin e të rinjve që sapo ishim kthyer nga varrimi i Hafizit të ndjerë, por edhe u ndjeva mirë sepse misionin për të cilin më kishte ngarkuar, edhe pse me sharje dhe tërheqje zvarrë nga pjesëtarët e kortezhit, e kisha kryer me sukses.

Derisa po e shikoja vëngër profesorin, e ndjeva se plani ishte lakuar pak. Kjo lakesë nuk kishte ndodhur nga ana e tij por nga ana ime, sepse nuk e kisha paraparë që këta të rinj pas varrimit të Hafizit të ngratë, do të shprehnin dëshirën të tuboheshim në mejhane, mu në kohën kur

në mënyrën më të fshehtë kishim lënë takimin me profesorin.

Derisa po e dëgjoja Rexhepin të fliste për pikturën dhe historinë e Imam Huseinit, pashë se njerëzit përreth po na shikonin disi më ndryshe dhe papritur, me lindi një ndjesi e brendshme se edhe hundëmadhi që sa po kishte zënë vend profesori pranë tij, sikur ishte përkrahës i sojit tonë dhe po çuditej me ne. Pas pak pashë se pranë tij u afrua një tjetër duke ia vënë dorën mbi shpatull dhe me zë të lartë i tha:

– Që kurë kanë filluar soji i juaj të vijnë në mejhane të tilla e të na mbajnë ligjërata për pikturat e Pejgambereve?

Hundëmadhi i frikësuar, edhe pse nuk kisha asnjë ide se nga i vinte gjithë ajo frikë, nuk la shenjë pa përdorur duke ia bërë me sy e vetulla, me gojë e buzë... bile mu duk se edhe hundën e madhe e futi në veprim për t'i dhënë shenjë tjetrit të mos fliste. Frika e tij sikur mu ngjit mua, derisa të mjegulluar e shikoja fytyrën tebdil të profesorit.

Profesori më dha shenjë. Porsa e piu kafenë u ngrit dhe mori drejt derës së moçme pranë banakut ku shkruante: „VC –MBYLLE DERËN". Shyqyr, thashë me vete edhe pse përbrenda ndjeva frikë. Pas pak e ndoqa pas. Pasi m'i dha paratë të mbështjella me najlon të bardhë, me ngutë e frikë bashkë se mos po na përndiqte ndokush i futa në xhepin e brendshëm të xhaketës. Pastaj dëgjova zërin e tij pëshpërimë:

– Siç të kam premtuar, të gjitha i ke këtu! Do t'i numërosh?

– Jo, jo! I numëroj dhe i shpërndajë në të njëjtën kohë sipas udhëzimeve që m'i ke dërguar më parë!

– Shumë mirë! Pagesat të bëhen sipas kohës së caktuar

më parë, por, vetëm pasi të merret vendimi historik.

– Si urdhëro!

– Kur e keni mbledhjen, nesër?

– Po! Nesër në mbrëmje!

– Ku do ta mbani kësaj radhe?

– Në lokalet e bashkësisë... jam marrë vesh me ta!

– Me pagesë?

– Po, me pagesë!

– Nuk po të pyes për çmimin, por po të përgëzoj! Ke bërë një punë shumë të mirë që arrite të futesh brenda lokaleve të tyre... njëherë si mysafir e pastaj nuk do të ketë bir nëne që do të na nxjerrë që andej! Bukur! Edhe në të ardhmen vepro kështu... e sheh; vetëm paraja i thyen ata qafirë! Për gjëra të tilla mos kurse! I pranishëm, si mysafir nderi, do të jetë Abu Al Khalidi. Menjëherë pas mbledhjes më njofto për rrjedhën apo... më mirë mos më njofto ti! I kam thënë të me njoftoj arabi... qartë?

– Si urdhëro!

– Natën e mirë!

– Natën e mirë! – ia ktheva pas pak.

Gjatë gjithë kohës sa qëndrova përballë profesorit tebdil, pata ndjesinë se dikush po na përgjonte nga qoshja e murit ku ishin të deponuara disa fuçi të mëdha vere. Disa herë e pashë profesorin të hidhte vështrime te këndi i errët. Pasi doli profesori, u ktheva me vrull andej! Nuk pashë gjë. Mu bë së dëgjova disa lëvizje të largëta, sikur më erdhën andej nga ishte çezma. Vrapova andej. Në gjerësinë e korridorit ku ishin të radhitura njëra pas tjetrës kabinat për banjë e tualet, nuk vërejta gjë. Dritarja si zakonisht ishte pakëz e hapur. Hodha vështrimin jashtë por nuk pashë ndonjë gjë të dyshimtë. Mora drejt fundit

të korridorit ku ishte dera e mbyllur me bravë që shpien në katin e dytë. Me një ndjenjë gëzimi që nuk ia fsheha dot as vetes, u afrova pranë derës ku shkruante: „Privat".

Pasi e përlava krejt vendin që me rrethonte me një shikim hetues, porsa u ndjeva i sigurt se nuk me kishte parë askush, nxora çelësin nga xhepi dhe e hapa derën. Duke i hedhur shkallët dy e nga dy, u gjenda pranë njërës nga ish dhomat e mia të dikurshme që i pata marrë me qira pasi qeshë kthyer nga Sarajeva. Edhe pasi e pata blerë shtëpinë për dy nuset e bukura boshnjake, njërën dhomë vazhdova ta mbaja me qira në mënyrë të fshehtë! Si atëherë, ashtu edhe sot, në thellësi të shpirtit vazhdon të më brejë një ndjenjë dyshimi e pasigurie! Prandaj, herë pas here e përdori si strehimore rezervë, por që fatbardhësisht nuk e di askush përveç Allahut, meje dhe mejhanexhiut! Ah, po! E di edhe Zejnebja, bukuroshja ime e lezetshme, por ajo mendon se kjo është dhomë e huazuar sa për t'u takuar me mua fshehurazi!

Teksa po shikoja rreth e qark dhomës, duke i përlarë me sy dollapët e vjetër prej druri dhe shtratin e ngushtë e të zhubravitur, për një copë herë mbeta duke u rrotulluar kuturu pa gjetur vend të përshtatshëm për t'i fshehur paratë. Edhe pse u përpoqa ta ruaj qetësinë, disi vetë duart me shkonin më rrëmbim duke rrapëlluar, derisa i hapja njërën pas tjetrës dyert e dollapit. Pranë dollapit të ushqimeve, pashë ca enë të vjetra. Në mesin e tyre ishte edhe një vegsh. E mora ndër duar dhe e rrotullova disa herë duke vështruar në brendi të tij se mos kishte ndonjë gjë të fshehur në të. Ishte bosh. I futa paratë përmes grykës së ngushtë dhe e ktheva prapë në vendin e tij. Kur po merrja nga dera për të dalë, u pendova! Vrik u

ktheva. Dyshimi se nuk i kisha fshehur mirë vazhdonte të me brente. E mora vegshin. Për gazep i nxora paratë. Qëndrova në mes të dhomës pa gjetur skutë tjetër të përshtatshme. Vështrimi më mbeti i mbërthyer për një copë herë mbi shtratin e zhubravitur të dy ditëve më parë kur i pata kaluar nja dy sahat të mira duke u zhgërryer me Zejneben time të bukur! E luta të më pranonte prapë në shtëpi por më refuzoi... çështë e vërteta ajo pranoi me kusht që të kthehet në katund, në kullën tonë të dikurshme, për t'ju vu kapak fjalëve përçmuese dhe thumbave nga të tjerët. E di që ajo është e lidhur shumë për atë vend... por tani, nuk di si t'ia bëj? Ne e shitëm kullën... Duhet gjetur patjetër një mundësi së si ta kthej prapë dhe bashkë me të edhe Zejneben time të hirshme.

Në fillim kur qeshë kthyer nga Sarajeva, sikur kishte eksploduar ndonjë bombë në shtëpinë time kur ajo e mori vesh për dy nuset e reja që i kisha sjellë me vete! Sa nuk u çmend nga xhelozia. Me tërbimin më të madh dhe me fjalët më të rënda më nxori jashtë. U përpoqa të jem i arsyeshëm dhe nuk lashë gur pa lëvizur për ta bindur. U mbështeta edhe në metodat e madhërishme të Hasretit Muhamed. Kur ishte në kulmin e zemërimit më tha me neveri se edhe Allahu ndodhet në anën tuaj të padrejtë! Pas dështimit, vendosa t'i dënoj të tri nuset. I këputa lidhjet me to, për t'i bërë që të vuajnë për mua. Por pas një kohe, duke e parë se dënimi që ua kisha dhënë atyre më shumë po më rëndonte mua, u mbështeta në fjalët e Allahut që ishin të shkruara në suren Tahrim dhe sikur të isha profet, vendosa ta prishi atë vendim dhe mos t'ia ndaloj vetes atë që ma ka lejuar Allahu i Madhërishëm!

Kur e ngrita lartë njërin skaj të dyshekut për t'i fshehë

paratë, sikur me shpërthej papritur një lloj paniku tinëzar si i fshehur prej vitesh brenda meje. Në çast m'u bë sikur isha zgjuar papritur i tmerruar nga gjumi dhe pashë së brenda dhomës shëtitej dikush si hije njeriu. E imagjinova atë hije sikur në njërën dorë mbante një thikë të rrezikshme që i shkëlqente tmerrshëm tehu në dritën e zbehtë që vinte nga jashtë, kurse me dorën tjetër sikur kërkonte të më mbërthente për fyti! E lashë lirshëm rrjedhën e imagjinatës sikur ajo hije këmbëzbathur lodronte mbi lulet vjollce të vizatuara me finesë mbi jorganin e zhubravitur, i shkelte pamëshirshëm luleshtrydhet mbi çarçafin bojë qielli dhe e shtypte me hidhërim luleakshamin e qëndisur mbi jastëkun e mrekullueshëm, duke shpalosë fytyrën e shpifur të vrasësit tim dhe nga frika mundohesha të nxjerr klithma të zëshme. Ky fanitet sikur m'u ngjit në mbarë trupin e drobitur dhe pasi e lëshova dengun e parave nën dyshek, m'u bë sikur po e mbuloja me dhé kufomën e trupit tim të vrarë, që paska qëlluar të jetë kjo dhomë fatale. Pavarësisht nga gjithë ky sharmë i fanitur, e ndjeva veten aq të vetmuar sa që nga goja me doli një zë i mbytur. Vetëm kur po i zbrisja shkallët m'u kujtua se pa dije e kisha thirrur në ndihmë Zejneben!

Anëtarët e grupit tim selef vazhdonin të qëndronin ashtu siç i kisha lënë rreth tryezës. Rexhepi vazhdonte tregimin për historinë e Imam Huseinit, kurse të tjerët e shikonin me admirim. U befasova kur pashë orën. E gjithë ngjarja e tmerrshme që e kisha përjetuar brenda atyre mureve të holla të dhomës sime sekrete nuk kishte marrë kohë më shumë se pesë minuta. Rashë shahadet.

Pas shpërndarjes së vëllezërve të mi selef, secili në shtëpi të vetë, për mua sa filluan përpjekjet për ta bërë

sa më parë pagesën e shtëpisë që kohë më parë e kisha blerë! Prenë që e futa në grusht, më lehtë më vjen ta mbaj pandershëm se sa ta humbi me nderë! Një lutje drejtuar Allahut dhe çdo gjë e pandershme do të ujdiset pastaj... por çfarë t'i bëjë frikës që ka filluar të më rëndojë secilën herë e më shumë? Nuk duhet të ligështohem nga vendimet madhore... pse mos është hera e parë që bëjë punë të tilla? Sa do të gëzohet Mirsada! E sheh moj sykaltëroshja ime, unë i mbaj premtimet, vetëm duro dhe ca, duro se tani koha e gëzimit të madh nuk matet më ditë e javë por më orë e minuta!

Teksa po i shtypja numrat e celularit njërin pas tjetrit, duke e falënderuar Allahun që ua kishte mbushur mendjen atyre kaurëve të pafe për ta zbuluar këtë mrekulli, e ftova pronarin dhe dëshmitarët që të tuboheshin sa më parë në mejhane për ta bërë pagesën e shtëpisë së blerë!

Pavarësisht se sa rrufeshëm u mblodhën pronari dhe dëshmitarët në të ndarën për mysafirë të zgjedhur pranë banakut të mejhanes, pavarësisht pagesës me atë shumë vërtetë marramendëse dhe nënshkrimeve të shitësit, blerësit që në këtë rast isha unë, dhe dëshmitarëve, për asnjë çast nuk i shqita nga mendja rreziqet që do të niseshin drejt meje bashkë me ato nënshkrime, duke i bërë të tjerët lakmitarë! Derisa po i paramendoja kurthet që mund të m'i kishte kurdisur që më parë profesori, dhe tani këta të pabesë që porsa i morën paratë, vendosa që përkujdesjen e kontratave t'ia besoja mejhanexhiut, i cili edhe herë të tjera me kishte kryer shërbesa të tilla me plot rreziqe!

Prej mejhanes dola nga dera sekrete. Jashtë koha ishte ftohur edhe më shumë. Që t'i largohem ndonjë kurthi

të mundshëm të profesorit apo të atyre banditëve të pacipë që shesin pronat në mënyrë të paligjshme, nuk e mora veturën. Rrugën gjer në shtëpi ku radhën e pritjes këtë natë e kishte Mirsada, vendosa ta bëjë me këmbë. Duke kthyer kokën prapa, u futa rrugicave të ngushta të qytetit të përgjumur. Sa më tepër që insistoja në humbjen e gjurmëve, aq më tepër e humbisja orientimin. Eca kuturu nga një rrugicë në tjetrën. Vende-vende nga kanatat gjysmë të hapura arrinte të depërtonte ndonjë rreze e zbehtë drite elektriku duke i bërë të dallueshme dritëhijet e mureve rrethuese të avllive. Kjo kishte qenë mrekulli, derisa befas u errësua çdo gjë përreth. Dritat e elektrikut u shuan në tërë lagjen. Për një çast mbeta si i hutuar. Një drithërimë tmerri ma përshkoi tërë trupin. Me vinte vapë. Mendja me iku të pusitë që njerëzit shpirtligj i bëjnë vetëm në errësirën absolute të natës. Edhe pse nuk desha ta kujtoj tani, nuk e shqita dot nga mendja përfytyrimin e pamjes së Hafizit të vrarë mizorish në errësirën e ndonjërës nga rrugicat e errëta të qytetit, ja si kjo ku tani ndodhem unë. Fillova ta përdori hamendjen për t'u orientuar. Nga një shtëpi përdhese dëgjova se dikush po bisedonte me zë të lartë. Një kollë e zgjatur nuk pushoi derisa u shua nga të lehura qensh. Prapa krahëve dëgjova hapa. Ktheva kokën i frikësuar. Thonë se gjatë netëve të errëta si kjo, shfaqen fantazmat. Sa nuk më lëshuan këmbët kur vërejta lëvizje të pakontrolluara të rrezeve të një drite elektriku që dikush po e mbante në dorë duke e ndritur rrugën para këmbëve të veta. Sa më shumë që më afroheshin ato lëvizje, aq më shumë më rritej frika. Kur rrezet u ngritën lartë duke me përlarë të tërin sa nuk më lëshuan këmbët. Një klithmë tmerri e

shoqëruar me mbështetje trupi pas muri, më erdhi si të ishte e atij që po më afrohej ngutshëm, e jo e imja. Rrezet e dritës më përlanë prapë. Nuk vërejta asgjë vetëm një rreth të fortë drite që m'i mori sytë.

– Për në qendër? – me pyeti një zë i qetë burri.

– Po! – ia ktheva me zë pak të ndryshuar derisa po e prisja pyetjen e radhës; „Imam, ti je?" „Jo, unë nuk jam Imami!" Sikur ju përgjigj flakë për flakë ai zëri im i brendshëm! Për fat të mirë, derisa u ndamë, duke i uruar njëri-tjetrit natën e mirë nuk pasoi ndonjë pyetje e ngjashme me ato që i mendova. Gjatë gjithë rrugës biseduam për gjëra të rëndomta.

As në shtëpi nuk e gjeta gëzimin që lezetshëm e pata paramenduar disa herë gjatë rrugës. Sykaltëroshja ime me priti me hundë e buzë bashkë. Se nga e kishte marrë vesh takimin tim të dy ditëve më parë me Zejneben nuk e di. Filloi të dërdëlliste me atë zërin e saj të hollë e të çjerrë duke më thënë së unë gjoja më shumë i dua ato të dyja, se gjoja këtë e kam vetëm sa për t'i shfry epshet... më tha kurvar i ndyrë, mburravec, i pabesë... nuk fola fare sepse ajo këtë e kërkonte, të flisja e pastaj të më hidhej në qafë me fjalët më të rënda duke i tmerruar fqinjët! Duke i njohur huqet e saj, u tërhoqa në dhomën e gjumit dhe e mbylla derën me bravë.

Për t'ju vërë fre thumbave dhe fjalëve përçmuese të grave, bleva shtëpinë e dytë. Ky veprim ngacmoi smirën dhe xhelozinë brenda radhëve të vëllezërve të mi selef! Prandaj, blerjen e shtëpisë së tretë që do t'ia dhuroj sykaltëroshes sime do ta mbajë të fshehur, të paktën për një kohë!

Natyrisht që të tjerët kanë të drejtë për t'u bërë xhelozë.

Depërtimin tim në kryesinë e Bashkësisë, në fillim e patën parë si mrekulli që ma kishte dhuruar Allahu, dhe kënaqeshin bashkë me mua. Bashkëpunimi i ngushtë me miqtë arabë, e veçmas me profesorin dhe vendimi që të shërbeja pikërisht në ato vende krizash ku luhej me krye siç ishte Sarajeva në atë kohë, bënë që disa të më përgëzonin për guximin tim, por pati edhe nga ata që më thanë hapur se kam filluar të rrjedh nga mendja. Natyrisht se gjatë gjithë kohës, larg syrit të keq dhe përgojimeve, të pakursyer e pata ndihmën e profesorit. Këtë ndihmë të tij e pata fituar në kohë krize kur unë ia pata ofruar një informatë... por këtu të jemi të qartë, pa e dëmtuar asnjërin nga anëtarët e vëllezërve të mi selef, apo të Bashkësisë! Estagfirullah! Informatat e mia kurrë nuk kanë pasur karakter fetar por thjeshtë, luftarak. Një gjest të tillë human që e ndalon gjakderdhjen, e përligj edhe Allahu i Madhërishëm, prandaj vazhdoj edhe sot me hulumtimin dhe sajimin e informatave për të njëjtin qëllim, paqen! Sigurisht se në raste të tilla keqbërësit do të bien nën pranga apo do të eliminohen, gjëra që përligjen nga i Madhërishmi! Por edhe profesori, mos t'i hyjë në hak, ka qenë dorëlirë dhe më ka shpërblyer, si në ato kohëra krizash, ashtu edhe tani. Kështu i ka hije një profesori të nderuar!

As në orët e vona të natës nuk gjeta lehtësim. As nuk flija, as nuk isha zgjuar. Disi si në ëndërr tretesha nëpër mjegull me orientime të hamendësuara. Kujtimet e ngjarjeve të fundit me përziheshin me ankth. Hendeqet dhe gropat që i kisha përgatitur me kohë që të mbyteshin në to injorantët dhe ziliqarët, sikur nuk tërhiqeshin prej tyre edhe pse me gjithë forcë i shtyja andej, por

më tërhiqnin mua që isha larg dhe pa dashur, sikur e parandieja rrezikun... dhe ndërkohë, makthi më mbante shtrëngueshëm për fyti, ma zinte frymën, sikur donte vërtetë të më mbyste dhe nga sikleti bëja të lëvizja, ta mbërtheja e mos ta lëshoja pa m'i plotësuar dëshirat... por ai nuk më shqitej... as nuk jepej! Në fund, i djersitur dhe me siklet zgjohesha nga gjumi! Me këto përpjekje kacafytjesh më zbardhi drita.

Edhe kësaj radhe Allahu ishte në anën time. Bashkë me agun e parë më dhuroi forca dhe ide të reja. E këqyra sahatin e markës „Serkisof." Tetë pa një çerek! Me Bismillahirr, u ngrita në këmbë! U vesha shpejt e shpejt dhe në maje të gishtave, si të isha hajdut, u gjenda në rrugë.

Të mejhanexhiu ishte ngrohët. Porosita salep. Derisa po ngrohesha pranë stufës, veshja ime ia tërhoqi kërshërinë mejhanexhiut, i cili me pyeti:

– Për ku kështu?

– Andej nga perëndimi i vendit. Do të bëjmë hutbe në një xhami që këmba e sojit tonë ende nuk ka shkelë.

– Vetëm?

– Jo, kësaj radhe do të më shoqëroj Abdallahu. Do t'i fusim në zbatim metodat e tij të reja që i solli nga ato vende të bekuara.

– Paçi fat, e dalshi faqebardhë!

Kur po çaja përmes mjegullës së dendur me makinën time të re, m'u kujtua koha e fëmijërisë. Isha pikërisht në rrugën e gjatë e plot gropa që e kisha kaluar çdo ditë për të shkuar në shkollë. Gropat ishin të mbushura plot me ujë të turbullt, sikurse i kisha lënë dikur. Mezhdat vende-vende ishin tretur, kurse vende-vende ishin po ato, me ndonjë ndryshim të padallueshëm. Në hyrje

të katundit mjegulla u davarit. Kodrinat e veshura me shkurre dhe fushat përreth të mbuluara nga një shtresë e hollë bore, dukeshin edhe më të shkreta se në ato kohërat e moçme. Sikurse atëherë, edhe tani, sa u mbulua pllaja me një tufë sorrash, të cilat, me zërat e tyre të mërzitshëm u zhvendosën mbi sipërfaqen e laskaruar të kodrës dhe prej aty u ngjitën lartë në qiellin e vërejtur. M'u bë se çdo gjë kishte ngelur e paprekur që nga ajo kohë. Dallimi ishte vetëm se atëherë isha i ri, plot forcë e shëndet dhe, derisa i kaloja me këmbë këto bokërima thurja ëndrra të bukura idile, kurse sot, pas kaq shumë vitesh, paksa i thyer në moshë dhe i zbrazur për një çast nga preokupimet e shumta, nga puna e mërzitshme me njerëz tinëzarë e të pabesë që këqyrin se si ta gjejnë apo ta kurdisin ndonjë rreng, e pastaj mos të shqitën pa të kushtëzuar; o paratë o tregova se ç'pashë... disi u ndjeva i mallëngjyer. Thellë në shpirt ndjeva dhembje për trojet e mia të dikurshme. Dashtë Allahu e m'u kthefshin pa sherr, e luta me gjithë shpirt të Madhërishmin! Amin!

Sa më shumë që i afrohesha kullës, aq më shumë përmallohesha. Zemra filloi të më rrihte me shpejtësi! Çuditshëm! Para meje, nën qiellin e vërejtur gri m'u shfaq kulla. Vështrimi m'u ngjit mbi oxhakun që vazhdonte të nxirrte tym, kurse kujtimi më rrëshqiti ngadalë mbi dritarezën e mbërthyer me po ata xhama të dikurshëm dhe që andej, u fut brenda dhomëzës sime të dikurshme të dhëndërisë duke u ndeshë me Zejneben e hirshme që më priste në gjerdek... e stolisur me vellon e bardhë e me plot perishane, buzëqershi, syjeshil e qerpik çetinë, vetull fiskajë, ballëgjerë dhe trup fidan, që vetëm ta këqyrje i mahnitur, të joshte ta puthje njëherë dhe të vdisje në

vend... dhe sikur po i dëgjoja!... pa pushim binin tri dajre nën tingujt melankolik të tri vajzave që këndonin pa pra dhe me këmbë të lehta, si flutura, vajza e nuse të dalldisura hidhnin valle në oborrin e kullës së stolisur me lule e gjethe të reja për festën e Shën Gjergjit! Sytë m'u përlotën!

Çeli, tani më i konvertuar në Abdallah, erdhi. Një përshëndetje fodulle, një ndërrim fjalësh të zakonshme të rënduara dhe të përziera me theks arab. Pastaj, heshtje! Heshtje serioze! Tepër serioze! Ky fyell, pinjoll dhe trashëgimtar i fundit i kullës së Lulajve akoma pa e mësuar mirë fenë myslimane, po e komenton tepër të shenjtë, tepër hyjnore që duhet të jetojë vetëm për t'u falë, për t'u lutur, për të bërë hutbe, e jo si unë, që falem për të jetuar! Bismil-lahirr i tij urrehet dhe është i urryer, përbuzët dhe është i përbuzur, përçmohet dhe është i përçmuar, armiqësohet dhe është i armiqësuar dhe të gjitha këto do t'ia shkurtojnë jetën akoma pa e shijuar. Kulla do t'i mbetët pa zot, trojet do t'i mbesin shkret... kurse Bismil-lahirr i im, më sjellë lumturi dhe më lumturojnë të tjerët, me sjellë begati dhe më begatojnë të tjerët, më sjellë para dhe më paguajnë të tjerët, më sjell gra të bukura të cilat me dëfrejnë dhe ma zgjatin ymrin që të jetoj i lumtur, pa brenga e armiqësi, i rrethuar nga bukuroshe symëdha, si pasha brenda haremesh... dhe kulla e tij, me selishtë e bashtina, me livadhe e kroje zabelesh, por që për gjynah të mbetura shkret, do të jemi të shtrënguar t'i trashëgojmë ne, unë bashkë Zejneben time të hirshme dhe në çast ju drejtova me zë të lartë asaj: E sheh moj bukuroshja ime? Edhe për ty tani gëzimi i madh nuk do të matet me muaj e javë por me ditë e sahat?

Me të dalë në magjistrale, mendimet e pakmëparshme sikur ishin përlloçur dhe ashtu plot zdralë mbetën prapa, të zhyera në gropat e rrugës. Në vend të tyre m'u rikthyen mendimet e natës, që i pata zgërlaqë mbi një plan të stërholluar, që sapo fillova zbatimin e tij. Qëllimisht e pyeta se a kishte dëshirë të qarkonim përmes unazës periferike, apo të futeshim mes përmes qytet. Mora atë përgjigje që e prisja dhe që e dëshiroja duke pasur parasysh se xhemati i kësaj xhamie kishte dhënë me kohë shenja të qarta armiqësore kundër sojit tonë! Për t'i dhënë shenja se edhe unë, sikurse të parët e familjes së madhe të Lulajve, isha patriot i zjarrtë, me besë e trimëri, i propozova që t'ia bënim një vizitë të shkurtër mullirit të Haxhi Zekës! Me këqyri me hidhërim. Nuk e ngava më tepër, sepse e parandieja së shpërthimi i hidhërimit të tij duhej të ndodhte në çastin dhe vendin e duhur e kurrsesi tani dhe kundër meje!

Për hatrin e tij, u gjendëm në Çarshi Xhami. Derisa po merrnim abdes, fshehurazi i provokoja qëllimisht pjesëtarët e xhematit të kësaj xhamie madhështore. Edhe pasi zumë vend në rresht dhe u lidhem namaz, vazhdova provokimet. Disa prej tyre i ofendova përmes mimike, duke ua shkelë syrin apo duke ua nxjerrë gjuhën, e ata që m'u ndodhën pranë i therja herë pas here me bërryla! Kur rashë për herë të parë sexhde, qëllimisht u zgjata më tepër se ç'duhej përpara dhe e preka vitheve atë që falej para meje. U kthye dhe më shikoi me urrejtje.

Gjithë provokimeve të mija, sikur ju vuri maje hoxha. Sikur të ishte i porositur nga unë filloi pikërisht ato biseda urrejtjesh kundër nesh. Vëngër shikova nga qyqari Çelë, i konvertuar në Abdallah. Sikur t'ju kishin futë shejtanët

nëpër bark, mezi përmbahej.

Fill pas hoxhës, flakë për flakë e mori fjalën qyqari i konvertuar. Derisa ai po fliste për ta bindur xhematin të kthehet në rrugën tonë, unë nuk pushova së provokuari ata njerëz që më shikonin të hutuar por edhe me urrejtje të përmbajtur. Disa herë thashë me vete se këta qenkan shumë të durueshëm. Kisha frikë se do t'i gëlltisnin të gjitha provokimet, sharjet dhe fyerjet tona dhe në fund, kur do të vijë koha, do të ndaheshim si të ishim miq! Kjo gjë nuk guxon të ndodhë prandaj, pa humbur kohë e godita një plak që m'u ndodh pranë. Qyqari Çelë i konvertuar në Abdallah nuk pa gjë, por një pjesë e xhematit më pa. Kjo mjaftoj për t'i nxitur në sulm kundër nesh. M'u hodhën sipëri duke më goditur me grushte e shqelma. As unë s'ua lash një mangët! Në mes të goditurave, pashë që edhe qyqarin tim e tërhiqnin zvarrë sikurse edhe mua dhe na hodhën përjashta duke na goditur me shqelma bythëve. Kur e pashë se nga hundët dhe nga goja po më rridhte gjak, e kuptova se misionin tim e kisha përfunduar me sukses edhe më të madh se ç'e pata paramenduar në fillim. Për të mos hëngër edhe ndonjë grusht, shqelm apo ndonjë hu shpinës, që për momentin ishin fare të panevojshme, u tërhoqa drejt vendit ku ishte vetura ime e parkuar. Ndërkohë pashë Çelin kokërruar të vinte drejt meje.

Derisa po bëja përpjekje ta nxisja për t'u kthyer në xhami për t'ua hedhë bombën, të cilën ia lëshova në dorë të mbështjellë me një napë të bardhë, ra celulari. Pas përfundimit të bisedës qëllimisht, sa për t'ia matë pulsin e fudullëkut të tij të shtirë, i thashë së po na presin për drekë dhe po nisemi menjëherë. I nxehur, me sy

që i nxirrnin xixa sikur po ma kujtonte fjalën e dhënë, tërlemen e tij të pshurrtë dhe gjoja sulmin! Krejt i qetë i thashë; shko! Pastaj, me fjalë mikluesi ia rrita mendjen së ai do të ishte shahiti i parë selef-us-salih-ëve nëse do të vritej për Allah, për e dinë e iman! Me yrysh doli nga vetura duke krijuar përshtypjen së vërtetë sot do ta bënte namin, por nuk i ndodhi asgjë të paudhit. Me tërlemen në kokë erdhi i patrazuar dhe u fut në veturë. Nuk më mbeti gjë tjetër vetëm të nisesha.

Porsa arritëm atje, krijova përshtypjen se motra e tyre e bukur nuk ishte në shtëpi. Ndjeva një zbrazëtirë në shpirt. Ishte pikërisht ajo që më pat lidhur aq fort pas vëllezërve të saj hutaq, sa që nuk lashë gur pa lëvizur derisa i futa në apologji, gjithmonë duke ëndërruar që përmes tyre ta fusja në dorë atë perri, për ta kurorëzuar pastaj si gruan time të katërt. Deri tani nuk ndodhi një mrekulli e tillë por as unë nuk e kam ndërmend të tërhiqem. Nuk do të lë dredhi, pusi e grackë pa përdorur derisa ta fus në dorë!

Derisa isha duke e prezantuar me marifet familjen mikpritëse, nuk e di se nga mbiu ajo duke ma ndërpre bisedën dhe me tregimin e saj pasues për babanë e saj me nxori gënjeshtar. Edhe pse e ndjeva veten të fyer nuk bëzana. Herë pas here një mendje më thoshte se e gjitha do t'i shkojë përshtat planeve të mia dhe herët a vonë ajo do të jetë e imja! Rrugë tjetër nuk ka!

Kur po drekonim rreth sofre, disa herë e zura qyqarin Çelë, të konvertuar në Abdallah t'i hidhte vështrime të zjarrta Albanës. Ishin vështrime kurvarësh që mua me bënë të turpërohesha para saj! Për një çast ndjeva trazim dhe neveri përbrenda. Kafshata e bukës më ngeli në grykë, kur i mendova këta të dy si burrë e grua, të rrethuar nga

një tufë kalamajsh që loznin të patrazuar në oborrin e kullës së fisit të Lulajve. Vetëm atëherë kur Albana la shtambën mbi tryezë dhe kokulur doli jashtë më erdhi zemra në vend, m'u rikthye hareja e mëparshme dhe rifillova të ha me oreks të shtuar.

Nga ideja që më erdhi ndërkohë, përforcova përshtypjen së vërtetë jam një krijesë e përkëdhelur e Allahut. Kur Albana po na lutej që të ndikonim të vëllezërit e saj, më erdhi në mendje se ishte rast i përkryer t'ua fusja një sherr të vogël në mes saj dhe Çelit, për t'ua shkatërruar edhe atë pak simpati që ndoshta mund ta gëzonin për njëri-tjetrin. Duke i pasur parasysh karakteret e tyre, i thashë Albanës se për t'ju ardhur në ndihmë vëllezërve të saj, nevojitej konvertimi i saj në besimin e tyre. Nga kjo pozitë, më së miri do t'ju ndihmonte vet, pa ia pasur nevojën askujt. Ajo e kundërshtoi propozimin tim, por Çeli im Abdallah, ishte këmbëngulës në përkrahjen e atij propozimi! Sherri i vogël u zmadhua. Mori përmasat e një grindje agresive nga ana e Çelit, dhe ironike nga ana e Albanës, sa që pata ndjesinë se agresiviteti që ai tregonte kundër ironisë së hidhur të saj, do të përfundonte me epilog grushtesh. Ndjesia m'u shndërrua në ngazëllim kur ai u ngrit në këmbë dhe mori drejt saj. Në momentin kur po e paramendoja dorën e tij të ngrihej mbi té, ndodhi ajo që nuk e dëshiroja. Ai torollak llafazan, i padenjë për asgjë, mori nga dera. As kësaj radhe nuk ndodhi asgjë. I dëshpëruar e ndoqa pas.

Tani, kur vetura po qarkullonte furishëm mbi asfaltin e lëmuar, ia hodha një vështrim vëngër pamjes profile të fytyrës së tij. As vetë nuk e di përse, por në çast me ndodhi e njëjta shkërmoqje sikurse në ato momente kur e pata

marrë lajmin për vrasjen e Hafizit. Në mendje filloi të më sqarohej e vërteta. Vrasësi finok, i zgjuar, dinak dhe këmbëngulës në bindjet e tij, hiq pa dyshim së ndodhej në mesin e lëvizjes së vëllezërve të mi selef. U drodha i tëri nga frika që kishte filluar të më pushtonte dalëngadalë, duke menduar se në fshehtësi të plotë, ai vrasës i poshtër edhe mua më kishte shpallur armik të përbetuar, pasi që disa herë, ashtu rrotull e rrotull ma kishte tërhequr vërejtjen që të hiqja dorë një herë e përgjithmonë nga djallëzitë, shpifjet e rrengjet që ua kurdisja të tjerëve. Këto virtyte, që m'i ka dhuruar i Madhërishmi dhe që i përdori vetëm kundër atyre që i madhi Allah me kohë ka heqë dorë prej tyre, përveç këtij qafiri askush tjetër nuk i di! Për të dytën herë u drodha rrëmbimthi, me rrëqethje trupi, nga vrasësi i tmerrshëm që nuk e kisha hiq më larg se njëzet centimetra.

I përqendruar në rrugën leqe-leqe, ndjeja sikur më vinte të ftohët edhe pse kabina e veturës kishte kohë që ishte ngrohë. Mendja e shpërqendruar më iku në të kaluarën e afërt kur ndodhesha pranë besimtarëve islam që luftonin si luanë për shpërthimin e rrethimit të Sarajevës. Nuk i numëroj dot sa shehitët i lava e ua fala xhenazen përmes plumbave. I ftoja trimat të faleshin para se të dilnin në luftë, që lufta t'ju vinte e lehtë ose e rëndë, dhe mos të kursenin pasurinë e as veten e tyre që të flijoheshin për Allah, për dinë e iman. I gjeja mundësitë dhe me zmadhues zëri në çdo vakt faljesh e thirrja ezanin duke i tërbuar kaurët... Të mllefosur na kishin rrethuar. Derisa ishim të lidhur namaz dhe po i luteshim Allahut, në befasi, na zunë të gjithëve si lepujt në qark, pasi i kishin therë si bagëtinë rojet tona. Na shanë, na rrahën, na torturuan

dhe na plaçkitën pa na lënë gjë nëpër xhepa dhe në fund na rreshtuan para skuadrës së pushkatimit. Nga çasti në çast pritej që togeri të jepte urdhrin: „zjarr!“ Duke u dridhur nga frika, thashë se kësaj radhe vërtetë qenkam ndeshë me vdekjen, kur befas pashë një ushtar që ju afrua togerit dhe i foli diçka te veshi. Me vrull u kthye nga ne. Pasi na shikoi të gjithëve me radhë e drejtoi dorën nga unë duke me urdhëruar që të dilja nga rreshti. Derisa po largohesha nga besimtarët e mi të shkretë, mëshira e Allahut qoftë mbi ta, një zë i ngjirur thirri me sa pati në kokë: „zjarr“ dhe fill pas, ai zë i tmerrshëm u mbyt nën krismat rafalë të armëve. Kur u afrova përballë togerit me shikoi në sy. Pa ndrojtje e sfidova duke ia ngulë sytë në bebëzat e syve të tij dhe aty e gjeta veten!

Edhe pse ishte kohë lufte, kohë përleshjesh e gjakderdhjesh, zbatoheshin ca rregulla nga palët ndërluftuese. Më gjithë egërsinë dhe urrejtjen kundër njëri-tjetrit, ekzistonte një lloj disipline që respektohej nga të dyja palët siç ishte rasti i robërve të luftës. Trajtimi dhe seleksionimi i tyre bëhej sipas rangut dhe përgjegjësisë. Liroheshin ata që fshehurazi i mbanin nën shërbimin e vet. Mbaheshin peng ata që ju nevojiteshin për ndërrim robërish dhe pushkatoheshin ata që paraqisnin rrezik apo që nuk kishin vlerë kompromisi! Ekzekutimet e këtyre të fundit vazhdimisht bëheshin nën kontrollin e një komande mbikëqyrëse. Të gjitha këto i mendova vetëtimthi dhe mendja m'u kthye të vrasja e fundit e Hafizit të gjorë dhe e pyeta veten: Vallë, vrasja e Hafizit, vrasja ime... o Allah, ç'po dërdëlliti kështu përçartë?...pra, vrasja e Hafizit a ishte nën kontrollin e dikujt, apo ishte aksidentale?... Gjithë frikë pashë nga Çeli, që vazhdonte të

qëndronte mbështetur lezetshëm në kolltukun e veturës dhe i ngrohur nga ajri i nxehtë që frynte prore. Dukej së kishte filluar të dremiste. Në këtë gjendje, gjysmë i gjallë e gjysmë i vdekur nuk dukej të jetë hiç i rrezikshëm. Fytyra i dukej e qetë, e njomë dhe e pafajshme. Por po ta kundroje me ngulm, do të vëreje atë dritën djallëzore që i reflektohet nga thellësia e shpirtit të tij mëkatar, duke ia ndritur fytyrën e tij të bardhë e dinake!

Tiparet e tij prej inatçiu të pandreqshëm që i kishte pasur kur ishte fëmijë, sikur i kishte ripërtërirë duke i përpunuar e gdhendur për t'ua përshtatur rrethanave të reja. Ishte po ai Çeli i pashëm dhe i hajthëm që sa e sa herë e kisha rrahë me thupër apo shuplaka faqeve të njoma për mashtrimet e dredhitë që ua bënte fëmijëve të tjerë. Ishte po ai Çeli i dikurshëm energjik. Sa ishte talent në lojë dhe këngë lahute, po aq ishte i pashëm, syshkruar e flokëgjatë që dukej si vajzë e bukur mitare. Mbi këto tipare të qeta, pa ia ngacmuar egërsinë djallëzore që i fshihet përbrenda, dukej të ishte tip i pavendosur dhe pa ndonjë synim të veçantë në jetë.

Kur arritëm pranë kullës, qëllimisht ia kujtova edhe njëherë mbledhjen dhe vendimet që pritet të merren. Edhe pse nuk ju besoja aspak fjalëve të tij të mëdha. Më mbante shpresa te tri fotografitë që befasishëm e prisnin në dhomëzën e tij, të cilat pa dyshim që do ta nxisnin drejt marrjes së vendimeve historike. Pasi ma kthej shpinën, me nge e përlava me sy kullën e vjetër. Për një çast m'u bë sikur po e shikoja Zejneben time të hirshme të shkonte drejtë saj, e jo këtë torollak të konvertuar e të pavlerë! Rashë shahadet dhe u nisa!

Të gjitha vareshin nga vendimet e tij. Nëse do të

merrte andej, kulla dhe e gjithë pasuria e tyre do të më mbetët mua, por nëse merr këndej, duhet të punoj me përkushtim, pa lënë dru e gurë pa lëvizur për ta bindur në një vendim tjetër të mbarë. Më është mbushur mendja top, nga parametrat e mi të pagabuar se një vendim i tillë do të ndodhë.

Derisa po darkoja në mejhane, mendja me vajti të mbledhja e kryesisë që koha e mbajtjes së saj dalëngadalë po afrohej. Sjelljet e dyshimta të mejhanexhiut me vunë në siklet. Mossigurimi i parave të mbetura nga pagesa e shtëpisë, ma shtoj edhe më tepër mëdyshjen. Pas disa vështrimeve vëngër të mejhanexhiut, dyshimi se ai ishte duke fshehur diçka m'u forcua edhe më. I tmerruar se paratë mi kishte rrëmbyer dikush, ndoshta vetë mejhanexhiu, më detyruan ta lë bukën mënjanë. U nisa drejtë dhomëzës sime. Prapa derës ku shkruante „Privat" mu bë së dëgjova hapa. Nxora çelësin dhe kur po bëja ta fusja në bravë, sikur ta kishte porositë dikush, u fiken dritat. Shpejt e shpejt nxora shkrepësen nga xhepi. Pas katër-pesë të shkrepurash, mori flakë. Për gazep e futa çelësin në bravë dhe i dhashë rrotullimthi, por nuk shkoi. E provova edhe njëherë, por prapë nuk lëvizi nga vendi. Me vrull e shtyva derën. Sa nuk u përplasa mbi shkallë në anën tjetër. Dera kishte mbetur e hapur. Dyshimi se dikush m'i kishte vjedhur paratë m'u shtua edhe më shumë. Nuk po më pritej derisa të ndodhesha pranë vendit ku i kisha fshehur. Derisa po përpiqesha nëpër terr t'i gjeja shkallët, prapë mu bë së dëgjova hapa dhe fish-fishët e dikujt që po lëvizte. Për herë të parë pata frikë. U futa nën shkallë dhe mbajta vesh. Derisa isha i strukur, vetëtimthi i solla në mendje ndodhitë e pakmëparshme

si; ardhjen në Mejhane, porosinë, njerëzit që ndodheshin në aty dhe shikimet e tyre, shikimin tinëzar dhe dinak të mejhanexhiut, shikimin dashamirës të Hilit, shikimin indiferent të një biondi të panjohur, fikja e dritave dhe dera e hapur. Nxora pak kokën dhe vështrimin e hodha nga dritarja, ku nga jashtë reflektoheshin dritat e zakonshme të elektrikut, por nuk e përcaktova në ishin dritat e shtëpive përreth apo ato të rrugës. Kurrë më parë nuk me kishte shkuar në mendje për një krahasim të tillë, prandaj nuk arrita dot në përfundimin e sigurt në i kishte fikë dritat qëllimisht dikush nga mysafirët e mejhanes apo ishte ndërprerje e zakonshme.

Ende pa marrë ndonjë vendim se çfarë duhej bërë, prapë ndjeva lëvizje, por kësaj radhe vinin nga jashtë. Për një çast u lehtësova nga pesha e dyshimit dhe e shava veten si frikacak. Bëra të dilja nga streha e nën shkallëve ku isha fshehur. Tamam sa e hodha hapin e parë, dëgjova hapa. U shtanga. Vrullshëm hyri dikush. Me rrapëllimë e mbylli derën. E ndjeva rrotullimin e bravës. Instinktivisht u struka edhe më thellë nën shkallë. Tani e kisha të qartë. Dikush po më përgjonte! Kërkon të më plaçkitë... të më vrasë! Por prapë, duke u mbështetur në pastërtinë dhe fisnikërinë time dyshoj që dikush mund ta vë në dyshim karakterin tim të dëlirë, e aq më tepër të më fus në lojëra të rrezikshme. Ka gjasa që më kanë ngatërruar me dikë tjetër... ose mund të jetë rastësi e asgjë më tepër. Po, po! Vetëm rastësi mund të jetë. Mendimi i fundit sikur më çliroi nga sikleti. Duke marrë frymë ngadalë që mos të më dëgjonte ai i mallkuar që e mbylli derën me bravë, në mendje mu feks një mendim i tmerrshëm sa gati më lëshuan këmbët. Sikur të ishte rastësi, ai që e mbylli derën

me bravë do të ngjitej shkallëve, apo do të merrte drejtimin e nën shkallëve për të kërkuar ndonjë gjësend nga mallrat e deponuara të mejhanes dhe pasi ta ketë marrë atë për të cilin ishte munduar gjer këtu do të ishte larguar që këtej... por ai i mallkuar vazhdon hala të qëndron në korridorin e ngushtë ndërmjet shkallëve dhe derës së mbyllur.

Tamam në kohën kur po e mendoja revolen atje lartë në dhomën time që ditë më parë e kisha fshehur nën jastëk, sikur m'u shfaq një dritë shprese në mes të kësaj errësire të tmerrshme, kur dëgjova një zë të mekur duke thënë:

– Dil në shesh o Imam, e mos u fshih si gratë e këqija prapa magjes!

Sikur të më kishte vërejtur me kohë se ku ndodhesha i fshehur, u afrua duke ndezë një elektrik xhepi. Rrezet e tij rrathë-rrathë m'i verbuan sytë.

– Ç'kërkon nga unë? – i thashë derisa po hiqesha zvarrë për të dalë në shesh nga ajo ngushticë ku isha fshehur.

– Paratë! – më tha me të njëjtin zë.

Ai vrushkull drite, që vazhdonte të më sillej në sy si rrathët e xhehenemit, edhe më keq ma humbën orientimin. Me hamendje u mbajta për shkallë. Si vrushkull i nxehtë uji mu bë se ajo dritë e mallkuar ma mbuloi tërë trupin. Më vinte vapë. Kisha filluar të djersitem. Me gjysmë zëri rashë shahadet, pastaj e pyeta:

– Cilat para?

– Ato që t'i dha profesori mbrëmë. – ma preu shkurt.

– Të paska rrejt dikush! – ia ktheva i tmerruar. Më tepër u tremba nga e vërteta që tha se sa nga zëri i mekur dhe hija shpirtligë që fshihej prapa dritës.

– Ndoshta dikush mundet edhe të më rrej, por unë ta rrej vetveten, sikur nuk shkon fare prandaj, mos u shtir

sikur nuk di gjë. Qiti paratë e mos e zgjat! – ma ktheu, po me atë zë të mekur, por me ton urdhërues!

– As që e di së për kë e ke fjalën. Duket se më ke ngatërruar me ndonjë tjetër! – u përpoqa të dal i larë para tij.

– Ti e di shumë mirë së për kë e kam fjalën dhe ti e di sikurse unë që nuk të kam ngatërruar me askënd prandaj, që të ndahem njerëzishëm, qiti paratë dhe vazhdo rrugën tuaj! Përndryshe... – vazhdoi me të tijën.

Për një çast mu bë se ndihma e Allahut ndodhet në anën time. Një ide e ndritur ma përshkoi mendjen. I çliruar dhe për t'ia tërheqë kërshërinë i thashë:

– Para po kërkon, para do të jap... ja merri të gjitha që i kam në kuletë. Unë nuk kam para të tjera! – i thashë me zë të lartë me shpresë se do të dëgjonte dikush nga mysafirët e mejhanes dhe kështu do të alarmoheshin të tjerët duke marshuar pa kontroll drejt nesh. Pastaj si me naze ia zgjata kuletën.

– Ncy, ncy, ncy!... hiç nuk po të besoj që nuk ke tjera... dhe mos bërtit! – ma ktheu me të njëjtin zë duke u larguar një gjysmë hapi prapa.

– Merri! Të thashë se nuk kam tjera merr vesh ti apo jo... pastaj, kush je ti? – i thashë me zë edhe më të ngjirur.

Derisa po prisja të më jepte përgjigje, hetova lëvizje të pakontrolluara të dritës, që befas dhe vetëtimthi disa herë m'u largua nga sytë. Vezullimi i asaj drite rrethore që më kishte ngelur në dritat e syve vazhdoi edhe për disa çaste, derisa ndjeva një dhembje të tmerrshme në dorën e djathtë. Kuleta me ra për tokë. Ende pa e marrë veten dëgjova të njëjtin zë të mekur që më urdhëroi:

– Merre kuletën e fute në xhep! Dhe dëgjo këtu, po

nxore zë nga goja, ta dish mirë së këtu do ta bëj varrin! A more vesh?

– Ç'kërkon nga unë? – e pyeta derisa po kërrusesha për ta marrë kuletën që kësaj radhe i gjithë vrushkulli i dritës ishte përqendruar mbi të.

– Paratë! – ma ktheu shkurt.

– S'kam tjera! – ia ktheva flakë për flakë derisa isha duke e marrë kuletën.

Lëvizjet e dritës, që sa kishin filluar të reflektonin mbi dorën time, u tundën ashpër derisa u zhdukën tutje duke u përzier me një dhembje të tmerrshme që e ndjeva në çast prapa kresë. M'u bë se dritat që ende lodronin në bebëzat e syve të mi, më dolën furishëm nga sytë dhe u zhdukën rrotullimthi në errësirën e nën shkallëve! Si në vegime, pasi fillova ta marr pak veten, e pashë tërlemen që m'u kishte rrokullisur pranë çizmeve të tij. Por, rrokullisja e terlemës pranë çizmeve të tij s'qe e habitshme, sa më çuditi fakti kur i pashë çizmet e tij të futura dhe të lidhura mirë në qese të bardha najloni!

– Paratë, o ta nxora shpirtin për bythe, kurvar i fëlliqur! – dëgjova kërcënueshëm zërin e tij të mekur, midis dhembjeve të tmerrshme dhe çudisë.

– Mati fjalët se ç'po flet! Kush deri me sot nuk më ka thënë kurvar! Unë jam burrë me namuz! – ia ktheva gjoja sedërvrarë. Ç'është e vërteta, nofkën kurvar e dëgjoj çdo ditë nga gratë e mia!

– Ti burrë me namuz? – më pyeti po me atë zë të mekur që nuk e kapja dot së cili fshihej pas tij.

– Po! Unë jam burrë me namuz, i ndershëm dhe besnik! – ia ktheva me zë të vendosur.

E kisha të vështirë t'i përgjigjesha në mënyrë të

përgjithësuar. Sikur ta dija se cili ishte ai shpirtzi, do t'ia përplasja fytyrës me argumente... edhe të shpifura qofshin ato.

– Po me Fitin ç'të lidhë ty, ë?... qen i pabesë! – më pyeti duke i ngërdhuc dhëmbët.

Në mendje m'u skalitën tri fotografitë lakuriqe të Fitit që tinëzisht ua kisha shpërndarë disa anëtarëve të vëllazërisë me qëllim të nxitjes së urrejtjes brenda shpirtrave të tyre, kundër imoralitetit, që do t'i shtynte drejt marrjes së vendimeve madhore për vetëflijim! Me gjithë sqarimet e bëra duket se i paskan keqkuptuar mesazhet e mia. Vetëtimthi në mendje i solla ata që i lidhë diçka me Fitin dhe fët e fët, tre veta që ua kam dërguar fshehurazi fotografitë i lokalizova në mendjen time, njëri prej të cilëve fshihet pas këtij zëri të mekur dhe kësaj maske futë të zezë!

– Me Fitin? Të betohem për Allah që s'ka be mbi të, nuk më lidhë asgjë me atë vogëlushe!

– Po tri fotografitë e saj lakuriqe si i bëre?

– Çfarë fotografish ore? Këto janë shpifje me prapavijë morale që kanë për qëllim zbehjen e autoritetit tim të pastër!

– Kësaj radhe i dua vetëm paratë, kurse me fotografitë e Fitit do të merrem njëherë tjetër prandaj, po të pyes për të fundit herë: Ku janë paratë?

Në çast tri gjëra më erdhën në mendje; E para; pjesa e mbetur e parave të fshehura nën dyshek. E dyta; revolja nën jastëk dhe e treta; dollapi. Midis dhembjeve i ndava këto tri gjëra që e përbënin formulën matematikore me një të panjohur, që në këtë rast ishte rruga e shpëtimit! Kjo formulë, ngutshëm kërkonte zgjidhje! Vendosa

të tregohem i arsyeshëm para tij, duke dhënë shenja bashkëpunimi. Në çastin kur po bëhej gati për goditjen e radhës fola me zë lutës:

– Mos të lutem... mos më çart! Paratë ndodhen të fshehura lartë në dhomë...

– Nën cilin numër? – më pyeti kërcënueshëm me po atë zë të shterur që tani kisha filluar të dridhesha nga frika e tij.

– Nuk e di numrin, të betohem për Allah, por e di dhomën... e kam edhe çelësin! – i thashë duke e fshi gjakun nga koka që kishte filluar të më rridhte pa ndërprerë tatëpjetë qafës duke u futur nën jakën e këmishës së bardhë.

– Ec përpara! – më urdhëroi duke me shtyrë drejtë shkallëve.

Porsa ia ktheva shpinën, ndjeva një shpim djegës në shpatullën e majtë nga një gjësend i mprehtë. Nën rrezet e elektrikut që e mbante në dorën e majtë i ndriti shkallët, kurse me të djathtën vazhdonte të më shponte në shpatull, si buallin me hosten.

Vetëm tani kur bëra ta nxirja çelësin nga xhepi, vërejta se gishtat e dorës së djathtë ma kishin lënë shëndetin. Nuk i lëvizja dot nga dhimbjet. Pa një pa dy, ma futi dorën në xhep dhe e mori çelësin duke ma lëshuar në dorën e majtë;

– Hape shpejt e mos u shtir, kurvar i fëlliqur! – më tha duke e mbajtur vrushkullin e dritës mbi vrimën e bravës.

Kësaj radhe nuk reagova fare nga fjalët e rënda që m'i tha. Një kollë e thatë u dëgjua në njërën nga dhomat matanë. Një rreze shprese lodroi lirshëm në mendjen time. Ndërkohë, me zhurmën e zakonshme u hap dera.

Pasi u gjendëm të dy në dhomë, e mbylli derën prapa

krahëve dhe u kthye nga unë. Prapë vrushkujt e dritës mi pushtuan sytë.

– Ku i ke fshehur paratë?

– Në një vegsh të moçëm, tutje në dollap.

Me kohë e kisha bërë hesapin që t'i thosha se paratë i kam fshehur në dollap për ta larguar sado pak nga vendi ku ishin vërtetë të fshehura paratë dhe revolja, por vegshi i moçëm nuk di se nga më erdhi në mendje. Ky marifet i çastit e bëri të besueshme përrallën time që sapo e trillova. Për një çast më la të lirë pranë shtratit dhe u nis andej. Kur ma ktheu shpinën, pas rrezeve të elektrikut që e mbante në dorë duke e shndritë dollapin, pashë hijen e trupit të tij futë të zi, duke filluar nga maska e zezë që e mbante në kokë e deri të çizmet e futura në najlon që shushuritnin lehtë mbi dysheme. Derisa ai po i afrohej dollapit, me kujdesin më të madh i hodha disa hapa prapa drejt shtratit të zhubravitur. Tamam në kohën kur ai ndaloi pranë dollapit, ndalova edhe unë pranë jastëkut. Ai zgjati dorën dhe e kapi rezën e derëzës së dollapit, unë u kërrusa dhe e ngrita jastëkun. Ai e tërhoqi ngadalë derëzën dhe e mori vegshin në dorë, kurse unë e mora revolen. Në çast u ndjeva i sigurt dhe i trimëruar njëherësh. Derisa ai po kontrollonte në brendi të vegshit bosh, unë po përpiqesha t'ia shkrehi siguresën revoles.

– Paratë nuk qenkan këtu qen i pabesë! – dëgjova po atë zë që për një çast ndjeva të dridhura që ma mbërthyen mbarë trupin. Derisa po e mbërtheja shikimin drejt tij, ai vazhdoi të fliste me zë të hapur... – shih, shih! Paske edhe revole bre rahmet të pastë shpirti!

Për një çast nuk desha t'ju besoj veshëve. Pas fjalëve të fundit nuk pata asnjë dyshim se cili fshihej prapa asaj

maske futë të zezë dhe atij zëri të mekur. Tamam në kohën kur po bëhesha gati ta thirrja në emër, pashë krahun e tij të djathtë të ngrehej lartë bashkë me atë gjënë e mprehtë që vezullonte frikshëm në dritën e çrregullt të elektrikut. Instinktivisht e ktheva revolen drejt tij edhe pse nuk kisha arritur t'ia shkrehja siguresën. Tamam kur e hapa gojën të flisja, ta thërrisja në emër, ta lusja... pashë dorën e tij të vërvitej vetëtimthi drejtë meje dhe në çast në mes të gjoksit ndjeva një shpim të ftohtë sa që mu bë se jo vetëm dritat, por edhe bebëzat e syve më dolën jashtë dhe u rrokullisën mbi dysheme si dy kokrra ulliri.

– Ti a?... ah!

Dhembja që e tmerrshme. U shkërmoqa duke u kërrusur përpara. Trupi filloi marramendës të më ligështohej. Fuqia filloj të më lëshonte. E ndjeva trokëllimën e revoles që u përplas për dysheme. Me forcën e fundit u përpoqa ta orientoj trupin që të binte sa më lehtë mbi dysheme duke mos e ngacmuar hanxharin që më kishte ngelë i ngulur thellë në mes të gjoksit. Në çast u tmerrova nga mendimi se po rashë mbi té, do të më shponte anë për tej! Me sy të errësuar e ndjeva kur trupi mori nga e djathta. Së pari në dysheme me çiku supi, pastaj koka e në fund hanxhari! E ndjeva kur u fut edhe më thellë në gjoksin tim të gjorë, duke me shkaktuar dhembje të tmerrshme. Dritat rrethore u riaktivizuan në sytë e mi. Filluan të më silleshin vërdallë si në kaleidoskop, duke i ndërruar ngjyrat dhe të tilla, si vorbull me tërhiqnin drejt një ulluku të ngushtë e të panjohur. Si në ëndërr, si të më vinte nga bota tjetër që sa isha nisur drejt saj, më erdhi i njëjti zë, por tani, ndoshta për shkak të dhembjeve, s'qe aspak i frikshëm:

– Këtu nuk janë të gjitha paratë! Ku janë tjerat? Fol sa s'ta këputa kryet si zogut!... hej, më dëgjon? Fol të lutem... ja, tani do të ndihmoj... të betohem për Allah!

Një vrushkull i fortë drite ma përshkoj fytyrën duke me rikthyer përmes vorbullës edhe njëherë në realitetin e hidhur. Me mundim hapa sytë. Në dritën e fortë të elektrikut, nën shtrat, mbi dysheme, pashë vezullimin e karficës me gur xhevahiri që ju pat tretur nga flokët e shpupurishura, atë ditë që bëmë dashuri për herë të fundit me Zejneben time të hirshme. Në vezullimin e gurit të xhevahirtë, mu skalit buzëqeshja e ëmbël e saj dhe bashkë me të sikur mora të tatëpjetën nëpër atë ulluk të ngushtë që nuk po shqitesha dot prej tij. Ndjeva se me shpejtësi marramendëse, si në përrallë, po rrokullisesha drejt botës tjetër, i shoqëruar me zërin bubullimë të Allahut: „Ehhhh, mooooreeee Imaaaaam!" U ndjeva i kënaqur kur vërejta se gjynahet ngelen prapa, në botën që sapo e lashë pas e bashkë me to edhe rrengjet e kurdisura që do t'ua shohin sherrin të tjerët pastaj!

HETIMET

Derisa po i afroheshim shtëpisë së të ndjerit Hafiz, thellë në shpirt ndjeva një përzierje melankolike që kishte filluar të më ndiqte hap pas hapi që nga mëngjesi i ditës së parë të detyrës së re! Loti i madh, i feksur në syrin e Zogës sime të bukur, ma kishte këputur shpirtin para agut të këtij mëngjesi të ftohtë. Përballja me një rast hetimi, të një vrasje nga pusia, takimi i parë dhe i drejtpërdrejtë me kufomën e masakruar, shikimi i vendit të ngjarjes dhe fillimi i hetimeve në baza ligjore ishin tronditje të qeta që ndoshta pa dashur nxirosën mendjen dhe shpirtin tim, tanimë tmerrësisht të trazuar.

E trokitura në portën e llamarintë, edhe pse e ndrojtur, mu bë se qe tepër e fortë. U tremba kur bashkë me të trokiturën pashë se dora që po i binte derës ishte dorë polici... dorë detektivi! Urrejtja dhe frika nga ky emër i nëmur ishte shtresuar palë-palë në shpirtin tim që nga

fëmijëria e hershme. Veprimet policore dhe vrazhdësia e tyre kundër popullit tim, kundër njerëzve të mi, kundër meje që isha përballur qindra herë me ta, kishin krijuar përshtypje të atillë sa që sido që të ishin ato uniforma, disi nuk mund të trajtoheshin ndryshe nga unë, veçse armiqësore! Si të isha zgjuar nga një ëndërr e llahtarshme, u tendosa kur pashë veten në praninë e tyre që sa kisha hedhur hapin e parë të bëhesha pjesëtar i asaj bande që e quaja armiqësore dhe e urreja tmerrësisht! Për një çast e urreva veten!

Të trokiturat që u përsëritën më erdhën të rënda, të vrazhda dhe të tmerrshme... m'u bë se ishin të shoqëruara me sharje, goditje grushtesh e shqelmash, shkrehje armësh, klithma fëmijësh, vaje grash e mallkime nënash... i dëgjoja!

Kur matanë portës së llamarintë u dëgjuan vaje të trazuara grash, shikimi me mbeti i mbërthyer në uniformat blu të dy policëve që m'u bë se në gatishmëri të shtuar po prisnin hapjen e derës dhe pastaj të shfrenuar të hidheshin në sulm kundër atyre që po na vajtonin neve bashkë me fatin tonë të zi, brenda atij oborri të imagjinuar. Në çast, ndjeva urrejtje kundër tyre, edhe pse ata, fare të qetë po bisedonin diçka në mes tyre, kurse detektivi që po i përgjigjej një pyetje të posa shtruar nga njeri polic, pa pikë mëshire po u thoshte me seriozitetin më të madh, disi si të një urdhri të prerë, duke shikuar nga unë: „... duhet t'ju ndihmosh!" – kjo me erdhi si urdhër për t'ju ndihmuar uniformave blu për ta arrestuar, torturuar apo vrarë dike! Në çast, si pjesëtar i tyre që isha, pata frikë nga vetvetja!

– Shtyje derën, se e hapur është! – u dëgjua një zë i mekur nga brendia e oborrit, duke m'i tretur mendimet

torturuese!

Kërcëllima e portës së llamarintë që filloi të tërhiqej nga brenda, sikur ma rikujtoi kohën e shkuar kur policët të përzier me çetnikë e paramilitarë trokisnin në portat tona dhe ne, të fshehur pas tyre i tërhiqnim ngadalë, me shpirt të dyzuar në mes të tmerrit të vdekjes dhe shpresës për jetë!

– Ju? Ç'kërkoni këtu? – u dëgjua i njëjti zë, derisa po na shfaqej pamja e një plaku thatim që nuk e fshehte dot zemërimin.

Në brendi të oborrit të gjerë u panë lëvizje. Atmosfera e vdekjes shtrihej po thuaj në çdo skaj të tij dhe arrinte deri te ne. Unë, që sapo e kisha hedhur prapa krahëve një luftë të llahtarshme, jo vetëm që e njihja, por edhe e ndjeja rëndë gjendjen e tyre të përhumbur nga dhembja, trishtimi, urrejtja dhe zemërimi!

– Jemi nga policia kriminale...

– E pastaj? Këtu erdhët ta kërkoni vrasësin? – ia ndërpreu plaku fjalën detektivit, pa e fshehur urrejtjen që kishte kundër nesh, e veçmas kundër uniformave blu, që vazhdonte t'i shikonte me përçmim!

E kuptoj. Dhembja për humbjen e më të dashurit të tyre i ka dëshpëruar të gjithë, e në mesin e tyre edhe shpirtin e këtij plaku thatak, duke e sjellë në këtë gjendje zemërate e rebelimi bashkë, të shprehura kundër nesh, por edhe këta duhet kuptuar se ne jemi në krye të detyrës për zbulimin e vrasësit.

Ndërkohë u afruan të përzier burra e gra, vajza e të mitur që po na vështronin sikur ne të kishim shkuar aty për mëshirim, apo, çështë edhe më keq, për t'ju gëzuar vuajtjeve të tyre.

Duke e parë hezitimin e çastit të detektivit, vrullshëm ndërhyra unë. Pas qëndrimeve të tyre rebele, nuk ua thashë fjalët ngushëlluese që përdoren në raste të tilla dhembjesh, por u futa menjëherë në temë:

– Jemi nga policia kriminale. Kërkojmë një takim më zonjën... bashkëshorten e të ndjerit!

– Urdhëroni ju lutem! – u dëgjua zëri i një gruaje në moshë që ndodhej prapa grumbullit të njerëzve.

Detektivi më shikoi ngultas në sy, sikur donte të më thoshte; „E nise me rrëmbim, vazhdoje vetë tani!"

Duke e parë përhumbjen e saj, që ia thoshin qartë sytë e skuqur dhe lotët e tharë, e pa fuqishme dhe e mbytur në hidhërimin e pa gajret, vërejta se nuk e merrte as më të voglin mundim që vizitorëve t'ju thoshte fjalë të ëmbla, t'i priste e t'i përcillte ashtu siç e kërkonte nderi në raste të tilla andaj, mu duk se do të ishte e tepërt t'ia thosha fjalët ngushëlluese, që në këtë rast nuk do të ishin gjë tjetër veçse një sjellje e kulturuar nga ana jonë. Megjithatë, kur hapa gojën të flisja nuk ju shmanga dot fjalëve ngushëlluese dhe fill pas tyre, me zë të ulët e të qartë u futa drejt e në temë. Kërkova prej saj të më tregonte se kur kishte dalë i ndjeri nga shtëpia, për ku ishte nisur, kë do ta takonte, në ç'kohë do të kthehej në shtëpi, pastaj, a kishte pasur armiq apo kërcënime, dhe nëse po, cilët ishin ata si dhe të na lejonte të kishim qasje në gjërat e tij personale.

Para se t'ia fillonte të fliste ngriti vështrimin dhe më shikoi përçmueshëm. Pastaj, po nga ata sy nënvlerësues pashë dy pika të mëdha lotësh që u varën në qepalla dhe rrëshqitën tatëpjetë faqeve të vyshkura duke u bashkuar në mjekër që sa kishte filluar t'i dridhej përvajshëm. Me buzët që i dridheshin, pasi na bëri me dorë që ta ndiqnim

pas, tregoi se një arab e kishte ftuar në një takim pune dhe se për atje ishte nisur. Pastaj tregoi se kishte pasur armiq të padukshëm dhe kërcënime anonime që i kërkonin të hiqte dorë nga hulumtimet e tij islame e bashkë me to edhe nga kryesia e bashkësisë. Këto kërcënime kishin filluar të shfaqeshin pas pranimit në kryesinë e Bashkësisë të njëfarë Imamit!

Kur po hynim në kabinetin e të ndjerit, ajo nuk ngurroi të thoshte hapur dhe me ironi së fajtorët për humbjen e bashkëshortit të saj ishim pikërisht ne. I ndjeri ju kishte lajmëruar disa herë së dikush është duke e kërcënuar përmes telefonatave anonime, përmes letrave me plot sharje e kërcënime, përmes provokimeve të pandërprera e veçmas gjatë pjesës së dytë të natës që trokisnin në portën e llamarintë duke sharë me potere e batërdi dhe pastaj zhdukeshin në errësirë si hije djajsh! Ju kishte lajmëruar edhe kur e kishin goditur me shufër hekuri në derën e xhamisë... por kot! Askush nuk ishte marrë me mbrojtjen e fatit dhe identitetit të tij... dhe ja tani, duke e parë se askush nuk po kujdesej për lëvizjet dhe jetën e tij, të trimëruar dhe të sigurt së nuk do të ndëshkoheshin nga askush e vranë!

Në heshtje, me luajtje koke në shenjë pohimi, të gjitha ato që po i thoshte zonja e të ndjerit i miratonte detektivi, dhe në të njëjtën kohë vazhdonte kontrollin brenda kasafortave, sirtarëve, në dollapin e librave dhe mbi tryezën e tij të punës ku ndodheshin një mori librash dhe letrash të shpërndara dhe pjesa më e madhe e tyre ishin të shkruara arabisht.

Pasi morëm disa letra, nga ato kërcënueset, dolëm duke e ngushëlluar zonjën për mortin që i kishte rënë, por edhe

duke e falënderuar për informatat që na i dha, të cilat na drejtonin në zyrën e përfaqësuesit arab.

Këtu u ndamë. Policët me uniforma shkuan në stacion, kurse ne vazhduam rrugën drejt zyrave të përfaqësive të huaja.

Gjatë rrugës me veturë, derisa i shikoja pa vëmendje kalimtaret e rastit, vazhduam bisedën rreth vrasjes së Hafizit të gjorë duke thurur versione të reja ku në qendër të vëmendjes tani ndodhej edhe një arab, drejt të cilit ishim nisur.

Në hollin e gjerë pranë shkallëve na priti një burrë mustaqe rruar e mjekërzi. Pasi na tregoi se ishte truproje e zotit Abu, kërkoi të dinte nga ne se cilët ishim dhe ku po shkonim. Foli detektivi. Filloi t'i tregonte se vinim nga policia dhe kërkonim një takim urgjent me zotin Abu. Ndërkohë, derisa dëgjonte me sy të zgurdulluar, futi dorën në xhep dhe nxori celularin, kurse dorën tjetër e ngriti drejt nesh duke formuar shenjen stop! Ne të dy heshtëm. Pas pak u dëgjua zëri i tij, por kësaj radhe duke nxjerrë disa fjalë të pakuptimta, të ndara në rrokje dhe çuditërisht të zgjatura e të stërzgjatura! Pas disa lëvizjeve të së njëjtës dorë që çaste më parë detektivit i kishte dhënë shenjë të heshtte, bëri edhe një shenjë nga ne të dy, sikur ishte duke i treguar dikujt që ta kthente kokën për të na parë. Derisa po mendoja për ato gjeste të trasha, e largoi për një çast celularin nga veshi dhe u drejtua nga ne:

– E flisni ndonjëri nga ju gjuhen e Allahut?

– Jo! – u përgjigj detektivi duke shikuar nga unë i çuditur.

Me ngutë foli edhe diçka në të njëjtën gjuhë dhe e mbylli celularin. Pastaj u kthye nga ne duke thënë:

– Do t'ju përkthej unë!

– Mirë! – ia ktheu detektivi

Para nesh u shfaq një sheik, sikur ata që i kisha parë në televizor, me atë veshjen karakteristike me xhybe e maramë në kokë. Na bëri me shenjë të zinim vend dhe pastaj u ul në kolltukun e tij të madh përballë nesh. Pas pyetjeve të rëndomta, kuptohet përmes përkthyesit, u futëm në temë. Në fillim i kumtuam lajmin e vrasjes së Hafizit. Foli diçka rëndë-rëndë në gjuhën e vet. Ne nuk kuptuam asnjë fjalë. Pastaj u ngrit në këmbë dhe bëri një qark, gjithmonë duke dërdëllisë, dhe në fund zuri vend prapë në vendin e tij. Pasi na shikoi me radhë, pa e përjashtuar as përkthyesin, uli kokën në shenjë dëshpërimi. Ne shikuam nga përkthyesi. Ai nuk foli... nuk përkthej.

Pas një heshtje të gjatë, detektivi ia shtroi pyetjet e radhës. Së pari e pyeti në e kishte ftuar vetë të ndjerin në ndonjë takim pune, apo kishte qenë vizitë e vullnetit të tij, e rastit ose e qëllimshme. Gjatë kohës së vizitës a kishte qenë i pranishëm edhe dikush tjetër në zyrën e tij, apo kishit qenë vetëm ju të dy? Për çfarë keni biseduar, në ç'kohë doli nga zyra e juaj dhe në fund, a të tregoi se ku do të shkonte pastaj?

Filloi të fliste duke i ndarë falët në rrokje, disi të mbërthyera dhunshëm në ca „e" në fillim të zgjatura e pastaj befas të këputura shkurt, imët, egër, e të pasuara me ndonjë „m" me ndonjë „n" apo me ndonjë „h" të theksuar, derisa unë po mendoja se këto fjalë të dredhura, vërtetë nuk mund të shkruhen ndryshe veçse me shkronja të tilla, po ashtu të dredhura! Ai vazhdonte me të tijen pa ndërprerë, pa na shikuar fare dhe pa i dhënë mundësi

përkthyesit ta kryente pjesën e detyrës së tij. Vazhdonte dhe vetëm vazhdonte. Për një çast, kujtova se do të na zinte nata duke dëgjuar dërdëllitjet e tij të pakuptimta... kur, befas teshtiu. Pastaj heshti! Plaç, mendova më vete në vend që t'i thosha shëndet.

– Edhe pse foli gjatë, unë nuk do të merrem me përsëritjet e fjalëve të tij për dhembjen e madhe që po ndjenë për Hafizin e vrarë por do t'i bije shkurt: – filloj të fliste me ngutë përkthyesi, sikur kishte frikë së fjalët e përdredhura të Abu Al Khalidit sa kishin filluar të rrokulliseshin mbi tryezë dhe në dysheme për të kërkuar vrima se ku të fshiheshin, e pastaj nuk do t'i jepeshin më atij për të na i përkthyer ne; – Thotë se unë nuk e kam ftuar të ndjerin as për qejf e as për ndonjë takim pune. Ai erdhi vet, jo për ndonjë takim pune por thjeshtë, për një vizitë miqësore! Gjatë gjithë kohës thotë, kemi qenë vetëm për vetëm ne të dy në zyre dhe në fund jemi ndarë si miq të vërtetë që ishim pa me thënë se ku e kishte ndërmend të shkonte! Kaq! Ky dëshiron që mos t'i shtroni pyetje të tjera dhe mos ta shqetësoni më me gjëra të tilla të dhembshme! Dëshiron të jetë i qetë në trishtimin e tij... mund të shkoni! Unë do t'ju përcjellë deri në fundin e shkallëve...

Derisa ne po largoheshim duke u përshëndetur me té, përkthyesi kishte dalë para nesh në korridor dhe befas m'u gjend pranë:

– T'ju them të drejtën, mua m'u bë se shkëlqesia e tij sikur harroi t'ju tregoj se dje në praninë e tyre ishte për vizitë edhe një miku i tij i posa kthyer nga Arabia. Nëse nuk gabohem Abdallah e quante zotëri Abu, kurse Hafizin e dëgjova kur ju drejtua me emrin Çelë... dhe se kur ka dalë Hafizi i gjorë nga zyra, ka qenë shumë i nevrikosur.

Sa nuk u përplas me mua që isha duke i ngjitur shkallët me nxitim për të parë së për çfarë po grindeshin me zë aq të çjerrë!

– E për çfarë po grindeshin? – e pyeta me nxitim dhe në çast më kaploi një ndjenjë frike se ai nuk do të fliste më.

– Nuk mora vesh gjë. Asnjëri nuk e zuri në gojë praninë e Hafizit! Por... nuk e di a ju hynë në punë edhe një detaj i vogël që e pashë ndërkohë?

– Thuaje! Çdo imtësi tani për tani na hynë në punë! – foli me shpoti detektivi.

– Pas grindjeve, kur unë u gjenda në derë, pashë kur Abu Al Khalidi i dha shenjë me krye Çelit, sikur donte t'i thoshte: „ndiqe pas" duke i thënë me zë të ulët së ky njeri nuk e meriton mëshirën e as përkujdesjen e Allahut!

– E pastaj?

– Pastaj, disa minuta më vonë doli pas Hafizit!... Ah, po! Derisa po kthehesha nga xhamia pas lutjeve të içindijes për herë të fundit e pashë Hafizin të futej në berberhanen e madhe pranë pazarit të teshave.

– Po Çelin, dua të them Abdallahun a e pe pastaj?

– Po! E pashë kur u kthye.

– Ku e pe?

– Përballë berberhanes!

– E pastaj?

– Ç'farë pastaj? Ku e di unë së ç'ndodhi pastaj! Unë u ktheva prapë këtu.

– Mirë, mirë! Megjithatë, ju falënderojmë shumë! Dhe... dëgjo këtu; përkthyes më të zhdërvjelltë nuk kam takuar ndonjëherë! Të lumtë! – i tha detektivi derisa ishte duke ia shtrënguar dorën!

Kur për herë të parë përkthyesi e zuri në gojë emrin e

Çelit, befas në mbarë trupin ndjeva një shkalafitje, sa që gati m'u ndal fryma. Derisa isha duke e pyetur veten në ishte e mundur që Çeli, ish shoku im më i mirë i fëmijërisë të ketë rënë deri në këtë nivel të ultë? Me dhembje në shpirt për té, hapa gojën t'i thosha detektivit se me Çelin njiheshim, por...

– Versionit paraprak tani ju ngjit edhe një tip i ri! – thashë, krejt diçka tjetër nga ato që i mendova.

Ndryshimet e Çelit, pas kthimit të tij nga Arabia m'u rikthyen të topitura në mendjen time të trazuar. Ato lëvizje të ngathëta kur po i afrohej stacionit të autobusëve, me atë shikim të përhumbur, me bisedën e rënduar nga theksi arab, me ato sjellje mekanike që nuk i shkonin fare injorancës së tij të shtirë, sikur e hapen para pamjes sime një peizazh gri, por që sa largohej tutje tehu, aq më tepër zhdukej në një horizont çuditërisht të nxirë, katran të zi! Ah, thashë me vete; ky fenomen s'është gjë tjetër vetëm përpjekje të mjera për zhdukjen e gjurmëve!

– Po, mirë! Nëse vërtetohen nga berberi këto që i tha përkthyesi, atëherë ne e kemi një adresë të saktë ku duhet ngjitur versionin e ri për përgjim. Padyshim së në qendër të vëmendjes tonë duhet të jetë ky farë Çeli! – m'i ndërpreu mendimet detektivi.

– Pa dyshim! Ai duhet të jetë! – thashë i pavendosur në ato që i mendova.

Derisa po kalonim me hapa të shpejtë pranë dyqaneve dyer mbyllura nga të ftohtit, nuk e di se nga më erdhi një ide e çuditshme. Për një çast vetja mu duk se unë isha ai detektivi që ecte me nxitim para dikujt, kurse unë, nuk e përcaktoja dot së cili isha?! Lëvizjet i kisha si të huazuara nga dikush. Mendimet, të një kohe të shkuar!

Kur ndaluam të berberi, m'u bë se aty kishim sosur me qëllim qethjeje si në ndonjë stil të moçëm perçeje.

Derisa po fliste berberi, më bëhej se tregimi i tij kishte një lidhje të largët por tepër të ngjashme, për të mos thënë identike me përrallat që m'i kishte treguar dikur gjyshi im ndjesë pastë... ishte se ç'na ishte, na ishte njëherë njëfarë Hafiz – hoxha që kishte shkuar të berberi për t'u rruar! Derisa berberi po e rruante, jashtë pranë derës, si qeni që e pret të zotin, në acarin më të madh të dimrit e kishte pritur një mjekërkuq, hasëm i pejgamberit selamu alejkum! Kur Hafiz hoxha i rruar për shtatë palë qejfe, kishte dalë jashtë tepër i nevrikosur dhe ishte nisë andej nga xhamia e Kajmekamit, mjekërkuqi, hasmi i Pejgamberit selamu alejkum, ju kishte vënë prapa!... Vonë mu kujtua se këto që po i dëgjoja, nuk ishin përralla por një dëshmi e radhës që shpinte drejt gjurmëve të vrasësit! Me nxitim nxora bllokun e shënimeve nga xhepi dhe desha të shkruaj, kur dëgjova detektivin ta falënderonte berberin dhe ndërkohë më tha mua: Ikim!

Jashtë kishte rënë nata. Të ftohtit sikur e kishte shtrënguar edhe më! Disa flluska të mëdha, por të rralla bore, vërviteshin në ajrin e ftohët dhe plandoseshin në tokën e ngrirë, mbi trotuar dhe akoma pa zënë vend mirë shtypeshin pa mëshirë nga kalimtarët e rastit.

Pasi u ndava nga detektivi e ndjeva veten të boshatisur. Eca drejt qendrës me një gjendje të trullosur. Kalova pranë dyqaneve dyer mbyllura nga të ftohtit, pranë një kafeneje që gumëzhinte si zgjua bletësh nga zërat e çjerrë që më ndoqën pas deri të furrxhiu hasjanë, që për një çast, me kënaqi aroma e këndshme e simiteve të nxehta. I pavendosur ndalova dy tre hapa tutje pranë xhamit të

argjendarit Jak Kovi, i cili shihej matanë duke biseduar diçka me një qift të rinjsh derisa në dorën e majtë e mbante një gjerdan ari që shkëlqente gëzueshëm në dritat e forta! Sa do ta dëshironte Zoga ime një të tillë!

Mu bë se kësaj radhe këmbët po e udhëhiqnin kokën, kur befas e pashë veten në prag të mejhanes. Aroma e mishit të pjekur jo vetëm që më ngacmoi, por edhe më kujtoi se gjatë gjithë ditës nuk kisha ngrënë. Derisa po bëja porosinë, vështrimin e përhumbur e vërvita rreth e qark mejhanes. Në qoshen matanë pashë tre burra fytyrërreshkur që dukeshin si tyxhar lopësh, të nxirë si qypa turshish, sigurisht nga betë e rrejshme mendova në çast! Pranë tyre kishin zënë vend pesë a gjashtë burra flokëthinjur me gotat e përgjysmuara të birrës dhe pa shkak po gajaseshin me njëri tjetrin! Kurse pranë tryezës sime kishin zënë vend tre veta me sy të përgjumur, si të shkarë nga kjo botë dhe po e dëgjonin njërin që po fliste me zë të lartë duke dhënë e marrë me duar si të ishte dervish që tundej e lëkundej për t'u liruar nga ndikimi i djajve! Isha duke e shikuar një burrë të vetmuar që i kishte rrasë turinjtë në një tas të madh supe, kur mejhanexhiu m'i hodhi përpara dy pjata të mëdha. Zgjata dorën dhe mora një copë patlixhan të kuq dhe e futa lezetshëm në gojë. Mish paska boll, dhe qepët i paska grirë imët, mendova derisa isha duke e kafshuar me shije byrekun e ngrohtë dhe herë pas here vështrimin e vërvitja mbi pikturën e Imam Hyseinit. Befas ra celulari. Nuk e mora menjëherë sepse gojën e kisha plot. Ndërkohë ai ra edhe nja dy tri herë pastaj, pa e shikuar se kush mund të ishte e hapa. Ishte Rexhepi, shoku im i medresesë. Me njoftoi për vrasjen e Hafizit dhe më ftonte për pjesëmarrje në

varrim. Me hesap, vetëm kësaj radhe më punoi mendja drejt, sepse e pashë si një rast ideal që po më jepej për hulumtime të mëtutjeshme drejt zbardhjes së vrasjes! Qëllimisht e pyeta se a e kishte lajmëruar Çelin? Po, më tha, edhe ai e ka konfirmuar pjesëmarrjen! Shumë mirë, thashë dhe i urova natën e mirë. Tani e ha me lezet edhe pjesën tjetër të byrekut, mendova duke e mbyllë celularin!

Të nesërmen, gjatë marshimit prapa tabutit, me xhenazen e të nderuarit Hafiz sipëri, që mbartej nga pjesëtarët e kortezhit, ne, ish shokët e medresesë u tubuam si asnjëherë më parë. Në fytyrat e të gjithëve vërehej dhembja e dëshpërimi të përziera me pyetjen e pa përgjigje; Kush e vrau mësuesin tonë të devotshëm? Kjo pyetje kureshtare më së tepërmi më rëndonte mua, jo sa për ta zbutur sado pak kureshtjen si gjithë të tjerët, por për ta kryer detyrën sekrete, të parën e këtij lloji, me të cilën isha ngarkuar. Porsa filluam të tuboheshim, i vura re njërin pas tjetrit ish shokët e medresesë pa i përjashtuar edhe nxënësit aktual, në mesin e të cilëve nuk kisha qasje.

Në kohën kur po e lëshonin në dhé trupin e pajetë të Hafizit të gjorë, pashë në sytë e Rexhepit dy pika të shndritshme lotësh që morën të tatëpjetën e faqeve të tij të skuqura nga të ftohti, por nuk i la të rrëshqisnin të lira; i fshiu me shaminë që e mbante në dorë. Pranë Imamit pashë Çelin, me pamje të pikëlluar dhe krenare njëherësh dhe bri tij Maksutin kokulur, sikur qante me dënesë! I shkreti Maksut, mendova me dhembshuri për të. Sikur atëherë kur ishim të mitur, ashtu edhe tani, për çdo gjë përmallohet dhe qanë me vuajtje e dëlirësi shpirti. Më shtini n'gjynah dhe u afrova pranë tij. Ndërkohë

pranë nesh u afrua edhe Rexhepi që filloi të merrej me Maksutin e pikëlluar kurse unë, u përqendrova në përgjimin e lëvizjeve të Çelit dhe në fjalimin mortor të Imamit, i cili e cilësonte Hafizin si njërin më të devotshmit të lëvizjes së selefinjëve! Nga turma u dëgjuan të shara dhe u panë lëvizje drejt Imamit, të cilin pas pak e pikasa jashtë rrethojës së varrezave. Ndërkohë, Çeli m'u tret nga përgjimi.

Andej nga perëndimi, qielli kishte marrë pamje të purpurt. Ne u tubuam pikërisht te këndi ku e kishin flakur Imamin. Sikur ta kisha porositur unë, Rexhepi kërkoi që siç ishim të tubuar të ndalonim në mejhane dhe të bënim një pushim të shkurtër pas pikëllimit dhe të ftohtit që na ishte futur në palcë! Imamit nuk i pëlqeu fare kjo ide! E kundërshtoj. Nuk është nder që pas varrimit të kthehemi në mejhane, tha pas pak! Por, pas këmbënguljes sonë pranoi. Morëm rrugën e qyteti duke e lënë Hafizin e ngratë në errësirën e natës së varrit që kishte filluar të errej.

Në mejhane, krejt „rastësisht" u gjenda i ulur në kënd, nga mund të shikoja çdo lëvizje të myshterinjve si në shuplakë të dorës. Derisa po dëgjoja i shpërqendruar tregimin e Rexhepit që më dukej se kishte lidhje me ca piktura, syri im gëlltiste ca pamje të dyshimta që i nevojiteshin mendjes për kompletim informatash. Maksuti, pasi hodhi mbi tryezë një kuti boshe duhani me zë pëshpërime tha se do të largohej shpejt sa për të blerë cigare. *„Ai ia fal atij që do dhe dënon atë që do,"* foli pa asnjë kuptim derisa po ngrihej në këmbë për të dalë. Derisa po mendoja se edhe kësaj radhe, si gjithmonë, pa asnjë lidhje ia futi maksutçe, ashtu kot, siç e kishte zakon,

e pashë se pa e marrë gëzofin u vërsul nga dera. Ndërkohë, një vështrim i shpejt drejt nesh, nga një burrë i panjohur, nuk e vuri në siklet Çelin që e kisha nën përgjim, por Imamin, i cili si me përtesë u ngrit dhe fill pas tij u zhduk matanë derës ku shkruante: „VC.“ Pas disa minutash, i panjohuri u kthye. Nga pamja e tij injorante, nuk arrita të zbërthej asnjë domethënie! Asgjë e dyshimtë nuk kishte ndodhur. Çdo gjë ishte rastësi, përderisa i përgjuari im për asnjë çast nuk ia kishte shqitë vështrimin Rexhepit, sikur përreth tij të mos kishte ndodhur asnjë lëvizje. Çdo gjë i takon normalitetit... rastit! Edhe pjesa e lëvizjeve gjatë largimit të burrit të panjohur nuk solli ndonjë dyshim. Pamja e tij e qetë, lëvizjet përmes tryezave që gumëzhinin nga tollovia e krijuar, u duk aq e mjerë sa të fuste në gjynah vetëm ta shikoje e jo më të dyshoje se mbante ndonjë të fshehur brenda brishtësisë së tij! Maksuti u ul me potere duke nxjerrë shtëllunga tymi nga hunda, kurse Imami erdhi qetë-qetë sikur kishte frikë se po ia prishte qetësinë atij hundëmadhit që ende po merrte e po jepte me duar sikur po ç'fajësohej para Azrailit!

Derisa po ndaheshim, nga pamjet e ditës me ngelën vetëm ato që dyshoja se i nevojiteshin mendjes për të sofistikuar përgjimin. Disa herë pata frikë se pamjet dyshuese nuk ishin të përqendruara në ato që i shikoja dhe i përjetoja vetë, por në ato që më kishin yshtur të tjerët me dëshmitë e tyre! Edhe pse i përforcova përndjekjet në gjurmimin e lëvizjeve të Çelit, për asnjë çast nuk e shqisja nga mendja sjelljet plot dyshim të Imamit! Vallë, ku ndodhet ai tani?

Nata qe edhe më torturuese. Më kishte mbërthyer një gjumë dinak. Sa kotesha pak, ëndrra me degdiste tutje,

brenda ca varrezave të rrethuara me mure të larta dhe dyer llamarine. Në krye të tyre dëgjohej një zë i çjerrë burri që i ftonte të gjithë të vdekurit të ngriheshin për ta pritur me nderime Hafiz-hoxhën, kurse zëri i Hafizit vinte melankolik duke kënduar sure nga Kurani! I tmerruar kthehesha në krahun tjetër dhe për një kohë të gjatë as që guxoja t'i mbyllja sytë... dhe prapë ai gjumi dinak më rrëmbente në flatrat e tij dhe më degdiste në të njëjtat varreza... Në gjumin e fundit, të para agimit, mu shfaq Hafizi-hoxha me gjithë bardhësinë e qefinit të tij. Sikur po dilte nga varri i freskët dhe kërcënueshëm më thoshte se ti e di së cili më vrau, prandaj po nuk tregove do të digjesh në zjarrin e xhehenemit bashkë me vrasësin tim! Përpiqesha t'ia mbushja mendjen se nuk e dija vërtetë se cili e kishte vrarë, por në fund i thashë me zë bubullime: – heetiimeet vaazhdoojnëë!... – dhe ai m'u përgjigj, po me atë zë të trashë e të zgjatur: – Imaamii e diii, Imaamii... eedhee aaii ngaatreesëtaarii aaraab!...

–Hilë, Hilë shpirt!... ç'pate zemër? Hilë!... O Hilë, zgjohu loçkë, zgjohu! T'kam shpirt, t'kam zemër, zgjohu!

Sa u mrekullova kur i hapa sytë dhe e pashë Zogën time të bukur të ulur pranë meje, e jo qefinin e bardhë të Hafizit! Ende po dridhesha i pabindur së çdo gjë që kisha parë nuk kishte qenë gjë tjetër veçse ëndërr dhe ashtu i trembur siç isha, faqen e djersitur e vura lehtë në prehrin e saj të butë!

– Nuk dua të fle më! – thashë derisa Zoga ma fshinte ballin e djersitur me peshqir.

Derisa po vishesha, për të dytën, apo për të tretën herë ia bëra pyetjen vetes: a thua, vërtetë u tremba nga ato ëndrra të tmerrshme? Po! U tremba! Por, për ca ëndrra

të frikshme s'jepem para Zogës sime të hirshme, nuk ç'burrërohem! Ndërsa me bëhet së zëri i saj zemërmirë sikur është krijuar apostafat për mua, me shprehje të sajuara vetëm për të më shfajësuar, apo për të me dalë në ndihmë para të tjerëve. M'u bë sikur e dëgjoja t'ju thoshte shoqeve të saj: eh i shkreti, ka detyrë me përgjegjësi të madhe, detektiv ma!

Jashtë ishte terr. Një erë e ftohët, e përzier me pjalm bore m'u përplas fytyrës. U mbështolla edhe më mirë me gëzofin tim prej saftjanit dhe me nxitim i hodha hapat mbi rrugën e ngrirë. Kur po kaloja pranë shtëpisë së braktisur, m'u bë sikur në brendi të saj vegova një dritë të zbehtë kandili që ndërkohë u shua. Një drithërimë e lehtë ma përshkoi tërë trupin. Edhe pse nuk doja tani të mendoja gjëra me lugetër dhe shpirtra të vdekurish, boll më kishin munduar gjithë natën, në mendje mu shfaq libri Err Rruh.[61] Sikur mu bë se para meje mu shfaq shpirti i dëlirë i Hafizit të gjorë që gjatë gjithë natës ishte vizituar nga shpirtrat e tjerë duke e pyetur për të gjallët, për fjalët dhe veprat e tyre që i kanë lënë në botën e të gjallëve, për familjet dhe të afërmit që jetojnë pas vdekjes së tyre, për takimet dhe vizitat në mes shpirtrave të vdekur, vizitat gjatë festave që ua bëjnë shtëpive ku kanë jetuar dikur, tundjet e frikshme e të gjykuarve në natën e parë të varrit... ah, Hafizi i shkretë, ofshana, duke u përpjekur t'i largoj ata shpirtra që më kishin mbështjellë të tërin si aurorë e akullt polare! U drodha edhe njëherë kur i kujtova ato që fliteshin për këtë shtëpi të braktisur! Thuhej se gjatë netëve të ftohta kur jashtë bie shi apo borë, aty mblidhen

61 *Arab. Libri mbi shpirtin*

xhindet dhe pasi ndezin zjarrin në oxhak kërcejnë valle, ju bien instrumenteve të tyre dhe bëjnë orgji në mes tyre dhe me të pafetë! Eca edhe pak kokulur pa guxuar të rishikoj andej nga shtëpia. Nuk e di se në ç'rrethana syri më kishte ikur vjedhurazi nga vullneti im dhe në pjesën e pasme të asaj shtëpie fantazmë, pashë diçka si një gungë të errët... pa pasur idenë së ç'mund të ishte, i trembur dhe ia dhashë vrapit! Pasi u largova në distancë, dëgjova një gërhitje motori. Vetvetiu ktheva kokën andej. I ngazëllyer, pashë atë gungë të lëvizte me farë të ndezur dhe mori drejtimin e rrugës. Ah frikacak, e shava veten! E ndoqa me sy veturën se mos rastësisht do të merrte drejtimin e qytetit dhe një pjesë të rrugës do ta bënim së bashku por jo, ajo iku në kahun e kundërt. Vazhdova rrugën i trimëruar duke menduar se nga të vdekurit, nga lugetërit e as nga shpirtrat e të vdekurve nuk të vijë ndonjë e ligë! E keqja të vjen nga të gjallët! Hafizin e gjorë sigurisht së nuk e vranë të vdekurit, prandaj edhe rrethi i hetimeve nuk është përqendruar andej nga varrezat edhe pse vrasja kishte ndodhur bri tyre, por këtej, mbi botën e të gjallëve!

Në një çast u ndjeva i shqetësuar. Pata ndjenjën se do të vonohesha dhe kjo nuk do të shikohej me sy të mirë nga eprorët. Vetvetiu i shpejtova hapat.

Kur arrita nga ana e pasme e komisariatit dhe pashë dritaret e errëta, pata një parandjenjë të çastit se isha tepër herët. Duke i hedhur hapat tani më të ngadalësuar, por të matur, m'u kujtua se ditën e parë të punës askush nuk më kishte thënë për ndonjë orar të caktuar për t'u paraqitur në punë, bile as që e kisha ndonjë ide në ishte e domosdoshme paraqitja në mëngjes?

Në zyre ishte ngrohtë. I çliruar nga pesha e gëzofit,

u afrova pranë tryezës duke e shikuar me admirim, jo vetëm atë, por edhe karrigen e madhe të mbështjellë me saftjan të zi dhe të vendosur mbi pesë rrotëza të vogla që e bënin të lëvizshme! U ula lezetshëm dhe e tërhoqa lehtë drejtë tryezës. Sa praktike mendova, kur pranë meje, mbi tryezë, pashë një grumbull letrash të palosura me kujdes në brendinë e një dosjeje të hapur. Mora fletët e para në dorë dhe u vura të lexoj. Në formën e një titulli, me germa të mëdha ishte e shkruar: *„Ngritja e versionit të parë mbi natyrën e vrasjes."* Sapo fillova nga leximi, në mendjen time mu shfaqën pamjet gri të ditës së parë të punës, pranë atyre varrezave të rrethuara me mure të ulëta dhe trupi i pajetë i Hafizit në mesin e rrugës plot lloç! Çdo gjë ishte e trajtuar deri në imtësi dhe me saktësinë më të madhe. Pata admirim për atë që e kishte bërë formulimin kaq të bukur të fjalëve mbi këtë version! I mrekulluar nga këto përshkrime mahnitëse e mora në dorë letrën tjetër ku ishte e shkruar: *„Ngritja e versionit të parë mbi motivin e vrasjes."* Që në fillim, në këtë version jepeshin lidhjet e të vrarit, jo vetëm me anëtaret e familjes së tij të ngushtë por më tepër përqendrohej te bashkëpunëtorët, e veçmas në imtësinë më të madhe përshkruheshin letrat kërcënuese që i ndjeri i kishte marrë pakë kohë para se të vritej. Më tutje përmendej letra e shkruar arabisht që ishte gjetur në xhepin e të ndjerit, tani e përkthyer që nuk kishte qenë gjë tjetër veçse ftesë drejtuar të ndjerit për t'u paraqitur në zyrën e përfaqësuesit arab. Të gjitha këto i konfirmonte dëshmia e gruas së tij, së çdo gjë kishte filluar të tensionohej pasi në anëtarësinë e kryesisë së Bashkësisë ishte pranuar Imami. Këtu tërhiqej një vizë dyshimi te Imami, i cili në bashkëpunim me përfaqësuesin arab, e

kishin luajtur një kartë të dyfishtë dhe dyshohej se të dy së bashku e kishin yshtur Çelin, së pari të kthehej nga Arabia e pastaj ta bënte vrasjen!

Pasi mora në dorë letrën tjetër ku ishte e shkruar: *„Ngritja e versionit të parë mbi personat e mundshëm, pjesëmarrës në vrasje“* si t'i kisha parasysh, fillova t'i rikujtoj lëvizjet e Imamit në mejhane... kur vrullshëm u hap dera. Ishte Kujtimi.

U ngrita në këmbë. Derisa po përshëndeteshim me pyetjet e zakonshme, ai e hoqi pallton e tij të gjatë dhe e vari në trekëmbëshin prapa derës, fare pranë gëzofit tim dhe ndërkohë me ftoi të pinim nga një kafe në kantinë. Kur po bënim të dilnim, befas u hap dera dhe si hije u shfaq një kokë e zgjatur brenda. Trupi i kishte ngelur jashtë fletëzës së derës. Ndoshta për shkak të shfaqjes së beftë, sytë e tij m'u dukën të mëdhenj e të fryrë si dy xhama biluri. Nuk e di përse por në çast mu kujtuan sytë e fryrë të Maksutit!

– Ah, këtu qenka! – foli tjetri si me vete duke hyrë i tëri brenda. – E solla procesverbalin mbi obduksionin. – tha duke ia zgjatë një dosar.

Derisa e la dosarin mbi tryezë detektivi filloi të më tregonte për të porsaardhurin se ishte njëri nga mjekët më të mirë të medicinës ligjore. Ishte një burrë në moshë të shtyrë. Kishte të veshur një këmishë me vija të theksuara ku dominonte e kaltra. Një fytyrë të rruar taze dhe me faqe të varura. Thuhej së pas demonstratave studentore, këtu e njëzet e ca vjet më parë, e kishin larguar nga puna sepse nuk kishte pranuar që të vrarët nga policia të trajtoheshin dhe të cilësoheshin si të aksidentuar.

Kur po kalonim përgjatë korridorit, pashë dy policë

që po e tërhiqnin dhunshëm nga krahët një djalë të ri, i cili duar lidhur prapa shpine, tundej e shkundej për t'u liruar prej tyre dhe herë pas here, në kulmin e zemërimit ua këpuste nga një të sharë me fjalët më të ndyta. Kur po kalonin pranë nesh, pashë se ishte i sojit të Imamit. Tërlemja sa nuk i kishte shkarë fare nga koka e rruar zero, kurse nga mjekra i kullonin jargët. Çfarë ndyrësie, mendova me neveri.

Pasi hymë në kantinë, zumë vend në këndin e majtë pranë një tryeze rrumbullake dhe porositëm kafe. Një zë i thekshëm femre, po i tregonte dikujt në lidhje më sapo të arrestuarin. Ktheva kokën dhe pashë nga dera. Ishte një vajzë e re, e veshur me uniformë. Në njërën dorë e mbante kapelën kurse në tjetrën filxhanin e kafesë. Pasi ma hodhi një vështrim shkarazi, zuri vend në tryezën përballë.

– Po thuaj çdo javë është mysafir i yni – i thoshte njërit nga policët që zuri vend përballë saj me shpinë nga ne... – shkon në xhami e nuk i le të tjerët t'i kryejnë ritet ashtu siç dinë e dëshirojnë vetë por dhunshëm përpiqet t'ua imponoj ritet e tij. Ata që e kundërshtojnë, i nxjerr jashtë me potere e batërdi!

Për t'i ikë vështrimit të saj, si pa të keq hodha vështrimin tutje nga dera gjysmë e hapur. Në skajin matanë pashë një burrë në moshë të shtyrë, i veshur me shije, e me vështrim të shkarë, sikur ishte duke i numëruar minutat e fundit të jetës. Derisa po mendoja për të, se çfarë e kishte munduar gjer këtu në këtë mot të lig, ai vuri buzën në gaz. Për një çast m'u bë sikur po i qeshet ditës që u rikthye edhe njëherë në jetë, kur u ngrit dhe u nis drejt nesh. Kur u afrua pranë, pashë Kujtimin që u ngrit në këmbë duke ia zgjatur dorën

me respekt. Nuk më mbeti gjë tjetër veçse ta imitoja atë. U ngrita në këmbë dhe ia zgjata dorën. Ai vazhdoi të ma tund dorën pa folur duke më shikuar me të njëjtin buzëqeshje të shkarë, që mua mu duk si buzëqeshje e vjetruar.

– Është detektivi i ri! – foli Kujtimi

– Ashtu? Autori i versionit të parë mbi personat e dyshuar? – Foli tjetri duke pulitë sytë gjysmë të fjetur.

– Po, po! Ky është! – e dëgjova i hutuar detektivin, dhe ndërkohë po e pyesja veten se për çfarë versioni e kishin fjalën?

Diskutimet e mëvonshme nxorën në pah identitetin e të porsa ardhurit. Ishte detektiv i specializuar zbulimi për krime të rënda! Derisa po mendoja, se vrasja e Hafizit a cilësohej e rangut të krimeve të rënda apo si vrasje ordinere:

– Jo, – vazhdoj të fliste ai, sikur të m'i kishte lexuar mendimet: – Vrasja e Hafizit hyn në versionin e vrasjeve politike që kanë për qëllim eliminimin dhe llogariten si krime të lokalizuara. Të paktën, kështu të lënë përshtypjen në pamje të parë por, nuk do të thotë se kjo vrasje nuk ka lidhje me përgatitjen dhe ekzekutimin e ndonjë krimi të rëndë, apo thënë më qartë, të ndonjë sulmi terrorist, nga ato të fundamentalistëve islamikë!

– Po ju, si kaluat dje me të përhumburin Imam? – me pyeti pas një pushimi të shkurtër.

– Po, si të them...

Pranë nesh sa arriti komandanti. Zuri vend përkrah meje. Derisa Kujtimi po e pyeste nëse dëshironte kafe, ai pa e ndërpre bisedën tundi kokën në shenjë mohuese. I shpërqendruar, u përpoqa të kuptoja së për kë e kishte fjalën, kur u ndesha me vështrimin e ëmbël të vajzës

police. Me erdhi fytyrë e njohur.

– ...dhe duket së gjurmimi duhet sofistikuar kryesisht kundër Imamit. Dyshohet sa ka lidhje me një të panjohur...

– Edhe unë dyshoj për këtë! – ia ndërpreva fjalën komandantit. Pasi i shikova të pranishmit me radhë, në pritje për të marrë ndonjë sinjal miratimi në duhet vazhduar më tej rrëfimin apo duhet ndërprerë, vërejta së po i mundonte kureshtja për të ditur më tepër për rastin në fjalë. Atëherë vazhdova: – Mbrëmë, derisa po rrinim në mejhane, pashë një burrë të panjohur që po shikonte me ngulm drejt nesh. Derisa isha duke u përpjekur për të saktësuar se cili ishte dhe përse na shikonte ashtu, ai u ngrit dhe iku në drejtim të tualeteve. Çudia nuk ndodhi pse ai na kishte shikuar dhe ishte zhdukur prapa derës ku shkruante „VC“ por kur Imami e ndoqi pas.

Derisa po flisja, pashë së vështrimi i vajzës ishte ripërqendruar mbi mua. Ndërkohë nga unë u kthye dhe po më shikonte me ngulm edhe bashkëbiseduesi i saj, që çaste më parë ia kisha vërejtur vetëm shpinën, si pa të keq, e ula zërin dhe bisedën e përmbylla shumë më herët se që kisha paraparë pa ua treguar deri në fund rrjedhën e atij takimi të dyshimtë.

Fjalët e shkoqura të komandantit, që sa kishte filluar të fliste me atë zërin e tij të thellë, sikur pluskonin mbi sipërfaqen e qetë të një liqeni imagjinar dhe vetvetiu mbushnin me freski ata sy të fryrë kureshtarë që po e shikonin me ngulmë secili nga këndvështrimi i tij. Kishte filluar të rrëfente për historinë e një të zhdukuri gjatë luftës së fundit.

– Pak pas njoftimit nga familjarët e tij se kishin rënë në gjurmë të sigurta se i zhdukuri ishte parë i vrarë në vendin

e quajtur Fushë-verr, kur hop një ditë, pa pritur, emri i tij me të gjitha të dhënat, me fotografi dhe me shenjat e gishtave ishte parë i regjistruar në një komunë tjetër. Ishin njoftuar familjarët, të cilët sipas fotografisë menjëherë e kishin identifikuar se ishte pikërisht i dashuri i tyre. E kishin kërkuar në adresën e shënuar por nuk kishin pasur asnjë mundësi ta takonin. Disa nga fqinjët ju kishin thënë se një burrë i ngjashëm me këtë të fotografisë ishte dukur disa herë këndej pari. Duke bërë roje në mënyrën më sekrete, e kishin takuar, por ai si gjind ishte zhdukur. Në fund, anëtarët e familjes së të zhdukurit, të indinjuar kishin deklaruar se i dyshuari nuk ishte i afërmi i tyre, edhe pse kishte ngjashmëri me të. Pastaj, hulumtimet tona të mëvonshme rezultuan se pas këtij emri fshihet një person që dyshohet se mbanë lidhje të fshehura me Imamin e Magjistarin e veçmas ka lidhje miqësie e takime të shpeshta me njërin nga përfaqësuesit arab dhe është i njohur me nofkën „profesori!". Se vërtetë, kush fshihet pas figurës së tij mbetet të shihet!

Si i dalë nga një ëndërr pasoi urdhri i radhës, për të vazhduar përgjimin e filluar në qarqet dhe objektet e njëjta. Pashë andej, ku kohë më parë kishte qenë e ulur vajza që më kishte shikuar me admirim, por ajo nuk ishte më aty. Të largët, e ndjeva mungesën e pranisë së saj.

Gjithë dita më kaloi mbi letra e dokumente duke gjurmuar mbi emra dhe fotografi të ndryshme të zhdukurish me shpresë së do të ndeshë ndonjë pamje të ngjashme me të profesorit. Pasi nuk gjeta gjë, zbrita në arkiv dhe fillova të shfletoj në brendinë e disa dosjeve që rastësisht kishin ngelur pas tërheqjes së policisë pushtuese. Aty gjeta shumë emra që gjatë kohës së luftës

kishin qenë tmerr për mua dhe popullin tim. Përveç tyre hasa në disa emra të njohurish që në mënyrë të fshehtë kishin vepruar nën urdhrat e policisë sekrete. Takova edhe emra zyrtarësh të lartë që edhe sot e gjithë ditën gëzojnë reputacione të shkëlqyera në qarqet politike. I çuditur disa herë e pyeta veten së si është e mundur që këta spiunë të dikurshëm që i kishin shërbyer një elite gjakatare, t'ju shërbejnë tani fitimtarëve? Ndoshta ishin njerëzit tanë të kyçur në radhët e policisë armike që kishin siguruar informata! Ndoshta!

Kur po bëhesha gati ta hapja një dosje tjetër pashë nga ora. Pasi i fërkova sytë, i befasuar së si kishte rrjedhë koha aq shpejtë, ofshana duke e ndjerë veten të lodhur dhe disi të zbrazur në shpirt. Duke mërmëritë më vete u nisa kah dera: Në dreq të mallkuar vafshin të gjithë spiunët.

Dola jashtë. Bora kishte pushuar. Tutje nga perëndimi qielli kishte marrë pamje të kuqërremtë. I mrekulluar nga pamja piktoreske u nisa drejt mejhanes. Si i largët më erdhi njoftimi, që tani nuk po më kujtohet i qartë se nga kush e kisha dëgjuar, se në orët e mbrëmjes së sotme, para se të fillonte mbledhja e paraparë që do të mbahet në lokalet e Bashkësisë, në mejhane do të takoheshin disa nga pjesëtarët e ithtarëve të Imamit.

U nisa për atje. Porsa e hapa derën dhe hyra në mejhane, në tryezën përballë ku ishte vendi im i preferuar pashë së kishte zënë vend një djalë i ri, me veshje elegante, që po vështronte andej nga banaku. Në çast, porsa ktheva vështrimin andej, u ndesha me pamjen profile të Imamit që kishte zënë vend në një tryezë aty kah mesi dhe i vetmuar po hante darkë. Dukej i shqetësuar, sepse herë pas here vështrimin e mbërthente mbi pamjen e zbehtë

të mejhanexhiut, i cili dukej si i trullosur prapa banakut.

Në tryezën pranë meje, me zë të lartë fliste një burrë i imtë që dukej si i vrarë bryme nga një e hirtë e theksuar që ia kishte pushtuar fytyrën. Edhe pse nuk jepte emër së për kë e kishte fjalën, i entuziazmuar lente mjaft të kuptohej se biseda e tij i dedikohej Imamit dhe profecive të tij.

– Të këqijat, – thoshte i entuziazmuar – që e kanë pllakosur këtë vend, kryesisht vijnë nga rebelët dhe maskarenjtë që kanë treguar shmangie nga rruga e ndritur e Allahut dhe u janë kthyer pisllëqeve që po bëhen prapa mureve të lokaleve të natës. A si ndëshkoi Allahu boshnjakët që me vetëdije ju kishin shmangur rrugës së Allahut? A nuk u ndëshkuam edhe ne që e lamë rrugën e ndritur të islamit dhe u bëmë lakmitar në shkollat kaure në vend të mejtepeve? Disa sish filluan të pinë raki duke shkuar prapa dervishëve gjysmë të fjetur e të dehur nga rakia e hashashi, të shpuar me biza e shufra e të zhgërryer pas njëri-tjetrit? Imami e di më së miri dhe këtë e thotë pa hezitim së rakinë dhe drogën, të parët që e sollën në vendin tonë ishin pikërisht dervishët. Këtë e bënë për t'ua prishë mendjen besimtarëve të bekuar islam. Sipas një hadithi që efendiu e ka kënduar, thuhet se bota njerëzore ndahet në katër grupe; i pari është grupi i njerëzve të mençur siç ishte dikur Hasreti Muhamed selamu alajkum, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi té, pastaj vjen grupi i besimtarëve të denjë islam, grupi i tyxharëve mysliman dhe në fund gripi i miniaturistëve mysliman. Të tjerët që nuk u përmenden në këto grupe si jehuditë, kaurët, budistët dhe dervishët janë të tepërt në këtë botë prandaj, o duhet kthyer në islam, o duhet hedhur në det!...

Befas Imami u zhduk prapa dere ku shkruante „VC."

Vetëm tani mu kujtua se ende nuk kisha bërë porosinë. Mejhanexhiu as që më kishte vërejtur. Derisa po përgatitesha ta njoftoja që të vinte për ta marrë porosinë, pashë kur në derë u shfaq Cufi. Pa një pa dy, porsa me pa buzagaz erdhi të unë. Pas përshëndetjeve të rëndomta, më tregoi se e kishte ndërmend të shkonte në kinema. Me ftoi edhe mua. Luan një film shumë interesant, që vë në spikamë parregullsitë e fesë krishtere, më tha. Ndërkohë, pranë nesh ia behu mejhanexhiu. Porosita çaj bjeshke!

Derisa Cufi po fliste për filmat, mua për asnjë çast nuk më shqiteshin nga mendja shqetësimet e Imamit dhe vonesa e çuditshme e tij. Ndërkohë, kur po bëhesha gati të largohesha drejt tualetit, më tepër për të parë se sa që kisha nevojë, në derë ia behu Maksuti. Ia bëra me dorë të vinte pranë nesh! Si përherë, erdhi rrëmbyeshëm dhe zuri vend pranë Cufit. Pas një bisede të shkurtë, ju kërkova falje dhe u hodha drejt tualetit. I kontrollova të gjitha kabinat por nuk pashë gjë. Shikova nga dera ku shkruante „privat." Se si më mbuloj një shtresë marazi e përzier me një re të hollë dyshimi. Poshtë në dysheme pashë disa flluska të kuqe, që mu dukën si pika gjaku. I preka me dorë. Ishin të freskëta. Provova ta hapja derën, por ishte e mbyllur. U ktheva në tryezën time. Gjatë mungesës sime kishin arritur edhe Rexhepi, Nexhi dhe Çeli. Ndërkohë, Cufi iku në kinema. Nexhi me ftoi edhe mua të merrja pjesë në mbledhjen e kryesisë së selefinjëve gjë që e pranova me kënaqësi, por çuditërisht, në momentet e fundit ky propozim u kundërshtua prerë nga Rexhepi, i cili tha se është mbledhje e mbyllur vetëm për anëtarët e kryesisë! As Çeli e as Nexhi nuk folën asnjë fjalë, përveç kur ma zgjatën dorën duke më thënë; „natën e mirë!"

Kur isha në kulmin e kureshtjes, pashë mejhanexhiun të përpëlitej sa majtas, djathtas, sa fliste me shqetësim me njërin, sa me tjetrin dhe në fund pashë kur e vuri celularin të veshi.

Kisha një parandjenjë të keqe.

Derisa isha duke e pirë çajin që ishte ftohur fare, bëja plane që fshehurazi të afrohesha pranë sallës së vogël të Bashkësisë dhe t'i përgjoja lëvizjet dhe mundësisht t'i dëgjoja bisedat e tyre, ra celulari. Ishte komandanti. Me njoftonte së në brendi të lokaleve të mejhanes kishte ndodhur një vrasje. I vrari dyshohej të ishte i përgjuari ynë Imami! Më urdhëronte të largohesha sa më parë nga vendi i ngjarjes dhe të paraqitesha në komisariat për konsultime shtesë!

Dukej sikur dikush po më priste.

Nga rruga pashë një tundje të lehtë të perdes në njërën nga dritaret e kasolles. Kur arrita të dera, dikush e hapi derën para se unë të trokisja dhe me ngutë me pyeti:

– Keni porosi për mua?

– Po... për profesorin!

– Nga kush?

– Nga Magjistrica...

– Futu brenda!

Një korridor i ngushtë. Një llambë e varur në njërin ballë të murit dhe përplasja e derës që u mbyll.

– Nuk ka dritë elektriku! – tha pas pak njeriu fantazmë që sapo e kishte mbyllë derën.

Hija e tij nën dritën e zbehtë të llambës sikur u zmadhua duke marrë formën e një përbindëshi të tmerrshëm. Zuri vend në një skutë të errët në qoshe, kurse pakon e hodhi mbi një tryezë të ulët ndërkohë, drita e llambës po përzihej lehtë me dritën e zjarrit që depërtonte nga derëza gjysmë e hapur e stufës.

– Si ishte magjistrica... e mirë ë? – më pyeti duke bërë

me duar sikur ishte duke peshuar diçka të rëndë!

– Mirë!...

– Jo vetëm mirë... brumë... brumë i arrirë është... – tha me një shikim të humbur diku në një skutë të errët!

As rrezet e zbehta të llambës nuk ia fshehën dot një nishan në faqe... për një çast mendja me iku larg, në një sfond gri ku e kisha parë të ekzekutohej Naku... e njoha cili ishte... por ec e guxo e çele gojën! Këtu, në këtë kasolle, në prani të tij, sikur jeta nuk ka asnjë vlerë!

– E njeh këtë njeri? – me pyeti me kureshtje derisa po e kthente nga unë një fotografi.

Ishte një djalë i pashëm, flokëkaçurrel, me vështrim të ëmbël dhe buzagaz.

Tunda kokën në shenjë mohimi.

– Jo, – thashë pas pak – nuk e njoh!

– Këtë e dua të vdekur nga dora jote...

– Jeni gabim zotëri! Nuk jam i tillë unë!

– Ha, ha, ha! Ti nuk qenke i tillë! Po Ismajlin si e vrave?... mësuesin e shkretë... si t'u duk magjistrica, të pëlqej? Sa pare i more kur e vrave komandantin, ë?

– Si?... ko... kom...

– Po, po! Komandantin... fol sa pare i more?

– Sa pare?... pooo...

– A do tjera?

– Ë-ë! – e mohova me luajtje koke.

– Shenja të mira bashkëpunimi?... Ja ku të presin këto...

– Ëhë... – dhe zgjata dorën për t'i marrë paratë!

– Ah! Jo tani! Kur ta marr lajmin për punën e kryer... dhe jo këtu... të magjistrica! Ik tani! Shporru, zuzar!

As natën e mirë nuk i thashë nga frika!... shpëtova kësaj radhe, mendova i çliruar pasi dola në rrugë.

RRËMBIMI

Nuk e marr dot me mend se për ç'arsye të tjerët nuk më kuptojnë, kur qartë ju tregoj së ç'farë e kam ndërmend t'ju bëj? Kështu më ndodhi me Hafizin kokëkrisur, kur ia thosha troç se e kisha ndërmend ta vrisja dhe nuk më besonte, kështu po më ndodhë edhe tani me Imamin, të cilit po i tregoj se e kam ndërmend t'ia rrëmbej paratë që një natë më parë ia dha profesori, por siç duket, as ky hutaq nuk e ka ndërmend të më kuptojë!

Për shkak të kundërshtimeve të tij kokëforta, më detyroi t'ia ngjeshi nja dy të rëna të rrasëta me shufrën time majëmprehtë. Njërën ia dhashë në dorën e djathtë, e tjetrën pas kreje, duke e detyruar kësaj radhe jo vetëm të më kuptojë, por edhe t'i zbatoj urdhrat e mi një për një!

Kur u hap dera e dhomës dhe ne po hynim brenda, ndjeva një erë të rëndë myku. Ai qëndroi kokulur pranë shtratit duke më treguar së paratë i kishte fshehur në

dollap, në një vegsh të moçëm! Kur po e hapja derën e dollapit, ndjeva një erë të këndshme pemësh dhe për një çast mu bë sikur në dorë po e mbaja sepeten e gjyshes përplot me molla, atje lartë në qilarin e saj të moçëm e jo vegshin bosh... me vrull u ktheva drejt tij! Sa nuk me lëshuan këmbët kur e pashë së në dorë mbante revole, dhe atë të kthyer drejt meje?! Nga frika e harrova për një çast zërin tim të shtirë dhe fola hapur! E pashë kur i ndritën sytë nga befasia! Me njohu. Nuk më mbeti gjë tjetër vetëm të mendojë dhe të bëjë plane se si do të përfundonte dueli ynë i heshtur që sa kishte filluar të intensifikohej! Mendja më punonte shpejt. Së pari ia drejtova rrezet e dritës së elektrikut në sy. Me shpejtësi e largova dorën nga trupi. Derisa ai kishte filluar të merrte nishan në drejtim të dritës, unë e përgatita shufrën duke e mbërthyer në mes si të ishte heshtë mesjetare dhe ashtu, me sa fuçi që pata e hodha drejt tij.

Hiç nuk e di sesi ndodhi, por pas një belbëzimi të venitur të dalë si ngërç nga goja e tij, pashë kur ra përmbys sa gjerë gjatë mbi dysheme, ndërmjet murit dhe shtratit të shkarravitur! Nga pesha e trupit të tij të rënduar, shufra e ngulur thellë në gjoks, nxori majën mbi shpatullën e tij të majtë! Nuk ju afrova derisa përpëlitej me këmbë e duar. Pasi u qetësua pak, u afrova shpejt e shpejt dhe fillova nga kontrolli. Kisha parandjenja se paratë i kishte fshehur diku aty! Pata të drejtë! Nën dyshek i gjeta. Kur e hapa najlonin, pashë se nuk ishin as gjysma e atyre që duhej të ishin! Ju kërcënova për ta detyruar të më tregonte se ku i kishte fshehur të tjerat... pastaj e luta, desha edhe ta ndihmoj... por ishte e kotë. Në ato çaste ai ishte duke dhënë shpirt! E rrotullova shpejt e shpejt trupin e tij tani

më të rënduar nga vdekja dhe ia nxora shufrën nga gjoksi! Era e gjakut të derdhur filloj të kundërmojë. Një shije e keqe m'u ngjit në grykë. Barku fillojë të më turbullohet, sikur më lëvrinte diçka e hidhur përbrenda dhe në çast me erdhi për të vjellë! Po unë ç'bëj këtu?, e pyeta veten duke e mbajtur gojën me dorë. Mora nga dera. Kur bëra të dal nga dritarja e vogël e tualetit, fresku më solli forca të reja duke ma larguar atë trazim çasti.

Kur këmbët e mia prekën tokën, u ndjeva i çliruar krejtësisht nga ajo lëvri barku. Ngazëllimi që ma përshkoi tërë trupin, sikur u tret në errësirë, kur mu kujtua e thëna tridhjetë e tre e Sures Isra, ku thuhet se nuk duhet vrarë njeriun përveçse me drejtësi! Allahu e ndalon vrasjen pa ndonjë shkak! Mirë pra! Ky qafir, që sapo e shtriva përdhé si një qen të zgjebosur, e kishte hak vrasjen? Sigurisht se po! Ju do më pyesni pse? Ja pse: ky qen bir qeni, mashtronte dhe rrente ngado që shkonte dhe me këdo që takohej. I shërbente dreqit e t'birit vetëm për të përfituar. I kishte tri gra me kurorë dhe nuk ju shqitej vajzave të reja... pasi dhe Fitin, bukuroshen e ëndrrave të mia e kishte futur në dorë?! Pak ju dukën këto bëma të tij? Qen i pabesë! Pastaj revolja... deshi të më vriste i paudhi! Mjafton të mos e kalojë kufirin në mbytje të tjera, sepse këto që i bëra deri me tani isha i ndihmuar nga vetë Allahu i Madhërishëm sepse Ai gjithmonë ma kishte mbushur mendjen të vrisja!

Pasi i largova nga këmbët mbështjellësit e najlonit që i kisha vu për humbjen e gjurmëve, pashë se kishte filluar të frynte një erë e ftohët. I hodha ata najlon duke e lutur Allahun që t'ju jepte udhë të mbarë e kurrë mos të bien në dorën e spiunëve të urryer. I pashë derisa u tretën në

skutat e errëta të rrugicës.

Krejt i liruar nga ajo ngjarje e rastësishme, e luta edhe një herë Allahun të më ndjejë për këtë vrasje, sepse vërtetë nuk e kisha ndërmend ta vrisja Imamin por... nga frika e bëra... është vrasja e parë që u shtrëngova të përdori forcën e tepruar për ta mbrojtur veten! Estagfirullah!

Nga prapa ndërtesës së mejhanes u gjenda në rrugë. Edhe kësaj radhe këmbët u treguan më të mençura se koka. Vetvetiu me sollën pranë derës së mejhanes. Që jashtë dëgjoheshin zëra që gumëzhinin si zgjua bletësh. E shtyva derën dhe u gjenda brenda. Deri në skutat më të errëta e përlava gjithë hapësirën e mejhanes. Prezenca ime sikur nuk ia tërhoqi vërejtjen askujt, përveç Hilit, i cili ngriti dorën dhe më ftoi të shkoja pranë tij. Derisa po afrohesha me hapa të ngadalshëm, në mendje po e planifikoja se sa në pozitë të mirë ndodhej i ulur Hili. Sikur të ishim në një vend tjetër, vetëm për vetëm ne të dy, tinëzisht do ta nxirja shufrën nga torba dhe pa pikë dhembje, sikur ta kisha goditur një kungull do t'ia kisha çarë kokën në dysh! Por ah, këtu është e pamundur... por, do t'i vijë radha edhe këtij qafiri!

Derisa po ia shtrëngoja dorën Cufit, m'u kujtua Fiti dhe lidhjet e saj të fshehta me Imamin hileqar. Hak e kishte vrasjen, thashë me vete derisa isha duke zënë vend pranë tij, i cili vazhdonte të fliste me pasion për filmin „Kodi i Da Vinçit" që po luante në kinema! Me ftoi edhe mua që ta shoqëroja!

– As që bëhet fjalë! – foli Rexhepi në vendin tim, dhe vazhdoj: – Kemi mbledhjen e kryesisë!

Në kohën kur ai po fliste, mua me shkrepi në kokë një mendim i çuditshëm, por i dashur dhe i ëndërruar kohë të

gjatë: derisa ky torollak të gjendet në kinema, të hidhem andej nga shtëpia e tij dhe me hir a më pahir ta rrëmbej Fitin! Por si? Mendja po më punonte me shpejtësi rrufeje duke sajuar plane! Përfytyrimi i trupit të saj lakuriq, i ngrirë në tri fotografi më erdhi jashtëzakonisht i ëmbël. Në çast m'u bë sikur Fiti, nga korniza e fotografisë e zgjati dorën dhe po më thoshte: „Në je trim, eja! Ja si jam e gatshme vetëm për ty! Eja!... po të pres!... Ah!..." sikur u shkalafit nga kënaqësia, dhe u nis të dilte jashtë kornizës! Nuk më ikën dot moj çapkëne... dhe fill pas Cufit mora nga dera. Derisa po e mbyllja derën pas krahëve të mi, vazhdoja të mendoja i dyzuar: Mos po bëj mëkat që po merrem me intriga? Jo! Nuk po bëjë mëkat! Allahu po më mëson të planifikoj! A nuk shkruan kështu në Suren Jusuf? Estagfirullah!

Kur hyra në katund, ndjeva një ndrydhje në zemër! Ishte një kryengritje e vogël nga ana e saj për mospranimin e atyre planeve ogurzeza që i trillonte mendja. Në një çast u ndjeva i luhatur. Se nga më erdhi kjo pavendosmëri nuk e di, por dukej se zemra do të fitonte karshi mendjes sime të krisur! Por jo! Derisa po i mendoja ato skena të ëmbla erotike, pranë trupit të saj fillak dhe të njomë, sikur e gjithë qenia ime kishte ngre krye kundër zemrës, e veçmas ai sendi delikat brenda pantallonave, që në raste të tilla ngre krye dhe pastaj çdo gjë lëvizë sipas vullnetit të tij të mbushur plot epsh!

Rrezet e argjendta të hënës po e shndrisnin paq rrugicën e ngushtë të mbuluar nga degët e zhveshura të pemëve. Derisa po e zija pritën, mu bë së në fundin e rrugicës dëgjova hapa. Me të shpejtë kalova në anën tjetër të gardhit dhe u fsheha pas trungut të trashë të

arrës. Ndërkohë, e vura maskën dhe dorëzat e zeza. Kur nxora pak syrin sa për të parë se kush mund të jetë në këtë orë të vonë të natës, të ç'trajtësuara i pashë dy hije që po nxitonin drejtë shtëpisë së Fitit! Njëra dukej të jetë fëmijë, kurse tjetra... si nëpër mjegull dëgjova një zë femre. Me erdhi i njohur, i dashur... i pritur! Kur hijet e tyre kishin filluar të trajtësoheshin dhe syri im vërejti se vetë Allahu ma kishte dërguar atë që e prisja me padurim, për herë të parë ndjeva së mendja, trupi dhe zemra, së bashku me vullnetin e Allahut të Madhërishëm kishin të njëjtin qëllim: Rrëmbimin! Do ta rrëmbej, sepse edhe i Madhërishmi ndodhet në anën time! Sikur të ishte kundër, nuk do të ma sillte kaq bukur në pritë! Ai është i urti, i gjithëdijshmi, i gjithëfuqishmi! I lumi unë për Té. Estagfirullah!

Andej nga rruga u dëgjua një e lehur qeni. Pastaj, si kundërpërgjigje u dëgjuan edhe disa të lehura në anën tjetër të katundit. Mua mu bë sikur të lehurat ishin të koordinuara me njëra-tjetrën! Hijet që po i vëneroja në vazhdimësi, dukeshin të trembura dhe u afruan pranë njëra-tjetrës! Kur të lehurat ishin shpeshtuar dhe kjo dukej së bëhej me urdhrin dhe vullnetin e Allahut të Madhërishëm, për të ma lehtësuar mua punën time, tani më të përligjur edhe prej Tij, të dy hijet sa ma kthyen shpinën pa pasur as më të voglin dyshim se unë isha i fshehur pas trungut të trashë të arrës. Në maje të gishtave dola nga errësira dhe u gjenda në rrugë. Qentë vazhdonin të lehnin edhe më afër nesh. Ato ngadalësuan hapat, kur në distancë u panë dy qen. Derisa ato i ngadalësonin hapat, unë nga torba e nxora thesin dhe po e përgatisja grykën. Kur ato ndaluan para

ngërdhucjeve të qenve, unë ia futa thesin në kokë Fitit dhe me shpejtësi marramendëse e tërhoqa tatëpjetë deri në fundin e këmbëve të saj! Qetësinë e natës, vrullshëm e theu britma e saj e lemerishme „Ah!... lëshomë... lëshomë i poshtër“ dhe u përcoll me britmën e vajzës së vogël e cila nuk pushonte së thirruri për ndihmë dhe nuk më shqitej duke më goditur me shqelma e grushta! Ia dhashë një flakaresh të fortë. E pashë kur u rrëzua për tokë. Sa hap e mbyll sytë e rrëmbeva Fitin nga këmbët dhe e hodha mbi krahun e djathtë! Ngërdhucja e qeneve vazhdonte me të lehura të ashpërsuara, por pa sulmuar. Unë mora drejt veturës. E hapa gepekun dhe e hodha brenda, pa ia vënë veshin vajit dhe përpëlitjeve të saj brenda thesit! U nisa! Derisa po e mbushja me gaz motorin e veturës, pashë vajzën e vogël që po vraponte pas veturës duke klithur me sa zë që kishte! Pasi mora kthesën e parë u gjenda në rrugën kryesore. Estagfirullah, edhe njëherë i kërkova të falur Allahut dhe mora drejtimin e shtëpisë së braktisur.

DHUNIMI

Sa me pëlqejnë netët me hënë, kur rrezet e saj shkrijnë si arë mbi pikat e vesës që vezullojnë mallëngjyeshëm mbi petalet e trëndafilit, që më ngjajnë si pika lotësh të ngrira në qepallat syve të vashave të dashuruara! Me vijnë edhe më të mallëngjyeshme kur e shoh vezullimin e xhevahirtë të brymës që kristalizohet thyeshëm nën ato rreze magjepsëse! I shikoj me përmallim ato shndritje kristali dhe padashur më degdisin në kujtime të largëta, të zbehta dhe të ftohta, tamam si rrezet e hënës dhe vetvetiu vështrimi më ndalet mbi lëndinën e bukur pranë kroit të kulluar të Milushit, aty ku thuhet së Zanat e malit, me flokë të gjata e të arta, të veshura si flaka, duke shndritë përreth me atë dritën e tyre magjepsëse që prej mijëra vjetësh, të dalldisura vazhdojnë të hedhin valle.

– Sa bukur! – tha Dili duke shikuar e mahnitur peizazhin para!

– Vërtetë bukur! Sa i dua netët me hënë... disi mallëngjehem...

– Shkojmë tani Fiti... unë kam frikë se do të ftohem! – më ndërpreu Lulja duke me tërheqë nga dora që ta ndiqja pas!

Pasi i urova natën e mirë Dilit, dora-dorës me Lulen u nisëm drejt shtëpisë. Derisa po ecnim në rrugën e shndritshme nga rrezet e hënës por të ngrirë nga acari që bënte, më vete po i bluaja ndodhitë e rastit, por shumë të këndshme që i përjetova gjatë kësaj mbrëmje të mrekullueshme. Edhe njëherë e solla në mendje vizitën në kullën e moçme të Lulajve! Pamja e dyzuar e Çelit nuk me shqitet për asnjë çast nga mendja. Herë-herë më bëhej së dashuria për të, jo vetëm që nuk kishte më dromca urrejtjesh, por ishte edhe më e fuqishme, edhe më përvëluese... dhe disi në shpirt e ndjeja së ai shpejt do të largohej nga ajo rrugë krejtësisht e huaj për hir të dashurisë sonë! Këtë e vërejta në sytë e tij të bukur, në zërin e tij, në lëvizjet e tij! Në njërën anë e kujtoj ashtu siç kishte hyrë dikur në zemrën time, ndërsa në anën tjetër, me dhembje e kujtoj të konvertuar siç e pashë në realitet! Për të dyja rastet ndjeja dhembje... kurse ai, ndoshta kurrë nuk do t'i kuptojë këto kujtime që po ia them kësaj nate të bukur... që po ia them hënës rrezeartë; „Ku ndodhet tani Çeli im?“ Ja, po e ndjej mallin e veguar të dashurisë që më vjen si një puthje e ethshme dhe e zjarrtë por e molisur nga pritja e gjatë dhe gati e mohuar jo vetëm nga unë por edhe nga dheu që nuk po dëshiron ta njohë filizin e vet me ndjenja e shpirt të konvertuar! Kam frikë të ecë, sepse po më duket së po ia kthej shpinën përgjithmonë Çelit tim të shtrenjtë! Më bëhet se do të degdisem larg,

ashtu siç u degdis ai, do të ndryshoj ashtu siç ndryshoi ai dhe për jetë të jetëve do të ngelim të ndarë... pa e shijuar zjarrin e dashurisë së ëndërruar me vite të tëra... dhe teksa eci pranë Lules, nën rrezet e arta të hënës, më bëhet sikur jam në ëndërr duke vrapuar pllajave të braktisura në kërkim të fytyrës së tij, ndërsa zemra më shpohet si nga një shigjetë me pupla në bisht!

Nuk e di as tani se si kishim arritur pranë selishtës sonë. M'u duk e zhveshur dhe e mjerë nën rrezet e zbehta të hënës. Trupat e mëdhenj të arrës mu bënë si trupa gjigant lugetërish, që prapa tyre fshihet diçka e tmerrshme. Të lehurat e qenve sikur më brengosën pak. Instinktivisht ia kisha shtrënguar dorën Lules e cila mu afrua edhe më tepër duke pëshpëritë:

– Kam frikë Fiti!

– Jo shpirt, ja gati arritëm... hë... Ah!...

U tmerrova kur ndjeva një lëvizje prapa krahëve të mi! Tamam në kohën kur po bëhesha gati të kthehem për të parë së ç'po ndodhte, befas u gjenda e ngatërruar, si kshetëza e mbërthyer në rrjetë! Bashkë me lëvizjet e ngathëta, përveç zërit tim të vrazhdë dhe të përvajshëm nga frika, dëgjova vikamën e Lules që po qante duke dhënë kushtrimin për ndihmë! Kur një palë duar të forta po më mbërthenin për leqe të këmbëve, për të dytën herë dëgjova jehonën e dhembshme të vajit të Lules. Ndërkohë, ndjeva që u shkëputa nga toka dhe pjesa e poshtme e barkut mu ngjesh fortë pas supit të dikujt! I dhashë trupit me gjithë fuqi që pata. U rrotullova si gjarpërushja, sa majtas djathtas, por duart e rrëmbyesit ishin shumë të forta dhe nuk shqitesha dot prej tyre. Sa më shumë tundesha duke thirrur për ndihmë, aq më shumë

më shtrëngonin. Disa herë e pyeta me zë të çjerrë së cili ishte dhe ç'kërkonte nga unë. Nuk përgjigjej i poshtri, vetëm vraponte. Pas disa çastesh i ndjeva lëvizjet e tij që u qetësuan. Po më lëshonte për tokë mendova... por jo! Vetëm sa me shtrëngoi edhe më keq duke ma zënë frymën. Ndjeva kur po hapej dera e metaltë e veturës. Tani e kisha të qartë. Dikush po më rrëmbente! Të jetë Çeli vallë?

Derisa po shpurdhja me duar e këmbë në përpjekje për t'u liruar, ndjeva një të rënë në pjesën e pasme të kokës, sa xixa stralli me dolën nga sytë. Fill pas, ndjeva kur me plandosi në një vend të ngushtë... o Zot, thirra e tmerruar; po me futë në gepek. E ndjeva së isha pshurrë nga frika, tmerri dhe lotët. Por ishte e kotë! Për herë të parë fillova të mendoj ndryshe, pasi me lot, britma e vaj nuk arrita gjë. U mbyll kapaku me një krismë të shurdhtë. Pastaj, dëgjova hapa të çrregullt, krismën e një dere që u mbyll dhe fill pas saj zhurmën e motorit bashkë me tundjet e ç'rregullta të veturës.

Tani nuk po qaj më. U dhashë pas ideve që të bëjë diçka për të shpëtuar. Fillova ta tërheqë atë rrjetë, që m'u bë se nuk ishte gjë tjetër veçse ndonjë thes kërpi... ah, mendova e dëshpëruar, kjo qenka grabitja me thes në kokë që sa e sa herë më kishte treguar gjyshja ndodhi e përralla të tilla! Kurrë nuk më kishte shkuar mendja së edhe mua do të më gjente një fat i tillë... tani në këto kohëra moderne!?

Duke lëvizur, hetova se gryka e thesit ndodhej në fundin e këmbëve dhe ishte e hapur. Fillova nga puna. Duke u rrotulluar mundimshëm në atë vend të ngushtë, sa majtas djathtas, arrita dalëngadalë ta tërheqë grykën e thesit deri të gjunjët! Me vinte zor, sepse në gepek kishte edhe

gjësende tjera, të forta e të mprehta, të cilat më lëndonin nëpër trup. E kisha të pamundur t'ju shmangesha, por megjithatë, vazhdoja shpërvjeljen e thesit pa humbur kohë. Kur arrita që gishtat e dorës së majtë t'i nxjerrë jashtë grykës së thesit, sikur u mrekullova. Edhe pak, dhe do ta hiqja qafe njëherë e mirë këtë rrjetë të mallkuar dhe pastaj do të rrëmbeja ndonjë shufër hekuri që siç duket paska këtu me bollëk dhe të pres në gjendje gatishmërie. Porsa të hapet gepeku, ta godas me gjithë forcë dhe të lirohem njëherë e mirë nga ky maskara... kur u ndal vetura.

E përshpejtova manovrimin. Arrita ta tërheqë grykën e thesit deri të beli. Edhe pak, dhe do të jem fare jashtë tij! Dëgjova kur ai idioti e hapi derën dhe pas pak përplasjen e saj. Hapat e tij me erdhën të ngathtë dhe të panjohur, kurse zhurma e metaltë e çelësit kur e futi në vrimën e bravës me tmerroi. Ende isha larg lirimit nga ai thes i mallkuar, kur e ndjeva hapjen e kapakut dhe një zë të ndrydhur, të shkërmoqur, të butë dhe të qetë, që asnjë ide nuk e kisha së kush fshihej pas tij.

– Ncy, ncy, ncy! Jo kështu zogëza ime, jo! Tani do të liroj vetë... vetëm duro edhe pak!

Në të kundërtën e fjalëve të ëmbla, të dalë nga ai zë gati i shterur, veprimet ishin të ashpra. Pasi m'i futi prapë këmbët në thes, u përpoq të më rrëmbente duke m'i ngulur ashpër thonjtë e tij të mprehtë në muskujt e dorës dhe të këmbës së djathtë. Fillova të kundërshtoj, duke lëvizur gjithë trupin:

– Lëshomë i poshtër... qen i pabesë... ç'kërkon nga unë?... lëshomë idiot!... – dhe fillova të bërtas me sa zë që kisha duke kërkuar ndihmë! Ndërkohë, derisa po përpëlitesha e hakërryer brenda thesit të ngushtë,

me britma e sharje nga më të ndryshmet, ndjeva një dhembje të tmerrshme në mollëzën e faqes së djathtë. Pas pak i ndjeva edhe disa të goditura të njëpasnjëshme në shpatull e vithe. Dhembjet ishin të tmerrshme. Britmat i ndërpreva por jo vajin dhe lotët që më treteshin diku në stofin erërëndë të thesit. Goja mu mbush më një shije të keqe. Nuk ishte as e vjellë as jargë. Nga me vjen kjo shije? Gjak?!... u tmerrova! Pa ndërpre vazhdonte të me mbushej goja me atë shije të njelmët... dhe pasi nuk kisha se si ta pështyja jashtë, isha e shtrënguar ta kapërdijë... ndërkohë e ndjeva zhvendosjen e rënduar të trupit. Me bark të mbështetur mbi cepin e supit të tij, kokëvarur, ndjeva së po me shpinte në drejtim të panjohur! Nga tundjet, mezi po merrja frymë. Goja vazhdonte të më mbushej prore me gjak. Nuk e kapërdija dot por as nuk e mbaja... m'u zbraz në ngushtimin e thesit. Një erë e rëndë fillojë të kundërmojë, sa që mu bë së zorrë e mushkëri do t'i nxirja jashtë nga të vjellat! O Zot, merrma shpirtin e mos më le të vuaj në kthetrat e këtij të poshtri! Ah, e mjera unë e mjera, ç'më gjeti, ofshana e trishtuar pa gjetur ngushëllim!

Si të isha zgjuar nga një jermi, ndjeva të hapej një derë! Fill pas ndjeve zhvendosjen e trupit që po më lëshonte për tokë dhe pastaj një peshë të rëndë mbi shpatulla. Me frymën e fundit arrita t'i them të më lironte pak sa të ngopesha me frymë. Më liroj pak duke më thënë më atë zë të shkërmoqur:

– Nëse vazhdon kundërshtimin e urdhrave të mi, do të therë si ftujë! A more vesh?

Nuk i dhashë përgjigje. Heshta! Heshta, sepse tani e kisha të qartë së kam të bëjë me një njeri shumë të

poshtër. Vallë, kush fshihet pas këtij zëri? Fillova ta ndjej së kundërshtimi i ashpër, kur ndodhësh duarlidhur nuk ishte mençuri. Për një çast, duke i mposhtur dhembjet, u vura të mendoj së çfarë duhej bërë që t'ju shpëtoj torturave! Kisha filluar të dridhesha... në të vërtetë nuk e mbaj mend tani së kur kisha filluar të dridhesha, por po e hetoja që po vazhdoja të dridhesha si thupra n'ujë. Nuk e ndaja dot në dridhesha nga tmerri apo nga të ftohtit! Oh, sa do të dëshiroja që t'i afrojë pëllëmbët pranë fytyrës e t'i fshi pikat e lotëve që në heshtje po me rrjedhin pa ndërpre dhe ta ledhatojë lehtë plagën në mollëzën e faqes si ujkonja kur i lëpinë plagët e veta e fshehur në shpellë... kur e ndjeva që filloi t'ia lidhë grykën thesit që ndodhesha në të, duke m'i futë edhe këmbët brenda! Nuk kundërshtova.

Pas një heshtje të shkurtër, i vura veshin lëvizjeve të pakontrolluara dhe fëfsh-fëshëve të shkaktuara nga disa lëvizje të ngathëta. Pas pak, që nga brendia e thesit dallova një si shkreptimë rrezesh të forta drite, që për disa çaste qëndruan mbi sytë e mi të fshehur në thes. Drita më erdhi si pamje e rrezeve të diellit prapa perdeve. Derisa drita po venitej, dëgjova lëvizje të lehta hapash të shoqëruara me ledhatim beli nga një dorë e lehtë dhe në të njëjtën kohë, zërin e shkërmoqur:

– Tani zogëza ime, do të jesh e lirë! – dhe ndjeva çarjen e thesit dhe lirimin e dorës së majtë!

Ngazëllimi nuk zgjati shumë. Ndjeva një dorë të fortë që ma shtrëngoj llërën, tani më të nxjerrë nga thesi dhe vrazhdësinë e lakut që po lidhej shtrëngueshëm aty te kyçi, ku e kisha të lidhur orën. Pas pak, ndjeva që përmes atij laku më tërhoqi zvarrë, për disa metra dhe

pjesën tjetër të lakut e lidhi diku! Pasi me rrotulloj pak nga e majta, e ndjeva kur e preu thesin aty ku ishte dora e djathtë. U përpoqa të kundërshtoj por pa sukses. Me vrazhdësinë më të madhe ma lidhi edhe dorën tjetër.

E kisha të qartë së çfarë e kishte ndërmend të më bënte. U tmerrova kur e mendova së pas pak çastesh dhunshëm do të jem e shtruar nën peshën e epsheve të tij. Mendja më punonte shpejt. Dhembjet i kisha harruar fare... kurse ai i mallkuari kishte filluar të çante thesin me maje thike pranë fytyrës time! I dhashë trupit me sa fuqi që pata, që thika e tij të ngulët në gjoksin tim, por nuk ndodhi asgjë, sepse ai gjithherë e largonte me kujdes! Pasi u hap gryka e thesit, pashë së isha në një bodrum të errët e të frikshëm. Përballë meje qëndronte i ulur galuc një figurë njeriu me pamje të zezë si futa! Pashë një kokë të futur nën maskë. I dallova buzët e trasha dhe një palë sy të hapur, që i shndrisnin si sy ujku përpara presë! Fillova të bërtas me sa zë që kisha, më shpresë së në atë shtëpi mund të kishte njerëz të tjerë të cilët do të më vinin në ndihmë!

– E ke kot zogëza ime! Këtu nuk ndodhet askush tjetër përveç ne të dyve... ah, po; edhe Allahu i Madhërishëm është më ne!– u dëgjua i qetë zëri i shkërmoqur.

– Po! Allahu e sheh së po më bëhet e padrejtë... sepse, *Ai e di për çdo gjeth që bie,*[62] prandaj po pres të më ndihmojë... të më lirojë...

– Prit ti prit! Ai ia e ndihmon atë që do dhe humb atë që do! E sheh, ty të ka dënuar, kurse mua do të mi falë mëkatet! – ma kthej me ironi zëri i shkërmoqur dhe filloi të më avitej duke mi ledhatuar faqet dhe gushën. Dorën e

---

62 Kuran 6:59

ndali mbi gjirin tim të majtë! E tmerruar fillova të bërtas më sa zë që kisha;

– Lëshomë, i poshtër! Ç'kërkon nga unë? Kush je ti?... lëshomë i poshtër, idiot... Ah!...

Vrullshëm më rrëmbeu nga flokët dhe ma ngriti kokën lartë! E hetova që po përpiqej të ma lidhte gojën me shami. U përpoqa ta kundërshtoj duke lëvizur kokën sa majtas djathtas, por ishte e kotë. Shamia e përdredhur përfundoj në gojën time si fre kali. Duke e shtrënguar me inat ma lidhi pas kreje. Tani nuk flisja dot. Një gulçimë e venitur me nga një „ë" të mekur më delte herë pas here nga goja, kurse çurgu i lotëve më rridhte pandërprerë!

Në mes të atyre përpjekjeve u dëgjua një sirenë alarmi. Në fillim nuk e ndava në ishte alarm policie, zjarrfikësish apo i ndihmës së shpejt. Zemra filloi të më rrah gëzueshëm kur e kuptova së ishte alarmi i policisë! Ah... nuk qenkan në dijeni se ku më ka fshehur ky malukat, thashë më vete e trishtuar pasi zëri i alarmit filloi të zhdukej. Kjo më dha idenë për të menduar së vendndodhja ime ishte diku në ndonjë shtëpi jo larg xhadesë. Hija e dhunuesit lëvizi drejt dritës dhe në çast e fiku. Pas pak, vërejta së nga mbi koka ime, nga të çarat e dërrasave të vëna në dritare, depërtonin rrezet e arta të hënës. Befas në mendje m'u feks një shtëpi me dritare të mbyllura me dërrasa bredhi që e kisha parë sa e sa herë. Nuk e kisha asnjë dyshim tani. Ndodhesha në shtëpinë e braktisur! Kur ai i poshtri po afrohej drejt meje, rrezet e hënës i ranë mbi maskë duke më tmerruar. Fillova t'i lëvizë këmbët, duke e nxjerrë herë pas here atë „ë"-në e mekur. Atij nuk i bëhej vonë. U afrua pranë këmbëve të mia dhe me maje të thikës, që vezullonte frikshëm nën dritën e rrezeve të hënës,

filloi ta çante thesin. Vendosa mos të lëvizi fare. Fillova të pozicionohesha duke i mbledh gjunjët. I paramendoja lëvizjet e tij të radhës prandaj bëja plane goditëse! Kur e ndjeva së këmbët ishin të papenguara dhe krejtësisht jashtë thesit, i mblodha edhe më tepër dhe po prisja kur të afrohej në atë pozicion që goditja ime të jetë e saktë dhe mundësisht sa më fatale për té. E la thikën mënjanë dhe filloj të më afrohej i pa u ndrojtur. Më sa fuqi që pata i dhashë këmbës së djathtë dhe e godita me takën e këpucës në anën e majtë të fytyrës. E pashë kur u rrokullis prapa duke lëshuar një „ah" të thatë. Si hije nate e pashë kur u ngrit dhe me shpejtësi marramendëse filloj të afrohej. Kur bëra të godas prapë, arriti të më mbajë nga këmba e djathtë. Pasi e tërhoqa me forcë këmbën nga vetja, i dhashë një të goditur tjetër me këmbën e majtë sa që e detyrova të shqitej i tëri nga unë dhe bashkë më këpucën time e ndjeva kur u përplas tutje në errësirë. Pas një heshtje relativisht të shkurtër, i ndjeva lëvizjet e tij pranë murit, në anën e djathtë të krahut tim. Tani e kisha të vështirë të manovroja. I dhashë trupit nga e djathta dhe u përpoqa ta arrijë për ta goditur prapë, por këmbët nuk arrinin deri aty ku ishte ai.

– Ncy, ncy, ncy... pas gjithë kësaj rezistence, do të shohim së cili do të qeshë i fundit! – dëgjova zërin e shkërmoqur.

Në kokë më lëvrinin lloj-lloj idesh ogurzeza së çfarë mund të më ndodhte në raste të tilla dhune. Donte të më vriste, të më dhunonte apo të më torturonte me atë thikën e tij të rrezikshme që e mbante prore në dorë! O Zot, më ndihmo! „Ë"-ja e mekur, e shoqëruar me përpëlitjet e trupit tim tani më të lodhur, sikur në vazhdimësi i

çonin sinjale rezistence atij të poshtri. Derisa isha duke e pyetur veten së cili shpirtzi fshihej pas asaj maske dhe shkarazi e më dyshim e kujtoja Çelin, ndjeva dy dhembje të njëpasnjëshme që nuk i ndava dot në ndodhën të ndara apo së bashku! Njëra më erdhi në mollëzën e faqes së majtë, kurse tjetra prapa veshit të djathtë! Një tingull i hollë e i zgjatur, si zë burie, më sillej pa ndërprerë brenda kafkës sime, sikur ishte duke kërkuar ndonjë shteg se nga mund të dilte jashtë për të dhënë kushtrimin. Më bëhej së nga çasti në çast, do të më çahej koka në dysh. Bashkë me dhimbjet e tmerrshme ndjeva kur filloi të më ngrohej qafa si nga një curril i hollë uji të ngrohtë. Qepallat më rëndoheshin prore. Disa herë i pulita sytë si në të dremitur. Ndërkohë, ndjeva një dorë të ftohët, të huaj dhe të largët që po mi hiqte rrobat nga trupi. Një freski e mbështjellë me mister ma përshkoj tërë trupin. Më mundim i hapa sytë. Nuk pashë asgjë! Ngado që e vërtita shikimin ishte errësirë. Derisa po më mbylleshin prapë sytë, ndjeva peshën e trupit të dikujt mbi mua, të shoqëruar nga ca dhembje të largëta, si të ndodhura në një trup të huaj dhe të shoqëruara me një zë të njohur... por që kësaj radhe nuk më bëri fare përshtypje kur tha:

– Kjo qenka e virgjër!?, paska rrejt ai qen...

Pastaj ndjeva përkundje... përkundje... përkundje! I largët dhe i dallgëzuar nga jehonat, më erdhi zëri i gjyshes, dora e së cilës ishte duke e përkundur në një djep të imagjinuar... e shoqëruar me ca këngë gulçimash të padëgjuara ndonjëherë! Derisa çdo gjë kishte filluar të venitej para një gjumi të rëndë që dalëngadalë po më afrohej pas gjithë atyre përkundjeve, si në ëndërr, ndjeva ngrohtësi në fundin e barkut. U përpoqa t'i hapi sytë por

kësaj radhe nuk mu bindën! Të largët e të venitur ndjeva këngën e bulkthit të shoqëruar më një „alo“ që u thërrmua në errësirë duke ia hapur shtegun një regëtimë drite që mu feks si një shkreptimë vetëtime para një gjumi të rëndë që po më avitej.

Dilni (në luftë), le t'ju vijë (lufta) e lehtë ose e rendë, luftoni për hir të Allahut me pasurinë tuaj dhe me veten tuaj; kjo është gjëja më e dobishme për ju, nëse e kuptoni.

Kuran – Sure Et Tevbe (9) ajet 41 Fq. 223

VENDIMI

Në kërkim për të kuptuar gjendjen shpirtërore të një xhemati të tërë, rashë në ndjenja të thella melankolike sa që tani nuk po e kuptoj as veten time... nuk po e kuptoj sepse jam i tradhtuar marrëzisht nga Fiti... nga ajo bukuroshe që dikur ma kishte falë zemrën dhe besën... po ku kanë besë femrat? Në suren Nisae thuhet së burrat janë përgjegjës për gratë, ngase Allahu ka graduar disa mbi disa të tjerë... dhe gratë e mira janë respektuese, janë besnike, janë emigruese... por ka edhe prej atyre që e shpalosin kryelartësinë para burrave të tyre, nuk ju përmbahen rregullave të bekuara islame... dhe të tillat duhet ndëshkuar, jo vetëm me fjalë, jo vetëm me largim nga shtrati por edhe duke i rrahur...[63] derisa të jenë të kënaqura më atë që burri ju ofron![64] Por unë,

63 Kuran 4:34
64 Kuran 33:51

tani për tani nuk e kam një kënaqësi të tillë, sepse po ta kisha, e di unë se çdo të bëja... do ta detyroja Fitin t'i zbatonte rregullat e sheriatit një për një... sepse Allahu i Madhërishëm grave ju ka dhënë mend përgjysmë më pak se sa burrave[65] dhe pjesës dërrmuese të tyre ua ka caktuar përjetësinë në xhehenem...[66] Por, ah! Mua, prapë po më vjen gjynah për të gjorën Fiti! Ndoshta është viktimë e matrapazllëqeve të pista të Imamit... apo të Milaimit?!... Si të largëta, të ftohta dhe të urryera më dolën para sysh shkronjat e lakuara të Imamit, të shkruara mbi letrën mbështjellëse të tri fotografive: *„Mos u merr me shkakun por me shkaktarin!"* Qen i pabesë! – shfryva me duf.

Kuturu i rashë trup e tërthorë qytetit. Shkova edhe në mejhane. U takova me shokët e fëmijërisë, më shokët e medresesë... me Hilin e çiltër, me Maksutin shpirtdhembshur, me Rexhepin e Nexhin... aty e pashë edhe të përhumburin Cuf që nuk e shikon ndotjen e nderit të familjes së tij, por sorollatët nëpër qytet për të parë filma kaur! Allahu e marroftë!

Vazhdova udhën. Asgjë prej gjëje nuk më bëri përshtypje. Njerëzit më dukeshin si kufoma të ringjallura... dhe tani ata të devotshmit po shëtitshin të lumtur nëpër rrugët plot me drita të xhenetit... të qytetit desha të them!... Ngrita pak kokën! Andej nga bjeshkët sikur pashë lumenj me rrjedhje uji të pastër, me rrjedhje mjalti e qumështi që nuk prishet kurrë, me rrjedhje verërash të shijshme për

---

65 *Volumi 3, Libri 48, Numër 826: Profeti tha, "A nuk është dëshmia e një gruaje e barabartë me gjysmën e dëshmisë së një burri?" Gruaja tha, "Po." Ai tha, "Kjo është për shkak të ultësisë së mendjes së gruas."*

66 *Volumi 2, Libri 18, Numër 161: Profeti tha, …unë pashë gjithashtu flakët e ferrit dhe nuk kisha parë kurrë një pamje më të tmerrshme. Pashë se shumica e banorëve ishin gra…*

njerëzit duke gurgulluar këndshëm pllajave e fushave plot e përplot me pemë e fruta të ëmbla... pallate madhështore, hije të mrekullueshme me freski... sikur pashë veten mbështetur në kolltukë të rehatshëm dhe po i kënaqesha ringjalljes, po i kënaqesha pamjeve të bukura të hyrive symëdha që po më shërbenin me mish e fruta... Oh, sa mirë!

Ndërkohë, diku larg filloi të binte një sirenë. Më sëmboi në vesh një zë i çjerrë burie i padëgjuar ndonjëherë! O Allah, ç'po ndodhë? Kiameti?! Sikur gjithë bota pushoj së lëvizuri, ndërsa zëri sa vinte e shtohej! Derisa e mbaja kokën të mbërthyer me duar, sikur isha duke e parë Israfilin duke i fry surit![67] Mu bë së i hapa sytë për të parë fillimin e kiametit! Llahtar! Shembje bjeshkësh! Shpërthim vullkanesh! Përmbytje uji! Djegie flakësh dhe ikje njerëzish me britma tmerri... pastaj qetësi! Qetësi e thellë... vetëm për besimtarët, kurse, *për jobesimtarët është jo e lehtë...* dikush më preku në cepin e krahut! Hapa sytë i ngazëllyer për t'i parë engjëjt...

– Kaloi alarmi! Mund të shkosh tani! – po me fliste një burrë duke më shikuar me një palë sy plot dhembshuri!

– Vallë, mund të jetë engjëll ky trup amorf? – pyeta me zë të çuditshëm, më shumë veten se sa atë.

– Si the? – me pyeti i çuditur i panjohuri.

– Ç'ka ndodhur?... – pyeta pastaj i hutuar.

– Asgjë, asgjë! Ishte një alarm i paralajmëruar testues. – tha tjetri duke më shikuar po me atë dhembshuri.

– Alarm testues?!... – thashë me zë të ulët sikur isha

---

67 *Buri me zë të thekshëm e të tmerrshëm, që engjëlli Israfil, është i ngarkuar t'i fryj me urdhrin e Allahut ditën e shkatërrimit të botës dhe ditën e ringjalljes.*

duke folur me veten time dhe vazhdova më të njëjtin zë: – Pse, edhe Allahu lëshon mbi tokë alarme testuese?! Është e mundur kjo? Po unë kush jam... jam i gjallë e i përmendur apo i vdekur e i ringjallur? Në ç'kohë kam jetuar? Kur kam vdekur? Që kur ndodhëm në sirat?[68] Po Maliki[69] ç'ka me mua? Si u ringjalla? Në cilën botë jam? Ku po shkoj tani?... ah, po! – Tunda kokën me forcë, duke ardhur plotësisht në vete! – Në mbledhjen e kryesisë! – thashë i gëzuar duke e shikuar me ngazëllim të panjohurin.

– Si the çun?... më duket së po flisni përçartë?! – foli i çuditur burri me sy të dhembshur.

– Ju faleminderit për kujdesin tuaj! Natën e mirë. – i thashë me shpoti dhe i turpëruar para tij ika.

– Natën e mirë. – që nga prapa krahëve më zuri zëri i tij miklues.

Ua vura veshin lëvizjeve përreth! Zhurmë motorësh të automjeteve që nuk i ndaja dot së cila vinte e cila ikte. Lëvizje të ngatërruara këmbësorësh. Fjalë teke të thëna nga dikush që po ikte me nxitim. Përzierje e rrezeve të hënës me dritat e neonit! Puhi e ftohët, rrugë asfalti, trotuare të ndritshme, rrugica të errëta matanë... qifte të fejuarish, puthje të dashuruarish diku në mugëtirë skaj rruge... vallë në cilën botë jam, në xhenet? Po hyria ime ku ndodhet? Ah Fiti, ç'më bëre!

Tani jam i përhumbur. Eci pa cak edhe pse herë pas here, si nëpër mjegull me kujtohet së koha e fillimit të mbledhjes ka kaluar. Nisem drejt zyrave të Bashkësisë dhe padashur gjendem para kinemasë! Nisem prapë për

---

68 Korridor i mprehtë dhe i hollë që lidhë xhenetin me xhehenemin.
69 Krye engjëlli i xhehenemit

atje dhe befas, me orientim të humbur, si nën ndikimin e kallakonxhave[70] gjendëm në korzo! Derisa eci mes përmes turmës, dëgjoj qeshje të harlisura vajzash. Cingërima celularësh. Lutje djelmoshash të dëshpëruar: „Të dua me gjithë zemër! Kthehu së po vuaj! Harroje të kaluarën! Nuk kthehem kurrë te ti! I pa shpirt! E pabesë! Tradhtar! Të dua! Vdeksh! Të djegtë zjarri i xhehenemit! Princi i ëndrrave të mia! Të vraftë dashuria ime jarabi!... fole gjë Fiti?!... do të shfajësohesh? Para kujt? E ke kot! Nuk të beson Allahu... as unë nuk të besoj!...“ dhe vazhdoj të eci fillikat i vetëm. Më bëhet sikur jam në rrugë të mbarë drejt zyrave të Bashkësisë. Inshallah!

Që larg, nga fundi i korridorit dëgjova një zë të trashë burri. Vinte i valëzuar sikur nga bota tjetër, i mbështjellë me nuanca të përvajshme vuajtjesh dhe mallkimi bashkë. Me ndrojtje e shtypa rezën. Zëri, sikur me kohë kishte qenë në kërkim të një shtegu për të dalë jashtë, kumboi rëndë-rëndë në faqet e bardha e të lëmuara të mureve anësore derisa u thërrmua në heshtjen e ftohët të korridorit! Hyra brenda si hajdut. Disa koka, me sy të zgurdulluar u kthyen drejt meje! E mbylla derën. Çudi, bashkë me mbylljen e derës pushoi edhe zëri! Për një çast m'u bë së ai zë i përçudshëm ngeli jashtë! Sytë më shkuan në ballë, në krye të sallës. U befasova kur pashë Abu Al Khalidin të veshur allafrënga që po më shikonte hutueshëm. Duke e tundur mjekrën e tij gri vazhdoj të fliste:

– Njerëzit, për mijëra vjet me radhë kanë qenë të robëruar nga forca e Allahut të Madhërishëm. Në

---

70 *Qenie mitologjike që përfytyrohej si hije njeriu, që i ngjitej mbi shpatulla shtegtarit të cilin e huton, ia mjegullon mendjen dhe nuk di të orientohet në hapësirë.*

pamundësi për të zbuluar fuqinë e Tij kanë rënë në robëri të krijesave të mendjeve të tyre të pazhvilluara. Çdo lëvizje në natyrë e kishin emëruar me një zot, me një hyjni, me një idhull duke menduar së prej tyre ishin të dënuar për mëkatet që i bënin mbi tokë pa ju shkuar fare në mendje së ata mjeranë ishin të dënuar nga Allahu xhel-le shanuhu që nuk i besonin fuqisë dhe madhështisë së Tij.

Me të zbritur fjala e Tij mbi dhé, njerëzimi përjetoi ndryshime të mëdha edhe pse një pjesë e madhe e tyre të prirë nga shejtani i mallkuar janë të yshtur për të bërë të liga dhe kanë marrë rrugën e mosbesimit. Si atëherë në ato kohëra të lashta, ashtu edhe sot për të mbijetuar islami, do të thotë të jetë gjithmonë në luftë në dy fronte: Fronti i parë është lufta për parandalimin e depërtimit të shejtanit të mallkuar në qenien dhe botën e brendshme të njeriut... dua të them të besimtarit, kurse fronti i dytë është lufta e pa kompromis kundër atyre që me shejtanin në bark janë të yshtur të bëjnë të liga mbi dhé, duke e sfiduar Madhështinë e Allahut xhel-le shanuhu! Prandaj, të dashur vëllezër selefinjë, për t'i fituar këto beteja të tmerrshme, nevojitet që muxhahedinët[71] të jenë të patundur, të ashpër, të kalitur dhe të gatshëm për flijime e vetëflijime në rrugën e shenjtë të xhihadit[72] islam! Të ashpër duhet të jenë së pari kundër vetvetes, duke ju shmangur me marifet ndjenjave të skrupujve moral, ndjenjave të dashurisë e të respektit dhe në të njëjtën kohë duke u kalitur në rrugën e ndritur të xhihadit! Ne nuk dëshirojmë të krijojmë dhunë në ato gjëra që nuk na takojnë por dëshirojmë që flamuri ynë të valojë

71 Arab. Luftëtar
72 Arab. Përpjekje

sërish në ato treva që për një kohë patën fatin e bardhë ta dëgjojnë thirrjen e myezinit duke e lavdëruar Allahun e Madhërishëm dhe pastaj, nën ndikimin shejtanit të mallkuar dhe të kaurëve të pafe drita e Islamit u shua dhe të paudhët ju kthyen mosbesimit! Të gjitha ato vende, përfshirë këtu edhe vendin tuaj të nëmur, duhet kthyer sa më parë në gjirin e ngrohtë të Islamit. Prandaj, është xhihad dhe Farz ajn[73] për të gjithë ju, të luftoni për tokën e nëpërkëmbur islame...

Për një çast u shkëputa nga fjalët e tij. Nëpër mendje filluan të më silleshin vërdallë fytyrat plot lesh të atyre muxhahidinëve zevzek që i pata njohur dikur por që tani nuk ndodhen më në këtë botë! Shkuan vetë në botën tjetër, në përjetësinë e xhenetit me mëkate të falura nga Allahu i Madhërishëm kur me vete morën me dhjetëra e qindra të pafe dhe hipokrit. Ndjeva dhembshuri dhe mall për muxhahedinët trima, por edhe krenari! U përpjekshim në ahiret jarabi! Amin!

U përqendrova të dëgjoj fjalët e mençura të Abu Al Khalidit:

– ...dhe shenjat, që vërtetë është duke vepruar Dexhalli po jepen të qarta çdo ditë e më shumë! A nuk u arrit shpejtësia e lëvizjes në tokë? A nuk ndodhi lindja e njerëzve përmes klonimit? A nuk po përgjigjen gjësendet e ngurta si radioja, televizori, kompjuteri, celulari! Të gjitha këto që i përmenda erdhën andej nga perëndimi... nga jobesimtarët dhe të pafetë, të cilët pa fije frike e sfiduan dhe po e sfidojnë çdo ditë Allahun xhel-le shanuhu duke e hidhëruar pamasë Madhërinë e Tij! Tani, vetëm po pritet

---

73 Arab. Obligim individual

lindja e diellit nga perëndimi dhe shfaqja e Dexhallit. Po pritet ardhja e hasreti Mehdiut për t'ua marrë gjakun shehitëve të Qerbelasë! Po pritet zbritja nga qielli e hasreti Isait në Damask për ta vrarë Dexhallin... A po e ndjeni ndikimin e ngatërrestarëve më të mëdhenj të dynjasë; Jexhuxh Mexhuxhet[74] të fshehur nën petkun e pseudoshkencëtarëve kaurë që po e përziejnë lindjen dhe perëndimin me shirk e fitne? Si guxojnë ata qafirë të thonë së besimi islam qenka i mbështetur në adhurimin pagan të hënës? Si guxojnë të thonë së në Mekë paska ekzistuar perëndia hënë e quajtur Hubal,[75] e pastaj të përpiqen t'i arsyetojnë këto blofe së gjoja origjina e gjysmëhënës në majën e xhamive tona e paska prejardhjen prej tij? Si guxojnë të thonë ata mjeranë kaurë së feja jonë e ndritur bazën e ka në paganizëm dhe sipas tyre ne po i besuakam hyjneshës Hënë Al-Ilah dhe po u përulkam para saj? Si guxojnë ata të thonë së sheriati nuk na qenka gjë tjetër veçse tubim traditash arabe të shekullit shtatë? Ne nuk do të tolerojmë ndërhyrje të tilla vulgare në fenë tonë të shenjtë, në fjalën e ndritshme të zbritur nga Allahu xhel-le shanuhu!

Vëllezër mysliman! Sonte jemi mbledhur këtu për ta mbrojtur vendin tuaj të nëmur, të vuajtur e të nëpërkëmbur. Ne e dëgjojmë atë së çfarë na thotë Allahu dhe i dërguari i tij, paqja dhe mëshira qofshin mbi të, dhe i bindemi urdhrave të tyre. Andaj, po ju pyes ju; ç'farë thotë Allahu kur idhujtarët, kaurët me shejtanin në bark dhe hipokritët e dhunojnë fenë më të ndritshme të mbarë njerëzimit? Allahu thotë së çdo mëkatar duhet të dënohet

74 Kuran 18:99
75 Idhulli i hënës të arabët e vjetër

në përputhje me mëkatet e tij. Këto fjalë nuk janë të miat, nuk janë të selef-us-salih-ëve e as të Ikhanul Myliminë! Këto janë fjalët e Allahut Fuqiplotë! – dhe ngriti kokën lartë! Pasi këndoi me zë të heshtur një dua u kthye nga ne duke ngritur zërin:

– E dëgjoni zërin e Allahut ju, o vëllezër mysliman? I Madhërishmi po na thërret, o sot o kurrë! „Dilni në luftë, le t'ju vijë lufta e lehtë ose e rendë, luftoni për hir të Allahut me pasurinë tuaj dhe me veten tuaj; kjo është gjëja më e dobishme për ju, nëse e kuptoni..." pra, kjo thirrje është zëri i Allahut që po jep kushtrimin për të luftuar të pafetë dhe botën e tyre të shfrenuar! Është Farz ajn për ju, e Farz Kafija[76] për ne, dhe për çdo mysliman në mbarë botën... dhe mos ngurroni t'i godisni pa mëshirë të pafetë, kaurët e hipokritët... po e përsëris edhe njëherë; me veten tuaj, që t'i shkatërroni të gjithë ata që kanë ngritë krye duke e dhunuar fjalën e Allahut!... Atëherë, po ju pyes ju: Si duhet ndëshkuar ata që i kanë pushtuar shtëpitë e Allahut dhe pamëshirshëm po i dhunojnë ato? Si duhet ndëshkuar ata që e kanë grabitur pasurinë e xhematit duke i rrejt e mashtruar? Si duhet përgjigjur atyre që po e përdhosin nderin islam? Si duhet përgjigjur atyre që po tallen me Allahun dhe me ne që po ua kujtojmë Kuranin Kelamullah? Si duhet përgjigjur atyre që po hedhin plumba e zjarr kundër myslimanëve? Si duhet përgjigjur atyre që po e nëpërkëmbin sheriatin? Si?!

Qetësia ishte absolute. Askush nuk pipëtinte.

– Po ua them unë; – tha me zë të ngritur dhe sy të zgurdulluar duke shikuar në një pikë të pacaktuar diku në

76 *Arab. Obligim i përgjithshëm*

tavan. Pas një heshtje të shkurtër vazhdoi: – Atyre duhet t'u përgjigjemi me bomba... me plumba e barot deri në shkatërrim! Luftoni pra, vetëm për Allah e për fitore, për prenë e luftës, për arkën e stërmbushur të Bashkësisë Islame e për fronin e saj, e mos ia ndaloni vetes atë që ua e ka lejuar Allahu i Madhërishëm! Përpara për tokën e shenjtë islame! Allahu ekber, Allahu ekber! La ilahe il-la-llah! Allahu kërkon kurban! Allahu kërkon kurban! Allahu kërkon kurban! Amin! – dhe vështrimin ngultas nuk e shqiste për asnjë çast nga sytë e mi, sikur donte të më kapërdinte. E pata mërzi atë shikim, prandaj ula vështrimin poshtë.

Një mori kokash u kthyen nga unë. Të gjitha njësoj. Me tërleme, me mjekra të ngatërruara... të zeza pis, të kuqërremta, të hirta, gri, të ngjeshura, të rralla, të shpupurishura! Sy... shumë sy... të zi, të kaltër, të shkruar, të mëdhenj, të fryrë, vezak, bajame, të zgurdulluar, të gjithë të kuq gjak! Vesh pipëz, llapush, vriguj, të palosur, të vegjël... buzë të trasha, të holla, të pulitura, të çaraveshura, të përjargura... mustaqe të holla, të rruara rrafsh... dhe, sikur të gjithë së bashku po me thoshin: Hë, ç'po pret? Ti e di rrugën e xhihadit... ti e di rrugën e ndritur të xhenetit... sepse vetëm ti je trim i specializuar për përzgjedhje, për kalitje, për konstruksione, për plane, për goditje... Thuaje porosinë që na e solle nga ato vende të bekuara nga Allahu i Madhërishëm... nga Ikhuanul-Muslimin, nga selef-us-salih! Fol pra, fol! Ç'pret?

Vështrimi i Abu Al Khalidit nuk po më shqitej. Tani më bëhej sikur po më thoshte me atë zërin e tij të zbutur, si prej kalifit të moçëm se ju... populli i juaj, nuk jeni mysliman të vërtetë, sepse me paudhësitë tuaja e keni

zemëruar shumë Allahun e Madhërishëm! Prandaj, ju nuk u takon ta shpalosni ndjenjën e përjetimit të xhenetit! Atë e bëjnë vetëm të urtit, të devotshmit... ne myslimanët e vërtetë që me besimin tonë asnjëherë nuk e kemi zemëruar Allahun xhel-le shanuhu, deri në atë masë sa që mbi ne ta zbrazë hidhërimin e Tij të ashpër, ashtu siç po e zbrazë kundër atyre popujve që nuk deshën ta besojnë fjalën e Tij të zbritur mbidhé!

E hapa gojën t'i thosha: „Nëse bota tjetër, Xheneti, tek Allahu është vetëm për ju, si dikur për çifutët, e jo edhe për njerëzit e tjerë, nëse jeni të sinqertë, kërkojeni vdekjen, e shkoni më shpejt!..."[77] por shyqyr që nuk e thashë atë që e mendova!... u kapërdiva disa herë me trishtim dhe bëra sikur vërtetë isha i joshur nga ato fjalë të zjarrta të tij, sikur vërtetë isha i ngazëllyer nga ato vështrime të shokëve të mi muxhahida dhe i përvëluar nga urrejtja e zjarrit të dashurisë... më falni, nga urrejtja e tradhtisë që po me djeg prore nga brenda ... më falni, nga urrejtja e papërmbajtur që po ndjej kundër kaurëve dhe të pafeve. Si të isha dalë rishtas nga një ëndërr e trishtueshme u ngrita në këmbë dhe me plot frikë e dyshim nga të panjohurat që do të më pasonin thashë:

– Me emrin e Allahut, mëshiruesit, mëshirëbërësit! Falënderimet i takojnë vetëm Allahut, paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi të dërguarin e Tij Muhamedin selamu alejkum, mbi familjen e tij, shokët dhe të gjithë ata që e ndjekin rrugën e tij deri në ditën e kiametit! Allahu ia faltë mëkatet xhihadit që po i sfidon të pafetë! Allahu ua lehtësoftë dhembjet muxhahidinëve trima... dhe në emër

---

77 Kuran 2:94

të Allahut, në emër të vëllazërisë së moderuar myslimane Ikhuanul-Muslimin, në emër të lëvizjes selef-us-salih dhe në emrin tim personal pohoj së edhe unë do të jem një prej atyre që do të luftoj me nder e besnikëri krah për krah vëllezërve të mi muxhahida, jo vetëm me pasurinë time, por edhe me veten time nëse edhe këtë do ta kërkojë nderi islam... dhe këtë do ta bëj vetëm për Allahun xhel-le shanuhu! Amin!

– Këtë e kërkon nderi islam! Të lumtë! Allahu qoftë me ty në rrugën e flijimit! Allahu të bekoftë e të ndihmoftë në... – ndërkohë, një zë i thekshëm i ndërpreu ata zëra të ngazëllyer që gumëzhinin nga të gjitha anët si zgjua bletësh, duke thënë:

– Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëmadhit! Falënderimet i takojnë vetëm Madhërisë së Tij, Allahut xhel-le shanuhu! Dëshmoj së unë do të jem i rreshtuar përkrah vëllezërve të mi muxhahida dhe e lus Allahun xhel-le shanuhu që edhe në dynjanë tjetër të gjendemi së bashku!

Në sallë u dëgjuan duartrokitje. Një zhurmë e ngatërruar me trokëllima karrigesh dhe me fjalë teke po me valëviteshin të dallgëzuara nëpër vesh. Pasuan shtrëngime duarsh, rrahje shpatullash, përqafime të vrullshme... nuk do t'ju lëmë vetëm, do të jemi me ju, do të na keni pranë, do të vdesim së bashku, do të tmerrohen të pafetë e kaurët, Allahu ua shpërbleftë me të gjitha të mirat e xhenetit në botën tjetër... u pjekshim në ahiret... na nderuat ne, e nderuat fenë tonë të shenjtë myslimane... e nderuat Allahun e Lartësuar!... i nderuat selef-us-salihët...

Prapë isha i përhumbur! Ndjeja lëvizje njerëzish rreth

e rrotull. Sy të zgurdulluar, buzëqeshje hipokrite, buzë të trasha që çaravesheshin në forma të ndryshme derisa po nxirrnin përjashta fjalë të largëta, zëra të shkërmoqur, qeshje të harlisura, zgërdhierje fytyrash të përziera me leshra mjekrash që lëviznin sa lartë poshtë duke nxjerrë përjashta klithma dhe duhmë... ndërsa unë po e falënderoja Allahun e Madhërishëm që ka lënë edhe një botë tjetër të mrekullueshme atje në ahiret dhe herë pas here po çuditesha pse duhej krijuar këtej edhe një botë mëkatare... pse duhej që të isha sonte në mesin e këtyre gjallesave të trullosura, pse duhej tretur në kujtime të trishta të një dashurie të vrarë? Pse moj Fiti?

– Kjo botë është krijuar për të gjallët! – vazhdonte të fliste Abu Al Khalidi, me plot pasion e sy të zgurdulluar. – Po spati të gjallë, nuk do të ketë vdekje, e po s'pati vdekje nuk do të ketë ringjallje! Allahu i Madhërishëm së pari ka caktuar lindjen, botën e të gjallëve, botën e mundimshme, botën e sfidave të mëdha për njerëzimin! Fill pas, e ka caktuar heshtjen e gjatë të ahiretit dhe në fund, ditën e ringjalljes kur Israfili do t'i fryj surit! Të tri këto botëra janë të veçanta, të ndara dhe të panjohura por të lidhura ngushtë me njëra tjetrën...

Vallë, a do të ringjallet edhe mëkatarja ime Fiti?

Dhe përhumbja ime vazhdon! Nuk më kujtohet së në ç'rrethana kam arritur përkrah Abu Al Khalidit. Derisa ne ecim trotuareve, në krahun tjetër të tij ndodhen disa nga vëllezërit e mi muxhahida! Tek tuk shikoj ndonjë hije njeriu që me nxitim largohet tutje. Në grykën e një rrugice gjysmë të errët m'u bë sikur e pashë Hilin? U përqendrova edhe më shumë në pamjen e tij. Kur po e pyesja veten së ç'kërkon kaq herët në këtë rrugicë të

humbur mu zhduk nga sytë. Ndoshta vegova!

Abu Al Khalidi vazhdon të flasë për ca toka të shenjta të dhunuara padrejtësisht nga të pafetë, nga murtadët, nga hipokritët... për ca sulme të largëta, ca eksplodime të fuqishme të përziera me tym e zjarr, për ca copëra dheu të përziera me këpucë teke, më copëra mishrash të shkapërderdhura nëpër ca rrugë të pluhurosura e me pellgje gjaku... për ca sheshe tregu ku në mesin e lakrave dhe specave mund të jenë të përziera edhe ndonjë kofsh fëmije, ndonjë gjysmë kokë gruaje, ndonjë kokërr syri, ndonjë pëllëmbë me gishta të këputur që përdridhen si bishta hardhucash, zorrë të stërzgjatura në kalldrëm, xhematë të përgjakur që dalin të tmerruar nga xhamitë duke i shtrënguar plagët me duar që ju kullojnë gjak...

– Ishin Hanefitë që kundërshtoheshin nga Shafitë, e këta kundërshtoheshin nga Malikitë, e këta kundërshtoheshin nga Hanbelitë, e këta kundërshtoheshin nga Xhaferitë.... dhe këta të fundit kundërshtoheshin nga Vehabitë! – Nuk e mbaj në mend më se cilët mysliman po i kundërshtojnë myslimanët tjerë, por e di së çdo mysliman kundërshtohet nga myslimanët, prandaj, – vazhdoj zoti Abu: – Të gjithë ata që kundërshtojnë duhet të dënohen sipas ajetit tridhjetë e tre të sures Maide kur Allahu thotë: *„Dënimi i atyre që luftojnë (kundërshtojnë) Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe bëjnë shkatërrime në tokë, nuk është vetëm se të mbyten ose të gozhdohen, ose (të gjymtohen), t'u priten duart dhe këmbët e tyre të anëve të kundërta, ose të dëbohen nga vendi. Kjo (masë ndëshkuese) është poshtërim për ta në dynja, dhe në botën tjetër ata do të kenë dënim të madh".*

– Kështu udhëzon Allahu i Madhërishëm?! – e pyeta krejtësisht i përhumbur.

– Po! Kështu shkruhet në Kuranin Kelamullah!

– Atëherë, kush i ndëshkon kundërshtarët? Allahu?

– Jo! Programi i lënë përgjysmë i Kalifit Al-Mutavakil[78]

– Kundër kujt?

– Kundër kaurëve por, edhe kundër myslimanëve që kundërshtojnë!

– Ashtu? Por ne nuk jemi mysliman që kundërshtojmë?

– Po, vëlla i dashuri mysliman! Me dhembje më duhet t'ju them së edhe ju jeni kundërshtar! Por, lavdi Allahut xhel-le shanuhu që më në fund ua mbushi mendjen t'i luftoni kundërshtarët! Kjo është gjëja më e dobishme për ju nëse e kuptoni, kështu shkruhet në Kuranin Kerim!

– Po, vërtetë ashtu shkruhet... prandaj, ne kundërshtarët mysliman, duhet t'i luftojmë kundërshtarët po ashtu mysliman? A s'është kështu?! – e pyeta i hutuar.?

– Gjithsesi duhet t'i luftoni kundërshtarët mysliman... me pasurinë tuaj dhe me veten tuaj... Marrim abdes?

– Po! Marrim abdes dhe me emër të Allahut po e falim sabahun e fundit!

– Po e falni sabahun e fundit... – e përmirësoi si nëpër mjegull Abu Al Khalidi.

Hoxha po e thërret ezanin. Ne po afroheshim pranë derës së hapur të xhamisë! I shpërqendruar u lidha namaz. Bëra ruku, rashë sexhde! Se mbaj mend asnjërën nga duatë, disi më janë ngatërruar... përpiqem t'i rikujtoj me këmbëngulje por nuk më kujtohen ashtu të radhitura siç duhet thënë... me vijnë disi të shkapërderdhura! Vazhdoj të përpiqem në radhitjen e ajeteve... dhe prapë bie sexhde! Mezi po e mbajë shurrën! Do të koritem! Më rrodhën dy

---

78 *Kalifi Al-Mutavakil (847 – 861) që e ktheu dhunshëm në islam Orientin dhe Afrikën veriore*

tri pika! Vazhdoj t'i lutëm Allahut me abdes të prishur! Allahu ma bëftë kabull këtë namaz të fundit... po, po! Allahu do të ma bëjë kabull namazin e fundit! Amin!

Kur dolëm jashtë, pashë qiellin e pastër. Yjet ishin në të venitur përveç yllit të karvanit. Derisa po i shikoja me admirim, nëpër mendje filloi të më vërvitej surja Al Naxhm. Befas sikur u ndesha më hyjneshën Al Lat, në trajtën e një gruaje të bukur e të gdhendur në mermer që po më vështronte e çuditur për vendimin që kisha marrë. Fill pas saj, sikur pashë Al Uhzanë, hyjneshën pemë, që bënte hije me kurorën e saj mahnitëse, kurse mbi flatrat e hyjneshës Al Manat sikur e pashë fatin tim të qëndisur me shkronja të Allahut.[79] Në çast, mu bë sikur ato hyjnesha, kojrrila madhështore, së bashku me Hubalin[80]... Allah... po talleshin me mua, por jo edhe me Abu Al Khalidin, sepse me të sikur njiheshin që nga kohërat e lashta të idhujtarisë prandaj, më bëhej sikur po i buzëqeshnin admirueshëm njëri-tjetrit!

– A ishte Hubali selef-us-salih? – e pyeta derisa isha duke e shikuar hënën.

Abu Al Khalidi më shikoi me inat, pastaj si nëpër dhëmb më tha:

– Ke filluar të shfaqësh shenja idhujtarie...

– Jo, jo... se si m'u kujtua kur lart në qiell pashë hënën pranë yllit të karvanit!

– Tani nuk duhet të mendosh gjëra të tilla! Ti duhet t'i lutësh Allahut për rrugën e ndritur të xhenetit dhe për faljen e mëkateve... këtë bëjë ti, kurse Hubalit le t'i falen pasardhësit e tij!

---

79 Kuran 53: 19-20

80 Arab. Perëndia e hënës në Qabe

Mu bë sikur dikush qeshi! Këqyra me ngulmë andej nga vinte gjithë ai gaz. Vallë, si po i del gazi para vde...? – fjala e fundit më ngeli në fyt, sepse u tremba shumë nga vdekja! Për herë të parë, vetëm për një çast mendova lirshëm! Një zë i huaj, si zë engjëlli, sikur po më pëshpëriste në veshin e majtë duke më thënë së jeta është më e vlefshme se sa vdekja... më e vlefshme se sa vetëvrasja... Allahu e dënon vrasjen... por jo edhe vetëvrasjen, sikur ju përgjigja flakë për flakë atij zërit të brendshëm e kryengritës! Ngazëllimi qe i shkurtër, sepse në çast mu kujtua së në veshin e majtë pëshpëritë vetëm ai qoftë larg nesh, shejtani i mallkuar, ashtu siç i kishte pëshpëritë njëherë e një kohë edhe vulës së profetëve, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të! Prandaj, të gjitha këto, nuk janë gjë tjetër veçse yshtje shejtani në rrugë të gabuar!

Vazhduam të ecim në trotuaret e ftohta.

– Ja, këtu do të takoheni me profesorin...– tha Abu Al Khalidi

– E di vendtakimin! Nuk është këtu, është pak më tutje! – m'u bë sikur dëgjova një zë të largët dhe të huaj që vinte si i valëzuar nga mugëtira. Më bëhej sikur e dija së zëri i kujt ishte... shejtani ma lidhi gjuhën! Nuk bëzana... vallë ndodhëm në dorën e Allahut apo të shejtanit?

Por, për një çast u çudita! Nga e din ky hutaq vendtakimin? Prapë nuk më doli asnjë zë, përkundrazi, në tërë trupin ndjeva një lloj tkurrje të përzier me mornica marazi e frike bashkë. Po dridhesha!

– Taksi! – thirri Abu Al Khalidi, duke e zgjatur dorën drejt një veture taksie që po çante me shpejtësi.

Vetura ndaloi nja dhjetë hapa larg nesh. Pastaj lëvizi prapa deri pranë këmbëve tona. Për një copë herë, Abu

Al Khalidi më shikoi me një palë sy të zgurdulluar. Një kokërr e vogël dhe e vetmuar loti, me mundim ju var në cepin e syrit të majtë. Ndoshta nga puhia e ftohët që po frynë, mendova duke i pulitë sytë që po më digjnin. Sikur të më kishte lakmuar mua, edhe ai i puliti sytë disa herë me forcë për t'i dhënë shtytje atij loti të mekur që t'i varej në qepallë... ju var dhe ju tret sakaq, pastaj më zë të ulët e të përvajshëm tha:

– Allahu ua shpërbleftë mundin... u përpjekshim në ahiret, trima muxhahida!

Pastaj, me çantën e tij diplomatike në dorë, u afrua pranë veturës. Shoferi ia hapi derën me respekt. Derisa po ulej në brendi të veturës, e dëgjova të thoshte:

– Në aeroport të lutem!

E ndjej se nuk jam vetëm i përhumbur, por edhe i shkërmoqur! Nuk e di së nga me vijnë këto ligësi! Ç'kërkon Abu Al Khalidi në aeroport? Ç'kërkoj unë këtu?... ç'u bënë vëllezërit e mi muxhahida? Shikoj rreth e qark. Nuk i shoh asgjëkund... ndërkohë vetura e taksisë bashkë me Abu Al Khalidin brenda, filloi të largohej në rrugën e qetë, duke lëshuar prapa një fije të hollë avulli të mjegullt!

Disa herë u rrotullova rreth e qark duke i kërkuar vëllezërit muxhahida. Ndërkohë një zë i thekshëm sikur po më thërriste si nga një botë tjetër. Ktheva vështrimin nga një rrugicë e ngushtë. Nuk pashë askënd. Eca disa hapa nga e djathta. Kalova një bërryl trotuari. Në anën e kundërt pashë një shesh të ngushtë para grykës së një rrugice. Tri vetura të parkuara pranë njëra-tjetrës, një sokak i mbushur me pellgje të ngrira uji dhe një dorë që tundej nga njëra dritare e veturës. Shikova rreth e

qark duke menduar së ajo dorë po i tundej dikujt tjetër. Nuk kishte njeri të gjallë përreth meje. Isha vetëm. Kur e ktheva vështrimin përsëri andej nga veturat, pashë një burrë të veshur me shije që kishte ndaluar para veturave dhe po vazhdonte me tundje dore sikur më thoshte: „Hej, këtu jam!“

Ndërkohë, derisa po afrohesha drejt tij, nga vetura dolën vëllezërit e mi muxhahida. Profesori, mendova me respekt derisa po i afrohesha të panjohurit. Kishte veshur një pallto të gjatë deri te gjunjët, me kopsa të mbërthyera deri afër gryke. Vetëm sa i dallohej nyja e kravatës dyngjyrëshe, kuq e kaltër e futur në mes të jakave të këmishës së bardhë... kur po ma zgjaste dorën, dallova një nishan në faqen e majtë. Sikur e kisha parë diku këtë flokgri me nishan në faqe!?

– Profesori! – tha me zë të butë duke ma shtrënguar dorën burrërisht.

Përveç përhumbjes dhe shkërmoqjes që nuk m'u kishin shqitë gjatë gjithë natës, tani sikur m'u shtua edhe çorientimi. Sikur nga larg, diku nga mesi i një grumbulli të madh njerëzish po më shfaqej një burrë i veshur me pallto të gjatë, me flokë gri e me një nishan në faqen e majtë. Me bëhet së po e shikoja të valëvitej tatëpjetë, diku pranë Arave të Mrizit... shumë sy të zgurdulluar, të mbushur plot lot dhembje e tmerri po i shikonin lëvizjet e tij të ngadalshme, lëvizjet e Nakut duarlidhur dhe lëvizjen e buzëve të tij duke nxjerrë zëra të frikshëm: „...pse u fshehe... edhe shurdhmemecët i merr plumbi!“ Ndërkohë, një regëtimë flake, një krismë e thatë, një shembje burri e përzier me vrushkuj gjaku... dhe zëri i vrazhdë: „Ç'më shikoni... shporruni!...“

Këto m'u shfaqën parasysh me vija të trasha por me ngjyra të forta, sikur isha duke e parë një ripërsëritje të ngadalësuar të ndonjë skene filmi. E përsërita edhe njëherë skenën e tmerrshme... edhe dy herë, edhe tri herë dhe pa asnjë dyshim! Nga përhumbja e pakmëparshme befas u këndella, nga shkërmoqja e mblodha veten dhe nga çorientimi u orientova, kur befas si tym i hollë eshke u shpërnda i njëjti zë, me të njëjtat lëvizje, më të njëjtin nishan në faqe dhe u trajtësua çdo gjë rreth e rrotull duke marrë pamjen e vërtetë, ashtu siç ishte, konkrete.

– Ç'pate, nuk ndjehesh mirë? – më pyeti me zë të pasigurt dhe tinëzisht e tërhoqi vështrimin e dyshimtë nga fytyra ime e pastaj u tërhoq edhe vetë duke u kthyer i tëri drejt vëllezërve të mi muxhahida.

– Po, po! Mirë jam... gospodine Janko! – i thashë duke i pritur me padurim reagimet e tij.

Kthimi i menjëhershëm nga unë dhe vështrimi pyetës, ishin shenja dalluese që ju ndodhë atyre njerëzve që rastësisht gjenden në një rreth të panjohurish dhe njëri prej të panjohurve befas e thërret në emër. Pas pak, në përpjekje e sipër për ta përmirësuar gabimin, bëri një lëvizje artificiale që nuk i shkonte fare natyrës së tij dyfytyrëshe, gjoja se nuk kishte dëgjuar të përmendet emri i tij, gjoja se nuk e dinte se emri i kujt ishte përmendur apo gjoja së fjalën që e fola unë, nuk qe gjë tjetër veçse kotësi... rastësi!

Kaq. Mua nuk do të më nevojitej më shumë kohë për ta ngacmuar trurin dhe për ta vënë në lëvizje. Për një çast m'u zhbënë të gjitha përjetimet që më kishin përcjellë gjatë gjithë kohës sa kisha qëndruar në ato vende të largëta. Unë, studiuesi më i denjë i islamit, adhuruesi

më i madh i Allahut, me veprimet e mia nuk paskam bërë gjë tjetër veçse paskam qenë vegël qorre në duart e huaja... në duart e njëfarë Jankut të tmerrshëm, që me urdhrin e tij na i dogjën shtëpitë, na përzunë nga trojet e stërgjyshërve tanë, na i vranë djemtë, na i dhunuan motrat, nënat dhe nuset tona dhe në fund, nga prapaskena na përgatisin rrëngje në rrugën muxhahidinëve? Vallë, kishte të drejtë Hafiz Osmani që e demaskonte flamën infektuese të vehabinjëve?!

Sikurse një shpend i ç'trajtësuar në horizont, që fillon të afrohet duke u konkretizuar derisa e merr trajtën e vërtetë që e ka, ashtu edhe mua, mendja filloi të m'i trajtësoj kujtimet e largëta të muxhahidinëve që në momentet e fundit e vërtetonin ndonjë rreng pabesie që dikush nga udhëheqësit e Ikhuanul-Muslimin apo të Selef-us-salih e kishte kurdisur kundër tyre sa për t'i dërguar drejt vdekjes së parakohshme, e pastaj për t'ua rrëmbyer pasurinë apo nuset e bukura që i lenin të vetmuara në kasollet e tyre! Me moral të rënë, kurrsesi nuk e pranonin flijimin... të mjeruar kundërshtonin! Për të tillët nuk pritej ndëshkimi i Allahut xhel-le shanuhu, por aty për aty ndëshkoheshin rëndë nga udhëheqësit e aksionit duke i përdorur ligjet e sheriatit, gjymtoheshin, qorroheshin, ju thyheshin kockat, ju pritej gjuha, mbyteshin me gurë apo ju pritej koka me shpatë... dhe vendin e tyre e zinte ndonjë muxhahidin tjetër... vallë, cili nga vëllezërit muxhahida do të më gjymtojë mua?... pastaj, cili do të pranojë të flijohet në vendin tim? Tani, assesi nuk po më mbushet mendja së këta torollak kaq të disponuar do të shkojnë drejt vdekjes! Jo! Tani sa kam filluar të ndjejë shije të hidhur tradhtie!

E vërejta së vëllezërit muxhahida po më afroheshin

ngadalë dhe më bëhej së e kishin ndërmend të shtireshin se nuk kishin dëgjuar gjë. Lehtë dhe si padashur, njëri pas tjetrit i shpalosën pak xhaketat sa për t'ju dalluar revolet! Të njëjtën gjë e manovroj edhe profesori! Kujdes, i thashë vetës me atë zërin e brendshëm, dhe vështrimin e vërvita mbi buzëqeshjen e vrarë të vëllezërve muxhahida, dhe e ndala mbi një nishan blu në mollëzën e faqes së majtë të njërit prej tyre! Vallë, kush e paska vulosur kaq trishtueshëm?

– Ke kujdes së çfarë po flet. Udhërrëfyesin më të denjë të islamit ta quash gospodine Janko nuk është nder as për ty që e the e as për ne që e dëgjuam, por është fyerje e rëndë jo vetëm për ne të dy, por edhe për tërë vëllezërit myslimanë! Për ta akuzuar dikë duhet pasur argumente... e ke parë së edhe në Kuranin Kerim, për ta vërtetuar madhështinë e tij, me qindra herë përmendet fjala argument, duke ua kërkuar mosbesimtarëve? Kështu që, tjetër është ngjashmëria midis dy njerëzve, e tjetër e vërteta, prandaj falë rrethanave të kësaj dite të shenjtë, unë do të jem shumë shpirtgjerë para jush.

– Sigurisht së të gjithë do të jemi shpirtgjerë në raste të tilla! Para ngjarjeve të tilla madhore, njeriu edhe mund të gabojë... s'ka gajle... futemi në temë së koha nuk pret. – sikur foli njëri nga vëllezërit muxhahida.

– Vazhdojmë, së vërtetë koha nuk pret! Dëgjo këtu: Kjo është vetura e juaj, kurse kjo tjetra është e imja. Që të dyja janë të mbushura përplot më eksploziv. Eksplozivi aktivizohet porsa të ndeshën turinjtë e veturës më gjësende të forta. Dëshiron t'i shikosh mbushjet?

– Jo, jo! Më falni për dyshimin e pabazuar... se si më erdhi!

– Harroje tash... – tha profesori, duke më vështruar vëngër, jo në sy, por diku në horizontin që shtrihej prapa shpinës sime dhe vazhdoi me ton të ndryshuar dhe urdhërues njëherësh: – vazhdo tutje!

– Pra, siç të thashë, do të bëhen dy sulme të koordinuara. Njëra në përfaqësinë amerikane në zemër të qytetit, kurse tjetra në aeroport me rastin e vizitës së një diplomati të lartë britanik. Sipas planit operativ të përpiluar nga profesori i nderuar, ti do të godasësh përfaqësinë amerikane, kurse sulmi tjetër do të kryhet kundër diplomatit britanik, porsa ai të ketë arritur në vendin tonë të shenjtë e mysliman!

– The së sulmet do të bëhen të koordinuara!

– Po! Sulmi i parë do t'i çorientoj mbrojtësit e rendit publik, kurse ne do të përfitojmë nga ky çorientim për goditjen e dytë!

– Shumë mirë e paskeni planifikuar! Kur duhet të nisemi?

– Sa më parë që të jetë e mundur, sepse ata tani do të qarkullojnë dhe sulmi duhet të bëhet kur ata t'i hapin portat për të dalë jashtë rrethojave të hekurta. Ke ndonjë dëshirë të fundit?

– Po!

– Urdhëro!

– Do të dëshiroja të kem edhe një revole më vete... për çdo rast, si dihet!

– Revole rezervë nuk kemi... – ndërkohë ndërdyri profesori.

– Nuk kemi shumë kohë që të përpilojmë plane të reja! Është koha të nisemi!

Tani e kisha të qartë. Vetëm unë duhet të vritem, apo të vetëvritem por jo për Allah e për dinë e iman siç e kisha

menduar e planifikuar, por për interesat e Jankut apo të dikujt tjetër që fshihet prapa tij! Ndërkohë, pa e pasur mendjen aty, m'u kujtuan fjalët e urta të shkruara nga Imami; *Kujdes para se të bëhet! U bë! Nuk zhbëhet më!...* O Zot i madh, ndihmomë, shpëtomë, derisa të ndodhem te thënia e parë: *Kujdes para së të bëhet!...* – dhe me zë të lartë thirra:

– Allahu ekber, Allahu ekber, Allahu ekber![81] – dhe zgjata dorën drejtë profesorit duke i thënë: – çelësat!

– Je i vendosur... me një mendje!? – më pyeti me mosbesim.

– Po!

– Je i sigurt!?

– Me emrin e Allahut, po!

– Mirë! Por... gjithsesi më duhet t'ju njoftoj paraprakisht se gjatë gjithë aksionit do të jesh nën përcjelljen tonë të rreptë. Nëse tenton të bësh ndonjë rreng, ndonjë gafë, do të ndëshkohesh rëndë... dhe jo vetëm ti, por edhe nëna jote plakë, e bukura Fiti, farefisi... Prandaj, kujdes! – më tha me zë të ulët por tepër të vendosur, kërcënues dhe të sigurt në ato që i thoshte.

E ndjeja së më kishte pushtuar një dëshirë e zjarrtë të isha sa më larg tyre dhe kjo arrihej vetëm me zbatimin e urdhrave fillestar. Kur e ndjeva peshën e lehtë të çelësit të veturës në dorë, në shpirt ndjeva ngazëllim. Pa humbur kohë, u ndodha në veturë dhe e ndeza motorin.

– Ndiqe prapa profesorin! – m'u bë sikur më urdhëroi dikush nga grupi i muxhahidinëve.

– Jo! – kundërshtoi ashpër profesori derisa po kthehej

---

81 Allahu Ekber – Allahu është i madh

me nxitim drejtë tyre dhe vazhdoj: – sipas planit, ju duhet të jeni të parët, kurse unë do të jem prapa jush për kontrollimin dhe koordinimin e mbarëvajtjes së aksionit.

Andej nga vetura e profesorit u dëgjua një sinjal i radiolidhjes dhe fill pas tij një zë i trashë burri. Kjo do të thotë se ka edhe mbështetës të padukshëm anësorë. Për një çast m'u duk se këto që po i përjetoja nuk ishin të vërteta por një ëndërr a episod filmi, që fundi nuk i dihej.

– Nisuni! – dha urdhër të prerë profesori dhe fill pas m'u drejtua mua: – Ndiqi pas!

Kishte kaluar aq pak kohë, sa që lëmshi që kishte zënë vend në kokën time të trazuar, vetëm sa ngatërrohej edhe më keq. Nuk e ndaja dot në duhej ndjekur veturën që sa ishte nisur para meje apo kundërshtuar hapur profesorin. Mekanikisht, u nisa.

Nuk kisha kaluar as njëqind metra, kur një veturë ma preu rrugën. Frenova, duke i hapur rrugë të qarkullonte para. Nuk lëvizi nga vendi. E shikova i përqendruar shoferin mjekërzi dhe muxhahid që po më kërcënohej me grykën e revoles së kthyer drejt meje. Nga ana tjetër pashë edhe një tjetër veturë. Nga brendia e saj pashë kur po me kërcënoheshin me automatik të drejtuar nga unë disa fytyra të panjohura. Herë pas here epnin e merrnin me duar duke më dhënë shenjë të nisesha.

U nisa.

Derisa po i afrohesha cakut, dendësia e automjeteve kishte marrë përmasat e tollovisë. Trotuaret ishin mbushur përplot me njerëz të moshave të ndryshme që nxitonin si milingonat secili në punën e vetë. Pranë një shkolle pashë fëmijët grumbuj-grumbuj që po gumëzhinin të gëzueshëm në oborrin e saj të madh... në çast sikur

dëgjova shpërthime, flakë, zallahi, ikje, copa gjymtyrësh të shkapërderdhura, gjak, vaj...

Vetura e muxhahidinëve ishte larguar në distancë. Në mes ishin futur shumë vetura të tjera, që nuk e përcaktoja dot në ishin të kalimtarëve të rastit apo të mbështetësve anësor? Profesori po më ndiqte pas me xhelozi. Deri tani nuk kishte lejuar asnjë veturë të hynte në mes. Veturat ndaluan. Përmes pasqyrës, e pashë profesorin kur po bisedonte me dikë përmes celularit... Po unë, ku e kam celularin tim? – pyeta veten dhe instinktivisht dorën e majtë e futa në xhep! Ndërkohë kolona lëvizi. Me mundim e nxora celularin nga xhepi dhe për një copë herë mbeta i dyzuar. Nuk kisha asnjë ide së kë duhej lajmëruar. Policinë? Nuk kam numër telefoni të policisë! Kujt t'i drejtohem... shokëve të medresesë? Jo, nuk ju besoj më atyre... ata duhet të jenë mbështetës të padukshëm anësor të planit operativ! Cufit? Jo, jo... ah po! Hilit? Po, vetëm Hilin duhet lajmëruar. Ai ka lidhje me policinë.

Me kujdesin më të madh fillova nga kërkimi i numrit të Hilit dhe më vete po ju falënderohesha atyre mendjendriturve kaurë që e kanë zbuluar këtë mrekulli që edhe gjësendet e ngurta të flasin e t'ju flasësh... por pa e larguar për asnjë çast nga syri e nga mendja atë çfarë e kisha ndërmend të bëja; ikjen!

Kur po binte sinjali i parë, pashë një rrugë që kthente nga e djathta... ishte pikërisht ajo rrugë që të shpinte larg qytetit, larg gumëzhitjeve të njerëzve, larg rrezikut për jetën e tjerëve. Pasi e shtrëngova celularin në mes të supit dhe veshit, me të dyja duart e rrotullova timonin duke hyrë në kthesë me një shpejtësi marramendëse. Në mes të vërshëllimave të gomave, nga ana tjetër e celularit

dëgjova zërin e qetë të Hilit:

– Urdhëro... hë, ç'kemi?...

Nga përplasjet e veturës mbi trotuar, nga lëkundjet dhe tundjet në vijim, e ndjeva trokëllimën gjatë rënies së celularit. Derisa isha duke e mbushë me gaz motorin, fillova të thërrasë për ndihmë me zë të lartë me qëllim që të me dëgjoj Hili... ndërkohë që me ngazëllim po e paramendoja së ai gjithsesi duhej të ishte në linjë... dhe ashtu i hakërryer, me vështrimin e përqendruar mbi rrugë, me duart mbi timon që herë pas here nga përplasjet, vetura më dilte jashtë kontrollit, më sa zë që kisha po i tregoja vendin së ku ndodhesha, drejtimin dhe përndjekësit e tmerrshëm, për gospopdin Jankon që fshihej pas nofkës së profesorit... në një çast m'u bë së kot po çirresha sepse ai nuk po më dëgjonte... u dëshpërova... shpresat m'u venitën!

Vetura e profesorit tani më ishte zhdukur nga pamja ime. Kurse dy vetura tjera, ndoshta të mbështetësve të panjohur anësor, po me ndiqnin me shpejtësi marramendëse. Herë pas here ktheja kokën prapa për të parë. Një breshëri plumbash e përzier me disa trokëllima të zhurmshme bënë që xhamat anësorë të veturës sime të thyheshin. Ula kokën poshtë duke e mbushur me gaz motorin. Një dhembje e përzier me fërgëllimë djegëse ma përshkoj supin e majtë... ndërkohë, një goditje e papritur nga krahu i majtë i veturës më bëri të tundesha disa çaste me ekuilibër të humbur. Ndjeva kur koka m'u përplas në një metal pranë xhamit të thyer të veturës! I tmerruar, pashë spërkatjet e gjakut në xhamin përballë dhe rrotull kabinës! Kur bëra ta ngre vështrimin sa për të parë rrugën, gati u përplasa me një traktor që qarkullonte ngadalshëm

në rrugën e tij. Lakova shpejtë nga e majta. Me gaz të shtuar, si nëpër tehun e gërshërëve, sa nuk u përplasa me një autobus që po vinte me shpejtësi marramendëse nga ana e kundërt. E rrotullova timonin në të djathtë! Sa nuk u përplasa me traktorin. Dëgjova sirenën e thellë të autobusit dhe pashë së si shkau nga rruga dhe ashtu vazhdë u largua duke lënë një re të tërë tymi të dalë nga gomat gjatë frenimit. E largët dhe e rëndë me erdhi edhe një zë sirene! Ktheva kokën prapa. Distanca në mes veturës sime dhe traktorit po rritej. Veturat ndjekëse nuk po dukeshin më. Për një çast u mrekullova!

Derisa po kaloja pranë disa bokërimave, e venitur me erdhi një sirenë alarmi. Ktheva kokën prapa. Që larg, pashë reflektime dritash blu. E përmblodha veten dhe disi fillova të ndjehesha shumë më i fortë me gjithë dhembjet e tmerrshme në shpatull!

Veturat me reflektime dritash blu po me afroheshin me shpejtësi marramendëse. Në bërrylin e parë të rrugës, kur veturat e ndjekësve nuk po shiheshin më, u futa në një rrugicë plot me gropa në drejtim të disa bokërimave të zhveshura buzë mali. Tundjet ishin të mëdha. Timoni më shkau nga dora. U përpoqa ta rikthej kontrollin mbi veturë, por ishte e pamundur. Shpejtësia më çorientoj edhe më tepër. Sa vinte e po më afrohej një maje e mbrehtë shkëmbi. Tutje, nga e majta pashë një greminë! Në çastet e fundit e hapa derën dhe u hodha jashtë, pa pasur kohë të paramendoja së ku do të përplasesha, në shkëmbin e thepisur apo në greminën pranë tij, që nuk e paramendoja dot së si do të dukej fundi i saj! O Zot më ndihmo!... Në të njëjtën kohë, kur po përplasesha në një grumbull kreshtash shkëmborë, dëgjova një sirenë

të thekshme alarmi, të përzier me dhembjet e çarjes së mishit dhe thyerjen e kockave dhe fill pas, një shpërthim i fuqishëm, që m'u bë së me futi pa mëshirë në të çarat e atyre shkëmbinjve të thepisur. Derisa po përpëlitsha për t'u ngopur me frymë, një rrebesh gurësh e dheu më ra sipëri duke më shkaktuar dhembje të tmerrshme. Çdo gjë përreth filloi të qetësohej sikur para një gjumi të rëndë! M'u bë sikur po binte nata dhe dalëngadalë po me vinte gjumi bashkë me një ninullë të zgjatur alarmi!

AKSIONI

Edhe me epsh të shfryer nuk po shkëputesha dot nga trupi i mrekullueshëm i Fitit. E ngrita kokën lartë sa për të parë nga distanca, atë çfarë mund të shihet brenda mugëtirës mbi lakuriqësinë e trupit të saj që sa e sa herë e kisha ëndërruar me afsh. Edhe kësaj radhe mu bë sikur isha në flatrat e një ëndrre të këndshme! Për ta bindur veten së nuk isha në ëndërr, por i zgjuar dhe pranë trupit lakuriq të bukuroshes sime Fitit, zgjata dorën e djathtë, tani e qetësuar nga dridhjet epshore të pakmëparshme dhe ia ledhatova lehtë gushën, faqen, duke e tërhequr rrëshqitshëm tatëpjetë mbi lëkurën e saj të mëndafshtë, deri të beli. Ia ledhatova barkun dhe kofshët duke u përpjekur t'ia shoh seksin e saj delikat të puthitur me timin, kur ra celulari. Nuk e mora menjëherë. Pas disa të rënave këmbëngulëse, që më vinin si zë i çjerrë gjinkalle, e mora. Ishte Rexhepi, i cili po me njoftonte me

atë zërin e tij qortues së koha e mbledhjes kishte kaluar dhe kërkonte të dinte nga unë në do të merrja pjesë apo jo? Me zë të ulët i thashë së për disa orë kam ngelur në mes të rrugës nga një defekt në veturë të cilin porsa e evitova dhe po nisem menjëherë. Thjeshtë e gënjeva, por në errësirë!

Pasi e mbylla celularin, për një çast u ndjeva i shqetësuar kur vura re së Fiti nuk po jepte shenja jete. Pasi i vesha shpejt e shpejt pantallonat, zgjata dorën drejt gushës së saj që zbardhëllente nga një rreze e vetme hënë që vjedhurazi depërtonte nga jashtë. Ia mata pulsin. Sa u mrekullova kur vërejta së ajo ishte gjallë, edhe pse frymëmarrjen e kishte ca të rënduar. Është e lodhur nga dashuria që bëmë... nga dhembjet gjatë humbjes së virgjërisë medoemos, sikur ju përgjigja shqetësimeve të zërit tim të brendshëm. Shpejt e shpejt ia zgjata fillin e litarit ku i kishte të lidhura duart. E vendosa më mirë mbi dyshek duke ia lidhur mirë e mirë këmbët! Pasi ia vendosa kokën mbi jastëk e mbulova me batanije. Fli tani princesha ime... nuk do të vonohem shumë... do të vij të ta heq mërzinë, sepse tani e tutje ti e imja je! Desha t'ia heqë shaminë nga goja, por nga frika së do të thërriste në ndihmë në çastet e fundit ndërrova mendje. Pasi ia putha faqen që kishte filluar t'i ftohej, dola jashtë duke e mbyllur derën me dry.

Ashtu siç isha xhunub, pa pasur kohë as mundësi ta bëja gusllin u nisa. Porsa dola në magjistrale, ndjeva nevojë të domosdoshme që gjatë kohës së udhëtimit të hyj në dialog me zërin tim të brendshëm! Shkurt të grindem me të, me kryeneçësinë e tij! Këtë duhet ta bëj ngutshëm për dy arsye: E para, për ta lënë veten të lirë që nga goja ime të dalin fjalët e vërteta rrjedhshëm e pa frikë së mos

po e nxjerr në pah para dikujt tjetër ndonjë të vërtetë të karakterit tim të ulët... të thërras e të bërtas pa frikë në vetmi dhe në mugëtirën e kabinës së veturës para së të arrijë në mesin e vëllezërve të mi selef, sepse në mesin e tyre kam frikë së zëri i brendshëm, për një çast do të shtendosët dhe tradhtisht do të depërtoj jashtë duke zbuluar të vërtetën e tmerrshme! Kurse arsyeja e dytë është për t'ju shmangur peshës së fajësisë dhe pendimit për krimin e porsa bërë. Kjo ndjenjë më mundon shumë, e sidomos në orët e para pas vrasjeve... dhe në çast mu kujtua së kësaj radhe nuk kisha bërë vrasje, por dashuri... dashuri dhe atë, me bukuroshen e zemrës sime! Kjo është mrekulli! Të dashurosh... të puthësh vasha të bukura... t'ua ledhatosh gushë e faqe, bel e kofshë, kjo është e lejuar nga Allahu i Madhërishëm dhe e thënë nga Pejgamberi Muhamed, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të... por jo me dhunë, ma kthej flakë për flakë ai zëri im i brendshëm! Në çast, si një fije e hollë tymi, nga ngazëllimi që për një çast ma përshkoi fytyrën, nuk mbeti gjë tjetër veçse errësira e frikshme brenda kabinës së veturës sime dhe pendimit që mu shfaq si rreze drite mbi fytyrën time hipokrite. Pa dashur kisha rrëshqitur aty ku nuk dëshiroja. Dhunshëm qesh i shtrënguar të merresha me gjykimin e asaj së çfarë në të vërtetë kisha bërë? Derisa isha duke e qortuar veten për atë të ligë që ia bëra asaj krijese të dobët dhe të mjerë që vërtetë e kisha dashur dhe që akoma vazhdoj ta dua me gjithë shpirt, vetura ime u fut në rrugicën pranë zyrave të Bashkësisë! U ndjeva i lumtur që për një kohë do të gjendem jashtë qortimeve nga zërat e mi të brendshëm dhe brenda kësaj kohe do të gjenden arsyet bindëse që gjithçka bëra ishte e drejtë

dhe me lejen e të Madhërishmit! Estagfirullah!

„O Allah, të kërkoj falje nëse kam bërë gjynah, sepse vetëm Ti je ai që i falë të gjitha mëkatet! Ti je që falë shumë, të këqijat i shndërron në të mira, Ti je mëshirues, dhe Ty të qofsha falë! Amin!“ – dhe me bismilah, zgjata dorën për ta hapur derën. Sa nuk më lëshuan këmbët nga tmerri, kur në dritën e elektrikut pashë dorën time të skuqur... O Allah, nga më erdhi kjo ngjyrë e kuqe? Të jem gjakosur nga shkelmimet e Fitit? Vetvetiu dora më shkoi në mollëzën e faqes së djathtë, që akoma më bëhej sikur ishte e mpirë. Pastaj i ktheva të dyja pëllëmbët e duarve për t'i parë... gjak?! Vallë, ta kem lënduar Fitin deri në gjakosje? Vrik u ktheva në anën tjetër të korridorit dhe u futa në tualet. Pranë pasqyrës së madhe pashë fytyrën time të qetë me një nishan blu në mollëzën e faqes dhe asgjë më tepër! Po gjaku?

Tani, sa u bind edhe ajo pjesa trutharë dhe e vobektë e trurit tim se nuk po bëhej fjalë më për ndonjë gabim rasti, por për një marrëzi fatale të kryer me gjakftohtësi dhe vetëdije të plotë, që ndoshta do ta çonte Fitin e hirshme drejt vdekjes së parakohshme. Në çast, në grykë m'u mblodh një duf sa gati nuk fillova të ulëri si i çmendur nga dhembjet e tmerri për fatin e saj! Të kthjellëta i rikujtova ato skena përleshjesh, ato qitje shkelmash mospajtimi nga ana e saj dhe grushtimet e mia të pamatura! Fill pas, i penduar e kujtova mosrezistencën e saj gjatë shfryrjeve të epsheve të mia! U ndjeva i penduar! Derisa po i pastroja duart që e skuqën edhe ujin që gurgullonte mbi vaskën e bardhë, kjo ndjesi e tmerrshme sikur ma zgjati mjerimin për disa shekuj!

I dëshpëruar dhe vjedhurazi sikur t'isha ndonjë kusar

e hapa derën. Në brendi të sallës pashë vëllezërit e mi muxhahida që ishin grumbulluar në mes të sallës dhe po e uronin dikë! Abu Al Khalidi porsa më pa, me një lëvizje koke, përmes mimike, që ne e kemi mjaft të zhvilluar, më dha shenjë që t'i afrohesha. Në mes të zhurmës së pakontrolluar në sallë më pëshpëriti pranë veshit së plani sa ishte futur në rrugën e mbarë, prandaj ishte koha që të paraqitesha si vullnetari i dytë. Pa humbur kohë, thirra me zë të thekshëm duke ju drejtuar vëllezërve të mi muxhahida që edhe unë isha i pajtimit që të flijohesha për dinë e iman e për Allah!

Gumëzhitjet e vëllezërve të mi muxhahida, në çast u zhvendosën drejt meje. Në mesin e tyre pashë edhe truprojën mjekërzi të Abu Al Khalidit, i cili duke më përqafuar dhe uruar, filloi të më tërhiqte drejt derës. Aspak nuk më kujtohen rrethanat së si u gjendëm jashtë. Me një zë të ultë pëshpërime më tha së kishte urdhër që ai bashkë me mua, të takoheshim menjëherë me profesorin, pasi e kishte lajmëruar për vendimin e gëzueshëm dhe historik që u mor sonte, ndaj edhe më tha se secili duhet të përkushtohet në detyrën e vetë! Derisa ai po e shpaloste planin operativ, mua për asnjë çast nuk po më shqitej nga mendja Allahu i Madhërishëm që sikur të mos donte Ai të ndodhte një sulm i tillë nuk do të na e kishte mbushur mendjen ne për të marrë vendime të tilla, prandaj, përderisa na e ka mbushur mendjen të ndodhin sulme të tilla, atëherë do të thotë së çdo gjë që do të ndodhë është me dëshirën, vullnetin dhe urdhrin e Tij! Ai është i Urti, i Gjithëdijshmi!... por mua, nuk e di së kush po më cytë t'ju gënjej tani se gjoja e pata mendjen të Allahu i Madhërishëm! Jo! Nuk e pata mendjen fare

aty! Këto i pata menduar në një kohë krejt tjetër! Kurse tani e kam ndërmend t'ua them të vërtetën: Gjatë gjithë kohës derisa ai po e shpaloste planin unë po mendoja për Fitin dhe fatin e saj! E kisha lënë krejtësisht të vetmuar, të shtrirë mbi dyshekun e Hajries, të gjakosur dhe të rraskapitur nga dhuna, të lidhur shtrëngueshëm duarsh dhe këmbësh dhe gojëmbyllur! Vallë a do t'i përballojë trupi i saj i brishtë kësaj torture derisa të kthehem? Po, po! Gjithsesi do të mbijetojë në saje të ndihmës së pakursyer të Allahut mëshirues. Çdo gjë që ka ndodhur në mes nesh është kryer me pëlqimin, dëshirën dhe urdhrin e Tij... sikur të mos dëshironte Ai nuk do të ma kishte mbushur mendjen të veproja ashtu... dhe kur i Madhërishmi ta mbushë mendjen për diçka, atë duhet marrë si urdhër të Tij dhe si të tillë duhet zbatuar!... pastaj nata i ka ligjet e veta! Allahu e ka krijuar natën për t'i vënë në gjumë krijesat e tij që të pushojnë, të ç'lodhën dhe kur të agojë e bardha dritë të zgjohen të gëzueshëm, të çlodhur dhe pasi t'i falën Madhërisë së Tij të fillojnë të kujdesen për jetën e tyre!

Kur, pas gjithë këtyre mendimeve të frikshme, erdha në vete, pashë së truproja e Abu Al Khalidit ende po fliste me zë të ulët, por kësaj radhe për një mbushje eksplozive. Porsa hapa gojën ta pyesja së për çfarë mbushje e kishte fjalën, ai më tërhoqi lehtë nga supi dhe bashkë me të morëm drejt veturës së tij.

Gjatë gjithë rrugës, edhe pse nuk qe ndonjë rrugë e gjatë, pata ndjesinë së kurrë nuk do të mbaronte. Për asnjë çast nuk arrita ta shqis nga mendja Fitin, që më vinte e përzier me disa mbushje eksplozive, me disa armë automatike, disa eksplodime... Qortimet e heshtura, nga

ai zëri i brendshëm për dhunën e egër që kisha treguar ndaj saj, sa nuk shpërthyen me një shqyerje të tmerrshme që do ta grisnin jo vetëm heshtjen e kabinës së mugët të veturës, por do ta thyenin edhe qetësinë e natës e do t'i bënin copë e grimë rrezet e ndritshme të hënës! Edhe kësaj radhe m'u bë se vetmia e mbështjellë me kureshtje të tmerrshme sikur po zgjatej e stërzgjatej me shekuj!

Kur vetura e kishte ngadalësuar shpejtësinë dukshëm dhe mori nga e majta duke u afruar pranë një dere llamarine të mbyllur, m'u bë sikur u zgjova nga një dremitje çasti dhe u shtriqa. Truproja e Abu Al Khalidit zbriti dhe e hapi derën. Si hije e padallueshme nga terri i natës hyri në kabinë duke e mbyllë derën e veturës lehtë-lehtë, me një kujdes jashtëzakonisht të veçantë. Pata përshtypjen së derën nuk e kishte mbyllë fare, kur vetura fillojë të rrëshqiste tatëpjetë. Vetëm tani e pashë së ne bashkë me veturë po futeshim në një bodrum të ndritshëm. Në fundin e tij pashë dy burra të ulur mbi arka municioni dhe po bisedonin me zë të ultë. Kur u afruam pranë tyre e ndërprenë bisedën. Ishte profesori. As që e mori mundimin të na përshëndeste, derisa shoqëruesi i tij po na shikonte më përbuzje! Pastaj u ngritën në këmbë. Profesori me ftoi me një lëvizje të lehtë koke. E ndoqa pas. Në skajin tjetër, pashë një tryezë të mbuluar me çarçaf të bardhë. Ndaluam pranë saj. Pasi e largoi çarçafin, pashë një arsenal të vërtetë armësh të llojeve të ndryshme, të radhitura njëra pranë tjetrës. Mori një revole të tipit TT. Pasi e rrotulloi disa herë nëpër duar duke e shikuar me kujdes, ia nxori karikatorin e fishekëve dhe ia hoqi siguresën. Pastaj e tërhoqi rrëmbyeshëm qarkun dhe ia tërhoqi këmbëzën. Pas një krismë të thatë metalike ma zgjati mua.

– Merre, është për ju! Sipas dëshirës, mbushi xhepat me karikatorë fishekësh! Për hollësitë e planit do të njoftoj gjatë realizimit të tij, Mirë?

– Si urdhëro!

– Tani, eja me mua! Derisa eksperti ushtarak do ta përgatisë veturën me mbushje eksplozive, ne do të shkojmë në vendin e takimit ku do të fillon realizimi i planit operativ. Kjo është vetura e juaj që do ta përdorësh gjatë aksionit. Më ndiq pas! – më tha duke më parë thellë e me dyshim!

Për një kohë të gjatë më mbeti i ngulitur në mendje shikimi i tij që shprehte dyshim, pabesi, dinakëri por jo edhe frikë siç do ta dëshiroja unë. Ky ngacmim m'i nxiti disa ndjenja të largëta e të harruara, që më erdhën të përziera me ca thërrime urrejtjesh kundër sojit të tij, por të fashitura përbrenda qenies sime. Kjo zbutje e rrëgjuar, më vjen si frikë, nënshtrim e përulje e tulatur para diktateve dhe urdhrave që më vijnë nga gjuha e tij sllave, por në anën tjetër pikërisht e njëjta zbutje e rrëgjuar më mbush me mburrje, trimëri dhe krenari para njerëzve të sojit tim, ku mbi ta ndjej epërsi dhe pa hezitim mund të them së askujt prej tyre nuk ia kam frikën!

Kur dola në rrugë, përballë mu shfaq Xhamia e Madhe dhe pirgu i lartë i Sahat-Kullës. Instinktivisht e shikova orën. Ishte pesë pa një çerek. I befasuar së kishte kaluar pjesa dërrmuese e natës mu bë sikur u shfaqa pas disa shekujsh vetmie pikërisht aty ku kisha rënë shehit dikur dhe padashur mendja me shkoi të Fiti që gjithashtu edhe atë, para disa shekujsh e kisha lënë të molisur dhe të lidhur me litarë në një bodrum të errët të një shtëpie të humbur që tani nuk i gjendën as themelet.

U ndjeva i lehtësuar kur vetura e profesorit ndaloi bri një sheshi të vogël. Ai qëndronte para veturës sime duke më dhënë shenjë së në cilën pjesë të sheshit duhet parkuar. Pastaj me ftoi të zbrisja dhe të shkoja pranë tij. Vrik doli jashtë. Më urdhëroi të hipi në veturën e tij dhe pas pak çastesh pashë veten pranë zyrave të Bashkësisë! As më të voglën ide nuk e pata pse më solli prapë këtu, por as unë nuk e pyeta fare. Zbrita nga vetura dhe mora nga dera.

Kur hyra në sallë, Abu Al Khalidi vazhdonte akoma me hutbe. Si temë kishte zgjedhur jetën e shkurtër të kësaj bote, transformimin në botën tjetër dhe ringjalljen. Kur më pa sikur ndaloi për një çast. Pastaj shikoi nga ora dhe i ra shkurt fjalimit të tij duke dhënë shenjë se kishte ardhur koha e faljes së sabahut!

Grumbuj-grumbuj morëm drejtimin e xhamisë ku do t'i bënim lutjet e mëngjesit. Derisa po kalonim mes për mes qytetit të ndritur bukur jo vetëm me dritat e neonit por edhe nga rrezet e arta të hënës, unë po e ndjeja veten në epërsi para gjithë atyre djelmoshave të sojit tim dhe fare pak të tulatur para madhërisë së tij, Abu Al Khalidit! Si komandant që isha, e parandjeva së kisha për detyrë zbatimin e rregullave mbrojtëse dhe kontrollin e lëvizjeve të besimtarëve por edhe lëvizjet e dyshimta të ndonjërit që rastësisht apo qëllimisht do të guxonte të na përgjonte fshehurazi nga distanca. Ndërkohë, shfrytëzova rastin, pasi isha larguar pak prej tyre dhe e mbusha revolen. Nuk i dihet... tani ndodhemi në luftë me kaurët!

Ja, derisa po hidhja hapa të shpejtë duke u rrotulluar nga një rrugicë në tjetrën për të parë së mos po na përgjonte kush, por edhe për të qenë sado pak çaste larg atij grumbulli të pavlerë gjytyrymësh trutharë, mendja

m'u përqendrua në atë më të tmerrshmen, plagosjen e Fitit, që disa herë me neveri e kisha larguar nga kujtesa. Kësaj radhe, edhe pse në mënyrë të pavullnetshme por të vendosur, ajo pjesa ëndërrimtare e trurit tim, në mënyrë të vendosur filloi të sajojë se cili në të vërtetë e kishte grabitur, dhunuar dhe plagosur për vdekje Fitin, bukuroshen time të gjorë. E sheh sa bukur? Sajimin e përrallës e fillova pikërisht pranë selishtës ku kishte ndodhur vërtetë grabitja. Pastaj, në akordim të plotë me rrethanat e vërteta u zhvendos në një veturë të huaj dhe fill pas në bodrumin e një shtëpie të braktisur ku aty kishte ndodhur ajo më e lemerishmja, plagosja dhe dhunimi. Dhe e gjithë kjo kishte ndodhur nga një njeri që ishte folur së njëherë e një kohë kishte pasur aferë dashurie me té dhe befas një ditë kur ishte kthyer nga ato vende të bekuara dhe e kishte mësuar të vërtetën e hidhur se ajo e kishte tradhtuar me Imamin e poshtër, për t'u hakmarrë kundër saj, ashtu siç e kërkon nderi islam, e kishte vrarë Imamin, e kishte grabitur Fitin dhe fill pas e kishte dhunuar dhe plagosur për vdekje! Për zhdukjen e gjurmëve kishte marrë vendim të vetëvritet gjoja në emër të xhihadit islamik... sa bukur... ide e mahnitshme që jo vetëm njeriu, por edhe Allahu do ta besojë!

Ndjehesha shumë i lumtur kur po frymëzohesha prore, si nga engjëlli Xhibril, së zbritja që po më bëhej nga lartë, do të besohej nga të gjithë, ashtu siç ishte besuar edhe zbritja e dikurshme e përrallës së ariut. Sikurse atëherë, edhe tani, unë do të jem engjëlli i ardhshëm, si heroi i legjendës që e shpëton nga kuçedra të bukurën e dheut unë do ta shpëtojë Fitin nga robëria dhe vdekja e sigurt! Oh, sa do të gëzohet Fiti kur do ta marrë vesh të vërtetën

së unë isha shpëtimtari i saj... se unë isha i dashuri i saj i vërtetë, (edhe pse ajo më kishte injoruar tmerrësisht)... e pastaj, unë do të jem mëshiruesi i saj, dhe për hir të dashurisë, unë do të jem zemërgjerë e do t'ia falë humbjen e virgjërisë nga ai horr, do t'ia falë sorollatjet rrugëve fytyrëzbuluar dhe të gjitha mëkatet e tjera... sepse unë jam ai që shumë falë, jam mëshirues... dhe, edhe kështu siç është e dalë feje, por si robëreshë lufte do të jetë në posedimin tim, që pastaj, do ta pranoj për nuse, sepse ajo do të bëhet një nuse e bukur! Vërtetë para saj, unë do të jem i Madhërishmi, i Urti!

Kur arrita pranë rrethojave të xhamisë, pashë së në brendi të tyre, aty pranë lëfyteve të gurrave që prore lëshonin vrushkujt e ujit që gurgullonte, besimtarët të kërrusur gërmuq po merrnin abdes për faljen e sabahut. U afrova më pranë kangjellave dhe e pashë atë qyqarin që kishte marrë vendim të vetëvritej. Për një çast më shtini n'gjynah kur pashë së po i dridheshin duart nga frika. Me marifet u largova nga aty, duke menduar se shpëtimi i tij nga vdekja do të jetë torturë, tmerr dhe mos e dhëntë Allahu, vdekje për mua!

Kur po bëhesha gati të futesha brenda oborrit të xhamisë për të marrë abdes, në këndin matanë, pranë një muri rrethues sikur pashë një gjysmë koke njeriu duke më vështruar tinëzisht. Kur e vërejti se e diktova, u zhduk tutje. Vrapova pas tij. Kur e arrita këndin ku kishte qenë i fshehur, pashë një rrugicë të gjatë dhe të boshatisur fare. U zhduk sikur ta kishte lëshuar toka. U ktheva me një fije dyshimi dhe shpejt e shpejt mora abdes.

Pas lutjeve të sabahut, isha i pari që dola nga xhamia. Me hapa të shpejtë dhe më vështrim të shkathtë i përlava

gjithë rrugicat përreth. Derisa po përshëndetesha më Abu Al Khalidin, prapë mu bë së dikush po na përgjonte. Sa hap e mbyll sytë mu zhduk nga pamja ime. Duke formuar një rreth të gjerë u gjenda prapë pranë vëllezërve të mi muxhahida. Së bashku arritëm pranë vendtakimit me profesorin. Derisa ai po i shpaloste konstruksionet e fundit të veprimit, unë vështroja pa ndërpre me vëmendje të shtuar sa majtas djathtas, sa para prapa, duke përlarë çdo vrimë e skutë me sy hetuesi. Prapë e hetova të njëjtin vështrim. Pa u rënë në sy të tjerëve u gjenda në vendin nga na kishte vështruar i panjohuri. E pashë edhe më mirë... dale njëherë! Ai nuk ishte i panjohur! Vetëm tani mu kujtua së ata sy nuk ishin të askujt tjetër përveçse sytë e të poshtrit Hilë. Një palë mornica të akullta ma përshkuan tërë trupin. Befas me erdhi një parandjenjë ogurzezë. Tani po e shoh së paskam gabuar në vlerësime, kur thashë pak më parë së askujt prej sojit tim nuk ia kam frikën! Ja ku mbiu ky malukat i paudhë, i mbushur plot sherr... e sherri e zëntë jarabi! Çdo metodë që përdora për ta mposhtur më shkoi huq, sepse është vetë shejtani... por siç po e shoh, sot i paska ardhur dakiku!... rahmet i pastë shpirti!

Kur po nisej kolona për aksion, prapë e pashë atë kokë tinëzare që po na shikonte. Kësaj radhë e pashë nga afër. Edhe ai më pa dhe nuk u largua fare, por vazhdonte të më shikonte më atë shikimin e tij prej budallai. Për pak më demoralizoi, por kur m'u kujtua revolja në brez u trimërova! Edhe njëherë i këndova rahmet shpirtit të tij mëkatar dhe u nisa drejt tij për t'ia zbrazë të shtatë plumbat m'u në lule të ballit. Iku i paudhi. Në çast u zhduk pas murit. Duke vrapuar pas tekave të tij, me vete

po i thosha: Tani më dil përpara po ta mbajti, qen bir qeni! Kur u afrova fare pranë këndit ku ishte zhdukur, nuk pashë gjë. Tutje, matanë murit të ulët ndjeva lëvizje. E shtyva derën e drunjtë dhe u futa në një oborr të huaj. Derisa po shikoja majtas e djathtas me shpinë nga muri, sikur dëgjova një përplasje këmbësh në trotuar dhe fill pas, hapa që po largoheshin. Nga frika së edhe kësaj radhe më shpëtoi, vrik dola në rrugicë. Në fundin e saj e pashë që u tret prapa shtëpive duke marrë një rrugicë tjetër që të shpinte në brendi të qytetit. Më revole të gatshme për zjarr, por të fshehur nën sqetullën e majtë e ndoqa pas. Kur po kthehesha vrullshëm tek bërryli ku çaste më parë ishte zhdukur i paudhi, befas ndjeva një goditje grushti në gjoks sa që ngela pa frymë. Në çast këmbët e humbën drejtpeshimin dhe u rrokullisa në gropat e rrugicës së ngrirë. Revolja më shkau nga dora dhe më ra në një pus duke e çarë cipën e hollë të akullit. Kur po i jepja zor trupit të ngritsha në këmbë, ndjeva edhe një goditje tjetër. I tmerruar nga dhembjet dhe nga urrejtja kundër tij, i dhashë vetit zor dhe arrita ta mbërthej rrëmbyeshëm nga flokët. Me një shtytje si prej të çmenduri e zateta për murin matanë. Pasi i forcova këmbët në pozicione të sigurta e tërhoqa nga vetja dhe me një rrotullim të çastit u gjenda mbi trupin e tij! Dorën nuk po e shqisja për asnjë çast nga flokët e tij të urryera. Derisa po mendoja së sa i lehtë paska qenë nënshtrimi i tij, m'u bë se asnjëherë në jetën time nuk e kisha pasur më pranë fytyrën e tij të rruar taze. M'u bë sikur po më ftonte prore për t'ia dhënë lezetshëm disa shuplaka... dhe ia dhashë turinjve disa flakaresha djegëse duke i thënë me mburrje dhe hidhërim bashkë:

– Si të dukët tani ë?... e din ti së Allahu e dënon atë që do dhe e falë atë që do... edhe kësaj radhe Ai do të dënojë ty dhe do të më falë mua sepse unë jam i përzgjedhuri i Tij!

– Ndoshta je i biri i Tij... apo i dërguari i Tij?

– Ndoshta... Ai e di më së miri, prandaj po me jep forcë!

Derisa ai përpëlitej të lirohej nga pesha e trupit tim, me dorën tjetër arrita ta nxjerrë thikën nga brezi. Me një lëvizje të shkathtë ia afrova të gusha. U magjepsa kur vërejta se përnjëherë e lëshoi fuqia. Tani me lezet ia afrova tehun e mprehtë pran gurmazit dhe duke ia tërheqë flokët me gjithë forcë nga prapa, ia zgjata qafën dhe ia preva pak lëkurën e butë! Fillojë t'i rridhte gjak.

– Njëherë më ke shpëtuar! – i thashë pa frikë së po nxirja në sipërfaqe ndonjë fshehtësi.

– Kur? – më pyeti i hutuar duke shpurdhë lehtë, jo për t'u liruar nga pesha e trupit tim por për të zënë vend më mirë.

– Atëherë kur ta çava kokën hu...

– Kurrë nuk më ka shkuar mendja së ti ushqen një urrejtje kaq të madhe kundër meje... domethënë, ti më paske goditur atëherë prapa shpine ë?

– Po! Unë të godita... por pak... dhe shpëtove qelbësirë!... por sot nuk do të më shpëtosh!... nuk e di deri kur do të përmbahem pa ta marrë shpirtin, stërvinë! – i thashë derisa po ia tërhiqja flokët prapa duke ia zgjatë qafën si kurbanit para therjes!

U tregua i zgjuar i poshtri. Më të parë tehun e thikës pranë gushës së tij nuk bëri asnjë lëvizje rezistence, përndryshe do t'i kishte fluturuar koka! Sytë ju zgurdulluan nga tmerri dhe më zë të butë më pyeti:

– Kujt i shërben ti ë?

– I shërbej Allahut të Madhërishëm dhe mësimeve të Tij! – ia ktheva me ngazëllim të madh që ndjeja në shpirt për epërsinë që kisha karshi tij. Kur e vërejta që po më dëgjonte pa asnjë rezistencë, i frymëzuar vazhdova: – Jo vetëm Allahut, por me të njëjtin vullnet i shërbej edhe thikës sime të mprehtë, që ta pret gurmazin me një të rënë... pa të shkaktuar shumë vuajtje...

– Do të më vrasësh edhe mua ashtu siç e vrave Hafizin?

– Ah jo, jo krejt ashtu i dashur, jo! Hafizin e mbyta shufër hekuri... Imamit ia shpova zemrën anë për tej me té, kurse ty, do të theri si kurban... të pëlqen të vdesësh si kurban, ë?... apo mos ke dëshirë të dish se kë e kam vrarë tjetër?

– Po!

– Edhe po të tregoj, nuk do të hyn fare në punë, sepse që nga ky çast ti llogaritësh me të vdekurit! A po e ndjenë peshën e trupit tim, ë? Jo krejt kështu... por të ngjashme, këtë peshë do ta përjetojë së shpejti edhe Zoga jote e bukur! Eh, sa e lezetshme që është... ti nuk e merr dot më mend se si do ta përmbledhë kur ta fus në dorë... Ha, ha, ha!

– E marr me mend, e marr!... sigurisht së do ta përmbledhësh ashtu siç e përmblodhe Fitin disa orë më parë?

– Sa mirë po e din ti! Eh, Fitin! Sa e dua bukuroshen time belkëputur! Nëse Zoga jote do të më kundërshtojë, do ta pësojë të njëjtin fat sikurse edhe Fiti! Kurse ty do të theri si dash... – dhe kur po hamendesha për ta shtyrë thikën drejtë gurmazit të tij, më tha më zë të butë dhe shikim të përvajshëm:

– Prit! Kam edhe diçka për të thënë!

E ndalova dorën. Derisa po e shikoj në atë gjendje të mjerë, disa herë më erdhi ta tërheqë zvarrë dhe t'ia zhys kokën në pus derisa t'ia nxjerri shpirtin për gazep këtij torollaku të pandreqshëm... apo, ndoshta më mirë po e lë të m'i tregoj amanetet e fundit? I shtendosur e lashë të fliste, duke i thënë:

– Fol! Thuaje atë ç'ke për të thënë!

– Mirë që e dhunove Fitin por, pse e vrave pastaj?

– Unë nuk e kam vrarë Fitin!

– Ne e gjetëm të vdekur në shtëpinë e braktisur!

Në çast, ndjeva sëmbime të tmerrshme dhimbjesh që ma përshkuan anë për tej zemrën duke harruar epërsinë e pozitës sime të përmbledhur mbi trupin e tulatur të tij. Mjaftoi një shkërmoqje çasti, të cilën ai i poshtër e shfrytëzojë për bukuri! Sa hap e mbyllë sytë, ma largoi dorën bashkë me thikën që ia mbaja pranë gurmazit dhe më një lëvizje të shpejt taktike u gjenda nën peshën e trupit të tij! Gjatë këtij manovrimi nuk më dha kohë as të mendoj së çfarë po ndodhte në të vërtetë! Kur fillova ta mbledhë veten duke u përpjekur ta liroj dorën që e mbaja thikën, ndjeva një goditje të rëndë në mjekër. Në çast mu duk se e tërë nofulla më doli nga vendi. Pas një tundje të papritur dore, e ndjeva kur më shkau thika. Derisa po mendoja me trishtim se si ngela i pambrojtur dhe pa të vetmen armë që e konsideroja shpëtim nga ky i poshtër, më erdhi goditja e dytë në anën tjetër të mjekrës. Në mesin e dhembjeve të tmerrshme i pashë një palë drita të forta, me portretin e Ismajlit në qendër, që më dolën nga sytë! Dhembjet qenë të padurueshme. Ende pa e marrë veten më ndodhi goditja e radhës. Ajo më erdhi nga një distancë e çuditshme dhe drejtpërsëdrejti

në fytyrë! Ishte aq e rëndë sa që e ndjeva kërkëllimën gjatë thyerjes së eshtrave të hundës dhe rrjedhën e ngrohët të gjakut! Prapë nga sytë me dolën të njëjtat drita por tani me portretin e Hafizit në qendër, i cili, sikur po më shikonte më sy të zgurdulluar! Derisa po përpiqesha të bëja lëvizje rezistence, i çorientuar, ndjeva një goditje tronditëse rrëzë veshit të majtë! Nga dhembjet nuk i hapja dot sytë, ku thellë në brendi, sikur po notonte fytyra e bardhë e imamit. Ndërkohë, nga goditja e radhës, e drejtpërdrejtë, ndjeva kur pjesa e pasme e kokës m'u përplas tmerrshëm në gurët e trotuarit! Sa hap e mbyll sytë, në kujtesën time mu vizatua pamja e mrekullueshme e Fitit, e cila, në mesin e dhembjeve të padurueshme po më shikonte më përbuzje cinike duke ju gëzuar gjendjes sime të mjerë! Ah, sikur ta dija se sa të tmerrshme qenkan dhembjet kur të godet dikush vdekje, sigurisht se edhe unë do të kisha pasur mëshirë ndaj viktimave të mia!

Në mesin e goditjeve, ndjeva kur po me pyeste egër:

– Kush fshihet pas teje?

Pas pak, më zë të vrazhdë më kërcënoi pasi nuk po i përgjigjesha.

– Kush fshihet pas teje po të them?

U përpoqa t'i përgjigjëm më zë të përvajshëm... të nënshtruar dhe po mendoja së ndoshta do ta shti në gjynah e më lëshon vetëm pak, sa ta marr veten dhe të ndodhem edhe njëherë në epërsi ndaj tij dhe pastaj e di unë së çdo të bëjë me të! Derisa po i mendoja këto më zë lutës i thashë:

– Lëshomë të lutëm, vetëm pak... ke mëshirë për mua!

– Kërkon edhe mëshirë? Fol, kush është pas teje, apo ta nxora shpirtin për gazep... i pa zemër!

– Magjistrica! – i thashë me zë të mekur.

– E di për të! Tjetër? – më pyeti prapë i poshtri.

– Nuk ka tjerë! – u përpoqa ta gënjej, por në çast ndjeva një dhembje të tmerrshme në mollëzën e faqes, sa që m'u bë se syri me fluturoi nga zgavra si trumcaku i frikësuar që del vrullshëm nga foleja.

– Fol qelbësirë! – më kërcënoi me zë të lartë e të tmerrshëm duke e shoqëruar me të goditura.

Tani nuk i mbaj mend më rrethanat së si më doli nga goja edhe një emër që nuk duhej të kishte dalë edhe sikur duhej ta kisha paguar më jetë:

– Profesori! – thashë gati duke qarë, kurse më vete po mendoja: „Po të isha në vendin tënd, kaherë ta kisha marrë shpirtin qelbësirë..." dhe vazhdova: – por unë nuk kam faj... të lutëm me beso!

– Thuaje emrin e jo nofkën. – më kërcënoi pa ua vërë veshin lutjeve të mia

– Janko Martinoviq! – nuk e di se a më doli një zë i mekur apo vetëm mendova.

– Përse i bëre gjithë këto krime ë? – më pyeti i hakërryer

– Për të përmbushur një mision!

– Çfarë misioni?...

– Një mision të Allahut!...

– Atë misionin tuaj të famshëm që Allahu ia fal mëkatet atij që do dhe dënon atë që do?

Vura re së isha para një agonie dhe si në jehonë, në mesin e të rënave të panumërta, dëgjova të përsëritej i valëzuar emri i Allahut.

Pastaj, derisa po përsërisja pandërprerë si nëpër ëndërr „*Bismilah, Bismilah...*" dëgjova zëra të hakërryer që nuk e përcaktoja dot se nga vinin dhe kujt po i drejtoheshin.

Ishte pikërisht ai çast që më kishte zënë agonia.

Kur erdha në vete pashë së dikush po më hidhte fytyrës ujë të ftohët e të turbullt nga pusi i rrugës! Më mundim i pulita disa herë sytë! Derisa po bëhesha gati të ngrihesha në këmbë, ndjeva së dikush më tërhoqi nga supi. Si nëpër ëndërr pashë figura njerëzish të mjegulluar rreth e qark që bënin lëvizje të pakontrolluara. Dikush më mbajti nga krahu tjetër. Kur fillova t'i lëvizë këmbët, dëgjova ca zëra të mekur që po shprehnin habi e dhembje bashkë! Sigurisht se po ju vjen gjynah nga pamja ime! Ndërkohë, ndjeva së leshrat e mjekrës sime synet po me ndyheshin prore me gjak e jargë! Kur bëra ta ngre dorën për ta fshi mjekrën, e hetova së më kishin prangosur... para meje pashë profesorin fytyrëvrenjtur dhe duarprangosur që po e tërhiqnin dhunshëm nga krahët!

Vetëm tani u bind edhe ajo pjesa budallaqe e trurit tim së unë vërtetë në duel më të tjerët jam tepër i dobët! I fortë, i pashpirt dhe i pathyeshëm jam vetëm në errësirë, tinëzisht dhe prapa shpinës së viktimave!

PËRGJIMI

Tamam në kohën kur kishin filluar të grumbulloheshin njerëzit kureshtarë për të parë së ç'farë kishte ndodhur në brendi të mejhanes, unë dola jashtë. Pashë qiellin e pastër që shndriste nga xixëllimat e yjve dhe rrezet e argjendta të hënës. Një puhi e lehtë por e ftohët ma përshkoi tërë trupin dhe më bëri për një çast të dridhem. Pasi e mbështolla mirë e mirë shallin rreth qafe, për herë të parë më ngacmoi një ndjesi faji për vrasjen e Imamit. Sa më shumë që thellohesha në mendime aq më e rëndë me vinte pesha e fajit! Çfarë përgjimi bëj unë, kur para hundëve ma vrasin të përgjuarin dhe vrasësi zhdukët pa lënë asnjë gjurmë?

Derisa po ecja me nxitim drejt komisariatit, si nëpër mjegull po më behej sikur një hije e maskuar nën gunë, gjatë kohës kur po dremisja syhapur në ngrohtësinë plot tym duhani të mejhanes, ma kishte vjedhur të përgjuarin

tim dhe tutje në kthinat e errëta e kishte vrarë! Kjo vjedhje vinte si rezultat i pozicionimit tim të gabuar. Edhe njëherë i kujtova me radhë lëvizjet e njerëzve në mejhane në çastet e fundit para vrasjes së Imamit. As kësaj radhe nuk vërejta asnjë të dyshuar potencial që kishte hyrë në tualet përveç vetë Imamit! Vallë, mos ka bërë vetëvrasje?

Kur hyra në komisariat, pranë derës së kantinës u takova me një grup policësh që po flisnin me zë të lartë. Kur u afrova më pranë pashë Kujtimin. Derisa po çuditesha me praninë e tij në komisariat e jo në vendin e ngjarjes, pashë të vinte komandanti me një dosar në dorë. Pasi futi kokën brenda derës së kantinës, thirri me zë të lartë:

– Vetëm ata që janë të ftuar për mbledhje të më ndjekin pas! – dhe e hapi një derë që ishte përballë derës së kantinës.

Duke vështruar në drejtim të Kujtimit, për disa çaste ngela i dyzuar. Nuk e kisha të qartë në isha i ftuar edhe unë, apo... kur pashë Kujtimin të më jepte shenjë përmes mimike që ta ndiqja pas. Hyra në sallë.

Derisa po zinim vend pranë tryezave, pashë një të ri elegant... për disa çaste mbeta i nemitur! Pa shih, pa shih?! Vallë, a mund të ndodhë kjo? Ishte pikërisht ai i riu elegant që kohë më parë e kisha takuar në mejhane të ulur në tryezën time të preferuar? Derisa po bëhesha gati ta pyesja Kujtimin së cili ishte, dëgjova të thoshte:

– Ju lutëm qetësi! Kohen e kemi jashtëzakonisht të shkurtër!

Pasi e mori një letër nga dosari që çaste më parë komandanti e kishte lënë mbi tryezë, u afrua pranë hartës së madhe të qytetit që ishte e varur në murin përballë.

Zemra po më rrihte me forcë kur pashë komandantin

që u afrua pranë tij dhe filloi t'i tregonte diçka pranë veshi duke shikuar nga unë. Edhe më keq e ndjeva veten kur edhe të tjerët kthyen vështrimin drejtë meje. Pasi i bëri dy tre hapa drejt meje, tamam kur isha duke i pritur qortimet e tij, i riu elegant foli rëndë-rëndë duke shpalosë letrën që e mbante në dorë.

– Këtu kam një skicë plani operativ, të koduar me emrin: „Furtuna." Është tepër sekret!

Oh, shyqyr, mendova me vete!

– Pas një kohe të gjatë e të mundimshme hetimesh, kemi arritur në përfundim të ekzistimit të një rrjeti të rrezikshëm terrorist, i cili vepron lirshëm jo vetëm brenda qytetit por edhe në rrethe të ndryshme të vendit. Veprimtaria e tyre fshihet nën petkun e pasuesve të fesë islame! Për këto grupe ekziston dyshimi i bazuar së veprojnë nën tutelën e shërbimeve sekrete të shteteve fqinjë, që kanë për qëllim destabilizimin e situatës politike dhe të sigurisë në vendin tonë. Dyshohet të jenë të përfshirë edhe disa miq nga shtetet islamike. Qëllimi i sulmeve është kryekëput politik! Prandaj, sipas informatave të sakta nga terreni, njoftohemi se nesër në orët e para të mëngjesit do të ketë sulme terroriste në përfaqësitë diplomatike të shteteve mike që veprojnë të akredituara në vendin tonë. Ne, gjithsesi duhet të veprojmë përmes një platforme taktike në mënyrë që, jo vetëm t'i parandalojmë sulmet, por edhe t'i kapim keqbërësit në tentativë! Për t'ia arritur këtij qëllimi, do të kemi një natë të gjatë, plot ankth, të rrezikshme, që mund të na kushtojë edhe me jetë! Jeni të përgatitur?

– Po! – u dëgjuan zëra të pakoordinuar në sallë!

– Mirë pra! Tani, në mënyrë të detajuar po e shpalos

planin operativ duke i ndarë detyrat dhe përgjegjësitë që dalin prej tij!

Pas disa rrotullimesh që i bëri pranë hartës së varur në mur, i riu elegant, filloi të fliste me zërin e mëparshëm por tani paksa të ndrojtur. Së pari vuri në dukje tërthorazi rëndësinë e planit operativ, si një mrekulli e kohës që kishte ardhur si rezultat i punës dhe përpjekjeve të shërbimit inteligjent. Pastaj, në pika të shkurtra vuri në spikamë pasojat e pandreqshme politike e veçmas ato psikologjike që do ta vënte në pikëpyetje edhe progresin e arritur gjer më tani në rendin dhe qetësinë publike, sikur planet djallëzore të armiqve të shtetit dhe popullit të lejoheshin të vepronin me dhunë e terror në atdheun tonë të shumëvuajtur! Kështu që ndërhyrjet tona, për parandalimin e këtyre dukurive të rrezikshme janë të arsyeshme... jo vetëm të arsyeshme por edhe të domosdoshme!

Pastaj, sikur ishte duke vepruar një hije, e jo një njeri, filloi të afrohej edhe më pranë hartës duke krijuar rrathë të paqëndrueshëm mbi sipërfaqen e saj, me shufrën e metaltë që e mbante në dorë:

– Ja, këtu – tha me zë të qetë, duke vështruar mbi një pikë nga mesi i hartës, – janë të tubuar pjesëtarët e të ashtuquajturës Ikhuanul-Muslimin të prirë nga disa pjesëtarë sektesh myslimane të quajtura me emër të butë selefi-us-salih, por që në të vërtetë i përkasin një sekti përçarës e plot sherr të quajtur Vehabi! Udhëheqës dhe pjesëtarë besnik të këtij sekti, të tubuar sonte në lokalet e Bashkësisë Islame, po pritet nga çasti në çast të marrin vendime historike, kuptohet; sulme vetëvrasëse. Këto sekte, dyshohet të jenë të nxitura dhe të përkrahura nga

një përfaqësues arab, njëri nga treshja e përbërë nga Imami dhe i ashtuquajturi profesor, që ne akoma nuk kemi arritur të zbulojmë saktësisht së cili personalitet fshihet pas nofkës së këtij të fundit, edhe pse gjurmët na çojnë të Janko Martinoviq, pjesëtar i vjetër i shërbimit sekret serb!

Pastaj, vazhdonte i riu elegant, duke i shënuar me shufër caqet ku duhej të zinin vend përgjuesit tanë;

– Një pjesë të forcave tona do t'i përqendrojmë pranë Xhamisë së Madhe, pra këtu, të Shenja „A" e planit. Pas tyre do të përgatitën sulmuesit, të cilët do të zënë vend pranë ndërtesave përreth, ja, këtu të shenjat: „B", që numërohen gjithsejtë katër sosh. Në rast nevoje, ne do të jemi të shtrënguar t'i përdorim edhe lokalet banesore për mbrojtje, sulm apo kundërsulm! Megjithatë, nuk ma ha mendja se do të vij puna deri aty!

Nuk e di për ç'arsye, përmendja e emrit të Imamit, më vuri prapë në siklet. Tani, jo nga trishtimi për vrasjen e tij, as nga kurioziteti për të ditur se nga kush është vrarë, as për përgjegjësinë time që kisha për përgjimin e tij por nga përmendja e emrit të një të vdekuri pa përdorë paraprakisht mbiemrin; „I ndjeri", që përdorët zakonisht për t'i dalluar të vdekurit nga të gjallët. Ndoshta nuk e ka vrarë askush të ndjerin... ndoshta i ndjeri e ka vrarë veten... hajde kokë hajde! Po ku vritet i ndjeri?, e pyeta veten i çuditur me ato që po mendoja, duke bërë përpjekje t'i largoj sa më parë nga mendja këto mendime hutaqe.

– Përderisa ne nuk e dimë vendtakimin e tyre, – vazhdonte të fliste i riu elegant, – apo thënë më qartë, përderisa ne nuk e dimë vendin e saktë të nisjes për aksion, në plan e kemi shënuar me shkronjën „X", vend

që do të caktohet nga pala kundërshtare gjatë realizimit të planit! Ne nuk e dimë të sigurt as vendin e goditjes. Sipas informatave që kemi në dispozicion, janë tri vendsulme të mundshme. Që të tri këto vende janë të shënuara me „Y“, prandaj edhe për këtë pikë të planit mbetët të merret vendimi sipas rastit që do të na paraqitet në terren.

Sa më shumë që po kristalizohej plani operativ, në mendjen time, herë pas here, po më vijëzohej Zoga ime e bukur. E gjora, sa do të merakoset për mua. Sigurisht se edhe ajo do ta ketë një natë të gjatë e pa gjumë, por jo të rrezikshme! Ofshana me dhimbje kur e kujtova humbjen e kësaj nate kaq të bukur larg shtratit të ngrohtë dhe përqafimit të saj!

Befas, ndjeva një të prekur të lehtë në supin e majtë. Ktheva kokën. Ishte një burrë fytyrërrumbullak që po më jepte shenjë me dorë e kokë andej nga dera. Kureshtar, ktheve kokën. Pashë komandantin që po më shikonte me ngulmë! Pasi ma bëri me kokë që ta ndiqja pas, doli jashtë. Lehtë, lehtë, pa zhurmë u gjenda në korridor. Zëri i të riut elegant më përcolli pa ndryshuar fare nuancat e tonit duke i ripërsëritë thëniet e mëparshme se:

– Do ta kemi një natë të rëndë, pa gjumë dhe të frikshme që secilit nga ne mund t'i kushtojë me jetë! Prandaj...

E mbylla derën.

I hutuar, po e shikoja komandantin që kishte zënë vend pranë Kujtimit. Më njëqind pikëpyetje në kokë, që të gjitha të lidhura me vrasjen e Imamit gjatë kohës së përgjimit tim, duke e pritur të hakërryer qortimin e komandantit që ndoshta do të përfundonte me largim nga detyra, suspendim apo... kur me zë të qetë më tha:

– Dëgjo Hilë! Në rrethin tuaj ka ndodhur një grabitje

e dhunshme vajze. Kërkojmë ndihmën tuaj.

– Si the? Grabitje?!

– Po! Dhunshëm është rrëmbyer një vajzë e quajtur Fiti! E njeh?

– Po! E njoh! – thashë i trishtuar dhe me një sëmbim në zemër. – Si ndodhi? – e pyeta pas pak.

– Nuk e dimë as ne. Derisa ishte duke u kthyer në shtëpi nga një shoqe e saj, është rrëmbyer dhunshëm nga një njeri i maskuar. Patrullat e para kanë shkuar në vendngjarje, por akoma nuk i kanë rënë në gjurmë rrëmbyesit! Keni ju ndonjë ide? – më pyeti kureshtar.

– Po! Dyshojë së rrëmbimin mund ta ketë bërë njëri... është folur rreth e rrotull për aferë por... nuk jam i sigurt! – thashë ngadalë e më vështirësi gjatë përpjekjeve për ta mbajtur sekret emrin e Çelit, mbi të cilin e kisha vënë dyshimin më kohë.

– Mirë! Sido që të jetë është mirë të niseni menjëherë, por mos t'ju ndodhë edhe kësaj radhe siç ju ndodhi me Imamin! – më tha me zë ironik.

Ula kokën i turpëruar. Derisa po bëhesha gati të arsyetohesha në çështjen Imami, komandanti tha:

– Pas një inspektimi të shkurtër, duhet të ktheheni prapë për të vazhduar përgjimin e mjekroshëve... ku na u gjendën edhe këto raste tani?

Kur vetura doli nga qyteti dhe hyri në magjistrale duke marrë shpejtësinë tetëdhjetë, si pa dashje me doli një psherëtimë. As vetë nuk po e kuptoja së kush isha, ku ndodhesha, ku po shkoja... Koka m'u kishte bërë lëmsh! Në njërën anë, akoma po vazhdonte të më brente tronditja nga vrasja e befasishme e Imamit, pastaj plani i shpalosur i të riut elegant dhe në fund rrëmbimi i Fitit! Vallë, ç'janë

këto mbrapshti ogurzeza që po më përcjellin që nga dita e parë e detyrës së re?

– A e keni gjithmonë kështu?

– Si?

– Vrasje, rrëmbime, dhunime?... – e pyeta Kujtimin duke u përpjekur për t'ia parë fytyrën brenda mugëtirës së kabinës!

– Vjedhje, plaçkitje, dhunë në familje... gjëra që ndodhin, por jo gjithmonë kaq shpesh! Edhe për mua këto krime të shpeshtuara janë të befasishme. Mendoj së kësaj radhe jemi duke u përballur më vrasës apo dhunues serik!

– Ashtu me bëhet edhe mua!

– Ke ndonjë ide?

– Për çka? – e pyeta i hutuar, me vështrimin e ngulur andej nga rruga.

Ndërkohë, kur pashë së vetura, me shpejtësi marramendëse po futej në katund duke kaluar pranë shtëpisë së braktisur, në çast pata një parandjenjë turbulluese të përzier me frikë e dyshim bashkë. Me shpejtësi marramendëse, nëpër mendje mu shfaq mëngjesi i kaluar, kur kisha parë regëtimë drite dhe pastaj atë veturë të frikshme që kishte dalë nga oborri i saj!

– Ndale veturën! – e urdhërova prerë Kujtimin.

– Pse? – me pyeti i çuditur, derisa ishte duke frenuar lehtë.

– T'ia bëjmë një kontroll kësaj shtëpie.

– Cilës?

– Asaj që sapo e lamë pas... është një shtëpi e braktisur...

– E pastaj? – me pyeti duke e kthyer kokën nga unë.

– Dje në mëngjes, pa zbardhë drita, derisa po udhëtoja

këmbë drejt stacionit të autobusëve, pashë një veturë që doli nga oborri i kësaj shtëpie! Kjo më bëri të dyshoj së dikush është duke e shfrytëzuar këtë shtëpi të braktisur për punë të dyshimta, për kontrabandë apo... kthehu prapa të lutem dhe futu në oborrin e saj... mundësisht me fare të fikura!

– Ke frikë? – më pyeti disi me zë ironik.

Asnjëherë nuk e kisha dëgjuar Kujtimin të fliste në këtë mënyrë. Prapë mendja më shkoi të Imami dhe vrasja e tij gjatë përgjimit tim! Thellë në shpirt ndjeva së kjo ngjarje e rëndë do të ma nxirosë karrierën time të porsa filluar deri në shkatërrim!

– Jo, nuk kam frikë, por e them për shkak të taktikës!

Kujtimi u tregua më i zgjuar së unë. Derisa veture po afrohej drejtë shtëpisë së braktisur, ai e bëri një lak nga ana e kundërt dhe pas një kthese në një rrugë fushore, me fare të fikur, e fshehu veturën nën degët e një shelgu. Pasi e fiku motorin, në qetësinë më të madhe dolëm jashtë. Pa fol asnjë fjalë morëm drejt shtëpisë së braktisur.

Hëna po e shndriste paq atë shtëpi fantazmë. Prapë më erdhën në mendje thashethemet që vazhdonin të qarkullonin së në këtë shtëpi, gjatë netëve të ftohta e me shi, mblidhen shpirtrat e të vdekurve dhe bëjnë...

– Ti merre krahun nga e majta dhe dili shtëpisë nga prapa, kurse unë po marr nga e djathta dhe po afrohem pranë dritares së bodrumit! Mirë? – m'i ndërpreu mendimet Kujtimi i cili më pëshpëriti pranë veshit sikur kishte frikë se do ta dëgjonte kush.

Pasi e përlava gjithë hapësirën prapa shtëpisë, zura vend të këndi duke shikuar Kujtimin që po i afrohej dritares së ngushtë të bodrumit. Pas një qëndrimi të palëvizshëm për

disa çaste, ngriti dorën nga unë dhe ma bëri me shenjë që të afrohesha pranë tij.

– Mu bë sikur dëgjova rënkime! Mbaj vesh edhe ti! – më tha me një zë pëshpërime pranë veshit.

Një ndjenjë trishtimi e përzier me frikë nga shpirtrat e të vdekurve ma përshkoi tërë qenien time. I trimëruar që ndodhesha pranë Kujtimit, i cili, sigurisht se nuk i kishte dëgjuar fjalët e përhapura për shpirtra të ligj që ishin dëgjuar vazhdimisht për këtë shtëpi të braktisur, me revole në dorë, të gatshme për zjarr, po afrohej vazhdimisht më pranë dritares së mbyllur me dërrasa. I vura veshin ambientit për rreth së mos po dëgjoj ndonjë zë jashtë lëvizjeve të tij! Ndërkohë, tutje nga rruga, me shpejtësi kaloi një veturë duke lënë prapa një zhurmë të mbytur. Ne u ngjeshëm edhe më shumë prapa murit. Derisa kishim filluar të dilnim në shesh nga streha, m'u bë së dëgjova atë „ë – në " e mbytur që çaste më parë ma kishte përshkruar Kujtimi! Për fat të mirë, „ë – ja" u përsërit edhe njëherë! Kësaj radhe u dëgjua edhe më e theksuar.

Sikur mos të ndodhesha në kërkim të Fitit të gjorë, në këtë vend do të më kishte lëshuar shpirti nga frika e atij rënkimi të padëgjuar ndonjëherë. I trimëruar, dhe më dyshim së ai rënkim vinte pikërisht nga Fiti, i dhashë shenjë Kujtimit të m'i mbronte krahët, kurse unë mora nga dera. Kur u gjenda në hajatin e errët, „ë – ja" u përsërit edhe disa herë. Kjo gjëmë e ngrirë të lente përshtypjen së ishte e vetme në këtë shtëpi fantazmë që të fuste frikën në palcë! Vallë, ç'mund të jetë ai rënkim, gjëmë fantazmash?

Po t'u shfaqën fantazmat nuk ke asnjë shpëtim! Thuhet së ato nuk i shpon thika, nuk i zë plumbi, nuk kapën

dot me dorë, nuk... ndërkohë, në derë u duk një si hije fantazme! Shpejt e mora veten. Ishte Kujtimi. Pasi u siguruam se në hajatin e errët nuk ishte askush përveç nesh, u afruam pranë derës së shkallmuar e të mbërthyer me dërrasa bredhi, që ishte e mbyllur me një dry të madh që varej në mesin e saj si një pagurë në një brez dervishi. Ndërkohë „ë – ja" sa vinte e shpeshtohej duke marrë nuanca të dhembjeve të padurueshme. Nën dritën e elektrikut u vura në siklet për të gjetur diçka sa për ta mposhtë atë dry të pamëshirshëm që po na ndante nga ato gjëmë të dhembshme por edhe të frikshme njëherësh.

Thonë se kur mblidhen shpirtrat e të vdekurve për të bërë orgji... në njërin kënd pashë diçka, si një lloj huni mbështetur për muri. Pa e pasur idenë së ç'mund të ishte, e rrëmbeva... ishte kazmë. Ngadalë, duke e mbajtur shtrëngueshëm ndër duar po i afrohesha drynit. Pasi i bëra me shenjë Kujtimit që të qëndronte në gjendje gatishmëria nga çdo e papritur, me gjithë fuqi e godita drynin me kazmë, i cili, pas një rrapëllime të zymtë ra për tokë duke u zhdukur diku thellë në errësirë. Pasi nuk pati asnjë reagim apo sulm nga ana e brendshme, e hapa derën.

Me shpejtësi marramendëse drita e elektrikut në dorën e Kujtimit e përlau mbarë dhomën. Pastaj, spikata një trup të shtrirë përtokë që nuk po jepte shenja jete. Së pari, vëmendjen ma tërhoqën dy duar të zgjatura drejtë murit dhe në mes tyre një kokë e mbuluar me flokë të shpupurishura. Një trup i brishtë dhe i zgërlaqur, i mbuluar pjesërisht me një batanije të zhubravitur. Dy këmbë të lidhura njëra me tjetrën shtrëngueshëm me litar dhe befas një „ëh" e zgjatur, e dhembshme... pata ndjesinë

së për herë të parë po takohesha me një shtrigë përrallash. „Ë – ja“ e dhembshme e dalë si nga një grykë burie dhe e pasuar nga një lëvizje e mundimshme dhe pa takt më dha të kuptoj se nuk po bëhej fjalë për shtriga përrallash por për një njeri të mjerë... të torturuar, të çnderuar dhe të lidhur frikshëm me litar. Nuk qe e vështirë të kuptohej se pasi e kishte lidhur dikush, dhunshëm e kishte torturuar e çnderuar deri në alivanosje.

I çliruar nga frika e çastit, u afrova pranë dhe ia largova flokët mënjanë. Në dritën e elektrikut pashë fytyrën e saj të gjakosur. Me sy të zgurdulluar sikur po kërkonte ndihmë nga unë dhe prapë „ë – ja“ e mbytur. Vetëm tani vërejta së në gojë kishte të futur një gjësend si fre kali, me ngjyrë të kuqe nga gjaku dhe ashtu e përdredhur mbështillej shtrëngueshëm prapa kresë. Pas disa përpjekjeve të dështuara për t'ia zgjidhë, nxora thikën dhe më kujdes e preva. Duke i fol herë pas here më zë të butë që mos të kishte frikë nga ne, arrita t'ia liroj së pari duart e pastaj edhe këmbët.

Ashtu e sfilitur siç ishte, pata ndjesinë së nuk do t'ju qëndronte as duarve të mia të lehta që përpiqeshin t'ia lehtësonin sado pak dhembjet e plagëve që akoma nuk i kisha vërejtur së ku i kishte. E rraskapitur vari kokën mënjanë. Derisa isha duke bërë përpjekje për t'ia ndreq sado pak kokën mbi një jastëk që kullonte gjak, sa për t'ia lehtësuar frymëmarrjen e vështirësuar, dëgjova zërin e Kujtimit që po i drejtohej dikujt për ndihmë të menjëhershme duke i treguar vendin së ku ndodheshim dhe duke kërkuar përforcime shtesë për këqyrjen e vendit të ngjarjes.

Ndërkohë, derisa po e mbuloja trupin e rënduar të Fitit

me batanijen e gjakosur, tutje nga rruga u dëgjua sirena e alarmit. Pas pak, u panë edhe reflektimet e dritave dhe u dëgjua zhurma e motorit të veturës që ndaloi në oborr.

Kujtim kishte dalë jashtë. Zëri i tij i thekshëm arrinte deri tek unë, kur po i urdhëronte policët të merreshin me ruajtjen e gjurmëve. Një zë i hollë femre, që më erdhi i beftë, duke ma kujtuar vajzën police të mëngjesit të ditës së shkuar atje në komisariat, m'u bë sikur po thoshte dikujt së familjarët ishin lajmëruar më kohë dhe pritet nga çasti në çast të arrijnë jo vetëm ata, por edhe një ekip i pajisur mjekësor!

Ashtu i përhumbur siç isha, ndjeva zërin e qetë të Kujtimit të më thoshte pranë veshit:

– Ikim! Na pret edhe një detyrë e rëndë.

Gjatë rrugës, brenda kabinës së ngrohtë të veturës, u vumë në një bisedë të pafund rreth versioneve hetimore që lidheshin me vrasjet, rrëmbimet dhe përgatitjet për sulme terroriste. Kujtimi ngulte këmbë së ishin raste të ndara dhe të izoluara. Tezën e tij ai e mbështeste në veçantinë e vrasjeve duke thënë se; si vrasja e Hafizit ashtu edhe vrasja e Imamit, ishin të planifikuara nga një dorë tinëzare për qërim hesapesh përbrenda sekteve myslimane që nuk kanë asnjë lidhje me terrorizmin. Kurse rrëmbimi e dhunimi i vajzave janë raste të izoluara që ndodhin edhe në shtetet më demokratike të botës. E sa për sulmin terrorist, që po përgatitej të ndodhë së shpejti, thoshte ai, së rrënjët nuk i ka të feja islame që është njëra nga më të përmbajturat e të gjitha besimeve, por te shërbimet sekrete të vendeve fqinjë që përmes të çarave brenda fesë islame po përpiqen ta njollosin popullin tonë para bote, duke e përdorë besimin islam, si gogol para të tjerëve!

Ngjashëm mendoja edhe unë, por duke i njohur tekat e shokëve të mi të dikurshëm të medresesë, të gjitha ngjarjet sa kishin ndodhur që nga kthimi i Çelit nga Arabia e deri me përgatitjen e sulmit terrorist që ishte në proces e sipër, i lidhja rreth një strumbullari. Edhe pse nuk desha të dilte nga goja ime emri i keqbërësit, lashë të kuptohej së për kë ishte fjala!

Pas një heshtjeje të gjatë, vetura ndaloi fare pranë pirgut të lartë të Sahat-Kullës. Derisa po zbrisnim, mendjen e kisha të germa „A" e planit operativ. Në fytyrën e komandantit, që na u shfaq befas para këmbëve, vëreheshin emocione të tilla kryelartësie thuajse vërtetë ishte në dijeni së si do të përfundonte plani operativ që për ne nuk kishte filluar akoma. Ndërkohë, heshtjen e theu kumbimi i lartë i zërit shqetësues i myezinit.

– Është koha të shpërndahemi, secili në pozicionin dhe detyrën e vetë. Kujtim, ti eja me mua, kurse ti, më tha mua, afrohu fshehurazi pranë xhamisë dhe mbaj nën përgjim lëvizjet e tyre. E qartë?

– Si urdhëro zoti komandant! – ia ktheva në të njëjtën kohë kur ai ishte duke ma kthye shpinën.

Pas një kontrolli të shpejtë rreth e qark, zura vend përballë kangjellave të rrethojës së xhamisë. Në brendi, i ulur në gurin e ftohët pranë çezmës pashë Çelin gërmuq duke marrë abdes. Ndërkohë, as vetë nuk e vërejta se nga mbiu Maksuti, i cili u afrua pranë kangjellave dhe për disa çaste mbeti duke shikuar brenda, pastaj, kur nuk e prisja vërviti shikim këtej nga isha i fshehur unë. Mu bë së më diktoi. U hodha shpejtë tutje nga rrugica matanë duke i zhdukur gjurmët nga pamja e tij.

Gjatë gjithë kohës sa zgjati falja e namazit, nuk bëra gjë

tjetër vetëm se e hulumtova terrenin përreth. I shikova me vëmendje rrugicat, rrethojat e oborreve të shtëpive, i provova dyert e oborreve dhe kopshteve në ishin të mbyllura apo të hapura. I mata me sy lartësitë e mureve rrethuese, nga mund të hidhesha. Bëra skica shtesë se në rast diktimi nga ana e tyre, si dhe nga mund të zhdukëm më lehtë e pa e rrezikuar as veten e as planin.

Nga këndi ku kisha zënë vend, kësaj radhe pashë xhematin kur filluan të dilnin nga xhamia. Aty nga mesi i besimtarëve pashë Çelin, por nga distanca nuk arrita t'ia vëreja shprehjet e fytyrës. Pastaj, pashë Maksutin që më hapa të mëdhenj mori një rreth me të gjerë duke nuhatur çdo skutë. Derisa po çuditesha me sjelljet e tij, prapë mu bë se më diktoi, sepse u nis drejt meje. Sakaq, arrita të futem në një oborr të ngushtë të mbushur përplot me pemë e hardhi të zhveshura. Për t'i humbur gjurmët, menjëherë u hodha mbi mur dhe u shtriva barkas. Kur ai u gjend brenda oborrit dhe po hidhte vështrimin rreth e qark me revole në dorë, u hodha ngadalë nga muri dhe rashë në rrugicë. Pas një vështrimi të rreptë nga dera e oborrit ku ishte duke hulumtuar Maksuti, ika me vrap duke u fshehur në rrugicën tjetër. Të këndi, sa nuk u përplasa me Kujtimin. Derisa po i tregoja së më kishte pikasur Maksuti dhe po më ndiqte, ai më tha:

– Kujdes! Ky konsiderohet më i rrezikshmi i grupit!

– Vërtetë? Po unë nuk e njoh për të tillë! – ia ktheva i çuditur

– Ne e njohim për të tillë! Kemi informacione të sakta për bëmat e tij!

– Interesant! Po andej nga ju si po shkojnë punët?

– Shumë mirë. Kemi arritur t'i arrestojmë po thuaj

gjithë mbështetësit e tyre anësorë, përveç këtij kusari, kurse qendrën e grupit të tyre sa e futëm nën kontroll. Ke kujdes! Ika unë! – më tha me nxitim dhe iku me vrap.

Derisa po ma kthente shpinën Kujtimi, nga mendja nuk po më shqiteshin për asnjë çast fjalët e tij interesante: Është më i rrezikshmi i grupit tha?!... Domethënë, Maksuti qenka më i rrezikshmi? Interesant!

Në çast mu kujtua koha e fëmijërisë! Para mu shfaq Maksuti i dhembshur, me ata veshët e tij vriguj duke vrapuar pas dhive të tij tekanjoze! M'u bë sikur isha të Krojzit, nën hijen e blirit duke luajtur me të guraçokthi. Në lojë ishte këmbëngulës, inatçi dhe hileqar. Kur fitonte, duke kënduar këngën „grith maçok" m'i grithte duart pa pikë mëshire deri në gjakosje. Ishte e vetmja lojë që nuk më shkonte ndoresh, më vonë, më kujtohet që nuk pata pranuar të luaja më me të, duke i thënë së unë jam djalë e nuk loz lojëra çikash! Pastaj filluam të luanim brezahypthi, aty të pusi i kalfët, ku mblidheshin gjithë çunat e katundit. Sa herë që e humbte lojën, ikte i pari duke qarë nga inati. Kurse, në rrafshin e bregut luanim guxhas! Ishte loja më ngatërrestare për ne, sepse ai, më të padrejtë i akuzonte të tjerët për hile, e veçmas mua, pa e parë veten se jo vetëm që bënte hile hapur, por ju binte në qafë të tjerëve me të shara e kërcënime dhe ishte gati t'i godiste me shkopin e guxhes! Pastaj e hidhte shkopin në mënyrë demonstrative dhe ikte pas dhive duke u gajasur si i çmendur, por edhe duke na kërcënuar nga larg. Veçmas, ishte i padurueshëm kur luanim lojën e pehlivanëve, apo atë të gurapeshit. Në këto lojëra ai nuk kishte asnjë shans të fitonte, qoftë edhe njëherë të vetme. Nga inati, gajasej si i marrë dhe ikte tutje!

Vetëm tani, me dyshim, fillova t'i kujtojë disa sulme brutale që brenda një periudhe të gjatë e patën torturuar mbarë katundin. Flitej së një dorë tinëzare i kishte vënë në shënjestër djemtë më të mirë të katundit. Së pari qe goditur për vdekje Coli i Kullurëve. Pastaj Hima nga Lagja e Epërme, e një natë më vonë Hasani nga Lagja e Mullinjve! Pas një pauze të shkurtër, natën vonë kur po kthehesha nga qyteti, aty pranë mullirit të vjetër dikush pas shpinës më pat goditur për vdekje dhe dy javë pas e goditën Xunin e Lulajve. Më së keqi që ndarë Ismajli, i cili vdiq nga plagët e marra. Ndërkohë, u përhapën fjalë së këto sulme i kishte bërë vetë Ismajli. Dikush kishte thënë së pasi ai e kishte sulmuar Maksutin, në përleshje e sipër kishte mbetur vetë i vrarë, gjë që ky i fundit e kishte hedhë poshtë me përbuzje, duke thënë së atë natë ai kishte pas një tronditje tjetër: sipas tij, atë natë ai kishte qenë në mal duke i kërkuar dhitë. Befas ishte ndeshur ballë për ballë me një ari të murrmë. Gjatë përleshjeve me të, kishte marrë disa plagë në trup, por më e dalluara kishte qenë një gungë e madhe në lule të ballit. Ky tregim i tij, i shndërruar pastaj në legjendë, ishte bërë edhe më i besueshëm kur për të kishin shkruar edhe gazetat! Por, as atëherë e as më vonë, askush nuk e vuri në dyshim vërtetësinë e kësaj historie ku për herë të parë në qendër të vëmendjes ishte Maksuti. Sa herë e pata përfytyruar ndeshjen e ariut trup me trup me Maksutin, sa që dikur nuk e ndaja dot se cili ishte ariu e cili Maksuti.

Pak kohë më vonë, Maksuti e kishte pranuar uniformën islame duke ju bashkangjitur grupit selef të vehabinjëve! Thuhej se, që nga ajo kohë ishte bërë shumë i sjellshëm. Rruga e tij e vetme ishte shtëpi xhami, dhe anasjelltas.

Ndërkohë, kur po dëgjoheshin hapat e tij që po më afroheshin prore, e afrova syrin të këndi i murit për të parë... o Zot! Ishte aq afër, sa që nuk pata kohë as të mendoj se ç'duhej bërë në raste të tilla. Kur pashë se nën sqetullën e majtë e mbante shtrëngueshëm revolen, pata përshtypjen së kësaj radhe nuk kisha të bëja me Maksutin e dikurshëm që në raste të tilla acarimesh mes nesh vetëm gajasej si i marrë dhe ikte tutje! Për herë të parë po ndeshesha drejtpërsëdrejti me atë fytyrën e tij të dytë, atë të panjohurën.

Porsa u shfaq te këndi i murit ku isha i fshehur, e godita me grusht në gjoks me sa fuqi që pata. Pashë se e humbi ekuilibrin dhe u përplas për tokë. Revolja i shkau nga dora dhe u plandos në pus. Tamam në kohën kur po mendoja se e mposhta me një lehtësi mahnitëse dhe ai si gjithmonë do të kërkonte shteg se nga do të zhdukej duke u gajasur me atë stilin e tij si prej të marri, ndodhi ajo që nuk e prisja: me fuqinë e një budallai më mbërtheu, së pari nga flokët duke më mbështetur me forcë pas murit e pastaj nga prapa shpine ma rrëmbeu dorën e majtë. Kur po bëhesha gati t'i kundërvihem, e ndjeva se më tërhoqi me gjithë fuqi nga e majta. Ndërkohë, më rrëshqiti këmba dhe sa hapë e mbyll sytë, u gjenda nën peshën e trupit të tij.

U përpoqa të mbushesha frymë, por nuk munda! Desha të lëvizë me forcë, por nuk arrita. Ai më shtrëngonte mbështjellash si trup gjarpri. Nga poshtë, në mollëzën e tij të djathtë pashë një nishan blu! Ndërsa mjekra e tij e zezë herë pas herë, gjatë përleshjeve më guduliste gushën. Tërlemja i kishte shkarë nga koka e rruar zero...

Derisa po vazhdonte të më mbante shtrëngueshëm

nga flokët, i dhashë edhe njëherë trupit për ta mposhtë, por nuk arrita as ta lëvizë nga vendi. Vetëm sa më përmblodhi edhe më shumë duke ma afruar edhe më pranë fytyrën e tij plot lesh dhe duke më shikuar me urrejtje të papërmbajtur me ata sy të tij të fryrë e të kuq gjak! Derisa po i dëgjoja dihatjet e frymëmarrjes së tij të rënduar, mi dha shpejt e shpejt disa shuplaka fytyrës, të cilat, jo vetëm që më befasuan, por edhe më ç'orientuan duke më mbushë me urrejtje të papërmbajtur kundër tij.

Si në ëndërr ndjeva kur po më thoshte më urrejtje, duke ma mbajtur thikën pranë gurmazit, së njëherë i kisha shpëtuar, pastaj po më tregonte më hollësi së si më kishte goditur atëherë duke më kërcënuar së tani do të më therte si dash kurbani!

Befas, e përsëriti atë broçkullën e tij të famshme që pa asnjë shkak e kishte thënë në mejhane një ditë para së të vritej Imami, se „Allahu ia fal atij që do dhe dënon atë që do." Vetëm tani e kam të qartë së kjo thënie nuk ishte gjë tjetër veçse përligjje e epërsisë së tij mbi viktimat!

Derisa po e vështroja legjendën e gjallë që thuhej se një herë e një kohë e kishte mundur edhe ariun në mal, nga i cili nuk kishte shumë dallim, tani po më mbushet mendja se e gjithë ajo mesele paskësh pas qenë e sajuar prej tij vetëm e vetëm për t'i humbur gjurmët e krimeve të tmerrshme që i kishte bërë herë pas here.

Kur ishte duke u gajasur se si do ta dhunonte Zogën time të shtrenjtë, me zë të tulatur e hodha bisedën tek Fiti. Nuk u çudit aspak kur po i thosha se orë më parë e keni dhunuar tmerrësisht. Në vend të arsyes filloi të dërdëllitë deri sa më shkoi mendja se këtë torollak të pandreqshëm duhet fajësuar për vrasjen e saj. Kur i thashë se pse e

kishte vrarë, e pashë se i iku gazi superior që kishte në fytyrë dhe u step duke e mohuar kategorikisht se nuk e kishte vrarë. Shtendosja e çastit, më dha mundësi t'i përdorë taktikat që i kisha mësuar gjatë stërvitjeve. Me një veprim të shpejtë arrita t'ia largoj dorën ku e kishte thikën e vendosur pranë gurmazit tim, duke ia përdredhë qafën me dorën tjetër u gjenda mbi trupin e tij amorf.

Pasi ia nxora thikën nga dora, fillova ta godas grushte fytyrës e nofullave për ta paaftësuar sa të mos ketë mundësi të më kundërvihet prapë, dhe në të njëjtën kohë duke e pyetur së kush fshihet pas tij! Me zë lutës më tregoi, në fillim për Magjistricën e pastaj për profesorin. Pasi e godita prapë më sa më hante dora me tregoi emrin e vërtetë të profesorit!

Kur e pashë së e lëshoi fuqia, e pyeta se përse i kishte bërë gjithë këto krime. Më zë të mekur më tha: Për ta përmbushë misionin e Allahut!

– Ç'farë misioni? – ia ktheva i hakërryer dhe me zë të lartë: – të vrasësh e të plagosësh, të rrëmbesh e të dhunosh vajza, të përgatisësh plane terroriste për të vrarë njerëz të pafajshëm vetëm e vetëm pse të tjerët nuk mendojnë si ti? Kështu thotë Allahu? Kështu thotë Kurani Kelamullah? Kështu thotë feja islame? Vërtetë, Allahu edhe mund t'ia fal mëkatet atij që do dhe ta dënojë atë që do, por kësaj radhe, para se të ketë mëshiruar Allahu, do të mëshirohesh nga drejtësia!

U largova prej tij kur dëgjova zërin e Kujtimit duke më thënë:

– Ja profesori... e arrestuam!

– Këtë e kam takuar disa herë në mejhane!

– Ashtu? E ke njohur më parë?

– Jo! Nuk thashë se e kam njohur por thashë se e kam takuar!

– Aha! Mendova së e ke njohur, sepse nuk po e tregon emrin!

– Emrin e tij sa e tregoi Maksuti. Janko Martinoviq ia thonë! – ju përgjigja shkurt.

Profesori më shikoi i çuditur! Pastaj vështrimin plot urrejtje e hodhi drejt Maksutit i cili akoma qëndronte i shtrirë për tokë.

XHENETI

Më bëhet së tani jam i vdekur. Nuk ndjej dhembje. Shpirti sa ka filluar të ngjitet lartë drejt qiellit. Çuditërisht pas vdekjes, qielli ka marrë formën e gjysmëhënës me ngjyrë jeshile! Kurse për trupin, tani për tani nuk di se çfarë t'ju them. Nuk e kam ndjerë nëse vërtetë është ndarë nga shpirti. As tani nuk e di se ku ndodhet, me mua, apo kërmë në fundin e greminës?

Thuhet se në botën e amshuar njeriu ndahet në dy pjesë: në njërën anë mbetët trupi, e në anën tjetër shpirti. Por, këto thënie më bëhet së nuk janë aspak të vërteta. Këtë ua them me bindje të plotë përderisa po e ndjej praninë e trupit tim edhe gjatë fluturimit tim hyjnor, mes për mes qiellit jeshil!

Pas një pritje të gjatë aty në fundin e thepisur të kreshtave të greminës, pashë Azrailin të vinte drejt meje

me një çantë plot vegla për ç'shpirtëzim. Pasi ma përgjoi frymëmarrjen, më preku lehtë në qafë e gjoks, ma mati pulsin, nxori nga çanta një lloj gypi (nuk më kujtohet forma e ngjyra) dhe ma futi në njërën vrimë të hundës, kurse vrimën tjetër, çuditërisht e mbylli me diçka të butë. Në librat e shpirtrave thuhet së Azraili nuk i ç'shpirtëzon krijesat e Allahut nga gojë të ndyra kur prore mbushën me currila gjaku, por kërkon shtigje tjera, të pastra! Më bëhet se edhe mua, ashtu lehtë e pastër, përmes atij gypi të hollë e të futur në njërën vrimë të hundës, do të ma nxjerrë shpirtin!

Tani ndjehem mirë! E ndjej së ndodhem në një kohë të çuditshme. Në kohëra të shkuara, para së të kisha lindur unë, thuhet se kishte ekzistuar një kohë që nuk kishte pasur as fillim e as mbarim! Edhe tani, pas vdekjes, sikur u ktheva prapë në të njëjtën kohë, aty ku kisha qenë edhe më parë, por kësaj radhe në një trajtë tjetër.

Por, gjëja që po më çuditë më së shumti është së veprimet e Azrailit nuk po përputhen fare me thëniet që janë të shkruara në librat e shpirtrave. Gjatë ç'shpirtëzimit, jo vetëm që nuk e hetova së kur ndodhi, por as nuk ndjeva dhembje të tmerrshme e as nuk klitha trishtueshëm!

Me fytyrë të çiltër e të qeshur, plot nur, si nga drita e një dielli të vogël, pashë engjëllin që më rrëmbeu butësisht mbi flatrat e tij si flaka dhe me ngriti pezull në një qiell të lartë e të bardhë, disi si në formë tabuti. Pasi më vendosi aty, me mbuloi mirë e mirë me re të pambukta dhe pas flatrave të tij po vazhdoja fluturimin drejt qiejve të mëndafshtë me ngjyrë jeshile.

Ndërkohë, po e ndjej me dhembje e trishtim kohën e shkuar, kohën kur isha gjallë! Këtë po e kujtoj me

mallëngjim vetëm tani. Isha më i dalluari në mesin e selifinjëve. Kisha zë të bukur që me admironin të gjithë. Një kohë të gjatë u mora vetëm më përzgjedhje të vullnetarëve në mesin e talebanëve. Oh, sa shije të hollë që kisha! Sa djem të bukur pata përzgjedhur! Pata udhëtuar nga një vend në tjetrin duke kaluar male të blerta me plot reflekse freskuese. Buzë oazave pata takuar tregtarë myslimanë që pushonin në freskun e hijeve të palmave. I pata shikuar karvanët e deveve nëpër shkretëtira dhe isha përdëllyer për kohën e ndritur të profetit. Sa e sa herë pata kaluar bri sarajeve të kalifëve të mëdhenj, pranë oborreve të tyre të blerta e të mbushura plot me pemë e fruta.

Sa butësisht, sikur po dilja nga një ëndërr e bukur, u gjenda mbi ca re të kuqe. Kalova mbi ca fusha të lagështa e të dërmuara nga stuhitë, mbi ca lumenj qumështi, mbi ujëvara mjalti, mbi burime verërash për njerëzit, mbi pallate të argjendta, mbi kodra të zhveshura, mbi shkëmbinj të thepisur që zbardhëllonin nga bora dhe ngricat dhe nga lart i magjepsur po i shikoja së si ato bjeshkë gjigante po e mbanin pezull drejtpeshimin e rrafshët të tokës. Sa e mahnitshme!

Gjatë udhëtimit mijëvjeçar, hasa gjithfarë lloj gjallesash. Pashë shtazë të tmerrshme e gjigante që fluturonin gojëhapur e të lira në qiejt e kaltër. Takova shpezë e insekte që gumëzhinin mbi ca moçale të verdha, mbi ca dete të murrme e liqene të argjendta. Pashë xhind të zemëruar që vëngëronin më urrejtje së ç'bëhej mbidhé. Takova Israfilin me bulçi të fryra që priste urdhrin e Të Madhërishmit për t'i fry surit! Pashë djaj me fytyra të flakta, tmerrësisht të inatosur. Takova demonë kryengritës të përzënë nga

parajsa. Kur po kaloja pranë zjarreve të xhehenemit sa nuk u përplasa me një grup kerubijanesh[82] që i torturonin gjynahqarët e mosbesimtarët në mesin e flakëve trishtuese të ferrit. I tmerruar dhe nën përcjelljen mëshiruese të engjëjve takova Ridvanin[83] në mesin e ruhanijanëve[84] duke i sistemuar shpirtrat e atyre që e kanë fituar parajsën dhe prapa tyre i pashë dritat magjepse të xhenetit dhe lëvizjet e hyrive symëdha... oh, sa të bukura që ishin!

Sa herë që po i kalonim katet e qiejve, engjëlli trokiste lehtë në portë! Pasi i njoftonte së po ngjitej për në qiellin e shtatë me një „shehit të përdëllyer të Allahut," na i hapnin dyert gjigante. Më zërat e tyre melankolik, të padëgjuar në botën e të gjallëve, më lavdëronin për punët e mira që i kisha bërë mbi dhé, për trimëritë dhe luftërat kundër kaurëve dhe myslimanëve të pavërtetë, që më bënin të ngashërehem në vaj duke derdhur lot gëzimi, megjithëse e dija se për të arritur deri në parajsë kisha rrugë edhe disa mijëra vjet.

Meqë ra fjala për zërat, pa hezitim mund t'ju them se ishin zëra melankolik e të mbështjellë me lloj-lloj ngjyrash, që më vinin nga anë të ndryshme të qiejve. Fillonin me uturimë e shndërroheshin në hukamë. Pastaj, merrnin ngjyrë jeshile, që me shtrëngonin të lidhesha ngushtë për botën e të gjallëve. Dëgjoja zëra të shndërruar nga ngjyrëtrëndafili në zë miklues femre, apo nga ngjyrë e zezë në zë të thellë, të rëndë e me jehonë burri.

Kur zërat thërrmoheshin si grimca kristalesh të përthyera në vrushkuj ngjyrash, i frikësuar por edhe

---

82 Engjuj të mëdhenj për ndëshkime dhe tortura
83 Krye engjëlli i xhenetit
84 Engjëj mëshirues të xhenetit

i lumtur e kuptova së tani ndodhesha pranë Tij! I përgjëruar, ndjeva së po më mbulonte të tërin një ngjyrë e kuqe që vezullonte mbi qenien time. Derisa po i mallëngjehesha prore qenësisë së Tij, ngjyra e kuqe ma mbushi shpirtin e po shpërndahej gjithandej horizontit derisa arriti në botën e të gjallëve, duke i mbuluar kaurët, të pafetë dhe hipokritët injorantë! Ishte e kuqe e arrirë, e pakrahasueshme, e bukur dhe e mahnitshme sa që më bëri të derdhi lot gëzimi kur mendoja së fjala e Tij ishte burimi i asaj ngjyre të kuqe gjak, kurse unë, isha vetëm një pikë e vogël në brendinë e saj!

– Murtad! – dëgjova një zë jehone

I hidhëruar tej mase fillova të derdhi lot dëshpërimi. Vetëm tani e kisha të qartë së pas gjithë përpjekjeve mbi dhé, e kisha fituar vetëm epitetin e tradhtarit. Ah, sikur të më bëhej e mundur edhe njëherë të ringjallesha, do të kisha vepruar kompakt urdhrave që dalin nga Kurani Kelamullah!... por kot përpiqet njeriu i shkretë, sepse i Madhërishmi nuk ia falë atij që ka merita por, „...*Ai ia fal atij që do dhe dënon atë që do.*“[85]

Lëvizjet e engjëjve me bënë të kuptoj se për shpirtin tim të mbushur mëkate tradhtish ishte përgatitur një kënd në mesin e dhjetëra e mijëra shpirtrave mëkatarë atje në berzah, për t'u pastruar deri në ditën e gjykimit të madh.

Detyrimisht, dhe nën përcjelljen e engjëjve e nisa fluturimin!

Gjatë fluturimit mijëvjeçar për të arritur në berzah, u ndesha me qiellin e errët. Tani nuk shikoja asgjë. Falë Madhërisë së Tij dhe udhërrëfimit të engjëjve, kalimi

---

85 *Kuran, 2:284*

në këtë pjesë të qiellit me behej secilën herë e më i lehtë. Brenda këtij udhëtimi nuk pashë asgjë të bardhë, asnjë ngjyrë mahnitëse, asnjë djegie flakësh, asnjë rreze të bukur hëne, asnjë xixëllimë yjsh... Çdo gjë përreth ishte e errët, e frikshme e misterioze. E vetmja gjë që më mbante akoma të pathyer dhe më mbronte të mos çmendesha nga frika e trishtimi, ishin zërat. Herë pas here, veshi me zinte zëra të çuditshëm si; përsiatje përpjekjesh për të përcaktuar ca diagnoza gjymtimesh, ca amputime gjymtyrësh që lidheshin me ca ndërhyrje kirurgjike, ca shqyerje muskujsh e thyerje kockash! Këta zëra më vinin të valëzuar, disi si nga një botë tjetër. Pastaj, dëgjoja zëra të përvajshëm nënash, vaje të ngashëryera motrash, gjëmë e përpëlitje nusesh, zëra ngushëllues burrash që kumbonin rëndë-rëndë e të valëzuar si të qullur nga rrebeshe furtunash.

Herë pas here më kishte ngacmuar një zë i ëmbël vajze. Ishte zë i dashur, i njohur, i arrirë, i valëzuar si freski pranverore, i lehtë si petale trëndafili që më guduliste në kujtesë duke kërkuar mbajtjen e një besë të dhënë dikur... Pastaj, dalëngadalë ai zë i këndshëm, shndërrohej në jehona të valëzuara dhe përmes ca hullive të imagjinuara zhdukej tutje në qiellin sterrë të zi. Oh, sa më mungonte ai zë! Si i shtrënguar nga një ngërç i molisur dhe me flatra të thyera, me tërë qenien time vihesha në kërkim të tij. Kur mendoja i kënaqur se më në fund e arrita, befas zhgënjehesha! Dëgjoja ca zëra të ngatërruar, si jehonë vajtimi për ca hoxhallar të vrarë që valëzoheshin përthyeshëm në zëra përpëlitjesh, në vajtime qyqesh, në klithje e përpëlitje vajzash të çnderuara duke u venitur frikshëm derisa zhdukeshin në errësirën e paanë! Ndërsa

unë, nën kujdesin e engjëjve vazhdoja fluturimin për në berzah, duke u betuar së nëse e ndjej edhe njëherë atë zë melankolik, edhe kështu i vdekur siç jam do të përpiqem të dal nga varri për ta mbajtur besën e dhënë...

Të gjitha këto vuajtje mund t'i krahasoja vetëm më ndjenjën përjetuese të një zëri të ndritshëm e mahnitës që gjatë mijëra vjetësh rrugëtimi në gjithësi, shpirti im po e kërkonte me ngulm dhe befas, pasi kishin kaluar disa dhjetëra e mijëra vjet fluturimi në errësirën e paanë, prapë mu shfaq i njëjti zë magjepsës duke ma zgjatur lumturinë edhe për disa shekuj! Më tërë forcën i dhashë trupit të çohesha... mjerisht, isha i vdekur dhe nuk lëviza dot!

Më tërhoqën engjëjt! Më mbajtën, më rrotulluan, më folën më zëra të kulluar... i dëshpëruar dhe i rënduar nga vdekja, vazhdova fluturimin hyjnor.

Kur nuk e prisja fare, në terr të plotë, derisa isha mbi flatrat e engjëjve për të arritur në berzah, pashë kur papritur u shkalafit errësira. Në fillim, sikur pashë që po shembej një mur i errët si nata dhe copëzat e tij, të çara pjesë-pjesë po notonin nën rrezet e një drite të përthyer që valëzohej si mbi sipërfaqen e një liqeni të bardhë. Ndërkohë, po i thosha vetes me ngazëllim; Ja, më në fund arrita në berzah!

Shikimi i turbullt filloi të kristalizohet duke i thithur etshëm ngjyrat mahnitëse brenda një sfondi të ngrirë si heje akujsh. Rreth e qark pashë përthyerje dritash me copëza ngjyrash jeshile që lëviznin të ç'rregullta në një hapësirë si të imagjinuar. Pas pak, të kristalizuar pashë shpirtra profetësh, të gjithë myslimanë, të mbështjellë me kaftanë jeshil që po qëndronin varë mbi kokën time. Derisa po mendoja se si është e mundur që shpirtrat e

tyre jeshil, të ndodhen të pa pastruar në berzah edhe pas kaq shumë shekujsh, njëri prej tyre sikur mu afrua pranë duke më shikuar me sy të mëdhenj, të thellë e të kaltër si qielli pa re. Pastaj, sikur po dëgjoja valëvitje jehonash të dallgëzuara e të mbërthyera në ca zëra të trashë e të thellë kreshnikësh, që po rrëshqisnin tatëpjetë Lugjeve të Verdha si mbi tel lahute:

– Si po ndjehesh pranë...

I ngazëllyer, e ndjeja që po më rritej gëzimi prore dhe rrëketë e lotëve nuk i mbaja dot, kur pranë meje po e shikoja vulën e profetëve që po më pyeste së si po ndjehesha në mesin e shpirtrave të tyre! Por, pasi nga goja nuk nxirja zë, ndjeva ngrohtësinë e lotëve që po më zbrisnin prore tatëpjetë faqeve. Tutje, nga mesi i atyre kaftanëve jeshil dëgjova zërin e dashur që më kishte përcjellë mijëra vjet errësirë, gjatë fluturimit tim hyjnor në qiejt sterrë të zi! Tani isha edhe më i ngazëllyer. Ai zë i ëmbël, i lehtë si flutur, i shtyrë si nga një puhi e lehtë pranvere shpërtheu si gonxhe trëndafili në mesin e kaftanëve jeshil duke m'u shfaqur me gjithë bukurinë mahnitëse dhe si në kaleidoskop, në mesin e qindra e mijëra ngjyrash m'u qartësua pamja e hirshme e Fitit!

Sëmbimi në zemër më dha të kuptoj se trupi im i kalbur dhe i zhdukur thellë diku në një varr të vithisur, që tani për tani as idenë nuk e kisha se ku ndodhej, kishte filluar të shpirtëzohej ashtu siç thuhet në suren Kaf, që është fjalë e ndritur e Allahut; „*...Ne e ngjallëm tokën e vdekur, e kështu do të jetë edhe ringjallja!*“ Ah, sa mirë! Unë po ringjallem! Njerëzimi po ringjallet... bota po zgjohet nga gjumi i amshuar miliona vjeçar! Po rikthehet në jetë çdo krijesë e Tij... ja drita e diellit, cicërima e zogjve, flladi i

pranverës... po i shoh, po i dëgjoj, po i ndjej!

Në fillim, ndjeva të rrahurat ritmike të zemrës. Pas pak e ndjeva frymëmarrjen e rënduar dhe lëvizjen plot dhembje të gjymtyrëve! Derisa po shpërtheja si gonxhe trëndafili për të dalë nga varri po e pyesja veten: A mund të ndodhë ringjallja pa e lëshuar mbi varre Allahu lëngun e trashë e të magjepsur për t'i ngjizur të vdekurit? A mund të ndodhë ringjallja pa jehonën e trishtueshme të surit të Israfilit?... E gjykimi i madh kur do të na bëhet? Asnjë përgjigje nuk më erdhi nga i Madhërishmi, përveç disa brohoritjeve të ngashëryera që me vinin përreth! Rreth e rrotull po shikoja fytyra të magjepsura që po derdhnin lot gëzimi! Vallë janë fytyra njerëzish apo engjëjsh?

– U zgjua, u zgjua...

Vështrimi më iku jashtë nga një dritare e hapur. Pashë natyrën e blertë që kishte shpërthye me lule ngjyra-ngjyra. Tutje, si të ngrirë në një horizont të kaltër pashë gjethe të blerta plepash që tundeshin lehtë nga puhitë e këndshme pranverore. Dëgjova cicërima të gëzuara zogjsh dhe i turbullt, si nga mesi i disa dënesave të përvajshme, shpërtheu një si zë melankolik, që me vinte si zëri shpresëdhënës i Orëve të bardha!

– Në fillim, bëmë ç'është e mundur që t'ia shpëtojmë jetën... pastaj, u ndodhem në një betejë të frikshme e të mundimshme për t'ia shpëtuar gjymtyrët! Edhe këtë, e arritëm disi! Më së shumti na ka munduar agonia e tij e gjatë... por duke e falënderuar zërin e mrekullueshëm të Fitit, e cila pranoi të vinte e t'i fliste më orë të tëra pranë veshit... dhe ja, zëri i saj e zgjoi nga ai gjumë i rëndë... Të lumtë Fiti! E keni shpëtuar një jetë njeriu nga vdekja e sigurt, i cili për t'i shpëtuar disa dhjetëra jetë njerëzish

të pafajshëm pranoi të sakrifikohet vetë! Mirupafshim Fiti! Mirupafshim Abd...

– Çelë ia thonë emrin!... – ndërhyri vrullshëm zëri që më kishte përcjellë mijëra vjet amshim.

– Të uroj shërim sa më të shpejt, Çelë!

Derisa po dëgjoja një zë të ëmbël gruaje t'i fliste dikujt, që i përngjante shumë zërit të dadës Zejnebe, në mendje sikur po më vijëzohej një rënie e tmerrshme drejtë një gremine, një gjëmim i fuqishëm i ngatërruar me ca dhembje të padurueshme dhe pastaj... fluturimi hyjnor...

Ndjeva një valë të ngrohtë lotësh që po më rridhnin tatëpjetë faqeve. Ngrita dorën dhe i fshiva. U mrekullova kur vërejta së po më mungonin leshrat e mjekrës... pastaj ngrita dorën për ta rregulluar tërlemen. Në vend të saj i preka flokët... sa më ishin rritur! Vallë, sa kohë kam qenë i degdisur në fluturimin hyjnor?

U përpoqa të flisja, por nuk kisha zë. U përpoqa të lëvizë... dikush me ndihmoi duke më tërheqë butësisht nga krahët. Me mundim arrita të ulëm në shtrat! Ngrita vështrimin për të parë! Një si dritë e rrumbullakët, si rrezet e hënës që shndrisin brymën e kristaltë, para meje po qëndronte fytyra e buzëqeshur e Fitit. Ia dallova çukat në faqe. Ata sy të kristaltë, sikur po i bënin dritë buzëve të saj të trëndafilta, që po shpërvileshin ngadalë në një buzëqeshje të përvajshme! Pastaj, pashë lot të mëdhenj që ju varën në cepat e syve të saj të shkruar dhe ju vijëzuan tatëpjetë faqeve! Mundimshëm ia zgjata dorën! U afrua më pranë! Tani ia dëgjoja frymëmarrjen, aromën e këndshme të flokëve dhe shtrëngimin e duarve të saj që po më mbështillte në përqafim! Derisa po më lagej faqja nga lotët e saj e dëgjova të më thoshte më ngashërim:

– Jam e çnderuar...

– Shshsh! Mos e thuaj... – ndjeva sikur më doli një zë si nga fundi i bunarit! Pastaj, me zë të përvajshëm i thashë: – ma ke thënë derisa ndodhesha në botën tjetër... Do bëhesh nusja ime? – nuk e di në e pyeta vërtetë, e mendova apo e kujtova nga koha e shkuar.

– Po! Në jetë të jetëve! – ma ktheu me ngashërim duke më shtrënguar në përqafimin e saj të ëmbël.

I porsa dalë nga terri i paanë, si nga fund i gjithësisë, i përndjekur nga copëza të imëta të ëndrrave dhe gjumit të amshuar, i ringjallur me ndjenja të fuqishme përjetimi, ndjeva së zemra po më mbushej me dashuri të pastër, të lirë e të sinqertë... dhe papritur, si përplasje jehonash, në vesh me ushtuan fjalët e moçme të gjyshit tim, ndjesë pastë, kur më thoshte buzë oxhakut: *...qëndroni ashtu siç ju ka krijuar i madhi Zot e mos u tjetërsoni...*

I inkurajuar nga fjalët e dikurshme të gjyshit tim, kësaj radhe nuk ia pata frikën askujt se po bëja mëkat. I lash mënjanë përrallat dhe shajnitë e huaja dhe i tëri u dhashë pas konkretes, pas përjetimit... pas ndjenjave të ëmbla të dashurisë!

M'u bë sikur isha duke vrapuar pllajave të zhveshura. Para meje po vraponte Fiti me ato këmbët e saj të lehta si të drenushës. Prapa, nën puhinë e lehtë të freskut pranveror sikur po i valëviteshin flokët e arratisura, kurse unë sa e arrita...

Dëgjova duartrokitje. Dikush po brohoriste duke thirrur me ngashërim. Dikush po fishkëllente. Rreth e qark kishte lëvizje... kurse unë, mëzi po mbushesha me frymë. Herën e fundit që kisha pasur emocione të tilla kishte qenë ajo ditë pranvere kur pranë kaçubës...

e mbërtheva nga beli drenushën time... Fiiitiiii, sikur dëgjova zërin gumëzhitës si të gjinkallës, të nënës së saj!

E rrotullova vështrimin andej nga Fiti. Njëri cep i buzës së saj sikur lëvizi pak, vetëm pak.

Ishte një buzëqeshje e njohur. E pa tjetërsuar. Origjinale. Ashtu siç ia kishte dhuruar i madhi Zot!... por, megjithatë, ishte vetëm një buzëqeshje. Asgjë më shumë. Vetëm një buzëqeshje që në mua ndryshoi çdo gjë. Rrënoi nënshtrimin tim ndaj të huajës e drejtuar të huajit. Rrënoi kullën e tjetërsimit.

Tani po e pres. Krahëhapur. Sepse Fiti do të vijë. Do të vijë si kjo pranverë që ka filluar t'i shkrijë flokët e tjetërsuara të borës.

Unë do të jem shkrirja e flokut të parë... do të jem dëshmitar i shkrirjes së fjollave të para të tjetërsuara!

Nëntor 2008

Fund

Përmbajtja

PARAARDHËSIT	5
KTHIMI	9
ËNDRRA	25
KUMTI	34
TAKIMI	49
FITI	73
LETRA	93
HAFIZI	101
MAGJISTARI	123
INTERPRETIMI	140
VRASËSI	162
NATA	175
VENDNGJARJA	181
HUTBE	198
DYFYTYRËSIA	238
PIKTURA	254
FOTOGRAFITË	269
IMAMI	301
HETIMET	331
RRËMBIMI	361
DHUNIMI	368
VENDIMI	380
AKSIONI	409
PËRGJIMI	428
XHENETI	449

Muharrem Blakaj
PARAARDHËSIT
Roman

Botues
„KOMBI" (IKDFK)
Prishtinë, 2009

Shtypshkronja:
MASTERPRINT
Prishtinë 2009

Katalogimi në publikim (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-31

BLAKAJ, Muharrem
Paraardhësit : roman / Muharrem Blakaj. - Prishtinë : "Kombi" (IKDFK). - 464 f. ; 21 cm.

[Shënime për autorin] : f.4 64

ISBN 978-9951-563-01-7

Muharrem BLAKAJ lindi më 6 janar 1959 në fshatin Vrellë, komuna e Istogut. Shkollën fillore mbaroi në vendlindje, ndërsa të mesmen ekonomike, tri vite në Pejë, e vitin e katërt, maturën, e përfundoi në Istog në pranverën e vitit 1979. Po atë vit e regjistroi Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë, degën gjuhë dhe letërsi shqipe, mirëpo, për shkak të veprimtarisë patriotike më, 14 dhjetor 1979 burgoset dhe kështu i ndërpriten studimet. Në nëntor të vitit 1986, në burg, me tortura, UDB-ja ia vret vëllanë Xhemailin, të cilin e kishin burgosur për veprimtari politike.

Më 5 shkurt 1987, M. Blakajn përsëri e burgosin, por në mungesë të provave e lirojnë pas tre muajsh. Nga ndjekjet edhe persekutimet e vazhdueshme, në tetor të atij viti detyrohet ta lëshoj Kosovën dhe të kërkoj strehim politik në Zvicër, ku edhe sot jeton bashkë me familjen e tij.

M. Blakaj, shkruan prozë. Sa ishte në Kosovë mblodhi tregimet e tij në një dorëshkrim me titull „Monolog i një komiti," dhe dy novela „Balta me gjak" dhe „Besa" me qëllim botimi. Mirëpo, gjatë bastisjeve të policisë në shtëpinë e tij, të gjitha dorëshkrimet i merren dhe nuk i kthehen asnjëherë.

Në shtypin shqiptar të diasporës në Zvicër, ka publikuar disa tregime, ndërsa në vitin 2004, botoi romanin e parë me titull; «Misioni sekret» në shtëpinë botuese „Rozafa" në Prishtinë, pastaj vazhdoj me romanin «Thesaret e humbura» që u botua nga SHKSH „Mëmëdheu"-ST. Gallen, dhe u shtyp në Prishtinë më 2005. Në vitin 2007 botoi romanin e tretë me radhë «Atentat brenda germës L», po ashtu i botuar nga SHKSH „Mëmëdheu"-ST. Gallen dhe i shtypur në shtypshkronjën "Adea" në Prishtinë.

«Paraardhësit» është romani i tij i katërt.

ISBN 978-9951-563-01-7